

ENVER HOXHA

VEPRA

16

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROK TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE**



ENVER HOXHA

**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH**

ENVER HOXHA

V E L L I M I

16

QERSHOR 1958 – DHJETOR 1958

SHTËPIA BOTUESE «8 NENTORI»
TIRANË, 1973

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN 16

Vëllimi i 16-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin shkrime të periudhës qershor 1958 — dhjetor 1958 ku ndër të tjera hyjnë: Raporti i mbajtur në Plenumin X të KQ të PPSH (20 qershor 1958), Fjala në sesionin I të legjislaturës së katërt të Kuvendit Popullor (21 qershor 1958), Artikulli i botuar në gazetën «Zëri i Popullit»: Revizionizmi modern duhet luftuar pa mëshirë deri në shkatërrimin e tij të plotë teorik e politik (22 qershor 1958), Raporti i mbajtur në Plenumin XI të KQ të PPSH.(3 nëntor 1958), diskutime në mbledhje të Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ të PPSH, biseda, letra, telegrame etj. Disa nga këto shkrime botohen për herë të parë.

Në këto Vepra pasqyrohet vazhdimi i luftës për të vënë në jetë vendimet e Kongresit III të PPSH. Ato bëjnë fjale për vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë si në lëmin e brendshëm ashtu edhe në lëmin e jashtëm. Në lëmin e brendshëm spikat mobilizimi revolucionar i masave punonjëse për realizimin e planit të vitit 1958 që i dha një shtytje të re zhvillimit ekonomik të

vendit. Tejkalimi i planit të prodhimit industrial për vitin 1958 tregoi drejtësinë e orientimit të Partisë për zbulimin dhe shfrytëzimin e rezervave të brendshme. Gjithashtu ishin arritur suksese në rrugën e transformimit socialist të fshatit, në zgjerimin e mëtejshëm të kolektivizimit të bujqësisë si e vetmja rrugë e drejtë për ngritjen dhe përparimin e shpejtë të fshatit, për forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave bujqësore, si dhe për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Shirohej detyra e rritjes së pandërprerë të mirëqenies së masave punonjëse mbi bazën e industrializimit të mëtejshëm të vendit dhe të përparimit të gjithanshëm të bujqësisë.

Partia tërhiqte vëmendjen për forcimin e jetës së brendshme të organizatave të Partisë, për ngritjen e nivelit ideologjik dhe politik të komunistëve, për një punë të vazhdueshme politike me masat, pa të cilat ishte e pamundur zgjidhja me sukses e problemeve ekonomike. Në shkrimet e këtij vëllimi trajtohen dhe probleme të zhvillimit të mëtejshëm të arësimit dhe të kulturës, të përmirësimit të metodës së punës nga organet e Partisë dhe të shtetit, për një ndihmë më të kualifikuar bazës si dhe probleme të forcimit të disiplinës e të ndërgjegjes në punë. Gjithashtu Partia shtronte me të madhe forcimin e vigjilencës revolucionare për mbrojtjen dhe konsolidimin e fitoreve të arritura, për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë sonë nga armiqëtë e jashtëm dhe të brendshëm.

Në lëmin e jashtëm në shkrimet e këtij vëllimi del

në pah qëndrimi konsekuent *internacionalist* i Partisë dhe lufta parimore politike dhe ideologjike kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, pasqyrohet lufta e vendosur dhe konsekiente e Partisë sonë për demaskimin e revizionizmit modern, lufta për ruajtjen e karakterit revolucionar e proletar të Partisë dhe të vijës së suj si dhe për ruajtjen e unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare e në radhë të parë të kampit socialist, mbrojtja e mësimeve të marksizëm-leninizmit mbi rolin udhëheqës të Partisë e të klasës punëtore, mbi diktaturën e proletariatit dhe mbi luftën e klasave.

PPSH ka zhvilluar një luftë parimore të vazhdueshme e të papajtueshme kundër revizionizmit jugosllav, në një kohë kur shumë parti komuniste e punëtore, sidomos PK e BS, në krye të së cilës kishin zënë vend udhëheqësit revisionistë hrushovianë e kishin pushuar një luftë të tillë. PPSH nuk e ndërtpriste luftën kundër revizionizmit jugosllav dhe hidhte poshtë çdo presion që i bëhej për ta ndërpërre këtë luftë, jo vetëm se shikonte që ai vazhdonte të ishte armik i marksizëm-leninizmit dhe një rrezik për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, por edhe sepse luftën kundër tij e quante luftë kundër çdo lloj revizionizmi e sidomos kundër tezave të Kongresit XX të PK të BS.

Luftën kundër revizionizmit modern PPSH e shikonte si një kusht të domosdoshëm për të zhvilluar me sukses luftën kundër imperializmit, veçanërisht imperializmit amerikan, i cili kishte si synim kryesor të mbillte fryshtë e oportunizmit dhe liberalizmit në ven-

det socialiste dhe në lëvizjen komuniste ndërkombe-tare, të dobësonte forcat revolucionare botërore që të prenatiste truallin për asgjësimin e diktaturës së proletariatit dhe të socializmit në BS dhe në vendet e tjera socialiste.

«MBI PIKËPAMJET ANTIMARKSISTE E ANTISO-CIALISTE QË U SHPREHËN EDHE NJË HERË NË KONGRESIN VII TË LIDHJES SË KOMUNISTËVE TË JUGOSLLAVISË E NË PROGRAMIN E SAJ DHE MBI LUFTËN PA KOMPROMIS QË DUHET BËRË PËR DEMASKIMIN E SHKATËRRIMIN POLITIK E TEORIK TË REVIZIONIZMIT MODERN»

Raport i mbajtur në Plenumin X të KQ të PPSH

20 qershor 1958

Komiteti Qendror është në dijeni të të gjitha materialeve të ndryshme që ka botuar shtypi ynë si dhe shtypi i PK të BS, i Partisë Komuniste të Kinës dhe i të gjitha partive të tjera motra mbi veprimtarinë armiqësore, tradhëtare të grupit trockist të udhëheqjes së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Nuk është nevoja të zgjatem këtu e të them se sa e drejtë dhe marksiste-leniniste ka qenë kurdoherë via e Komitetit Qendror dhe e Partisë sonë ndaj këtyre tradhëtarëve. Partia jonë ka qenë vazhdimisht në këmbë kundër tyre, s'është lëkundur asnjëherë ndaj tradhëtarëve të Beogradit dhe i ka luftuar ata pa mëshirë.

Partia jonë e ka të qartë se ç'luftë të pamëshirshme duhet të zhvillojmë ne për demaskimin dhe për shkataerrimin e plotë të revizionizmit modern që udhëhiqet nga grupi tradhëtar i Beogradit.

Nuk është e tepërt që, në dritën e ngjarjeve të fundit, të flasim edhe një herë për trockistët jugosllavë, me gjithëse ne ishim të bindur qind për qind se ata prisnin çastin e favorshëm për të na dëmtuar. Tani neve na duhet të formulojmë se ç'rrezik paraqit revizionizmi i sotëm, d.m.th. punën armiqësore të LKJ si në projekt-programin ashtu edhe në Kongresin VII të tyre.

Dihet se në bazë të situatës së krijuar u muar vendim nga KQ i PK të BS, qysh në 1954, për të përmirësuar marrëdhëni me klikën e Beogradit. Por trockistët jugosllavë edhe pas këtyre përpjekjeve treguan edhe një herë tjeter, akoma më mirë, se ç'ishin.

Udhëheqësit trockistë të Beogradit na ftuan të dërgonim një delegacion për të marrë pjesë në Kongresin VII të LKJ¹. Byroja Politike nuk u shpejtua të jepte përgjegje, për arësy se ne e dimë mirë se ç'janë ata dhe ç'do të bënin. Bile Byroja Politike gjykonte drejt duke menduar se ata do të përfitonin nga situata që kishte krijuar Partia jonë për përmirësimin e marrëdhë-

¹ Kongresi VII i LKJ që u mbajt prej 22-26 prill 1958 në Lublanë aprovoi një program fund e krye antimarksist e revizionist, i cili shërbeu si platforma ideologjike e revizionizmit ndërkombëtar, duke u drejtuar kundër marksizëm-leninizmit e forcave revolucionare në botë dhe kundër dokumentave historike të Moskës të vitit 1957.

nieve për të bërë poshtërsitë e tyre ashtu siç bënë më 1956¹.

Duke mos u shpejtuar në përgjegjen e kësaj ftese, Byroja Politike mendonte të shihte se ç'do të bënин edhe partitë e tjera motra dhe pastaj të vendoste. Po vendimi që do të merrte Partia jonë nuk do të influen-cohej nga ai i partive të tjera motra, sepse edhe Partia jonë ka mendimet e veta dhe mendimi ynë, që në fillim, ishte që të mos merrnim pjesë në Kongresin VII të LKJ. Pastaj, kur u publikua edhe projektprogrami i LKJ, ne vendosëm përfundimisht të mos dërgonim në asnje mënyrë delegacionin edhe sikur partitë e tjera të dërgonin. Mirëpo ashtu sikurse ne, menduan dhe vepruan edhe të gjitha partitë e tjera motra ndaj Kongresit VII të LKJ.

Tani nga të gjitha partitë motra zhvillohet një luftë e ashpër kundër klikës tradhëtare të Beogradit. Edhe Partia jonë po lufton për të mbrojtur pastërtinë revolucionare të marksizëm-leninizmit nga sulmet që bëjnë imperialistët nëpërmjet revisionistëve dhe kryesisht nëpërmjet grupit tradhëtar të LKJ.

Partia jonë, besnikë e marksizëm-leninizmit, së bashku me të gjitha partitë e tjera, ka luftuar, lufton dhe do të luftojë deri në fund për demaskimin e revisionizmit dhe për ruajtjen e pastërtisë ideologjike të Partisë. Me anën e materialeve që janë botuar dhe po

¹ Është fjalë për Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës, për komplotin revisionist të Dali Ndreut e Liri Gegës, për vëprimtarinë armiqësore të Tuk Jakovës, Bedri Spahiut etj.

botohen dhe që edhe më shumë duhet të botohen, Partia ka vënë në dijeni organizatat e Partisë, anëtarët e saj dhe popullin, për luftën që bëjnë partitë komuniste dhe punëtore kundër revizionizmit.

Shfaqja e revizionizmit të sotëm nuk është një gjë e rastit. Ajo është diçka e diktuar nga disa rrëthana historike objektive. Dihet se sot kontradikta themelore është kontradikta midis kampit socialist dhe kampit imperialist, lufta midis socializmit, që po rritet e zhviliohet me shpejtësi, dhe kapitalizmit, që po dobësohet vazhdimisht. Në këtë situatë imperializmi nuk i dorëzon armët. Përkundrazi ai përpinqet me çdo kusht që të pengojë rritjen e forcave të socializmit dhe të zgjatë ekzistencën e vet. Eksperiencia historike ka treguar se përt'ia arritur këtij qëllimi imperializmi përdor dy metoda: a) metodën e dhunës, të shtypjes së lëvizjes revolucionare në vendet kapitaliste me anë të forcës, metodën e diversionit dhe të preqatitjes së hapur të luftës kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të kampit socialist, dhe b) metodën e mashtrimit e të shpifjes, të skllavërimit shpirtëror të masave. Metodën e parë imperializmi e realizon me anën e policisë, të gjyqeve dhe të dikaturës së tij, ndërsa metodën e dytë e realizon me anë të propagandistëve të tij, të ideologëve borgjezë dhe të agjentëve të ndryshëm në radhët e lëvizjes punëtore, siç janë aristokracia punëtore, socialistët e djathtë dhe oportunistët e revizionistët e ndryshëm. Në kohën e sotme, kur idetë e marksizëm-leninizmit janë bërë të masave dhe nën flamurin e tyre popujt po luftojnë me besim për të ardhshmen e tyre, aristokracisë punëtore e socialistëve të djathtë, që vazhdimisht kanë mbajtur

anën e borgjezisë, u ka dalë boja. Ata nuk munden më të mashtrojnë popujt. Kështu, p.sh. askush nuk u beson socialistëve në Francë as laburistëve në Angli. Për këtë arësy roli kryesor për mashtrimin e klasës punëtore dhe të popujve të ndryshëm i është besuar nga imperializmi revizionizmit të sotëm dhe në radhë të parë revizionistëve jugosllavë, që janë qendra e revizionizmit të sotëm. Prandaj ne shohim se sipas udhëzimeve të imperializmit, dhe kryesish të imperializmit amerikan, revisionistët jugosllavë nga dita në ditë po shtojnë aktivitetin e tyre antisocialist, antimarksist e antileninist, që arriti kulmin në Kongresin VII të LKJ.

Bazë ideologjike e revizionizmit të sotëm, pra edhe e revizionizmit jugosllav, janë teoritë e vjetra të revizionizmit të Bernshtajnit, Kautskit etj.; janë teoritë antimarksiste të të gjithë oportunistëve dhe armiqve të socializmit, e trockistëve, buharinistëve, opozitës punëtore etj., janë teoritë false të socialdemokracisë. Kjo shprehet qartë në programin e LKJ. Por revisionistët jugosllavë këto «teori» kërkojnë t'i shesin si marksiste, ata flasin si «marksistë», si «luftëtarë për socializmin», pra, fshehin fytyrën e tyre të vërtetë.

«Dialektika e historisë është e tillë, shkruante Lenini, që fitorja teorike e marksizmit i detyron armiqtë e tij të vishen me petkun e marksistëve »¹.

Revisionistët jugosllavë, për të mashtruar edhe më

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 18, f. 653.

mirë popujt dhe klasën punëtore, e paraqitit vendin e tyre si «socialist», partinë e tyre si «komuniste» etj. Në të vërtetë si është puna? Marksizëm-leninizmi mëson se partitë politike nuk gjykohen nga deklaratat e titujt që i vënë vetes, por nga veprimet e tyre konkrete, nga vendi që zënë në luftën e klasës që zhvillohet midis klasës punëtore dhe borgjezisë, midis socializmit dhe kapitalizmit. Shumë kohë më parë dhe veçanërisht në kohët e fundit gjithë bota po e sheh qartë se shteti jugosllav dhe LKJ në luftën midis dy kampeve objektivisht ka marrë anën e armiqve të socializmit, atë të minimit të partive komuniste e punëtore, atë të shkattërrimit nga brenda të shteteve socialiste (ngjarjet e Hungarisë e provojnë këtë), atë të përçarjes së kampit socialist dhe partive komuniste. Askush nuk mashtrohet nga fakti që në Jugosllavi ka disa forma socialiste, që janë krijuar menjëherë pas çlirimit të vendit, dhe të thotë se gjoja klasa punëtore është në fuqi, se ndërmarrjet janë në duar të punonjësve etj. Të gjitha këto ruhen me qëllim nga udhëheqësit revisionistë jugosllavë. Ato nuk i prishin punë as imperializmit amerikan, sepse në këtë mënyrë titizmi fsheh më mirë fytyrën e tij të vërtetë përparrë botës dhe përparrë vetë popullit jugosllav dhe e ka më lehtë të zhvillojë veprimtarinë e tij armiqësore. Forma nuk e ndryshon përbajtjen. Këtë e tregon vetë realiteti jugosllav: shteti quhet republikë popullore, por politika dhe veprimtaria e tij është kundër popullit, kundër socializmit, është në dobi të borgjezisë imperialiste; ndërmarrjet industriale gjoja vetadministrohen nga punëtorët e jo nga kapitalistët, por kjo nuk pengon që në

treg të veprojnë ligjet kapitaliste të konkurencës dhe të anarkisë në prodhim, të varfërimit të masave, të pasurimit të një pjese të vogël, pra, të lindjes së elementit të ri kapitalist; tokat nuk janë në duar të çifligarëve, por bujqësia zhvillohet mbi bazën e pronës private, kooperativat bujqësore u shkatërruan dhe dihet nga të gjithë se prona e vogël private pjell përditë kapitalizmin. Të gjitha këto tregojnë se Jugosllavia gjendet në fazën e kalimit të plotë në rrugën e zhvillimit kapitalist, të shqelmimit përfundimtar të aspiratave dhe të luftës së popujve jugosllavë për socializmin. Shteti jugosllav objektivisht po kthehet në një shtet borgjez të klasës punëtore dhe LKJ në një parti borgjeze të klasës punëtore, e cila nuk ndërton socializmin, por lufton kundërtij. Këtu shihet qartë se udhëheqja revizioniste jugosllave nuk është gjë tjetër, veçse një bandë e turpshme renegatësh, që ka tradhëtuar socializmin dhe që vepron edhe në dëmin e interesave jetikë të vetë popujve jugosllavë. Këtej del edhe detyra për të gjithë komunistët që të zhvillojnë një luftë të papajtueshme për ta varrosur politikisht dhe teorikisht revizionizmin, si rrezikun kryesor për lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, si agjenturën më të tërbuar të imperializmit e veçanërisht të imperializmit amerikan.

Dihet se udhëheqësit jugosllavë u larguan nga parimet bazë të marksizëm-leninizmit dhe shkanë në pozitat e nacionalizmit borgjez që përpara vitit 1948. Vendi ynë dhe Partia jonë e Punës mbi kurrizin e tyre i provuan në atë kohë vijën dhe qëllimet antimarksiste të udhëheqjes revizioniste jugosllave. Në vitin 1948 në letrat e njoitura të PK të BS dhe në Rezolutën e Byrosë

Informative të partive komuniste e punëtore motra «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave» u kritikuau në mënyrë parimore pikëpamjet antimarksiste e revisioniste të udhëheqjes jugosllave. Me këtë rezolutë u solidarizuan të gjitha partitë komuniste, duke përfshirë edhe Partinë tonë. Kjo kritikë parimore dhe tezat e saja kanë qenë dhe janë plotësisht të drejta dhejeta provoi se ato janë të vlefshme edhe sot. Pas vitit 1948 nga partitë komuniste e punëtore u zhvillua një luftë e ashpër kundër pikëpamjeve revisioniste e armiqësore të udhëheqjes jugosllave.

Nga viti 1954 KQ i PK të BS, me shokun Hrushov në krye, mori iniciativën për të normalizuar marrëdhënet me shtetin jugosllav dhe LKJ.

Por megjithkëtë udhëheqja revisioniste jugosllave jo vetëm që nuk hoqi dorë nga rruga e vjetër, por vazhdoi të futej edhe më thellë në rrugën revisioniste e antimarksiste. Ajo vazhdoi punën e saj minuese kundër vendeve socialiste dhe partive komuniste e punëtore, vazhdoi aktivitetin e saj agjentural kundër kampit të socializmit. Vendi ynë dhe Partia jonë e njohin mirë këtë veprimtari të revolucionistëve jugosllavë kundër Partisë dhe popullit. KQ i Partisë më se një herë i ka vënë në dijeni organizatat e Partisë për këtë. Këtu kemi parasysh rolin armiqësor që luajtën jugosllavët në organizimin e punës antiparti në Konferencën e Tiranës më 1956, përpjekjet e tyre për të organizuar turbullira kundër Partisë dhe kundër pushtetit tonë popullor me anë të elementeve armiq të Partisë e të popullit si Liri Gega, Dali Ndreu etj., nxitja aktive dhe mbështetja që u dhanë armiqve të Partisë dhe të popullit Tuk Jakova e

Bedri Spahiu etj. Partia jonë e Punës, besnikë e mark-sizëm-leninizmit dhe e interesave jetikë të popullit tonë, vigjilente ndaj veprimeve armiqësore që organizoheshin kundër saj e kundër popullit, me vendosmëri i dërmoi këto komplotë dhe nuk lejoi që sado pak të preken vija e interesat e Partisë dhe të popullit. Revisionistët jugosllavë te ne nuk gjetën shesh. Por ata mundën të veprojnë dhe vepruan në Hungari, ku për organizimin e kundërrevolucionit luajtën një rol shumë aktiv. Atje filloi të shfaqet në mënyrë edhe më të hapur roli armiqësor përcarës dhe antisocialist i grupit udhë-heqës të LKJ. Fjalimi i Titos në Pula dhe ai i Kardelit në Skupshtinën e Jugosllavisë në fund të vitit 1956, sulmet e tyre kundër Bashkimit Sovjetik, kundër partive komuniste e punëtore dhe kundër kampit socialist treguan se ata janë armiq të betuar të socializmit dhe që nën maskën e «marksizmit» dhe të «vijës jugosllave të socializmit» veprojnë për llogari dhe sipas udhëzimeve të imperializmit. Partitë komuniste e punëtore i dhanë përgjegjen e merituar në atë kohë kësaj veprimtarie armiqësore të grupit udhëheqës të LKJ.

Me qëllim që edhe një herë t'i jepej mundësia për të ndërruar rrugë, u organizua takimi në Rumani në vitin 1957 midis delegacioneve të PK të BS dhe të LKJ. Por edhe pas këtij takimi jugosllavët vajtën më thellë. Ata nuk pranuan të nënshkruanin Deklaratën e Moskës të partive komuniste e punëtore në nëntor 1957 dhe në prill të 1958-s në Kongresin VII të LKJ, duke sistematizuar më mirë pikëpamjet e tyre revisioniste e anti-marksiste, aprovuan programin e punës së ardhshme, i cili synon të përqajë lëvizjen komuniste e punëtore

ndërkomëtare, të minojë partitë komuniste e punëtore, të mbytë vrullin revolucionar të klasës punëtore, t'i hapë rrugën imperializmit amerikan për t'i skllavëruar popujt e ndryshëm. Në kongres udhëheqësit e LKJ hapur, përpara popullit të tyre dhe popujve të të gjithë botës, përpara syve të të gjithë komunistëve, dolën si renegatë të socializmit, si agjentë e mbrojtës të imperializmit e vëcanërisht të imperializmit amerikan, si armiq të betuar të socializmit, të Bashkimit Sovjetik dhe të kampit të socializmit. Përpjekjet e partive komuniste e punëtore për të kthyer në rrugën e drejtë Jugosllavinë nuk dhanë rezultat, por ato bënë që titizmi ta demaskojë vetëveten përpara mbarë botës. Tani përpara lëvizjes komuniste e punëtore ndërkomëtare del detyra që të demaskohet dhe të luftohet deri në fund revizionizmi jugosllav, që të shkatërrohet ai politikisht e teorikisht si bandë e turpshme renegatësh, si agjenturë që i shërbën imperializmit. Këtë janë duke bërë tani partitë e ndryshme, këtë detyrë ka edhe Partia jonë, besnike e marksizëm-leninizmit. Detyra e të gjithë komunistëve, anëtarë të Partisë së Punës të Shqipërisë, është që, duke demaskuar grupin revizionist të udhëheqësve jugosllavë si armiq të betuar të Partisë e të vendit tonë, si armiq të kampit të socializmit dhe të Bashkimit Sovjetik, si një agjenturë e fëlliqur në shërbim të imperializmit amerikan, të forcojnë vigjilencën revolucionare në radhët e Partisë dhe të popullit kundër çdo propagande e veprimtarie armiqësore, që revizionistët jugosllavë mund të përpiken të zhvillojnë kundër Partisë dhe popullit tonë.

• • •

Dihet se imperialistët i kanë dhënë deri tani Jugosllavisë një ndihmë prej afro 3 miliard dollarësh. Këto para kapitalistët nuk i kanë dhënë kota. Ata kërkojnë edhe shpërblimin përkatës. Këtë shpërblim grapi udhëheqës revizionist i LKJ ia bën imperializmit duke propaganduar kundër socializmit, duke u përpjekur që të minojë vendet socialiste e partitë komuniste. E thamë edhe më parë se rolin e tyre revizionistët jugosllavë e kryejnë edhe duke propaganduar tezat e tyre antimarksiste, të cilat kryesisht u formuluan në programin e LKJ që aprovoi Kongresi i saj VII. Anëtarët e Partisë sonë, nëpërmjet shtypit, janë njohur me këto teza dhe dinë se si duhen luftuar ato, por në këtë raport, për t'i pasur mirë parasysh dhe për të qenë kurdoherë të gatshëm për t'i luftuar, edhe një herë shkurtimisht po ndalemi në disa prej tyre:

1. — Revizionistët jugosllavë mohojnë ekzistencën e dy kampeve të kundërtë, të kampit socialist dhe të kampit imperialist. Ata me qëllim i quajnë ato «bloqe ushtarake» dhe në mënyrë të ulët dhe shpifëse deklarojnë se ndarja e botës në bloqe ushtarake, dhe si pasojë ndarja ekonomike e saj, çshtë shkaktuar nga Bashkimi Sovjetik, i cili gjoja ka ndjekur politikën nga «pozitat e forcës», se Pakti i Atlantikut u krijua si rrjedhim i kësaj politike të Bashkimit Sovjetik. Qëllimi i revizionistëve jugosllavë është që të çorientojnë popujt, që të largojnë vëmendjen e tyre nga armiku i vërtetë i paqes, nga nxitësi dhe organizatori i vërtetë i luftës, që, siç e

di gjithë bota dhe siç mëson marksizëm-leninizmi, éshtë imperializmi dhe në radhë të parë imperializmi amerikan.

2. — Revisionistët jugosllavë deklarojnë se ata ndjekin një politikë të pavarur dhe asnjanëse, se nuk bëjnë pjesë në asnje kamp, se «qëndrojnë mbi bloqet». Në të vërtetë kjo pozitë e Jugosllavisë shpreh në mënyrë më të qartë nacionalizmin borgjez reaksionar të grupit udhëheqës të LKJ dhe, siç e ka vërtetuar koha dhe vetë veprimet e Jugosllavisë, pozita «asnjanëse» e shtetit jugosllav nuk éshtë gjë tjetër veçse një maskë. Në fakt gjithë politika dhe veprimitaria e udhëheqësve të LKJ tregon se ata përditë e më shumë i përshtaten politikës së kampit imperialist, se kjo «pozitë asnjanëse» dhe «qëndrim mbi bloqet» nuk éshtë gjë tjetër veçse mënyra më e mirë, që i intereson edhe imperializmit, për të mbrojtur kampin imperialist dhe për të shpifur e për të luftuar kundër kampit socialist.

3. — Me shpifjet kundër Bashkimit Sovjetik, udhëheqësit revisionistë jugosllavë synojnë të ulin influencën që ka dhe dashurinë e madhe që gjëzon vendi i parë socialist në të gjithë popujt e botës, kërkojnë të ngjallin ndjenjat nacionaliste e shoviniste dhe të përcajnjë kampin socialist. Në të njëjtën kohë ata përpilen të reklamojnë marrëdhëniet që ekzistojnë në botën kapitaliste, të ngrenë në qill «ndihmën» amerikane sipas planit Marshall dhe, duke e pranuar këtë pa rezerva për veten e tyre, t'ua rekomandojnë edhe vendeve të tjera.

4. — Revisionistët jugosllavë e treguan veten si armiq të betuar të të gjitha partive komuniste e punëtore. Duke vepruar si agjenturë e borgjezisë në lëvizjen punë-

tore, ata godasin partitë komuniste dhe shpifin për udhëheqësit e sprovuar marksistë-leninistë të klasës punëtore. Sipas grupit titist, «lëvizja punëtore gjatë këtyre dekadave të fundit nuk ka ecur përpara» dhe partitë komuniste nuk bëjnë një politikë «të pavarur» etj. etj. Grupi udhëheqës i LKJ me këtë përpinqet të mbulojë dhe të zvogëlojë fitoret e mëdha të arritura nga lëvizja komuniste ndërkombëtare, duke filluar që nga Revolucioni i Tetorit, nga revolucionet popullore në vendet e demokracisë popullore në Evropë e në Azi, nga revolucioni i popullit të madh kinez, e deri te shndërrimi i socializmit në një sistem botëror, që përfshin mbi 950 milion njerëz. Revisionistët jugosllavë mbajnë një qëndrim të ulët mendjemadh ndaj partive komuniste të vendeve kapitaliste, të cilat po luftojnë me heroizëm dhe në kushtet e një terrori të madh, me sakrifica e vetëmohim po u qëndrojnë forcave të reaksionit e të fashizmit, po mbrojnë me vendosmëri çështjen e paqes dhe të socializmit.

Si përcarës i lëvizjes komuniste e punëtore, grupi udhëheqës i LKJ, duke zbatuar porositë e borgjezisë imperialiste, kërkon të largojë partitë komuniste nga njëra-tjetra, nga solidariteti internacionalist i tyre, kërkon t'i shkëputë nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Por partitë komuniste të botës, të udhëhequra nga shkenca ngadhnjimtare marksiste-leniniste, forcojnë unitetin e tyre, në të cilin qëndron edhe garancia e fitoreve të ardhshme të socializmit, luftojnë me vendosmëri kundër çdo shmangjeje nga parimet e internacionizmit proletar.

5. — «Teoritë» e revisionistëve jugosllavë mbi ka-

pitalizmin e sotëm, mbi shtetin dhe revolucionin, mbi luftën e klasave dhe partinë, mbi socializmin dhe komunizmin s'janë gjë tjetër, veçse një grumbullim, një gëreshetim i të gjitha «teorive» revisioniste të vjetra dhe të reja, një ringjallje e tezave të atit të oportunizmit Bernshtajnit dhe Kautskit, të oportunistëve të Internacionales së dytë dhe të socialistëve të djathtë të sotëm, të trockistëve dhe të buharinistëve, të cilat janë varrosur me kohë nga marksizëm-leninizmi.

Marksizëm-leninizmi ka treguar se imperializmi është faza e fundit e kapitalizmit. Kjo u vërtetua me triumfin e Revolucionit socialist të Totorit dhe të revolucioneve socialistë në vendet e demokracisë popullore. Mirëpo revisionistët jugosllavë, duke dashur të mbrojnë kapitalizmin, përpilen ta shtrembërojnë në mënyrë trashanike natyrën dhe realitetin e kapitalizmit të sotëm. Ata thonë se brenda në sistemin kapitalist ka lindur «socializmi», sepse sektori shtetëror në ekonominë kapitaliste është «socializëm». Pra, kapitalizmi i sotëm në mënyrë spontane po integrohet në socializëm. Për «socializmin», sipas revisionistëve jugosllavë, janë jo vetëm klasa punëtore, por të gjitha klasat, edhe ata që e kuptojnë se ç'është socializmi, edhe ata që nuk e kuptojnë, edhe ata që e dëshirojnë atë, edhe ata që e urrejnjë. Prandaj nuk qëndron më problemi i revolucionit socialist. Teoria leniniste e revolucionit proletar, thonë ata, «është vjetruar». Këto teza nuk janë të reja. Ato janë marrë nga Kautski, i cili thoshte se do të vijë epoka e ultraimperializmit, ku kapitalizmi vetëvetiu, automatikisht do të shndërrohet në socializëm. Kjo

është teza e «teoricienëve» të socialistëve të djathtë të sotëm etj.

Duke e paraqitur kapitalizmin monopolist shtetëror si «socializëm», revisionistët jugosllavë shtrembërojnë thelbin e shtetit të sotëm kapitalist dhe përpiken ta paraqitin atë sikur nuk është armë në duart e borgjezisë monopoliste, por sikur qëndron mbi klasat. Këtë e bëjnë për të mohuar domosdoshmërinë e vendosjes së dikaturës së proletariatit dhe të shkatërrimit të aparatit shtetëror borgjez.

Sipas të gjitha këtyre pikëpamjeve del se klasa punëtore në vendet kapitaliste nuk duhet të organizohet dhe të luftojë për çlirimin e saj, për socializmin. Po kështu del se nuk është nevoja që ajo të ketë partinë e saj revolucionare marksiste-leniniste, sepse siç e po-hojnë revisionistët jugosllavë, në socializëm të gjunjë edhe partitë borgjeze apo organizata të tilla si sindikatat dhe këtu përfshijnë edhe sindikatat e SHBA që janë reaksionare. Ja deri ku arrijnë revisionistët jugosllavë.

Të gjithë c kuptojnë thelbin dhe qëllimin e këtyre pikëpamjeve antimarksiste, antisocialiste, thellësisht armiqësore për klasën punëtore, të revisionistëve jugosllavë. Si të gjithë agjentët e tjerë në lëvizjen punëtore ata përpiken të skllavërojnë shpirtërisht klasën punëtore, ta largojnë atë nga lufta e vërtetë për socializëm, të mbrojnë e të zgjatin jetën e kapitalizmit. Por klasa punëtore dhe masat e tjera punonjëse në vendet kapitaliste, që e ndjejnë çdo ditë mbi shpatullat e tyre zgjedhën dhe shfrytëzimin imperialist, shtypjen dhe violencën e aparatit shtetëror kapitalist, që i vuajnë mbi kurzin e tyre urinë dhe papunësinë, persekutimet dhe

terrorin, nuk gënjenen lehtë nga përrallat e oportunistëve, të revizionistëve dhe të agjentëve të tjerë të imperializmit. Ato përqafojnë marksizëm-leninizmin dhe shkojnë pas partive komuniste, sepse vetëm këto shprehin interesat rrënjosorë të tyre, i udhëheqin drejt në rrugën revolucionare të çlirimit nga skllavëria kapitaliste.

6. — Përderisa udhëheqësit revizionistë jugosllavë kanë marrë përsipër rolin e mbrojtësit të kapitalizmit, kuptohet se ata nuk mund të mos shpifin dhe të mos sulmojnë diktaturën e proletariatit dhe sistemin socialist të vendeve tona. Diktatura e proletariatit, sipas udhëheqjes jugosllave, të shpie patjetër në burokraci, «kufizon demokracinë», prandaj duhet të hiqet dorë nga ajo, meqë edhe armiqtë e klasës tashmë nuk ekzistojnë, dhe duhet të kalohet në të ashtuquajturën demokraci të drejtëpërdrejtë. Kuptohet se këtë «këshillë» udhëheqësit jugosllavë ua jepin vendeve socialiste, sepse në vendin e tyre ata e forcojnë diktaturën dhe të gjitha organet e saj, por kuptohet, jo në luftë kundër imperializmit dhe armiqve të socializmit, por për të ruajtur sundimin e tyre, për të shtypur kundërshtarët e tyre. Partitë komuniste dhe punëtore të vendeve socialiste janë gjithmonë vigjilente, ato e kanë gjithnjë parasysh eksperiencën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që dërmoi trockistët e buharinistët, të cilët kërkonin gjithashtu dobësimin e diktaturës së proletariatit për t'i hapur rrugën rivendosjes së kapitalizmit. Ato i kanë parasysh mësimet e Leninit të madh se pa diktaturën e fortë dhe të ashpër të proletariatit nuk mund të ndërtohet socializmi. Ato kanë shumë të freskët eksperiencën e Hungarisë, ku dobësimi i dik-

taturës së klasës punëtore vuri në rrezik çështjen e socializmit në Hungari. Prandaj partitë komuniste të vendeve socialiste e forcojnë në mënyrë të gjithanshme shtetin socialist, të gjitha armët e tija. Diktatura e proletariatit, shteti socialist, siguron demokracinë e vërtetë për masat e gjera punonjëse, për popullin dhe shtyp pa mëshirë çdo rezistencë të armiqve të popullit, të armiqve të socializmit. Karakteri me të vërtetë demokratik i pushtetit tonë shihet në të gjitha fitoret tona në frontin e zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës, në përmirësimin e pareshtur të jetës, në pjesëmarrjen e gjerë të vetë punëtorëve dhe të fshatarëve në drejtimin e vendit. Prandaj, pushteti popullor i ka rrënjet thellë në popull dhe gjëzon përkrahjen e plotë të tij. Kjo u tregua në mënyrë të shkëlqyer edhe një herë në vendin tonë me rezultatet e zgjedhjeve për Kuvendin Popullor.

7. — Përsa i përket «demokracisë së drejtëpërdrejtë», për të cilën bëjnë kaq zhurmë revisionistët jugosllavë, çështja është se ata duan të mohojnë rolin ekonomik që duhet të luajë shteti i diktaturës së proletariatit për ndërtimin e socializmit. Sipas grupit udhëheqës të LKJ, shteti socialist nuk duhet të drejtojë ekonominë, nuk duhet ta planifikojë zhvillimin e saj, nuk duhet të kujdeset për investimet apo për sigurimin e maqinerisë e të lëndës të parë, nuk duhet të bëjë shpërndarjen ose të ushtrojë kontroll mbi prodhimin dhe konsumin. Këtë punë, sipas tyre, duhet ta bëjnë çdo ndërmarrje për veten e saj, punëtorët e çdo qendre pune, të cilët bëjnë planin, caktojnë normat, pagat, çmimet etj. Kjo është «demokracia e drejtëpërdrejtë». Këto «këshilla» të revisionistëve jugosllavë kanë për qëllim

të shkaktojnë konfuzion në mendjet e njerëzve, të nxitën çorganizimin e ekonomisë, konkurrencën dhe anarkinë në prodhim, të cilat janë karakteristike për kapitalizmin. Në këtë rrugë është futur vetë Jugosllavia dhe rezultatet tregojnë se kjo është rruga e restaurimit të kapitalizmit.

Me gjithë sasinë e madhe të dollarëve, që revolucionistët jugosllavë kanë marrë nga vendet e kampit imperialist, ekonomia jugosllave në një varg degësh ka qëndruar në vend. Edhe ajo rritje e prodhimit industrial që është bërë në krahasim me paraluftën ka ardhur jo nga rritja e rendimentit në punë, por nga shëimi i numrit të punëtorëve në prodhim. Bujqësia ndodhet në një gjendje shumë të keqe. Në vitin 1956 u prodhuan afro katër milion ton drithë më pak se në vitin 1939. Ndërsa para lufte Jugosllavia eksportonte bereqet, tanj ajo është e detyruar të importojë çdo vit mbi një milion ton drithë. Sipërsaqet e tokave të punueshme pakësohen nga viti në vit. Në vitin 1952 mbctën pa u punuar 358 mijë ha. tokë, kurse në vitin 1956 kjo shifër u rrit deri në 575 mijë ha. Mbi 55 për qind të ekonomive fshatare u mungon inventari bujqësor. Numri i fshatarëve të varfër dhe i fshatarëve të pasur vjen gjithnjë duke u shtuar, gjë që siç dihet është karakteristike për zhvilimin kapitalist të bujqësisë. Në fshatin jugosllav përdoret gjerësish puna me mëditje, shfrytëzohen fshatarët pa tokë ose me pak tokë. Niveli i jetesës së popullit është i ulët. Çmimet e mallrave të konsumit lëvizin sipas dëshirës së ndërmarrjeve tregëtare, të cilat me spekulime të ndryshme synojnë të nxjerrin sa më shumë fitime në kurriz të konsumatorëve. Ja cilat janë frutet

praktike të tradhëtisë së udhëheqësve revizionistë jugosllavë. Ja «rruga jugosllave» e ndërtimit të socializmit.

•
• •

Partia jonë e Punës, duke u qëndruar besnikë mësimmeve të marksizëm-leninizmit, me vendosmëri dhe mbi baza parimore ka luftuar kundër revizionistëve jugosllavë. Qëndrimi parimor dhe i drcjtë i Partisë sonë, vlerësimi real i rrezikut që paraqiste për vendin dhe Partinë tonë grupi udhëheqës i LKJ, vigjilanca revolucionare e komunistëve tanë dhe e Komitetit Qendror kanë bërë që pikëpamjet dhe veprimet armiqësore të revizionistëve jugosllavë të mos kenë asnje fushë veprimi në popullin e Partinë tonë heroike. Kjo i ka gjëzuar miqtë tanë, te të cilët është shtuar simpatia dhe dashuria për Partinë e Punës, kjo i ka xhindosur armiqëtë tanë, revizionistët jugosllavë, të cilët vazhdimisht e kanë pasur dhe e kanë halë në sy popullin dhe Partinë tonë. Edhe në të ardhshmen, duke ruajtur si sytë e ballit pastërtinë e marksizëm-leninizmit, ne do të vazhdojmë të demaskojmë revizionizmin jugosllav dhe do të luftojmë për shkatërrimin e tij politik e teorik deri në fund. Kjo luftë është një detyrë internacionale, që i shërben forcimit të unititetit të kampit tonë socialist me Bashkimin Sovjetik në krye, i shërben çështjes së paqes dhe të socializmit, u shërben edhe vetë interesave të popujve të Jugosllavisë.

Në lidhje me luftën kundër revizionizmit përparrë organizatave të Partisë dalin detyra të rëndësishme.

Komiteti Qendror tërheq vëmendjen e organizatave bazë në detyrat e mëposhtme:

1. — Organizatat e Partisë duhet të punojnë në mënyrë sistematike për ngritjen e nivelit ideologjik të komunistëve, për t'i armatosur ata sa më mirë me shkencën marksiste-leniniste. Vetëm në këtë mënyrë anëtarët e Partisë do të jenë në gjendje plotësisht që të luftojnë jo vetëm në terrenin praktik, po edhe në atë ideologjik kundër veprimtarisë revizioniste të jugosllavëve, për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit dhe për forcimin e çelnikosjen e mëtejshme të unititetit ideologjik të Partisë sonë.

2. — Eksperienca e deritanishme tregon se në planet e revizionistëve jugosllavë për të minuar vendet socialiste dhe partitë komuniste e punëtore lufta kundër vendit e Partisë sonë përbën një nga objektivat kryesore. Këtë tregojnë tentativat e jugosllavëve për të minuar Partinë tonë që gjatë Luftës nacional-çlirimtare, ndërhyrjet e tyre brutale në punët tona të brendshme deri në vitin 1948, të cilat, siç janë në dijeni komunistët dhe populli ynë, synonin në sklavërimin e vendit, në kthimin e Shqipërisë në një republikë të shtatë të Jugosllavisë, në likuidimin e pavarësisë politike dhe ekonomike të vendit tonë. Këtë tregojnë nxitja dhe përkrahja që ata i kanë dhënë tradhëtarit dhe armikut të Partisë e të popullit Koçi Xoxes me shokë, si edhe më vonë aktet e diversionit dhe të spiunazhit, nxitja e elementit antiparti kundër vijës marksiste-leniniste të Partisë sonë, siç e provoi puna armiqësore që u zhvillua në Konferencën e Partisë në Tiranë më 1956, puna agjenturale me armiqëtë e Partisë dhe të popullit Liri

Gega, Dali Ndreu, Tuk Jakova, Bedri Spahiu, Panajot Plaku etj., të cilët, duke zbatuar direktivat e revizionistëve jugosllavë, u përpoqën të godasin prapa shpine Partinë dhe pushtetin tonë popullor, presionet e vazhdueshme dhe propaganda me shtyp e radio kundër Partisë dhe qeverisë sonë popullore etj. etj. Por të gjitha këto tentativa të revizionistëve jugosllavë për të gjunjëzuar Partinë dhe popullin tonë kanë dështuar me turp. Qëndrimi heroik dhe konsekuent marksist-leninist i Partisë sonë të lavdishme, orientimi i drejtë i caktuar nga kongreset e Partisë dhe nga Komiteti Qendror i Partisë sonë, besnikëria e patundur ndaj marksizëm-leninizmit dhe ndaj Bashkimit të madh Sovjetik e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të gjitha këto kanë bërë që puna armiqësore e revizionistëve jugosllavë kundër Partisë e popullit tonë të dërmohet.

Por kjo nuk duhet të vërë në gjumë vigjilencën tonë në të ardhshmen. Shembulli i Hungarisë tregon qartë se armiku është dinak dhe i rrezikshëm. Prandaj është detyra e çdo komunisti, e të gjitha organizatave bazë, që të forcojnë vigjilencën revolucionare, që ta edukojnë edhe popullin në këtë drejtim. Revisionistët jugosllavë do të përpiken edhe në të ardhshmen që ta dëmtojnë Partinë e pushtetin tonë, ata do të kërkojnë të nxitin armiqëtanë të brendshëm, kulakët, ish-diversantët dhe të arratisurit ose bazat e familjet e tyre, elementët anti-parti dhe të përjashtuarit nga Partia për arësy politike etj. Detyra e organizatave bazë të Partisë është që të forcojnë vigjilencën dhe të njohin mirë veprimtarinë që zhvillojnë këta elementë. Në rast se vihen re shenja të një pune armiqësore, komunistët duhet të jenë të

gatshëm për ta demaskuar dhe për ta shkulur atë nga rrënjet. Komunistët duhet të jenë vigjilentë edhe në ruajtjen e unitetit të çelniktë të Partisë sonë, që është gjëja më e shtrenjtë, garancia për fitoret tona të tashme dhe të ardhshme.

3. — Organizatat bazë të Partisë duhet të përmirësojnë punën e tyre për sqarimin politik të masave popullore dhe për demaskimin e plotë të revizionizmit jugosllav. Revisionistët jugosllavë do të përpilen të helmojnë mendjet e njerëzve me propagandën e tyre. Radiot reaksionare, qofshin këto të Perëndimit apo të Jugosllavisë, vazhdimisht në mënyra të ndryshme propagandojnë idetë e revizionizmit, u bëjnë thirrje njerëzve për të ndjekur shembullin jugosllav etj. Komunistët duhet të jenë kurdoherë të gatshëm dhe aktivë për të demaskuar parullat e armikut dhe propagandën e tij armiqësore.

4. — Veçanërisht KQ i Partisë tërheq vëmendjen e organizatave të Partisë për të forcuar më tej punën edukative dhe kujdesin që duhet të tregohet për edukimin e rinisë sonë heroike dhe të intelektualëve tanë. Dihet se armiku synon që me punën e tij të çorientojë rininë, duke nxitur në të shfaqjet e huaja dhe pikëpamjet mikroborgjeze. Po kështu në radhët e intelektualëve armiku kërkon të ngjallë pakënaqësi dhe t'i çorientojë ata, të mbjellë konfuzion ideologjik. Duhet thënë se si rinia jonë, ashtu edhe intelektualët kurdoherë janë treguar patriotë të denjë, besnikë për çështjen e popullit dhe të Partisë, luftëtarë të vendosur kundër armiqve dhe kundër revizionizmit. Organizatat e Partisë megjithkëtë duhet të përmirësojnë edhe më tej punën e tyre, duhet

të qëndrojnë sa më afër këtyre masave dhe të mos nën-vleftësojnë dëmin që mund të sjellë puna e armikut në këto drejtime.

5. — Revisionistët jugosllavë kanë për qëllim të përqajnjë kampin e socializmit dhe të diskreditojnë Bashkimin Sovjetik. Detyra e Partisë sonë është që në të ardhshmen, ashtu si edhe deri tani, të punojmë për të forcuar dashurinë dhe miqësinë tonë të madhe për të gjithë popujt e vendeve të kampit socialist dhe në radhë të parë për Bashkimin e lavdishëm Sovjetik. Organizatat e Partisë duhet të propagandojnë në masat sukseset e vendeve të kampit socialist, që shprehin edhe frutin e marrëdhënieve vëllazërore e të ndihmës reciproke që ata i japid njëri-tjetrit, sukseset e Bashkimit Sovjetik dhe ndihmën që ai u jep vendeve socialiste. Në këtë drejtim duhet të aktivizohet veçanërisht Shoqëria e Miqësisë me Bashkimin Sovjetik. Organizatat e Partisë të marrin masa që këtë vit muaji i miqësisë me Bashkimin Sovjetik të festohet më mirë se çdo herë tjetër.

6. — Duke punuar për zbatimin e detyrave të siperme, organizatat e Partisë të mobilizojnë të gjithë komunistët dhe masat e gjera të punonjësve për zgjidhjen e problemeve ekonomike, për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit në të tëra fushat jo vetëm e forcojnë më shumë atdheun tonë nga çdo pikëpamje, por ato janë shprehja më e mirë e unitetit të popullit tonë, e lidhjes së ngushtë të tij rrëth Partisë, një fitore e qartë e ideve të marksizëm-leninizmit mbi ideologjinë borgjeze dhe revolucioniste. Ato janë një grusht i fortë kundër revizio-

nistëve jugosllavë, të cilët do të dëshironin dobësimin ekonomik të Republikës sonë.

Këto ishin mendimet që Byroja Politike mendon t'ia parashtrojë Komitetit Qendror. Forca e ideve të socializmit është e madhe. Ato po përhapen çdo ditë gjithnjë e më shumë në të katër anët e botës dhe po bëjnë për vete çdo vit me miliona e miliona njerëz dhe fitorja jonë në luftën kundër armiqve të socializmit dhe të komunizmit do të jetë e sigurtë.

*Botuar për herë të parë në
«Dokumenta Kryesore të
PPSH» vëll. III, 1970,
f. 186*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**MBI ZHVILLIMIN E PUNIMEVE TË MBLEDHJES SË
PËRFAQËSUESVE TË PARTIVE KOMUNISTE DHE
PUNËTORE TË VENDEVE SOCIALISTE QË U MBAJT
NË MOSKË NGA 20-24 MAJ 1958**

Nga raporti i mbajtur në Plenumin X të KQ të PPSH

20 qershor 1958

Prej 20 deri më 24 maj 1958 në Moskë zhvilloi punimet mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore të vendeve socialiste.

Në këtë mbledhje u diskutuan çështje që kishin të bënин me koordinimin dhe bashkëpunimin ekonomik akoma më të ngushtë midis vendeve tona. Praktika e deritanishme ka treguar se shumë nga vendimet që janë marrë nga Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke nuk janë zbatuar sa dhe si duhet nga disa vende anëtare. Mbledhja arriti në përfundimin se po të ishin vënë në jetë me përpikëri vendimet e marrura deri tanë, sukseset ekonomike të vendeve tona do të ishin edhe më të mëdha. Prandaj u vendos që këtej e tutje, nga të gjitha vendet pjesëmarrëse, vendimet që do të merren të zbatohen plotësisht dhe hartimi i planeve tona ekonomike të koordinohet më mirë se më parë.

Pjesëmarrësit në mbledhje shtruan edhe nevojën e përmirësimit të punës së Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke dhe të organeve të tij.

Rëndësi pati në këtë mbledhje diskutimi i problemit të çmiveve midis vendeve tonë. Lidhur me këto u ngritën çështjet e mëposhtme:

1. — Për tregëtinë e jashtme ato të përcaktohen duke marrë si bazë të qëndrueshme çmimet që janë krijuar gjatë disa vjetëve, në bazë të çmiveve në tregjet botërore, duke mënjanuar influencën e krizave dhe faktorëve të tjerë me karakter joekonomik që ndikojnë në shkallën e çmiveve në tregjet kapitaliste. Tani atje ka krizë dhe çmimet bien. Prandaj, çmimet tonë nuk duhet të ndikohen nga ato të tregut kapitalist, po duhen marrë për bazë çmimet e disa vjetëve.

2. — Për mallrat e tregëtisë së jashtme çmimet të caktohen, si rregull, për më shumë se një vit, me përashtim të mallrave çmimet e të cilave kanë pësuar ndryshime me rëndësi në tregjet botërore dhe kur janë të bazuara ekonomikisht.

3. — Për të njëjtat mallra, në kushte të barabarta, çmimet të janë të njëlllojta në tregëtinë midis vendeve socialiste, sepse ndodh që një shtet të njëjtin mall në një vend e merr më lirë, në një tjetër më shtrenjtë.

4. — Për disa mallra të rëndësishme për kampintonë dhe disa vende të interesuara, në mënyrë reciproke, mund të caktohen çmime favorizuese për të nxitur zgjerrimin e prodhimit të tyre në vende socialiste të veçanta.

Ne ishim për çmime të barabarta për të njëjtat mallra në vendet socialiste.

Nga të gjitha delegacionet u ngrit çështja mbi

mundësinë që në të ardhshmen vendet socialiste në tregëtinë midis tyre të krijojnë gradualisht sistemin e vet të çmimeve. Prandaj, të gjithë u shprehën dakord për nevojën e studimit të këtij problemi dhe ky studim do të fillojë.

Pala shqiptare, lidhur me pozitën tonë gjeografike, ngriti edhe çështjen e shqyrtimit të llogaritjes së shpenzimeve të transportit për mallrat tona të import-eksportit, si dhe çështjen që çmimet të caktohen nga komisioni i përhershëm i tregëtisë së jashtme dhe të mos mbeten që ato të caktohen nga organizatat ekonomike kur bëhen kontraktimet.

Në mbledhje u diskutua gjithashtu edhe nevoja e një bashkëpunimi më të shpejtë e më të ngushtë tekniko-shkencor midis vendeve tona.

Përsa i përket çështjes së organeve të planifikimit të vendeve tona, nga të gjitha delegacionet u dha një informacion mbi punën e bërë deri tanë për hartimin e projektplaneve perspektive.

Nga ana e Bashkimit Sovjetik dhe e disa vendeve të tjera u ngrit rëndësia e zhvillimit ekonomik të mëtejshëm të vendeve socialiste në bazë të shfrytëzimit të burimeve të tyre natyrale dhe të leverdisshmërisë. Për këtë ka rëndësi të madhe përpunimi i metodave të krahasimit të leverdisshmërisë së prodhimit në ato ose këto vende socialiste, si dhe metodat e krahasimit të leverdisshmërisë ekonomike të investimeve në këto ose ato degë të ekonomisë popullore të vendeve socialiste.

Edhe nga ana jonë mbledhja u informua mbi hartimin e një projektplani 15-vjeçar të zhvillimit të ekonomisë sonë, ku vend të rëndësishëm do të zënë degë

të tilla si industria e naftës, e gazit, e kromit, e bakrit, e hekurit etj. si dhe ngritja e industrisë së plehrave azotike e fosforike. Ne shfaqëm pikëpamjen që vendi ynë të specializohet në prodhimin e ferro-kromit, në cigare dhe në përpunimin e frutave e të perimeve për eksport. Lidhur me zhvillimin perspektiv të ekonomisë së vendit tonë, ne kërkuam që vendet mike të na ndihmojnë me projektet dhe me pajisjet e duhura si dhe me akordimin e kredive të nevojshme për përballimin e investimeve që do të bëjmë. Pala jonë theksoi se me realizimin e këtyre planeve do të arrijmë balancimin në pagesat e tregëtisë së jashtme dhe do të fillojmë nga shlyerja e detyrimeve ndaj miqve. Paralelisht me këto do të përmirësohet mjaft edhe niveli i jetesës së popullit tonë, por natyrisht ky do të jetë edhe atëhere akoma larg nga niveli i jetesës së vendeve të tjera socialiste.

Pastaj shoku Enver foli edhe për një sërë vendimesh që u morën në atë mbledhje si:

Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit tonë ekonomik;

zhvillimi i gjithanshëm i prodhimit të lëndëve të para dhe i materialeve, sidomos i metaleve të zeza e me ngjyra, i prodhimeve kimike, i lëndëve djegëse dhe i prodhimeve bujqësore;

përpunimi i masave praktike në lëmin e bashkëpunimit tekniko-shkencor;

marrëdhëniqet në lëmin e tregëtisë së jashtme të udhëhiqen nga parimi që ato të janë ndihmë për njëri-tjetrin, të leverdisshme dhe të nxitin zhvillimin ekonomik të çdo vendi pjesëmarrës në KNER;

planet perspektive të çdo vendi socialist të përpun-

then edhe me interesat e vendeve të tjera socialiste;

forcimi në tërësi i punës së Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke dhe i organeve të tij vartëse;

shqyrtimi nga Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke i çështjes për ngritjen e mëtejshme të rolit të komisioneve të përherershme në përpunimin e bazave të zhvillimit të degëve të ndryshme të ekonomisë popullore dhe për vënien në jetë të vendimeve që merren;

koordinimi i planit 1961-1965 brenda 6-mujorit të parë të vitit 1959;

koordinimi i planit 1966-1975 brenda vittit 1960;

përpunimi i propozimeve konkrete për zbatimin e vendimeve të kësaj mbledhjeje dhe marrja e masave për përmirësimin e metodës së punës së Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke dhe i organeve të tij.

Këto ishin shkurtimisht disa nga problemet që u diskutuan në këtë mbledhje të rëndësishme të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 28 maj të këtij viti, aprovoi veprimtarinë e delegacionit tonë në mbledhjen e fundit të Moskës dhe i rekomandoi qeverisë të marri të gjitha masat e nevojshme për zbatimin në praktikë të vendimeve të kësaj mbledhjeje.

Lidhur me të gjitha këto probleme, për të kontribuar edhe ne në forcimin e mëtejshëm të punës së Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke, që të jemi të rregullt dhe aktivë në pjesëmarrjen e punës së komi-

sioneve të përherershme dhe të grupeve të ndryshme që na interesojnë, duhen dërguar atje njerëz që t'i përgjigjen detyrës lidhur me specialitetin, si dhe në numrin e nevojshëm, qoftë për të mos mbetur jashtë koordinimit të ndonjë çështjeje, qoftë që të përfitojnë specialistët tanë nga eksperiencia e specialistëve të vendeve të tjera. Atje do të jetë një shkollë e mirë për njerëzit e vendit tonë.

Organet shtetërore përkatëse t'i kushtojnë kujdes të posaçëm preqatitjes në kohë dhe me cilësi të materialeve që kërkohen nga komisioni i përherershëm i Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke dhe nga grupet e tij të punës.

Lidhur me detyrat që na dalin, Komiteti Qendror dhe qeveria të marrin masa për organizimin e shqyrtimit të projektplanit të pesëvjeçarit të tretë dhe për pasqyrimin në të të propozimeve të bazës, për shfrytëzimin sa më të madh të mundësive të brendshme dhe, pa bërë shtesa në planin e ndërtimeve, investimeve dhe importit, të rritet prodhimi dhe të përmirësohen treguesit e ndryshëm tekniko-ekonomikë. Kjo punë të mbarojë brenda vitit 1959. Komisioni i Planit, në bashkëpunim me dikasteret të hartojnë projektplanin përfundimtar, duke pasur parasysh edhe propozimet e bazës dhe t'a paraqitin Byrosë Politike dhe qeverisë për shqyrtim, deri në 3-mujorin e parë të vitit 1960. Gjithashtu brenda vitit 1959 të hartohet edhe projektplani për periudhën 1966-1975 dhe nga fillimi i vitit 1960, pasi të aprovohet nga Komiteti Qendror, t'i dërgohet Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke për të bërë koordinimin me vendet e tjera. Ky është një farë plani pune që ka vendosur

Byroja Politike gjatë shqyrtimit të këtyre problemeve të rëndësishme që duhet t'i dijë edhe Komiteti Qendror.

Ky ishte, shokë, në vija të përgjithshme raporti ynë mbi punimet e mbledhjes së fundit të Moskës. Tani plenumi mund të bëjë vërejtje ose diskutime rrëth këtij raporti.

Plenumi aprovoi njëzëri reportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi këto çështje si dhe aktivitetin e delegacionit të Partisë sonë në mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialistë, që u mbajt në Moskë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga protokolli i mbledhjes së Plenumit X të KQ të PPSH që gjendet
në AQP*

**FJALA E MBAJTUR NË SESIONIN I TË
LEGJISLATURËS SË KATËRT
TË KUVENDIT POPULLOR**

21 qershor 1958

Shokë deputetë,

Më lejoni, t'ju sjell në emër të Partisë sonë dhe të Komitetit të saj Qendror, përshëndetjet më të zjarrta dhe t'ju uroj nga zemra, juve, përfaqësuesve të popullit në Kuvendin Popullor, suksese në punën tuaj të lavidhme.

Gjatë periudhës së legjislaturës së tretë, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe qeveria jonë, kanë punuar me të gjitha forcat për të kryer me nder dhe me sukses detyrat që i kishin ngarkuar popullit, Partia dhe Kuvendi Popullor. Qëllimi kryesor i Partisë dhe i qeverisë sonë ka qenë dhe do të jetë ndërtimi i socializmit në vendin tonë, ngritja gjithnjë e më shumë e nivelit material e kultural të popullit. Partia dhe qeveria kanë punuar për forcimin e pushtetit popullor, për sigurimin dhe zhvillimin e fitoreve të popullit tonë, për mbrojtjen e pavarësisë, të lirisë dhe të sovranitetit të atdheut, për mbrojtjen e paqes në Ballkan dhe në botë.

Vijën e drejtë marksiste-leniniste dhe largpamëse të Partisë sonç e ka vërtetuar dhe po e vërteton çdo ditë e më shumë koha. Populli ynë heroik, i cili ka luftuar me shekuj për lirinë, pavarësinë dhe përparimin, mundi të bëhet zot i fateve të veta, të marrë pushtetin në duart e tija dhe të ndërtojë me sukses socializmin vetëm nën udhëheqjen e Partisë së Punës dhe me ndihmën e Bashkimit të madh Sovjetik. Vendosja e pushtetit të demokracisë popullore, i cili kryen funksionet e dikaturës së proletariatit, është fitorja më e madhe historike e popullit tonë. Duke përqafuar mësimet e urta të Partisë, populli ynë iu përvesh punës për ndërtimin e socialistit, për ta bërë atdheun e tij të bukur, të lumtur dhe të begatshëm.

Gjatë katër vjetëve të legjislaturës së tretë, populli ynë, duke vënë në jetë vendimet historike të Kongresit III të PPSH, ka arritur suksese të rëndësishme në të gjithë sektorët e jetës së tij. Industria jonë është rritur dhe është zgjeruar. Në vitin 1957, volumi i përgjithshëm industrial ishte 64 për qind më i madh se në vitin 1953. Fabrika, uzina dhe hidrocentrale të reja iu shtuan industriisë sonë socialiste, të cilat i shërbejnë përmirësimit të vazhdueshëm të jetës të të gjithë punonjësve. Krahas me ngritjen dhe me zgjerimin e industrisë po rritet e forcohet klasa jonë heroike punëtore që është forca drejtuese e pushtetit tonë të demokracisë popullore.

Bujqësia jonë, dikur e prapambetur dhe primitive, po shkon përpara në rrugën e socializmit. Në saje të kujdesit të vazhdueshëm të Partisë dhe të pushtetit popullor është shtuar sipërfaqja e mbjellë, janë hapur toka të reja, janë bërë dhe po bëhen bonifikime të më-

dha, janë rritur rendimentet e kulturave bujqësore. Një kujdes të veçantë Partia dhe qeveria, gjatë kohëve të fundit, i kanë kushtuar zgjerimit të mekanizimit të punimeve bujqësore. Fshatarësia jonë patriote, duke ndjekur rrugën e treguar nga Partia, po futet në masë në rrugën e kolektivizimit. Më 1 qershor të këtij viti ishin ngritur 1 926 kooperativa bujqësore që përfshijnë më tepër se 72 për qind të sipërfaqes së punueshme të fshatarësisë, si Republikë. Kjo është një kthesë historike në vendin tonë për fitoren e socializmit në fshat.

Rezultate të rëndësishme ka arritur populli ynë edhe në fushën e arësimit dhe të kulturës popullore. Nga një vend i lënë në errësirë nga regjimet antipopullore, Shqipëria është kthyer në një vend që ecën me hapa të shpejtë drejt përparimit të arësimit, kulturës dhe të artit. Gjatë legjislaturës së tretë është rritur në mënyrë të konsiderueshme numri i nxënësve dhe i shkollave fillore, 7-vjeçare e të mesme. Për herë të parë në historinë e popullit tonë u çel Universiteti i parë shtetëror i Tiranës duke u realizuar në këtë mënyrë ëndrra e patriotëve tanë të Rilindjes dhe e gjithë popullit shqiptar. Me mijëra kuadro janë pregatitur gjatë kësaj kohe në kurse e shkolla, brenda dhe jashtë shtetit.

Sukseset që ka arritur populli shqiptar në sektorin e industrisë, të bujqësisë, ndërtimive, tregtisë e komunikacionit, të kulturës dhe të shëndetësisë, kanë bërë qëjeta e masave punonjëse të bëhet më e mirë, më e lumtur dhe më e begatshme. Masat që kanë marrë herë pas here Partia dhe qeveria, siç janë ulja 5 herë e çmimeve gjatë legjislacionit të kaluar, nga e cila popullsia ka përfituar mbi 5 miliard lekë, ngritja e pensioneve dhe e

rrogave të ulëta, zhdukja e plotë e sistemit të triskëtimit, si dhe një sërë masash të tjera favorizuese për fshatarësinë, kanë bërë që niveli material e kultural i popullit të vijë gjithnjë duke u rritur.

Këto fitore të mëdha vendi ynë i ka arritur në saje të mobilizimit të gjithanshëm të klasës sonë punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies, në saje të udhëheqjes së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë.

Një e ardhshme e shkëlqyer, e begatshme dhe më e lumtur e pret popullin tonë. Duke u mbështetur në forcën krijuar, në entuziazmin e masave punonjëse dhe në ndihmën që Bashkimi Sovjetik i dha popullit tonë vitin e kaluar, Plenumi i Komitetit Qendror, që u mbajt në shkurt të këtij viti, i bëri shtesa të rëndësishme planit të dytë pesëvjeçar, të cilat hapin perspektiva edhe më të mëdha për zhvillimin e mëtejshëm me ritme akoma më të shpejta të ekonomisë dhe të kulturës sonë popullore.

Plani perspektiv 15-vjeçar që po pregaritin Partia dhe qeveria jonë, do ta lulëzojë Shqipërinë, do të shtojë begatinë e popullit, do të ndërrojë krejtësisht strukturën e klasave dhe do të bëjë të përfundohet ndërtimi i socialistit në Shqipëri.

Gjatë periudhës së ardhshme ekonomisë sonë popullore do t'i shtohen objekte të reja të shumta si fabrika e pasurimit të bakrit, hidrocentralet e Shkopetit dhe të Bistricës, kombinati ushqimor, një sërë fabrikash e punishtesh të tjera, do të shtohet zhvillimi i mëtejshëm i naftës dhe i mineraleve të tjera. Do të bëhen një sërë bonifikimesh të rëndësishme që do të rritin sipërfaqen e tokës dhe rendimentet e kulturave bujqësore etj.

Rëndësi të madhe për zhvillimin perspektiv ekonomik të vendit tonë, kanë gjithashtu vendimet e mbledhjes së përfaqësuesve të partive dhe të qeverive të vendeve pjesëmarrëse të Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke, që u bë kohët e fundit në Moskë dhe që zhvilloi punimet e veta në fryshtë e bashkëpunimit vëllazëror.

Të gjitha këto perspektiva shtrojnë përpëra Partisë, organeve të pushtetit dhe të gjitha masave të popullit detyra të rëndësishme për zbatimin e të cilave duhet të mobilizohen të gjitha forcat e punonjësve dhe të kuadrove drejtues të Partisë e të shtetit, me qëllim që brenda një kohe sa më të shkurtër ta kthejmë atdheun tonë të dashur në një kopësht të lulëzuar

Gjatë legjislaturës së tretë autoriteti i Republikës Popullore të Shqipërisë është rritur akoma më shumë. Në saje të politikës së drejtë dhe paqësore që kanë ndjekur Partia dhe qeveria. Sot shteti ynë ka lidhje diplomatike dhe marrëdhënie tregtare me shumë vende të Evropës, Azisë dhe Afrikës. Politika e jashtme e Partisë dhe e qeverisë sonë është orientuar dhe do të orientohet si kurdoherë edhe në të ardhshmen, në radhë të parë, në forcimin e mëtejshiën të miqësisë së pathyeshme me Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, me Kinën e madhe Popullore dhe me vendet e tjera të kampit të fuqishëm të socializmit dhe në mbrojtjen e paqes.

Republika Popullore e Shqipërisë është pjesëtare e denjë dhe aktive e kampit të fuqishëm të socializmit. Partia dhe qeveria jonë si kurdoherë do të luftojnë edhe në të ardhshmen që edhe vendi ynë i vogël të japë kontributin e tij modest për forcimin dhe kompaktësinë e

kampit tonë të socializmit. Gjithashtu Partia dhe qeveria jonë, ashtu si deri tani edhe në të ardhshmen, do të luftojnë për miqësinë dhe bashkëpunimin midis popujve dhe veçanërisht me vendet fqinje, për ruajtjen dhe forcimin e çështjes së paqes.

Partia, qeveria dhe populli kanë qenë dhe do të janë kurdoherë vigjilentë kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, kundër intrigave armiqësore të imperializmit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, të cilët i kanë halë në sy sukseset e popullit shqiptar dhe të kampit tonë socialist dhe përpiken me çdo kusht ta pengojnë atë në rrugën e tij për ndërtimin e socializmit dhe të preqatitin një kasaphanë të re botërore. Partia dhe populli ynë do të janë vigjilentë dhe do të luftojnë pa mëshirë deri në fund kundër revizionizmit modern, i cili, sikurse u theksua në mbledhjet e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore që u mbajtën në nëntorin e vitit të kaluar në Moskë, përbën rrezikun kryesor në lëvizjen komuniste punëtore ndërkombëtare dhe që sot përfaqësohet nga grupi udhëheqës i Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë. Populli ynë nuk është gjunjëzuar dhe nuk do të gjunjëzohet kurrë përpara imperializmit dhe këlyshëve të tij që përpiken ta pengojnë atë në rrugën e drejtë të socializmit.

Partia jonë, sikurse dihet, ka mbajtur kurdoherë një qëndrim të papërkulur marksist-leninist kundër veprimtarisë përcarëse, armiqësore e antimarksiste të grupit revizionist dhe renegat të Beogradit. Sado që të mundohen armiqëtë tanë për të na ndarë, Partia jonë do t'i dërmojë si kurdoherë përpjekjet e tyre dhe nuk do të kursejë asgjë për të çelnikosur kurdoherë më shumë

miqësinë e përjetshme dhe dashurinë e pakufishme të popullit tonë ndaj popujve të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjerë vëllezër të kampit të socializmit dhe do t'i qëndrojë besnike përjetë marksizëm-leninizmit. Partia jonë do të punojë pa u lodhur për çelnikosjen e unitetit dhe për ruajtjen e pastërtisë ideologjike të radhëve të saja, për unitetin moral e politik të popullit tonë rrëth Frontit Demokratik të udhëhequr nga Partia e asnje propagandë ose manevr e imperialistëve dhe e revizionistëve nuk mund ta dobësojnë unitetin e çelniktë të Partisë dhe të popullit tonë.

Të dashur shokë,

Komiteti Qendror i Partisë, duke u udhëhequr nga mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, ka pasur gjithmonë parasysh forcimin gjithnjë e më shumë të rolit udhëheqës të Partisë në të gjithë jetën e vendit dhe me pjekurinë e drejtësinë e vijës së saj ajo ka fituar besimin e plotë të të gjitha masave punonjëse të vendit, gjë të cilën e treguan më së miri rezultatet e shkëlqyera të zgjedhjeve për deputetët e Kuvendit Popullor që u bënë më 1 qershor të këtij viti. I gjithë populli, me një entuziazëm të madh, shkoi në votime dhe votoi si një trup i vetëm për politikën e drejtë të Partisë sonë, për forcimin e Republikës Popullore, për jetën e tij të begatshme, për socializmin dhe paqen.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës, në mbledhjen e tij plenare që u bë këto ditë, më ka ngarkuar që në emër të tij t'i propozoj Kuvendit Popullor që për formimin e Qeverisë së re të Republikës Popullore të Shqipërisë.

përisë, të ngarkojë anëtarin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë, ish-kryetarin e Këshillit të Ministrave, shokun Mehmet Shehu, i cili është një bir i shqar e besnik i Partisë dhe i popullit, një drejtues i palodhur, energjik dhe me talent i Partisë dhe i shtetit tonë.

Ne kemi bindjen e plotë se nën udhëheqjen e Partisë dhe të Komitetit të saj Qendror, qeveria e re, e kryesuar nga shoku Mehmet Shehu, ashtu si deri tani do të punojë pa u lodhur edhe gjatë kësaj legjislature për të vënë në jetë mësimet e Partisë, për të mbrojtur interesat e popullit dhe të atdheut, për të ndërtuar socializmin në atdheun tonë të dashur.

Rroftë populli ynë heroik dhe paqedashës!

Rroftë Partia jonë e lavdishme e Punës!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i Popullit»,
Nr. 148 (3049), 22 qershor 1958*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

REVIZIONIZMI MODERN DUHET LUFTUAR PA MËSHIRE DERI NË SHKATËRRIMIN E TIJ TË PLOTË TEORIK E POLITIK¹

22 qershor 1958

Të gjitha partitë marksiste-leniniste po zhvillojnë një luftë të vendosur kundër revizionistëve jugosllavë, të cilët, me programin dhe Kongresin VII të LKJ, filuan një sulm të ri të poshtër kundër marksizëm-leninizmit, Bashkimit Sovjetik dhe kampit socialist, partive komuniste e punëtore të botës. Kritikës së drejtë e të faktuar të partive marksiste-leniniste, udhëheqësit e LKJ nuk guxojnë t'i përgjigjen drejtpërdrejt për asnjë çështje, por përpiken t'i shpëtojnë asaj me manevra demagogjike dhe me shpifje, duke i akuzuar partitë tonë se ato po kthehen më 1948, se ato po i shtrembojnë pikëpamjet e udhëheqjes së LKJ dhe po godasin këtë «viktimë të pafajshme» pa të drejtë, se ato po ndërhyjnë në punët e brendshme të Jugosllavisë dhe po cënojnë sovranitetin e saj etj. Me këtë gjuhë u shpreh edhe Titua në fjalimin e 15 qershorit, ku ai e tregoi edhe një

¹ Artikull i botuar në gazetën «Zëri i Popullit».

herë veten, ashtu siç ka qenë e vazhdon të jetë, revizionist e tradhëtar i marksizëm-leninizmit, armik i Bashkimit Sovjetik, i Kinës, i vendeve të demokracisë popullore dhe i partive komuniste e punëtore. Ky qëndrim i udhëheqësve të LKJ tregon se në sa pozita false e të dobëta janë ata, se ata nuk kanë ç'të thonë. Ai tregon se udhëheqësit e LKJ, të cilët bëjnë shumë demagogji duke bërtitur se gjoja duan «diskutime ideologjike», i largohen luftës parimore si djalli nga thimjami, ata kanë frikë të nxjerrin fytyrën e tyre të vërtetë para botës e para popujve të Jugosllavisë, ata duan t'u hedhin njerëzve hi syve.

Por me demagogji kaq të lira s'mund të fshihen faktet historike. Dhe faktet historike vërtetojnë se udhëheqësit e LKJ prej shumë kohësh e kanë tradhëtuar marksizëm-leninizmin dhe janë kthyer në një agjenturë të borgjezisë imperialiste për të përhapur konfuzion ideologjik dhe për të helmuar ndërgjegjen e komunisteve e të klasës punëtore, për të shkatërruar nga brenda partitë komuniste dhe shtetet socialiste, për të përçarë kampin e socializmit dhe lëvizjen komuniste ndërkontinentare. Grupi Tito ka një kohë shumë të gjatë që po zhvillon veprimtarinë e tij armiqësore; ai e ka filluar këtë veprimtari para 1948-s dhe e ka vazhduar me vendosmëri pas 1948-s, ai e ka ndjekur këtë rrugë me këmbëngulje edhe pas 1954-s, kur partitë tona bënë përpjekje për të normalizuar marrëdhëniet me Jugosllavinë; ai vepron me të gjitha mjetet në këtë rrugë edhe tani. Sulmi antimarksist e antisocialist që shpërtheu grupi Tito në Kongresin VII të LKJ nuk ishte aspak një gjë e papritur dhe e rastit, por rezultat logjik

i rrugës së tij antimarksiste, të filluar disa vjet më parë, rezultat logjik i veprimtarisë armiqësore që ai po zhvillon prej një kohe shumë të gjatë. Tani, kur udhëheqësit e Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë dhe shtypi jugosllav bërtasin se ata kurrë s'kanë për të hequr dorë nga rruga e tyre dhe se çdo përpjekje për t'i larguar ata nga kjo rrugë është e kotë, ne nuk çuditemi aspak. Revisionistët jugosllavë kanë dhënë shumë «prova» që tregojnë haptas se ata janë armiq të betuar të marksizëm-leninizmit. Partia jonë kurrë nuk ka pasur iluzione lidhur me udhëheqësit e LKJ, sepse ajo e njeh mirë fytyrën e tyre të vërtetë, sepse veprimtaria e tyre antimarksiste ka lënë gjurma gjaku në shpinën e Partisë e të popullit tonë. Nga betimi i revisionistëve jugosllavë për të vazhduar në rrugën e tyre, duket edhe një herë qartë se ata janë të pandreqshëm dhe del vetëm një konkluzion: t'i çirret maska revizionizmit modern dhe të luftohet ai pa mëshirë deri në fund.

Kongresi VII i LKJ dhe programi që adoptoi ai, treguan edhe një herë se revisionistët jugosllavë u kanë shpallur luftë bazave të marksizëm-leninizmit dhe me shumë zell propagandojnë teoritë antimarksiste, me qëllim që partitë komuniste të bien në llumin oportunist e trockist dhe të heqin dorë nga teoria revolucionare, që lëvizja komuniste të mbetet pa busull, pa far ndriçues. Ata duan të bindin partitë komuniste të heqin dorë nga lufta revolucionare për të përmbysur kapitalin monopolist dhe diktaturën e egër të borgjezisë, të cilat, sipas grüpit Tito, po u shndërrrokan vetë në «socializëm». Ata përpiken të diskreditojnë para masave punonjëse idenë e socializmit duke shpifur pa skrupull kundër

vendeve të tjera socialiste, përpinqen të bindin komunistët dhe popujt tanë që të heqin dorë nga roli udhëheqës i partisë dhe nga diktatura e proletariatit, me qëllim që të sabotojnë ndërtimin e socializmit në vendet tona dhe të na çarmatosin para imperialistëve agresorë e armiqve të brendshëm. Ata shpifin poshtërsisht kundër Bashkimit Sovjetik, duke e akuzuar atë si shkaktar të ngritjes së tensionit, të krijimit të bloqeve ushtarake etj., dhe mbrojnë politikën agresive të imperialistëve amerikanë, ngrënë në qiell planin Marshall, «ndihmën amerikane» etj. Grupi Tito, prej shumë vjetësh po bën vetë ato për të cilat akuzon Bashkimin Sovjetik, po ndërhyjn haptas në punët e brendshme të partive komuniste e të shteteve socialiste, me qëllim që t'i sënkatërrojë ato nga brenda.

Shqipëria është një nga dokumentat më të mira që e vërteton këtë, sepse në asnjë vend tjetër udhëheqësit e LKJ s'kanë ndërhyrë kaq hapur e brutalisht sa në Shqipëri. Qysh para çlirimt e deri sot ata kanë mbajtur kundrejt Partisë dhe shtetit tonë një qëndrim krejt antimarksist e shovinist, ata kanë punuar sistematikisht e me të gjitha mjetet që ta kthejnë Partinë tonë marksiste-leniniste në një parti oportuniste, ta bëjnë Shqipërinë socialiste një provincë të shtetit jugosllav, të shkelin lirinë e pavarësinë që populli ynë i fitoi me kaq gjak. Mjafton të përmendim këtu vetëm disa nga faktet e shumta që e vërtetojnë këtë.

Në prakun e çlirimt të Shqipërisë, para mbledhjes së Plenumit II të Komitetit Qendror të PKSH, të mbajtur në qytetin e çliruar të Beratit, në nëntor të 1944-s, udhëheqja jugosllave dërgoi në Shqipëri një mision të

udhëhequr nga një farë Velimir Stojniç, i cili sipas urdhërave të Titos, organizoi fshehtazi një fraksion shumë të rrezikshëm në kokën e Partisë. Udhëheqja jugosllave u përpoq me çdo mënyrë që ta diskreditonte e ta përmbyste udhëheqjen besnikë të Partisë sonë dhe ta zëvendësonë atë me një bandë oportunistësh e tradhëtarësh si Koçi Xoxe, Sejfulla Malëshova etj. Udhëheqja jugosllave e sulmoi vijën politike të Partisë sonë duke e quajtur të gabuar, megjithëse drejtësia e kësaj vije ishte vërtetuar në zjarrin e Luftës nacional-çlirimtare, e cila atëhere po kurorëzohej me fitoren më të madhe historike të popullit tonë — çlirimin nga pushtuesit fashistë dhe nga reaksiioni i brendshëm; ajo u përpoq që t'i impononte Partisë sonë «vijën jugosllave», e cila mohonte rolin e Bashkimit Sovjetik dhe synonte të na shkëpuste nga ai, kërkonte që Partia dhe populli ynë të shikonin vetëm nga Jugoslavia, mohonte rolin udhëheqës të Partisë, mohonte luftën e klasave dhe i hapte rrugën oportunizmit. Kështu udhëheqja jugosllave mendonte të zhdukte pengesat për nënshtimin e plotë të Partisë e të shtetit tonë të ri. Komploti i titistëve nuk mundi të fitojë plotësish, sepse pjesa e shëndoshë e udhëheqjes, megjithëse nuk e dinin prapaskenën e fshehtë të Beratit, luftonin për të mbrojtur vijën e drejtë të Partisë; por ai disa rezultate i arriti. Komploti i titistëve ishte thika që i futej Partisë sonë në shpinë, mina e parë në themel e pavarësisë së Shqipërisë. Kjo ishte «ndihma» që udhëheqja e LKJ i jepte Partisë sonë të re, kështu i përgjigjej ajo gjakut të partizaneve të dy divizioneve shqiptare që luftonin atëhere krashas me vëllezërit e tyre jugosllavë për të çliruar Jugos-

llavinë. A nuk është i mjaftë edhe vetëm komploti titist në Berat, kjo ndërhyrje brutale dhe e egër në punët e brendshme të një partie dhe të një shteti sovran, për të vërtetuar sa i lashtë është procesi i degjenerimit të revizionistëve jugosllavë? A nuk tregon ai se sa demagogjike është zhurma e revizionistëve jugosllavë për respektimin e barazive e të sovranitetit, për mosndërhyrjen në punët e brendshme etj., zhurmë që ka për qëllim të mbulojë veprimtarinë e tyre shumë të rrezikshme minuese?

Për të rimëkëmbur ekonominë e shkatërruar nga pushtuesit dhe për të ndërtuar socializmin Partia jonë kërkoi ndihmë nga miqtë tanë: nga Bashkimi Sovjetik, nga Jugoslavia që ishte fqinja dhe aleatja jonë, nga vendet e demokracisë popullore. Por udhëheqja jugosllave në marrëdhëniet ekonomike me vendin tonë ndiqte qëllime antimarksiste, kolonialiste, shfrytëzuese. Më 1946 u firmuan me Jugosllavinë konventa ekonomike dhe një sërë protokollesh për koordinimin e planeve, krijimin e shoqërive të përbashkëta, parifikimin e monedhave, unifikimin e çmimeve, heqjen e doganave etj. Këto marrëveshje shkelnin edhe rregullat më elementare të marrëdhënieve midis shteteve sovrane, ato u përdorën nga udhëheqja jugosllave për ta kthyer vendin tonë në një koloni, ato e dëmtuan rëndë ekonominë e vendit tonë. Pala jugosllave nuk bëri investimet që i takonin në shoqëritë e përbashkëta shqiptaro-jugosllave, vetëm merrte fitime nga investimet ekzistuese shqiptare. Parifikimi i monedhës shqiptare me dinarin jugosllav u bë me një zhvleftësim të madh të frangut. shqiptar, duke humbur të paktën 3,5 lekë për çdo frang.

Bashkimi doganor u hapi rrugën organizataave tregëtarëre dhe tregëtarëve privatë jugosllavë për të rjepur rezervat e mallrave në tregun tonë. Shkëmbimi i mallrave në bazë të çmimeve të brendshme e jo të tregut ndërkombëtar na pruri humbje të mëdha, se Jugosllavia merrte nga Shqipëria prodhime bujqësore me çmime të ulëta e na shiste prodhime industriale me çmime shumë të larta. Por kryesorja ishte se me anë të këtyre marrëveshjeve, me anë të koordinimit të planeve, udhëheqja jugosllave synonte që ekonomia jonë të zhvillohej si pjesë e ekonomisë së Jugosllavisë dhe e kondicionuar nga ajo, t'i furnizonte Jugosllavisë lëndë të parë dhe të lihej mënjanë zhvillimi i industrisë në vendin tonë, të sabotohej prodhimi i drithërave dhe ne të vareshim nga Jugosllavia edhe për bukën e gojës. Qëllimi i udhëheqjes jugosllave ishte të shtinte në dorë ekonominë e vendit tonë dhe ta përdorte këtë për të bërë presion mbi ne, që të na thyente dhe të nënshtronte politikisht Partinë dhe shtetin tonë. Puna arriti deri atje sa me insistimin e qeverisë jugosllave u krijua në Tiranë komisioni i koordinimit të planeve i kryesuar nga Kraigeri, komision që qe në të vërtetë qeveri mbi qeverinë e popullit shqiptar. Në një dokument të firmuar nga Kidriç, ish-president i Komisionit të planit të Jugosllavisë, Shqipëria figuron si republika e shtatë e Jugosllavisë. A mundet një parti e vërtetë marksiste-leniniste, një shtet i vërtetë socialist të ndjekë një politikë të tillë kolonialiste e shfrytëzuese si ajo që udhëheqja e LKJ ka ndjekur kundrejt vendit tonë? Një politikë të tillë mund ta ndjekin vetëm socialshovinistët, vetëm ata që e kanë tradhëtuar marksizëm-leninizmin e socia-

lizmin. Politika e udhëheqjes së LKJ i ngjan asaj që ndjekin socialdemokratët e djathtë francezë dhe laburistët anglezë kundrejt kolonive të shteteve të tyre. Dhe me gjithë këto revisionistët jugosllavë duan «t'i mësojnë» vendet e demokracisë populllore si të ndërtojnë marrëdhëniet në mes të tyre.

Por të gjitha përpjekjet e udhëheqësve jugosllavë nuk shkonin lehtë. Komiteti Qendror i Partisë sonë, megjithëse në fillim nuk i kishte të qarta qëllimet e vërteta të udhëheqjes jugosllave, ka bërë shumë vërejtje të drejta lidhur me marrëveshjet ekonomike, ka kërkuar që çështjet të konkretizoheshin, ka kundërshtuar synimet e udhëheqjes jugosllave. Por revisionistët jugosllavë, të ndihmuar nga fraksionistët, i luftuan këto dhe, për të arritur qëllimet e tyre, përdorën të gjitha metodat trëckiste, përqarjen e unitetit të udhëheqjes, shpifjet, intrigat, shantazhet. Misionerët e shumtë jugosllavë, që kishin ardhur në Shqipëri si «delegatë» të Komitetit Qendror të LKJ, diplomatë, si këshilltarë në aparatet e Partisë, në ushtri, sigurim, ekonomi etj., si «teknikë e specialistë», punuan me zell për të zbatuar urdhërat e udhëheqjes jugosllave, përpinqeshin të rekru-tonin agjentë, ndihmonin fraksionistët, përpinqeshin me anë të tyre të shtinin në duart e udhëheqjes jugosllave sektorët më jetikë të Partisë e të shtetit tonë. Në gjashtëmujorin e dytë të 1947-s udhëheqja jugosllave i dërgoi Komitetit Qendror të Partisë sonë dy akuza, dy ultimatumë. Në akuzën e nëntorit 1947 revisionistët jugosllavë e akuzonin Partinë tonë se ajo luftonte për forcimin e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe se, shoku Enver, «pas ardhjes së tij nga Moska, e kishte

ndryshuar politikën karshi Jugosllavisë», se Partia johë gjoja kishte lejuar formimin e një fronti antijugosllav në Shqipëri, se qeveria jonë gjoja po pengonte ndihmën që Jugoslavia do t'i jepte popullit shqiptar, se projektplani pesëvjeçar yni ishte i shtrembër, ireal e autarqik pse e ndante ekonominë tonë nga ajo e Jugosllavisë etj. etj. Kjo ishte ndihma më e madhe që i bëhej fraksionit të krijuar në Berat, i cili vetëm me forcat e tija, pa këtë ndërhyrje brutale nga jashtë, nuk mund të thyente pjesën e shëndoshë të udhëheqjes sonë. Në këtë situatë, me metoda trockiste dhe duke bashkëpunuar në prapaskenë me të deleguarit e Komitetit Qendror të Jugosllavisë, fraksioni i Koçi Xoxes pregetiti Plenumin VIII, i cili u mbajt në shkurt 1948, dhe ishte pas Plenumin II të Beratit grushti më i rëndë që iu dha Partisë sonë, pavarësisë së Shqipërisë. Këtu u godit Sekretari i Përgjithshëm dhe u persekutuan shumë shokë që, bashkë me të, mbronin Partinë; iu hapën portat ndërhyrjes së hapur jugosllave. Dokumentat që ka Komiteti Qendror vërtetojnë se për të realizuar plotësisht qëllimet, Koçi Xoxe i shpejtoi pregetitjet për likuidimin fizik të udhëheqjes sonë me anë të gjyqeve të kurdisura dhe me shpifje të fabrikuara, por ai nuk arriti ta realizonte këtë. Njerëzit jugosllavë dhe miqtë e tyre filluan të flasin haptas për «bashkimin» e Shqipërisë me Jugosllavinë, e quanin Shqipërinë «Republikë të shtatë të Jugosllavisë» dhe fraksioni i Koçi Xoxes e shtroi këtë çështje në Byronë Politike, por s'pati sukses. Më 1948, atëherë kur po afrohej demaskimi i grupit Tito, revisionistët jugosllavë, me qëllim që ta bënin fakt të kryer pushtimin e Shqipërisë nga Jugosllavia,

kërkuan me urgjencë që të vinin në Shqipëri disa divizione jugosllave, gjoja për të mbrojtur vendin tonë nga një agresion i shpejtë i ushtrisë greke. Por udhëheqja e Partisë sonë, me gjithë presionet e udhëheqësve jugosllavë e të fraksionit të Koçi Xoxes, nuk e pranoi këtë. Ky qe një vendim historik, që e shpëtoi popullin tonë nga gjakderdhja. Është e qartë se sikur të mos kishte rezistuar Partia jonë e udhëhequr nga pjesa e shëndoshë e Komitetit Qendror, sikur të mos ishte Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, sikur të mos kishte dalë në kohë Rezoluta e Informbyrosë, pavarësia e Partisë dhe e vendit tonë do të qe varrosur dhe Shqipëria do të qe bërë krahinë e Jugosllavisë. Në dritën e këtyre fakteve del qartë sa pa skrupull janë deklaratat e fundit të Titos, ku ai i paraqit revizionistët jugosllavë si «martirët» që persekuchohen pse «mbrojnë tezat parimore mbi marrëdhëniet e drejta dhe të vërteta midis vendeve socialiste», si heronjtë që po «e shpëtojnë sozializmin nga degjenerimi dhe nga kaosi».

Në dritën e këtyre fakteve, sa absurde na duken neve komunistëve shqiptarë pretendimet e udhëheqjes së LKJ se më 1948 u bë kundrejt tyre një padrejtësi e madhe, se ata s'kishin gabime, por u kritikuan për shkak se ishin të vetmit që i rezistonin revizionimit të marksizëm-leninizmit. Kritikat që partitë komuniste e punëtore i bënë udhëheqjes së LKJ më 1948 ishin plotësisht të drejta dhe të faktuara, sepse kjo udhëheqje me kohë ishte larguar nga marksizëm-leninizmi dhe kishte rënë në pozitat e nacionalizmit borgjez, në pozitat e socialshovinizmit. Këtë e vërtetoi historia: të gjitha tezat e revizionistëve jugosllavë që po luftohen tanë

i kishin nxjerrë brirët që atëherc. Grupi Tito bëri çmos që partitë tona ta quanin Rezolutën e Informbyrosë të 1948-s të padrejtë, me qëllim që të mbuloheshin veprimtaria e tyre armiqësore dhe pikëpamjet e tyre antimarksiste, të dilte sikur ata kishin pasur të drejtë dhe kështu të vinin në gjumë vigjilencën e komunisteve dhe të krijonin mundësi për të zhvilluar më me lehtësi punën e tyre. Revisionistëve jugosllavë u duhej dënim i rezolutës së 1948-s edhe për një qëllim tjetër; ata ishin të vendosur për të vazduar rrugën e tyre antimarksiste dhe kur partitë tona do të detyroheshin ta ridemaskonin këtë, dënimin e rezolutës së 1948-s ata ta përdornin si një armë për të na goditur, duke thënë: «ju po merrni mbrapshë autokritikën tuaj». Por grupi Tito i kishte bërë llogaritë gabim. Partitë tona nuk mund të lejonin kurrë që Rezoluta historike dhe plotësisht e drejtë e 1948-s të hidhej në shportë.

Udhëheqja e LKJ, megjithëse më 1955, për sy e faqë, pranoi të përmirësonte marrëdhëni me vendet tonë, u përpoq, me të gjitha mënyrat që të shfrytëzonte situatën e krijuar për të realizuar planet e saj. Revisionistët jugosllavë e përdorën kritikën që iu bë kultit të Stalinit si një armë për të diskredituar Bashkimin Sovjetik dhe partitë tona. Por Stalini është një revolucionar e marksist i shquar, që ka merita të mëdha në lidhje me mbrojtjen dhe me zhvillimin e teorisë marksiste-leniniste, me triumfin e socializmit në Bashkimin Sovjetik, me fitoren e shkëlqyer të popujve sovjetikë mbi agresorët hitlerianë, me zhvillimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Nën flamurin e «destalinizimit», revisionistët jugosllavë filluan një kryqëzatë të vërtetë për

të goditur marksizëm-leninizmin, për të minuar partitë tona dhe shtetet socialiste, për të përçarë unitetin e kampit socialist. Vetë Titua, sekretar i përgjithshëm i LKJ dhe president i RFPJ, deklaroi haptas se «Jugosllavia nuk guxon të mbyllët në lëvozhgën e saj, por duhet të punojë në të gjitha drejtimet që të triumfojë kursi i ri i filluar në Jugosllavi»¹, dhe bëri thirrje që të rrëzohen udhëheqjet e partive e të shteteve tona. Atëherë kur zhvilloheshin ngjarjet e përgjakshme në Hungari, zëvendësi i sekretariatit për punët e jashtme të RFPJ u tha ambasadorëve përkatës: — «Prisni se këto do të ngjasin edhe në Shqipëri e Bullgari». Të tilla kërcënimë përsëritheshin nga Titua, Kardeli dhe shtypi jugosllav. A nuk janë këto ndërhyrje nga më ciniket në punët tona dhe orvatje e poshtër për të minuar partitë tona nga ata që kaq shumë bërtasin për «rrugët e ndryshme të ndërtimit të socializmit» dhe për «mos-ndërhyrje në punët e brendshme»?

Megjithëse populli ynë kishte pësuar shumë nga ndërhyrjet brutale të udhëheqësve jugosllavë ne deklaruam më 1955 se jemi gati të rifillojmë marrëdhëniet tona mbi baza të reja marksiste-leniniste. Por udhëheqësit e LKJ nuk iu përgjegjën kësaj dhe deshën të vazhdojnë në rrugën e vjetër. Prandaj edhe pas deklaratës së Beogradit², kur grupi Tito tregohej sikur donte të

¹ Nga fjalimi në Pula, janar 1956.

² Është fjalë për deklaratën e përbashkët që u nënshkrua në Beograd më 2 qershor 1955 midis delegacionit qeveritar sovjetik që kryesohej nga N. S. Hrushov dhe delegacionit qeveritar jugosllav të kryesuar nga J. B. Tito.

përmirëson te marrëdhëniet me vendet socialiste, Shqipërinë ata vazhduan ta sulmojnë me kaq tërbim sa edhe reaksionarët habiteshin. Udhëheqësit jugosllavë përdorën të gjitha presionet e shantazhet që ta gjunjëzonin Partinë tonë, që ta bënин të pranonte gabime që s'i kishte bërë dhe ta nxirrte të larë udhëheqjen jugosllave nga gabimet e rënda antimarksiste e shoviniste që kishte bërë kundrejt vendit tonë, që të rehabilitonte kriminelin e tradhëtarin Koçi Xoxe. Por Partia jonë nuk u mposht, sepse ajo është një parti marksiste-leniniste, sepse ajo ka dalë nga një popull që thotë «më mirë vdis në këmbë se sa të rrosh i gjunjëzuar». Udhëheqësit e shtypit jugosllav shpërthyen një fushatë armiqësore të shfrenuar kundër Partisë sonë, duke e paraqitur gjendjen e Shqipërisë si skëterrë, ku mbretëron terrori është varfëria, duke bërë thirrje që të përmbysheshin Partia dhe regjimi i demokracisë popullore, që ata i quanin «stalinistë», duke botuar shpifje dhe karikatura të poshtra për të diskredituar udhëheqësit e Partisë e të shtetit tonë. Nuk është e rastit që gjithë shtypi dhe radiot imperialiste e të emigracionit reaksionar shqiptar i trumbetonin nga të katër anët parullat e shtypit jugosllav dhe kërkonin nga populli ynë që të rrëzonin «socializmin antidekomratik e stalinist» dhe ta zëvendësonin me «socializmin humanitar të tipit të Titos». Udhëheqësit e LKJ u përpdqën të grumbullonin elementët oportunistë, të përjashtuarit nga Partia dhe armiqëtë e Partisë, të prishnin unitetin e Partisë sonë, të ngjallnë popull pakënaqësi ndaj Partisë, të tërhojnë në kopenë e tyre të zgjebosur agjentin e tyre të vjetër të maskuar, tradhëtarin Panajot Plaku etj. U intensifikua

propaganda subversive dhe u organizuan komplotë me elementët antiparti për të minuar Partinë e pushtetit popullor, siç doli qartë nga puna armiqësore e organizuar në Konferencën e Partisë të Tiranës, nga grupi i Liri Gegës e Dali Ndreut, nga grupi i Tuk Jakovës e Bedri Spahiut etj. Komunistët dhe populli ynë me plot të drejtë pyesin: Pse mbahen në Jugosllavi 3000 e ca të arratisur shqiptarë, midis të cilëve shumë kriminelë fashistë? Pse revisionistët jugosllavë përpiken të rekrutojnë informatorë dhe të grumbullojnë informata ushtarake rrëth vendit tonë?

Revisionistët jugosllavë veprojnë jo vetëm kundër Shqipërisë. Ashtu siç kanë deklaruar përfaqësuesit e shumë partive komuniste, ata tregohen shumë aktivë për të futur turinjtë kudo, për të shtetur e minuar partitë tona, për të penguar luftën që bëjnë ato për socializëm e paqe. Mjafton të përmendim këtu dy fakte: Gazeta «Rabotničesko Djelo» më 15 maj 1958 shkruan: «Dihen përpjekjet e udhëheqjes së LKJ për të krijuar ndjenja kundër udhëheqjes së partisë e të shtetit në vendin tonë gjatë plenumit të prillit të Komitetit Qendror të PK të Bullgarisë dhe pas këtij plenumi përpjekjet për të krijuar ndjenja armiqësore midis udhëheqjes së disa partive komuniste dhe vendeve socialiste, përpjekjet e tyre për të krijuar përçarje dhe konfuzion në radhët e lëvizjes demokratike sindikale botërore të rinisë». Sekretari i PK të Sirisë ka deklaruar: «Ka ardhur koha që opinioni publik botëror të njohë veprimtarinë shkatërruese që bëjnë revisionistët jugosllavë në Lindjen Arabe. Të dërguarit e klikës revisioniste të Beogradit punojnë në vendet arabe jo vetëm për të izoluar

lëvizjen komuniste arabe nga lëvizja e përgjithshme komuniste dhe për ta përçarë atë, por punojnë edhe për të shmangur lëvizjen nacional-çlirimtare nga vija e saj e natyrshme e luftës kundër imperializmit dhe sidomos e luftës kundër imperializmit amerikan. Ata bëjnë gjithshka për të prishur miqësinë midis vendeve arabe, për ta përçarë lëvizjen nacional-çlirimtare dhe për ta shkatërruar frontin patriotik kundër imperialistëve».

Kundërrevolucioni hungarez tregoi qartë se revisionistët jugosllavë janë bërë kazma më e mirë në duart e imperialistëve amerikanë për të shkatërruar nga brenda partitë tona dhe shtetet socialiste. Faktet e njo-hura botërisht tregojnë se Imre Nagi, Loshonci etj., që preqatitën shpërthimin e kundërrevolucionit fashist dhe u vunë pastaj në krye të këtij kundërrevolucioni, kishin bashkëpunuar prej kohësh me grupin Tito, ishin organizuar dhe drejtoheshin drejtëpërdrejt nga revisionistët jugosllavë dhe legata jugosllave në Budapest ishte qendra e kësaj bande kundërrevolucionarësh. Revisionistët jugosllavë morën pjesë aktive në preqatitjen e kundërrevolucionit. Shtypi dhe radiot jugosllave disa muaj me radhë u morën me procesin e «demokratizimit» të Hungarisë, i dhanë një vend të gjerë botimit të deklaratave të tipit të klubit «Petëf», zhvilluan një fushatë të madhe për të diskredituar Partinë e Puno-njësve e shtetin hungarez dhe nxitën luftën e elementeve armiq kundër këtyre. Emisarë të ndryshëm jugosllavë që vinin në Hungari si «korrespondentë», «turistë» etj., u treguan gjithashtu shumë aktivë. Tërë propaganda e armiqve të socializmit në Hungari bëhej me parullat e «rrugës jugosllave». Atëherë kur plasi kun-

dërrevolucioni fashist, atëhere kur vendosej fati i sozializmit në Hungari dhe kur ishte rreziku i krijimit të një vatre lufte kundër kampit socialist, presidenti Tito dhe shtypi jugosllav e mbrojtën haptas këtë kundërrevolucion, duke e përshëndetur si «revolucion popullor». Ata u përpoqën me të gjitha mënyrat të pengjnë dështimin e kundërrevolucionit dhe e dënuan si intervencion ndihmën që u dha Bashkimi Sovjetik punonjësve hungarezë për të shkatërruar komplotin e imperialistëve. Përgjegjësinë për ngjarjet e Hungarisë, ku dhanë jetën me mijëra bij të popullit hungarez dhe të popujve sovjetikë, grapi Tito tani nuk e fsheh dot nga asnjeri dhe aq më tepër nga ne, shqiptarët, që e dimë nga eksperienca e hidhur se veprimitari të tillë armiqësore të revisionistëve jugosllavë s'janë të reja.

Projektprogrami dhe Kongresi VII i LKJ, ku revisionistët jugosllavë sulmuancë marksizëm-leninizmin, partitë komuniste e punëtore dhe shtetet socialiste me shpifjet më të poshtra të huajtura nga arsenali i armiqeve më të tërbuar të komunizmit, është një dëshmi tjetër e rolit minues të grupit Tito, e ndërhyrjes së tij brutale në punët tona. Me këtë revisionistët jugosllavë i shtuan një hallkë të re vargut të gjatë të veprimitarisë së tyre armiqësore për të shkatërruar e përçarë parti-të tona dhe shtetet socialiste.

Revizionizmi jugosllav nuk është fenomen i rastit, ai ka lindur në kushte të caktuara historike, ai ka bazën e tij objektive. Më parë borgjezia monopoliste, për të helmuar ndërgjegjen e klasës punëtore, shpenzonte një pjesë të superfitimeve për të bërë aristokracinë pu-

nëtore, e cila qe baza e lindjes së oportunizmit, baza e krijimit të partive borgjeze të klasës punëtore, siç i quajtën klasikët e marksizëm-leninizmit partitë laburiste dhe partitë socialdemokrate. Por sot, kur socializmi është bërë sistem botëror, kur lufta zhvillohet midis kampit socialist dhe kampit imperialist, imperialistëve nuk u mjaftojnë vetëm partitë borgjeze të klasës punëtore brenda vendeve të tyre; për të luftuar shtetet socialiste, atyre u duhet një shtet borgjez i klasës punëtore. Prandaj, imperialistët amerikanë dhe imperialistët e tjerë nuk i kanë kursyer paratë e tyre duke i dhënë grupit të Titos si «ndihmë» një shumë të madhe prej 3 miliard dollarësh. Mbi këtë bazë ekonomike është zhvilluar dhe qëndron në këmbë revizionizmi jugosllav, i cili objektivisht luan rolin e agjenturës së borgjezisë monopoliste në kampin e socializmit dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Për të maskuar këtë rol të tyre revisionistët jugosllavë mbulohen prapa frazeologjive marksiste, thonë se ndërtojnë socializmin. Por socializmi kurrë nuk mund të ndërtohet në rrugën anti-marksiste, nën udhëheqjen e revisionistëve dhe me ndihmën e imperialistëve amerikanë. Ruajtja e disa formave socialiste të krijuara në Jugosllavi menjëherë pas çlirimit, bëhet me qëllim nga revisionistët jugosllavë, sepse kështu ata fshehin ftyrën e vërtetë para botës e para popullit jugosllav dhe e kanë më lehtë të zhvillojnë veprimtarinë e tyre minuesc. Kjo është në interes të imperialistëve amerikanë, të cilët, për të mashtruar popullin kanë nevojë për një shërbëtor me maskë «socialiste» se shërbëtorë të zakonshëm borgjezë ata kanë plot. Forma nuk ndryshon përmbytjen: në Jugos-

llavi në fuqi nuk janë kapitalistët dhe shteti quhet republikë popullore, por politika e këtij është në favor të borgjezisë imperialiste e jo të socializmit, ndërmarrjet industriale «vetadministrohen» nga punëtorët, por në treg veprojnë ligjet e anarkisë e të konkurencës së lirë, bazë për lindjen e elementeve kapitalistë; tokat s'janë në duart e çifligarëve, por kooperativat u prishën dhe 90 për qind e tokës është pronë individuale, që pjell përditë kapitalizmin dhe është bazë e fuqishme për restaurimin e tij. Këto tregojnë se Jugosllavia gjendet në një fazë të kalimit plotësisht në rrugën e zhvillimit kapitalist. Shteti jugosllav është një shtet borgjez i klasës punëtore, një shtet revizionist, trockist, baza klasicë e të cilit është partia oportuniste, intelektualët borgjezë, borgjezia e vogël dhe e mesme, aristokracia punëtore e helmuar nga revizionizmi e nacionalizmi borgjez.

Revisionistët jugosllavë kanë degjeneruar në një bandë renegatësh të marksizëm-leninizmit, që u shërbën qëllimeve të politikës së imperialistëve. Në pikëpamje ideologjike revizionizmi jugosllav përfaqëson sintezën e rrymave të vjetra e të reja antimarksiste, ai është një helm i koncentruar që drejtohet kundër lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Për më tepër grapi Tito, me gjithë veprimtarinë e tij të gjatë, që ka ardhur duke u rritur, është vetafir-muar si udhëheqja më aktive dhe më agresive e revizionizmit modern ndërkombëtar. Veçantia e revisionistëve jugosllavë qëndron në faktin se ata, duke e mashtruar popullin jugosllav, mundën të shtien në dorë pushtetin dhe tani përdorin për qëllimet e tyre jo vetëm

propagandën, por të gjitha mjetet e mundësítë që krijon pushteti shtetërор.

Veprimitaria e gjatë armiqësore e udhëheqjes së LKJ kundër Partisë e shtetit tonë, tragjedia hungareze dhe gjithshka kanë bërë e po bëjnë ata kundër partive të tjera motra, tregojnë qartë rolin e rrezikshëm të revizionistëve jugosllavë. Dështimi i revolucioneve që u zhvilluan pas Revolucionit të Tetorit në disa shtete të Evropës Perëndimore dhe kundërrevolucioni në Hungari, tregojnë se revizionizmi gjithmonë shërben për t'i hapur portat vendosjes së diktaturës së përgjakshme të borgjezisë. Tani imperialistët, me anë të revizionistëve jugosllavë, duan t'u vënë minat partive dhe shteteve tona socialiste, që t'i përmbyisin ato, duan të krijojnë Hungari të reja. Këtë e shprehu qartë Këshilli i NATO-s, i cili me propozimin e Fon Brentanos vendosi që rruga më e leverdissime për «çlirimin e popujve të Evropës Lindore» është përkrahja me çdo mënyrë e përhapjes në këto vende të titojzmit. Publicisti i njohur amerikan Sulzberg, duke shprehur qartë qëllimet e rretheve drejtuese të SHBA-së, ka shkruar se titojzmi është ura më e mirë për të rivendosur në vendet socialiste «demokracinë perëndimore» (d.m.th. pushtetin e urryer të kapitalistëve e të çifligarëve).

Këtë rol që luan tani revizionizmi jugosllav në shërbim të imperialistëve, nuk e sheh vetëm ai që me qëllim i mbyll sytë. Por partitë tona marksiste-leniniste, të ndërgjegjshme për përgjegjësinë e tyre historike përfatet e popujve të tyre, të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të mbrojtjes së paqes, nuk mund ta nënveftësojnë këtë rrezik. Prandaj, ato po e demaskojnë

me vendosmëri revizionizmin modern dhe do ta vazhdojnë këtë luftë pa asnje kompromis, deri në shkatërrimin e tij të plotë teorik e politik. Ato ndriçohen nga shembulli i luftës së pamëshirshme që ka bërë kundër oportunizmit Lenini i madh.

Partia jonë ka mbajtur gjithmonë një qëndrim të drejtë marksist-leninist kundrejt udhëheqjes së LKJ dhe ka luftuar pa asnje lëkundje kundër pikëpamjeve dhe veprimtarisë antimarksiste e antisocialiste të revisionistëve jugosllavë. Po mbushen afro 15 vjet që grapi Tito po ndjek një politikë antimarksiste, shoviniste, armiqësore kundër Partisë, shtetit dhe popullit tonë. Revisionistët jugosllavë kanë menduar se Shqipëria, si vendi më i vogël i kampit socialist, mund të «goditet» më lehtë. Por ata kanë dështuar e do të dështojnë, sepse Partia jonë ka qenë e do të jetë përjetë besnikë e marksizëm-leninizmit, ka mbrojtur e do të mbrojë si gjë-në më të shtrenjtë pavarësinë e lirinë e popullit tonë. Partia jonë do të vazhdojë të luftojë me vendosmëri kundër revizionizmit modern.

Revisionistët modernë do të dështojnë, sepse fuqia e marksizëm-leninizmit, fuqia e partive komuniste është e pamposhtur.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 148 (3049), 22 qershor 1958

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 148 (3049), 22 qershor 1958

POPULLI SHQIPTAR ESIHË I LASHTË NGA MOSHA, POR KURDOHEREË I RI NGA ZEMRA

*Fjala në takimin e parë zyrtar me delegacionin
qeveritar çekoslovak¹*

24 qershor 1958

Të dashur shokë çekoslovakë,

I ngarkuar nga Komiteti Qendror i Partisë së Punës, nga qeveria dhe nga delegacioni ynë kötu, më lejoni t'ju shpreh juve dhe nëpërmjet jush, popullit vëlla çekoslovak dhe Partisë motër Komuniste Çekoslovake, përshëndetjet më të përzemërtat.

Ardhjen tuaj këtu ne e konsiderojmë shumë të rëndësishme përmjaft arësyte.

Vendet tonë kanë lidhje të ngushta me njëri-tjetrin sepse si pjesëtarë të kampit tonë të fuqishëm të socializmit kanë të njëjtat ideale, të njëjtat qëllime, ato i lidh lufta përmbrojtjen e paqes në botë, i lidh rruga e përbashkët përmëdha e socializmit dhe të komu-

¹ Më 24 qershor 1958 erdhi në vendin tonë një delegacion qeveritar çekoslovak i kryesuar nga V. Shiroki, Kryetar i Qeverisë së Republikës Çekoslovake.

nizmit. Vizita juaj do t'i forcojë edhe më tepër këto lindhje midis popujve tanë për të ecur krah për krah drejt rrugës së socializmit, për të cilën kanë besim të plotë se do ta çojnë deri në fund sepse ata udhëhiqen nga partitë e tyre marksiste-leniniste, të cilat kanë dëlën nga gjiri i popujve tanë të vuajtur, janë mbrujtur në luftën e përgjakshme për triumfin e çështjes së klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve të vendeve tona dhe janë udhëhequr, udhëhiqen dhe do të udhëhiqen edhe në të ardhshmen nga idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit. Ardhja juaj do ta forcojë edhe më shumë miqësinë e popullit tonë me popullin vëlla çekosllovak, ajo do ta çelnikosë miqësinë që ekziston midis popujve tanë dhe do të kalitë ndjenjën e madhe të internaciona- lizmit proletar që frysmezon punonjësit e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Ardhja juaj, të dashur shokë, është një ngjarje me rëndësi për vendin tonë edhe nga ana politike si për brenda ashtu edhe për jashtë vendit. Në të kaluarën vendi ynë as që përfillej ndonjëherë nga Shtetet kapitaliste të Perëndimit, kurse pas Luftës së dytë botë- rore këto vende janë detyruar ta shohin ndryshe Shqipërinë. Vendi ynë sot nuk është më i vëtmuar si në të kaluarën. Tani ai ka miq besnikë dhe aleatë të fuqishëm që e duan dhe e përkrahin me të gjitha mundësi- të. Kështu, pra, ardhja e përfaqësuesve të shtetit të fuqishëm të demokracisë popullore të Çekoslovakisë në vendin tonë do të ndikojë edhe në forcimin e mëtejshëm të pozitave ndërkombëtare të Republikës Po- pullore të Shqipërisë.

Vizita juaj ka rëndësi për vendin tonë edhe në lë-

min ekonomik. Populli shqiptar nuk do ta harrojë kurrrë ndihmën e vëllezërve të tij çekosllovakë, që, duke filluar që nga viti 1949, me kërkësën e Partisë dhe të qeverisë sonë, i kanë dhënë atij me qëllim që të zhdukte shkatërrimet e shkaktuara nga lufta dhe të ndryshonte sa më shpejt faqen e atdheut të tij. Në vendin tonë, me ndihmën e vëllezërve çekosllovakë janë ndërtuar disa fabrika. Me ndihmën tuaj ne po vazhdojmë punimet për nxjerrjen e mineraleve të hekurit dhe të nikelit. Me dhjetëra specialistë çekosllovakë që kanë ardhur për të na ndihmuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë së vendit tonë, si në termocentrale, në sektorin e naftës, në minierat e hekur-nikelit si dhe në sektorë të tjerë të industrisë sonë, janë duke punuar si në atdheun e tyre.

Ne mendojmë se kjo vizitë do të jetë njëkohësisht një kontribut për forcimin e kampit tonë të socializmit.

Gjatë kohës që ju do të qëndroni në vendin tonë do të shihni entuziazmin e popullit tonë. Populli ynë është i lashtë nga mosha, po ai është kurdoherë i ri nga zemra. Më lejoni, të dashur shokë, t'ju thoshja disa fjalë, megjithëse ju jeni në dijeni, mbi disa karakteristika e tradita të popullit tonë, vuajtjet dhe mjerimet e tij në të kaluarën, shpresat dhe realizimet e sotme të tij.

Populli shqiptar është një popull i thjeshtë dhe që ka luftuar shekuj me radhë. Megjithëse trim, ai ka vuajtur nga robëria e së kaluarës së largme dhe të afërme. Kjo e kaluar plot mjerime e ka bërë popullin shqiptar të vuajë, po njëkohësisht ajo e ka kalitur dhe e ka bërë të papërkultur ndaj armiqve dhe fatkeqësive.

Në të kaluarën, megjithëse ka luftuar shumë, po-

pulli ynë nuk mundi të fitojë lirinë. Lirinë dhe pavarësinë ai i fitoi vetëm në saje të mësimave dritëdhënëse të marksizëm-leninizmit, në saje të fitores së lavdishme të Revolucionit të madh socialist të Tectorit, që krijojë parin shtet të fuqishëm socialist në botë, Bashkimin Sovjetik, në saje të Luftës heroike nacional-çlirimtare të popullit tonë të udhëhequr nga Partia Komuniste Shqiptare, tani Partia e Punës, të cilën ai e do aq shumë. Po shokë, populli shqiptar e do shumë Partinë e tij marksiste-leniniste, ai e do se ajo e nxori në dritë, se ajo i ka qëndruar, i qëndron dhe ai ka besim të plotë se ajo do t'i qëndrojë përjetë besnikë marksizëm-leninizmit.

Gjatë kohës së Luftës nacional-çlirimtare populli dhe Partia e tij marksiste-leniniste kanë kaluar së bashku momente jashtëzakonisht të vështira, jo vetëm për shkak të luftës së egër të fashistëve italianë e të nazistëve gjermanë, por edhe për shkak të intrigave të mëdha të imperialistëve anglezë e amerikanë, të cilët që atëhere u përpoqën t'i rrëmbejn popullit nga duart fitoret, që po korre nën udhëheqjen e ndritur të Partisë së tij. Në kohën e luftës, nën maskën e «aleatit» e të «ndihmës», imperialistët anglezë u përpoqën të zbarkonin në vendin tonë, por harruan se koha e tyre kishët perënduar në Shqipëri dhe dështuan. Pas çlirimt imperialistët organizuan komplotë e incidente në kuftë e vendit tonë me qëllim që të gjenin «shkak» përzbarkimin e trupave të tyre në portet tona. Por edhe këto plane u dështuan. Ata dështuan sepse Shqipëria, populli ynë, udhëhiqej nga Partia e tij largpamëse, se ajo ishte e lidhur me Bashkimin Sovjetik dhe me të gjithë

thë popujt e tjerë vëllezër të demokrative populllore.

Ne, që ndodhemi këtu në këtë mbledhje, jemi nga shokët më të vjetër të Partisë sonë. Kur e filluam luf-tën ishim të rinj dhe teori nuk dinim aq shumë. Por ne kishim një gjë të qartë — idealin tonë: luftë deri në fund për çlirimin e atdheut, në popull e bashkë me popullin kurdoherë në ballë të luftës për lirinë e pa-varësinë e atdheut, për një Shqipëri të re, demokrati-ko-popullore. Me mijëra komunistë ranë për këto që-llime të larta. Populli pa te Partia, te bijtë e bijat e saja, çlirimtaren e tij, prandaj ai u lidh ngushtë e përjetë me të. Në këtë luftë Partia jonë e udhëhoqi popullin deri në çlirimin e Shqipërisë, deri në fitoren e plotë të cilën nuk e kishte parë kurrë historia e popullit tonë.

Pulsi i madh që i kishte dhënë Partia popullit dhe besimi i madh që populli krijoi te ajo gjatë luftës, bënë që edhe pas çlirimtës së bashku vështirësi të reja jashtëzakonisht të mëdha veçanërisht gjatë viteve të para të pasluftës. Kjo sepse në prak të çlirimtës, sidomos në vitet e para të çlirimtës, ne hasëm në armiq të tjerë të tërbuar, shumë dinakë dhe shumë të maskuar. Kë-ta ishin renegatët titistë jugosllavë, të cilët në fakt e kishtin filluar luftën kundër Partisë sonë marksiste-leniniste, kundër popullit shqiptar dhe krenarisë së tij patriotike që më 1943. Në prakun e çlirimtës së plotë të Shqipërisë, sidomos nga fundi i vitit 1944, kur Partia jonë e çoi popullin shqiptar në fitore, kur divizionet tona kapér-çyen kufitë e vendit tonë e u hodhën në tokat e Jugosllavisë për të kryer detyrën e tyre internacionliste dhe ndihmuani për çlirimin e Malit të Zi, Bosnjës e Hercegovinës, Maqedonisë, Kosovës e Metohisë, kur me qindra

e qindra bij të popullit tonë po jepnin jetën e tyre për çlirimin e popujve të Jugosllavisë, përfaqësuesit e Titos që erdhën në këtë kohë në Shqipëri akuzuan haptas Partinë tonë se gjoja ajo nuk i kishte kryer si duhet ështërat që i takonin. «Ruga e Partisë suaj, thoshnin ata, nuk ka qenë plotësisht e drejtë, ajo ka qenë sektare». Ata që akuzojnë Bashkimin Sovjetik dhe vendet tona socialiste për ndërhyrje të brendshme në punët e njëri-tjetrit e të vendeve të tjera, nxorën brirë të mëdhenj këtu në Shqipëri kundër Partisë dhe popullit tonë që në vitin 1944.

Historia e Partisë sonë lidhur me këto çështje është e hidhur, por edhe heroike. Jugosllavët atëhere ne i konsideronim sinqerisht si shokë dhe vëllezër, ndërsa ata, pas shpine, bënин të gjitha përpjekjet për likuidimin e Partisë sonë marksiste-leniniste dhe të Shqipërisë si shtet i pavarur. Për më shumë se 4 vjet ata luf-tuan për të realizuar këtë qëllim, duke u përpjekur ta futnin në varr Partinë tonë që të mos i dëgjohej zëri dhe në vend të saj të dëgjohej vetëm zëri i organizatës së Frontit ashtu sikurse kanë bërë në vendin e tyre. Por Partia jonë i rezistoi kësaj manevre.

Ata u përpoqën gjithashtu që në vendin tonë të mos ngrijhej asnje industri, sado e vogël që t'ë ishte kjo. Për ndihmën që ata gjoja i kanë dhënë Shqipërisë ne ruajmë një farë punishte primitive, të cilën mund t'ua tregojmë e mund ta shikoni edhe vetë që është nga të shekullit të kaluar. Unë nuk do t'ju flas këtu për grabitjet e mëdha që jugosllavët bënë në Shqipëri. Ata sabotuan te ne shfrytëzimin e naftës, për të cilën vendi ynë kishte jashtëzakonisht nevojë, u përpoqën që buj-

qësinë tonë ta mbanin në prapambetje dhe rrëmbyen sa mundën nga prodhimet tona.

Ne, me gjithë zemër, kujtonim se ata ishin shokë dhe vëllezër, ndërsa ata i bënë vendit tonë gjithë këto të këqia si pasojë e intrigave të tyre që thurnin për të zhdukur pavarësinë e Shqipërisë. Ata krijuan në vendin tonë organizma shtetërore të tilla që e likuidonin Qeverinë e RP të Shqipërisë. Çdo gjë në vendin tonë ala kërkonin të bëhej vetëm në drejtimin e tyre. Ata likuiduan çështjen e kufive, ndërsa planet tona ekonomike u vunë nën drejtimin direkt dhe në mëshirën e planeve ekonomike të Jugosllavisë. Ata donin të likuidonin Ushtrinë tonë Nacional-Çlirimtare dhe ta reduktonin atë në njësi pa vlerë dhe vepruan duke goditur e duke hequr nga radhët e ushtrisë sonë njerëzit dhe luftëtarët më të shquar e të vendosur të saj.

Udhëheqësit revizionistë jugosllavë shkuan në provokacione akoma më të mëdha ndaj vendit tonë. Duke parë se puna e tyre tradhëtare po demaskohej, u përpoqën, më në fund, që me anën e agjentëve të tyre në Partinë tonë ta likuidonin shtetin tonë të demokracisë popullore dhe ta kthenin atë në një republikë të shtatë të Jugosllavisë. Duke parë rezistencën e papërkulur të Partisë dhe të shtetit shqiptar, si dhe ndihmën e madhe të Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit, revizionistët jugosllavë u përpoqën të futnin në Shqipëri divizonet jugosllave, me qëllim që të shtypnин rezistencën e Partisë dhe të popullit tonë. Një farë gjenerali Kupreshanin, përfaqësues i Titos në vendin tonë, na tha, në atë kohë, se «Shqipëria do të sulmohej nga Greqia», me qëllim që ne të pranonim futjen në atdheun tonë të katër di-

vizioneve jugosllave dhe ta pushtonin kështu Shqipërinë.

Ata u munduan të shkatërronin normat leniniste të Partisë sonë, ta kthenin në rrugën e partisë së tyre, të shthurnin unitetin e Partisë sonë dhe të përçanin udhëheqjen e saj, duke likuiduar kuadrot besnikë të marksizëm-leninizmit. Për këtë qëllim ata, me anën e tradhëtarit Koçi Xoxe, organizuan një komplot prapa shpinës së Komitetit Qendror, me një plan të studjuar mirë. Janë pikërisht këta, ata që i bënin popullit tonë gjithë këto të këqia, që sot flasin me paturpësi gjoja për hegjemoni dhe për ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë nga ana e vendeve dhe e partive tona. Por Partia jonë rezistoi, nuk u përkul, luftoi dhe doli fitimtare ndaj intrigave të mëdha të trockistëve jugosllavë që si të tillë nuk janë të orës së fundit, por të vjetër.

Pas marrëveshjes së Beogradit Tito-Hrushov të vitit 1955, revisionistët jugosllavë e vazhduan veprimtarinë e tyre armiqësore ndaj Partisë dhe popullit tonë, jo vetëm me anën e shtypit, artikujve, karikaturave etj., po edhe me agjentë dhe diversantë që kanë hedhur dhe që vazhdojnë gjithnjë të hedhin në vendin tonë për të dëmtuar e përmbysur pushtetin tonë popullor. Por të gjitha këto plane atyre u kanë dështuar e do t'u dështojnë në saje të unitetit të çelniktë të popullit tonë rrëth Partisë së tij, në saje të drejtësisë së vijës së Partisë sonë marksiste-leniniste, në saje të qëndrimit vigjilent e revolucionar të Partisë dhe të popullit shqiptar.

Edhe Partia jonë vendosi në Kongresin III të saj që të përmirësonim marrëdhëni me jugosllavët, por vetëm në rrugën marksiste-leniniste. Po, në këtë rrugë, me ata

nuk ishte e mundur të merreshe vesh, se ata nuk ishin shokë, por tradhëtarë të marksizëm-leninizmit. Ashtu sikurse ju, edhe ne jemi plotësisht të bindur se ata nuk e pushuan kurrë luftën e tyre kundër marksizëm-leninizmit dhe vendeve të kampit tonë socialist.

Ata nuk hoqën dorë asnjëherë nga lufta kundër partive dhe vendeve tona. Ju i dini më mirë punët tuaja, po ne dimë se klika revizioniste e Beogradit e ka pasur halë në sy Partinë Komuniste të Çekoslovakisë, në atë shkallë sa e ka pasur dhe e ka halë në sy edhe Partinë tonë për veprimtarinë dhe qëndrimin kurdoherë marksist-leninist.

Lufta me revisionistët jugosllavë e forcoi edhe më tepër Partinë tonë dhe e kaliti atë edhe më shumë. Në këtë luftë Partia jonë ka fituar një eksperiencë të madhe. Mësimet e marrura gjatë kësaj lufte na detyruan të bisedojmë me shokët hungarezë që përpara se të sillonin mbledhjet në klubin «Petëf». Partia jonë e kuptonte dhe provat treguan, se klika e Beogradit kishte një pjesë shumë të rëndësishme në preqatitjen e ngjarjeve të hidhura të Hungarisë. Për këtë arësyne ne u thamë shokëve hungarezë të kishin kujdes nga veprimtaria minuese e revizioniste jugosllave, sepse këtë e kishim ndjerë në kurrizin tonë për vite me radhë. Revisionistët jugosllavë atë që bënë në Hungari, janë përpjekur vazhdimisht, me anën e agjentëve të tyre ta bënin edhe në Shqipëri. Por Partia jonë i mbajti sytë hapur dhe përpara se të ndodhnin ngjarjet hungareze i demaskoi agjentët e trockistëve jugosllavë dhe i likuidoi, midis tyre edhe anëtarë të Komitetit Qendror si Tuk Jakova, i cili ka pohuar me gojën e tij hollësishët se

si ka punuar në shërbim të revizionistëve jugosllavë për të përbysur qeverinë, Komitetin Qendorr dhe Partinë tonë. Ne kemi në dorë dokumenta të tilla që dëshmojnë se Titua i ka njoftuar agjentët e tij kryesorë, si Tuk Jakovën etj., se janë shpejtar në veprimtarinë e tyre dhe se duhet të kishin pritur. Del pyetja: Çfarë duhet të prisnin? Kuptohet lehtë, ata duhet të prisnin dhe të shfrytëzonin ngjarjet në Hungari.

Këto qëndrime armiqësore ndaj marksizëm-leninizmit dhe vendeve tona të kampit të socializmit, ata i treguan edhe një herë tanë së fundi në Kongresin VII dhe me programin e tyre.

Partia jonë ka qenë, është dhe do të jetë kurdojerë solidare me vendimet që janë marrë në Mbledhjen e Moskës për luftën e pamëshirshme që partitë komuniste e punëtore duhet të bëjnë kundër revizionizmit, për forcimin e mëtejshëm të unitetit të kampit tonë socialist, për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit.

Vija e drejtë e Partisë sonë, të dashur shokë, dhe kalitja e saj e vazhdueshme kanë bërë që uniteti i popullit shqiptar rrëth Partisë së tij të jetë më i fortë se kurrë. Është e vërtetë se në çështjet ekonomike ne kemi akoma vështirësi, po përsa i përket unitetit moral dhe politik të popullit rrëth Partisë dhe unitetit të Partisë ndaj udhëheqjes së saj, ai është jashtëzakonisht i fortë. Megjithëse për vite me radhë qëndruam të rrëthuar gjeografikisht, asnje minutë popullit shqiptar nuk i lëvizi qepalla e syrit. Ai kishte besim të madh në forcat e tija, ai kishte besim të patundur në drejtësinë e vijës e të udhëheqjes së Partisë së tij, ai kishte besim se do ta ndihmonin popujt vëllezër të kampit të socia-

lizmit. Dhe ndihma nuk mungoi t'i vinte popullit shqiptar.

Gjendja jonë ekonomike, shokë, sikurse e dini e siç do ta konstatoni edhe vetë, dhe shoku Mehmet do t'ju vërë në dijeni më me hollësi, duke e krahasuar me të kaluarën, është si nata me ditën. Por ne kemi akoma shumë vështirësi. Niveli i jetesës së popullit tonë është akoma i ulët.

Në vendin tonë përpara nuk ekzistonte pothuajse fare industria, ndërsa bujqësia ishte krejtësisht e prapambetur. Fshati ynë nuk kishte parë kurrë traktorë, përveç par mendës së drurit. Vendi ynë ishte në feudalizëm dhe populli shqiptar jetonte me një artizanat primitiv. Në kurri zë popullit jetonin bejlerët, feudalët dhe okupatorët.

Ne mund të themi se e gjithë industria që do të shihni te ne filloi të ndërtohej pas vitit 1948, d.m.th. pas prerjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë. Të gjithë kuadrot që do të shihni dhe që drejtojnë sot këtë industri përpara ishin gjysmanalfabetë. Por pas çlirimtata mësuan në shkollat e larta të vendit tonë, në ato të Bashkimit Sovjetik, të Republikës Çekoslovake dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore.

Tani mund të themi se i kemi bazat e industrisë në disa drejtime. Industria jonë sot po i plotëson disa nga nevojat e vendit. Po bëhen të gjitha përpjekjet që të shfrytëzohen sa më shumë të gjitha maqineritë që ndodhen aktualisht në vendin tonë dhe mundësitë e njerëzve që i drejtojnë ato.

Një të ardhshme të mirë ka në vendin tonë zhvillimi i minierave. Shoku Mehmet do t'ju flasë për këtë

çështje me hollësi. Partia dhe qeveria mendojnë t'i jepin një rëndësi të madhe këtij sektori me qëllim që me anë të mineraleve e të metaleve që do të nxjerrim të mund të ngrihet niveli i jetesës së popullit. Për këtë qëllim ne do të kërkojmë dhe me siguri do të kemi edhe ndihmën e vëllezërve çekoslovakë, pasi për zhvillimin e mëtejshëm të minierave në vendin tonë ne kemi nevojë për traktorë, automjete si dhe për lëndë të tilla si hekur, prokate etj.

Ju do të kaloni nëpër rrugët tona. Ato nuk janë aq të mira. Por ne jemi të bindur se kur të kaloni në këto rrugë do të krenoheni për «Skodat» tuaja në duart e shoferëve tanë të mrekullueshëm, të cilët kanë bërë nga 500 deri në 600 mijë kilometra pa riparim të përgjithshëm nëpër rrugët tona të vështira, ndërsa ata që bëjnë nga 150 mijë, 200 e 300 mijë kilometra pa riparim të përgjithshëm janë me qindra. Por mjete të tilla neve na duhen akoma se transporti automobilistik është transporti kryesor për vendin tonë malor.

Partia dhe qeveria jonë kanë në plan që bujqësia të zhvillohet dhe të përparojë. Ajo tashmë ka dalë nga prapambetja. Fshatarësia jonë në pjesën më të madhe është kolektivizuar dhe besojmë se deri në vitin e ardhshëm ne do të kryejmë kolektivizimin e plotë.

Toka dhe klima jonë janë të tilla që mund të merren rendimente të larta. Këtij qëllimi ne do t'ia arrijmë, sepse kemi bërë dhe po bëjmë vazhdimisht bonifikime të mëdha dhe kanale të shumta ujitëse, po zgjerojmë mekanizimin, kemi një plan të gjerë për zhvillimin e frutikulturës, të vreshtave, të agrumeve, të ullinjve etj. Në realizimin e këtyre detyrave të rëndësi-

shme ne nuk mendojmë vetëm si patriotë shqiptarë, po edhe si internacionalistë. Ne themi se po të kemi relativisht, gjysmën e mekanizimit të Çekoslovakisë, vendi ynë, me kushtet klimaterike dhe pedologjike që ka, mund të ushqente disa herë më shumë banorë se sa ka sot Shqipëria.

Populli shqiptar do të vërë të gjitha forcat që toka jonë të bëhet sa më shumë pjellore, që të ngrihet sa më shpejt dhe më shumë standardi i jetesës së popullit dhe të bëjmë që nga prodhimet tona t'u dërgojmë edhe miqve që kanë nevojë për to.

Ne do të vëmë të gjitha forcat që edhe vendet e tjerrë vëllezër, ndër ta edhe Çekoslovakia, të furnizohen nga vendi ynë me sa më shumë prodhime sidomos me fruta, që ju të mos shkoni të merrni portokalla, limona, mandarina etj. në Izrael, po me këto t'ju furnizojë populli shqiptar, ashtu sikurse edhe me fruta të tjera si siq, arra, kumbulla, bajame, mollë, dardha etj.

Pra, përpjekjet e popullit tonë do të jenë të mëdha në drejtim të shtimit të prodhimeve bujqësore, blegtoreale etj. Por, pa ndihmën e Bashkimit Sovjetik, të Çekoslovakisë dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore, ne nuk mund t'i realizojmë në kohën e duhur qëllimet tona për rritjen e mirëqenies së popullit tonë. Ne nuk kërkojmë që standardi i jetesës së popullit shqiptar të ngrihet menjëherë siç është sot në Çekoslovakia. Ne sot për sot, nuk kemi të tilla pretendime. Por duke marrë parasysh gjendjen e vendit tonë, ne dëshironjmë që standardi i jetesës së popullit tonë të ngrihet vazhdimisht.

Që të keni një ide më të plotë dhe të njiheni më

nga afër me gjendjen tonë ekonomike na lejoni, të dashur shokë, që shoku Mehmet Shehu t'ju informojë mbi këtë çështje. Ju do të keni rastin për shtatë ditë me radhë ta shihni konkretisht këtë gjendje, kështu do të formoni një ide më të plotë mbi përparimet e mëdha dhe boshllëqet ekonomike të vendit tonë.

*Botitet për herë të parë sipas
tekstit të marrë me stenoogram
që gjendet në AQP*

FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA ÇEKOSLOVAKË NË TIRANË

28 qershor 1958

I dashur shoku Shiroki,
Shokë dhe miq të shtrenjtë,

Në radhë të parë unë dëshiroj, në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës dhe të qeverisë shqiptare, të shpreh gjëzimin tonë të madh dhe njëkohësisht t'ju falenderoj për këtë pritje kaq të përzemërt, si dhe për fjalët e ngrohta që u thanë sonte këtu në drejtim të Republikës Popullore të Shqipërisë, të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të qeverisë sonë. Ne nuk jemi vetëm miq e vëllezër, ne jemi luftëtarë të çështjes më fisnike dhe më të madhe që ka frymëzuar deri sot njërzimin, të çështjes së çlirimit të njërzimit, nga çdo shtypje e shfrytëzim, të lumturisë dhe vëllazërimit të të gjithë popujve, të çështjes së komunizmit. Lidhjet tona mbështeten mbi parimet e solidaritetit dhe të internacionalezmit proletar. Ne kemi të njëjtat qëllime, të njëjtat interesa. Ne na udhëheq e njëjta ideologji, shkenca fitimtare e marksizëm-leninizmit. Ne bëjmë pjesë në të njëjtën familje, në kampin unik e të fuqi-

shëm të socializmit, që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik.

Eshtë pikërisht ky unitet veprimi, qëllimi dhe ideali nga i cili buron forca e pakufishme e miqësisë dhe e bashkëpunimit tonë vëllazëror. Vizita e delegacionit qeveritar çekoslovak në vendin tonë është një ngjarje e shënuar në historinë e këtyre marrëdhënieve dhe i forcon ato akoma më shumë. Ajo do të mbetet e paharruar në mendjen dhe në zemrën e popullit shqiptar.

Popujt tanë të lirë, në saje të luftës së tyre heroike dhe të ndihmës së Bashkimit Sovjetik, kanë zhdukur çdo shtypje e shfrytëzim dhe, në bashkëpunim dhe në unitet me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe me të gjithë popujt e vendeve të tjera të kampit socialist, sot ndërtojnë me sukses socializmin. Sukseset e arritura gjatë viteve të pushtetit demokratik nga populli vëlla çekoslovak, nën udhëheqjen e urtë të Partisë Komuniste Çekoslovake dhe të qeverisë së tij popullore, janë jo vetëm një dëshmi e shkëlqyer e forcës së ideve të komunizmit, por njëkohësisht burim frymëzimi dhe mbështetje e madhe për popullin tonë dhe për popujt e tjerë që ndërtojnë socializmin, si dhe për lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Populli shqiptar i ndjek me admirim të sinqertë fitoret tuaja, të dashur vëllezër, gjëzohet dhe i çmon ato si fitoret e tija.

Ne këmi admirim dhe respekt të thellë për popullin vëlla çekoslovak, për klasën e tij punëtore heroike, e cila, në ditët e shkurtit 1948, duke iu përgjegjur thirrjes së partisë së saj komuniste zbriti në rrugë, shpartalloi komplotin kundërrevolucionar të borgjezisë dhe nisi rrugën e socializmit në Çekoslovaki. Partia

Komuniste Çekoslovake, me në krye luftëtarë dhe udhëheqës marksistë-leninistë të shquar, si shokët e paharruar Gotvald dhe Zapotocki, ka udhëhequr me trimëri të shquar klasën punëtore dhe të gjitha masat punonjëse çekoslovake dhe ka fituar respektin e dashurinë e të gjitha partive marksiste-leniniste dhe të proletariatit ndërkombëtar për qëndrimin e saj luftarak dhe për besnikërinë e saj të patundur ndaj parimeve të marksizëm-leninizmit dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për luftën e paepur që u bën revizionistëve të sotëm.

Para çlirimit Shqipëria qe një vend i prapambetur, i shkatërruar nga luftërat dhe nga plaçkitjet e pamëshirshme të shkelësve të huaj, nga shtypja kriminale e klasseve sunduese të vendit dhe e imperialistëve. Por ja, brenda një periudhe shumë të shkurtër, populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, me punë vetëmohuese, me përpjekje dhe sakrifica që mund të krahasohen me ato që përballoi heroikisht në Luftën e tij nacional-çlirimtare, si dhe me ndihmën vëllazërore të Bashkimit Sovjetik, në radhë të parë, të Republikës Çekoslovake e të vendeve të tjera vëllezër, ka arritur suksese të mëdha në ndërtimin e socializmit dhe tanë vendit tonë i janë hapur perspektiva akoma më të bukura.

Sot Republika Popullore e Shqipërisë ka një industri moderne, e cila në fund të 1957-s prodhoi 14,6 herë më shumë se më 1938. Një zhvillim të madh ka marrë prodhimi i minierave. Bujqësia po mekanizohet dhe po kolektivizohet me ritëm të shpejtë. Një rrjet i dendur shkollash të çdo kategorie dhe institucionesh të ndryshme kulturale mbushin vendin tonë, ku para çlirimit 85 për

qind e popullatës ishte analfabete. Mirëqenia e masave punonjëse është rritur në mënyrë të ndjeshme. Natyrisht, neve na mbetet që të bëjmë edhe shumë e shumë përpjekje që të arrijmë në nivelin e lartë të jetesës së popullit çekoslovak, por ne këto përpjekje do t'i bëjmë, populli ynë nuk prapset para vështirësive dhe ndihma e miqve nuk do të na mungojë. Me siguri, nga viti në vit ne do të shënojmë fitore të reja.

Dihet se armiqtë e socializmit, në periudha të ndryshme të lëvizjes revolucionare dhe sipas interesave të kohës, janë munduar të trillojnë lloj-lloj shpifjesh dhe teorish për të mashtruar klasën punëtore dhe për të penguar fitoren e sistemit socialist, që zhduk shfrytëzimin e njeriut nga njeriu dhe që do të triumfojë në të gjithë botën. Kështu, për shembull, ideologët borgjezë kanë predikuar, kur ka qenë rasti për vende të industrializuara, se socializmi nuk mund të fitojë në një vend me industri të përparuar. Të njëjtën gjë kanë thënë edhe kur ka qenë rasti për vende bujqësore të prapambetura. Domethënë, sipas tyre, socializmi nuk do të fitonte asgjékundi. Por Revolucioni socialist i Tetorit u dha një shuplakë dërmuese këtyre «teorive» të kalbura dhe sot socializmi është bërë sistem botëror, që shtrihet nga brigjet e Adriatikut deri në oqeanin Paqësor. Çekoslovakia me Shqipërinë, ndër të tjera, janë dy shembuj karakteristikë që hedhin poshtë këto «teori» kallpe. Fitorja e socializmit si në Çekoslovakianë e industrializuar, si në Shqipërinë bujqësore e të prapambetur, jo vetëm që ishte e mundshme dhe në të dy rastet zhvilloi me ritëm të shpejtë forcat prodhuase për një mirëqenie më të madhe materiale e kulturale të masave

punonjëse, por tregoi se ajo është e domosdoshme dhe e pashmangshme për të gjitha vendet e botës.

Në kohën e sotme fitorja e socializmit është shënja dalluese e zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Këtë epokë e hapi Revolucioni i madh socialist i Tetorit. Bashkimi Sovjetik u bë mbështetja e sigurtë e fitores së socializmit në vendet e tjera, ashtu sikundër Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, e themeluar nga i madhi Lenin, me eksperiencën e saj të pashoqe në revolucionin proletar, në ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit, u bë model për të gjitha partitë komuniste e punëtore.

Socializmi ushtron një influencë sa vjen e më të madhe në mbarë botën. Ai është bërë shpresa dhe e ardhshmja e të gjithë popujve punonjës për të shpëtuar botën nga gremina që prej shumë vjetësh ndjekin imperialistët amerikanë dhe partnerët e tyre. Politika «nga pozitat e forcës», që prej shumë vjetësh ndjekin imperialistët e ndryshëm, ka për qëllim frikësimin dhe nënshtimin e popujve, zhdukjen e lirisë dhe të pavarësisë së tyre, zhdukjen e vendeve socialiste dhe vendosjen në to edhe një herë të sundimit të egër të kapitalit. Pasojat e kësaj politike i kanë ndjerë në kurrizin e tyre shumë popuj të Azisë dhe të Afrikës, ku imperialistët janë orvatur dhe po orvaten, me intriga, komplotë, presione brutale dhe deri në ndërhyrjen direkte të armatosur, për t'i a nënshtuar diktatit të tyre. Por kjo politikë ogurzezë ka dështuar dhe, si deri tani, do të dështojë me siguri edhe në të ardhshmen.

Ekzistenca e kampit tonë të fuqishëm të socializmit, që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik dhe forcimi përditë i marrëdhënieve tona kaq vëllazërore, lulëzimi i

ekonomisë dhe i kulturës socialiste me ritme të shpejta në vendet tona, janë pengesë e pakapërcyeshme për imperialistët, për realizimin e politikës së tyre të shtypjes dhe të skllavërimit të popujve.

Pikërisht në këtë kohë, kur superioriteti i socializmit mbi kapitalizmin shkëlqen me forcë në të gjitha fushat dhe kur imperializmi e ndjen veten më ngushtë se kurrë për shkak të ashpërsimit të mëtejshëm të kontradiktave të tija dhe të krizës së tij të përgjithshme, është periudha kur udhëheqësit revisionistë jugosllavë u hodhën në sulm të tërbuar kundër teorisë marksiste-leniniste, kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste, kundër unititetit të tyre dhe lëvizjes komuniste botërore dhe morën hapur nën mbrojtje imperializmin amerikan. Projektprogrami i Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë dhe kongresi i saj i fundit dëshmuani më së miri se udhëheqësit jugosllavë janë anti-marksistë e antileninistë, se programi dhe vija e tyre janë tejembanë revisioniste, antiproletare e antisociale të i shërbejnë vetëm imperializmit.

Ngjarjet provuan se sa i drejtë ka qenë vlerësimi që bënë partitë komuniste e punëtore të vendeve sociale në Deklaratën e Moskës, kur theksuan se në kohën e sotme revisionizmi përbën rrezikun kryesor në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Revisionistët e sotëm, duke nxjerrë nga balta flamurin e fëlliqur të Bernshtajnit, Kautskit, Trockit etj., mundohen të mbjellin konfuzion në radhët e klasës punëtore, të përçajnë lëvizjen e fuqishme komuniste botërore dhe të diskreditojnë idetë fitimtare të marksizëm-leninizmit. Ata predikojnë përçarjen e kampit tonë so-

cialist, ata do të dëshironin të përsëritnin kundërrevolucionin e Hungarisë, t'i hapin rrugën restaurimit kapitalist, të shpëtojnë sistemin kapitalist që po jep shpirt. Por balta e lëveres që kanë marrë në duar u ra mbi fytyrë. Të gjitha partitë komuniste e punëtore të botës, në solidaritet të plotë, denoncuan projektprogramin e Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë, e dënuan me forcë revizionizmin modern jugosllav dhe po e luftojnë me vendosmëri si një rrymë armiqësore, si pjellë të borgjezisë për të minuar revolucionin proletar dhe fitoren e socializmit e të komunizmit.

Shokë,

Ecja drejt ndërtimit të komunizmit në Bashkimin Sovjetik, drejt ndërtimit të socializmit në Kinën e madhe dhe në vendet e demokracisë popullore po zbuluron jetën e popujve tanë, shpejton ditën kur të gjithë popujt do të çlironen nga zgjedha e egër e kapitalit, nga mjerimi dhe nga shtypja.

Më lejoni, shokë, ta nGRE këtë dolli për popullin e lavdishëm të Çekoslovakisë, për miqësinë e përjetshme midis popujve tanë vëllezër, për lulëzimin dhe forcimin e gjithanshëm të atdheut tuaj të mrekullueshëm në rrugën e ndritur të socializmit...

Botuar për herë të parë në gazeten «Zeri i Popullit», Nr. 155 (3056), 29 qershor 1958

Botohet me ndonjë shkurtim sipas tekstit të gazetës «Zeri i Popullit», Nr. 155 (3056), 29 qershor 1958

**FJALA E MBAJTUR NË MITINGUN E ORGANIZUAR
NË TIRANE PËR NDER TË DELEGACIONIT
QEVERTATAR ÇEKOSLOVAK QË KA
ARDHUR NË VENDIN TONË**

29 qershor 1958

Qytetarë të Tiranës,

Shokë dhe shoqe,

Më lejoni që, në emër të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, në emrin tuaj dhe të të gjithë popullit shqiptar, të përshëndes nga zemra delegacionin qeveritar çekoslovak të kryesuar nga Kryetari i Qeverisë së Republikës Çekoslovake, shoku ynë i dashur, Viliam Shiroki, dhe nëpërmjet tij popullin vëlla çekoslovak.

Gëzimi i madh dhe entuziazmi i popullit tonë për vizitën e miqve tanë të shtrenjtë janë një dëshmi e fuqishme e dashurisë së thellë e të sinqertë që ai ushqen për popullin mik e vëlla çekoslovak, janë një dëshmi e qartë e marrëdhënieve vëllazërore që bashkojnë të dy vendet tona.

Vizita e delegacionit qeveritar çekoslovak është

një ngjarje me rëndësi të madhe në marrëdhëniet e miqësisë shqiptaro-çekoslovakë.

Miqësia jonë ka rrënëtë thella në të kaluarën e lavdishme të popujve tanë. Që në kohën kur populli shqiptar, nën udhëheqjen e Skënderbeut, luftonte me trimëri kundër shkelësve turq, shumë çekë e sllovakë, sidomos nga vegjelia, rrëmbyen armët dhe erdhën vullnetarisht në ndihmë të popujve ballkanikë kundër osmanllinjve. Lufta heroike e popullit tonë pati jehonë e simpati të madhe në popujt çekë e sllovakë; këtë e dëshmojnë librat e kohës, këtë e dëshmon portreti i Skënderbeut që dhe sot e kësaj dite, në një kështjellë të mesjetës në Sllovari, ruhet si portreti i një udhëheqësi të shquar ushtarak.

Populli çekoslovak njihet në histori si një popull trim, i kultuar, liridashës e përparimtar. Nuk është e rastit, pra, që luftërat e pandërprera ndër shekuj të popullit shqiptar për liri e pavarësi kombëtare kundër shkelësve të huaj, vetitë e tija të larta patriotike dhe thesari i tij kultural të kenë ngjallur interesim dhe simpati në një varg dijetarësh, burrash të shquar dhe militantësh revolucionarë çekoslovakë, sidomos që nga shekulli XIX. Populli shqiptar do të kujtojë kurdoherë me respekt, ndër të tjerë, albanologun U. Jarnik, i cili me punën e tij kontribuoi jo vetëm në shkencë, por dhe në luftën e popullit tonë për çlirimin nga zgjedha türke; poetin revolucionar S. K. Neuman, i cili ka qenë ushtar i thjeshtë në Shqipëri në Luftën e parë botërore dhe më vonë u bë një nga themeluesit e Partisë Komuniste Çekoslovakë; militant e shquar revolucionar çekoslovak, shokun tonë të nderuar Z. Nejedli, i cili në

periudhën e okupacionit nazifashist, që nga radio Moska i drejtonte fjalët më të zjarrta popullit shqiptar që luf-tonte me heroizëm kundër shkelësve fashistë.

Popujt tanë kanë qenë të detyruar të luftojnë me armë në dorë kundër armiqve të egër e të pabesë. Ata qenë viktimat e para të agresionit fashist në Luftën e dytë botërore. Ata e njohtën deri në fund hipokrizinë, përbuzjen dhe tradhëtinë e fuqive kapitaliste, e të ashtuquajturave demokraci perëndimore. Në ditët e ze-za të marsit e të prillit 1939 vetëm Bashkimi Sovjetik i dënoi agresionet fashiste kundër vendeve tona dhe i mbrojti këto. Lufta heroike e popujve tanë kundër bishave fashiste triumfoi edhe në saje të luftës çlirimtare të Bashkimit Sovjetik mbi ushtrinë hitleriane. Kjo luftë na bashkoi akoma më shumë, ne derdhëm gjakun për liri kundër të njëjtët armik. Lidice në Çekoslovakia dhe Borova në Shqipëri u bënë shkrumb e hi dhe u mbytën në gjak nga hitlerianët, u bënë simbol i barbarisë kriminale hitleriane por, në të njëjtën kohë, edhe simbol heroizmi i popujve tanë. Sot ato janë simbol i vendos-mërisë së popujve tanë që kurrë të mos kthehet e kaluarë e zezë, që kurrë të mos përsëritet tragjedia e Lidi-ces dhe e Borovës në botë, që të ruhet paqja dhe t'u pritet dora agresorëve imperialistë.

Fitorja e revolucionit popullor në Shqipëri dhe në Çekoslovakia e bashkoi përfjetë popullin shqiptar me popullin çekoslovak. Nën udhëheqjen e urtë e largpamëse të partive të tyre marksiste-leniniste që u rritën e u kaliten në luftë, në shembullin e Partisë Komuniste të të madhit Lenin, në miqësi të përjetshme me popujt sovjetikë dhe në unitet me të gjithë popujt e vendeve

të tjera të kampit socialist, popujt tanë ecin me vendosmëri në rrugën e shkëlqyer që çau Revolucioni i madh socialist i Totorit, në rrugën e socializmit e të komunizmit.

Ne gëzohemi pa masë dhe me gjithë zemër për sukseset e popullit vëlla çekoslovak. Partia Komuniste Çekoslovake, duke u mbështetur në eksperiencën e Bashkimit Sovjetik në ndërtimin e socializmit dhe duke ua përshtatur këtë kushteve konkrete të Çekoslovakisë, ka vërtetuar më së miri rëndësinë universale të eksperiencës së Bashkimit Sovjetik sipas mësimeve të Leninit të madh, ka vërtetuar më së miri se rruga kryesore për ndërtimin e socializmit, duke mos lënë pasdore veçoritë konkrete të çdo vendi, është një për të gjitha vendet, është ajo që çau Revolucioni i Totorit dhe ndoqi me sukses Bashkimi Sovjetik, që po e ndjekin sot po me aq sukses si Çekoslovakia e industrializuar, si Kina e madhe 600 milionshe, ashtu edhe Shqipëria e vogël dikur e prapambetur edhe vendet e tjera të demokracisë popullore në Evropë e në Azi. Jashtë kësaj rruge mund të shkohet në greminë e jo në socializëm.

Sukseset e Çekoslovakisë, që ne i konsiderojmë si sukseset tona, janë një kontribut i madh në forcimin e mëtejshëm të kampit socialist, në çështjen tonë të përbashkët të socializmit, në çështjen e paqes. Republika Çekoslovake është bërë një shtet i fortë e i përparruar socialist, me një autoritet të madh ndërkombëtar, të cilin ajo e ka vënë në shërbim të lirisë dhe të pavarësisë së popujve, në shërbim të paqes dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, në shërbim të socializmit.

Populli shqiptar është krenar që ka një mik plot

talent dhe aftësi të mëdha krijuese siç është populli çekoslovak, një mik të fortë dhe bashkëluftëtar të vendosur në çështjen tonë të madhe. Populli ynë i uron popullit vëlla çekoslovak fitore akoma më të mëdha në rrugën e socializmit dhe të komunizmit.

Shokë,

Gjatë viteve të ekzistencës së pushtetit popullor te ne, marrëdhëni midis dy vendeve tona, të bazuara mbi parimet leniniste të barazisë, mosndërhyrjes, respektit reciprok, bashkëpunimit të ngushtë dhe ndihmës reciproke vëllazërore, janë zhvilluar në të gjitha drejtimet dhe po forcohen përditë e më shumë. Bashkëpuni mi ynë në fushën e tregëtisë, kulturës, shkencës dhe teknikës është shembullor dhe përbën një faktor më rëndësi në forcimin e ekonomisë sonë dhe në zhvillimin e kulturës së popullit shqiptar.

Populli ynë çmon së tepërmë ndihmën internacionale që i jep Republika Çekoslovake vendit tonë për ndërtimin e socializmit. Te Partia Komuniste Çekoslovake, te qeveria çekoslovake, te i gjithë populli çekoslovak ne kemi gjetur një gatishmëri vëllazërore ndaj kërkesave tona. Republika Çekoslovake na ka akorduar kredi dhe me to ne kemi ndërtuar një numër objektesh me rëndësi. Specialistët çekoslovakë, në kuadrin e bashkëpunimit tekniko-shkencor, na kanë ndihmuar në zbulimin dhe në shfrytëzimin e burimeve të reja të ekonomisë sonë, në zhvillimin dhe në modernizimin e prodhimit të artizanatit etj. Me ndihmën e Republikës Çekoslovake kryem zbulimin gjeologjik dhe hapëm mi-

nierën e hekur-nikelit në zonën e Pishkashit. Tani e kemi vënë në shfrytëzim këtë burim ekonomik shumë të vlefshëm për vendin tonë. Inxhinierët, doktorët dhe teknikët tanë që kanë kryer studimet në Çekoslovakia, janë bërë kuadro të astë që kanë vënë në shërbim të popullit diturinë që kanë marrë në shkollë dhe cilësitë e larta në punë që karakterizojnë punonjësit çekoslovakë. Ne duhet të mësojmë shumë nga vëllezërit çekoslovakë, sidomos në çështje të ekonomisë, të mësojmë nga qëndrimi i tyre ndaj punës, të mësojmë të zbulojmë dhe të shfrytëzojmë plotësisht burimet ekonomike të vendit, në mënyrë që asgjë të mos na shkojë kot, të mësojmë të punojmë me llogari, ashtu si punon çekoslovakë.

Me këtë rast, më lejoni shokë dhe shoqe, që në emrin tuaj, në emrin e mbarë popullit shqiptar, të Partisë dhe të qeverisë sonë, t'i shpreh shokut Shiroki dhe në-përmjet tij popullit çekoslovak, Partisë Komuniste të Çekoslovakisë dhe Qeverisë së Republikës Çekoslovake falenderimet dhe mirënjohjen më të përzemërt të popullit, të Partisë dhe të qeverisë sonë për ndihmën e çmuar e bujare që na kanë dhënë.

Shokë dhe shoqe,

Çështja e mbrojtjes së paqes sot është në qendër të vëmendjes të të gjithë popujve. Të gjithë popujt e botës janë të vendosur për paqen dhe kundër luftës. Paqja sot është në rrezik për shkak të politikës aggressive që ndjekin fuqitë e mëdha perëndimore dhe në radhë të parë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Imperializmi përpigjet të krijojë vatra lufte në pikë të ndrysh-

me të botës dhe pastaj t'i vërë zjarrin gjithë botës. Sot në Lindjen e Aférme e të Mesme, për shkak të ndërhyrjeve kriminale të imperialistëve amerikanë në Liban dhe të luftës shfarosëse që për më shumë se tre vjet po bëjnë kolonizatorët francezë kundër popullit heroik algjerian, i cili po vadit me gjak tokën e tij për të fituar lirinë dhe pavarësinë kombëtare, është krijuar një gjendje pasigurie nga e cila mund të shpërthejë një konflikt ndërkombëtar. Rrezik krijon edhe ndërhyrja amerikane në Indonezi dhe në vende të tjera.

Imperializmi është tronditur thellë si nga kriza e tij e përgjithshme që po e bren përbrenda ashtu edhe nga forcimi i vazhdueshëm i unitetit të kampit të socialistëve. Sot kur të gjithë popujt shikojnë me shpresë të madhe nga Bashkimi Sovjetik, nga kampi i socialistëve, që është kështjella e paqes dhe e sigurimit ndërkombëtar, imperializmi kërkon rrugëdalje me anën e luftës.

Të dy qeveritë tona kanë mbështetur dhe mbështetin plotësisht propozinet me rëndësi të Bashkimit Sovjetik për uljen e tensionit ndërkombëtar dhe deklarojnë se do të vënë të gjitha energjitet që ato të kurorëzojnë me sukses, që forcat e paqes të përparojnë dhe ato të luftës të prapsen.

Të dy qeveritë tona i japid rëndësi të veçantë thirrjes së konferencës së nivelit të lartë, që është propozuar prej kohësh nga Bashkimi Sovjetik, mbledhja e së cilës po sabotohet pa pikë turpi nga qeveria amerikane.

Ne mendojmë se në gjendjen e sotme ndërkombëtare, thirrja e një konference të nivelit të lartë është bërë një nevojë e kohës, për të nxjerrë marrëdhëni

ndërkombëtare nga pika e rrezikshme ku ndodhen sot dhe për të hapur rrugën e uljes së tensionit, të mënjanimit të luftës, të forcimit të paqes dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar mbi parimet e bashkëjetesës paqësore.

Sot, më fort se kurrë, në sytë e të gjithë popujve del rëndësia jetike që ka për jetën e tyre dhe për paqen uniteti i kampit të socializmit të kryesuar nga Bashkimi Sovjetik. Pikërisht sot, kur imperializmit po i hapet varri nën këmbë dhe monopolet amerikane po bëjnë çmos për të hedhur njerëzimin në një kasaphanë të tmerrshme atomike, udhëheqësit jugosllavë dalin e mbështetin shpifjet dhe sulmet e urrejtshme të imperializmit amerikan kundër Bashkimit Sovjetik, kundër unititetit të vendeve socialiste, kundër partive komuniste e punëtore dhe lëvizjes komuniste botërore, kundër marksizëm-leninizmit. Në kongresin e fundit të Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë, udhëheqësit titistë të Jugosllavisë dolën hapur si tradhëtarë të marksizëm-leninizmit, revisionistë të pakorrigjueshëm, si dhe antimarksistë të vendosur, si agjenturë e regjur dhe me eksperiencë e imperializmit amerikan.

Epiqendra e revizionizmit modern është në Beograd, pasi në Jugosllavi revizionistët janë në fuqi, kanë në dorë pushtetin, përhapin me të gjitha mjejet teoritë e tyre antimarksiste. Në këtë rrugë ata kanë përkrahjen e plotë të imperializmit amerikan, i cili i ndihmon me të dy duart për të luftuar socializmin, për të dobësuar dhe për të minuar kampin socialist. Ne e njohim me kohë urrejtjen e Titos dhe të shokëve të tij kundër popullit shqiptar, Partisë dhe qeverisë sonë. Ne i dimë mirë përpjekjet e pareshtura të grupit na-

cional-shovinist të Beogradit për ta likuiduar Partinë tonë marksiste-leniniste, Republikën tonë Popullore dhe për ta kolonizuar popullin shqiptar. Sharjet e Titos në Pula dhe tani së fundi në Labin kundër nesh, ne na nderojnë, se nga të tillë shovinistë dhe antimarksistë s'mund të presim veçse sharje. Renegatët e Beogradit duhet të dinë, se kanë një eksperiencë të gjatë disfatash në lidhje me Shqipërinë, se popullin shqiptar dhe Partinë e tij të lavdishme të Punës as e kanë frikësuar, as e kanë përkulur veprimtaritë minonjëse të hapura e të fshehta të tyre. Republika Popullore e Shqipërisë dhe Partia e Punës kanë qëndruar dhe do të qëndrojnë kurdoherë si një shkëmb graniti dhe kushdo që ta prekë këtë shkëmb do të thyejë kokën. Idetë triumfuese të marksizëm-leninizmit, që udhëheqin partitë tona komuniste dhe punëtore, ua çorën maskën përgjithmonë Titos dhe shokëve të tij. Më kot revizionistët e Beogradit, duke parë disfatën e tyre të plotë, përpiken të manevrojnë duke u munduar të bëjnë diferencime në mes të partive komuniste dhe punëtore, për të na përçarë. Më kot titistët luajnë rolin e qengjit. Ato janë taktika të njoitura që u ka dalë boja. Më kot ata kanë shpresa se kupa që ata thyen dhe e bënë thërrime do të ngjitet. Më kot fletushkat e Beogradit u bëjnë thirrje popujve tanë dhe socializmit ndërkombëtar të shpëtojnë nga «stalinistë» këtë «viktimë të mjeruar». Çdo përpjekje u bë nga lëvizja komuniste ndërkombëtare për të shpëtuar ç'mund të shpëtohej, por tradhëtarët mbeten tradhëtarë dhe natyrisht, ashtu si na mëson Lenini i madh, ne nuk do të kursehem aspak që t'i luftojmë këta renegatë të marksizëm-leninizmit derisa të mbyten krejtësisht në

llum e në kënetë, se vetëm kështu i shërbejmë komunizmit dhe popujve vëllezër të Jugosllavisë.

Revizionizmi i sotëm, me gjithë lustrën pseudo-marksiste që i kanë veshur udhëheqësit jugosllavë, është një armë e ndryshkur e borgjezisë që do të bëhet copë e çikë e do të mbarojë në koshin e plehrave të historisë.

Shokë dhe shoqe,

Vizita e delegacionit qeveritar çekosllovak dhe bisedimet që u zhvilluan në Tiranë midis delegacioneve qeveritare të dy vendeve tanë vëllezër përbëjnë një faktor shumë të rëndësishëm në forcimin e miqësisë së singertë të dy popujve tanë dhe janë një kontribut i vlefshëm për forcimin e unitetit të kampit tonë socialist.

Bisedimet tona u zhvilluan në frysë miqësore dhe vëllazërore, sepse pikëpamjet tona janë plotësisht të njëllojta mbi të gjitha çështjet e interesit të përbashkët të kampit tonë socialist, të lëvizjes punëtore ndërkombëtare dhe të ruajtjes së paqes në botë.

Të dashur miq dhe vëllezër çekosllovakë,

Së shpejti ju do të largoheni nga vendi ynë që ju priti me dashuri dhe me përzemërsi. Ne nuk do të harrojmë kurrë shprehjet e dashurisë suaj të singertë ndaj popullit tonë. Miqësia e popullit vëlla çekosllovak e frysëzon popullin shqiptar dhe i jep forca të reja në luftën e tij. Ju lutem t'i transmetoni popullit vëlla dhe

aleat çekosllovak ndjenjat e thella të dashurisë vëllazërore që ushqen për të populli ynë dhe ta siguroni se populli shqiptar do të ecë gjithnjë krah për krah me popullin çekosllovak në rrugën e përbashkët të socializmit, në unitet të pathyeshëm me vendet vëllezër të kampit socialist.

Rroftë dhe u forcoftë përjetë miqësia dhe aleanca e paprekshme midis popujve vëllezër shqiptar dhe çekoslovak!

Rroftë populli heroik çekosllovak, Partia e tij e lavdishme Komuniste dhe qeveria e tij demokratike!

Rroftë uniteti i pathyeshëm i vendeve të kampit socialist me Bashkimin Sovjetik në krye!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i Popullit»,
Nr. 156 (3057), 1 korrik 1958*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

TE MENDOJMË E TE VEPROJMË VAZHDIMISHT PËR PËRMIRËSIMIN E MËTEJSHËM TË METODËS SË PUNËS UDHEHEQESE TË PARTISE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

3 korrik 1958

Kjo mbledhje e Sekretariatit të Komitetit Qendror ka një rëndësi të veçantë përfaktin se këtu u diskutua mbi përmirësimin e metodës së punës. Në këtë çështje, me gjithë përparimet që janë bërë, ne kemi akoma shumë anë të punës sonë që duhet t'i përmirësojmë më tej. Rreth këtyre çështjeve të metodës së punës kisha disa vërejtje pasi këtu janë edhe mjaft sekretarë të parë të komiteteve të Partisë të rretheve, nga të cilët ne ndihmohemi dhe përpinqemi gjithashtu t'i ndihmojmë.

Dihet se mbledhjet e Sekretariatit të Komitetit Qendror kanë një vlerë të madhe përfundimtare e Partisë

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi rezultatet nga eksperiencia e punës në aparatin e Komitetit Qendror pas organizimit të ri.

dhe këto mbledhje nuk duhet të bëhen sa për të shkuar radhën. Sekretariati ka detyra të caktuara nga ana e Komitetit Qendror, të cilat ai duhet t'i kryejë si jo më mirë.

Detyra kryesore e Sekretariatit të Komitetit Qendror është që të organizojë mirë punën e të gjithë aparatit të Komitetit Qendror, në mënyrë që, nga Partia, të zbatohen me kohë dhe ashtu si duhet të gjitha vendimet e Komitetit Qendror dhe njëkohësisht të pregatiten mirë materialet e nevojshme që do t'u kalojnë për shqyrtim Byrosë Politike dhe Sekretariatit të Komitetit Qendror. Mirëpo vërehet se një punë e tillë kohët e fundit nuk po kryhet si duhet. Prandaj kjo duhet të ndreqjet patjetër.

Materialet që i paraqiten për shqyrtim Byrosë Politike dhe Sekretariatit të Komitetit Qendror kanë një rëndësi shumë të madhe. Për pregatitjen e mirë të këtyre materialeve nuk kanë detyrë vetëm sekretarët e Komitetit Qendror, por këtë duhet ta kuptojnë mirë të gjithë drejtorët, inspektorët dhe instruktorët e Komitetit Qendror, si dhe sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve. Prandaj, për këtë qëllim është e nevojshme të sigurohet një organizim më i mirë i punës nga ana e sekretarëve të Komitetit Qendror me drejtoren dhe inspektorët e Komitetit Qendror. Në këtë mënyrë do të pregatiten si duhet problemet më të përshtatshme dhe të nevojshme për Sekretariatin e Komitetit Qendror, mbi të cilat do të merren vendime të drejta, që do të janë një ndihmë e madhe për Partinë. Por, që të realizohet kjo, duhet të bëhet një punë më e organizuar. Për këtë çështje unë kam folur me sekretarët e Komitetit Qendror, po e ndjej të nevojshme

të diskutoj edhe në këtë mbledhje të Sekretariatit.

Sekretarët e Komitetit Qendror duhet të kenë mbështetjen e drejtive, të inspektorëve të Komitetit Qendror dhe të sekretarëve të parë të rretheve. Pra, rëndësi shumë të madhe ka çështja se si e organizon punën sekretari i Komitetit Qendror. Drejtoret janë në lidhje me inspektorët e Komitetit Qendror, të cilët shkojnë në terren për të ndihmuar, për të kontrolluar dhe për të ndjekur zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror nga ana e komiteteve të Partisë, instruktorëve të tij dhe organizatave bazë. Janë inspektorët në radhë të parë ata, që i sjellin Komitetit Qendror eksperiencën, nevojat, pikëpamjet e bazës dhe ngrenë problemet më urgjente që duhen zgjidhur. Prandaj instruktorët e Partisë, si kötu, ashtu edhe në rrethe, duhet të mendojnë dhe të punojnë me kokë. Por që ta kryejnë mirë detyrën, ata nuk duhet të ecin pa plan, as të fluturojnë si bleta. Kur instruktori shkon në terren, nuk duhet të mjaftohet vetëm me ndonjë fjalë që thotë dhe të kujtojë se e mbaroi detyrën që i ka ngarkuar Komiteti Qendror. Kjo do të ishte e gabuar. Ai duhet ta ndihmojë bazën për shumi të çështje që janë në kompetencën dhe zotësinë e tij. Pasi mbaron punën në bazë, instruktori kthehet në qendër dhe duhet t'i sjellë të preqatitura problemet kryesore që kanë dalë në këtë ose në atë rreth, në mënyrë që të merren menjëherë masa nga ana e Sekretariatit të Komitetit Qendror. Po të punohej në këtë mënyrë, nuk do të kishin ndodhur gabimet që u vërtetuan në Peshkopi ose më parë në Shkodër në lidhje me kolektivizimin. Prandaj inspektorët duhet të kenë një plan pune të preqatitur e të studjuar mirë, me

qëllim që problemet që do të ndjekin kur të shkojnë në bazë dhe ato që do t'i ngrenë Sekretariatit të Komitetit Qendror, t'i shërbejnë me të vërtetë përmirësimit të punës së Partisë.

Ju, shokë inspektorë, jeni ndihmësit kryesorë të sekretarëve dhe të drejtoreve të Komitetit Qendror, sepse ju keni kontakt të vazhdueshëm me bazën. Prandaj, kur shkoni në terren, punoni me plan; kur ktheheni në qendër, ia sillni Byrosë Politike dhe Sekretariatit të Komitetit Qendror problemet që preokupojnë Partinë, propozoni dhe kérkonи zgjidhjen e tyre të drejtë dhe të shpejtë. Po të jeni të armatosur mirë, burokratizmi e ka vështirë të zërë vend në punën tuaj. Hedhja e problemeve në letër për t'ia paraqitur Sekretariatit, nuk do t'ju kérkojë shumë kohë, por sa të mira sjell kjo punë. Në materialet që paraqitni, nga ju nuk kërkohet të bëni teori. Vutë re se në një rreth nuk ecën mirë një problem, ta zëmë ai i kolektivizimit, atëhere takoni pa vonesë sekretarin e Komitetit Qendror dhe ai i propozon Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror që të bëjë mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror për shqyrtimin dhe për zgjidhjen e këtij problemi. Nuk duhet që çështjet të paraqiten në udhëheqje atëhere kur e keqja është bërë dhe duket sheshit.

Inspektorët e Komitetit Qendror kanë një rol të madh në drejtim të preqatitjes së materialeve për Sekretariatin e Komitetit Qendror. Por duhet që drejtorët të shfrytëzojnë mirë punën dhe kapacitetin e inspektorëve të Komitetit Qendror dhe të mos nijaftoheni vetëm me ndonjë raport ose disa shönime që ata na jaspin. Inspektorët duhet të konsiderohen dhe të trajto-

hen në lartësinë dhe funksionet që kanë, sepse drejtoret e Komitetit Qendror nuk mund ta kenë syrin kudo. Frandaj, në ndihmë të tyre janë inspektorët, të cilët paraqitin probleme. Edhe mbledhjet e Sekretariatit të Komitetit Qendror duhet të bëhen ekspeditive.

Sekretarët e parë të rretheve janë nga udhëheqësit më të rëndësishëm të Partisë. Kur njëri prej tyre sheh se në rrethin ku punon ka një problem, për zgjidhjen e të cilit duhet të ndërhyjë Sekretariati i Komitetit Qendror, ai duhet të vijë menjëherë këtu, ta diskutojë çështjen te sekretari i Komitetit Qendror, i cili e shtron pastaj në Sekretariat. Në qoftë se çështja duhet paraqitur me shkrim, kjo të bëhet shkurt dhe qartë nga vetë sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit dhe t'i paraqitet pa vonesë Sekretariatit të Komitetit Qendror, i cili do të vendosë sipas rastit.

Gjatë punës për të preqatitur çështjet që do të shqyrtohen në Sekretariat, sekretari i Komitetit Qendror nuk duhet të pranojë materiale të gjata. Këto materiale më parë duhet të përpunohen nga drejtoritë e Komitetit Qendror. Instruktorët dhe inspektorët e Komitetit Qendror duhet t'i studojnë me kujdes materialët që i vijnë Sekretariatit të Komitetit Qendror, t'i përpunojnë ato dhe, çështjet që janë në kompetencën e tyre, të mos ia japid as drejtorit as sekretarit të Komitetit Qendror, po të marrin vetë përgjegjësi dhe t'i zgjidhin në vend. Drejtoreve t'u jepen çështjet më të rëndësishme. Nëse drejtori ka nevojë ta lexojë materialin që i paraqitet, le ta lexojë, ndërsa sekretarit të Komitetit Qendror mund t'i njoftohet përbajtja e materialit dhe t'i propozohen masat që duhen marrë.

Kjo është një ndihmë efektive dhe e shpejtë. Çështja është që të thjeshtohet e të forcohet puna, sepse këtu nuk është vetëm çështja e mbledhjeve të Sekretariatit të Komitetit Qendror, po e mbarëvajtjes së gjithë punës së Partisë. Kështu do të ndihmohen edhe komitetet e Partisë të rretheve, byrotë, sekretarët dhe instruktorët e tyre, sepse kur përdoren metoda më të mira pune në aparatin e Komitetit Qendror, marrin shembull edhe rrethet. Ndryshe, po të zvarriten çështjet e të shtyhen mbledhjet e Sekretariatit të Komitetit Qendror, çfarë shembull mund t'u jepet irretheve? Është fakt se këto kohët e fundit, për shkak se s'kanë qenë të preqatitura mirë materialet e Sekretariatit të Komitetit Qendror janë bërë më pak mbledhje, kurse janë bërë më shumë mbledhje të Byrosë Politike. Kështu ne nuk jemi në rregull.

Lidhur me materialet kisha edhe një vërejtje tjeter. Ditët e fundit po ndodh kështu: Pasi shpërndahet materiali sipas rendit të ditës që është aprovuar, na dërgohen njëra pas tjetrës materiale të tjera. Një punë e tillë nuk është aspak e mirë. Materialet të dërgohen në kohë dhe mbledhjet e Sekretariatit të Komitetit Qendror t'i zhvillojmë të paktën dy herë në muaj. Prandaj t'i kemi mirë parasysh këto çështje.

Të marrim si shembull çështjen e Peshkopisë. Në rrëthin e Peshkopisë nc dërguam një ekip. Rëndësi këtu ka çështja përsë shokët e Peshkopisë i kanë lejuar vetes gabime në kolektivizimin e bujqësisë. Problemi i kolektivizimit ka një rëndësi shumë të madhe për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, por është edhe një problem mjaft delikat, prandaj nuk duhet shpejtuar, sepse nuk

është një çështje thjesht ekonomike, po edhe politike.

Çështja e kolektivizimit të bujqësisë e ka preokupuar dhe e preokupon shumë Komitetin Qendror, i cili ka dhënë gjithmonë direktiva dhe ka dërguar letra. Në Sekretariatin e Komitetit Qendror ky problem është shtruar disa herë, janë kritikuar edhe raste gabimesh, siç ka ndodhur tani afër në rrethin e Shkodrës. Atëhere përse byroja e Komitetit të Partisë dhe sekretarët e saj në Peshkopi nuk kanë punuar në mënyrë të tillë që, në rrethin e tyre të mos vërtetoheshin të meta dhe gabime politike, ideologjike dhe ekonomike në drejtim të kolektivizimit, siç po diskutojmë sot? Pas të metave dhe gabimeve që kanë bërë të tjerët, çfarë mësime kanë nxjerrë, si kanë punuar dhe ç'mendojnë të bëjnë shokët e Peshkopisë për të përmirësuar gjendjen në të ardhshmen?

Nga gabimet që bëhen në një rreth, duhet të përfitojnë edhe rrethet e tjera. Në Shkodër u bënë gabime, por me sa duket shokët e Peshkopisë vazduan kolektivizimin duke përdorur në disa raste masa administrative, të cilat e dëmtojnë çështjen e Partisë. Është thënë edhe herë të tjera se në themel të punës së Partisë për kolektivizimin e bujqësisë është metoda e bindjes, vullnetarizmi.

Peshkopia është një rreth bujqësor, me bujq të përparuar. Kolektivizimi i bujqësisë në këtë rreth jo vetëm do të ngrinte ekonominë, por do të ndihmonte edhe si Republikë, pse atje ka njerëz me eksperiençë dhe të zgjuar. Nga pikëpamja politike, sukseset në kolektivizimin e bujqësisë janë edhe një grusht i rëndë për titistët, sepse Peshkopia është një rreth kufitar.

Çështja themelore është që të ngrihet puna politike me masat. Shtëpia e kulturës që është ndërtuar atje, duhet të bëhet një qendër me plot aktivitete kulturaie. Talente ka, t'i zbulojmë e t'i përdorim ato për punën me masat, të aktivizohen mirë arësimtarët. Puna propagandistike për kolektivizimin është çështje e të gjithë Partisë. Në radhë të parë, vetë komunistët të jenë të qartë, të qëndrojnë fort në parimet e statutit. Premtimi jashtë statutit të mos bëhen, padrejtësitë të vihen në vend në bazë të ligjeve të shtetit. Oborret kooperativiste të mos zmadhohen. Të mos bëhen njerëzit të pakë-naqur si rrjedhim i punës së dobët për sqarimin e tyre, ose për shkak të gabimeve që bëjnë disa shokë komunistë apo drejtues. Kundër pakënaqësive nuk veprojnë organet e sigurimit, por puna e madhe politike e Partisë, që zemrat e njerëzve të jenë të pastra dhe ata të jenë të bindur në vijën e drejtë të Partisë. Edhe lufta kundër armikut duhet zhvilluar jo vetëm nga ana e organeve të sigurimit, po nga i gjithë populli, nën udhëheqjen e Partisë.

Një nga çështjet e rëndësishme që duhet ta kemi kurdoherë parasysh është ajo e forcimit të organizatave bazë të Partisë. Është e domosdoshme që ta sinjalizojmë edhe një herë Partinë, që organizatat bazë të bëhen luftarake, t'i kuptojnë thellë problemet, të marrin vendime për zgjidhjen e tyre dhe të luftojnë për zbatimin e këtyre vendimeve. Në këtë punë një rol të madh luan sekretari i organizatës bazë, ngritjen politike, ideologjike dhe teknike të të cilit komitetet e Partisë duhet ta kenë në plan të parë. Kur një sekretar organizate bazë është i aftë, ai do ta kryejë patjetër në mënyrë

revolucionare punën e Partisë. Format e edukimit të sekretarëve të organizatave bazë, seminaret për çështje politike dhe ideologjike që ne duhet t'i zhvillojmë sipas situatës e kushteve të çdo rrathi, të vlerësohen akoma më mirë nga ana e aparateve dhe e inspektorëve të Komitetit Qendror, sekretarëve dhe instruktorëve të komiteteve të Partisë, të cilët jo vetëm ta kuptojnë rëndësinë e tyre, por të preqatiten sa më mirë kur referojnë në to. Edukimi i sekretarëve të organizatave bazë në të gjitha format duhet të merret me seriozitet më të madh se deri tani. Kjo kërkon që sekretarët dhe instruktorët e komiteteve të Partisë të njojin, në vija të përgjithshme dhe në detaje, jo vetëm çështjet ekonomike, po edhe ato të arësimit, të kulturës etj., të jenë të preqatitur e të shfrytëzojnë edhe eksperiencën e bazës. Pregatitja teorike dhe politike e sekretarëve të organizatave bazë, e lidhur me praktikën dhe me problemet e bazës, kontaktet e gjalla me popullin dhe me komunistët, do të vlejnë shumë për edukimin dhe për kualifikimin e tyre dhe, si rrjedhim, kjo do ta çojë punën më përpara.

Një punë më të madhe duhet të bëjnë komitetet e Partisë edhe për rritjen e astësive të instruktorëve të tyre. Përveç kontakteve të vazhdueshme që kanë me ta sekretarët e komiteteve të Partisë, instruktorët duhet të bëjnë më shumë përpjekje që, nga kontaktet me bazën dhe eksperienca e Partisë, të arrijnë në përgjithësime e të nxjerrin konkluzione për një punë më të thellë e më të kualifikuar. Sekretari i komitetit të Partisë, duke u nisur nga praktika, të bëjë sintezën e problemeve dhe t'u hapë instruktorëve perspektiva të gjera

për punën. Kështu do të rritet edhe autoriteti i sekretarit të komitetit të Partisë përpara instruktorëve. Prandaj kontaktet dhe instruksionet për instruktorët e komiteteve të Partisë duhet të përbëjnë një preokupacion të jashtëzakonshëm për sekretarët e komiteteve të Partisë. Fo të bëhet mirë kjo punë, atëhere edhe puna e komiteteve të Partisë do të përmirësohet. Instruktorët e komitetit të Partisë do të veprojnë në një zonë të caktuar, kështu që, në rast se ne do ta bëjmë punën mirë me çdo instruktor, atëhere e kemi bërë punën mirë në të gjithë rrëthim. Te puna me instruktorët duhet t'i biem mirë çekanit. Natyrisht, detyrat nuk do të na ecin të gjitha mirë, menjëherë, por të jemi të bindur se me përpjekje më të mëdha do të kemi më shumë rezultate në çdo drejtim.

Sekretarët e parë dhe sekretarët e tjera të komiteteve të Partisë, duhet të mendojnë e të veprojnë vazhdimisht për përmirësimin e mëtejshëm të metodës së punës. Secili të mendojë si ta kryejë më mirë punën jo vetëm në zonën që ka në ngarkim, po në të gjithë rrëthim sipas ndarjes funksionale. Në këtë çështje një rëndësi të madhe ka sidomos puna e sekretarit të parë të komitetit të Partisë të rrëthit, i cili nuk duhet të bjerë në pozitat e ndonjërit prej sekretarëve të tjera të komitetit të Partisë që mund të thotë: «Unë kam zonën time dhe nuk përgjigjem dot për sektorin». Sekretarët e komiteteve të Partisë të rrëtheve janë ngarkuar vërtet të punojnë në një zonë të caktuar, por me këtë nuk hiqet përgjegjësia e tyre për sektorët. Përkundrazi, me organizimin sa më të mirë të punës, me një bashkërendim e koordinim të saj, të arrihet që sekretarët e tjera

të komitetit të Partisë ta kryejnë sa më mirë detyrën sipas ndarjes profesionale që kanë, pavarësisht se ata, në kushte të caktuara, ngarkohen edhe me përgjegjësi zonale. Ta mbajmë këtë formë të re organizimi, shokë, se do të kemi rezultate të mira në punë. Kjo do t'i bëjë sekretarët e komitetit të Partisë që të jenë më të lidhur me bazën.

Çështja e lehtësimit të punës së sekretarit të parë, ka mundësi që të rishikohet nga byrotë e komiteteve të Partisë në bazë të gjendjes dhe të forcave që ekzistojnë në çdo rrëth. Sekretari i parë mund të drejtojë direkt dy ose edhe vetëm një sektor, sepse puna e tij është shumë e rëndësishme, sidomos në periudhën e tanishme, kur ai duhet të mbajë në lidhje të gjithë sekretarët e tjerë të komitetit të Partisë dhe t'i ndihmojë që ata të ngrihen në nivelin e udhëheqësve të rrëthit. Përveç kësaj, është e domosdoshme që sekretari i parë të shikojë edhe si po zbatohen çështjet në rrugën shtetërore, pra, ai duhet të mbajë kontakte me shokët përgjegjës të organeve të diktaturës së proletariatit etj. Prandaj, sektorët që do të marrin nën vartësinë e tyre direkte sekretarët e parë, le t'i shohin përkatësisht komitetet e Partisë. Ne nuk do të kemi kundërshtime që sekretari i parë të mbajë, ta zëmë vetëm sektorin e agjACIONIT e të propagandës, sepse duke pasur më pak lidhje, ndihma e tij për bashkëpunëtorët do të jetë më e mirë dhe, si pasojë, edhe punët do të zgjidhen më shpejt. Prandaj, në disa rrethe, si për shembull në Shkodër, sekretari i parë, përveç drejtimit të përgjithshëm mund të merret me çështjet e agjACIONIT e të propagandës. Atij mund t'i jeplet edhe

një instruktor i aftë për ta ndihmuar. Kështu mund të themi edhe për Durrësin, ku ka shumë probleme ekonomike dhe sekretari i parë është mjافت i ngarkuar etj.

Kritikat, që na u bënë në këtë mbledhje të Sekretariatit, të na shërbejnë për të përmirësuar dhe për të gjallëruar punën. Mbledhjet e Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror duhet të konsiderohen si ngjarje me rëndësi të madhe. Kur zhvillohen këto mbledhje, duhet të dinë të gjithë ata që punojnë në aparatin e Komitetit Qendror, të cilët të mësojnë edhe se ç'vendime u morën. Po mbledhjet tona pak njerëz i dinë. Prandaj, të gjithë ata që marrin pjesë në to, siç është rasti i sotëm, që kemi thirrur në Sekretariat 7-8 sekretarë komitetesh partie, kanë për detyrë që, porsa të dalin nga mbledhja, brenda 1 ose 2 ditësh, të vënë në dijeni vartësit e tyre për vendimet që u morën. Punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror, përveç ndonjë çështje me karakter të brendshëm, duhet t'i njojin të gjitha vendimet e Komitetit Qendror. Po kjo nuk mjaf-ton. Ata duhet të vihen në dijeni të mbledhjeve tona jo vetëm për të mësuar mbi vendimet e marrura, por edhe sepse janë ata që kanë preqatitur materialet e tyre, në mënyrë që të shohin frutet e punës së vet në bazë të vërejtjeve dhe të konkluzioneve që bëhen në mbledhje. Kështu, punonjësi i aparatit të Komitetit Qendror do të ketë edhe kënaqësi në punën e tij. Po nuk është vetëm kjo. Çështja është se këta njerëz i vëmë përpëra detyrave të reja, u hapim perspektiva pune dhe, kur venë në bazë, janë të armatosur mirë për të ndihmuar. Shënimet që mbani në mbledhje, shokë, duhet t'i përdorni për punën dhe jo t'i futni në xhep.

Nga diskutimet që bëhen në mbledhjet tona, lindin shumë probleme të rëndësishme që preokupojnë Partinë. Mirëpo ne nuk kemi mundësi ta vëmë në dijeni Partinë ne anë të instruktorëve për të gjitha këto probleme. Për këtë qëllim janë edhe organet e shtypit, të cilat brenda 2-3 ditëve duhet të botojnë shkrime për problemet që vendosen në mbledhje të Byrosë Politike apo të Sekretariatit. Këto shkrime të mos bëhen vetëm nga një njeri i «Zërit të Popullit». Po kush duhet të shkruajë në shtyp? Për këtë qëllim shokët që merrten me shtypin dhe agitacionin në aparat, menjëherë pas mbledhjes duhet të preqatitin planin. Ata të kujdesen që të dalin disa artikuj të thjeshtë dhe me tituj tërheqës, me qëllim që njerëzit të nxiten për t'i lexuar dhe të shohin te shkrimi që botohet vijën e Partisë dhe porositë e saja përpara se të shkojë në bazë instruktori. Prandaj, shokët e agitacionit e të propagandës, jo vetëm të vënë në dijeni vartësit e tyre, por të caktojnë edhe temat që duhet të trajtohen dhe kush do t'i shkruajë ato në shtyp. Natyrisht, artikujt do t'i shkruajnë ata që janë kompetentë. I tillë nuk është vetëm kryeredaktori i gazetës «Zëri i Popullit» që ftohet të marrë pjesë në mbledhje, kompetentë për të shkruar ka shumë, të gjithë duhet të jenë propagandistë të direktivave të Partisë. Veç të kihet parasysh që artikujt në shtyp të mos jenë të gjatë, ai që shkruan të mos hyjë në të gjitha gjërat dhe ta futë lexuesin si në ndonjë pyll. Artikujt tanë të jenë të shkurtër, të qartë, konkretë, me qëllim që të ndihmohen mirë sekretarët, instruktörët e komiteteve të Partisë dhe komunistët, të cilët, pasi t'i lexojnë ato në shtyp, t'i kuptojnë dhe të orien-

tohen se si të punojnë. Mua më duket se nuk ka ndonjë vështirësi të madhe për të shkruar artikuj të tillë, sidomos nga njerëz që i njohin çështjet për të cilat shkruajnë. Për shembull, drejtori, që merret me çësh-tjet organizative të Partisë, ka mundësi të shkruajë artikuj të shkurtër për problemet e sektorit të tij, kështu mund të themi edhe për shokët e sektorëve të tjera. Kë-to botime janë një ushqim shumë i dobishëm për Partinë, sepse me anë të tyre konkretizohen direktivat e Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë.

Kjo praktikë duhet ndjekur edhe në bazë; kur bëhen mbledhjet e byrosë së komitetit të Partisë të rre-thit duhet të vihen në dijeni të gjithë punonjësit e aparatit të komitetit të Partisë e të mendohet edhe për masat që duhen marrë pas mbledhjes. Nga diskutimet që u bënë dhe problemet që u rrahën në këtë mbledhje për metodën e punës të sekretarëve, drejtorive dhe instruk-torëve të Komitetit Qendror, duhet të reflektojnë thellë edhe shokët e rretheve. Në dritën e problemeve që u shtruan këtu, të mendohet mirë edhe për problemet e tjera. Edhe vartësve të të gjitha hallkave, kur t'u flitet për një problem, ky të lidhet gjithashtu me problemet e tjera. Këto punë t'i bëjmë mirë dhe shpejt e jo me mbledhje të gjata, bille edhe sot me këtë mbledhje sikur e tepruam ca, sepse zakonisht mbledhjet duhet të bëhen të shkurtëra si këtu në qendër, ashtu edhe në bazë. Prandaj, të evitojen diskutimet e gjata dhe përsëritjet. Shokëve përgjegjës t'u thuhet shqip se nga diskutime të gjata e plot me përsëritje nuk rritet autoriteti i tyre në Parti. Përkundrazi.

Konstatojmë se po bëhen shumë mbledhje, prandaj

problemi që na shtrohet është se si t'i shkurtojmë ato sa të jetë e mundur më shumë. Për këtë, pasi ta studjojmë çështjen, mendojmë të nxjerrim një nomenklaturë, me të cilën të japim disa drejtime konkrete. E detyrueshme është që një herë në muaj të zhvillohet mbledhja e organizatës bazë, një herë në muaj mbledhja e organizatës profesionale në qendrën e punës, mund të jetë e detyruar edhe ndonjë mbledhje tjetër dhe të tjera mbledhje nuk ka. Këtë duhet ta dijë çdo anëtar partie. Në rast se ai lajmërohet për një mbledhje tjetër jashtë atyre që thamë dhe dëshiron të shkojë, le të vejë, po në rast se nuk dëshiron, nuk mund t'i kërkohet llogari duke i thënë se «nuk e ke bërë detyrën». Anëtarit të Partisë i themi se s'e ke kryer detyrën, atëhere kur ai nuk zbaton direktivat e Partisë dhe jo kur nuk shkon në një mbledhje, sepse ai në shumë mbledhje s'ka si të vejë dhe në të gjitha mbledhjet ai nuk është i detyruar të shkojë. Edhe në fshat bëhen shumë mbledhje. Këtë praktikë ne duhet ta ndryshojmë medoemos, po më parë është e domosdoshme të përcaktojmë se ç'mbledhje duhen zhvilluar. Partia duhet ta organizojë mirë zbatimin e të gjitha detyrave dhe të mos i heqë nga puna e të mos i mërzitë njerëzit duke bërë mbledhje e duke i thirrur njerëzit për pak gjë në orarin e punës. Ai vjen, pse është anëtar partie ose patriot, po shiko edhe punën që prish ardhja e tij në mbledhje ose kur e thërret në zyrë.

Kështu është edhe çështja e raporteve. Ato duhet të jenë konkrete dhe të shkurtëra, sepse kur janë të gjata edhe diskutimet bëhen të tilla dhe kanë po atë ton. Në rast se ne bëjmë një raport konkret e të shkurtër,

diskutojnë dhe 5-6 vetë, të cilët bëjnë shtesa e plotësimë të nevojshme, këto janë më të vlefshme nga raportet e zgjatura. Mbledhjet që zgjaten humbasin përgjegjësinë, kurse përgjegjësia duhet të forcohet dhe demokracia të mos dobësohet. Ja për shembull, propozohet që zgjedhjet në organizatat e Partisë të bëhen një herë në dy vjet. Unë nuk jam me këtë mendim, sepse shokët e zgjedhur humbasin përgjegjësinë përparr zgjedhësve, përparr Partisë. Kështu ata do të mendojnë se dy vjet i kemi siguruar. Stalini ishte shumë rigoroz në këtë çështje, ai nuk lejonte që të mos bëheshin zgjedhjet çdo vit dhe për këtë bënte shumë mirë. Mund të shkurtojmë formalitetet, raportet, mbledhjet e tjera, por jo të rrallojmë zgjedhjet, zhvillimi i të cilave çdo vit ka rëndësi të madhe nga pikëpamja e demokracisë. Në këtë drejtim do të na ndihmojë shumë përmirësimi i metodës së punës.

Mos harroni se çështjet ekonomike kanë rëndësi të madhe për ne. Prandaj, të bëhen përpjekje që të realizohet plani i shtetit. Po kjo nuk mund të arrihet pa kuadro, të cilët, së pari, duhet të edukohen. Kjo kërkon që çështjet e arësimit e të kulturës të mos lihen në radhë të fundit nga Partia, po të vlerësohen më shumë për preqatitjen dhe për sigurimin e kuadrit të aftë, që të përvetësojë teknikën dhe të drejtojë ekonominë. Prandaj, të kontrollohen e të ndihmohen me kujdes shkollat, të mbahen afër arësimtarët, të cilët mund të ndihmojnë për shumë gjëra, të aktivizohen më mirë në të ardhshmen. Vetë sekretarët e parë të marrin pjesë në seminaret e tyre, sepse detyra e arësimtarit ka rëndësi të jashtzakonshme. Mosha e pedagogëve që japid mësim

tani në shkollat e larta është e re, sepse këta kuadro kanë filluar shkollat menjëherë pas çlirimt. Nevojat e zgjerimit të arësimit kanë diktuar që në arësim të dërgohen shumë mësues të dobët, prandaj të bëjmë përpjekje që ta kapërcejmë edhe këtë vështirësi duke u vënë rëndësi të madhe problemeve të arësimit dhe kulturës. Natyrisht, të mos neglizhohen detyrat në sektorët e tyre si në propagandën e prodhimit, në realizimin e detyrave ekonomike etj. Prandaj, të organizohet puna në mënyrë që çdo gjë të ecë në rregull, paralelisht, sepse secila ka rëndësinë e vet.

Krahas problemeve që shtruam për Sekretariatin e Komitetit Qendror, dëshiroj të theksoj që secili nga sekretarët e Komitetit Qendror ka përgjegjësinë dhe kompetencat e veta dhe, siç na ka këshilluar Byroja Politike, secili duhet të mendojë dhe të veprojë me iniciativë. Gjërat e vogla t'i zgjidhin vartësit, të cilët nuk duhet t'i rrrethojnë sekretarët e Komitetit Qendror me çështje që mund t'u japid rrugë vetë. Sekretarët e Komitetit Qendror t'u japid përgjegjësi shokëve drejtore dhe këta vartësve të tyre, në mënyrë që sekretarët e Komitetit Qendror të mendojnë për probleme më të mëdha, të cilat janë të shumta. Në këtë mënyrë sekretarët e Komitetit Qendror do të shfrytëzojnë mirë kapacitetin e njerëzve, po kështu edhe sekretarët e komiteteve të Partisë të rrtheve.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**TELEGRAM NGUSHULLIMI DËRGUAR KQ TË PK
FRANCEZE ME RASTIN E VDEKJES
SË FREDERIK ZHOLIO KYRISE**

17 gusht 1958

**KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE
FRANCEZE**

Të dashur shokë,

Komunistët dhe i gjithë populli shqiptar mësuan me hidhërim të madh vdekjen e Frederik Zholio Kyrië, anëtarit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Franceze, dijetarit të shquar dhe luftëtarit të palodhur të lëvizjes ndërkombëtare të partizanëve të pages, të cilën ai vite me radhë e krycesoi.

Në emër të Komitetit Qendror të PPSH dhe të të gjithë komunistëve shqiptarë më këtë rast i shprehim, të dashur shokë, dhimbjen tonë të thellë si dhe ngushullimet tona më të përzemërtta partisë dhe gjithë komunistëve të Francës.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

GUR THEMELTAR I FITOREVE¹

6 shtator 1958

Botimi i këtij numri të posaçëm të «Izvestijas» për Shqipérinë na ka prekur thellë, sepse tregon edhe një herë dashurinë e singertë dhe kujdesin shumë të madh të njerëzve sovjetikë për vëllanë e tyre të vogël, popullin shqiptar. Për ne, ky gjest shumë miqësor, është një nder i madh, që na mbush zemrat me gëzim, sepse do të kontribuojë që lexuesit e «Izvestijas», gjithë njerëzit sovjetikë, të njihen akoma më shumë me të kaluarën dhe të tashmen e popullit tonë, të forcohen më shumë lidhjet miqësore vëllazërore që tashmë janë futur në gjakun e popujve tanë.

Populli shqiptar e ka kurdoherë parasysh se liria, pavarësia, sovraniteti i atdheut tonë, ndërtimi i socialistit, e ardhshmja e lumtur, fati i popullit tonë janë të lidhura edhe me luftën dhe me eksperiencën e Bashkimit Sovjetik.

E kaluara e popullit tonë është plot luftëra e përpjekje heroike. Për shekuj me radhë që në kohët më të lashta dhe deri tani vonë, pushtues të ndryshëm kanë

¹ Artikull i botuar në gazetën «Izvestija».

sulmuar atdheun tonë për të na mposhtur, për të na grabitur dhe për të na detyruar një jetë prej skllavi. Mbi kurrizin e tij populli ynë i vuajtur ka provuar edhe pushtimin e rëndë të të huajve edhe kërbaçin e feudalëve dhc të kapitalistëve të vendit.

Por kurrë populli shqiptar nuk është përkulur. Ai asnjëherë nuk i ka pritur me lule pushtuesit, por me armë në dorë ka mbrojtur lirinë e tij; ai kurrë nuk i ka lënë të shijnë të qetë sunduesit grabitqarë vendës. Historia jonë është një varg luftërash e përpjekjesh heroike të njëpasnjëshme për lirinë, pavarësinë, për një jetë më të mirë. Por sado trimërisht që u ka rezistuar furtunave të ndryshme, populli shqiptar asnjëherë nuk arriti të shohë ditë të bardha. Ai rronte kurdoherë me shpresë se do të vinte koha e tij, kur i lirë dhe i pavarur do të ndërtonte jetën ashtu si donte dhe ëndërronte ai.

Shpresa për popullin tonë lindi që kur në tetor të vitit 1917, jehona e Revolucionit të madh fitimtar socialist në Rusi, që shënoi një kthesë të madhe në historinë e njerëzimit, ushtoi edhe në viset më të largëta të atdheut tonë, ngjalli te populli shqiptar shpresa të bukurë se nuk do të ishte e largët dita që Shqipëria e vogël të bëhej e lirë, ku populli të ishte zot i fateve të tij.

Dhe kjo ditë erdhi më në fund. Idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit, që fituan për herë të parë në Bashkimin Sovjetik dhe lindja, rritja e zhvillimi i shtetit të parë socialist në botë, ushtruan një influencë shumë të madhe në zhvillimin e ngjarjeve në botë. Bashkimi Sovjetik u bë shpresa e lirisë dhe e pavarë-

sisë së popujve, shpresa e së ardhshmes së lumtur të tyre, modeli se si ata mund të luftonin, të fitonin dhe të ndërtonin jetën e re pa shfrytëzues. Popujt shihnin vazhdimisht se Bashkimi Sovjetik ishte miku më i mirë, mbrojtësi dhe shpëtimtari i të gjithë popujve të mëdhenj e të vegjël, armiku i papërkulur i çdo lloj shfrytëzimi dhe skllavërimi.

Partia Komuniste e Shqipërisë (sot Partia e Punës), e udhëhequr kurdoherë nga marksizëm-leninizmi dhe nga eksperienca e madhe e Partisë së lavdishme Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që në fillim e mësoi popullin tonë se liria dhe e ardhshmja e tij e lumtur do të siguroheshin vetëm duke u lidhur ngushtë me Bashkimin Sovjetik. Populli shqiptar, që e do dhe i zbaton me besnikëri porositë e Partisë së tij, në ditët e vështira të Luftës së dytë botërore i lidhi fatet e tij me ato të popujve sovjetikë, u ngrit si një trup i vetëm në Luftën e tij nacional-çlirimtare dhe me heroizëm të madh, në saje të kësaj lufte dhe të fitores historike të Bashkimit Sovjetik mbi hordhitë naziste fitoi lirinë, mori në duart e tija pushtetin. U realizua ëndrra shekullore e popullit tonë!

Partia jonë, ashtu sikurse gjatë luftës, edhe në periudhën pas çlirimtimit e mësoi popullin tonë të shikonte nga Bashkimi Sovjetik, të mësonte nga eksperienca e tij e madhe e ndërtimit të socializmit dhe me ndihmën e tij dhe të punës së vet vetëmohuese t'i përvishej me entuziazëm ndërtimit të jetës së re.

14 vjet nuk janë mbushur akoma që kur është çliruar vendi ynë. Po gjatë kësaj kohe shumë të shkurtër në historinë e një populli, Shqipëria ka bërë përparime

kolosale në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës, në përmirësimin e jetës së popullit. Nga një vend i prapambetur, vendi ynë është kthyer në një vend të përparruar agraro-industrial dhe shpejt ai do të bëhet akoma më i pasur, akoma më i bukur. Në saje të punës vetëmohuese të popullit tonë dhe të ndihmës që po na jepin Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjerë vëllezër të kampit të socializmit, Shqipëria do të bëhet në një kohë jo shumë të largët një kopësht i lulëzuar.

Po këto suksese historike të popullit tonë nuk janë arritur lehtë. Në rrugën tonë ne jemi ndeshur me vëشتirësi dhe me pengesa të panumërtë, të brendshme e të jashtme. Arniqtë e jashtëm e të brendshëm, imperialistët e ndryshëm, sidomos imperialistët amerikano-anglezë dhe revisionistët jugosllavë, nuk kanë lënë gjë pa bërë për të penguar popullin shqiptar në rrugën e tij dhe për të përbysur pushtetin tonë popullor. Ata kanë pasur në këtë punë armiqësore përkrahjen e mbeturinave të reaksionit të brendshëm, që ëndërrojnë të rikthejnë të kaluarën. Po të gjitha planet djallëzore të imperialistëve dhe të revisionistëve jugosllavë kanë dështuar me turp në saje të guximit dhe të vendosmërisë së popullit tonë.

Këto ditë, kur në mbarë vendin tonë po festohet me madhështi muaji tradicional i miqësisë shqiptaro-sovjetike, populli shqiptar manifeston më shumë se kurdoherë dashurinë e madhe dhe mirënjohjen më të thellë për popujt vëllezër sovjetikë, miqtë e tij më të ngushtë në ditë të mira dhe në ditë të vëshitura.

Populli shqiptar e ruan dhe do ta ruajë si gjënë më

të shtrenjtë miqësinë me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe nuk ka e nuk do të ketë forcë në botë që ta prishë këtë miqësi. Çdo përpjekje dhe propagandë e imperialistëve dhe e revisionistëve të marksizëm-leninizmit për të njollosur miqësinë tonë të përzemërt do të dështojë si kurdoherë me turp. Populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, do ta ngrëjë kurdoherë lart flamurin e shenjtë të miqësisë me Bashkimin Sovjetik dhe në unitet të pathyeshëm me të gjitha vendet e kampit socialist me Bashkimin Sovjetik në krye ai do të ecë përpara drejt fitoreve të reja për realizimin e qëllimeve të larta të ndërtimit të socializmit dhe për triumfin e paqes në botë. Forcimit të unitetit të çelniktë të vendit tonë me vendet vëllezër të kampit të socializmit, Partia e Punës dhe populli shqiptar do t'i kushtojnë edhe në të ardhshmen vëmendjen më të madhe, të gjitha forcat e tyre.

Duke përfituar nga ky rast, unë, në emër të gjithë Partisë dhë të popullit tonë, i uroj gjithë popullit mik dhe vëlla sovjetik suksese të mëtejshme në ndërtimin e komunizmit dhë në luftën fisnike që bën atdheu i lavdishëm i Leninit për ruajtjen dhe për forcimin e paqes në botë. Populli shqiptar dhe komunistët shqiptarë i sigurojnë vëllezërit e dashur sovjetikë dhe Partinë e lavdishme të Leninit se te nc ata kanë dhe do të kenë në shekuj miqtë dhe shokët më besnikë, se ne do ta mbajmë kurdoherë lart flamurin e lavdishëm të leninizmit, flamurin që nxori popullin tonë nga errësira në drithë, nga vuajtjet në rrugën e begatshme të socializmit.

Të rrojë dhe të kalitet në shekuj miqësia e madhe
në mes të popullit shqiptar dhe të popujve vëllezër
sovjetikë!

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Izvestija», Nr. 229
(12845), 24 shtator 1958*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**NGA FJALA NE PRITJEN E DHENE NGA
AMBASADA BULLGARE NE TIRANE ME RASTIN
E 14-VJETORIT TE CLIRIMIT TE BULLGARISE**

9 shtator 1958

I dashur shoku Dimitri Dimov,

I dashur shoku ambasador,

Shokë dhe miq,

Më lejoni t'ju sjell përshëndetjet më të përzemërta të popullit shqiptar, të Partisë së Punës dhe të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë me rastin e festës së madhe të çlirimit të popullit vëlla bullgar dhe t'i uroj këtij, Partisë Komuniste Bullgare dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Bullgarisë suksese akoma më të mëdha në ndërtimin e shoqërisë socialiste. Kjo fitore e madhe, që u arrit 14 vjet më parë në saje të luftës heroike të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike mbi hordhitë naziste kurorëzoi me sukses përpjekjet dhe luftërat e vazhdueshme për liri të popullit bullgar dhe aspiratat shekullore të masave të gjera punonjëse.

Populli bullgar, i bashkuar ngushtë si një trup dhe i udhëhequr nga Partia Komuniste Bullgare, i ndih-

muar vëllazërisht nga Bashkimi Sovjetik dhe në bashkëpunim të ngushtë e të sinqertë me vendet e tjera socialistë, ia ka ndryshuar krejt fytyrën atdheut të vet, me kombinate e uzina të mrekullueshme, me qytete të reja socialistë, me zhvillimin e madh dhe të gjithanshëm të bujqësisë dhe të kulturës së re socialistë.

Është e pamundur, shokë dhe miq, të numërohen këtu të gjitha ato që janë bërë në Bullgari gjatë këtyre 14 vjetëve, por ne shprehim gjëzimin e madh tonin kur themi se sukseset e popullit vëlla bullgar janë të mëdha. Mjafton të kujtosh se gjatë dy planeve të para pesëvjeçare u rrit 7 herë prodhimi industrial dhe u kolektivizua 91 për qind e tokës së punueshme. Perspektiva të mëtejshme i çelen popullit bullgar me direktivat e planit të tretë pesëvjeçar, duke caktuar si detyrë zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë sociale, zgjerimin e bazës materiale të saj, forcimin gjithnjë më tepër të marrëdhënieve sociale në prodhim dhe rritjen e prodhimit industrial 60 për qind e të prodhimit bujqësor 35 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e dytë; po kështu ato parashikojnë rritjen e pagës reale të punonjësve të fshatit dhe të qytetit jo më pak se 30 për qind në krahasim me vitin 1957. Në mbarim të pesëvjeçarit të tretë, brenda më pak se 30 ditëve punë, Bullgaria do të prodhojë aq prodhime industriale sa prodhonte Bullgaria kapitaliste në vitin 1939.

Pak janë 14 vjet, por, kur populli i drejton vetë fata të tij, kur çdo gjë bëhet për të mirën dhe në interes të popullit, kur në rrugën e lumturisë ke ndihmën e Bashkimit Sovjetik, gjithshka mund të arrihet. Sukceset e Bullgarisë motër e vërtetojnë edhe një herë këtë.

Populli shqiptar, i cili ushqen një dashuri të madhe e simpati të veçantë për popullin punëtor e paqedashës bullgar, gëzohet shumë për këto fitore dhe për perspektivat e shkëlqyera që i hap plani i tretë pesëvjeçar. Popullin shqiptar e lidh një miqësi e vjetër tradicionale me popullin trim e liridashës bullgar. Lufta nacional-çlirimtare e përtëriti, e zhvilloi dhe e forcoi akoma më shumë këtë miqësi. Marrëdhëniet e ngushta vëllazërore që na lidhin sot frymëzohen nga idealet e përbashkëta për ndërtimin e socializmit dhe për ruajtjen e paqes, nga ndjenjat e internacionalizmit proletar dhe të bashkëpunimit të singertë midis popujve.

Përfundimi më 1947 i Traktatit të miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke, nënshkrimi i një sërë dokumentash me karakter ekonomik e kultural, nënshkrimi së bashku i Traktatit të Varshavës, i Deklaratës së Moskës dhe i Manifestit të paqes, shkëmbimi i delegacioneve qeveritare e parlamentare e kanë çelnikosur miqësinë tonë tradicionale dhe i kanë forcuar pozitat ndërkombëtare të të dy vendeve tona në gjirin e kampit të fuqishëm socialist që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik. Vizita e delegacionit qeveritar bullgar me në krye shokun Anton Jugov ka qenë një ndihmë e madhe politike për Republikën Popullore të Shqipërisë dhe ka kontribuar shumë në forcimin e gjithanshëm të lidhjeve vëllazërore midis dy popujve tanë. Sot vizita e delegacionit parlamentar bullgar në vendin tonë është një shprehje tjetër e miqësisë së singertë midis dy vendeve, është një kontribut i ri në forcimin e lidhjeve të ngushta dhe vëllazërore midis popullit shqiptar dhe popullit bullgar, të cilët ecin krah për krah dhe të bashku-

ar si një trup i vetëm në rrugën e paqes dhe të socializmit. Në këtë rrugë të përbashkët populli vëlla bullgar i ka dhënë dhe i jep një ndihmë frutdhënëse popullit tonë, sidomos në sektorin e bujqësisë. Ndihma në kredi, pregetitja e kuadrove tanë të rinj në Bullgari, eksperienca e shokëve bullgarë dhe e specialistëve që kanë punuar e punojnë në vendin tonë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e ekonomisë së vendit.

Të bashkuar si asnjëherë tjetër, në saje të politikës së drejtë të partive dhe qeverive tona, popujt e të dy vendeve, së bashku me popujt e tjerë të familjes sonë të madhe me në krye Bashkimin Sovjetik, kanë dhënë dhe japid kontributin e tyre për triumfin e paqes dhe të socializmit.

Qeveritë e vendeve tona kanë ndjekur dhe ndjekin një politikë të jashtme marksiste-leniniste dhe në përputhje me parimet e bashkëjetesës paqësore midis popujve. Nëpërmjet deklaratave të tyre ato kanë përkrahur vazhdimisht luftën e popujve për liri dhe pavarësi, duke demaskuar dhe duke luftuar ashpër përpjekjet e imperialistëve luftënxitës dhe qëllimet e tyre grabitqare. Imperialistët, dhe në radhë të parë qarqet reaksionare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përpilen të ngjallin vatra lufte, t'i mbajnë popujt nën zgjedhë dhe të nxjerrin kështu fitime siç kanë bërë kohët e fundit në Lindjen e Aférme dhe të Mesme. Këtij qëllimi i përgjigjet edhe provokacioni i poshtër i tyre në ngushticat e Taivanit. Por popujt u mësuan tashmë me të tilla gjëra, u mësuan të shohin dështimin me turp të të gjitha provokacioneve imperialiste sepse kundër tyre

luftojnë me këmbëngulje forcat e paqes. Ne jemi të bindur se përpëra forcës së madhe të popullit kinez, që gjëzon përkrahjen e plotë të vendeve socialiste dhe të vendeve të tjera paqedashëse, të njëjtin fat të turpshëm do të pësojë edhe ky provokacion. Populli kinez do të fitojë dhe, në fund të fundit, imperialistët do të ikin duarbosh edhe nga Taivani.

Ne ecim të sigurtë dhe me besim të patundur në fitoren tonë përfundimtare, në ngadhnjimin e socializmit dhe në sigurimin e paqes. Imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, revisionistët e Beogradit, përpigen të përcajnjë unitetin e çelnikët të kampit të fuqishëm të socializmit dhc unitetin e lëvizjes punëtore ndërkombëtare. Popujt tanë e dinë mirë se ç'janë revisionistët jugosllavë, të cilët janë munduar shumë herë të ndërhyjnë në punët e tyre të brendshme. Tani që atyre iu çorr maska dhc u pa qartë fytyra e tyre e vërtetë, e gjithë bota i njeh si agjentë provokatorë në shërbim të imperializmit, të cilët luftojnë kundër interesave të vendeve socialiste.

Populli shqiptar dhe populli bullgar, të udhëhequr nga partitë e tyre marksiste-leniniste, do të luftojnë për të forcuar gjithnjë e më shumë unitetin e vendeve tona, e partive tona me partitë e tjera komuniste dhe punëtore motra se kështu garantohet më së miri pavarësia jonë, ndërtimi socialist i vendit dhe ruajtja e paqes në Ballkan dhe në botë. Ata do të dinë kurdoherë të jenë vigjilentë dhe të luftojnë krah për krah dhe si një trup i vetëm kundër të gjitha përpjekjeve të imperializmit, që synon të dobësojë kampin tonë dhe të na rrëmbejë fitoret tona socialiste. Popujt e kampit të socializmit

janë të sigurtë në fitoret tona të mëdha edhe në të ardhshmen.

Në fund shoku Enver Hoxha ngriti dolli për popullin vëlla bullgar, për Partinë Komuniste të Bullgarisë, për miqësinë e pathyeshme midis dy popujve shqiptar dhe bullgar.

Botohet për herë të parë si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MBI DISA MASA PËR PËMIRËSIMIN E PUNËS SË KËSHILLAVE POPULLORE TË LOKALITETEVE

16 shtator 1958

KRYESISE SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH

Nga kontrolli që bëri aparati i Komitetit Qendror për punën e këshillave popullore të lokaliteteve në rrethet Durrës dhe Sarandë, si dhe nga konsulta që u mbajt në drejtorinë e organeve të Partisë, rinisë dhe bashkimeve profesionale pranë aparatit të Komitetit Qendror të PPSH, ku morën pjesë edhe shokë të grupit të inspektorëve të pushtetit popullor, të Kryeministrisë, si dhe të degës së këshillave popullore të Presidiumit të Kuvendit Popullor, rezulton se edhe pas organizimit të ri është treguar pak kujdes për ngritjen e rolit të pushtetit në lokalitet.

a) Në fakt u dërguan njerëz më të mirë në lokalitet si kryetarë dhe sekretarë, u plotësuan ato me teknikë të mesëm për bujqësinë etj., por niveli dhe metoda e punës së tyre pothuajse nuk ka ndryshuar. Kooperativave bujqësore u jepet nga lokalitetet një ndihmë shumë e kufizuar, e paorganizuar mirë dhe sënkë e shko. Këtu pengon, natyrisht, niveli i ulët i

kryetarëve dhe i sekretarëve të lokaliteteve, kultura e paktë që kanë ata, sidomos në drejtim të problemeve të kooperativave bujqësore.

b) Nga ana e komiteteve ekzekutive të rretheve u jepet lokaliteteve një ndihmë shumë e paktë. Nuk ndihmohen si duhet ato për të funksionuar në rregull si këshillë e si komitet ekzekutiv, si organ i rregullt i pushtetit lokal, por i përdorin si «të plotfuqishëm» të tyre ose i kapërcejnë fare.

c) Edhe ndihma nga Kryeministria, e sidomos nga Presidiumi i Kuvendit Popullor në këtë drejtim, ka qenë e pamjaftueshme.

Duke pasur parasysh sa u tha më sipër duhet të merren këto masa:

1. — Zëvendëskryeministri që merret me pushtetin lokal duhet të kujdeset më seriozisht për përmirësimin e punës nga komitetet ekzekutive të rretheve dhe të lokaliteteve, të sigurohet për to një ndihmë më e mirë.

2. — Për të edukuar kryetarët dhe sekretarët e lokaliteteve, të hapet pranë shkollës së kuadrove të kooperativave bujqësore një kurs 3-4 mujor me një program të veçantë, ku t'u shpjegohen vendimet kryesore që kanë të bëjnë me punën e tyre, si dhe gjërat më të domosdoshme për njojen e problemeve të kooperativave bujqësore. Gjithashtu në rrethe të organizohen seminare të rregullta mujore me ta, ku jo vetëm të jepen udhëzime për problemet korrente, por të punohen edhe tema të ndryshme për zgjerimin e horizontit të tyre.

3. — Për t'u ardhur në ndihmë punonjësve të

pushtetit lokal në përgjithësi s'do të jetë keq të botohen manuale me ligjet, urdhëresat dhe vendimet kryesore që kanë të bëjnë me punën e tyre. Njëkohësisht mund të botohen broshura të vogla me udhëzime për punën praktike të pushtetit lokal.

4. — Në seminarin që do të mbahet me kryetarët e komiteteve ekzekutive të rretheve të flitet edhe për punën që duhet të bëjnë ata me këshillat popullore të lokaliteteve për të ngritur rolin e tyre.

Ne mendojmë se këto çështje duhet t'i shikojë Kryesia e Këshillit të Ministrave dhe të marrë masa sa më parë.

Nga ana jonë do të udhëzohen komitetet e Partisë që t'i kenë parasysh këto çështje dhe të ndjekin zgjidhjen e tyre.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

ORIENTIME KRYESORE QË DUHEN MARRE SI BAZE PËR HARTIMIN E PLANIT TË TRETE PESËVJEÇAR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

17 shtator 1958

Dëshiroj të bëj edhe unë disa vërejtje parimore rrëth projektit të planit pesëvjeçar që na është paraqitur për shqyrtim.

Çështja e parë që dua të theksoj është nevoja e përmirësimit të punës së planifikimit. Duke u nisur nga pikëpamja se në çdo pesëvjeçar problemet na paraqiten më të komplikuara, nga organet e përpunimit të planeve duhet një kujdes më i madh e një punë më serioze. Edhe nga udhëheqja e Partisë kërcohët më tepër vëmendje për t'i studjuar ato më thellë. Në këtë drejtim përgjegjësia që bie mbi ne si udhëheqje e Partisë është

¹ Në këtë mbledhje që u zhvillua më 16-17 shtator 1958 u diskutua mbi shifrat orientuese kryesore të projektpolanit të tretë pesëvjeçar.

e madhe. Kur themi udhëheqje e Partisë nuk kuptojmë vetëm 3-4 vetë dhe as Byronë Politike, por të gjithë Komitetin Qendror, i cili, për shifrat kryesore të çdo pesëvjeçari, duhet të jetë në dijeni, në mos nëpërmjet mbledhjeve të plenumit, të cilat nuk mund të zhvillohen në çdo kohë, duhet menduar që në një mënyrë ose në tjetrën, anëtarët e plenumit të dinë se ku janë bazuar shifrat e planit pesëvjeçar dhe cilat janë orientimet kryesore që përbëjnë boshtin e këtij plani. Natyrisht, një ndihmë të madhe duhet t'i japë udhëheqjes Komisioni i Planit, sepse ai për këtë qëllim është krijuar.

Këtu për shembull përmendet, dhe është e drejtë, që ky plan pesëvjeçar është hartuar në bazë të planit perspektiv me afat të gjatë, i cili është përpunuar sipas studimeve të bëra, realizimeve tona dhe mundësive të mëtejshme të zhvillimit të ekonomisë. Por, në qoftë se pyesim shumë shokë të udhëheqjes, do të thonë vetëm ato që kanë dëgjuar për këtë çështje dhe jo më shumë. Mjaft nga anëtarët e Komitetit Qendror pothuaj nuk i dinë orientimet e përgjithshme të këtij plani perspektiv. Kjo nuk duhet të ndodhë. Nuk është e drejtë që udhëheqja e Partisë të lihet pa u vënë në dijeni për disa gjëra, nëpërmjet të cilave ajo do të njohë perspektivën e ndërtimit të socializmit, sepse këto perspektiva, nëpërmjet planeve pesëvjeçare duhet të përcaktohen nga udhëheqja e Partisë. Prandaj nuk duhet pritur mbledhja e plenumit dhe anëtarëve të tij t'u jepet një material e t'u kërkohet të mendojnë e të jatin ndihmën e tyre. Pra, është e domosdoshme që ne të mendojmë si t'ia japim këto gjëra me kohë udhëheqjes.

Po si do t'ia japim udhëheqjes këto materiale?

Shokët e Komisionit të Planit mund t'i shtypin këto plane dhe t'ia dërgojnë udhëheqjes. Po mua më duket se nuk duhet vepruar kështu. Ai është një plan perspektiv, që ka të mirat dhe dobësitet e veta. Prandaj, nga ana e Komisionit të Planit të Shtetit ka mundësi të përpunohen me kohë disa orientime kryesore, që t'i jepen udhëheqjes së Partisë si material sqarues, mbi bazën e të cilave është ndërtuar një plan perspektiv, në mënyrë që shokët e udhëheqjes të dinë ku po ecim. Çështja është që të shikohet nga të gjithë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror, në çdo sektor që ata punojnë dhe për të gjithë sektorët e jetës së vendit tonë se cilat janë realiteti, lufta, vështirësitet që ekzistojnë dhe ç'duhet bërë. Kjo do ta ndihmojë shumë udhëheqjen e Partisë në këtë drejtim, kjo do të jetë një shkollë e madhe për të, sepse kur udhëheqja e Partisë u futet studimeve të tillë, ajo mësohet të kapë kyçin e problemeve, të njohë e të dijë thelbin e çështjeve në lidhje me planin perspektiv.

Kur vjen çështja për planin pesëvjeçar, Byrosë Politike veçanërisht duhet t'i vijnë disa probleme kyçe, të studjuara mirë dhe të kuptueshme, që të mos thonë pastaj shokët e Byrosë Politike: «këtë çështje nuk e kam të qartë». Veç kësaj këto gjëra nuk duhet t'i jepen Byrosë Politike të gjitha së bashku, sepse përbëjnë një material voluminoz. Ato duhet t'i jepen asaj pjesë-pjesë që më përpara në mënyrë që të jemi më të sigurtë për çështjet që do të vendosim. Ja, për shembull, ne diskutuam në këtë mbledhje çështjen e ndërtimit të hekurudhave, për të cilat u dhanë edhe mendime. Ka nga këto mendime që nuk figurojnë fare në projekt. Komisioni

i Planit thotë të ndërtohet hekurudha në një drejtim, Spirua thotë në një drejtim tjeter, Abdyli ka mendim të mos planifikojmë fare hekurudhë edhe në këtë pesëvjeçar, kurse unë them se, që të ndërtosh një hekurudhë, duhet më parë të jetë e qartë se çfarë do të transportosh, të kesh materiale të rënda dhe volume të mëdha si mineral kromi, hekur, plehra minerale, naftë etj. Ndërtimi i hekurudhave është një problem shumë i rëndësishëm, që ka të bëjë me përparimin e ekonomisë, por nă kushtojnë edhe shumë, prandaj duhet t'i studjojmë me shumë kujdes, të shohim cilat linja janë më të leverdisshme, ku janë perspektivat më të mëdha të zhvillimit të ekonomisë, distancat më të shkurtëra dhe pastaj të vendosim. Mund të jetë me leverdi për shembull vija Vorë-Milot, po edhe kjo do studjuar. Meqenëse kërkohen investime të mëdha, problemin e hekurudhave dhe të ndërtimit të porteve ta shikojmë së bashku. Për portin e Vlorës mendoj se në këtë gjendje që jemi nuk i kemi mundësitë që t'i futemi. Hë për hë të përmirëscjmë atë që kemi duke pasur parasysh çfarë mund të bëjmë për pjesën ku transportohet nafta si dhe për anijet e peshkimit. Për këtë qëllim të parashikohen edhe investimet e mundshme. Përsa i përket një porti lë madh tregëtar në Vlorë, kjo i përket perspektivës dhe duhet studjuar. Ja se si pleksen problemet, të cilat duhen parë të lidhura me njëra-tjetrën. Prandaj, është koha që Byrosë Politike t'i paraqitet një studim i vëçantë mbi ndërtimet e hekurudhave në vendin tonë, duke përfshirë anën e tyre ekonomike, politike, strategjike etj.

Ose të marrim çështjen e qomyrit. Nga të gjithë

thuhet se qomyri do te zevendesohet me solar ose me naftë. Po kush e ka vendosur dhe si eshtë vendosur kjo çështje? Ky eshtë një problem mjaft i madh që kërkon studim, sepse kalojmë përfundimisht nga një energji që kemi përdorur deri tani, në një energji tjetër. Pra, kjo çështje nuk mund të kalohet vetëm me fjalët se «kemi më shumë leverdi», «kemi pak qymyr». Këto mund të jenë të vërteta, por Byrosë Politike problemi duhet t'i vijë i studjuar më përpara, në mënyrë që kur çështja të diskutohet këtu, në mbledhje të Byrosë Pelitike, secili të flasë me kompetencë dhe të vendosim drejt që qomyri për shembull të shfrytëzohet në köta sektorë, kurse në sektorët e tjera të përdoret nafta.

Ose le të marrim çështjen e gazit. Ashtu si paraqitet në materialin që na eshtë dhënë, çështja e gazit trajtohet deri në ngritjen e fabrikave për fije sintetike. Ne le të sigurojmë gazin të paktën për nevojat e plehrave azotike që kanë një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për bujqësinë, për nevojat e ngrohjes së qyteteve dhe pastaj të mendojmë për fijet sintetike. Për probleme të tilla duhet të bindet e gjithë Byroja Politike, pse nuk është vetëm çështja se duhet të sigurohet gaz, po ka edhe çështje të tjera, siç eshtë për shembull, ajo e tubacioneve, për sigurimin e të cilave ka vështirësi të mëdha. Prandaj, të mos bëjmë hapa të shpejtuar, pa pasur mirë të dhënat dhe llogaritë. Nga ana e Komisionit të Planit l'i preqatitet Byrosë Politike një studim kompleks për gazin e naftës. Vetëm në rast se bindemi që gaz tani kemi, mendoj se problemi i ndërtimit të një uzine për prodhimin e plehrave azotike eshtë aktual dhe duhet ta bëjmë. Nuk jam dakord me Komisionin e Planit, po

me Mehmetin, që sigurimi i plehrave kimike është i një rëndësie shumë të madhe për ekonominë tonë. Prandaj ta ndërtojmë këtë uzinë, ndryshe kulturat bujqësore nuk mund të jepin rendimentin e duhur, gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me ngritjen e nivelit të jetesës së popullit tonë. Prodhimi i plehrave azotike hyn në degën e industrisë, po në fakt këto janë investime që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me zhvillimin e bujqësisë.

Leverdi ka edhe sigurimi i tubacioneve për sjelljen e gazit që të zëvendësojmë drutë, po për këtë të vendosim pasi të na paraqitet studimi. Kjo çështje lidhet edhe me qymyrin, të cilin mendoj se duhet ta destinojmë atje ku duhet, ta shfrytëzojmë dhe jo ta lëmë të dëmtohet, për shkak se nuk tërhiqet në kohë, nuk transportohet, po mbetet në miniera. Ajo që thuhet në lidhje me ngrohjen e qyteteve me qymyr, mbetet në letër. Në rast se kemi qymyr sa ta përdorim edhe për ngrohje, atëhere të ulim koston dhe ta përdorim duke marrë masa serioze. Por mua më duket se kjo s'ka mundësi të bëhet, prandaj studimi për përdorimin e qymyrgurit duhet të synojë që ai të jetë sa më i leverdisshëm dhe të mos themi kaq shpejt se atë do ta zëvendësojmë me solar dhe me naftë. Neve duhet të na paraqiten studimet përkatëse për të parë nëse do të bëjmë rikonstrukcionin e mekanizmave për përdorimin e solarit apo të gazit për djegie. Në këtë mënyrë të shikonim edhe perspektivën e zëvendësimit të qymyrit me gaz edhe për ngrohjen e qyteteve. Por këto çështje nuk mund të trajtohen pa studime të thelluara të mbështetura mbi disponibilitetet, leverdinë si dhe të gjithë kompleksin.

Ka nga fabrikat tona që nuk janë ndërtuar për t'u shfrytëzuar në mënyrë racionale dhe me kosto të ulët duke përdorur gzin si burim energjie, po jemi bazuar te qomyri. Prandaj disa fabrika që mund të ndërtojmë të kemi parasysh nëse do t'i vëmë ose jo në lëvizje me naftë, apo do të përdorim qomyrin. Disa fabrika, që do të ngrihen, siç janë ato të tullave ose ndonjë fabrikë çimentoje mund të punojnë me qymyr, kjo kërkon që problemin ta studjojmë mirë në bazë të lëndëve djegëse që kemi, po edhe ku do t'i përdorim ato dhe në asnjë mënyrë të mos e pakësojmë rëndësinë e nxjerrjes së qomyrit.

Studimet që mund t'i vijnë Byrosë Politike do të shërbejnë për të gjithë udhëheqjen, duke përfshirë edhe anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror, të cilët është e domosdoshme të marrin njohuri për këto gjëra. Ne kemi në këtë mbledhje, për shembull, shokun Ramiz Xhabia, anëtar i plenumit, që Partia e ka ngarkuar për shfrytëzimin e naftës. Ai duhet të dijë se si do të zhvillohet ekonomia jonë në vija të përgjithshme. Në këtë mënyrë ai do të punojë më mirë që të mos ndodhin më në naftë ato që kanë ngjarë. Ai mund të ketë të drejtë përsa u përket veglave të këmbimit, çështje që e ngriti edhe këtu, por duke qenë në dijeni mbi bilancin e import-eksportit dhe të vështirësive që ne kemi në këtë çështje, ai do t'i kërkojë këto vegla sepse duhen, por do të përpinqet që t'i shfrytëzojë ato deri në fund dhe t'i mbrojë si pika gjaku. Por unë jam i sigurtë se shoku Ramiz, ashtu si dhe shumë shokë të tjerë udhëheqës nuk ka dijeni për të gjitha çështjet kryesore. Kjo kërkon që ne ta organizojmë medoemos punën që shokët e

Komititetit Qendror të jenë në dijeni të të gjitha çështjeve.

Për t'ia arritur kësaj, duhet që jo vetëm Komisioni i Planit ta ndryshojë punën, po edhe ne këtu, në aparatin e Komitetit Qendror. Prandaj sekretarët e Komitetit Qendror të tregojnë më shumë kujdes se deri tanë, që këto materiale të vijnë në kohë nga Komisioni i Planit ose nga Kryeministria dhe, kur kanë nevojë, të kërkohet që të plotësohen, pastaj të shërbejnë si për Byronë Politike, ashtu dhe për Plenumin e Komitetit Qendror. Në këtë drejtim ne duhet të ndërrojmë metodën e punës, se situatat kanë ndryshuar, niveli i njerëzve është ngritur, prandaj paralelisht me këtë gjendje të re që është krijuar edhe studimet tona duhen preqatitur më mirë, se kështu edhe udhëheqja do të vendosë sa më drejt.

Çështja e dytë që duhet të kemi parasysh është se hartimi i këtij plani është i lidhur edhe me miqtë tanë jashtë. Ne duhet ta shikojmë edhe këtë anë të problemit. Rëndësi ka në këtë rast që edhe në marrëdhënie me miqtë, ka gjëra në plan që duhen korrigjuar në bazë të vërejtjeve e të propozimeve që u bënë në këtë mblidhje. Them kështu që të mos marrim angazhime as të mëdha as të vogla, por të marrim ato që janë reale.

Po çfarë kërkesash duhet t'u shtrojmë miqve? Këtu është çështja e ndihmës që do të kërkojmë prej tyre dhe e shifrave që duhet të angazhohemi për eksport. Kreditë që do të kërkojmë nga miqtë përbëjnë një bazë të rëndësishme për planet tona dhe mendoj se është e crijtë që edhe ne të jemi të arësyeshëm në kërkesat tona duke i argumentuar ato. Miqtë nuk do të na lënë

pa ndihmë. Po ka disa gjëra që varen se ku dhe si do të na ndihmojnë ata.

Dihet se ndihmat në kredi miqtë do të na i japin për investime, për të fuqizuar ekonominë tonë, industrinë dhe bujqësinë. Përsa u përket kredive për mallratë konsumit të gjerë osë për sigurimin e lëndës së parë për industrinë, në këtë drejtim kemi gjetur shumë vështirësi, bila që në vitin 1950, kur ne mund t'u thoshim miqve të na jepnin, se nuk kishim si bënim pa to e ku t'i gjenim. Mirëpo tani flasim për vitin 1960, prandaj kërkesat tona ndaj miqve duhet të jenë të matura dhe të argumentuara.

Pra, në hartimin e planit të kërkesave duhet të kemi parasysh që ato të jenë sa më shumë të shtërnguara. Të vendosim një herë investimet kapitale që kanë të bëjnë me shtimin e prodhimit, veçanërisht në industri e në bujqësi. Ne duhet të jemi shumë të shtërnguar në harxhimin e valutës sonë në sektorët e tjerë, duke marrë parasysh se kemi shumë mungesa në shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve ekzistuese, në harxhime të tępërtë të materialeve e tjetrë, për të cilat duhet të marrim masa që ta forcojmë punën tonë.

Këto ishin dy çështje parimore, për të cilat besoj se shokët s'kanë ndonjë kundërshtim. Tani kisha edhe disa çështje konkrete, të cilat kanë të bëjnë gjithashtu me projektin që na është paraqitur.

Lidhur me naftën. Nafta jonë është shumë e nevojshtme për ne dhe për niqtë tanë. Me naftën në përgjithësi ne ecim mirë, me gjithë mungesat e vështirësitë, të cilat janë vështirësi të rritjes, të ecjes përpëra. Prandaj, ne duhet të marrim të gjitha masat dhe të jemi më

mirë të armatosur për të realizuar planin. Nuk është mirë as për ekonominë tonë as për prestigjin e Komitetit Qendror dhe të qeverisë që ne ta zbresim parashikimin e vendosur për nxjerrjen e naftës në vitin 1960. Kjo nuk është aspak serioze dhe na kushton si ekonomikisht ashtu edhe politikisht. Tani Komisioni i Planit kërkon që, për të mbuluar mosrealizimet, në shumë mallra të importit ne të futim gërvshërët. Këtë çështje ne mund ta shqyrtojmë edhe në një mbledhje të veçantë të Byrosë Politike.

Unë jam dakord me propozimet që bënë shokët këtu që të shtohen shpimet e kërkimet. Po të ketë mundësi të studjohet edhe çështja që, përveç Marinëzës të bëhen edhe tri fusha të tjera. Rëndësi për ne ka çështja që të dimë ku është nafta. Edhe debitin mesatar për pusht e Marinëzës ne duhet ta korrigojmë, po të mos bëjmë më gabime duke caktuar një debit mesatar përtëj mundësive reale.

Raporti që na ka paraqitur qeveria për shpime tregon se ne duhet të jemi shumë të shtërnguar në drejtim të shpejtësisë së sondave, të veglave të ndërrimit, të kujdesit që duhet treguar kundër avarive. E them këtë sepse, nga njëra anë kemi shumë vështirësi në importimin e këtyre materialeve dhe, nga ana tjetër, nuk është e drejtë që të mos i shfrytëzojmë ato si duhet. Ne kërkojmë nga të gjitha ndërmarrjet që të shtohet shfrytëzimi sidomos i maqinerisë së naftës. Të tregohemi më të aftë për të frenuar importimin e veglave të ndërrimit. Vëglat e këmbimit duhet të jenë nën një kontroll e rregulla shumë të rrepta dhe, veç kësaj, të forcohet edhe baza e remontit.

Këto vërejtje duhet t'ua bëjmë edhe shokëve të naftës, se e ardhshmjë e naftës dhe zbulimi i fushave të reja ka rëndësi, po nuk duhen lënë pasdore fushat ekzistuese. Nuk është e drejtë të neglizhohet, për shembull, fusha e Patosit dhe e Qytetit «Stalin». Prandaj të këmë mendjen, t'u bëjmë shërbimin fushave të vjetra, t'i shfrytëzojmë si duhet materialet, të bëjmë kërkime dhe konturime. Unë kisha biseduar një herë sikur të ndahej Marinëza nga Patosi, kjo le të shikohet, por kombinati është në vështirësi pse Marinëza nuk jep sa duhet.

Duhet të fillohet nga shpimet e thella mbi 3000 m. edhe në Patos edhe në Qytetin «Stalin». Nuk duhet të lëmë pa verifikuar Qytetin «Stalin» dhe Patosin ku këmë shumë puse nafte. Edhe në të ardhshmen, pra, ne duhet t'i zhvillojmë puset e thella dhe të mos i shpërndajmë shumë forcat. E them këtë se çështja e Qytetit «Stalin» ka rëndësi të madhe, se atje kemi një qytet të tërë në këmbë. Më vonë do të kalojmë edhe gjetkë në shpime të thella.

Uzinën e ferro-kromit kemi leverdi të madhe ta ndërtojmë, sepse kështu vlerësohet kromi ynë, për këtë s'besoj të kemi ndonjë kundërshtim, po unë mendoj se kjo çështje do biseduar më parë me vendet të cilave do t'u kërkojmë kreditë që nevojiten për këtë qëllim. Gjithashtu për fabrikën e letrës nuk vendosim dot ta bëjmë ose jo pa studjuar problemin e lëndës së parë.

Edhe uzinën e fosforiteve ta ndërtojmë, pasi edhe ajo është me leverdi, po sigurisht pasi të sqarohen të gjitha kushtet përsa u përket apatiteve, evadimit dhe përdorimit të acidit-sulfurik, etj. Unë them se mund ta

bëjmë edhe këtë, natyrisht kjo varet edhe nga ndihma që do të na jepet nga miqtë. Këto gjëra ne duhet t'i përcaktojmë.

Për prodhimin në vend të pjesëve të këmbimit, edhe unë mendoj, siç u tha këtu, që ky kapitull të rishikohet krejtësisht me qëllim që për veglat e ndërrimit të ngremë një uzinë tjetër mekanike si ajo që kemi në Tiranë dhe të arrijmë që një pjesë të madhe të pjesëve të këmbimit të mos e importojmë, por ta prodhojmë në vend.

Jam dakord edhe me mendimin që neve na duhet çimentua, po është e domosdoshme të shohim llogarinë përfundimtare, të bëjmë me kujdes bilancin e çimentos dlie këtë fabrikë të re ta bëjmë afër burimeve të lëndës së parë, të energjisë dhe të ndërtimeve kapitale. Kjo duhet parë me kujdes që të mos na dalin gjëra të papritura.

Për ndërtimin e një sërë fabrikash ose ndërmarrjesh, më duket se nuk kemi ide shumë të qarta. Në këtë drejtim dukemi si pak dorëlëshuar, gjë që mund të rrjedhë edhe nga ndikimi i specialistëve që na vijnë nga jashtë e që na sjellin si model fabrikat e mëdha. Kështu për shembull, Fabrika e Likusit në Elbasan mund të bëhej më e thjeshtë, kurse na kushtoi shumë. Po kështu edhe fabrikat e përpunimit të rrushit na kushtojnë shumë, prandaj mund të kërkohet që ato të ndërtohen më të lira, pra, më të thjeshta. Po të mendojmë dhe të veprojmë kështu, nuk do të harxhojmë edhe shumë valutë. Ose për prodhimin e mëndafshit, më parë ne duhet të sigurojmë lëndën e parë, manet, prodhimin e mëndafshit të fillojmë ta përpunojmë në

mënyrë artizanale ose ta eksportojmë dhe më vonë të shikojmë nëse do të ngremë një fabrikë mëndafshi. Edhe fabrikën e eternitit ta shohim në lidhje me azbestin, éshtë mirë që lëndën e parë ta sigurojmë në vend.

Jam dakord për ndërtimin e fabrikës së konservimit të peshkut dhe të bëhen përpjekje që të gjendet edhe treg për peshkun. Të merren masa që të peshkohet kudo qhe plani i peshkut të mos ulet. Për këtë qëllim të merren masat e nevojshme, të sigurohen anije, të pre-gatiten kuadro të aftë që të shtojnë prodhimin dhe t'i jepet popullit më shumë peshk.

Përsa i përket mishit të derrit, në qoftë se ai na kushton shumë shtrenjtë dhe nuk kemi leverdi, atëherë edhe ne duhet ta hamë atë si e hanë të tjerët, dome-thënë ta bëjmë sallam, proshutë, suxhuk dhe të përzier me mishra të tjera që të bëhet i shijshëm. Në rast se nuk do të konsumohet në vend, po të ketë leverdi, të eksportohet. Mishin e derrit nuk e futim dot menjëherë në popull se disa s'e hanë atë, disa të tjerë nuk do ta hanë po të jetë i shtrenjtë. Prandaj duhet të bëhen përpjekje që derri të na kushtojë lirë.

Këtu, në material, nuk éshtë përmendur fare problemi i qumshtit, i djathit, i gjalpit etj. dhe nuk shohim asnjë masë për forcimin e industrisë së lehtë përpunimin e tyre.

Edhe rrugët automobilistike, qoftë ndërtimi i rrugëve të reja, qofshin asfaltimet ose meremetimet, na marrin shuma të mëdha investimesh. Ne duhet t'i ndreqim rrugët, po jo të shpejtojmë e të veprojmë jashtë mundësive. Sikur të ecim një çikë më me kujdes, të ndërtojmë e të meremetojmë ato që janë të ngar-

kuara me trafik më të madh e më të rëndë, ndërsa të tjerat t'i rishikojmë. Pastaj në këto vepra të kërkojmë edhe ndihmën e ushtrisë.

Ka edhe vërejtje të tjera në drejtim të rishikimit të investimeve edhe për ndërtimet. Ky problem duhet përpunuar me tendencë që investimet të ulen. Se sa do të jetë kjo ulje, kjo duhet parë dhe jo vetëm në objektet kryesore, po edhe në objektet e tjera, për një pjesë të të cilave ne nuk kemi të dhëna. Është më mirë që objektet t'i marrim e t'i shohim një nga një sikurse bëmë me pesëvjeçarin e dytë. Prandaj për këtë çështje Komisioni i Planit të Shtetit të bëjë një punë pregatitore sipas orientimit të Byrosë Politike, që investimet të mos jenë shumë të rënda, të mos bëhen shumë ndërtime joprodhuese, pa cënuar banesat, për të cilat duhet të shpejtohem ca, sepse në fund të pesëvjeçarit të tretë do të bëhen 21 vjet çlirim dhe nuk mund të ecet si deri tani. Të kihet parasysh se duhen marrë masa dhe përzbukurimin e qyteteve, për hartimin e planeve rregulluese të tyre, për ruajtjen e shëndetit të popullit etj., se të gjitha duhen. Është e domosdoshme që këto çështje të shikohen në një prizëm të favorshëm se janë të nevojshme, natyrisht duke përjashtuar gjërat e luksit.

Në sektorin e ndërtimeve kemi shumë dobësi dhe ato mund të bëhen më të mëdha me këto investime kolosale. Kjo duhet të na preokupojë seriozisht. Ç'duhet bërë atëhere? Ky është një problem shumë i vështirë, prandaj Byroja Politike dhe qeveria t'i japin rëndësi të madhe forcimit të punës në Ministrinë e Ndërtimit. Ndërtimet te ne zënë një vend të madh. Ministria e Ndërtimit me organizmat dhe ndërmarrjet e saja ndër-

ton fabrika, termocentrale, hidrocentrale, rrugë, ura, porte, shkolla, banesa, bën bonifikime, kanale etj. Nuk mjaftojnë këto, po i themi të prodrojë edhe materiale ndërtimi. Përsa i përket strukturës së ministrisë dhe të ndërmarrjeve që varen prej saj, më duket se këtë duhet ta shohim më mirë e më thellë, të shohim nëse vëllimit të madh të punës i përshtatet ose jo struktura ekzistuese, organizimi i sotëm.

Shtabi i Ministrisë së Ndërtimit jo vetëm duhet të plotësohet, por të jetë një udhëheqje e shëndoshë, të ndjejë thellë përgjegjësinë e madhe që ka, të forcojë kontrollin e vet, të jetë një kokë drejtuese, t'u japë si duhet tonin gjithë punëve të ndërtimit deri në bazë. Kjo kërkon që organizimit më të mirë të punës në qendër t'i përgjigjet edhe një organizim më i mirë i punës në bazë. Atje ka një farë ndarjeje, ka ndërmarrje të veçanta për bonifikim etj., po kjo ndarje duhet të rishikohet, të bëhet edhe një ristudim i shpérndarjes së kuadrove të ndërtimit, qofshin të lartë ose të mesëm, inxhinierë dhe teknikë, në proporcione më të drejta midis këtyre ndërmarrjeve, sipas rëndësisë dhe numrit të punonjësve të tyre. Pra, duhet ta rishikojmë organizimin në këtë sektor, të krijojmë një situatë më të shëndoshë, sepse në Ministrinë e Ndërtimit, jo për faj të saj, megjithëse ndërmarrjet janë të ndara, ka një pleksje të tillë të problemeve që vështirësojnë situatën dhe janë një pengesë shumë e madhe. Ne po harxhojmë miliarda lekë për banesa, për ndërtimin e të cilave duhet një ndërmarrje e veçantë. Kështu edhe për bonifikimet që kanë një karakter të veçantë, për rrugët e urat, hekurudhat etj. Prandaj, duke marrë parasysh

investimet dhe ndërtimet e mëdha që ka Ministria e Ndërtimit ne duhet ta forcojmë këtë ministri, të forcojmë dhe organizmat e saj në bazë, të cilat ta ndjejnë si duhet përgjegjësinë e tyre për të kryer të gjitha detyrat dhe të zhduket konfuzioni që ekziston në këtë sektor.

Unë kam qenë dhe jam i mendimit që Ministria e Ndërtimit t'i ketë vetë materialet e ndërtimit, se kështu si është sot nuk del përgjegjësia. Ky problem mund të shihet, që sektorit të ndërtimit t'i jepet, për shembull, çimentua, sharrat, tullat etj. Mundet që edhe mos i jepen të tëra, po një kategori materialesh i duhen dhënë. Kjo nuk do të thotë që t'i japim ndërtimit punislitet e artizanatit dhe ai të merret me prodhimin e gëlqeres. Ose të marrim prodhimin e dyerve e të drितareve të gatshme. Këto mund t'i ngarkohen t'i prodrojë një ndërmarrje me këto zdrukthtarë që kemi. Por edhe kjo çështje duhet studjuar nëse ka leverdi ta marrë ndërtimi, apo ta mbajë industria.

Duke u nisur nga orientimi që ka dhënë Byroja Politike lidhur me rritjen e ritmeve të prodhimit industrial duhet që Komisioni i Planit të punojë në këtë drejtim dhe të bëjmë të gjitha përpjekjet që ritmi mesatar vjetor i rritjes të jetë mbi 11-12 për qind ose, po të jetë e mundur, edhe më lart. Kjo kërkon që rendimentet të venë duke u rritur. Shifrat që janë parashikuar të rishikohen jo në fryshten dikasteriale, po në fryshten e interesit të përgjithshëm të zhvillimit të ekonomisë. Po kështu të shihet edhe ulja e kostos. Përsë i përket pagës reale të punonjësve, të kihet parasysh që ajo të ngrihet mbi 30 për qind. Kështu të mendohet

edhe për rritjen e të ardhurave të fshatarësisë. Të gjitha këto duhen bërë sipas mundësive tonë.

Për sektorin e bujqësisë në përgjithësi jam dakord me ato që thuhen në material dhe me vërejtjet e shokëve. Për këtë sektor shoku Hysni bëri mjaft vërejtje, bille në detaje. Këto vërejtje janë mjaft të vlefshme. Do të kemi kohë që t'i diskutojmë e t'i thellojmë mjaft propozimet që u bënë për bujqësinë, por çështja kryesore në këtë sektor është ajo e bonifikimeve. Disa ne i kemi filluar dhe të tjera do të fillojmë. Këto janë aksione me rëndësi, që shtojnë fondin e tokës dhe të ardhurat e punonjësve të qytetit e të fshatit. Po në këtë drejtim mendoj se edhe mund të frenohemi pak. Për shembull, sikur ta heqim bonifikimin e Karavastasë, mundet, në rast se shihet e arësyeshme, të heqim edhe objektin e bonifikimit Lezhë-Mat e të studjojmë bonifikimin e Durrësit. Duhet parë se cila ka më tepër rëndësi. Në Hoxharë mund edhe të shtojmë diçka dhe të tre objektet që përmenda t'i lëmë për më vonë. Përsa i përket kostos së tyre, në shikimin e parë duket shumë e madhe, po nuk di si është llogaritur, a hyjnë në të të gjitha shpenzimet, duke përfshirë edhe amortizimet e maqinerive? Për këtë duhet të jemi të qartë. Në rast se nuk hyn amortizimi i ekskavatorëve, atëhere ato kushtojnë qimet e kokës. Pastaj, nuk dimë sa përfaqësojnë mekanizmat e tjera që do të sjellim për bonifikimet. Pra, të studjojen mirë këto çështje. Që ne duhet të luftojmë për hapjen e tokave të reja, kjo s'ka diskutim, por deri në ç'masë, kjo duhet parë. Këto gjëra t'i saktësojmë.

Shifrat për arësimin e shëndetësinë të qëndrojnë si

janë, se ato që parashikohen janë të arësyeshme të bëhen. Mund të ketë edhe gjëra të vogla për të shtuar ose pakësuar, po në përgjithësi për këta sektorë shifrat janë parashikuar mirë.

Parashikimin e të ardhurave nga turizmi, nga cigaret etj. të mos e bëjmë kaq të shtërnguar. Edhe rezervat e qeverisë që parashikohen në material mendoj se duhet të jenë më shunië.

Në fund, doja të thoshja se është e domosdoshme që t'i vëmë Komisionin e Planit dhe ministritë e ndryshme përpara përgjegjësisë, sidomos Ministrinë e Industrisë dhe atë të Bujqësisë, që t'i paraqitin udhëheqjes ekzaktërish koston e shumë fabrikave të përfunduara, si qëndron çështja e amortizimit të tyre, si për shembull çështja e Fabrikës së Sheqerit, e Hidrocentralit «Karl Marks» etj., në mënyrë që të kemi një ide të saktë se sa na kanë kushtuar këto ndërmarrje që kemi ngritur dhe për ç'arësyte na kanë dalë kaq të kushtueshme, jashtë parashikimeve.

Tani duhet caktuar data për ripunimin e të gjithë këtij projekti, të cilin ta shohim më parë me shokët e Kryesisë së Këshillit të Ministrave dhe ta bëjmë gati për një mbledhje tjetër të shpejtë të Byrosë Politike me karakter informativ, ku të jepen shifrat e përgjithshme dhe të merret aprovimi.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

TE AKTIVIZOJME MË MIRE ANETARET E PLENUMEVE TE KOMITETEVE TE PARTISE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

24 shtator 1958

Problemi që shqyrtojmë ka të bëjë me forcimin e mëtejshëm të Partisë, prandaj duhet të na preokupojë të gjithëve. Përveç vërejtjeve të drejta që u bënë në këtë mbledhje, kisha dhe unë për të thënë disa fjalë.

Format e punës organizative të Partisë nuk duhet të jenë statike, po të ndryshueshme, në përshtatje me kushtet e reja të kohës. Lidhur me këtë çdo organ dhe organizatë partie të jetë në luftë, për të zbatuar kurdo-herë forma të reja pune. Këtë të përpinqemi ta bëjmë realitet çdo ditë duke aktivizuar të gjithë Partinë, të gjithë komunistët. Çdo anëtar partie ta ndjejë veten si një udhëheqës dhe të gjithë, udhëhecqja e Partisë nga lart dhe baza e Partisë nga poshtë, të jenë më aktivë.

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Mbi disa çështje të punës organizative të Partisë».

Si ta bëjmë këtë? Forumet udhëheqëse të Partisë nuk punojnë si duhet për të aktivizuar anëtarët e tyre, të gjithë kuadrot. Shpeshherë punët mbarojnë me mbledhjet e plenumeve dhe, anëtarët e tyre, pas mbledhjes, vazhdojnë punën e zakonshme. Plenumi i komitetit të Partisë duhet të mendojë si të vërvë në lëvizje jo vetëm anëtarët e tij, por të gjithë anëtarët e Partisë. Elbasani, për shembull, ka në Cërrrik 1-2 anëtarë plenumi, po kështu në sharra etj., të cilët janë njerëz të kualifikuar. Por këta anëtarë plenumi nuk e luajnë mirë rolin e tyre si udhëheqës partie, ata nuk ndihmojnë si duhet organizatat bazë dhe drejtoritë, që këto të bëhen luftarake, për të zhdukur dobësitë dhe të metat në punë. Është e domosdoshme që anëtarët e plenumeve të komiteteve të Partisë të bëhen me të vërtetë u-lëheqës të Partisë kudo që janë dhe instrukturët e sekretarët e komitetit të Partisë të mbajnë kontakte të gjalla me ta. Duke u vënë në lëvizje të gjithë anëtarët e plenumeve, ata do të luftojnë më mirë për të gjallëruar edhe organizatat bazë. Ne kemi mundësi që këtë ta arrijmë, sepse kudo tani ata janë më të kualifikuar. Edhe në organizatat bazë ka plot njerëz, që njojin për shembull problemin e kostos, të normave etj., por, me gjithkëtë, ata nuk merren sa duhet me problemet për të cilat i dhëmb ndërmarrjes. Komitetet e Partisë dhe sekretarët e tyre akoma nuk e kanë kuptuar mirë se problemet s'mund t'i zgjidhin vetëm me instrukturët. As sekretarët e as instrukturët e komiteteve të Partisë nuk mund të gjenden kudo dhe të japid mendime për çdo gjë; këtë rol duhet ta luajnë më tepër anëtarët e plenumeve. Kjo duhet të na preokupojë. Anëtarët e

plenumit duhen aktivizuar. Ata dhe anëtarët e thjeshtë të Partisë duhet të bëhen të ndërgjegjshëm për detyrat e mëdha që kanë, të shohin e të shqyrtojnë gësh-tjet në fryshtën e Partisë dhe të mbajnë lidhje të ngush-ta me komitetet e Partisë.

Të mos kënaqemi me formën e re të organizimit duke prishur qarqet. Ne kemi suksese, por kemi dhe dobësi. Është e vërtetë se tani jemi më të lidhur me bëzën, po ana negative në metodën e punës së komiteve të Partisë është se sekretarët dhe instruktorët e tyre i rrëmbejn bujqësia. Komiteti Qendror e ka detyrë serioze organizimin e edukimit të punëtorëve të Partisë në punë e jashtë saj, për t'i bërë ata të aftë të ve-projnë në të gjitha drejtimet, të drejtojnë si duhet jetën dhe punët në rrëthim e tyre. Prandaj, të përmirë-sohet vazhdimi i instruktazhi dhe të armatosen ata për të gjitha problemet.

Instruktorët të mos janë njerëz prakticienë. Puna e tyre është një shkollë e madhe, po ajo duhet organizuar mirë. Sekretarët e komiteve të Partisë të kenë lidhje të mira me ta e t'i dëgjojnë me vëmendje për punën që bëjnë, t'u japid atyre udhëzime të bazuara në dobësitë e vërtetuara dhe në detyrat që dalin. Instruktazhi të përmirësohet nga vetë sekretarët e komiteve të Partisë, të cilët nuk duhet të interesohen vetëm për sektorët që ndjekin dhe të humbasin përgjegjësinë që kanë për të gjithë rrëthim. Kjo përbën rrezikun më të madh në praktikën e tyre. Të mos harrojmë rolin që ka sekretari i komitetit të Partisë si një nga udhë-heqësit në rrëth. Ndryshtë do të dobësohet përgjegjësia kolegiale në punë. Këto pasoja do të evitojnë nëse se-

kretarët e komiteteve të Partisë e kuptojnë thellë përgjegjësinë që kanë për problemet e ndryshme, që duhet të ndjekin në të gjithë rrithin.

Udhëheqja e komiteteve të Partisë në rrethe të organizojë mirë seminaret me sekretarët e organizative bazë, të përmirësohet cilësia e punës së tyre. Kur seminaret zhvillohen në bazë zone, të drejtohen nga një sekretar i komitetit të Partisë dhe jo nga instruktori i zonës. Këto seminare të mos janë vetëm për udhëzime e direktiva, po të hapin perspektiva të reja për të mobilizuar Partinë dhe popullin. Për ndonjë problem që preokupon të gjithë rrithin, seminari mund të bëhet në bazë rrithi, nën drejtimin e sekretarit të komitetit të Partisë.

Nga ana e tij, Komiteti Qendror ta shfrytëzojë më mirë këtë eksperiencë. Ka filluar një punë më e mirë me inspektorët. Por është e domosdoshme të nxjerrim nga eksperiencia disa tema, që t'ua referojmë kuadrove nga pikëpamja teorike dhe praktike. Drejtoritë e Komitetit Qendror duhet të punojnë më shumë për edukimin e kuadrove të Partisë.

Interesimi për kuadrin është një problem me rëndësi. Inspektorët e instruktorët e Komitetit Qendror këtë punë nuk e ndjekin si duhet duke mbajtur edhe evidencë mbi përshtypjet që kanë për punën e kuadrove, për të pasuruar karakteristikat e tyre, që janë shumë të vlefshme për t'i njojur ata në punë e sipër dhe, këto t'ua bëjnë të ditura sekretarëve të komitetit të Partisë, që ky njeri është i mirë, i zgjuar, me iniciativë. Lufta për socializmin nxjerr njerëz të rinj, kuadro të rinj. Ne kemi plot njerëz të tillë në plenumet e komiteteve

të Partisë që punojnë në qendra të ndryshme. Detyra jonë është që të përmirësojmë e të çojmë përpara punën e tyre.

Jam dakord që kemi përparime në pranimet për anëtarë partie, por duhet më shumë kujdes për edukimin e tyre. Sa të jetë e mundur të bëhen më pak përjashtime. Përjashtimet e shumta tregojnë se puna politike e ideologjike nuk është në lartësinë e duhur. Komitetete të Partisë t'u themi se punët e bujqësisë etj., do të venë më mirë, kur të forcohen organizatat bazë, në të cilat të mos ketë, për shembull grindje etj., por punë revolucionare. Prandaj, komitetet e Partisë, çështjes së edukimit t'i kushtojnë rëndësi më të madhe, se kjo influencon edhe në realizimin e planeve. Po të bëhet më mirë edukimi, edhe masat ndëshkimore do të jenë më të pakta.

Masat ndëshkimore deri te përjashtimi nga Partia kanë ndodhur edhe për shkak të kujdesit jo të mjaftueshëm për këto probleme. Tani ka ardhur koha që të vihen mirë përpara përgjegjësisë ata që bëjnë rekomandime për të hyrë në Parti. Kjo të ngrihet me forcë. Ai që rekomandon ta ndjejë thellë përgjegjësinë. Puna e tij nuk mbaron vetëm me rekomandimin që bën, ai ka për detyrë edhe ta edukojë komunistin e ri që rekomandon, me qëllim që ky të jetë shembull në çdo drejtim.

Gjithashtu duhet të tregohet më shumë kujdes për të shtuar radhët e Partisë me gra. Ky problem ka rëndësi dhe duhet të na preokupojë më tepër, se ka sektarizëm, i cili është i dëmshëm dhe është më i theksuar sidomos në fshat, ku gruaja nënveftësohet. Të futen

në Parti ato gra që meritojnë, që janë besnikë për Partinë, që luftojnë e janë të vendosura për socializmin.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP

TE MERREN TE GJITHA MASAT POLITIKO-ORGANIZATIVE DHE TEKNIKE PER TE PERFUNDUAR BONIFIKIMIN E THUMANES

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

26 shtator 1958

Bonifikimi i Thumanës është një aksion me rëndësi të madhe politike dhe ekonomike për rrethin e Krujës veçanërisht, prandaj komiteti i Partisë i këtij rrethi duhet të ishte marrë seriozisht me këtë aksion. Fshatarësia jonë është e gatshme të ndërtojë vepra, por ajo e bën këtë kur komiteti i Partisë merr masa konkrete organizative dhe politike për sqarimin dhe mobilizimin e saj. Nuk mjaftojnë vetëm parullat, por duhet organizim e përpjekje, për t'i vënë ato në jetë.

Nuk lejohet që Komiteti i Partisë i rrethit të Krujës të mos mendonte për të kriuar me kohë organizatën bazë të Partisë në kantierin e Thumanës, e cila do të

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth punës së organizatës së Partisë në kantierin e bonifikimit të Thumanës.

udhëhiqte punën që në fillim për ndërtimin e kësaj vepre. Puna në këtë objekt duhej organizuar me anëtarë partie, të cilëve, që në ditët e para, t'u ngarkoheshin detyra të caktuara dhe përgjegjësi e plotë. Nuk mjaf-tonin vetëm tre anëtarë partie sa u dërguan, po duhej një grup i tërë komunistësh, që të vinte në rrugë fillimin e punimeve në kantier. Është e qartë se bonifikimi i Thumanës është nënvleftësuar si nga Komiteti i Partisë i rrethit të Krujës, ashtu dhe nga Ministria e Ndërtimit dhe nga Drejtoria e Industri-Ndërtimit pranë Komitetit Qendror, e cila duhej të kishte vënë para përgjegjësisë ministrinë që kjo të bënte punën që i takonte. Komiteti i Partisë i rrethit duhej të kishte menduar me kohë që disa komunistë, bile nga më të zotët dhe nga më organizatorët, pasi t'i udhëzonte mirë e t'u tregonte rëndësinë e objektit, t'i dërgonte atje e të udhëhiqnin punën. Kjo nuk u bë, prandaj edhe puna çaloi. Çështja e këtij aksioni të madh nga ana e komitetit të Partisë mund të jetë shtruar vetëm në mënyrë propagandistike, por nuk është ndjekur me këmbëngulje.

Të marrim problemin e punës vullnetare të fshatarësisë. Është dhënë udhëzimi që 25 për qind e volumit të punimeve në bonifikimin e Thumanës të realizohej me kontributin vullnetar të fshatarësisë, por kjo nuk është arritur në shkallë rrethi, sepse ka munguar organizimi i punës, për t'ua bërë të qartë fshatarëve se kjo është për të mirën e tyre. Grafiku që është bërë për këtë qëllim ka mbetur në letër. Mundësitet kanë qenë dhe janë që edhe ky grafik të realizohej, edhe punët e tjera të fshatit të mos mbeteshin pa u kryer. Por kjo kërkonte që në çdo

organizatë bazë partie të fshatit të ngarkoheshin 1-2 anëtarë partie përgjegjës për të siguruar forcat vullnëtare, të cilat të ishin gati për të punuar në aksion. Ose mund të krijuar grupë me anëtarë partie sipas sektorëve, ku të kishte përgjegjës të caktuar për çdo koperativë. Një herë në muaj këta të mblidheshin në bazë sektori, të analizonin punën, të koordinonin detyrat dhe të merrnin masa pér zbatimin e tyre. Mirëpo në çdo fshat nuk ka përgjegjës të tillë, që organizata bazë të informohet e t'u kërkojë llogari pér punën që bëhet.

Për këtë objekt duhej t'u caktoheshin detyra edhe instruktorëve e sekretarit të komitetit të Partisë të zonës. Me një organizim të tillë do të sigurohej realizimi i planit të veprës, natyrisht, pa neglizhuar detyrat e tjera veçanërisht ato të bujqësisë. Gjithë këta njerëz duhej të ishin nën kontrollin e komitetit të Partisë pér zbatimin e vazhdueshëm të detyrave dhe nën drejtimin teknik të ndërmarrjes. Pra, kjo punë duhej organizuar me kujdes, se nuk është e lehtë të kryhet. Organizimi i shëndoshë i punës nga ana e Partisë është faktor me rëndësi pér realizimin e detyrave të caktuara. Kështu duhet të punojnë edhe rrëthet e tjera ku po ndërtohen vepra bonifikimi. E them këtë sepse ndërsa në rrëthin e Krujës, me gjithë të metat, është bërë diçka pér bonifikimin e Thumanës, në rrëthet e tjera mund të themi se nuk është shtruar fare kjo çështje, në kundërshtim me vendimet e Byrosë Politike.

Forcimi i Partisë dhe i punës së saj në këto vepra ka rëndësi të madhe, sepse ato kryhen jo vetëm me djersë e me propagandë, por edhe me organizim të mirë e me ndjekje të vazhdueshme të problemit të tyre nga

ana e komitetit të Partisë. Prandaj caktimi në çdo fshat i një përgjegjësi skuadre, që t'i mbledhë njerëzit në kohë, t'i nisë në punë, t'i kontrollojë për zbatimin e normave dhe të organizojë emulacionin midis tyre — të gjitha këto janë të domosdoshme për zbatimin deri në fund të detyrave. Puna e Partisë është shumë e vështirë, sepse ajo ka të bëjë me njerëzit, që kanë gjithfarë pikëpamjesh, por në rast se mobilizohet si duhet e gjithë Partia, të gjitha levat e saja, duke bërë secili punën e vet, atëhere nuk ka problem që të mos zgjidhet. Duhet thënë që, edhe Ministria e Ndërtimit, për të metat e vërtetuara në punën e saj, duhet të marrë masa serioze për t'iu përgjegjur plotësisht vendimeve të Komitetit Qendror dhe të Këshillit të Ministrave, ndryshe puna dëmtohet. Po kështu edhe Drejtoria e Ndërmarrjes së Bonifikimit të Thumanës të kryejë më mirë detyrat e veta. Ajo duhet të organizojë mirë punën, se populli nuk ka vetëm një detyrë, atë të bonifikimit të Thumanës, por ka edhe shumë probleme të tjera për të zgjidhur e shumë detyra të tjera për të kryer.

Komiteti i Partisë të influencojet që të përmirësohet furnizimi i kantierit, duke u caktuar një përgjegjës për këtë çështje në komitetin ekzekutiv. Të merren gjithashtu masa edhe për strehimin dhe défrimin e punëtorëve, për të cilët kantieri duhet të kujdeset më shumë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verballi i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

ZHVILLIMI I KULTURES DHE I ARTIT KERKON NJË ORGANIZIM DHE DREJTIM MË TË MIRE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

26 shtator 1958

Të aktivizohen më mirë institucionet ekzistuese në fshat². Organizatave bazë të Partisë të fshatit, t'u rekmandohet që t'u kushtojnë rëndësi akoma më të madhe shtëpive dhe vatrave të kulturës. Detyra e tyre është që, duke aktivizuar të gjithë njerëzit më të pregatitur që ka fshati ynë, institucionet kulturale të bëhen qendra të rëndësishme dhe të zhvillojnë aktivitet për edukimin dhe për argëtimin e masave të fshatarësisë.

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua gjendja dhe masat për formimin e për zgjerimin e punës kulturale në fshat si edhe gjendja e kuadrit në sektorin e kulturës e të artit dhe masat për përmirësimin e saj.

² Në atë kohë në fshat ekzistonin 545 shtëpi popullore leximi. Me vendim të Sekretariatit të KQ të PPSH, Nr. 324, datë 26.9.1958, që u muar në këtë mbledhje, paskëtaj në fshat krijojen dy kategori institucionesh: shtëpi kulture dhe vatra kulture.

Organizatat e Partisë, si udhëheqëse të gjithë jetës edhe në fshat, është e domosdoshme të bëjnë punën e tyre, por ka rëndësi që në shtëpitë dhe në vatrat e kulturës të caktohen drejtues të përshtatshëm, të cilët të marrin pjesë njëkohësisht edhe në prodhim. Natyrisht, këta nuk do të jenë shumë të zënë me punë prodhuese, me qëllim që të kenë kohë të mendojnë e të organizojnë aktivitete kulturale, por pjesëmarrja në prodhim do t'i ndihmojë ata që, duke punuar bashkë me popullin, të njohin jetën dhe problemet e tij. Ndryshe është vështirë që puna kulturale t'i shërbejë si duhet edukimit, argëtimit, prodhimit. Përgjegjësi i këtyre institucioneve është mirë të jetë arësimtar, që të luajë si duhet rolin e organizatorit, të drejtuar nga Partia dhe të vërë në lëvizje të gjithë njerëzit e tjerë me kulturë e me eksperiencë. Sigurisht, kjo punë do të bëhet gradualisht dhe ka mundësi të realizohet, sepse në fshat arësimtarët përbëjnë një forcë të madhe¹. Megjithatë, atje ku s'ka mundësi që në krye të shtëpisë së kulturës të vihet një arësimtar i zoti, atëhere mund të jetë një njeri tjetër me kulturë, organizator i mirë.

Sa për pajisjen materiale të shtëpive e të vatrave të kulturës duhet të mendojnë e të kontribuojnë vetë kooperativat bujqësore. Në kooperativat më të mëdha e më të grumbulluara të ndërtohen shtëpi kulture të mira. Edhe organizata e Frontit mund të përdorë një pjesë të fondeve për ndonjë shtëpi kulture. Prandaj, problemet e kulturës në fshat është e domosdoshme të preokupojnë më tepër jo vetëm Ministrinë e Arësimit

¹ Atëherë në fshat vendi ynë kishte 4 550 arësimtarë.

e të Kulturës, por sidomos Ministrinë e Bujqësisë dhe Drejtorinë e Bujqësisë pranë Komitetit Qendoror.

Çështjet e kulturës në fshat ne duhet t'i shohim jo vetëm për sot, por sidomos në perspektivë. Për këtë, problemi më i rëndësishëm është ai i sigurimit të kuadrit për kulturën dhe artet, për fshatin dhe qytetin. Propozimet, që na bëhen, mendoj t'i pranojmë dhe t'ia propozojmë Byrosë Politike që të futen në planin pesëvjeçar. Por të mbajmë mirë parasysh që të mos nënvliftësohen kuadrot e vendit, të cilët kanë eksperiencë. Për shembull shumë nga pjesëtarët e orkestrës, megjithëse janë pa shkollë, për veglat e tyre janë mjeshtër, aftësitë i kanë fituar me praktikë. Po të rishikohen mirë këta kuadro mund të gjenden disa nga më të mirët dhe të caktohen si pedagogë për të mësuar kuadro të rinj që të përdorin disa vegla. Kështu do të sigurohen kuadro në masë, pse vetëm me anë të konservatoreve nuk mund të zgjidhet problemi. Pra, të mos nënvliftësohen mundësittë tonë për preqatitjen e kuadrove, të trajtohen mirë ata, të lehtësohen nga detyrat e vogla që kanë, të cilat mund t'i kryejnë të tjerë. Në këtë mënyrë ne do të shfrytëzojmë si duhet kapacitetin e kuadrove tanë, me të cilët ka mundësi që të bëhet një punë më e kualifikuar edukative. Pra, për zhvillimin e kulturës e të artit duhet organizim dhe drejtim më i mirë.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

**FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA
KINEZE NË TIRANË ME RASTIN E 9-VJETORIT
TË THEMELIMIT TË RP TË KINES**

1 tetor 1958

I dashur shoku ambasador,

Të dashur shokë dhe miq,

Jam shumë i gëzuar që më jepet rasti në këtë ditë festë dhe gëzimi për popullin e madh kinez, në ditën e 9-vjetorit të themelimit të Republikës Popullore të Kinës, të sjell këtu përvjetoretjet e zjarrta të popullit shqiptar, të Partisë së Punës dhe të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë për popullin e madh kinez, për Partinë e lavdishme Komuniste dhe Qeverinë e Republikës Popullore të Kinës, për udhëheqësin e shquar të popullit kinez, shokun Mao Ce Dun dhe t'u uroj atyre suksese akoma më të mëdha në ndërtimin e socializmit, në lulëzimin e atdheut të tyre, në luftën e vendosur për ruajtjen e paqes në botë.

Themelimi i Republikës Popullore të Kinës më 1 tetor 1949 është realizimi i aspiratave të popullit të madh kinez, është kurorëzimi i gjithë luftës dhe i përpjekjeve të tija shekullore për liri e për pavarësi. Në rrugën e

tij të lavdishme për paqe e lumturi, për jetë të lulëzuar dhe socializëm, populli kinez, ashtu si populli ynë dhe të gjithë popujt përparimtarë të botës, u frymëzua nga sitorja e shkëlqyer dhe ngadhnjimtare e Revolucionit socialist të Tetorit.

Gjatë këtyre 9 vjetëve, Republika Popullore e Kinës, nën udhëheqjen e ndritur të Partisë Komuniste dhe të qeverisë, në saje të punës vetëmohuese të popullit të saj të mrekullueshëm, ka korrur fitore të mëdha në ndërtimin e socializmit, në ruajtjen dhe në mbrojtjen e paqes. Vija e drejtë dhe largpamëse e Partisë Komuniste, udhëheqja e saj marksiste-leniniste, puna dhe lufta për paqe e për socializëm, e kanë bërë atë një forcë kolosale, një kala graniti të ruajtjes së paqes në botë. Pozita ndërkombëtare e Republikës Popullore të Kinës është rritur dhe është foruar. Republika Popullore e Kinës, e cila lufton për mbrojtjen e paqes dhe për ndërtimin e vendit, gjëzon përkrahjen dhe simpatinë e shumë vendeve dhe të popujve përparimtarë të botës. Ajo luan sot një rol të madh në luftën e popujve aziatiko-afrikanë për liri e për pavarësi dhe mbron me këmbëngulje të drejtat e tyre për vetëvendosje.

Partia e Punës dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë shohin në Republikën Popullore të Kinës një luftëtare të vendosur, përkrah Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste, për mbrojtjen dhe për ruajtjen e paqes në botë. Tërheqja e trupave të vullnetarëve kinezë nga Koreja dhe të gjitha masat e propozimet e saj për uljen e tensionit ndërkombëtar, për heqjen dorë nga provokacionet dhe shantazhet nga ana e imperialistëve në zonën e Lindjes së Mesme dhe të

Largët, tregojnë luftën e vendosur të Republikës Populllore të Kinës për ruajtjen e paqes në botë, politikën e saj të drejtë dhe paqësore që mbështetet në idetë e pavdekshme të marksizëm-leninizmit.

Më lejoni, shokë, të përshëndes këtu punën e madhe vetëmohuese që është bërë dhe po bëhet në Republikën Populllore të Kinës nga populli i madh kinez, nën udhëheqjen e shkëlqyer të Partisë Komuniste dhe të qeverisë, për ndërtimin me ritme shumë të shpejta të socializmit. Sukseset e mëdha, të arritura në Republikën Populllore të Kinës brenda një kohe shumë të shkurtër, janë një pasqyrë e qartë dhe një dëshmi e udhëheqjes së drejtë marksiste-leniniste të Partisë Komuniste dhe të Qeverisë së Republikës Populllore të Kinës, janë një shembull i gjallë i unitetit të madh të popullit me partinë dhe me qeverinë e tij.

Populli i madh kinez është mobilizuar me të gjitha forcat e tija për të ndërtuar socializmin në bazë të parimit: «më shumë, më shpejt, më mirë, më me ekonomi».

Sikur të hedhim një sy vetëm në disa nga rezultatet e gjashtëmujorit të parë të këtij viti, do të shikojmë se prodhimi i përgjithshëm i industrisë (pa përfshirë ndërmarrjet industriale të zhvilluara nga kooperativat bujqësore), u rrit në 34 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke plotësuar 58 për qind të planit vjetor.

Gjatë gjashtëmujorit të parë, investimet kapitale në ndërtime kanë qenë 88,1 për qind më të mëdha në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar; deri në fund të qershorit, janë vënë në shfrytëzim plotësisht ose pjesërisht 62 objekte mbi planin për industri-

në dhe minierat, janë ndërtuar 640 km. linjë hekuru-dhore dhe 3 164 km. rrugë automobilistike.

Që nga viti i kaluar fshatarësia punonjëse e Republikës Popullore të Kinës ka korrur rezultate të mrekullueshme në rendimentet bujqësore. Prodhimi i drithërave verore është shtuar 69 për qind në krahasim me vitin e kaluar; parashikohet që sivjet të prodhohen 350 milion ton drithëra, d.m.th. 500 kg. drithëra për frysë. Lëvizja e gjerë e masave për ngritjen e komuneve popullore është një revolucion i madh në jetën e popullit kinez. Që në ditët e para të ngritjes së tyre, ato arritën rezultate të shkëlqyera. Rendimentet e larta në grurë, oriz, pambuk etj., dëshmojnë për efektin e organizimit të punës së komuneve.

Hovi i arësimit dhe i kulturës në Republikën Popullore të Kinës, ku vetëm këtë vit janë hapur me iniciativën e vetë masave popullore 68 000 shkolla të mesme dhe më shumë se 400 shkolla të larta, tregon kujdesin e madh që i kushtojnë partia dhe qeveria këtij sektori të rëndësishëm.

Të dashur shokë,

Republika Popullore e Kinës është bërë dhe po bëhet gjithnjë e më shumë një kështjellë e madhe në kampin tonë socialist. Ajo ka dhënë një kontribut të çmuveshëm në forcimin e unitetit të kampit të socializmit dhe në mbrojtjen e paqes. Për gjithë këtë madhështi, për të gjitha këto suksese, ajo është halë në sy të imperializmit, i cili po bën çmos për ta penguar në ngritjen e jetës së re. Provokacionet e vazhdueshme të

imperializmit amerikan në ngushticën e Taivanit, përpjekjet dhe manevrat e tija për t'i mbajtur nën zgjedhë Taivanin dhe ishujt bregdetarë, të cilët janë tokë e pandarë e Kinës, janë një lojë e rrezikshme me zjarrin. Përkrahja pa rezerva, që i kanë dhënë të gjitha qeveritë e vendeve të kampit socialist Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për të mbrojtur të drejtat e saja legjitime dhe të pakontestueshme mbi Taivanin dhe ishujt e tjerë bregdetarë, është një tregues tjetër i unititetit, i kompaktësisë dhe i fuqisë së madhe të kampit socialist. Sulmi kundër Republikës Popullore të Kinës do të ishte një sulm kundër të gjithë kampit tonë socialist dhe njerëzimit përparimtar dhe kjo do t'i kushtonte shtrenjtë imperializmit.

Interesat e paqes kërkojnë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës t'u japid fund aventurave shumë të rrezikshme dhe pretendimeve të tyre të çmendura mbi Taivanin dhe ishujt e tjerë bregdetarë të Kinës, të térheqin menjëherë flotën e 7-të dhe forcat e tyre tokësore e ajrore nga kjo zonë. Dihet botërisht se ata i kanë pushuar ilegalisht dhe i mbajnë me anën e forcës së armëve këta ishuj, jo vetëm pör t'i skillavëruar e pör t'i shfrytëzuar, por edhe pör t'i përdorur si bazë agresioni kundër tokës kontinentale të Republikës Popullore të Kinës dhe kundër vendeve të tjera paqedashëse të Azisë. Me të drejtë populli i madh kinez është ngritur në këmbë pör të mbrojtur atdheun e vet, pör të çliruar Taivanin dhe ishujt bregdetarë që vuajnë nën kthetrat e imperializmit. Ne jemi të sigurtë se, ashtu siç deklaroi para disa ditësh shoku Çu En Lai në pritjen e 28 shtatorit pör nder të specialistëve të huaj, «në qoftë se impe-

rialistët amerikanë ngulin këmbë në provokimet e luf-tës për të zbatuar agresionin e tyre kundër ishujve Kue-moi e Macu, atëhere të 600 milion kinezët, të bashkuar si një njeri i vetëm dhe me simpatinë dhe përkrahjen e të gjithë kampit të socializmit dhe të të gjitha vendeve paqedashëse dhe popujve paqedashës, do të bëjnë që veprimet agresive të imperialistëve amerikanë të dësh-tojnë plotësisht dhe përfundimisht».

Partia dhe qeveria jonë, i gjithë populli shqiptar, mbështetin pa rezerva qëndrimin e Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës dhe të gjitha masat që ajo ka marrë. Ne kemi deklaruar botërisht dhe deklarojmë përsëri se përkrahim plotësisht, me gjithë zemër dhe me të gjitha fuqitë tona, kërkesat e drejta dhe legitime të Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për të çliruar Taivanin dhe ishujt bregdetarë nga okupatorët amerikanë dhe nga shërbëtori i tyre, tradhëtarë Çan Kai Shi, për t'u dhënë fund ndërhyrjes së patolerueshme të imperialistëve amerikanë në punët e brendshme të Kinës dhe provokacioneve e shantazheve të forcave të armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në ngushticën e Taivanit. Ne përkrahim përpjekjet e Republikës Popullore të Kinës për uljen e tensionit ndërkombëtar. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke luajtur me zjarrin, paraqitin kërkesën e tyre absurde për «ndalimin e zjarrit». Kjo nuk është gjë tjetër veçse një dredhi dhe provokacion për të legalizuar pushtimin e tokave kineze dhe për të zgjeruar agresionin kundër Republikës Popullore të Kinës.

Qeveria jonë, me anë të delegacionit të saj, përkrahu çështjen e pranimit të Republikës Popullore të Kinës

në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, sepse kjo është një e drejtë e ligjshme e saj dhe sepse, siç e dinë të gjithë, problemet e rëndësishme ndërkombëtare nuk ka si të zgjidhen sot pa pjesëmarrjen e kolosit kinez. Sot, si brenda në Organizatën e Kombeve të Bashkuara ashtu edhe jashtë saj, Qeveria e Republikës Popullore të Kinës ka një përkrahje të gjerë nga shumë vende paqedashëse dhe mekanizmi i votës, nën presionin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nuk do të mund të ketë efekt për shumë kohë. Mund të mos u vijë mirë imperialistëve amerikanë, por patjetër do të vijë dita që Kina Popullore të zërë vendin e merituar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe të çlirojë tokat e saja, të rrëmbyera arbitrarisht.

Ne ecim, shokë, të sigurtë dhe me besim të patundur në fitoren tonë përfundimtare, në ngadhnjimin e socializmit dhe në sigurimin e paqes. Vendet e kampit të socializmit, të udhëhequra me hapa të sigurtë drejt fitoreve të reja nga partitë e tyre marksiste-leniniste, kanë forcuar akoma më shumë bashkëpunimin e tyre të gjithanshëm e vëllazëror, unitetin e tyre ideologjik e politik, janë bërë kështjellë e pamposhtur e paqes dhe pengesë kryesore e vendimtare në realizimin e planeve djallëzore të imperialistëve, për të skllavëruar botën. Partia Komuniste e lavdishme e Kinës, e udhëhequr nga mësimet e Leninit të madh, duke mbajtur një qëndrim marksist, parimor, konsekuent dhe thellësisht internacionalist, ka luftuar me vendosmëri kundër çdo orvatjeje të ideologëve të borgjezisë dhe të revizionizmit modern që përpilen të shtrembërojnë dhe të mojnjë idetë e pavdekshme dhe ngadhnjimtare të mark-

sizëm-leninizmit. Ky është një kontribut tjetër i çmueshëm për forcimin e unitetit të kampit socialist, për fitoren e socializmit dhe të komunizmit, për triumfin e paqes. Imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, revisionistët e Beogradit, të cilët përpiken të përcajnë unitetin e kampit të fuqishëm të socializmit dhe unitetin e iëvizjes punëtore ndërkombëtare, nuk do të mundin t'ia arrijnë kurrë qëllimit të tyre. Popujt tanë e dinë mirë se ç'janë revisionistët jugosllavë, të cilët janë munduar shumë herë të ndërhyjnë në punët e tyre të brendshme. Me shpifjet dhe me provokacionet e tyre kundër Bashkimit Sovjetik, kundër Kinës Popullore dhe vendit tonë, kundër të gjitha vendeve socialiste, ata s'bëjnë gjë tjetër veçse vënë në jetë porositë e Uashingtonit, të cilit i shërbejnë me besnikëri dhe tregojnë në mënyrë të hapur tradhëtinë ndaj marksizëm-leninizmit.

Populli shqiptar dhe populli kinez, të udhëhequr nga partitë e tyre marksiste-leniniste, do të luftojnë krah për krah, për të forcuar gjithnjë e më shumë unitetin e vendeve tona, të partive tona me partitë e tjera motra të kampit socialist, se kështu garantohen më së miri pavarësia jonë, ndërtimi i socializmit dhe ruajtja e paqes. Ata do të dinë të janë kurdoherë vigjilentë dhe të luftojnë kundër të gjitha përpjekjeve të imperializmit, që synon të dobësojë kampin tonë dhe të na rrëmbejë fitoret tona socialiste.

Sukseset e shkëlqyera të Republikës Popullore të Kinës ne i konsiderojmë si sukseset tona; ato janë një kontribut i madh në forcimin e mëtejshëm të kampit tonë socialist, në kauzën tonë të socializmit, në kauzën e paqes. Republika Popullore e Kinës është bërë një

shtet i fortë dhe po ndërton me hapa viganë socializmin; ajo ka fituar një autoritet të madh ndërkombëtar, të cilin e ka vënë në shërbim të lirisë dhe të pavarësisë së popujve, në shërbim të paqes dhe të socializmit. Ne i urojmë me gjithë zemër popullit të madh e vëlla kinez suksese të mëtejshme në luftën e tij aktive dhe të vendosur për kauzën e paqes dhe të socializmit.

Populli ynë, Republika jonë Popullore, janë krenarë që kanë një mik të madh e besnik siç është Republika Popullore e Kinës dhe populli i saj plot talent e astësi. Ne, të dashur shokë, i jemi mirënjojës me gjithë zemër Republikës Popullore të Kinës për gjithshka ka bërë për ne, për gjithë ndihmën bujare që i ka dhënë dhe i jep vendit tonë. Ne e çmojmë ndihmën e popullit të madh kinez dhe dimë e do të dimë ta përdorim atë. Partitë dhe qeveritë tona do të vazhdojnë të bashkëpunojnë midis tyre, do t'i shtojnë dhe do t'i forcojnë akoma më shumë marrëdhëniet e ngushta dhe vëllazërore për të mirën e tyre, për të mirën e kampit tonë të fuqishëm të socializmit. Vizita e delegacionit tonë ushtarak në Republikën Popullore të Kinës është një kontribut tjetër për zgjerimin dhe për forcimin e miqësisë midis vendeve tona, midis popujve tanë dhe ushtrive tona.

Duke i uruar me gjithë shpirt popullit vëlla kinez fitore gjithnjë e më të mëdha në rrugën e shkëlqyer të socializmit dhe të komunizmit më lejoni, shokë, ta ngrë këtë dolli:

Për popullin e madh dhe të mrekullueshëm kinez!

Për miqësinë e përjetshme midis popujve tanë!

Për Qeverinë e Republikës Popullore të Kinës dhe

Partinë e lavdishme Komuniste të Kinës me në krye udhëheqësin e shquar të popullit kinez, marksist-leninistin e sprovuar, shokun tonë të dashur Mao Ce Dun!

Për forcimin e unitetit të kampit të socializmit!

Për triumfin e paqes në botë!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zeri i Popullit»,
Nr. 237 (3138), 2 tetor 1958*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

TA ZHIVILLOJMË BLEGTORINE MBI BAZA SHKENCORE

*Nga fjala në takimin me kooperativistët e Dukajt
të rrethit të Tepelenës*

4 tetor 1958

Gjatë rrugës për në Tepelenë shoku Enver Hoxha u ndal në shkollën 7-vjeçare «Selam Musai» të Sinanajt, ku bisedoi përzemërsisht me mësuesit e me nxënësit e kësaj shkolle dhe u interesua për përparimin e nxënësve në mësimë dhe për lidhjen e teorisë me praktikën. Ai bisedoi edhe me fshatarët e Sinanajt e të fshatrave të afërt. Një pritje shumë e ngrohtë iu bë shokut Enver nga kooperativistët e Dukajt. Ai, pasi u interesua për punët e kooperativës, për rendimentet që ajo ka marrë në kulturat e ndryshme bujqësore, sidomos në blektori dhe për perspektivat që ka kooperativa, tha:

Partia jonë e Punës lufton për të realizuar dëshirat e popullit, që ai të përmirësojë kushtet e jetesës dhc të rrojë në paqe. Në saje të punës vetëmohuese të masave dhe të drejtimit të urtë të Partisë për ndër-

timin e socializmit, të ndihmës së Bashkimit Sovjetik në radhë të parë, të Kinës së madhe dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore, ne kemi arritur suksesë të ndjeshme në përmirësimin e mirëqenies materiale e kulturale të punonjësve. Por, megjithatë, te ne ka akoma vështirësi. Vitet që do të vijnë do të sjellin përmirësimë akoma më të mëdha. Si rezultat i zhvillimit të mëtejshëm të industrisë, të bujqësisë e të sektorëve të tjera të ekonomisë, do të përmirësohet edhe më shumëjeta e popullit. Për të arritur këtë duhet një punë e madhe. Kooperativisët duhet të bëjnë më shumë ditë-pune të frutshme. Kooperativa juaj dhe në përgjithësi kooperativat bujqësore të rrethit të Tepelenës, kanë kushte shumë të favorshme për zhvillimin e blegtorisë, që është një sektor shumë i rëndësishëm për rrethin tuaj. Për këtë duhet punuar jo vetëm për shtimin e kërçeve të gjësë së gjallë, por edhe për përmirësimin e racës dhe mbarështrimin e saj. Prodhimi i qumshtit, i mishit dhe i leshit, akoma nuk është i kënaqshëm. Për të rritur prodhimin e gjësë së gjallë nuk mjafton vetëm ndërzimi artificial i dhënve me desh të racës, me të cilin ju keni arritur rezultate shumë të mira, por duhet treguar kujdes edhe për t'i sigruar gjësë së gjallë ushqimin e nevojshëm. Kullo-tat tuaja natyrale janë të përmendura, por blegtoria ka nevojë për ushqim të njomë gjatë gjithë vitit, pra edhe në dimër. Ky ushqim mund t'i sigurohet bagëtisë duke silazhuar sa më shumë kashtë e misër hamullor, barëra të këqia e të tjera. Tepelenasit janë të dëgjuar për blegtori, po për të marrë më shumë mish, qumësht dhe yndyrna, duhet që blegtoria të zhvillohet në baza

shkencore. Pa nënvleftësuar eksperiencën praktike, neve na duhen edhe njerëz që të kenë të paktën njohuritë elementare të shkencës zooteknike. Kjo mund të përvetësohet me anë të kurseve e të seminareve të ndryshme. Veç kësaj, kooperativat bujqësore sot kanë mundësi të dërgojnë me shpenzimet e veta djem dhe vajza të tyre në shkollat e mesme bujqësore dhe jo vetëm për blegtori, por edhe për sektorët e tjerë të ekonomisë bujqësore.

Rrethi i Tepelenës ka gjithashtu kushte të favorishme edhe për shtimin e frutikulturës dhe të vreshtave. Pas vendimeve të rëndësishme të Plenomit të Shkurtit të këtij viti të Komitetit Qendror të PPSH mbi rishqyrtimin e planit të dytë pesëvjeçar në bujqësi, edhe në këtë rreth ka filluar të bëhet një punë e mirë për mbjelljen e pemëve frutore dhe të vreshtave të reja. Por ju, shokë kooperativistë, duhet të mos kënaqeni me rezultatet e arritura deri sot, por të mbillni edhe më shumë, sidomos vreshta dhe ullinj. Kooperativat bujqësore duhet të ngjallin te anëtarët e tyre dashurinë përritjen e bletës. Ky sektor, me pak shpenzime e punë, i jep ekonomisë sonë të ardhura të mëdha. Zhvillimi i sektorit të blegtorisë, të frutikulturës dhe të bletëve, veç të tjerave, do t'u sigurojë anëtarëve të kooperativave bujqësore shumë të ardhura për ditë-pune.

Botuar për herë të parë në gazeten «Zëri i Popullit», Nr. 240 (3141), 5 tetor 1958

Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 240 (3141), 5 tetor 1958

ARËSINTARI TA EDUKOJË RININË QË AJO TË MOS U TREMBET VËSHTIRËSIVE

*Nga sjala në takimin me arësimtarët e shkollës 7-vjeçare
«Abaz Shehu» të Tepelenës*

4 tetor 1958

Në qytetin e Tepelenës shoku Enver Hoxha bëri një vizitë në varrezat e dëshmorëve dhe në shkollën 7-vjeçare «Abaz Shehu», ku u prit me shumë përzemërsi nga nxënësit dhe nga arësimtarët. Pasi vizitoi laboratorin, kabinetin e punës së dorës dhe klasat, shoku Enver pati një takim me arësimtarët e qytetit, të cilëve u dha shumë këshilla të vlefshme:

Detyra juaj, tha ai midis të tjerave, është shumë e madhe dhe fisnike. Juve Partia ju ka besuar edukimin e brezit të ri, i cili duhet jo vetëm të jetë i pajisur me njohuri teorike, shkencore, por të mësohet që të mos i trembet punës, sepse ka raste që disa të rinj që mbarojnë shkollat tonë, u tremben vështirësive, i bëjnë bisht punës kur caktohen të punojnë në rrëthe të tjera veç Tiranës dhe disa qyteteve të tjera të vendit. Më-

suesit dhe intelektualë të tjerë, duke u marrë vetëm me punë mendore, duke luftuar vetëm me argumenta teorikë, ka rrezik të shkëputen nga puna praktike, nga lufta e përditshme e masave punonjëse për ndërtimin e socializmit, të mendojnë se ata janë më të zotët dhe se qëndrojnë mbi gjithë të tjerët. Kjo gjë bën që ata të anojnë nga oportunizmi dhe të kërkojnë t'i zgjidhin çështjet jo në mënyrë revolucionare. Ja sepse duhet luftuar që t'i edukojmë njerëzit me dashurinë për punën. Kjo në radhë të parë duhet filluar nga vetë intelektualët, nga të gjithë punonjësit e administratës, që nga kuadrot më të lartë deri te më të ultët, sepse kështu ata do të kaliten e do të lidhen më mirë me masat. Juve mësuesve ju bie barra që t'i kalitni fëmijët me këtë frymë. Ne jetojmë në shekullin e shkençës moderne, prandaj duhet t'i pasuroni dituritë tuaja dhe t'u jepni rëndësi lëndëve shkencore, sepse vendi ynë ka shumë nevojë për teknikë. Një punë të madhe duhet të bëni për të lidhur shkollën me jetën.

Kujdes të tregoni për mësimin e gjuhës shqipe dhe të luftoni që nxënësit të njojin më mirë historinë e vendit tonë. Mësuesit nuk duhet të kufizohen vetëm në punën shkollore, ata duhet të ndihmojnë shumë për ngritjen kulturale të masave tona punonjëse, sidomos të fshatit. Në kooperativa bujqësore duhet të ngrihen shtëpi kulture me gjithë kuptimin e fjalës. Këto qendra kulturale nuk mund ta kryejnë misionin e tyre pa ndihmën e arësimtarëve.

Në fund shoku Enver Hoxha shprehu kënaqësinë e tij për punën e mirë që janë duke bërë arësimtarët

e rrrethit të Tepelenës për përparimin e shkollës dhe u uroi suksese të mëtejshme në punën e tyre fisnike.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i Popullit»,
Nr. 240 (3141), 5 tetor 1958*

*Botohet sëpas tekstit të nxjerrë
nga gazeta «Zëri i Popullit»,
Nr. 240 (3141), 5 tetor 1958*

NGA FJALA ME PUNONJËSIT E MINIERËS SË QYMYRGURIT NË MEMALIAJ

4 tetor 1958

Shoku Enver, duke folur para punonjësve të minierës, tha:

Ju falenderoj nga zemra për pritjen e nxehtë që më bëtë. Ky është një ndër i madh që i bëhet Partisë sonë. Populli e do me gjithë shpirt Partinë e tij, sepse ajo i solli atij këto ditë të lumtura dhe po i pre-gatit ditë akoma më të lumtura. Minatorët gjëzojnë respektin e të gjitha masave të vendit tonë se, ndërsa punëtorët e sektorëve të tjera të ekonomisë punojnë në diell dhe në ajër, ju, minatorët, punoni në kushte shumë të vështira, luftoni përditë me vështirësitë e nëntokës. Por ju nuk u trembeni vështirësive, ju jeni nga punëtorët më guximtarë dhe nga më të kaliturit. Realiزمi i planit nga ju është një sukses i rëndësishëm, sepse qymyrguri është buka e industrisë sonë.

Në Memaliaj janë bërë shumë ndryshime. Ai ka marrë pamjen e një qyteti të bukur. Janë ndërtuar dhe po ndërtohen shumë shtëpi të reja dhe akoma më shumë do të ndërtohen vitet e ardhshme. Një gjë e tillë po bëhet kudo në vendin tonë. Perspektiva të

shkëlqyera i hapen vendit me planin e tretë pesëvjeçar. Gjatë pesëvjeçarit të ri do të zhvillohen shumë industria e naftës, ajo e sheqerit, e tekstileve, industria ushqimore etj. Me bonifikimin e fushave të atdheut tonë, me zgjerimin e mekanizimit të punimeve në bujqësi dhe me ngritjen e kombinatit të madh të plehrave kimike, i cili parashikohet të përfundojë nga mbarimi i pesëvjeçarit të tretë, rendimenti i kulturave bujqësore në vendin tonë do të rritet 2-3 herë. Të gjitha këto do të sjellin, pa dyshim, ngritjen e mëtejshme të nivelist të jetesës së masave punonjëse të vendit tonë. Ne jemi të bindur për realizimin me sukses të këtyre detyrave të mëdha që vë Partia, sepse kemi një klasë punëtore heroike, një fshatarësi revolucionare, e cila ka përqafuar në masë rrugën e kolektivizimit të bujqësisë; ne kemi edhe ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera të demokracisë populllore.

Pastaj shoku Enver Hoxha, duke folur për situatën aktuale ndërkomëtare, tha:

Përpjekjet e imperializmit, me atë amerikan në krye, për shpërthimin e një lufte të re, gjejnë një mbështetje të madhe në punën e tyre të fëlliqur te revisionistët jugosllavë. Grupi i Titos, i cili tanimë është larguar krejtësisht nga marksizëm-leninizmi, çdo ditë e më shumë ka treguar sytyrën e tij të vërtetë si shërbëtor besnik i imperializmit. Partia jonë, besnikë deri në fund e parimeve të pavdekshme të marksizëm-leninizmit, u ka qëndruar vazhdimisht e patundur sulmeve të revisionistëve jugosllavë dhe për këtë me të drejtë ajo ka fituar dashurinë dhe respektin e të gjitha partive komuniste dhe punëtore motra.

Pas mitingut shoku Enver Hoxha vizitoi disa nga shtëpitë e punëtorëve, si dhe mensat e fjetoret e punëtorëve.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 240 (3141), 5 tetor 1958

Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 240 (3141), 5 tetor 1958

RRITJA E NORMAVE SJELL RRITJEN E TE ARDHURAVE

*Nga biseda në takimin me kooperativistët e Katalit
të Përmetit*

5 tetor 1958

Kooperativistët e Katalit e përqafojnë me dashuri të madhe shokun Enver, i urojnë atij jetë të gjatë përlumturinë e popullit e të atdheut dhe bisedojnë me të për problemet kryesore të kooperativës. Shoku Enver, pasi i uroi ata për sukseset e arritura dhe pasi i këshilloi që të zhvillojnë edhe më tej ekonominë e tyre, në mënyrë që të jenë gjithmonë shembull për kooperativat e tjera të rrëthit, tha:

Ju e keni kuptuar shumë mirë që kolektivizimi është e vetmja rrugë e drejtë për ta çuar bujqësinë tonë përpara, për të dalë nga varfëria. Ju e shikoni se, duke qenë të bashkuar, duke punuar në mënyrë të organizuar me brigada e skuadra pune, rendimenti i prodhimeve bujqësore e blegtorale rritet shumë dhe përmirësohet mjaptjeta e fshatarit. Këtë e ka kuptuar shumë mirë fshatarësia jonë punonjëse, e cila po bin-

det çdo ditë e më tepër për epërsinë e rendit kooperativist dhe po bashkon gjithnjë e më shumë tokën e mjetet e punës në kooperativa.

Më poshtë, duke vazhduar bisedën, ai tha:

Revisionistët e Beogradit e hedhin poshtë rrugën e drejtë marksiste-leniniste të ndërtimit kooperativist të fshatit. Ata e kanë vënë fshatin jugosllav në rrugën e ringjalljes së ekonomisë kapitaliste. Kulakët, matrapazët shtypin e grabitin përsëri fshatarësinë jugosllave. Gjithë bota po shikon se revisionistët jugosllavë janë bërë shërbëtorë të zellshëm të imperializmit dhe në radhë të parë të atij amerikan.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH u foli pastaj kooperativistëve për forcimin organizativ të kooperativës:

Funksionimi i rregullt i mbledhjes së përgjithshme të kooperativës është kusht i domosdoshëm për forcimin ekonomik të saj. Kryetarët që e bëjnë në rregull mbledhjen e përgjithshme dhe dëgjojnë zërin e saj, që lutojnë për zbatimin e statutit, janë kryetarët më të mirë.

Kooperativistët duhet të bëjnë sa më shumë ditë-pune dhe të realizojnë normat. Te disa vihen re tendenca për të ulur normat dhe për të planifikuar rendimente të ulëta, kjo është e dëmshme e jo në interes të vetë kooperativistëve, sepse kufizon përpjekjet e tyre për të rritur prodhimin dhe pakëson të ardhurat e anëtarëve, prandaj duhen luftuar ashpër si tendenca antikooperativiste.

Duke u larguar, shoku Enver u uroi edhe një herë kooperativistëve të Kutalit suksese të reja në zhvillimin dhe në forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativës.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 241 (3142), 7 tetor 1958

Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 241 (3142), 7 tetor 1958

TË RRITET GJITHMONE E MË SHUMË ROLI UDHËHEQESES I PARTISE NE USHTRI

*Nga fjala në takimin me ushtarët dhe me oficerët
e repartit të Përmetit*

5 tetor 1958

Ushtarët dhe oficerët e repartit të Përmetit e ndjejnë veten shumë të lumtur që kanë sot në mes të tyre udhëheqësin e dashur të Partisë dhe të popullit tonë. Ata bisedojnë me të me përzemërsinë më të madhe, i tregojnë për jetën që bëjnë në ushtri, për mësimet e vlefshme që kanë fituar. Shoku Enver vizitoi me radhë klasat e mësimit të teknikës luftarake, të stërvitjes taktkike etj., kuzhinën, mensat, dhomat e fjetjes dhe pastaj pati një takim me të gjithë oficerët e repartit. Ai i përshëndeti të pranishmit në emër të Komitetit Qendror të Partisë e të qeverisë, u uroi suksese në detyrën e tyre dhe midis të tjera, tha:

Detyra juaj ka qenë e lavdishme dhe mbetet e tillë përderisa ekziston rreziku i shpërthimit të luftërave nga imperializmi. S'ka dyshim që ky rrezik nuk na tremb, por situata duhet vlerësuar ashtu siç është.

Dhe tani situata nuk është e qetë. Imperializmi, me atë amerikan në krye, preqatitet për luftëra të reja. Vitet e fundit shumë luftëra kanë shpërthyer imperialistët për të mbajtur popujt nën zgjedhë, por kemi parë se përpjekjet e tyre kanë dështuar. Në Kore ata u mundën dhe u detyruan të tërhiqen me turp; kështu ngjau edhe në Vietnam, Egjipt dhe kështu do të ngjasë edhe në Liban e Jordani. Kjo tregon se ata nuk e kanë të lehtë të fitojnë mbi popujt. Por megjithatë ata vazhdojnë përpjekjet për të shpërthyer një luftë të re, sepse pozita e tyre po dobësohet gjithnjë e më shumë, regjimi i tyre shkon drejt greminës. Tani ata kanë fillouar provokacione në shkallë të gjerë kundër Republikës Popullore të Kinës, por Kina është sot një shtet i fuqishëm, që ka një ushtri të madhe e të fortë dhe s'ka dyshim se nuk do të jetë e largët dita kur ishujt kinezë Macu, Kuemoi dhe Taivani të çlirohen nga kthetrat e imperializmit amerikan.

Pastaj shoku Enver Hoxha foli për zhvillimin e madh të ekonomisë dhe të shkencës në Bashkimin Sovjetik, në Kinën e madhe dhe në vendet e tjera të kampit të socializmit, për sukseset dhe perspektivat e ardhshme të zhvillimit të ekonomisë sonë dhe tha se këto suksese e kanë tërbuar imperializmin dhe prandaj ai përpiqet për luftëra të reja.

Duke iu drejtar oficerëve të repartit të Përmetit, ai tha:

Ju keni dalë nga lufta, e dini se çfarë është lufta dhe e kuptioni se në këtë situatë duhet të preqatjeni mirë. Ushtria jonë e lavdishme është sot shumë e fortë dhe e zonja t'i japë grushtin e merituar

çdo agresioni që do të guxojë të prishë paqen e lumturinë e popullit tonë. Ndërgjegjja e saj është e lartë. Ushtria jonë është e pajisur me armë moderne dhe ka kuadro të preqatilur mirë. Megjithatë ne duhet të punojmë akoma për ta bërë ushtrinë tonë edhe më të fortë, për të përvetësuar më mirë armët e reja. Kudrot e ushtrisë sonë duhet gjithashtu t'i futen më thellë studimit të teorisë marksiste-leniniste, sepse ajo do t'i ndihmojë shumë në punën e tyre. Duhet të luftojmë që të forcohet gjithnjë e më shumë Partia në ushtri, të gjallërohen radhët e saja me elementë të rinj, besnikë, nga radhët e klasës punëtore e të fshatarësisë. Partia është shpirti, motori i gjithë jetës së vendit tonë; kështu është edhe në ushtri. Kudrot ushtarake të repartit të Përmetit duhet të interesohen edhe për problemet ekonomike të rrëthit, të mbajnë lidhje të ngushta me komitetin e Partisë dhe atë ekzekutiv në rrëth dhe të jenë shembull në zbatimin e ligjeve dhe të rregulloreve të pushtetit.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 241 (3142), 7 tetor 1958

Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 241 (3142), 7 tetor 1958

BONIFIKIMI DHE HAPJA E TOKAVE TË REJA — REZERVA TË MËDHA PËR EKONOMINË TONE

*Nga fjala në takimin me kooperativistët e Starovës
së Beratit*

6 tetor 1958

*Shoku Enver, pasi i përshëndeti kooperativistët dhe
pasi u uroi atyre suksese të mëtejshme, tha:*

Fshatrat tuaja u dogjën e u bënë hi gjatë luftës, por ju nuk u përkulët dhe pas çlirimt i ndërtuat ato. Ju keni bërë shumë sakrifica. Gjaku i dëshmorëve, që i dhatë atdheut, qëndron në themel e Shqipërisë së re, e cila sa vjen e po zbukurohet. Kudo po ngrihen fabrika e kooperativa. Edhe ju e keni bërë të bukur jetën tuaj, të cilën nuk ka forcë që t'ua prishë. Bujqësia po shkon përpara. Me anë të bonifikimeve dhe të hapjes së tokave të lëna djerrë, që janë rezerva të mëdha për zhvillimin e ekonomisë sonë, do të fitohen me mijëra hektarë tokë e re, një pjesë e mirë e së cilës do të ujitet. Ne kemi sjellë shumë maqineri bujqësore dhe shumë të tjera do të na vijnë. Do të ndërtohet dhe fabrika për prodhimin e plehrave kimike. Të gjitha

këto do të bëjnë të lulëzojnë jo vetëm fushat, por edhe kodrat tona. Me gjithë kushtet jo të favorshme klimaterike të këtij viti, ju keni arritur rezultate të mira në pambuk, duhan e kultura të tjera bujqësore, por, po t'ua bëni më mirë shërbimet kulturale, po të kujdeseni më shumë për bimët, duke filluar që nga punimi i tokës e deri në vjeljen e prodhimit, patjetër që do të merrni më shumë prodhime.

Ju, shokë kooperativistë, duhet të zhvilloni në mënyrë të gjithanshme ekonominë tuaj, të mbillni edhe më shumë pemë frutore, ullinj, vreshta, të mbani më shumë shpendë, të irritni bletë dhe të tregoni kujdes të madh për shtimin e blegtorisë dhe për rritjen e prodhimitarisë së saj, duke u siguruar bagëtive një bazë të shëndoshë ushqimore.

Zotimet, që keni marrë ju, tregojnë entuziazmin e madh për punë, guximin për të kapërcyer vështirësitë. Perspektivat tuaja në të ardhshmen janë shumë të mëdha.

Shoku Enver kaloi disa orë në mes të kooperativistëve, vizitoi ndonjë nga shtëpitë e tyre dhe bisedoi me shumë fshatarë për jetën e tyre dhe për shumë probleme të kooperativës.

Botuar për herë të parë në gazeten «Zëri i Popullit», Nr. 242 (3143), 8 tetor 1958

Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 242 (3143), 8 tetor 1958

DISA POROSI DHËNË SEKRETARËVE TË ORGANIZATAVE TË PARTISË E KRYETARËVE TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE TË ZONAVE MALORE TË BERATIT

7 tetor 1958

Në takimin me kryetarët e kooperativave bujqësore të zonave malore dhe me sekretarët e organizatave bazë të Partisë të këtyre kooperativave, shoku Enver, pasi pyeti për rezultatet e arritura gjatë këtij viti në ekonomi dhe për probleme të tjera të Partisë, dha këto porosi:

Në kooperativat tuaja dhe përgjithësisht në rrëthin e Beratit, është bërë një punë e mirë për zhvillimin e frutikulturës, ullinjve e vreshtave, por mundësitetë këtu janë shumë më të mëdha. Prandaj, është mirë tani që jemi në vjeshtë dhe që akoma s'ka filluar mbjellja e pemëve, të rishqyrtoni edhe një herë planet tuaja dhe t'i rritni ato. Të njëjtën gjë të bëni edhe për shtimin e blegtorisë. Lidhur me sigurimin e ushqimit për blegtordinë, veç të tjerave, ju duhet të organizoni më mirë shfrytëzimin e kullotave verore e dimërore.

Kryesitë e kooperativave bujqësore dhe organizatat e Partisë të fillojnë që tani për t'u preqatitur

mirë për ndarjen e të ardhurave, sepse ato janë kuro-rëzimi i punës së anëtarëve. Kjo nuk është punë e lehtë, ajo kërkon mjaft kujdes dhe preqatitje të mirë. Duke bërë ndarjen e të ardhurave, të analizohet edhe puna e gjithë vilit, të shikohet cilat kanë qenë rezultatet. Si janë mobilizuar organizata e Partisë dhe kryesia e kooperativës për të kryer detyrat e planit, të vihen në dukje të metat dhe detyrat për vitin e ardhshëm, sepse kështu ju do të armatosni më inirë, do të lidheni më shumë me masat dhe ato do të aktivizohen më tepër për problemet e kooperativës. Por, duke bërë këtë punë, të mos lëmë pasdore detyrat e stinës. Tani jemi para mbjelljeve të vjeshtës, me të cilat hidhen bazat për prodhime të larta në vitin e ardhshëm. Dhe për këtë duhet preqatitur mirë. Gjatë kësaj kohe është mirë të shikoni edhe çështjen e zë-vendësimit gradual të misrit me grurë, sepse eksperiencia ka treguar se misri në kooperativat tuaja nuk bëhet mirë. Veç kësaj, duke mbjellë grurë, ka mundësi që shumë kooperativa të mbjellin misër hamullor dhe të martir kështu dy prodhime.

Sekretarët e organizatave bazë të Partisë duhet të forcojnë punën e Partisë në kooperativat bujqësore, në mënyrë që organizata e Partisë në kooperativë të jetë e shëndoshë, monolite, e zonja për të kryer si duhet detyrat. Partia në fshat duhet të luftojë kundër shfaqjeve të tarafit, ambicieve etj., që vihen rë tek-tuk në disa kooperativa. Këto, sigurisht, nuk kanë karakter politik, por duhen luftuar me t'u shfaqur, sepse e dobësojnë Partinë, dhe kur Partia nuk është e fortë, edhe punët e kooperativës nuk shkojnë mirë.

Komunistët, veçanërisht sekretarët e organizatave të Partisë dhe gjithë kuadrot e kooperativave duhet të punojnë për ta gjallëruar Partinë me elementë të rinj, në mënyrë të veçantë duke u kujdesur për të futur në radhët e saja më shumë gra. Gruaja është bërë një forcë e madhe në kooperativë. Ajo kryen shumë punë të rëndësishme bujqësore, shumë gra ua kalojnë edhe burrave; e këto gra të dalluara dhe besnikë për çështjen e Partisë, nuk duhen lënë jashtë radhëve të saja. Për pranimet në Parti duhet punuar me kujdes më të madh, të mos mjaftohemi duke u lexuar kandidatëve për në Parti vetëm Statutin, por të bëhet me ta një punë e vazhdueshme.

Instruktorët e Partisë të zonave kanë detyra të mëdha dhe roli i tyre është shumë i madh. Praktika e deritanishme ka treguar se forma e re e organizimit të aparateve të Partisë ka dhënë rezultate. Duhet treguar një kujdes më i madh për të ndihmuar instruktorët e Partisë. Të organizohen me ta seminare për probleme konkrete, në të cilat të shkëmbhet edhe eksperiencia e punës së tyre.

Forcimi i pushtetit ka gjithashtu rëndësi të madhe. Kryetarët e kooperativave nuk duhet të futen në kompetencat e kryetarëve të këshillave populllore të fshatit, përkundrazi ata duhet të luftojnë që të rritin autoritetin e pushtetit në fshat. Duke forcuar këshillin popullor të fshatit forcohet edhe pushteti në lokalitet. Shpesh ngjet që nga lart komitetet e ekzekutive të lokaliteteve u jepin vetëm urdhëra dhe u kërkohet llogari. Kjo patjetër që duhet bërë, por krahas kësaj ato duhen ndihmuar konkretisht për probleme të ndryshme.

Një problem tjetër me shumë rëndësi është edhe çështja e krijimit të skuadrave të ndërtimit në kooperativat bujqësore. Këto kanë shumë rëndësi sidomos tani, që volumi i ndërtimeve në vendin tonë është rritur shumë. Krijimi i tyre është në interes të kooperativës dhe të shtetit.

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i Popullit»,
Nr. 242 (3143), 8 tetor 1958*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë
nga gazeta «Zëri i Popullit»,
Nr. 242 (3143), 8 tetor 1958*

**ARËSIMTARËT TANË DUHET T'U NDIHMOJNË
FAMILJET QË EDHE ATO TË KUJDESEN
PËR EDUKIMIN E FËMIJËVE**

*Nga fjala në takimin me arësimtarët e shkollave
të mesme të qytetit të Beratit*

7 tetor 1958

*Në takimin me arësimtarët e shkollave të mesme
të qytetit, shoku Enver, midis të tjerave, tha:*

Arësimtarët kanë një mision shumë të lartë, një detyrë të shenjtë, por jo të gjithë e çmojnë atë si duhet. Fëmijët tanë janë me ndjenja shumë të pastra, por këtë pastërti duhet ta ruajmë dhe jo vetëm ta ruajmë, por edhe ta zhvillojmë më tej. Në këtë drejtim rol të madh luajnë familja, shkolla, puna. Familja shqiptare ka tradita, ajo është e ndershme, patriote, por për shkak të shtypjes nga regjimet e kaluara antipopullore, ajo është akoma e ulët nga niveli kultural, prandaj edhe ndihma e saj ndaj fëmijëve nuk është e mjaftueshme. Për këtë, juve, arësimtarëve, ju bie detyra që, me anën e formave të ndryshme, ta ndihmoni familjen tonë, të bëni që ajo të kujdeset edhe më shu-

më për përparimin e fëmijëve në mësime. Rol të madh në edukimin e fëmijëve luan edhe ambienti, shoqëria që i rrethon. Regjimet antipopullore në të kaluarën jo vetëm që nuk lejonin hapjen e shkollave, por për nxënësit dhe mësuesit krijonin një atmosferë mbytëse. Kurse tani kemi një atmosferë krejt të re. Kudo hapen shkolla, shteti ka dhënë e jep shumë bursa. Nga ana e tyre nxënësit, duke kuptuar rëndësinë e madhe të detyrave të reja, ndjekin me zell shkollën dhe mësojnë mirë.

Edhe mësuesit tani mbajnë një qëndrim të ri ndaj detyrës së tyre patriotike. Këtu nuk duhet harruar se edhe mësuesit e vjetër kanë bërë shumë përpjekje për përhapjen e arësimit, megjithëse te ndonjëri mund të jenë vënë re lëkundje e mungesë inisiative. Duke analizuar gjithë punën e tyre mund të themi se ata i kanë dhënë një kontribut të madh atdheut dhe përpjekjet e tyre për ta pajisur popullin me arësim janë të mëdha e të lavdishme. Partia dhe qeveria janë i falenderojnë për këtë dhe e kanë në konsideratë punën e tyre. Mësuesit e rinj e të vjetër udhëhiqen nga parimet e marksizëm-leninizmit, prandaj te ne po arrihen suksese të rëndësishme. Të gjithë arësimtarët duhet të mësojnë shkencën marksiste-leniniste. Ata duhet të armatosen patjetër me këtë shkencë, se ajo i pastron ata nga çdo botëkuptim i shtrembër që mund të ketë zënë vend në ndërgjegjen e tyre. Marksizëm-leninizmi të hap horizonte të reja, të armatos me njohuri të reja, të ndihmon në punën e përditshme. Por këtë shkencë nuk duhet ta dini vetëm në teori, por ta zbatoni në praktikën e punës suaj.

Detyrën e madhe të lidhjes së teorisë me praktikën, të shkollës me jetën duhet ta kenë shumë parasysh arësimtarët tanë. Për këtë të mos kufizohen vetëm me punën e dorës dhe me atë praktike në kopshatin e shkollës, po çdo ditë, gjatë shpjegimit të çdo mësimi, të punojnë me nxënësit në mënyrë që t'u rrënjoset ndjenja e dashurisë për punën. Partia e pushteti në rreth duhet të ndihmojnë më shumë shkollat, të kenë lidhje më të ngushta me arësimtarët dhe të krijojnë për ta kushte më të favorshme për lidhjen e teorisë me praktikën.

Arësimtarëve dhe kuadrove të Partisë e të pushtetit u bie edhe një detyrë tjetër, ajo e kujdësit që duhet treguar për ruajtjen e të gjitha monumenteve arkeologjike, si dhe të objekteve e të veprave të artit antik. Berati ka ndryshuar e do të ndryshojë akoma më shumë, por ai është njëkohësisht një qytet shumë i vjetër dhe ka shumë ndërtime me vlerë të madhe artistike, për ndërtimin e të cilave gjyshërvë e stërgjyshërvë tanë u është dashur të derdhin shumë djersë. Këto vepra arti duhen ruajtur me kujdesin më të madh brez pas brezi.

Në fund drejtori i shkollës pedagogjike falenderoi shokun Enver për vizitën dhe për këshillat e plefshme dhe e siguroi atë, në emër të të gjithë kolegëve të tij të Beratit, se do të zbatojnë të gjitha porositë e Partisë për ta çuar shkollën drejt sukseseve të reja.

Botuar për herë të parë në gazeten «Zëri i Popullit», Nr. 242 (3143), 8 tetor 1958

Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 242 (3143), 8 tetor 1958

**FJALA NË CEREMONINË E DHËNIES SË TITULLIT
«HERO I PUNËS SOCIALISTE» ME RASTIN
E 50-VJETORIT TË DITËLINDJES**

15 tetor 1958

Të dashur shokë,

Më lejoni t'ju falenderoj me mirënjojje të thellë për vlerësimin e madh që ju i bëni punës sime modeste. duke më dekoruar me titullin më të lartë të Republikës, me rastin e 50-vjetorit të ditëlindjes sime. Unë ju siguroj se do ta mbaj me nder, derisa të kem jetën, këtë titull të lartë dhe do të luftoj me të gjitha forcat e mia për lumturinë e popullit tonë dhe për forcimin e Partisë sonë të lavdishme të Punës, si bir dhe ushtar besnik i tyrc. Unë jam komunist dhe i ndërgjegjshëm për detyrat që më kanë besuar Partia dhe populli, si dhe për përgjegjësitë dhe detyrimet që unë kam ndaj tyrc. Por as detyrat e rënda dhe as përgjegjësitë që rrjedhin prej tyre nuk më kanë trembur dhe nuk do të më trebin kurrcë, por do t'i plotësoj me nder, në mënyrë revolucionare dhe në rrugën marksiste-leniniste, sepse për mua, si për çdo komunist dhe patriot, çështjet e Partisë dhe të popullit janë gjërat më të

shenjta dhe më të shtrenjta. Mbi këto nuk mund të vihet asgjë tjetër.

Shokë të dashur,

Ky ndër i madh, që më bëhet mua sot, i përket Partisë sonë të lavdishme, Komitetit Qendror të saj dhe Byrosë Politike të Komitetit Qendror, ku unë jam një anëtar në mes të anëtarëve të tjerë dhe që të gjithë, si një trup i vetëm, monolit dhe i çelniktë, e çojmë popullin tonë në rrugën e lavdishme të socializmit dhe të komunizmit. Është vetëm kjo arësy që gjëzon sot pa masë zemrën time, kur shoh këtë dashuri të pakufishme që ushqen populli ynë për shpëtimtaren e tij të lavdishme, Partinë e Punës të Shqipërisë, kur shoh këtë unitet të çelniktë të popullit rrëth Partisë së tij heroike, kur shoh këtë besim të pafund që populli ka për Partinë e tij. Ne, anëtarët e Partisë, kemi të drejtë ta mbajmë kokën lart për këto fitore kaq të mëdha dhe vendimtare që u realizuan me kaq sukses nga Partia, që është farkëtuesja e çlirimt të popullit përgjithmonë nga robëria, e pavarësisë, e sovranitetit të Shqipërisë dhe e ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Partia jonë e lavdishme është një Parti e tipit të ri marksist-leninist, është një Parti që udhëhiqet dhe do të udhëhiqet sa të jetëjeta nga marksizëm-leninizmi. Ajo është pjella e lavdishme e popullit tonë heroik. Duket dielli që kur lind, thotë një fjalë e urtë e popullit tonë. U duk, pra, që në lindjen e saj se ç'do të ishte Partia jonë. Ajo lindi në furtunën më të madhe

të historisë shekulllore të popullit tonë, ajo lindi në çastet kur luhejjeta ose vdekja e tij. Në luftë ajo lindi, në luftëra dhe në beteja u kalit. Ajo s'lindi në krevat prej puplash, as u ushqye si një fëmijë e përkëdhelur e borgjezisë, por në gjak dhe në rreziqe, në shi e në borë, në mes të urisë e të varfërisë dhe u hodh me një shpirt vigan, me një hov të madh revolucionar, me heroizëm dhe me pushkë në dorë, për të përmbysur botën e urryer të skllavërisë dhe të varfërisë, për të vendosur drejtësinë e popullit fukara, për të vendosur diktaturën e proletariatit. Dhe e vendosi diktaturën e proletariatit siç mund ta bënte një parti e vërtetë e klasës punëtore, ashtu siç është Partia jonë. Me një hov akoma më të madh revolucionar Partia jonë marksiste-leniniste e transformoi Shqipërinë, ndërton me sukses socializmin, ecën përpala pa u trembur nga vësh-tirësitë, kapërcen dhe mposht rreziqet, u ka thyer dhëmbët armiqve të jashtëm e të brendshëm të popullit. Ajo korr dhe do të korrë kurdoherë suksese dhe fitore, se rruga e saj, politika dhe qëllimet e saj janë të drejta, janë të popullit. Për këto qëndrime të drejta dhe të palëkundshme kurrë nga rruga e marksizëm-leninizmit, Partia jonë ka fituar besimin dhe respektin e partive komuniste dhe punëtore të të gjitha vendeve të botës. Po për të njëjtat arësyte ajo ka fituarurrej-tjen e armiqve imperialistë dhe të revisionistëve modernë, që udhëhiqen nga revisionistët e Beogradit, tradhëtarë të marksizëm-leninizmit.

Ç'kërkojnë imperialistët dhe revisionistët? Të shembin socializmin dhe të vendosin regjin e urryer të kapitalit. Ç'kërkojnë ata të bëjnë kundër Shqipërisë?

Të zhdukin Partinë tonë dhe të skllavërojnë popullin shqiptar. Dhe pikërisht pse ata janë vënë në pamundësi për të realizuar ëndrrat e tyre, janë tërbuar kundër nesh. Shantazhet, kërcënimet, dredhitë, taktikat e tyre ne ua dimë dhe s'kemi frikë prej tyre. Partia jonë s'do të lejojë kurrë të cënohen pavarësia dhe sovraniteti i atdheut, do t'i ruajë si sytë e ballit dhe do t'i mbrojë nga armiqjtë e çdo ngjyre fitoret e popullit dhe pastërtinë e marksizëm-leninizmit. Armiqtë e popullit tonë tërbohen kur shohin përparimin e madh të vendit tonë, por qentë le të lehin, karvani ecën përpara. Shqipëria jonë po lulëzon,jeta e popullit shqiptar po përmirësohet çdo ditë. Kudo në vendin tonë janë ngritur dhe po ngrihen fabrika e kombinate, po thahen këneta të tëra që as nuk mund t'i përfytyronte fshatarësia jonë, kudo janë hapur dhe po hapen shkolla dhe institucione kulturnale. Të gjitha këto i bëri forca e popullit dhe drejtësia e vijës së Partisë dhe e qeverisë sonë. Një e ardhshme akoma më e bukur e pret popullin tonë. Për këtë janë mobilizuar të gjitha forcat tona, kësaj do t'ia kushtojmë gjithë jetën tonë, si ushtarë besnikë të popullit dhe të Partisë sonë që na rilindi, që na edukoi, që na mëson e na kalit, për t'i shërbyer me nder dhe me devociion popullit tonë heroik.

Shokë të dashur,

Çdo njeri në punë ka anët e tija pozitive, por ka edhe të meta. Edhe komunistët nuk i shpëtojnë kësaj gjëje. Sot, kur mbush 50 vjet, si çdo komunist dhe njeri

i ndershëm edhe unë analizoj punën time dhe konstatoj se në të ka pasur të meta, që Partia m'i ka ndrequr, më ka mësuar, më ka edukuar. Partia, vazhdimisht, me pjekurinë e saj shembullore, me durimin e saj të madh e bën këtë siç e bën për çdo anëtar të saj dhe për të gjithë masën e popullit tonë. Unë as revolucionar as komunist linda. Të tillë më bëri lufta e popullit, më bëri Partia jonë e lavdishme. Mëma ime më lindi, por Partia ime më rilindi, më tregoi rrugën, më tregoi qëllimin e lartë të jetës së njeriut, më bëri që, derisa të keni jetën, të luftoj me besnikëri për çështjen e saj, që është çështja e shenjtë e popullit. Me mirënjojje dhe me besnikëri të pafund e falenderoj Partinë tonë të dashur.

Partia është zemra e popullit tonë. Forca e saj s'njeh kufi, se forca e saj është forca e popullit, drejtësia e saj është drejtësia e popullit, dituria dhe pjekuria e saj janë dituria, zotësia dhe pjekuria e popullit. Populli ynë thotë një fjalë të urtë: trimi i mirë me shokë shumë. Kjo në gjuhën shkencore të marksizmit do të thotë: uniteti i mendimit dhe i veprimit është kyçi i fitores. Një unitet i tillë i karakterizon dhe do t'i karakterizojë lidhjet dhe luftën e Partisë e të popullit, lidhjet, luftën dhe veprimet e jetës së brendshme të Partisë, lidhjet, luftën dhe veprimet e organizatave bazë të Partisë, të Komitetit Qendror dhe të Byrosë Politike të Komitetit Qendror, lidhjet, luftën dhe veprimet e qeverisë sonë.

Armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, që janë orvatur dhe jo vetëm një heië ta prishin këtë unitet, kanë thyer dhe do të thyejnë kokën.

Nuk c them për modesti, por shpreh realitetin, kur them se puna ime modeste në shërbim të popullit dhe të Partisë është një pjesë shumë e vogël e forcës kolosale të Partisë, e anëtarëve të saj, e anëtarëve të Komitetit Qendror, të qeverisë, e zotësisë, e diturisë, e pjekurisë së atyre dhjetëra mijëra njerëzve të lavdishëm, guximtarë, heroikë, që lufta e tyre për çlirimin e atdheut, lufta e tyre në rrugën e drejtë të Partisë, lufta e tyre në ndërtimin e socializmit i solli në Parti e në udhëheqje, u besoi detyra kaq të rënda dhe me kaq përgjegjësi. Dhe këto detyra ata i kryejnë me nder. Prandaj, ky nder, që më bëhet mua sot, u përket të gjithë komunistëve, anëtarëve të Komitetit Qendror të Partisë sonë të lavdishme dhe duke u bërë interpret i ndjenjave të tyre të zjarrta, ne i themi popullit se Partia jonë është më e fortë se kurrë. Partia dhe udhëheqja e saj do të mbrojnë kurdoherë me besnikëri të pasund çështjen e popullit dhe të Partisë dhe do ta mbajnë lart flamurin e marksizëm-leninizmit.

Rroftë populli ynë i dashur!

Rroftë Partia e lavdishme e Punës e Shqipërisë!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i Popullit»,
Nr. 249 (3150), 16 tetor 1958*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

FALENDERIM DREJTUAR GJITHË ATYRE QË I DËRGUAN URIME ME RASTIN E 50-VJETORIT TË DITËLINDJES

20 tetor 1958

Falenderoj me gjithë zemër të gjitha organet dhe organizatat e Partisë e të masave, punonjësit e enteve shtetërore, të institucioneve kulturale e arësimore, të ndërmarrjeve industriale, tregtare, të transportit, të kooperativave bujqësore, efektivat e reparteve ushtarake, si dhe shokët e miqtë e tjerë që më drejtuani urime me rastin e 50-vjetorit të ditëlindjes sime.

Të gjitha këto urime dhe fjalë të mira që më janë drejtuar i përkasin në radhë të parë popullit tonë heroik dhe Partisë sonë të lavdishme marksiste-leniniste, që luftojnë me entuziazëm për përparimin dhe begatinë e atdheut tonë, për socializmin dhe paqen.

Duke mos qenë në gjendje t'u përgjigjëmenjëherë letrave e telegrameve që më janë drejtuar, me këtë rast ju lutem të gjithëve të pranojnë falenderimet e mia më të nxehta dhe urimet më të mira për suksese

në detyrat e secilit për të mirën dhe lumturinë e popullit tonë, për lulëzimin e atdheut tonë të dashur socialist.

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i Popullit»,
Nr. 253 (3154), 21 tetor 1958*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PARTIA JONË ESHTË E PASTER SE AJO NUK E KA PUSHUAR KURRË LUFTËN KUNDER REVIZIONIZMIT

*Nga biseda në takimin me dy shokë të PK
të Finlandës*

27 tetor 1958

Ne jemi shumë të gjëzuar, të dashur shokë finlandezë, si për ardhjen tuaj për të kaluar pushimet te ne, ashtu edhe për përshtypjet e mira që ju keni për vendin tonë dhe na vjen keq që nuk ju premton koha të qëndroni edhe më gjatë për të marrë kështu njohuri akoma më të plota mbi vendin tonë.

Ne dëshirojmë që shokët finlandezë ta njohin së të jetë e mundur më shumë e më nga afër Shqipërinë, historinë e saj të kaluar dhe përpjekjet e Partisë e të popullit tonë në luftë për çlirimin e vendit e për ndërtimin e socializmit. Shokët e KQ të Partisë Komuniste të Finlandës, sigurisht janë në dijeni të historisë së Shqipërisë, të Partisë sonë dhe të disa çështjeve që na preokupojnë si ne edhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare, por mendojmë se ata nuk i njohin plotësisht ato. Prandaj, ne e ndjejmë të nevojshme që në këtë takim

t'u bëjmë të njohur shkurtimisht shokëve finlandezë realitetin tonë shqiptar, kjo është dhe porosia e Byrosë Politike, veçanërisht për çështjet e Partisë, si lindi dhe si u ndërtua ajo, si u rrit dhe si u forcua, si e organizoi, e udhëhoqi Luftën nacional-çlirimtare, si luftoi dhe lufton kundër revizionizmit modern dhe armiqve të tjerë të marksizëm-leninizmit, si lufton, në krye të masave tonë punonjëse, për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Në fund mund t'ju japim edhe një pasqyrë të zhvillimit të ekonomisë së vendit tonë gjatë pushtetit popullor të krahasuar me gjendjen e paraçlirimit.

Ju, të dashur shokë, nuk e merrni dot me mend se ç'ndryshime të mëdha ka bërë vendi ynë në krahasim me të kaluarën. Këtë ju mund ta kuptonit po që se do të kishit ardhur në Shqipëri para çlirimt, natyrisht në mënyrë ilegale, sepse komunistët tanë në atë kohë, luftonin në ilegalitet të plotë, pra, vetëm kështu ju do të kuptonit se si ka ndryshuar krejtësisht faqja e Shqipërisë nga çdo pikëpamje.

Para çlirimt vendi ynë ka qenë një monedhë tregu e të huajve. Kush e kishte pushtuar përpëra Shqipërinë? Më mirë do të ishte të thoshim kush nuk e kishte pushtuar. Shumë barbarë kanë shkelur mbi tokën shqiptare që nga lashtësitë deri në vitet 40 të këtij shekulli. Por gjatë të gjitha pushtimeve, gjatë të gjitha periudhave më të errëta të historisë së tij, populli shqiptar kurrë nuk është përkultur, por gjithmonë ka luftuar me armë në dorë kundër pushtuesve, feudalëve dhe borgjezisë së vendit.

Kështu populli dhe komunistët shqiptarë, që luf-

tuan me heroizëm që ditën që Italia fashiste shkeli vendin tonë, më 7 prill 1939, kishin në aktivin e tyre tradicional luftën për liri e pavarësi, luftën për tokë dhe demokraci. Të gjitha këto tradita luftarake dhe liridashëse të popullit shqiptar, që nisin që nga kohët e lashta e deri te luftërat e fshatarëve shqiptarë kundër tanzimatit e xhonturqve, të patriotëve tanë të Rilindjes, të demokratëve tanë revolucionarë, u mishëruan në Partinë e klasës punëtore, në Partinë Komuniste Shqiptare, sot Partia e Punës.

Në tablonë që shikoni në mur është një patriot demokrat shqiptar. Ai është patrioti Bajram Curri, që luftoi dhe u vra në atë shpellë që quhet Shpella e Dragobisë, në luftë kundër tiranit të popullit shqiptar, Ahmet Zogut. Luftën e këtij patrioti mund ta quajmë rezistençën e fundit të demokracisë borgjeze kundër feudalizmit në vendin tonë. Por, ajo që është interesante te ky patriot është besimi i tij i madh te komunizmi. Shpresat e çlirimt të popullit tonë ai i ka pasur te Partia Komuniste nën shembullin e asaj të Bashkimit Sovjetik. Bajram Curri i ka shkruar edhe një letër V.I. Leninit, ku ndër të tjera i shpreh simpatinë e tij për të, për Partinë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik, entuziazmin për ditët e lumtura të popullit në pushtetin e Sovjetëve dhe shfaq shpresat se do të vijë një ditë e tillë edhe për Shqipërinë.

Nga kjo e kaluar e popullit tonë mund të nxjerrim karakteristikat e Partisë sonë.

Përpara formimit të Partisë sonë në nëntor të vitit 1941, në Shqipëri kishte një klasë punëtore shumë të vogël, sepse te ne pothuajse nuk kishte fare industri,

me përjashtim të artizanatit, por ajo qe klasa më përparimtare në Shqipëri dhe e aftë për krijimin e Partisë. Fshatarësia jonë, me gjithëse e prapambetur, kishte në gjirin e saj tradita të lashta revolucionare dhe ishte kallitur në luftëra të vazhdueshme kundër pushtuesve dhe feudalëve. Ajo përbënte pjesën dërmuese të popullit. Në shekuj ajo kishte luftuar e derdhur gjak, pór asnjëherë nuk e kishte fituar atë që kërkonte sepse nuk kishte kush ia organizonte e ta udhëhiqte. Te Partia Komuniste ajo gjeti çlirimtaren dhe udhëheqësen e saj. Për këtë arësyje fshatarësia jonë revolucionare u lidh ngushtë me Partinë e klasës punëtore, pranoi udhëheqjen e saj, përqafoi vijën e saj marksiste-leniniste dhe me flamurin e Partisë përpara luftoi për çlirimin e atdheut dhe me këtë flamur ajo sot lufton për ndërtimin e socializmit. Nën udhëheqjen e komunistëve rinia shkolllore qëndronte në ballë të lëvizjes demokratike antifashiste dhe u bë përcuese e ideve marksiste-leniniste e të patriotizmit luftarak në masat popullore.

Në fillim Partia jonë kishte rrëth 200 anëtarë. Ata ishin njerëz të dalë nga radhët e klasës punëtore, të fshatarësisë së varfér e të mesme dhe të inteligjencies patriote. Një gjë i dallonte ata nga masat e popullit: preqatitja ideologjike dhe besimi i patundur te marksizëm-leninizmi. Ata gjithashtu u treguan jashtëzakonisht trima dhe siç mund ta dini, trimëria është një nga virtytet më të larta të popullit shqiptar, të cilën ai e ka ushqyer e trashëguar brez pas brezi.

Por, si para edhe pas themelimit të Partisë, komunistëve shqiptarë iu desh të bënин një luftë të vazhdueshme dhe të pandërprerë kundër elementëve trockistë,

të cilët të ardhur nga jashtë, sidomos nga Greqia, përpinqeshin të shuanin çdo lëvizje dhe përpjekje për formimin e Partisë Komuniste Shqiptare. Partia jonë që në fillim si dhe gjatë luftës goditi me ashpërsi dhe likuidoi të gjitha fraksionet trockiste që u përpoqën të shkatërronin Partinë nga brenda dhe më vonë likuidoi edhe grupimet politike ushtarake e kuislinge të organizuara nga pushtuesit.

Që me krijimin e saj ajo doli me një program të quartë, ku ushton thirrja drejtuar gjithë popullit për të rrokur armët e për t'u ngritur në luftë kundër pushtuesve, feudalëve e borgjezisë së vendit për çlirimin e Shqipërisë dhe për demokracinë, në bashkëpunim të ngushtë dhe të lidhur fort me luftën e Bashkimit Sovjetik dhe të të gjithë popujve të tjerë që luftonin kundër fashizmit. Vetëm kështu do të vinte liria, mendonte Partia jonë.

Partia jonë, megjithëse e porsakrijuar, ishte një Parti marksiste-leniniste, besnikë e Partisë që themeloi Lenini. Në programin e saj Partia kishte, pra, luftën deri në fund dhe pa kompromis kundër pushtuesve dhe tradhëtarëve të vendit. Në program thuhej se çlirimi i Shqipërisë do të sigurohet me luftën e armatosur të të gjithë popullit, nën udhëheqjen e Partisë. Programi i saj parashikonte gjithashtu që pas çlirimit të bëheshin reforma të mëdha ekonomike, në radhë të parë reforma agrare, e cila do t'u jepte tokat fshatarëve.

Për realizimin e këtij programi filloi lufta e pandërprerë e Partisë sonë me akte të mëdha heroike nga ana e anëtarëve të saj. Shembulli i lartë i vetëmohi-

mit të komunistëve bëri që populli të krijojë besim të plotë te Partia Komuniste si e vjetmja organizatë politike për luftë të vendosur kundër pushtuesve dhe të ngrihet i téri në këmbë, nën udhëheqjen e Partisë, të rrokë armët për të realizuar këtë program që ai e aprovonte me gjithë zemër, sepse në të ai shikonte kërkcesat, dëshirat, aspiratat e lirinë, për të cilat kishtë luftuar gjithë jetën. Në këtë luftë anëtarët e Partisë sonë të re u kalitën. Anëtarësinë e Partisë e merrnin vetëm ata shokë ose shoqe, që kryenin akte me të vërtetë heroike, që ishin vënë me mish e me shpirt në shërbim të luftës për çlirimin e atdheut dhe që kishin dhënë prova besnikërie e devocioni ndaj Partisë e popullit.

Të gjithë shokët e udhëheqjes së Partisë sonë dolën nga fusha e betejës. Ata e filluan jetën e Partisë nga anëtar i thjeshtë, ndërsa si udhëheqës ushtarakë nga partizan i thjeshtë. Anëtarët e Partisë sonë, megjithëse të uritur, të zhvçshur e në vuajtje të vazhdueshme, në çdo moment i gjaje në gjirin e popullit. Ata kurrë nuk u përkulen përpara këtyre vështirësive, në popull e me popullin i kapërcenin ato, te ai ata gjenin mbësh-tetjen, strehimin dhe frymëzimin. Kjo qëndresë dhe vendosmëri bëri që ne t'u bënim ballë vetë divizioneve italiane dhe gjermane, duke i goditur ato pa mëshirë e pa pushim. Partizanët shqiptarë luftuan vite me radhë dhe u armatosën me armët që i rrëmbyen armikut në luftë kundër tij.

Me pak fjalë, Partia jonë që nga lufta doli shumë e kalitur, e kreua me nder detyrën që i ngarkoi momenti historik dhe klasa punëtore e vendit tonë, e cila, sado e vogël në numër, udhëhoqi popullin në fitoren më të

madhe që ka parë historia e tij, në çlirimin e plotë nga pushtuesit dhe nga klasat sunduese.

Partia jonë ditën e çlirimit të atdheut, numëronte në radhët e saja 2 800 anëtarë. Siç e shihni edhe nga kjo shifër, ajo ka qenë mjaft e shtërnguar në pranime, bille mund të themi se ishte pak sektare në këtë drejtim, duke marrë parasysh që në prakun e çlirimit ne kishim 70 000 partizanë në një popullsi, jo më të madhe se 1 milion e 100 mijë frysë. Kështu ne, gjatë asaj kohe, mund të kishim pranuar nië shumë shokë e shoqë në radhët e Partisë. Këtë gabim ne e korrigjuam më vonë. Tani Partia jonë ka në radhët e saja 50 722 anëtarë.

Vendit tonë armiku i shkaktoi humbje të mëdha. Populli ynë sakrifikoi për lirinë jetën e 28 000 dëshmorëve, numër shumë i madh ky në krahasim me popullsinë e vogël të Shqipërisë, 4 000 invalidë qind për qind dhe afro 8 600 invalidë 50 për qind, afro 10 000 të internuar nëpër kampe përqëndrimi dhe 63 000 shtëpi të djegura. Të gjitha urat, rrugët, portet u hodhën në crë nga armiku dhe në ndonjë rast edhe nga partizanët me qëllim që ato të mos shfrytëzoheshin nga armiku ose të mos i shërbën atij.

Po edhe ne nuk lamë kusur kundër armikut, i cili la në vendin tonë koskat e 26 600 vetëve, 21 245 të plagosur dhe i zumë 20 800 robër, të cilët i tërhoqëm nëpër male, ku populli me fukarallëkun e tij i mbajti deri në çlirim, kur i lamë të lirë të ktheshin në vendin e tyre. Humbje të mëdha pësoi armiku edhe në teknikë e materiale të tjera lufte, kështu atij i shkatërruam osc i rrëmbyem mbi 2 100 tanksa, autoblinda e automobila dhe 4 000 topa e mortaja si dhe armë të tjera, me të cilat

u armatosën repartet tona partizane. Jo vetëm kaq, por nga armatimet e zëna mundëm të mbajmë edhe në depo, si rezervë. Lufta jonë nacional-çlirimtare ka kaluar në për disa momente shumë të rëndësishme që kanë luajtur rol vendimtar në arritjen e fitoreve. Për kalitjen e Partisë nga ana politike, organizative dhe ideologjike, ajo gjatë kohës së luftës ka organizuar disa konferenca e aktive me rëndësi historike që shërbyen për realizimin e politikës së saj, për mobilizimin e mëtejshëm dhe për grumbullimin e të gjitha masave të popullit, pa dallim politik, besimi, krahine etj. rreth Partisë.

Një nga këto konferenca ka qenë ajo që u mbajt më 16 shtator 1942 në Pezë, një fshat i vogël afër Tiranës, e cila ka rëndësi historike për dy çështje të mëdha:

Së pari, sepse atje u krijua Fronti Nacional-Çlirimtar ku Partia Komuniste Shqiptare ishte organizatorja dhe udhëheqësja e Frontit. Kjo do të thoshte se i gjithë populli që dëshironte të luftonte kundër armikut duhej të mobilizohej e të grumbullohej rreth Frontit Nacional-Çlirimtar, pa dallim politik dhc besimi. Në këtë konferencë u konkretizua edhe më mirë politika e Partisë për gjithë kohën e luftës. Partia atje afirmoi rolin e saj udhëheqës në Luftën nacional-çlirimtare duke shënuar kështu fitoren e parë të madhe politike të saj.

Së dyti, sepse në këtë konferencë u hodhën themellet e pushtetit populor në Shqipëri, d.m.th. u themeluan këshillat nacional-çlirimtare.

Në këtë konferencë Partia jonë sipas mësimeve të marksizëm-leninizmit hodhi parullën revolucionare: të shkatërrohet nga themeli pushteti i vjetër dhe në vend të tij të ngrihet pushteti populor.

Dhe menjëherë pas Konferencës së Pezës, komunistët dhe gjithë partizanët e lëvizjes nacional-çlirimtare, kudo që ishin, në zonat e çliruara dhe në ato që akoma mbaheshin të pushtuara nga armiku, në fshatra dhe në qytete ngrinin këshillat nacional-çlirimtare, të cilat luajtën një rol të madh në jetën e vendit.

Të gjitha privilegjet, ligjet dhe zakonet e shtetit borgjez dhe fashist u shqelmuant dhe në vend të tyre po viheshin në veprim ato të pushtetit popullor. Në këto kushte të reja për feudalët dhe borgjezët u bë shumë e vështirë shtypja, shfrytëzimi i njerëzve, administrimi i tokave dhe i pasurive, sikurse ndodhët përpara. Ata e kuptuan se po u rrëshqiste tokë nën këmbë dhe menjëherë pas krijimit të organizatës së Frontit Nacional-Çlirimtar dhe të këshillave nacional-çlirimtare, në bashkëpunim të ngushtë me pushtuesit dhe tradhëtarët e tjerë të popullit filluan sulmin dhe krahas me këtë sulm ata punuan edhe për krijimin e grupeve politike për t'iu kundërvënë Frontit Nacional-Çlirimtar dhe Luftës sonë nacional-çlirimtare. Kjo ua hoqi maskën jo vetëm feudalëve e borgjezëve, por edhe të ashtuquajturve nationalistë. Kështu në luftë u bë edhe diferençimi i njerëzve në mes atyre që ishin për luftë kundër pushtuesit dhe atyre që bashkëpunonin me të, për të mbrojtur interesat e tyre të ngushta. Populli e kuptoi se Partia Komuniste Shqiptare po e conte në rrugën e çlirimtës së plotë, jo vetëm nga imperialistët, por edhe nga feudoborgjezia, prandaj u grumbullua edhe më shumë rreth Partisë, tanë nëpërmjet një organizate më të gjerë dhe luftoi me besim të patundur.

Partia jonë ndoqi një politikë të urtë edhe me nje-

rëzit e besimeve të ndryshme si edhe me klerikët, natyrisht, duke bërë edhe këtu diferencime. Politika e Partisë ishte që të mos prekeshin ndjenjat besimtare të popullit, por të gjithë pa dallim feje të ngriheshin kundër armikut. Në bazë të kësaj politike, qindra klerikë që nuk ishin komprometuar me armikun, u lidhën shumë ngushtë me Partinë dhe me Luftën nacional-çlirimtare, bile, në radhët tona ka pasur edhe nga ata që kanë luftuar me heroizëm. Disa prej tyre arritën të marrin edhe grada të larta ushtarake, deri kolonelë të ushtrisë sonë, ndonjëri u bë edhe anëtar partie. Një prej tyre ishte edhe Baba Faja Martaneshi, i cili me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor u shpall «Hero i Popullit». Këtë luftëtar të shquar për lirinë e popullit tonë, pas çlirimit, na e vrua reaksioni. Këta ishin nga njerëzit e thjeshtë të klerit. Ndërsa kleri i lartë e vëçanërisht ai katolik u bashkua dhe bashkëpunoj me pushtuesit dhe me tradhëtarët e vendit në luftë kundër popullit. Ndaj këtyre Partia jonë luftoi pa mëshirë dhe i demaskoi si tradhëtarë, luftë kjo që vazhdoi edhe më e ashpër pas çlirimit.

Në prakun e çlirimit të Shqipërisë, i gjithë populli shqiptar, ishte me armë në dorë dhe i lidhur ngushtë me Partinë. Në të gjithë vendin u vendos pushteti i demokracisë popullore. Kudo në zonat e çliruara dhe në qytetet akoma të paçliruara ishin vendosur këshillat nacional-çlirimtare, duke u bërë organe të pushtetit të demokracisë popullore.

Në mbarimin e luftës ne dolëm fitimtarë, po vendi duhej rindërtuar se ishte krejtësisht i shkatërruar dhe në varfëri të madhe. Prandaj filluam menjëherë nga

zbatimi i reformave, sidomos të atyre ekonomike. Të gjithë kuislingët, kriminelët dhe tradhëtarët e tjerë që u kapën kaluan në gjyqet e popullit. Ata që kishin bërë krime të shëmtuara dhe që e kishin dëmtuar rëndë popullin u pushkatuan, të tjerët u futën nëpër burgje. Të gjithë pronarëve të mëdhenj dhe bejlerëve që u lidhën me pushtuesit iu konfiskuan tokat. Borgjezia e pasur tregëtarë e lartë dhe e mesme u detyrua të paguante tatimet e fitimeve të luftës. Bankat u shtetëzuan. Tregëtia e jashtme u bë monopol i shtetit. Koncesionet e huaja italiane, franceze, angleze, amerikane, që në Kongresin e Përmetit, pa përfunduar akoma lufta u vendos të mos njiheshin dhe pas çlirimit këto u shtetëzuan. U rimëkëmb tregëtia, iu bë thirrje borgjezisë së vogël që ishte marrë me punë të tilla, të fillonte të punonte, natyrisht nën drejtimin e komisarëve. Ajo iu përgjegj thirrjes dhe e filloi punën.

Klasat e shtypura akoma kishin shpresë se do t'u vinte përsëri dita duke menduar se ne nuk do t'i kapërcenim gjithë këto vështirësi të mëdha që na dilnin përpara në atë kohë, po ato u gabuan. Ne ishim kalitur me vështirësitë dhe për kapërcimin e tyre kishim shembullin e Partisë së madhe të Leninit dhe ndihmën e saj. Kështu me mobilizim të plotë dhe entuziazëm të madh brenda dy vjetëve ndërtuam të gjitha rrugët, urat, portet, minierat, shtëpitë e djegura etj. Të gjithë e kuptionin tani se me forcën e madhe të popullit dhe me vijën e drejtë të Partisë s'kishte gjë që të mos bëhej.

Populli vuante shumë edhe në vitet e para të çlirimit. Në treg nuk kishte bukë në radhë të parë, këpucë e rroba. Kjo vinte ngaqë armiku na kishte dëmtuar

shumë. Megjithatë populli dhe komunistët i duronin me këmbëngulje këto mungesa të mëdha dhe armët s'i lëshonin nga duart, po duke i pasur kurdoherë pranë punonin me entuziazëm për rindërtimin e vendit. Në këtë fryshtë dhe me entuziazëm u punua në atë kohë dhe gjithshka u rindërtua.

Në nëntor të vitit 1946 ne përfunduam me sukses reformën agrare. Kjo ishte një tjetër fitore e madhe e popullit tonë, sidomos e fshatarësisë që shekuj me radhë kishte luftuar për këtë tokë. Vetëm këtë herë fshatarësia jonë tha: «vërtet derdha gjak, po Partia më çlroi përgjëjtë dhe më dha tokën». Prandaj lidhjet me klasën punëtore dhe me Partinë u forcuan edhe më shumë.

1. — Mbi luftën kundër revizionizmit modern

Përveç armiqve të shpallur, Partia dhe populli ynë, gjatë luftës dhe në vitet e para të cilimit patën edhe një tjetër armik shumë të egër që ndërhyri në punët tona të brendshme, revizionistët jugosllavë, të cilët na u hoqën si miq e marksistë. Sot të gjitha partitë tona marksiste-leniniste e luftojnë me të gjitha forcat revizionizmin modern që ka në krye atë jugosllav. Jashtë mund të ketë edhe shokë që mund të mendojnë se përse shqiptarët i godasin me kaq ashpërsi jugosllavët dhe nuk ndjejkën me ta një taktilë pak më të përpunuar. Por, këta shokë, mund të bëjnë edhe pyetje: përse revizionistët jugosllavë i godasin kaq fort komunistët shqiptarë? Përse u kanë ndërhyrë e mundohen t'u ndërhyjnë kaq brutalisht?

Unë do t'ju tregoj, të dashur shokë finlandezë, përse kanë ngjarë e ngjasin këto. Sot është e qartë për të gjithë se revizionistët jugosllavë janë armiq të betuar të socializmit e të komunizmit. Të tillë ata kanë qenë prej kohësh. Dhe këtë ata e kanë treguar me vepra që gjatë kohës së luftës. Por siç dihet nga eksperienca, revisionistët kurdoherë përdorin maska për të fshehur sytyrën e tyre të vërtetë dhe këtë e bëjnë për të goditur më lehtë partitë komuniste. Ndaj Shqipërisë, ndaj Partisë sonë ata që atëhere kanë pasur synime të caktuara. Këto synime ata mendonin se do t'i realizonin lehtë. Shqipërinë, si një vend i vogël, mendonin ata, do ta gëlltinin lehtë dhe do ta bënin shumë shpejt një provincë jugosllave. Për këtë ata kishin besim të plotë. Prandaj ata filluan ndërhyrjet dhe punën armiqësore ndaj vendit tonë që gjatë luftës. Në fillim ne nuk kishim për ta asnjë dyshim, megjithëse kishim disa mosmarrëveshje. Këto i merrnim si keqkuptime ose gabime të rastit. Pra, kemi pasur mosmarrëveshje dhe jemi përleshur me ta që në kohën e luftës, por nuk i dinim akoma synimet e tyre dhe i konsideronim gjithnjë si miq, si marksistë. U deshën edhe disa vite që ata të zbuloheshin dhe të demaskoheshin nga Partia jonë dhe nga partitë e tjera marksiste-leniniste.

C'janë përpjekur të bënin revizionistët jugosllavë në vendin tonë? Ata u përpoqën që vija e Partisë sonë gjatë luftës të shndërrohej në vijë oportuniste në qëndrimin ndaj kuislingëve. Po Partia jonë nuk lejoi kurrë të realizohej një orvatje e tillë. Ata u përpoqën që ne ta shikonim çlirimin e vendit dhe ta lidhним luftën e populit tonë jo me Bashkimin Sovjetik, por vetëm me

Jugosllavinë. Partia jonë nuk lejoi të zinte vend një synim i tillë. Ata edhe para 1948-s flisnin kundër Bashkimit Sovjetik.

Në prak të çlirimit të Shqipërisë, revisionistët jugosllavë organizuan në Partinë tonë një grup fraksionist trockist. Ata arritën ta krijojnë këtë grup edhe me një rrezikshëm, organizoi edhe një Plenum të Komitetit Qendror, Plenumin II të Komitetit Qendror që u mblohd në Berat, i cili në vend që të punonte për realizimin e detyrave të ngutshme që duheshin kryer në prakun e çlirimit bëri të kundërtën. Ky Plenum i Komitetit Qendror, me ndërhyrjen e revisionistëve jugosllavë dhe nën drejtimin direkt të tyre, i dha një grusht të rëndë vijës së drejtë të Partisë që po e çonte popullin drejt fitores. Ata për të realizuar qëllimet e tyre bënин plane shumë të rrezikshme.

Një synim tjetër i tyre sipas këtyre planeve ishte të likuidonin të gjithë udhëheqjen e Partisë sonë, sidomos shokët tanë heroikë që nuk ishin dakord me pikëpamjet dhe me qëllimet e tyre të cilat më vonë, kur tradhëtarët e Beogradit dolën haptazi, u bënë më të qarta.

Pas çlirimit, pasi e panë që nuk ia arrinin dot qëllimet për ta hedhur në dorë gjithë udhëheqjen, ata nisen një taktkë tjetër që të likuidonin Partinë dhe pushtetin e demokracisë popullore në Shqipëri, ta kthenin Shqipërinë në republikë të shtatë të Jugosllavisë. Për të realizuar këtë ata morën masa:

E para, u përpoqën që të shtinin në dorë Ministrinë

e Punëve të Brendshme. Dhe këtë e bënë nëpërmjet tradhëtarit dhe trockistit Koçi Xoxe, që ishte sekretari organizativ i KQ të Partisë dhe ministër i punëve të brendshme. Ai dhe bashkëpunëtorët e tij, agjentët jugosllavë, filluan punën për minimin dhe për likuidimin e Partisë sonë nga brenda. Për këtë ata e nisën me likuidimin e normave leniniste që ishin vendosur në Parti. për dobësimin e saj nga ana organizative, për të shthurur unitetin ideologjik, politik dhe organizativ që Partia e kishte krijuar dhe e kishte siguruar në luftë e sipër me aq gjak e sakrifica. Me akuza të ndryshme ata filluan të likuidonin kuadrot heroikë të Luftës sonë nacional-çlirimtare. Për të gjithë ne, shokët e Komitetit Qendror të Partisë, ata kishin hapur kartela në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Koçi Xoxe dhe trockistë të tjera, që punonin në këtë ministri sipas urdhërave të Rankoviçit, ishin duke pregetitur materiale për likuidimin politik dhe fizik të të gjithë udhëheqjes besnikë të marksizëm-leninizmit.

Pra, revisionistët jugosllavë u përpoqën të likuidonin kuadrot udhëheqës të Partisë dhe ta kthenin Partinë nga një Parti marksiste-leniniste, në një parti oportuniste. Për të gjitha këto që po them kemi fakte e dokumenta që i zbuluam pas vitit 1948.

E dyta, ata u përpoqën të shtinin në dorë edhe armën tjetër të diktaturës së proletariatit, Ushtrinë tonë Popullore dhe kuadrot drejtues të saj pasi Ministrinë e Punëve të Brendshme e kishin në duart e tyre.

Trockistët jugosllavë u përpoqën të likuidonin kuadrot heroikë të luftës së popullit tonë, të ulnin frymën e heroizmit të ushtrisë sonë dhe të kuadrove të saj, të

futnin në ushtrinë tonë metodat dhe taktikën e ushtrisë jugosllave, të likuidonin llidhjet e ushtrisë sonë me ushtrinë e Bashkimit Sovjetik. Për të gjitha këto, e përsërit edhe një herë, ne kemi fakte dhe dokumenta, po unë po ua them shkurt.

E treta, për të realizuar plotësisht planin e tyre ndaj Shqipërisë paralelisht me masat e mësipërme ata kishin filluar dëmtimin e vendit tonë edhe nga ana ekonomike. Ne i konsideronim si miq, si marksistë, ndërsa ata praktikisht e goditnin vazhdimisht ekonominë tonë të prapambetur. Kur populli ynë ishte pa bukë, pa këpucë, edhe ato pak depo me mallra që ne ua kapëm tregëtarëve na i ngriten të gjitha dhe i çuan në Jugosllavi. Puset e naftës të Kuçovës (sot Qyteti «Stalin»), të cilat gjatë luftës u hodhën në erë, pas çlirimit ne u përpoqëm t'i vinim në funksionim me ata njerëz të paktë që kishim, duke vënë në punë edhe teknikët italianë, disa prej të cilëve na sabotuan me ndërgjegje dhe për këtë ne i ndëshkuam rëndë. Edhe atë sasi të paktë naftë, që ne e nxirrnim me kaq vështirësi të madhe, dhe për të cilën ekonomia jonë e shkatërruar kishte aq shumë nevojë, revisionistët jugosllavë na e merrnin në Jugosllavi, duke mos na dhënë mundësi të mbanim asnjë llogari përkëto çështje e duke na thënë: «ka kohë t'i rregullojmë këto punë», «ne jemi miq dhe do t'ju japim kredi përtë ngritur industrinë». Po revisionistët jugosllavë jo vetëm që nuk na lanë të ngrinim industrinë tonë të re, po na penguan të rimëkëmbnim edhe atë artizanat që kishim. Edhe prodhimet tona shumë të pakta bujqësore në atë kohë na merreshin në Jugosllavi.

Qëllimi i gjithë këtyre masave nga ana e revisionis-

tëve jugosllavë ishte që nga ana ekonomike ta mbanin popullin tonë në varfëri, që Shqipëria të mos zhvillohej, po të mbetej një vend i varfër agrar, i varur për çdo gjë nga Jugosllavia. Ky ishte, pra, drejtimi tjetër për të shtënë në dorë vendin tonë dhe Partinë tonë. Për ta realizuar këtë qëllim ata na bënin presion vazhdimisht për të qenë kurdoherë të lidhur vetëm me Jugosllavinë dhe jo me vende të tjera.

E katërta, një drejtim tjetër i sulmit të revizionisteve jugosllavë ishte likuidimi i të gjitha organeve shtetërore të pushtetit tonë, në radhë të parë likuidimi i qeverisë sonë dhe i Komisionit të Planit të Shtetit. Ne kishim një traktat miqësie, bashkëpunimi dhe ndihme reciproke me Jugosllavinë. Por revizionistët jugosllavë, duke u maskuar në këtë traktat, e deformuan atë dhe krijuan në vendin tonë një organizëm të tillë, që zëvendësonte në fakt qeverinë tonë. Kështu që edhe për gjënë më të vogël ata kërkonin që ne të pyesnim Beogradin, që kufitë midis të dy shteteve të hapeshin dhe monedha jonë të bëhej njëlloj si ajo e Jugosllavisë, pavarësisht nga vlera.

E pesta, sulmi tjetër i tyre ishte lufta kundër Bashkimit Sovjetik, ashtu sikurse veprojnë edhe tani.

E gjashta, ata u orvatën të na frikësonin e ta pushtonin ushtarakisht Shqipërinë duke kërkuar të sjellin këtu 4 divizione, gjoja për të përballuar një sulm që po preqatitej kundër Shqipërisë nga ana e Greqisë. Pra, udhëheqja jugosllave kërkonte «të na shpëtonte» nga Greqia duke dashur të fuste 4 divizione ushtarësh jugosllavë në Shqipëri, po Partia jonë nuk e pranoi këtë kërkesë të udhëheqësve jugosllavë. Për këtë na mbësh-

teti edhe shoku Stalin. Pak ditë më vonë, ata u demas-kuan nga letrat e KQ të PK (b) të Bashkimit Sovjetik dhe nga Informbyroja.

Për këto çështje ju fola shkurtimisht, por duhet të dini se Partia jonë ka luftuar vite me radhë kundër intrigave të këtyre armiqve të socializmit dhe të komunizmit, por të fshehur dhe që e hiqnin veten si miqtë tanë e marksistë. Revisionistët jugosllavë nuk mundën ta mposhtnin Partinë tonë në asnjë moment. Ajo ishte në luftë të përditshme kundër këtyre trockistëve.

Edhe më vonë, udhëheqësit revisionistë jugosllavë asnjëherë nuk e pushuan luftën kundër lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit të vendit tonë, bile edhe pas marrëveshjes sovjeto-jugosllave të qershorit 1955. Me anë të shtypit, të diversantëve dhe të mjeteve të tjera ata na kanë sulmuar vazhdimi. Legata jugosllave në Tiranë është bërë një qendër spiunazhi e aktiviteti të madh kundër nesh, duke nxitur për veprim sidomos elementët antiparti.

Pas Kongresit XX të PK të BS ata bënë çmos përtë gjunjëzuar Partinë tonë, por ajo nuk u përkul se i dinte prej kohësh se cilët ishin ata, i njihte mirë nga gjithë ato fakte që ju thashë. Përpara se të bëhej kundërrevolucioni në Hungari, ata, nëpërmjet dy anëtarëve të Komitetit Qendror të Partisë sonë¹, u orvatën të pregatitnin kundërrevolucionin edhe te ne, por Komiteti Qendror i Partisë sonë, si një blok, i demaskoi. 6-7 muaj përpëra se të bëhej kundërrevolucioni hungarez revisionistët jugosllavë organizuan një grusht kundër Partisë.

¹ Është fjala për Tuk Jakovën e Bedri Spahiun.

sonë në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës, po e gjithë Partia u ngrit në këmbë dhe i demaskoi qëllimet e tyre. Disa nga elementët antiparti që nxorën krye në Konferencën e Tiranës pohuan vetë se ishin agjentë të legatës jugosllave dhe bënин pjesë në agjenturën e saj.

Prandaj ne, shqiptarët, as që na çuditi kundërrevolucioni hungarez. Kur filloj lëvizja kundërrevolucionare në klubin «Petëf», Komiteti Qendror i Partisë sonë u tha shokëve hungarezë të merrnin masa se në këtë veprimtari kishin gisht jugosllavët, por shokët hungarezë nuk na dëgjuan.

Lufta e Partisë sonë kundër revizionistëve jugosllavë është një luftë e drejtë që i bëhet revizionizmit, ashtu siç na mëson Lenini dhe kurri ne nuk do të gënjehem nga demagogjia, nga parullat dhe nga veshja prej qengji e këtyre revizionistëve që në fakt është veshja prej ujku. Partia jonë do të luftojë deri në fund kundër këtyre armiqve të komunizmit, pasi e ka shumë të qartë se kush janë dhe kujt i shërbejnë ata.

Partia jonë është udhëhequr dhe kurdoherë do të udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi dhe do t'i qëndrojë atij besnikë përgjithmonë dhe do të luftojë pa mëshirë kundër revizionistëve sepse ata janë armiq të tërbuar të komunizmit, ata janë «kali i Trojës» që përpilen me të gjitha mundësitë të përqajnë dhe të dobësojnë forcat e socializnit dhe ashtu siç shkruante gazeta jonë «Zëri i Popullit» këto ditët e fundit: dyert e kalasë së kampit socialist janë të myllura për armiqtë.

Ato që kanë bërë titistët në kurriz të Partisë dhe të popullit tonë kërkojnë t'i bëjnë sot edhe në gjithë lëvizjen komuniste dhe punëtore ndërkombëtare. Pran-

daj Partia jonë e ka për detyrë që t'i vërë në dijeni shokët e luftës sonë të përbashkët mbi ato që revizionistët jugosllavë kanë bërë kundër nesh dhe nga këto mund të nxirren mësime. Në fushatën dhe në luftën e tyre të tërbuar kundër lëvizjes komuniste ndërkombëtare, revizionistët jugosllavë kanë synuar veçanërisht të likuidojnë demokracinë popullore të Shqipërisë. Por ne do të mbrojmë kurdoherë pavarësinë e sovranitetin e atdheut tonë dhe me forcat tona modeste do të mbrojmë mark-sizëm-leninizmin. Dhe këtë do ta bëjmë gjithë jetën. Ne jemi të bindur se revizionistët jugosllavë do të demaskohen plotësisht, do të dështojnë në të gjitha përpjekjet e tyre dhe do t'i njohin edhe më mirë partitë motra.

2. — Mbi përbërjen e Partisë sonë

Tani doja t'ju flisja shkurtimisht edhe për përbërjen e Partisë sonë. Partia jonë tashmë është një Parti e kalitur dhe po mbush 17 vjet jetë. Ajo është e re në krahasim me partinë tuaj që ka 40 vjet që është krijuar, por edhe 17 vjet rrugë luftërash e përpjekjesh nuk janë pak. Në radhët e saja sot, sikurse ju thashë, militojnë 50 722 komunistë. Përsa i përket origjinës: 76 për qind e gjithë këtyre rrjedhin nga shtresa të varfëra, prej të cilëve afro 5 000 vetë janë me origjinë punëtore. Kjo shifër, siç e shihni, është e ulët, ajo reflekton numrin e vogël të klasës punëtore në vendin tonë para çlirimit; rreth 20 për qind të efektivit të Partisë vijnë nga shtresa të mesme dhe 3,4 për qind nga shtresa të pasura. Po

duhet të kemi parasysh se këta të fundit janë nga ata njerëz që kanë marrë pjesë në luftë që nga fillimi e deri në fund dhe kanë dhënë prova se janë vënë krejtësisht në shërbim të klasës punëtore.

Përsa i përket gjendjes shoqërore: 22,6 për qind e efektivit të Partisë janë punëtorë, 25 për qind anëtarë të kooperativave bujqësore, 3,4 për qind fshatarë të varfër, 2,4 për qind fshatarë të mesëm, 40 për qind të tjerë; duke përfshirë edhe oficerët, janë nëpunës, gati të gjithë oficerët në vendin tonë janë anëtarë partie, 2,1 për qind janë anëtarë të kooperativave të artizanatit dhe 3 për qind të ndryshëm. Siç del nga kjo pasqyrë në radhët e Partisë sonë janë rrëth 12 000 punëtorë dhe rrëth 9,2 për qind të efektivit janë gra. Ky është një sukses i madh për Partinë tonë.

Në çështjet e ngritjes arësimore në Parti ne kemi bërë një hap përpëra në krahasim me të kaluarën. Shumë komunistë para se të futeshin në Parti ishin fare pa arësim. Tani në Parti kemi vetëm 0,3 për qind analfabetë, këta janë nga partizanët e vjetër dhe gra me moshë të shkuar; 17 për qind të efektivit të Partisë dinë të shkruajnë e të lexojnë; 47 për qind kanë vetëm shkollë fillore; 26 për qind kanë kryer shkollë 7-vjeçare; gati 8 për qind janë me arësim të mesëm dhe afro 2 për qind janë me arësim të lartë.

Siç e shihni, niveli arësimor i Partisë sonë është akoma mjaft i ulët. Por duhet pasur parasysh se para çlirimtë të Shqipërisë 85 për qind e popullit ka qenë analfabet, ndërsa tani analfabetizmi është zhdukur për moshat nën 40 vjeç. Tani rrëth 15 mijë anëtarë Partie ndjekin shkolla të natës ose me korrespondencë, veç

atyre që janë të rinj nga mosha dhe që ndjekin shkollat e larta me shkëputje nga puna.

Përsa i përket edukimit marksist, 47 për qind e efektivit ndjekin format e arësimit të Partisë. Format e arësimit të Partisë dhe shkollat shtetërore i ndjekin rrëth 70 për qind të të gjithë efektivit. Ne kemi një shkollë partie trevjeçare, një shkollë njëvjeçare si dhe kurse e rrethe të ndryshme të arësimit të Partisë.

Ne kemi një rrjet të dendur shkollash politike marksiste-leniniste në të gjithë vendin tonë. Gati të gjithë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë sonë kanë mbaruar shkolla të larta ekonomike, ushtarake, politike, teorike etj. këtu dhe në Bashkimin Sovjetik. Pothuaj të gjithë sekretarët e parë të rretheve kanë mbaruar shkollë të lartë partie, po kështu edhe disa nga sekretarët e dytë. Synimi i Partisë sonë është që brenda një kohe sa më të shkurtër të gjithë sekretarët e parë dhe sekretarët e tjerë në rrethe, inspektorët dhe instruktorët e Komitetit Qendror të Partisë të kenë mbaruar Shkollën trevjeçare të Partisë «V.I. Lenin», ose të marrin arësim të lartë shtetëror.

Uniteti i Partisë sonë është i fortë, qoftë në udhëheqje qoftë në të gjithë Partinë. Kjo i detyrohet luftës parimore që bën çdo ditë Partia jonë për zbatimin e normave leniniste të Partisë dhe ndjekjen me besnikëri të madhe të mësimeve të marksizëm-leninizmit dhe të eksperiencës së PK të BS.

3. — Dy fjalë mbi zhvillimin ekonomik e kultural të vendit tonë

Në fillim unë ju thashë se faqja e vendit tonë kanë ndryshuar kudo në krahasim me të kaluarën. Ky ndryshim është rrjedhim i heroizmit të popullit tonë të udhëhequr nga Partia në Luftën nacional-çlirimtare, pasojë e luftës së drejtë të Partisë sonë për ndërtimin e socializmit si dhe e ndihmës së vendeve miq.

Kush vjen në Shqipëri për herë të parë vë re se te ne të gjitha gjërat janë të reja. Në radhë të parë te ne të bie në sy industria, që është krejt e re. Në krahasim me vitin 1938 sot prodhimi i përgjithshëm industrial në vendin tonë është rritur rreth 17 herë më shumë.

Kur e shfrytëzonin italianët naftën tonë nxirrin mesatarisht 80 mijë ton në vit. Por gjatë kohës së luftës pushtet u hodhën në erë dhe në këtë drejtim vumë dorë edhe ne me qëllim që të mos i shfrytëzonte armiku. Në naftë në fillim ne kishim vetëm një inxhinier, dhe ai ishte inxhinier kimist dhe jo për naftë. Po sot në naftë punojnë me qindra inxhinierë dhe teknikë të mesëm. Veç këtyre tani ne kemi dhe një ushtri të tërë me punëtorë të naftës, që i rriti të gjithë Partia.

Gjatë këtyre 14 vjetëve të çlirimit kemi hapur miniera të reja të qymyrit, të bakrit që ka perspektiva të mëdha, të kromit që ka gjithashtu perspektivë të madhe, kemi hapur miniera hekur-nikeli, shpresojmë të kemi sasi të konsiderueshme fosforitesh, kemi minierën e bitumit natyral përvëç bitumit të naftës etj.

Politika e Partisë dhe e qeverisë sonë është të shfrytëzohen këto pasuri të mëdha në shërbim të popullit. Për këtë qëllim janë bërë dhe do të bëhen investime të mëdha që ta zhvillojmë edhe më shumë industrinë tonë. Tani jemi duke bërë shpime në masë për shfrytëzimin e vajgurit, do të ngremë një sërë fabrikash për përpunimin e bakrit dhe të ferro-kromit; kemi në plan të ngremë fabrika të plehut azotik dhe fosforik, ku mund të vëmë në shfrytëzim edhe sasinë e madhe të gazit që kemi në vendin tonë.

Me zhvillimin e minierave, ne natyrisht, do të zgjerojmë edhe më shumë rrjetin e hekurudhave dhe portet tona. Vendet e tjera socialiste kanë trashëguar dhe nga këto pasuri, kurse ne i ndërtojmë të gjitha këto duke filluar që nga e para. Kjo e bën të kuptueshëm edhe faktin përsë niveli i jetesës në vendin tonë është akoma më i ulët nga ai i vendeve të tjera të demokracisë popullore. Kjo ka ardhur se përpara ne kemi qenë jashtëzakonisht të varfër, të shtypur e të shfrytëzuar deri në palcë nga të huajt. Prandaj kemi dhe shumë vështirësi. Miqtë tanë na i kuptojnë këto vështirësi dhe na ndihnojnë.

Në gjithë këtë punë të madhe që po bëhet për ngrijtjen e ekonomisë Partia jonë ka pasur edhe të meta, po është fakt se në drejtimet kryesore ajo ka pasur dhe ka një vijë të drejtë marksiste-leniniste që e ka çuar nga suksesi në sukses.

Ne kemi ndërtuar dy hidrocentrale të rinj dhe tani jemi duke ndërtuar edhe dy të tjera; perspektivat janë që në të ardhshmen të ndërtojmë edhe të tjera. Janë ndërtuar gjithashtu edhe një numër termocentralesh

dhe shpresojmë që gjatë pesëvjeçarëve të tretë dhe të katërt të kemi energji të mjaftueshme për të gjithë industrinë tonë dhe do të elektrifikohen edhe fshatrat në të cilat, para çlirimit, në të shumtë e rasteve mungonte edhe kandili me vajguri dhe për ndriçim përdornin vetëm pishën.

Përsa i përket industriisë së lehtë, ajo pothuajse nuk ka ekzistuar fare te ne. Sot kemi një kombinat të madh tekstilesh që prodhon 20 milion metra linear në vit. Të gjithë punonjësit atje janë bij e bija fshatarësh analfabetë, disa prej të cilëve kanë qenë edhe vetë barinj. Tani atje vetëm inxhinierë ka aq sa kishte në gjithë Shqipërinë para çlirimit. Kemi ndërtuar një fabrikë sheqeri dhe një sërë fabrikash për konservimin e frutave, të zarzavateve, të peshkut etj. Sot kemi gjithashtu një kombinat druri, uzina mekanike, fabrika qelqi, çimentoje, lëkurësh, këpucësh etj. Në planin tjetër pesëvjeçar do të ngremë një sërë fabrikash të tjera, sepse edhe nevojat e popullit shtohen dhe popullsia e vendit tonë rritet dita-ditës. Meqë ra fjala mund t'ju themi se shtesa natyrale e popullit tonë në këto 3-4 vjetët e fundit është rrreth 29 për mijë, shifër kjo që konsiderohet nga normat më të larta ndërkombëtare.

Bujqësia jonë para çlirimit ka qenë jashtëzakonisht e prapambetur. Vetëm prodhimi i drithërave në krahasim me 1938, është rritur 98 për qind, janë hapur 78 për qind më shumë sipërfaqe tokash të reja, kolektivizimi i bujqësisë në vendin tonë ka arritur gati 75 për qind të tokës dhe 63 për qind të gjitha tokat fushore. Ne mendojmë se vitin 'e ardhshëm do të përfundojë kolektivizimi në të gjitha tokat fushore. Kini parasysh

shokë, se vendi ynë konsiderohet malor dhe fermat shtetërore zënë 9,5 për qind të të gjithë sipërfaqes së punueshme të tokës. Në vitin 1957 ne kemi pasur rrëth 2 000 traktorë fizikë.

Partia ka ndërmarrë një punë shumë të madhe në lidhje me bonifikimet. Tani kemi nëpër duar harta të reja të Shqipërisë. Në hartat e vjetra të vendit tonë që mund t'i keni edhe ju në Finlandë keni parë se edhe në Shqipëri ka liqene e këneta. Por sot disa nga këto këneta nuk janë më. Kështu p.sh. këneta e Maliqit, këneta e Tërbufit etj. nuk ekzistojnë më në hartat e reja, sepse ato janë tharë. Tani jemi duke tharë edhe këneta të tjera dhe për këtë qëllim janë duke u bërë punime kolosale në të gjitha fushat tona. Deri në fund të këtij pesëvjeçari ne do të arrijmë të fitojmë 168 mijë hektarë toka të reja, prej të cilave 70-80 mijë hektarë do t'i ujitim.

Kulturat kryesore që rriten në vendin tonë janë drithërat, pambuku, duhani, panxhari i sheqerit etj. Po çdo kulturë mund të kultivohet në Shqipëri. Ne i kemi vënë detyrë vetes të punojmë më shumë që të shtojmë sipërfaqet e tokës së punueshme, të rritim rendimentin e kulturave për hektar etj. Orientimi i Partisë është ta kthejmë bujqësinë tonë në një bujqësi intensive. Te ne bien shumë shira në dimër dhe veçanërisht në pranverë, që na pengojnë shumë për mbjelljet. Një detyrë kryesore e fshatarësisë sonë është të fitojë luftën me shiu. Kjo do të thotë të luftojmë si kundër lagështirës së dimrit, duke hapur sa më shumë vija e kanale kulluese, ashtu edhe kundër thatësirës së verës, prandaj bonifikjmë fushat, bëjmë kanale për ujitje etj. Të gjitha

këto do të na ndihmojnë të ngremë rendimentet e kulturave bujqësore. Por që t'ia arrijmë këtij qëllimi na duhen edhe plehra kimike. Për këtë ne do të ngremë në pesëvjeçarin e ardhshëm edhe fabrika të plehrave azotike dhe fosforike. Një pjesë të planit tonë për bujqësinë ne po e realizojmë. Vetëm kur të realizojmë këto detyra ne mund të themi se bujqësia jonë ka dalë nga prapambetja. Ne kemi besim të plotë se këto detyra do t'i plotësojmë dhe këtë e tregon fakti që një pjesë të mirë të planit në fushën e bujqësisë po e realizojmë që tani.

Ne kemi edhe një tjetër pasuri të madhe, blegtorenë. Populli ynë ka pasur dhe ka tradita të mira përritjen e saj. Gjatë luftës blegtoria jonë u dëmtua jastëzakonisht. Megjithatë vështirësitë e pasluftës i kaluan dhe tani kemi tejkaluar shifrat e 1938-s në këtë sektor. Në fund të 1957-s ne kemi pasur rreth 405 mijë gjedhe, mbi 1,6 milion krerë dhen, rreth 1,1 milion dhi, mbi 17 mijë dosa, mbi 1,2 milion shpendë etj.

Pas disa ditësh ne do të bëjmë një Plenum të Komitetit Qendror për shtimin e prodhimit të mishit, të qumshtit dhe të gjalpit në vendin tonë. Sipas studimeve që janë bërë për preqatitjen e këtij plenumi rezulton se ne kemi mundësi që në vitin 1965 të shtojmë edhe më shumë sasinë e gjedheve, të bagëtive dhe të shpendëve.

Një fushatë të madhe kanë hapur Partia dhe qeveria për zhvillimin e shpejtë të frutikulturës në vendin tonë, veçanërisht të limonave, të portokalleve, të ullinjve që tani kemi rreth 2 milion rrënës dhe që më 1965 do të kemi rreth 7 milion; të mollëve, të dardhave,

të kumbullave, të siqve sidomos të vreshtave, me një fjalë të të gjitha frutave. Për përpunimin e frutave dhe për prodhimin e verës do të ngremë 12 fabrika.

Këto suksese të mëdha që kanë arritur Partia dhe populli ynë, vetëkuptohet nuk janë realizuar pa luftë dhe pa vështirësi të mëdha. Populli dhe Partia jonë kanë bërë sakrifica të mëdha dhe do të na duhet të bëjmë sakrifica edhe më të mëdha për të kapërcyer vështirësitë që kemi përpara. Ne jemi të ndërgjegjshëm se sukseset arrihen gjithashtu me vështirësi dhe me luftë. Ne jemi të sigurtë se ato do t'i kapërcejmë, se populli ynë është një popull heroik dhe punëtor, i thjeshtë dhc pa pretendime të shumta. Ai ka besim të patundur në udhëheqjen e Partisë dhe në vijën e saj. Partia, që në fillim nuk i premtoi qiellin popullit, po i tha se çdo gjë do ta arrinte vetë me luftë dhe me punë nën udhëheqjen e saj, për zbatimin e vijës së saj. Dhe populli në këtë luftë dhe në këlo përpjekje pa se vija e Partisë ishte e drejtë, se ajo vijë i siguroi atij ato që i tha ajo,jeta e popullit u përmirësua. Rëndësi të madhe ka ajo që populli e ka të qartë perspektivën. Kjo është arësyca kryesore që populli çdo vendim të Komitetit Qendror të Partisë e pret me entuziazëm të madh dhc lufton me mish e me shpirt për t'i zbatuar ato.

Rezultatet e mira në industri, bujqësi e në sektorë të tjera kanë ngritur nivelin e jetesës së popullit. Vetëm vitet e fundit janë bërë 7 herë ulje çmimesh, gjë që i dha mundësi popullit të fitojë 5 560 milion lekë. Shuma më e madhe e buxhetit i shkon ekonomisë kombëtare.

Ushtrinë ne e kemi të fortë. Të gjithë oficerët tanë janë njerëz që kanë dalë nga lufta, gati të gjithë janë komunistë, shumica e tyre kanë mbaruar akademi në BS ose shkolla të tjera ushtarake në vend. Ushtrinë ne e kemi të armatosur me mjetet më moderne luftarake. Megjithkëtë buxheti i ushtrisë te ne zë një përqindje relativisht të vogël. Veç ushtrisë është armatosur edhe një pjesë e madhe e popullit. Partia u ka dhënë armë fshatarëve. Të gjithë, sidomos në fshat, preferojnë të rrinë më mirë pa bukë se sa t'u heqësh armët.

Buxheti i arësimit zë 20 për qind të gjithë buxhetit të Republikës. Në vitin 1958 do të harxhohen mbi 5 miliard lekë pér këtë sektor. Më 1938 në vendin tonë kishte 665 shkolla të arësimit të përgjithshëm e profesional, kurse tani vetëm shkolla fillore, 7-vjeçare e të mesme të arësimit të përgjithshëm e profesional kemi 2 728. Nga 58 000 nxënës që kishim më 1938, tani kemi rrreth 230 000. Më parë ne nuk kishim universitet, kurse tani kemi Universitetin Shtetëror të Tiranës me 6 fakultete, 46 katedra dhe me afër 3 400 studentë, pa përfshirë në këtë shifër ata që ndjekin shkollat e larta jashtë shtetit. Përveç këtij kemi edhe dy institute pedagogjike dhe një institut të lartë bujqësor.

Përpara Shqipëria nuk kishte as teatër dramatik pa le teatër të operës etj. Tani ne kemi Teatrin e Operës dhe të Baletit, 4 teatro dramatike, 6 estrada profesioniste, shtëpi kulture, kinema etj., ndërsa muzeume po ngrihen gati në çdo qytet.

Në vitin 1957 ne nxirrnim 8 gazeta me tirazh 24 milion e 295 mijë në vit si dhe 22 revista. Ndërsa për-

para gazeta kryesore dilte me 4 mijë kopje në ditë, tanë vetëm gazeta «Zëri i Popullit» del në 54 mijë kopje në ditë. Përpara ne kishim një radiostacion të vogël, kurse tanë kemi 8 radiostacione dhe po ndërllojme edhe të tjerë më të mëdhenj. Gjatë 15 vjetëve të regjimit feudal të Zogut u botuan gjithsejt 832 libra, kurse në pushtetin popullor vetëm në vitin 1957 u botuan 324 libra me tirazh rrëth 2,5 milion.

Përsa i përket politikës së jashtme të shtetit tonë ju e dini. Është e njohur që Republika jonë popullore ndjek politikën e bashkekzistencës me të gjitha shtetet. Sot shteti ynë ka marrëdhënie diplomatike me 22 shtete dhe marrëdhënie tregtare me më shumë akoma.

E tillë është gjendja që krijoi për popullin Partia jonë marksiste-leniniste. Mbi të gjitha ajo ka krijuar unitetin e çelnikët të popullit rrëth saj që është burimi i të gjitha fitoreve tona. Këtë e vërtetoi edhe një herë 1 qershori i këtij viti, kur te ne u bënë zgjedhjet e deputetëve për në Kuvendin Popullor. Për politikën e Partisë votuan 99,97 për qind e votuesve. Kjo do të thotë se nga rrëth 780 mijë e atyre që votuan, vetëm 261 votë votuan kundër politikës së Partisë. Siç dihet këto zgjedhje u bënë me votime të përgjithshme, të barabarta, të drejtëpërdrejta dhe të fshehta, pra demokratike, ashtu siç mund të bëhen në një vend ku drejton një parti marksiste-leniniste.

Tani më falni, shokë të dashur, se ndoshta u zgjata pak në këto që ju thashë, po Byroja Politike dhe Komiteti Qendror na kanë rekomanduar që shokët finlandezë t'i vëmë në dijeni sa të jetë e mundur me ho-

llësi për të gjitha çështjet dhe këtë e bëjmë sepse e duam dhe kemi respekt për partinë tuaj. Pavarësisht se jemi larg njëri-tjetrit zemrat tona janë shumë afër jush sepse ato rrahin për një qëllim të përbashkët.

Është e vërtetë se neve na janë dashur shumë përpjekje për të kapërcyer vështirësitë dhe për të arritur në sukseset që përmenda, por ne dimë gjithashtu vështirësitë e mëdha të partisë suaj dhe luftën tuaj heroike. Por natyrisht sukseset e njëresh parti janë edhe të çdo partie tjetër motër. Kështu kur ne korrim një fitore në vendin tonë, siç ishte ajo që u arrit në zgjedhjet tona të fundit, mendojmë se në mënyrë modeste ajo ndihmon në arrijen e fitoreve e në forcimin e pozitive të reja të lëvizjes punëtore komuniste ashtu si dhe fitoret tuaja të tanishme dhe ato përfundimtare në të ardhshmen ndihmojnë Partinë tonë dhe kampin e socializmit.

Ju jeni shokët e parë finlandezë që keni ardhur në Shqipëri. Ne kemi dashur të bisedojmë gjatë me ju. Prandaj, duke shfrytëzuar rastin e qëndrimit tuaj midis nesh, ju bëmë këtë ekspoze në vija të përgjithshme mbi të kaluarën e vendit e të Partisë sonë, mbi gjendjen e tanishme dhe mbi perspektivat e vendit tonë ku u munduam të tregonim gjithshka që mund t'ju interesojë. Por ne, shqiptarët, mendojmë se kjo vizitë e shokëve finlandezë në vendin tonë nuk do të jetë as e para dhe as e fundit. Ne shpresojmë se takime të tjera do të ketë midis nesh. Çdo vit, kurdoherë që të dëshironi ju duhet dhe mund të vini në Shqipëri ku do ta ndjeni veten si në mes vëllezërish e shokësh.

Tani në rast se ju do të keni ndonjë pyetje për të

bërë rrëth atyre që ju fola, ose edhe për ndonjë çësh-tje tjetër ne jemi në dispozicionin tuaj, do t'ju dëgjojmë me vëmendje dhe do të mundohemi t'ju japim çdo sqarim që do të dëshironi.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të marrë me stenogram
që gjendet në AQP*

ME FORCAT TONA, TË SIGUROJME PËR POPULLIN MË SHUMË MISH DHE QUMËSHT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

28 tetor 1958

Diskutimet që u zhvilluan rrëth këtij raporti, trajnënë se të gjithë shokët e Byrosë Politike janë dakord që, ai, pasi të përmirësohet me vërejtjet e bëra, t'i paraqitet plenumit, i cili, natyrisht, do ta shqyrtojë edhe më mirë problemin e furnizimit të popullit me më shumë mish e qumësht.

Nevoja e shtimit të mishit dhe të qumshtit me ritme më të shpejta lind nga qëllimi i lartë që ka Partia jonë për ta përmirësuar gjithnjë e më shumë jetën e popullit. Dhe për t'ia arritur kësaj, nuk kërkohen as kredi as investime as maqineri etj. Këtë problem, i

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua dhe u aprovua raporti që do ti paraqitet Plenumit të KQ të PPSH «Mbi masat që duhen marrë për shtimin me ritëm më të shpejtë të prodhimit të mishit dhe të qumshtit».

cili është me rëndësi jetike, ne mund dhe duhet ta zgjidhim me forcat tona, me mundësitë që kemi brenda vendit, me mobilizimin e popullit, me forcën organizuese e udhëheqëse të Partisë sonë. Përmirësimi i jetës së popullit duhet zgjidhur nga vetë ne.

Krahasimet që bëhen me disa nga vendet miq trajognë se ne kemi shumë për të bërë lidhur me shtimin e mishit dhe të qumshtit, prandaj ta organizojmë më mirë punën në këtë drejtim. Shumë gjëra ne nuk i kemi trashëguar nga e kaluara. Të tilla janë për shembull, agroteknika e lartë, plehrat etj. Kreditë që na kanë dhënë miqtë, në radhë të parë BS, për zhvillimin e bujqësisë do të na jasin rezultate në të ardhshmen. Po ne jemi të ndërgjegjshëm se kemi shumë rezerva, të cilat nuk i shfrytëzojmë si duhet, kemi pengesa dhe të meta. Prandaj, të kemi më tepër sedër për të ecur me hapa më të mëdhenj përpara. E them këtë sepse te ne ka shumë zëra të planit, të cilat jo vetëm s'i realizojmë, por jemi dhe deficit. Po të ecim kështu do të ndodhemi në pozita të vështira. Llogaria duhet bërë vërtet, po nuk ecet pa guxim e fryshtë revolucionare. Duhet më shumë guxim, duhet të udhëhiqemi më mirë nga nevojat që kemi dhe nga propozimet e bazës. Mund të qëndrojmirë në shifrat që parashikohen në raport, po nuk bëjmë keq të pranojmë shifrat e bazës, të cilat, duke qenë mendime të masave të gjera të popullit, janë më revolucionare, më të avancuara.

Realizimi i shifrave që parashikojmë varet shumë nga organizimi dhe drejtimi i të gjithë punës. Përmirësimë kemi, por në këtë fushë duhet të bëjmë akoma më shumë edhe për çështjet që diskutojmë. Të marrim

për shembull fermat, që duhet të jenë pasqyra e kooperativave bujqësore. Edhe këtu nuk po luftohet me këmbëngulje për të marrë sa më shumë prodhime. Nëse duam të realizojmë planin e mishit e të qumshtit, atëherë është e domosdoshme të ushqejmë si duhet bagëtitë, të cilat kanë nevojë për lëndët ushqyese siç janë lakrat etj., ndryshe si do të marrim prodhimet sipas shifrave të parashikuara? Të mos nënveftësohen koncentratot, po të vlerësohen edhe ushqimet e gjelbëra. Kam përshtypjen se fermat nuk janë kontrolluar mirë për këtë çështje, që ato të punojnë si duhet për të siguruar bazën ushqimore. Po të veprojnë kështu fermat, do të mësojnë edhe kooperativat bujqësore. Por zooteknia nuk e ka kryer si duhet detyrën. Ajo duhet t'i japë shtetit në blegtori një ndihmë jashtëzakonisht të madhe. Të ecim në bazë të mundësive tona reale, të mos jemi pesimistë në arritjen e shifrave të planit, sepse ato janë të realizueshme, prandaj të mobilizohemi me të gjitha forcat.

Ministria e Bujqësisë duhet të marrë masa serioze për zhvillimin e derrit. Sigurisht, ajo ka të drejtë që kërkon frigoriferë, po nuk vepron mirë që i skarton derrat, sepse për ta ne kemi nevojë, ashtu si dhe për lopët. Duke luftuar për të shtuar lopët, nuk na jep njeri të drejtën të lëmë pa shtuar derrin. Dhitë t'i mbajmë, po ato t'i shohim në lidhje me pyllëzimet, të forcohet kontrolli që dhia të mos na prishë pemët. Pra, t'i shohim të gjitha dhe të luftojmë për të gjitha, bile edhe për peshkun e për gjahun, që këtu u fol fare pak. Gjahu i vrarë t'i dorëzohet grumbullimit. Do të vijë dita që derri të hahet. Në fshat kjo shkon më

ngadalë, po në qytete s'ka pasur sa duhet kujdes, se këtu derri s'hahet jo për arësyet fetare, po për forcë zakoni. Në fshat duhet ta futim më shumë mishin e derrit, sidomos në të rinxjtë. Jo vetëm të bëjmë që mishi i derrit të hahet më shumë, por ai është i leverdissë edhe për ta eksportuar, që të mund të importojmë artikuj të tjerë. Mishit të derrit mund t'i ulim edhe çmimin. Të mos harrohet sallua, sidomos ajo e derrit.

Këto janë disa nga problemet që do t'i shtrojmë gjerësisht në plenumin e ardhshëm të Komitetit Qendror.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PARTIA JONE ËSHTË KALITUR NË LUFTË ME VËSHTIRËSITË

*Nga biseda në takimin me dy shokë të PK
të Indonezisë*

30 tetor 1958

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë sonë, shokë, na ka ngarkuar të bisedojmë me ju, prandaj po të na lejoni ne mund t'ju njohim shkurtimisht me historinë e Partisë sonë.

Mbi ç'baza dhe si u formua Partia Komuniste Shqiptare?

Partia jonë është një Parti e re, 17-vjeçare, e formuar gjatë Lustës së dytë botërore. Në fillim ajo kishte rrreth 200 anëtarë. Momentet kur u themelua Partia jonë ishin shumë të vështira. Situata kur u krijuar ajo kishte anët e veta të favorshme e të disfavorshme. Ndër ato që e favorizonin krijimin e saj mund të përmendim:

Së pari, traditën luftarake të popullit tonë. Populli shqiptar është një popull me tradita të lashta luftarake për lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e atdheut të vet. Me shkuj ka qenë i pushtuar populli ynë, po ai asnje-

herë nuk e ka pushuar luftën kundër pushtuesve. Ju keni dëgjuar për luftërat e popullit tonë të udhëhequra nga Heroi ynë Kombëtar, Skënderbeu, dhe besoj se e keni parë filnin «Skënderbeu», ku del qartë lufta e popullit tonë kundër turqve osmanllinj në shekujt XIV-XV. Në këto luftëra populli ynë është treguar një nga popujt më përparimtarë dhe më luftarakë në Evropë dhe këtë e ka treguar me përpjekjet e tija heroike për mbrojtjen jo vetëm të vendit të tij nga hordhitë otomane, por edhe të qytetërimit evropian. Filozofi i madh francez i shekullit XVI, Montenj, veprën e tij të madhe filozofike me titull «Essais» e fillon duke rekomanduar të merret shembull nga virtytet e larta të Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut. Kështu, shumë kohë përpara, janë vlerësuar historia, trimëria dhe lufta e popullit shqiptar.

Populli shqiptar jo vetëm që ka luftuar gjatë shekujve, por ka krijuar edhe kulturën e tij. Ai, si popull i lashitë, ka edhe një kulturë të lashtë. Gjatë shekujve shkelësit e huaj e kanë shtypur dhe e kanë shfrytëzuar ekonomikisht, ata janë përpjekur gjithash tu të zhduknin edhe kulturën e vjetër të popullit tonë dhe ta quanin atë si një popull barbar dhe pa asnjë farë kulture. Lidhur me lashtësinë e kulturës sonë ne jemi duke zbuluar tani shumë monumente të vlefshme arkeologjike që vërtetojnë ekzistencën dhe zhvillimin e kulturës së lashtë të popullit tonë.

Traditën luftaraKE si një nga virtytet më të shkëlqyera të popullit tonë dhe kulturën tradicionale i trashëgoi dhe i përvetësoi Partia jonë.

Së dyti, mësimet e marksizëm-leninizmit. Partia

jonë në rrugën e saj të vështirë, si busull orientuese kishte mësimet teorike dhe praktike të marksizëm-lenismit. Këto mësimë kishin hyrë në Shqipëri, para krijimit të Partisë, nëpërmjet grupeve të para komuniste. Partia jonë kishte eksperiencën e luftës së lavdishme të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, te e cila ajo u mbështet me të gjitha forcat e saja, që me bashkimin e grupeve të para komuniste të Shqipërisë.

Së treti, puna pregitore e grupeve komuniste. Lëvizja komuniste në Shqipëri nuk filloi në vitin 1941. Ajo kishte filluar që përpara, nëpërmjet individëve dhe grupeve, që luftonin kundër regjimit feudal të Zogut për të drejtat demokratike dhe sindikale. Por meqenëse bëhet fjalë për shumë grupe komuniste në Shqipëri në këtë kohë, kuptohet se jo të gjitha këto grupe kishin një orientim të qaritë. Midis grupeve komuniste në Shqipëri kishte të tilla me pikëpamje të drejta e marksiste, por kishte edhe nga ato me pikëpamje të shtrembra. E tillë ishte te ne lëvizja komuniste e fillimit. Me gjithë të metat e tyre, këto grupe ndihmuin për marrjen kontakt me masat, për përhapjen në popull të ideve të komunizmit dhe për njohjen e jetës së re në Bashkimin Sovjetik. Ekzistanca e këtyre grupeve të para dhe përhapja e ideve komuniste në masat qenë një bazë e mirë që ndihmuin në themelimin e Partisë sonë.

Së katërti, mungesa e partive politike para çlirimt. Gjatë regjimit të Ahmet Zogut nuk ka pasur asnjë parti politike në Shqipëri. Zogu nuk lejonte të ngriheshin parti, qofshin ato me tendenca borgjeze, socialdemokrate ose edhe të tjera të atilla që nuk e dëmtonin regjin

e tij. Kështu rezistenca kundër regjimit të Zogut dhe kundër preqatitjes së pushtimit nga Italia fashiste u mbajt lart vetëm nga grupet komuniste. Mungesa e partive të tjera ndihmoi në propagandimin më lehtë të ideve komuniste, të cilat nuk gjetën përpara pengesë nga ide e teori të partive borgjeze. Komunistët shqiptarë hasën në kërbaçin, plumbin dhe litarin e regjimit të Zogut veçanërisht gjatë preqatitjeve që bëheshin për ardhjen në fuqi të fashizmit. Kur vendi ynë u pushtua nga Italia në vitin 1939, populli shqiptar, nën influencën e traditave të tija luftarake për liri dhe të veprimtarisë së patriotëve të udhëhequr nga komunistët, u gjend i téri në këmbë kundër pushtuesve italianë, feudalëve dhe njerëzve të Ahmet Zogut që tradhëtuani. Kështu lufta kundër tradhëtarëve dhe fashistëve nga komunistët dhe populli ynë filloi më 1939. Po çfarë lufte bëri populli me komunistët në krye? Ai bëri luftë politike dhe ideologjike, të kombinuar me atentate e aksione konkrete, në bazë të mësimeve marksiste-leniniste. Paralelisht me këtë luftë dhe nëpërmjet kësaj lufte komunistët shqiptarë me të vërtetë marksistë, synonin dhe punonin edhe për një qëllim të madh, për formimin e Partisë Komuniste Shqiptare. Pra, edhe para formimit të Partisë sonë, d.m.th. nga viti 1939 e deri më 1941 nën shembullin dhe nën drejtimin e komunistëve e të patriotëve, u zhvilluan shumë përpjekje kundër pushtuesve italianë.

Idetë e komunizmit fituan shpejt simpatinë dhe përkrahjen e popullit, sepse komunistët që në fillim u mbështetën në popull dhe u treguan udhëheqës trima në krye të tij, në çdo situatë, pavarësisht se ata ishin

shumë të rinj nga mosha. Me trimëritë e tyre ata gjëzuan respektin e dashurinë e popullit se ai i do dhe i respekton shumë trimat. Por këto ide u mbështetën nga populli edhe për faktin se ai e kuptoi që ato dhe përhapësit e tyre ishin shpëtimtarët e vërtetë të tij.

Së pesti, klasa punëtore të ne, megjithëse e vogël në numër, e luajti plotësisht rolin e saj pararojë. Në Shqipëri nuk kishte një klasë punëtore të madhe e të zhvilluar meqenëse mungonte pothuajse krejt industria, përveç një farë artizanati. Por shpejt ajo u bë e ndërgjegjshme për rolin e saj.

Së gjashti, shpirti patriotik e revolucionar i fshatarësisë sonë. Ne kishim një fshatarësi patriote e shumë revolucionare, e cila u bashkua plotësisht me Partinë e proletariatit, përqafroi programin e saj, pranoi udhëheqjen e Partisë sonë Komuniste, d.m.th. pranoi udhëheqjen e klasës punëtore. Kjo qe një anë shumë e favorshme për Partinë tonë. Forcat revolucionare që u ndodhën në gjirin e fshatarësisë sonë, natyrisht, gjenden edhe në gjirin e popujve të tjerë, por ato duhen mobilizuar, orientuar e udhëhequr. Është fakt se fshatarësia e vendit tonë, sidoqë ishte e prapambetur nga ana kulturale dhe ekonomike, frymën patriotike e kishte të lartë, jo vetëm kaq, por ajo pa te komunistët çliruesit e vërtetë të saj, për këtë arësyte ajo pranoi edhe udhëheqjen e klasës punëtore dhe të pararojës së saj, të Partisë Komuniste.

Si e organizoi dhe e udhëhoqi Partia Luftën nacional-çlirimtare?

Lufta e popullit tonë kundër pushtuesve fashistë filloji në vitin 1939 dhe mbaroi me çlirimin e plotë të

Shqipërisë. Gjatë kësaj lufte mund të themi se jo vetëm u arrit uniteti i plotë i popullit shqiptar nën udhëheqjen e Partisë, por u bë edhe diferencimi i armiqve të popullit.

Cilat ishin, me pak fjalë, vijat kryesore të programit të Partisë sonë? Çështja e parë ishte lufta deri në fund e pa kompromis kundër pushtuesve dhe bashkë-punëtorëve të tij. Partia e konsideronte kryengritjen e armatosur si të vetmen rrugë për çlirimin e vendit dhe marrjen e pushtetit. Kjo do të arrihej duke mobilizuar gjithë popullin, të gjithë ata që ishin për luftë kundër armikut pa bërë asnje dallim pavarësisht nga idetë politike ose besimet e tyre. Qëllimi i Partisë sonë ishte që, duke i konsideruar të gjithë ata miq të Partisë dhe të popullit, t'i mobilizonte rreth saj e të luftonin pushtuesit dhe tradhëtarët e vendit.

Çështja tjetër ishte se lufta e popullit tonë nuk ishte e vërtmuar, por e lidhur shumë ngushtë me luftën e Bashkimit Sovjetik kundër të njëjtët armik. Parulla e Partisë sonë ishte: luftë deri në fitore kundër armiqve krah për krah me BRSS, pasi liria do të na vinte me luftën tonë të ndihmuar nga lufta çlirimtare e popujve sovjetikë.

Edhe nga ana ideologjike Partia jonë ndoqi me vendosmëri mësimet e marksizëm-leninizmit dhe të Partisë Komuniste (Bolshevike) të Bashkimit Sovjetik.

Partia jonë luftonte gjithashtu për një Shqipëri të lirë, të pavarur dhe demokratike, për reforma të mëdha politike, ekonomike dhe ndër ato ekonomike në radhë të parë për reformën agrare. Këto ishin vijat kryesore të programit tonë. Me këtë program Partia jonë luftoi me armë në dorë.

Në luftën për liri, përveç divizioneve të shumta italiane dhe gjermane, Partia jonë luftoi edhe kundër shumë armiqve të brendshëm të saj dhe të popullit. Në radhë të parë Partia luftoi kundër elementeve përcarës trockistë, të cilët vepronin të maskuar që përparrë formimit të Partisë. Kur arriti koha që të themelohej Partia jonë ata u rigrupuan dhe u përpoqën ta pentgonin këtë. Por ajo u krijua dhe ata dështuan në këto përpjekje. Pastaj ata, me anë fraksionesh, u përpoqën të likuidonin Partinë dhe të shkatërronin vijën e saj të drejtë, por ajo i likuidoi këta armiq dhe doli fitimtare.

Partia, që kur u krijua, i bëri thirrje për luftë gjithë popullit, si edhe mjaft elementeve që dikur kishin pasur pikëpamje përparimtare, por që tani lëkundeshin të luftonin kundër pushtuesve; ajo u përpoq t'i tërhoqte edhe këta me vete dhe t'i hidhte në luftë kundër pushtuesve. Këtu është fjala për disa krerë dhe elementë, të cilët në të kaluarën kanë pasë krijuar një farë influence në popull e që njiheshin prej tij, pavarësisht se kohët e fundit mbanin qëndrim të lëkundshëm. Por Partia kurrë nuk mendoi t'i varte shpresat te këta ose lidhjet e saja me popullin t'i bënte nëpërmjet këtyre. Ajo u përpoq që këta elementë ta përcaktonin qëndrimin e tyre: ose të hidheshin në luftë krah për krah me popullin, ose të skartoheshin. Pra, Partia u përpoq që këta njerëz t'i afronte pas vetes duke i hedhur në luftë ose të paktën t'i neutralizonte, ndryshe, në rast se ata do të bashkëpunonin me armikun, vetëvetiu do të humbisnin influencën dhe si rrjedhim vetë populli do t'i shikonte se ç'ishin e do t'i luftonte.

Një punë të madhe bëri Partia me nationalistët

për t'i tërhequr edhe këta në luftë kundër armikut. Por duke synuar bashkimin dhe bashkëpunimin e singertë me nacionalistët, PKSH pati parasysh kurdoherë lëkundjet që viheshin re në një pjesë të tyre, mungesën e vazhdimesisë për një luftë revolucionare dhe për demokratizimin e vendit, prirjet që dukeshin në disa për kompromis me kuislingët dhe pushtuesit. Politikën e tërheqjes së tyre Partia jonë e bëri nëpërmjet një çështjeje: në vatrat tona ndodheshin pushtuesit, për t'i larguar këta duhej luftuar, atëhere ajo hodhi parullën - kush e do atdheun duhet të luftojë. Dhe në këtë rast do të dukej mirë se kush ishte patriot dhe kush ishte tradhëtar. Sa për çështjet e tjera që mund të lindnin, ato do të rregulloheshin kur të çlirohet Shqipëria. Këtë politikë e kuatoi shumë mirë populli shqiptar. Pseudonacionalistët që nuk e përkrahën luftën për çlirim, filuan ta humbasin influencën që kishin në popull. Por edhe ata nuk ndenjën me duar lidhur. Në fillim ata nuk i vlerësuan drejt forcat e popullit dhe forcën e madhe të Partisë sonë të re që porsa kishte lindur. Ata mendonin se populli shqiptar ishte në stadin e këtu e 30-40 vjetëve përpara dhe që këta edhe tanë mund ta gjenjenin fare lehtë. Ata mendonin se Partia jonë ishte e përbërë «nga kalamanë», se mund ta diskreditonin kur të donin në sytë e popullit duke përdorur parullat e njohura të borgjezisë se «komunistët prishin familjen», «janë pa moral» etj. Ky nënveftësim ne na favorizoi se na dha kohë. Por në këtë çështje, natyrisht, ata u gabuan, sepse guximi dhe politika e drejtë e Partisë gjatë luftës bënë që populli të ngrihej në këmbë dhe të kishte besim të madh te Partia. Atëhere këta

njerëz e kuptuan rrezikun e tyre dhe filluan ta përcaktojnë më mirë qëndrimin e tyre. Por ishte vonë. Partia e kishte bërë punën e saj me popullin. Populli kishte fituar besim të plotë te ajo dhe parullat e tradhëtarëve nuk pinin më ujë.

Partia e kishte të qartë se lidhja e ngushtë me masat ishte treguesi më i mirë i forcës dhe i aftësisë së një partie marksiste-leniniste, ajo e dinte se nga aftësia e saj për të luajtur rolin si pararojë e klasës punëtore, nga aftësia për të lidhur teorinë revolucionare me praktikën konkrete të revolucionit varej mosizolimi nga masat dhe mosmbetja në bisht të situatës. Prandaj, Partia, iu përvesh punës me të gjitha forcat për t'u lidhur me masat popullore dhe për t'i bindur ato në drejtësinë e vijës së saj politike. Këtë detyrë ajo e vuri në plan të parë, si çelës për zgjidhjen e problemit të bashkimit e të mobilizimit të popullit në luftë.

Partia jonë në vitin 1942 hartoi një program shumë të rëndësishëm në lidhje me mobilizimin e masave. Kjo ishte një ngjarje me rëndësi që shpuri në Konferencën e Pezës, fshat afër Tiranës. Qëllimi kryesor ishte, së pari, të krijohej Fronti Nacional-Çlirimtar i Shqipërisë dhe, së dyti, të hidheshin bazat e pushtetit populor në vendin tonë. Në Konferencën e Pezës Partia jonë ftoi shumë njerëz: përveç komunistëve u ftuan dhe patriotë të vjetër, patriotë të rinj, nacionalistë, njerëz me pikëpamje jokomuniste, bile edhe njerëz antikomunistë, besimtarë të ndryshëm etj. Një pjesë e mirë e të ftuarve erdhën në konferencë, midis tyre edhe elementë antikomunistë, por që në ato momente, për interesa të ngushta personale paraqiteshin kundër pushtuesve; erdhën gjith-

ashtu edhe përfaqësues të mbretit Zog. Megjithatë disa të tjerë, që ishin stuar, nuk erdhën, sidomos nga ata që kishin pasur influencë në popull, por që tanë ishin lidhur, në mos haptas po fshehtas, me pushtuesit.

Në këto kushte u krijua me unanimitet Fronti Nacional-Çlirimtar dhe u hodhën bazat e pushtetit të ardhshëm popullor, pushteti i këshillave nacional-çlirimtare. Fronti nuk ishte bashkim partish politike, por bashkim vullnetar i gjithë popullit shqiptar. Nacionalistë dhe patriotë të tjerë morën pjesë në Front si individë dhe jo si përfaqësues të partive apo të grupeve të ndryshme politike. E vetmja parti politike në Front ishte PKSH. Kjo ishte një fitore e madhe e politikës së Partisë dhe e popullit tonë. Konferenca e Pezës vuri themellet e Frontit Nacional-Çlirimtar e të pushtetit popullor. Ajo afirmaoi rolin udhëheqës të PK Shqiptare në Luftën nacional-çlirimtare, shënoi në këtë mënyrë fitoren e parë të madhe politike të saj dhe ligjëroi bashkimin vullnetar të masave të gjerë popullore, bazat e të cilit ishin hedhur në luftën kundër pushtuesve. Farkëtuesja e këtij bashkimi dhe udhëheqësja e drejtëpërdrejtë dhe e vetme e Frontit ishte PKSH. Ky Front në themel kishte aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë.

Meqenëse pushtuesit italianë nuk mundën ta sabotonin Konferencën e Pezës me agjentët e tyre, filluan ta sulmonin zonën e Pezës me divizione, po partizanët dhe populli rezistuan me vendosmëri.

Kur armiqjtë mendonin se e kishin likuiduar Partinë tonë, në një natë korriku, sipas udhëzimeve të Komitetit Qendror të Partisë, në gjithë Shqipërinë u prenë telat dhe shtyllat e telefonit, u sulmuan gjithashtu

rrugë, ura, kamionë dhe u bënë edhe aksione të tjera kundër armiqve. Kjo tronditi jo vetëm italianët, por edhe tradhëtarët. Kriza e përgjithshme që u shkaktua në radhët e armikut nga rritja e vrullshme e Luftës nacional-çlirimtare bëri që më vonë të rrëzohej qeveria kuislinge.

Gjatë këtyre kohëve lufta vazhdonte pa ndërprerje dhe zgjerohej. Çetat u bënë batalione, batalionet u bënë brigada dhe këto u bënë divizione etj. U çliruan krahi na të tëra e në to u shkatërrua aparati i vjetër i pushtetit të pushtuesit dhe u ngriten në vend të tij këshillat popullore, u hapën shkolla dhe tradhëtarëve u bëheshin gjyqe nga ana e popullit. Të gjitha privilegjet e feudalëve u likuiduan, asnjë taksë nuk u jepej më atyre nga ana e fshatarëve. Edhe në qytete që ishin akoma të pushtuara u krijuan këshilla nacional-çlirimtare. Kështu çdo lagje në këto qytete kishte këshillin e vet. Qyteti kishte këshillin e vet që punonte për mbledhjen e informatave ushtarakë dhe politike, për të mbledhur e për të dërguar ndihma partizanëve, për të organizuar sulme kundër depove dñe kazermave të armikut, për të furnizuar Ushtrinë Nacional-Çlirimtare me armë, veshmbathje, ushqime etj.

Pas Konferencës së Pezës pushtuesit fashistë duke parë luftën e ashpër që po bëhej kundër tyre, u përpoqën të krijonin me anën e reaksionit një kundërparti, «Ballin Kombëtar», siç u vetëquajt kjo organizatë. Qëllimi i tyre ishte që të mënjanonin popullin dhe ta largonin atë nga lufta kundër tyre. Për këtë qëllim ata, natyrisht, përdornin plot parulla demagogjike.

Fronti Nacional-Çlirimtar, që udhëhiqej nga Partia,

u bëri thirrje elementëve të kësaj organizate që, në qoftë se donin me të vërtetë të luftonin, të vinin në Frontin Nacional-Çlirimtar dhe të pranonin platformën e tij, bille u propozuam edhe bisedime dhe këto nisën, mirëpo nuk u përfundua asgjë. Ata s'kishin si ta luftonin pushtuesin derisa ai vetë i kishte organizuar. Kështu brenda një kohe shumë të shkurtër parullat demagogjike të këtyre elementëve u demaskuan. Dhe ndërsa lufta jonë po merrte hov dita-ditës, «Balli Kombëtar» u detyrua të dilte haptas përkrah armikut. Populli e pa qartë se kjo organizatë ishte një armë në duart e pushtuesve. Politika e drejtë e Partisë sonë ndaj nationalistëve bëri që të arrihej edhe diferencimi midis tradhëtarëve, të lëkundurve dhe patriotëve. Populli pa qartë tani se cili i mbronte me të vërtetë interesat e tij dhe cili ishte kundër tij. Më vonë edhe ato pak forca të armatosura balliste i likuidoi Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare.

Thamë se në Konferencën e Pezës erdhën edhe përfaqësuesit e mbretit Zog, i cili ishte arratisur jashtë shtetit që më 1939. Qëllimi i tyre ishte demagogjik e reaksionar. Kur panë se nuk mund të luanin dot kartën e tyre edhe këta u shkëputën prej nesh dhe me ndihmën e anglezëve formuan një organizatë të tyren, që e quajtën «Legaliteti». Por edhe kjo organizatë u demaskua dhe u likuidua që gjatë luftës nga fakti se asgjë nuk bënte kundër pushtuesve dhe armiqve të popullit, përkundrazi kërkonte të sabotonte luftën e popullit.

Në shtator 1943 kapituloi Italia fashiste. Partia u bëri thirrje të gjithë ushtarëve italianë të mos u dorëzo-heshin gjermanëve, po të virin në mal me ne dhe u thamë se atyre që donin të luftonin kundër fashistëve

gjermanë ne ishim gati t'u jepnim edhe armë. Një pjesë e tyre erdhën.

Pas kapitullimit të Italisë në vendin tonë erdhën ushtritë gjermane të pushtimit, kundër të cilave populli ynë nën udhëheqjen e Partisë bëri luftë shumë të ashpër.

Kështu deri në çlirimin e Shqipërisë ne kaluan nëpër shumë etapa të rëndësishme. Një nga këto etapa ishte mbledhja e një konference të rëndësishme të Partisë¹ ku u zgjodh edhe Komiteti Qendror i Partisë sonë. Deri para kësaj konference vepronte Komiteti Qendror i Përkoħshäm. Punimet dhe vendimet e kësaj konference e forcuan më shumë Partinë nga ana organizative. Kur u zmađhua ushtria jonë partizane u bë një tjetër konferencë e rëndësishme në të cilën u hodhën bazat e shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare. Më 24 maj 1944 u thirr Kongresi i Përmetit ku u dërguan delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, komunistë dhe patriotë, pjesëtarë të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe të këshillave popullore nacional-çlirimtare të krahinave të çliruara e të paçliruara.

Në Kongresin e Përmetit, pasi u bë bilanci i të gjitha fitoreve të arritura deri në atë kohë, u morën disa vendime shumë të rëndësishme. Atje u vendos të kalohej në sulm të përgjithshëm për çlirimin e plotë të Shqipërisë. Me këtë rast iu bë thirrje edhe një herë të gjithë atyre, që ishin të gabuar, që të hidheshin me Luftën nacional-çlirimtare, kundër pushtuesve. Kongresi i Përmetit vendosi që të gjitha koncesionet e huaja politike dhe ekonomike të anuloheshin; të gjitha trakta-

¹ Eshtë fjala për Konferencën e parë të Vendit, që u mbajt prej 17-22 mars 1943.

tet e nënskruara nga qeveria e Zogut me shtetet imperialiste si me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Anglinë, me Italinë, me Greqinë etj. bëheshin të pavlefshme. Në atë kohë në Londër nga anglezët u bënë tentativa për të ngritur «një qeveri» në mërgim, gjoja demokratike siç ishin ngritur për disa shtete të tjera. Kongresi i Përmetit vendosi që populli shqiptar të mos pranonte asnjë qeveri tjetër dhe regjimi i Ahmet Zogut të mos rikthehej më në Shqipëri. Gjithashtu këtu nga Këshilli i Përgjithshëm Antifashist Nacional-Çlirimtar, i cili doli nga Kongresi i Përmetit dhe që tani ne e quajmë Kuvendi Popullor, u zgjodh Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar me atributet e një qeverie provizore. Pas Kongresit të Përmetit sulmi i përgjithshëm i ushtrisë sonë kundër divizioneve gjermane dhe bandave tradhëtare të vendit filloi me divizionë.

Në prakun e çlirimit të Shqipërisë, në tetor 1944 u bë Mbledhja e Beratit. Ajo që është për t'u përmendur nga kjo mbledhje është ndarja e organizatës së Frontit Nacional-Çlirimtar si organizatë politike nga organet ekzekutive të pushtetit popullor.

Më 29 Nëntor 1944 u arrit çlirimi i plotë i Shqipërisë nga Ushtria Nacional-Çlirimtare, e cila në prakun e çlirimit kishte 70 mijë vetë. Tani i gjithë pushteti ishte në duart e popullit të udhëhequr nga PKSH, sepse asnjë parti tjetër në Shqipëri nuk mori pjesë në luftë kundër pushtuesve. Regjimi i vjetër ishte shkatërruar nga themellet, ndërsa pushteti popullor i formuar që gjatë kohës së luftës vinte duke u forcuar.

Akoma pa u çliruar Shqipëria, ushtria jonë u shkoi në ndihmë, me divizionë të tëra, popujve dhe partiza-

nëve jugosllavë. Kështu divizionet tona në Jugosllavi ndihmuani për të çliruar Malin e zi, Bosnjën, Sanxhakun, Kosovën dhe Metohinë. Në luftën për të ndihmuar popujt e Jugosllavisë repartet tona humbën me qindra partizanë.

Ne patëm shumë dëme nga armiku. Ne jemi një popull i vogël, po shifrat e humbjeve janë relativisht të mëdha. Na u vranë 28 000 vetë dhe na u plagosën rrëth 12 600 vetë, ndërsa 10 000 na u internuan nëpër kampet e përqëndrimit. Fshatra, qytete e krahina të tëra na u shkatërruan nga armiku. Afro 63 000 shtëpi na u dogjën, na u dëmtua rëndë blegtoria, urat dhe portet detare na u hodhën në erë. Edhe ne i goditëm rëndë pushtuesit, nga ata mbetën të vrarë në truallin tonë 26 600 vetë, 21 245 u plagosën dhe 20 800 i zumë robër, të cilët i kemi mbajtur nëpër male dhe, kur u çlirua Shqipëria, të gjithë i lejuam të shkonin në vendin e tyre. Përveç njerëzve, armiqve u shkatërruam ose u kapëm mbi 2 100 tanksa, autoblinda e automobila, 4 000 topa e mortaja, pa llogaritur pushkët, mitralozat dhe armë e pajisje të tjera.

Partizanët tanë e filluan luftën me armë të vjetra ose me nga një revolver të prishur. Armët me të cilat ne bëmë luftën nuk ishin këto, por armë moderne që ua rrëmbyem me luftë armiqve nga depot e tyre ose në frontin e betejës.

Luftha partizane në vendin tonë u zhvillua në shembullin e luftës së partizanëve sovjetikë. Në bazë të mësimeve të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit ne bëmë një luftë shumë të lëvizshme, duke e goditur armikun nga të katër anët, atje ku ai nuk e priste.

Përveç armiqve fashistë italianë e gjermanë dhe

bashkëpunëtorëve të tyre, tradhëtarëve të vendit, gjatë kohës së luftës na nxorën shumë telashe edhe anglezët e amerikanët sado që hiqeshin si aleatë. Ata dërguan në zonat e çliruara nga ne disa misione ushtarake, që, me gjithëse deklaronin se do të na ndihmonin, bënин çmos për të sabotuar Luftën nacional-çlirimtare të popullit tonë. Qëllimi i tyre ishte të organizonin reaksionin dhe kuislingët. Me armët që na premtonin se do të na i jepnin neve, në fakt, ata pajisnin reaksionin. Po ne nuk mund të na e hidhnin dot. Partia jonë ishte shumë vijilente. Shumë herë ne i paralajmëruam ata për këto veprime. Më në fund ata na vunë në pozita të pranonim një aksion të përbashkët në bregdetin tonë. Ata synonin të futnin këmbët dhe të pushtonin kështu vendin tonë. Por këtë e bënin edhe për një qëllim tjetër: në qoftë se ne nuk do të pranonim, të na akuzonin se ne nuk luftojmë bashkë me aleatët, por vetëm me rusët. Komanda jonë e kuptoi planin e tyre dhe pranoi propozimin për të bërë këtë aksion, por me kushte rigorozë dhe i paralajmëroi ata që me t'u kryer aksioni, brenda 24 orëve të largoheshin, ndryshe ushtria jonë do të fillonte luftën kundër tyre. Kështu ushtria angleze, e cila do të ishte asgjësuar po të mos kishin sulmuar partizanët tanë mbi gjermanët, u detyrua të largohej dhe plani i tyre dështoi.

Anglo-amerikanët dhe pas çlirimt organizuuan shumë komplate kundër pushtetit tonë, po të gjitha u zbuluan dhe u likuiduan. Ne kemi dokumenta angleze të kapura në vendin tonë me të cilat vërtetohet se ata pas çlirimt bënin preqatitje për të sulmuar Shqipërinë nga ana e Durrësit dhe e Vlorës. Ata gjithashtu bënë shumë përpjekje që zgjedhjet tona për në Asamblenë Kushte-

tuese të sabotoheshin dhe, kur nuk ia arritën dot këtij qëllimi, në shenjë proteste se gjoja në vendin tonë nuk kishte demokraci u larguan duke mos e njojur qeverinë shqiptare. Po ne jetojmë e punojmë shumë mirë edhe pa ata e pa njojen nga ana e tyre.

Gjatë kohës së luftës Partia bëri një politikë të urtë edhe në lidhje me çështjet fetare. Partia nuk bëri asnjë dallim midis njerëzve dhe tha se detyra e të gjithëve ishte, në atë kohë, të çlirohet Shqipëria. Ndjenjat e popullit nuk do të cënoheshin, po Partia kërkonte që klerikët të ndihmonin në atë kohë Luftën nacional-çlirimtare. Nga ana e Partisë u bënë përpjekje që edhe klerikët të rroknin armët dhe të hidheshin në luftë kundër armiqve. Komunistët dhe partizanët edukohe-
shin me respektin për të kaluarit nga mosha. Rinia porositej nga Partia të tregohej e pjekur dhe të res-
pektonte njerëzit me moshë të kaluar pavarësisht nga paragjykimet fetare etj. që kishin, të respektohej e kaluara e popullit tonë, patriotët e vjetër. U demaskua aktiviteti i poshtër që bënин armiqtë fashistë, që futnin derra në xhami ose hidhnin kryqe dhe thoshin se këto gjëra bëhen nga komunistët.

Partia porosiste vazhdimesht partizanët për të ruaj-
tur nderin e grave. Për këtë çështje ne morëm masa të rrepta. Kështu gruaja shqiptare që ishte e myllur deri në atë kohë do të merrte pjesë në luftë dhe nuk do t'i lihej rast as propagandës armike. Me këto qëndrime ndaj nderit të gruas u krijua një psikologji e tillë në popull saqë edhe pleqtë më fanatikë i lejonin vajzat dhe nuset të shkonin në luftë me partizanët tanë ose t'i ndih-
monin ata sepse «ata janë njerëz të ndershëm» thoshin.

Shikoni se ç'hap përpara bëri gruaja te ne, në një kohë kur ajo në shumë krahina ishte akoma e mbyllur dhe e mbuluar me perçë. Kështu afro 6 000 gra dolën në mal. Të gjitha shtëpitë e fshatarëve ishin të hapura për partizanët dhe gratë i prisnin me dashuri e respekt në një kohë kur gruaja, sipas zakoneve në shumë krahina, nuk duhej t'i dilte burrit fare në sy.

Rregulla të rrepta vendosi Partia që të mos bëhej as vjedhja më e vogël, të mos i merrej popullit asnje kokërr rrush nga partizanët. Dhe këto rregulla të Partisë u zbatuan në mënyrë shembullore.

Kështu të gjitha parullat e pushtuesve dhe të reaktionit kundër Partisë Komuniste Shqiptare e në përgjithësi kundër komunizmit u demaskuan nga ndershmëria e komunistëve dhe e partizanëve ndaj grave, nga forcimi i familjes, nga trajtimi i besimtarëve etj. Pra, shembulli i mirë i komunistëve i hodhi poshtë parullat e armiqve.

E gjithë udhëheqja e Partisë sonë u krijua në luftë. Të gjithë anëtarët e Komitetit Qendror e kanë filluar punën e tyre nga partizan i thjeshtë. Sot një pjesë e tyre mbajnë akoma grada ushtarake si gjeneralë, kolonelë etj. dhe gjatë Luftës nacional-çlirimtare kanë dhënë prova të shkëlqyera trimërie. Po ky fenomen nuk u duk vetëm për anëtarët e Komitetit Qendror dhe për anëtarët e qeverisë, por edhe shumica e punonjësve të ndryshëm të organeve shtetërore, të organizatave të masave dhe të Partisë, kanë qenë partizanë. Po kështu gati edhe të gjithë udhëheqësit e Partisë në rrethe kanë qenë partizanë dhe luftëtarë të Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare me grada të ndryshme. Me një fjalë të gjithë kuadrot tanë udhëheqës kanë marrë pjesë në luftë.

Mbi përbërjen e Partisë sonë

Tani dëshiroj t'ju vë pak në dijeni mbi përbërjen e Partisë sonë. Dua të theksoj që në fillim se te ne pranimi në Parti i një personi kushtëzohej nga detyra të mëdha para tij. Në Parti pranoheshin sikurse edhe sot vetëm ata që jepnin prova të mëdha, jo me fjalë, por në praktikë, në luftë dhe kryesisht pranoheshin nga radhët e punëtorëve e të fshatarëve të varfër.

Sot Partia jonë ka mbi 50 mijë komunistë. Nga i gjithë efektivi i saj 76 pér qind janë nga shtresa e varfër, nga këta 8,8 pér qind janë me origjinë punëtore, kjo, sepse e vogël ka qenë në vendin tonë vetë klasa punëtore. 20 pér qind të efektivit janë nga shtresa të mesme dhe 3,4 pér qind nga shtresa të pasura. Këta të fundit kanë marrë pjesë aktive në luftë dhe kanë dhënë prova besnikërie duke filluar që nga partizan i thjeshtë, ata kanë kaluar nga zjarri i luftës. Rreth 23 pér qind të efektivit të Partisë tani e kemi me gjendje punëtore. Kjo ka ardhur se pas çlirimt eshtë shtuar klasa jonë punëtore; afro 31 përqind e efektivit janë me gjendje fshatarë.

Zhvillimi i shoqërisë sonë tregon rritjen e klasës punëtore dhe pakësimin relativisht të fshatarësisë. Nga komunistët me gjendje fshatarë 25 pér qind e tyre janë anëtarë të kooperativave bujqësore, 3 pér qind janë fshatarë të varfër dhe 2,4 pér qind fshatarë të mesëm. Pas çlirimt të Shqipërisë dhe sidomos pas zbatimit të reformës agrare dhe kryerjes së kolektivizimit të bujqësisë vihet re që numri i fshatarëve të varfër po zvogëlohet, ndërsa po shtohet numri i anëtarëve të kooperativave bujqësore. Kjo vjen ngaqë kolektivizimi, veç-

nërisht, u ka krijuar fshatarëve kushte më të mira ekonomike, si rrjedhim, gjendja ekonomike e fshatarësise sonë po përmirësohet çdo ditë e më shumë.

40 për qind e gjithë efektivit të Partisë janë nëpunës, në këtë shifër përfshihen edhe oficerët, të cilët gati të gjithë janë anëtarë partie; 2,1 për qind janë artizanë.

Si paraqitet niveli arësimor në Partinë tonë? 47 për qind e efektivit të Partisë sonë kanë mbaruar shkollën fillore, 26 për qind shkollën 7-vjeçare, afro 8 për qind shkollën e mesme dhe vetëm 2 për qind kanë arësim të lartë. 17 për qind e efektivit dinë vetëm të shkruajnë dhe të lexojnë. 0,3 për qind janë analfabetë. Po duhet të keni parasysh se përpala çlirimini 85 për qind e popullit tonë ishte analfabete, kurse tani analphabetizmi është zhdukur nën moshën 40 vjeç. Analfabetë në Parti kanë mbetur nga njerëzit e moshuar, që kanë luftuar e luftojnë me vendosmëri, por që e kanë të vështirë të mësojnë. Sot rreth 15 mijë anëtarë partie ndjekin shkolla të niveleve të ndryshme me korrespondencë. Në edukimin marksist-leninist përfshihen pothuaj gjithë pjesa tjeter e efektivit të Partisë. Kështu, 21 mijë komunistë ose 47 për qind e efektivit të Partisë ndjekin forma të ndryshme të arësimit të Partisë. Gati të gjithë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror kanë mbaruar shkolla të larta, disa janë bërë spezialistë për industrinë, disa për bujqësinë, ndërsa disa të tjerë që shërbejnë në ushtri kanë mbaruar akademi ushtarake, një pjesë e tyre kanë marrë arësim të lartë partie. Gati të gjithë sekretarët e parë të komiteteve të Partisë i kemi me shkollë të lartë partie. Shumicën dërmuese të sekretarëve të ko-

miteteve të Partisë i kemi gjithashtu me shkollë të lartë partie. Komiteti Qendror i Partisë sonë ka në plan që të paktën brenda 5 vjetësh të gjithë sekretarët e parë, sekretarët e tjerë të komiteteve të Partisë, inspektorët e Komitetit Qendror dhe instruktorët t'i pajisim me arësim të lartë partie.

Si forma të arësimit në Parti ne kemi në radhë të parë shkollën politike, pastaj rrrethet e studimit për historinë e Partisë sonë, për Historinë e PK (b) të BS, për historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, në mes të së cilës edhe historinë e Partisë Komuniste të Indonezisë për të cilën ne kemi marrë material nëpërmjet partive të tjera; tani që janë mundësítë presim të na japid edhe vetë shokët indonezianë. Kemi edhe rrrethe studimi si për filozofi, për ekonomi politike, për ekonomi industriale dhe bujqësore, për Statutin e Partisë etj. Përveç këtyre formave një rol të madh për edukimin e komunistëve luan Shkolla trevjeçare e Partisë «V.I. Lenin», e cila është edhe burim kuadrosh për Partinë, pushtetin dhe organizatat e masave.

Mbi luftën kundër revizionizmit

Lufta e Partisë kundër revizionizmit jugosllav ka qenë dhe është një luftë e ashpër parimore. Unë dëshiroj t'i vë në dijeni shkurtimisht shokët e KQ të PK të Indonezisë mbi këtë luftë. Revisionistët jugosllavë nuk janë të rinj. Të tillë ata kanë qenë prej kohësh. Këtë e vërteton edhe lufta e vazhdueshme e Partisë sonë kundër tyre, e cila ka filluar që nga koha e luftës dhe jo nga

1948. Më parë ne kemi qenë shokë dhë miq me të ashtu-quajturit komunistë jugosllavë, bile në fillim kemi pasur besim të madh te ata, megjithëse që gjatë luftës shumë prej pikëpamjeve të gabuara të tyre i kemi kundërshuar. Qëllimi kryesor i grupit të Titos ka qenë që Shqipëria të bëhej republikë e shtatë e Jugosllavisë. Për t'ia arritur këtij qëllimi ai ka punuar nën rrugët rru-gët antimarksiste e antileniniste.

Në fillim revisionistët jugosllavë e nisën punën kundër nesh në drejtim të Luftës sonë nacional-çlirimtare. Ata u munduan ta sabotonin atë me mënyra shumë të stërholluara. Revisionistët jugosllavë u përpoqën që Partinë tonë dhe Luftën nacional-çlirimtare të popullit tonë t'i kishin nën drejtimin e tyre të plotë dhe direkt. Këto synime ata i shfaqën disa herë e në shumë drejtime. Ata akuzonin Partinë tonë se gjoja bënte një politikë sektare ndaj elementeve tradhëtarë të «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit» etj. Qëllimi i tyre këtu ishte që ne t'u hapnim dyert e lëvizjes revolucionare këtyre tradhëtarëve. Komiteti Qendror nuk e lejoi kurrë këtë gjë dhe vija e Partisë sonë mbeti gjithmonë e pastër dhe e drejtë. Në forma të mbuluara ata u përpoqën gjithashtu që Partia jonë të mos arrinte të krijonte një ushtri të fortë partizane e me reparte të mëdha. Ata nuk e lejuan Partinë tonë që me politikën e saj të drejtë marksiste-leniniste të mobilizonte të gjithë popullsinë shqiptare që jetonte në Jugosllavi, për ta hedhur plotësisht atë në luftë kundër pushtuesve. Siç mund ta dini, në Jugosllavi ka një popullsi të madhe shqiptare, më shumë se një milion, gati sa ka Shqipëria sot, të cilët banojnë në Kosovë, në Rrafshin e Duka-

gjinit, në krahinat e Dibrës etj., toka shqiptare që kanë mbetur brenda kufive të shtetit jugosllav në bazë të vendimeve të Londrës (1913), të Traktatit të Versajës (1919) etj. Qëllimi i grupit të Titos ka qenë gjithmonë që të fuste në Republikën Federative të Jugosllavisë gjithë Shqipërinë.

Megjithëse ne atëhere i konsideronim ata shokë dhe miq, për ndërhyrjet e tyre në punët tona të brendshme sidomos për çeshtje taktike të Partisë dhe të ushtrisë sonë, kemi pasur mosmarrëveshje dhe grindje. Por nga-që nuk i njihnim, në kritikat tona jemi nisur gjithnjë nga pozita miqësie dhe shoqërie duke i quajtur këto ndërhyrje si keqkuptime ose gabime të disa njerëzve të veçantë jugosllavë. Më vonë, kur lufta jonë mori zhvillim më të madh dhe Partia jonë po kalitej çdo ditë e më shumë, ata organizuan grushte kundër Partisë sonë për ta kthyer atë në një instrument të bindur të grupit jugosllav. Për këtë qëllim ata organizuan në vitin 1944, një fraksion të rrezikshëm në udhëheqjen e Partisë, pikërisht në kohën kur Shqipëria ishte në prakun e çlirimit të plotë.

I deleguari i Titos që kishte ardhur te ne¹ organizozi fshehurazi nga Komiteti Qendror i Partisë sonë këtë fraksion nëpërmjet tradhëtarit të Partisë sonë Koçi Xoxes, atëhere sekretar organizativ i Komitetit Qendror të Partisë dhe pas çlirimit të Shqipërisë edhe ministër i punëve të brendshme. Ky komplot kundër Partisë u duk qartë në Plenumin II të Komitetit Qendror që u mblohdh në Berat, ku merrte pjesë edhe përfaqësuesi i

¹ Është fjala për Velimir Stojniçin.

udhëheqjes jugosllave. Në këtë plenum filloi haptazi sulmi i këtyre armiqve kundër gjithë vijës së Partisë, e cila e kishte çuar dhe po e çonte popullin tonë në fitore të plotë duke e quajtur këtë si një vijë jo të drejtë dhe sikur Partia jonë nuk e kishte kryer detyrën e saj historike. Armiqtë në këtë mbledhje e akuzuan udhëheqjen e Partisë si një udhëheqje oportuniste. Oportunistët na akuzonin ne për oportunizëm! Plani i tyre ishte të likuidonin gjithë udhëheqjen e Partisë, Komitetin e saj Qendror, shokët që shikoni në këtë takim dhe shokë të tjerë që nuk janë këtu. Mirëpo ata nuk arritën dot të realizonin qëllimet e tyre. Duke parë se dështuan edhe këtë radhë trockistët jugosllavë vendosën ta linin këtë plan për më vonë, kur të pregatiteshin më mirë. Pas çlirimit të Shqipërisë, nëpërmjet agjentëve të tyre filluan sulmin frontal për të likuiduar Partinë dhe shtetin tonë të demokracisë popullore, për të likuiduar të gjitha fitoret e luftës sonë. Sulmi, si zakonisht, filloi në radhë të parë, kundër Partisë nëpërmjet agjentëve të tyre. Qëllimi i tyre këtë radhë kishte avancuar edhe më tej: të likuidonin politikisht dhe fizikisht elementët e shëndoshë marksistë-leninistë të udhëheqjes së Partisë sonë. Për të realizuar këtë akuzuan shokë heroikë të Luftës sonë nacional-çlirimtare. Për të gjithë ne, anëtarët e Komitetit Qendror, u pregatitën fshehurazi akuza dhe dosje për t'i përdorur në çastin më të volitshëm për ta. Këto dosje ruheshin në Ministrinë e Punëve të Brendshme nga përfaqësuesit dhe agjentët e titistëve në Shqipëri me Koçi Xoxen në krye. Të gjitha këto dosje u zbuluan në arkivat e shtetit pas vitit 1948.

Po bëhej një politikë e tillë që roli udhëheqës i

Partisë të shuhej dhe të dilte si forcë drejtuese e luftës, e rindërtimit dhe e ndërtimit të vendit, organizata e Frontit, ashtu siç kanë bërë revisionistët jugosllavë në vendin e tyre. Dhe kjo nuk ishte e re. Që më 1942, ata thoshin se «nuk duhet të dalë në shesh roli i Partisë, po të dalë vetëm Fronti për të mos e trembur popullin!» Kështu Partia duhej të qëndronte në gjendje gjysmigale. U bënë përpjekje për të vendosur forma «të reja» për zbutjen e formave organizative të Partisë të vendosura që gjatë luftës, dhe për më tepër të vihej kontrolli i organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi Partinë. U përdorën masa terrori ndaj njerëzve të thjeshtë të popullit, për të ngjallur te ai pakënaqësi.

Në këtë mënyrë grapi i Titos u përpoq ta kthente Partinë tonë në një parti socialdemokrate dhe fashiste. Agjentët e Titos Armën e Sigurimit të Shtetit e hodhën në dorë nëpërmjet Koçi Xoxes. Prandaj filluan përpjekjet për të shtënë në dorë edhe armën tjetër të diktaturës, ushtrinë tonë. Në të ata u përpoqën të futnin metodat dhe taktilën e tyre antimarksiste dhe antisovjetike. Edhe këtu ata s'dolën pa gjë. Ata arritën deri aty sa të hiqnin nga komanda drejtuese e ushtrisë kuadro revolucionarë, shokët tanë të lavdishëm, që kishin luftuar e luftonin që ajo të kalitej, të forcohej e të organizohej në mënyrë shembullore dhe të vihej në shërbim të plotë të atdheut e të popullit të saj. Gjithashtu ata u përpoqën të demoralizonin oficerët tanë dhe qëllimi ishte i qartë: të dobësonin Ushtrinë tonë Nacional-Çlirimtare.

Me qëllim që të likuidonin edhe organet shtetërore të vendit tonë, revisionistët jugosllavë krijuan forma të

tilla organesh që në praktikë likuidonin qeverinë tonë, organet e planifikimit të shtetit tonë etj. Ata hapën kufitë tanë, unifikuan doganat dhe monedhën. Këtë ata e bënë gjoja për qëllime bashkëpunimi. Me këto masa ata preqatitnin bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Për këtë bashkim ata vepronin në të gjitha drejtimet.

Paralelisht me këto përpjekje revizionistët jugosllavë synimet e tyre i drejtuani edhe në fushën ekonomike. Qëllimi i tyre ishte që Shqipëria të dilte nga lufta e varfër, ta shkatërronin edhe ata vetë më shumë me qëllim që vendi ynë të ishte edhe nga ana ekonomike nën vartësinë e Jugosllavisë. Literalisht ata e kanë grabitur popullin tonë pas çlirimt të Shqipërisë. Ato plaçka të pakta që ne kapëm nga borgjezia e vendit në shumicën e tyre dërmuese shkuan në Jugosllavi, një pjesë e mirë e prodhimeve të pakta bujqësore shkuan gjithash tu në Jugosllavi me pretekst se gjoja edhe ata do të na ndihmonin, do të na jepnin kredi, «pasi jemi vëllezër», e plot gjëra të tjera na thoshin. Në drejtimin ekonomik qëllimi i tyre ishte që të mos ngrihej industria në vendin tonë, që Shqipëria të mbetej një vend agrar dhe i prapambetur. Dhe për këtë ata punuan sistematikisht.

Për të realizuar planet e tyre djallëzore, ata mundo-heshin të shfrytëzonin edhe incidente për provokacione në shkallë ndërkombe, që ne të frikësoheshim e të kërkonim ndihmën e tyre. Për këtë krijuan legjendën se gjoja Shqipëria po rrezikohej prej një sulmi nga ana e Greqisë dhe në bazë të traktatit që ishte nënshkruar në mes të dy vendeve ata kërkonin të futnin në Shqipëri

4 divizione jugosllave. Qëllimi ishte i qartë për ne, revisionistët jugosllavë kërkonin tani të pushtonin Shqipërinë me anën e forcave të armatosura, të likuidonin shtetin shqiptar dhe ta kthenin Shqipërinë në një republikë të shtatë jugosllave. Po Partia jonë ua shkatërrroi edhe këtë plan revisionistëve jugosllavë. Në këtë drejtim Partinë tonë e ndihmoi edhe shoku Stalin. Kur Partia jonë e njoftoi Stalinin për çka kishin kërkuar jugosllavët nga ne, J.V. Stalini u përgjegj se nuk kishte asnje rrezik në atë kohë për vendin tonë, prandaj të mos lejonim futjen e asnje divizioni jugosllav në Shqipëri.

Revisionistët jugosllavë u përpoqën gjithashtu ta izolonin Shqipërinë nga Bashkimi Sovjetik. Me të gjitha format, të fshehta dhe të hapëta, që me çlirimin e Shqipërisë, ata u përpoqën ta diskreditonin Bashkimin Sovjetik në popullin tonë. Por edhe kësaj s'ia arritën dot.

Kundër të gjitha këtyre veprimeve të revisionistëve jugosllavë ndaj vendit tonë, Partia jonë ka luftuar duke u qëndruar heroikisht të gjitha këtyre manevrave dhe komploteve.

Ne kemi edhe dokumenta të tilla, të firmosura nga udhëheqës kryesorë jugosllavë që e konsideronin Shqipërinë si një republikë të shtatë të Jugosllavisë.

Pas këtyre ngjarjeve u bë demaskimi i grupit të Titos nga Byroja Informativë. Të gjitha partitë e tjera motra dinë për revisionistët jugosllavë ato që përmendeshin në Rezolucionin e Byrosë Informativë «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave», po ne, shokë, kemi gjithë këto fakte dhe të gjitha këto që po ju themi i kemi me dokumenta. Prandaj shihet se sa i drejtë

ka qenë demaskimi i grupit të Titos nga Byroja Informative.

Pas këtij demaskimi nga ana e Byrosë Informativë revizionistët jugosllavë e vazhduan akoma më me egërsi luftën e tyre të poshtër kundër Republikës Populllore të Shqipërisë dhe Partisë sonë, bile ata e vazhduan me ashpërsi këtë luftë, pa marrë parasysh deklaratën e përbashkët sovjeto-jugosllave të vitit 1955, që u bë me rastin e vajtjes së Nikita Hrushovit në Beograd. Revizionistët jugosllavë, pa pushuar asnjëherë, që nga viti 1948 kanë hedhur dhe vazhdojnë të hedhin në vendin tonë grupe diversantësh, organizojnë në vendin tonë grupe spiunazhi dhe sabotazhi dhe legata jugosllave në Tiranë është bërë një qendër e hapët spiunazhi.

Kundër Partisë sonë ata kanë organizuar grupe agjentësh sidomos për ta minuar atë nga brenda. Pas Kongresit XX të PK të BS ata u përpoqën edhe një herë ta goditnin Partinë tonë. Por Partia jonë ka fituar një eksperiencë të madhe në luftën kundër trockistëve jugosllavë. Kështu, para se të organizohej kundërrevolucioni në Hungari, revizionistët jugosllavë organizuan të njëjtin komplot edhe kundër Partisë e popullit tonë. Por Partia jonë e zbuloi këtë para se ata ta vinin në zbatim. Komiteti Qendror i Partisë sonë demaskoi dy nga anëtarët e Komitetit Qendror që më vonë u provua se ishin agjentë jugosllavë¹. Agjentët e tyre u orvatën në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës, në prill 1956, për të komplotuar kundër Partisë sonë. po puna e tyre u zbulua, u demaskuan dhe faktet dëshmuani se

¹ Është fjala për T. Jakovën e B. Spahlun.

organizatorët ishin agjentë të revisionistëve jugosllavë.

Kur po pregatitej kundërrevolucioni në Hungari, Komiteti Qendror i Partisë sonë ishte i sigurtë se aty ishte gishti i revisionistëve jugosllavë. Komiteti Qendror i Partisë sonë e sinjalizoi Komitetin Qendror të Partisë motër të Hungarisë për të bërë kujdes, po atje punët kishin marrë një rrugë tjeter dhe u bë ajo që u bë. Udhëheqës jugosllavë, bashkëpunëtorë të ngushtë të Titos, kur po bëhej kundërrevolucioni në Hungari deklaronin se edhe në Shqipëri do të ndodhë e njëjta gjë. Po te ne ata hëngrën grushte dhe nuk ngjau e as do të ngjasë kurrë një gjë e tillë.

Edhe pas përmirësimit të marrëdhënieve, revisionistët jugosllavë ndoqën kursin e tyre të mëparshëm. Po ajo që bënë ata ishte një blof dhe Partia jonë kurrë nuk u gënjiye, kurrë nuk ka pasur besim te ata. Megjithatë bëri hapa për përmirësimin e marrëdhënieve, megjithëse ishte e sigurtë që udhëheqësit jugosllavë ishin trockistë, revisionistë, armiq të tërbuar të marksizëm-leninizmit dhe ashtu doli. Kongresi VII i LKJ ishte demaskimi i tyre. Qëndrimi i tyre u duk që në Konferencën e Moskës që u bë me rastin e 40-vjetorit të Revolucionit socialist të Tetorit, më 1957. Ne jemi të bindur qind për qind se revisionistët jugosllavë kurrë nuk do të përmirësohen dhe kurrë ne nuk mund të kemi besim ndaj armiqve të tillë të marksizëm-leninizmit, të komunizmit. Ata janë në shërbim të imperializmit amerikan, ata kanë për mision të shkatërrojnë kampin tonë socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Partia jonë mendon se çdo lëshim ndaj këtyre tradhëtarëve të marksizëm-leninizmit është një krim që i

bëhet komunizmit ndërkombe tar. Partia jonë ka mbajtur dhë do të mbajë një qëndrim marksist-leninist.

Sot uniteti i Partisë sonë është i çelniktë. Partia jonë është e pastër dhe kjo rrjedh nga Lufta nacional-çlirimtare që ajo ka bërë në krye të popullit tonë kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, nga lufta kundër fraksionistëve dhe trockistëve jugosllavë, ajo është kalitur në luftën për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Siç e shihni, Partia jonë është rritur e është kalitur në luftë me vështirësitë dhe ka arritur suksese të mëdha, por ajo nuk është dehur kurrë nga sukseset, përkundrazi, ato e kanë nxitur atë të marshojë më me guxim përpara.

Pak fjalë për zhvillimin tonë ekonomik e kultural

Tani dua t'ju them diçka edhe për zhvillimin e ekonomisë në vendin tonë. Pas çlirimt Partia jonë fillojë reformat e mëdha ekonomike. Siç dihet arkat e financave ne i gjetëm të boshatisura, bujqësinë të shkatërruar dhe shumë të prapambetur, edhe ajo pak industri që ishte u gjet e shkatërruar. Megjithkëtë populli u mobilizua jashtëzakonisht shumë për rindërtimin e vendit. Brenda dy vjetëve u rindërtuan të gjitha rrugët, urat, portet dhe shtëpitë e djegura nga lufta vetëm në saje të vullnetit të madh të popullit.

Paralelisht me punën për rindërtimin e vendit morëm edhe disa masa të rëndësishme siç ishte shtetëzimi i bankave, i tregëtisë së jashtme, konfiskuam të gjitha

tokat e bejlerëve feudalë dhe zbatuam reformën agrare që përfundoj në nëntor 1946. Për këtë qëllim krijuam në çdo fshat komitetet e fshatarëve të varfër nën udhëheqjen e komunistëve. Këto organe punuan për ndarjen e tokave fshatarëve të varfër. Borxhet që kishte populli u likuiduan. E gjithë borgjezia tregëtare që kishte nxjerrë fitime jashtëzakonisht të mëdha gjatë luftës u detyrua të paguante tatimet e luftës. Ata që i paguan nxorren floririn që kishin, ata që nuk donin të paguanin iu dhanë gjyqeve të popullit. Në gjyq shkuan gjithash tu edhe të gjithë kriminelët e luftës, kështu ata që kishin bërë kime të rënda kundër popullit në shumicën më të madhe u pushkatuan, të tjerët u futën nëpër burgje dhe tani punojnë nëpër kanale ose ndërtojnë shtëpi për punëtorët.

Pastaj shoku Enver Hoxha foli për gjendjen e industrisë, bujqësisë, arësimit e kulturës së vendit tonë në të kaluarën dhe në të tashmen si dhe për perspektivat e tyre në të ardhshmen.

Gjendja ekonomike e popullit tonë është përmirësuar shumë në krahasim me të kaluarën, vazhdoi shoku Enver. Megjithatë ne jemi akoma shumë prapa nga vendet e tjera të demokracisë popullore, sepse kemi qenë shumë të varfër dhe prandaj kemi akoma mjaft për të bërë. Por, është fakt se, nga e kaluara përmirësimi i jetesës së popullit tonë është shumë i madh dhe, ajo çka është pozitive, populli shikon perspektivën, shikon se Partia ka një vijë të drejtë, se ato që thotë dhe vendos Partia realizohen me luftë dhe me përpjekje.

Përsa i përket politikës së jashtme të Partisë sonë

ajo është e njojur. Ajo është një politikë paqësore që mbështetet në lidhje të ngushtë vëllazërore me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e demokracisë populllore, është një politikë e bashkekzistencës me të gjitha vendet e tjera. Vendi ynë po ndjek një politikë miqësore veçanërisht me vendet arabe si edhe me vende të tjera si me Indonezinë etj.

Ne kemi shumë gjëra të përbashkëta me vendin dhe me popullin tuaj ashtu sikurse kemi edhe me popujt e vendeve arabe, prandaj mund të kontribuojmë në mënyrë modeste, duke u treguar popujve të tjerë të shtypur se si një nga vendet më të vegjël të demokracisë populllore, dikur edhe ai i varfër e i shtypur dhe me populsi në shumicën dërmuese muslimane, mund të ndërtojë socializmin. Kjo ka një rëndësi të madhe për çështjen tonë të përbashkët. Tani ne po shkëmbejmë delegacione me vendet arabe, me Egjiptin, Sirinë, Jemenin, Omanin etj. Njerëz nga këto vende kanë ardhur dhe ne kemi dërguar atje. Përveç kësaj me shumë nga këto vende kemi edhe marrëdhënie diplomatike. Pastaj ne shtypim në gjuhën arabe botime siç është revista «Shqipëria e Re», kemi shkëmbyer reciprosht studentë dhe kemi në plan që marrëdhëni tona me vendet arabe t'i zgjerojmë akoma si nga ana kulturale ashtu edhe nga ana tregëtare.

Ne do të ishim shumë të gëzuar sikur edhe me popullin dhe me vendin tuaj t'i aktivizonim marrëdhëni tona miqësore. Kjo do të ishte në interes të të dy popujve tanë. Përsa u përket marrëdhënieve të Partisë sonë me Partinë tuaj ne duam me gjithë zemër t'i aktivizojmë. Ne i njohim kushtet dhe vështirësitë ma-

teriale të partisë suaj. Prandaj në dobi të zhvillimit të këtyre marrëdhënieve ne ju ftojmë të dërgoni nga partia juaj shokë në çdo kohë që të doni. Ne dëshirojmë gjithashtu që në vendin tonë të vijë edhe ndonjë delegacion nga ana e partisë, nga populli, ose edhe ndonjë delegacion parlamentar, qeveritar ose ndonjë delegacion kultural etj. Kjo do të ishte një ndihmë e madhe për Shqipërinë e vogël.

Përsa i përket shkëmbimit të literaturës midis nesh, ne do të përpinqemi që materialet e Partisë dhe të shtetit tonë t'ua dërgojmë në gjuhët frëngjisht ose anglisht. Ne dëshirojmë gjithashtu të na dërgoni edhe ju materiale të partisë suaj dhe kjo do të ishte një ndihmë për Partinë tonë, sepse eksperienca e partisë suaj është shumë e vlefshme për ne, sidiqë kushtet e të dy palëve janë shumë të ndryshme. Megjithëse ne jemi një vend i demokracisë popullore i çliruar, kushtet e jetës, format e punës dhe lufta e partisë suaj do ta ndihmojnë Partinë tonë për ta forcuar luftën tonë për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Partia jonë kurdoherë ka pasur, ka dhe do të ketë një vijë të drejtë marksiste-leniniste. Po ne në punën tonë kemi edhe të meta e dobësi, kemi vështirësi dhe gabime, por gabime parimore në Partinë tonë nuk janë vërtetuar. Të metat dhe gabimet në punë ne po i korrigojmë me guxim, në rrugën marksiste-leniniste. Ne asgjë nuk i fshehim Partisë dhe popullit nga gabimet dhe të metat, ashtu sikurse na mëson marksizëm-leninizmi dhe kjo është rruga më e drejtë. Për këtë arësy populli ynë e do shumë Partinë dhe është jastëzakonisht i lidhur me të. Ka një unitet të çelnikët në

mes të popullit dhe të Partisë sonë. Dashuria e madhe që ka populli ynë për Partinë u vërtetua edhe një herë në zgjedhjet e fundit për deputetët në Kuvendin Popullor, që u bënë në qershorin e këtij viti. Përfundimi i fushatës për këto zgjedhje ishte një fitore e shkëlqyer e politikës së drejtë të Partisë sonë. Në 780 mijë votues, për politikën e Partisë votuan 99,97 për qind e zgjedhësve dhe kundër 0,03 për qind d.m.th. 261 vetë. Zgjedhjet u bënë në mënyrë demokratike ashtu siç mund të bëhen në një vend ku drejton Partia e klasës punëtore, d.m.th. të lira, direkte, të fshehta, të barabarta dhe me votim të përgjithshëm. Politika e drejtë e Partisë, pra, ka bërë që edhe shumë njerëz të cilët më parë kanë luftuar kundër Partisë sonë tanë po i vënë gishtin kokës, sepse shohin që ajo ka një vijë të drejtë, prandaj këta njerëz po ndryshojnë mendimin.

Të dashur shokë, më falni se u zgjata me ekspozënë time, ndoshta edhe nuk munda t'ju jap sqarime për ato gjëra që do t'ju interesonin më shumë, po ne jemi në dispozicionin tuaj t'ju përgjigjemi për çdo gjë, nëse keni pyetje për të bërë, sepse e ndjejmë për detyrë komuniste që ta vëmë në dijeni Komitetin Qendror të Partisë suaj për çështjet e Partisë sonë. Ju mbajtëm kaq shumë se jeni të parët shokë indonezianë me të cilët takohemi në vendin tonë. Kur të vijnë shokë të tjerë nga partia juaj, ata do të jenë më në dijeni të çështjeve, prandaj do të kenë mundësi të futen më thellë në problemet e ndërtimit të socializmit në Shqipëri.

Do të ishte një nder dhe një gjëzim i madh për ne

sikur shoku Aidit të vinte dhe të pushonte në vendin tonë.

Ne i urojmë Partisë heroike Komuniste të Indonezisë suksese të shkëlqyera në punën e saj të lavdëshme. Ne kemi një dashuri të madhe për partinë tuaj, të dashur shokë indonezianë dhe këtë e shohim se nuk e kemi vetëm ne, po të gjitha partitë komuniste dhe punëtore. Ne ju urojmë që të korrni kurdoherë fitore deri në triumfin e plotë të politikës së partisë suaj, në realizimin e plotë të programit të partisë suaj. Ne do t'i ndjekim me shumë kujdes fitoret tuaja, sepse ato do të jenë fitore edhe të Partisë sonë, fitore të çështjes sonë të përbashkët.

Edhe një herë ju falenderoj, shokë, në emër të Komitetit tonë Qendror për ardhjen në vendin tonë dhe ju lutemi të na vini çdo vit e ta konsideroni Shqipërinë si shtëpinë tuaj. Ju lutemi njëkohësisht t'u transmetoni shokëve të Komitetit Qendror të Partisë suaj dhe shokëve kryesorë udhëheqës përshëndetjet tona shoqërore më të nxehta nga Komiteti Qendror i Partisë sonë si dhe urimet më të mira për suksese të reja në punë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të marrë me stenogram
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJEVE TË PLENUMEVE TË KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEREVE

Letër dërguar komiteteve të Partisë të rretheve

31 tetor 1958

GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEREVE

Rritja e rolit të plenumeve të komiteteve të Partisë të rretheve ka qenë dhe mbetet një nga detyrat më të rëndësishme për përmirësimin e vazhdueshëm të punës udhëheqëse të komiteteve të Partisë, të metodës së tyre të punës dhe në përgjithësi për forcimin organizativ të Partisë, për ngritjen e aftësive luftarake të organizatave të Partisë. Për këtë çështje Komiteti Qendror i Partisë ka dhënë vazhdimisht porosi.

Por, me gjithë përmirësimet e arritura, në krahasim me të kaluarën, kohët e fundit janë vënë re përsëri mjaft dobësi, lidhur me thirrjen e me zhvillimin e plenumeve të komiteteve të Partisë. Kjo tregon se nuk mbahet gjithnjë parasysh dhe nuk vlerësohet si duhet e kurdoherë rëndësia që kanë në punën e Partisë rritja

dhe forcimi i mëtejshëm i rolit të plenumeve të komitetave të Partisë. Byrotë e komitetave të Partisë dhe, në mënyrë të vegantë sekretarët, rrëmbehen nga problemet e ditës, nga problemet ekonomike dhë sidomos nga ato të bujqësisë, humbasin disa herë në to dhe nuk i kushtojnë kështu rëndësinë e duhur një çështjeje të tillë kryesore, me rëndësi të madhe parimore dhe praktike, siç është forcimi i mëtejshëm i punës kolegjiale në komitetet e Partisë, mbledhja e rregullt e plenumeve të Partisë.

Cilat janë disa nga dobësitë më të rëndësishme që vihen re në këtë drejtim?

1) Para së gjithash duhet thënë se, siç rezulton nga të dhënrat për zhvillimin e plenumeve, deri më 30 shtator 1958, shumica e komitetave të Partisë të rretheve nuk kanë thirrur në rregull, sipas afateve të caktuara në Statutin e Partisë, plenumet e tyre. Veçanërisht të pakudesshme janë treguar komitetet e Partisë: i Kombinatit të Naftës «Stalin», i rrethit të Shkodrës, i rrethit të Burrelit etj. Dhe kjo është mjaft serioze. Thirrja e rregullt e plenumeve të komitetave të Partisë është kusht i parë për rritjen e rolit të tyre udhëheqës, është një kusht i domosdoshëm i udhëheqjes kolegjiale. Në qoftë se nuk respektohet thirrja e rregullt e mbledhjeve të plenumeve të komitetave të Partisë, patjetër dobësohet seriozisht roli i tyre si organ më i lartë i Partisë në rreth.

Byrotë e komitetave të Partisë nuk marrin masa me kohë për preqatitjen e çështjeve që do të shqyrtojnë plenumet, nuk aktivizohen si duhet për këtë punë anëtarët e plenumit. Kështu ndodh shpesh dhe kjo

nuk është aspak e rregullt, që planifikohen mbledhjet e plenumit, caktohen data e thirrjes dhe çështjet që do të merren në shqyrtim dhe pastaj përsëri anulohen. Është bërë si zakon që çdo muaj shtyhen për muajin tjetër shumica e mbledhjeve të plenumeve. Komiteti i Partisë i rrëthit të Pukës, që në qershor kishte planifikuar të thërriste plenumin për të analizuar problemin mbi rritjen e prodhimtarisë së blegtorisë, por deri në fund të shtatorit nuk ka bërë gjë.

Ka mjaft raste që, krahas me shtytjen e datës për zhvillimin e mbledhjes së plenumit, ndryshon edhe çështja që do të merret në shqyrtim. Këto veprime trajognë se disa herë përcaktimi i problemeve, që do të shqyrtohen në plenum, nuk bëhet i matur dhe i studjuar. Nuk caktohen problemet më të rëndësishme që janë më preokupantet për punën e Partisë në rrëth dhe prandaj tematikat ndërrohen si pa të keq. Komiteti i Partisë i rrëthit të Lushnjës kishte vendosur që në maj të bënte mbledhjen e plenumit për problemin e korrjeve, shirjeve e grumbullimit, kurse në qershor dhe jo në maj, thirri plumin për shërbimet e bimëve prashitëse. Raste të tillë vazhdon të ketë mjaft.

2) Tematika e problemeve, që merren në shqyrtim është shpesh e njëanshme; shqyrtohen kryesisht çështje të bujqësisë e të blegtorisë. Ndërsa problemet e drejtimit të punës së Partisë, të jetës së saj të brendshme, të forcimit të punës organizative e ideologjike të Partisë që duhet të shqyrtohen në radhë të parë, zënë pak vend në krahasim me problemet e tjera të drejtimit të ekonomisë. Këtu sigurisht influencon edhe fakti i për-

mendur më lart, se që nga zgjedhjet e deri në fund të shtatorit janë thirrur pak plume.

3) Megjithëse në përgjithësi është rritur cilësia e materialeve që u paraqiten plumeve, vazhdon të mos përpunohen si duhet masat konkrete për zgjidhjen e çështjeve që diskutohen. Në shumicën e rasteve, edhe në mbledhjet e plumeve, vërejtjet dhe propozimet lidhur me projektvendimet e paraqitura janë të pakta. Një e metë e rëndësishme, që vërehet dendur, është karakteri më shumë shtetëror i raporteve që mbahen në plenum. Si rrjedhim edhe punimet e plenumit marrin një karakter të tillë dhe ndërsa për organet shtetërore përcaktohen detyra të hollësishme, puna që duhet të bëjnë organizatat e Partisë, mbetet e përgjithshme.

Në raportin që u dha në plumin e rrethit të Fierit të zhvilluar në muajin gusht për tregëtinë, nuk bëhej fjalë fare për punën e organizatave bazë të Partisë në sektorin e tregëtisë. Kjo gjë karakterizoi dhe punimet e këtij plenumi. Po kështu ishte dhe raporti mbi gjendjen e higjenës, paraqitur në muajin qershori, në plumin e rrethit të Beratit.

4) Dobësi të theksuara ka sidomos lidhur me aktivizimin e anëtarëve të plumeve. Në shumë raste ata e ndjejnë veten të tillë vetëm për atë kohë, sa zgjat mbledhja e plenumit. Anëtarët e plumeve nuk marrin pjesë gjallërisht në punën e përditshme të organit udhëheqës të Partisë. Disa herë nuk aktivizohen këta edhe për preqatitjen e vetë plumeve. Ka anëtarë plumi si p.sh. në rrethin e Vlorës e të Kolonjës, të cilët që nga zgjedhja e tyre nuk janë ngarkuar ndonjëherë me detyra konkrete.

Këto mungesa pasqyrohen qartë në pjesëmarrjen e anëtarëve të plenumeve në shqyrtimin e në zgjidhjen e problemeve në vetë mbledhjet e plenumeve. Disa anëtarë plenumi, kur marrin fjalën, jasin më tepër raporte personale, ata nuk flasin si udhëheqës të organizatës së Partisë në rreth dhe nuk marrin pjesë gjallërisht në përpunimin e masave për përmirësimin e mëtejshëm të punës së Partisë.

5) Këto mungesa dobësojnë zhvillimin e kritikës dhe të autokritikës në mbledhjet e plenumeve, sidomos të kritikës në drejtësia e byrove e të sekretarëve dhe dhënien llogari nga ana e tyre, nuk ndihmojnë në analizimin thellë të problemeve që shqyrtohen, bëjnë që të mos sillet si duhet eksperiencia e organizatave të Partisë.

6) Dobësi vërehen edhe në thirrjen dhe në zhvillimin e aktiveve të Partisë. Pak aktive thirren me vetë iniciativën e komitetet e Partisë, nuk zhvillohen ato si duhet në bazë të kritikës e të autokritikës dhe në ndonjë rast marrin më tepër karakterin e seminareve.

Dobësitë që vihen re në thirrjen dhe në zhvillimin e plenumeve të komitetet e Partisë, si dhe të aktiveve të Partisë dëmtojnë seriozisht punën e Partisë, ato influencojnë në mënyrë negative në rrjetjen e rolit drejtues të komitetet e Partisë, në ngritjen e veprimtarisë së organizatave të Partisë dhe të komunistëve, në gjithë punën për zbatimin e vendimeve të Partisë. Detyra e komitetet e Partisë është që të marrin sa më parë masa për korrigjin e tyre.

Që në fillim, menjëherë pas zgjedhjeve, të pregatitet plani i mbledhjeve të plenumeve për gjithë vitin,

i cili të shqyrtohet e të vendoset nga vetë plenumet. Në plan të parashikohen çështjet më të rëndësishme që preokupojnë Partinë në rreth, nga zgjidhja e të cilave varet shumë përmirësimi i punës së Partisë. Plani duhet të zbatohet me rigorozitet dhe mund të ndryshohet vetëm kur del ndonjë problem tjetër i rëndësishëm, që nuk ka qenë e mundur të parashikohej. Në këtë mënyrë çështjet që do të caktohen, duhet të jenë të studjuara thellë, në bazë të gjendjes dhe të nevojave të rrethit.

Plenumet duhet të marrin në shqyrtim problemet më të rëndësishme që preokupojnë Partinë në rreth, probleme që janë kyçe për mbarëvajtjen e punës së Partisë dhe që kanë të bëjnë me zgjidhjen e detyrave që i përkasin rrethit. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet analizës së çështjeve në plenum, të dalë ku janë dobësitë dhe të metat në punën e organizatave të Partisë dhe të përcaktohen mirë detyrat që u takojnë organizatave të Partisë. Të dalë në mënyrë të veçantë puna për ngritjen e rolit udhëheqës të tyre dhe roli që duhet të luajnë komunistët në mobilizimin e masave për zgjidhjen e detyrave që shtrohen. Mbledhjet e plenumeve duhet të shërbejnë njëkohësisht për dhënie llogari, si nga ana e byrove të komiteteve të Partisë, ashtu edhe nga ana e organeve shtetërore.

Me qëllim që të sigurohet pregatitja e mirë e plenumeve dhe thirrja e tyre brenda afateve të caktuara në Statutin e Partisë, që kur aprovohet plani, të ngarkohen anëtarët e plenumit, sipas rastit dhe shokë të tjera, që do të merren me studimin dhe me pregatitjen e materialeve për mbledhjet e ardhshme. Ata duhet të

bëjnë në këtë drejtim një punë sistematike. Çështja është, që jo vetëm raportet dhe masat të përpunohen sa më mirë, por që gjatë një periudhe të tërë problemi që do të merret në shqyrtim në plenum të jetë i studjuar dhe i pregetitur, duke u mbështetur edhe në vërejtjet dhe propozimet që bëjnë baza dhe punonjësit që kanë të bëjnë me problemin që do të shqyrtohet. Duke vepruar në këtë mënyrë materiali për plenumin do të jetë më i pregetitur, pse ka dalë nga konsultimi i gjerë me bazën dhe është marrë mendimi dhe vërejtjet e saja. Nga ana tjetër, një praktikë e tillë në pregetitjen e çështjeve ndihmon shumë për vënien në jetë të vendimeve, pse baza është e pregetitur që më parë mbi detyrat, që do t'i shtrojë plenumi. Po kështu duhet të veprohet edhe për pregetitjen e aktiveve të Partisë.

Eksperiencia ka treguar se jeta nxjerr edhe probleme të tjera të paparashikuara që duhet të shqyrtohen nga plenumet e komiteteve të Partisë në rrethe. Komitetet e Partisë duhet t'i pregetitin edhe këto, t'i shtojnë në rendin e ditës të plenumit si një çështje të dytë, por pa u hequr nga rendi i ditës çështja e rëndësishme, që ka qenë parashikuar në plan.

Byrotë dhe sekretarët e komiteteve të Partisë duhet të tregojnë kujdesin më të madh që, sipas çështjes, anëtarët e plenumeve jo vetëm të marrin pjesë gjallërisht në pregetitjen e raportit, por të gjithë ata të marrin pjesë gjallërisht në drejtimin e punës së Partisë në rreth. Aktivizimi i anëtarëve të plenumit nuk duhet të kufizohet vetëm duke i ngarkuar me detyra të rastit, me punim vendimesh në organizatat bazë të Partisë ose si ndodh në mjaft raste duke i aktivizuar si ndih-

mës të instruktorëve të komiteteve të Partisë. Ata, si udhëheqës të Partisë në rreth, duhet të aktivizohen në radhë të parë për çështjet kryesore dhe më të rën-dësishme të Partisë në rreth. Kështu anëtarët e plenumit do të ngrihen në lartësinë e detyrës dhe të përgjegjësisë që u ka besuar organizata e Partisë si anëtarë të organit më të lartë të Partisë në rreth. Anëtarët e plenumit nuk duhet ta ndjejnë veten si anëtarë të forumit drejtues vetëm në kohën e mbledhjeve plenare, por vazhdimisht, duke marrë pjesë në punën e përditshme të udhëheqjes.

Nuk duhet harruar se kolegjaliteti në punën e organeve të Partisë nuk qëndron vetëm në organizimin dhe në zhvillimin e plenumeve. Përkundrazi, forcimi i punës kolegiale kërkon gjithashtu që shokët përgjegjës të punës së Partisë të këshillohen kurdoherë me anëtarët e komitetit, t'u ngarkojnë në emër të komitetit detyra me përgjegjësi, t'i tërheqin ata në kontrollin e zbatimit të vendimeve, në përpunimin e çështjeve që shqyrtohen në mbledhjen e byrosë, të plenumit etj.

Anëtarët e rinj të plenumit, që nuk kanë kurdoherë eksperiencën e mjaftueshme për të kryer si duhet detyrat që u ka besuar organizata e Partisë, duhet të ndihmohen me kujdes për të fituar njohuritë dhe eksperiencën që u duhet dhe t'i kushtohet kujdes i vëçantë punës për edukimin e për ngritjen e nivelit të tyre.

Byrotë e komiteteve të Partisë duhet të ndjekin përparimin e anëtarëve të plenumit në format e arësimit të Partisë dhe në shkollat, të ndihmohen duke marrë pjesë në seminare dhe të punohen me ta tema të vëçanta, të organizohet puna që ata të vijnë në komi-

tetet e Partisë dhe të studjojnë vendime e materiale të ndryshme nga të cilat do të përfitojnë, do të njihen me jetën dhe me problemet e Partisë.

Thirrja e rregullt e mbledhjeve të plenumeve, zhvillimi i tyre në një nivel të lartë, në bazë të kritikës e të autokritikës dhe rritja e veprimtarisë dhe e rolit të anëtarëve të plenumeve, krijon mundësi që të arrihen rezultate më të mira në punën e Partisë, në zbatimin e vendimeve të saj, që të përmirësohet udhëheqja ejeta e brendshme e organizatave të Partisë, që të zgjidhen më mirë problemet e rrithit apo të qytetit dhe të afrohen akoma më tepër komitetet me organizatat bazë të Partisë.

Komiteti Qendror porosít edhe një herë byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve dhe të qyteteve, që t'u kushtohet kujdes i veçantë jo vetëm mbledhjeve të rregullta të plenumeve, ashtu si përcaktohet në Statutin e Partisë, por që në këto mbledhje të shqyrtohen problemet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me jetën e brendshme të Partisë, me ngritjen e nivelit ideologjik, si dhe çështje të tjera ekonomike dhe kulturale që preokupojnë Partinë në rreth.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**MBI MASAT QË DUHEN MARRË PËR SHTIMIN
ME RITËM MË TË SHPEJTE TË PRODHIMIT
TË MISHIT DHE TË QUMSHTIT**

Raport i mbajtur në Plenumin XI të KQ të PPSH

3 nëntor 1958

Shokë,

Byroja Politike i paraqit për shqyrtim këtij plenumi gjendjen e prodhimit të mishit e të qumshtit dhe masat që duhen marrë në të ardhshmen për të shtuar këto prodhime me ritëm më të shpejtë. Dihet mirë se mishi dhe qumshti janë nga prodhimet më të rëndësishme për ushqimin e popullit, prandaj shtimi i prodhimit të mishit dhe të qumshtit është i lidhur direkt me realizimin e qëllimit më të lartë të Partisë sonë, përmirësimin e vazhdueshëm të nivelistës së masave tona punonjëse.

Kongresi III i Partisë, i mbështetur në mësimet e marksizëm-leninizmit dhe në eksperiencën e ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik, caktoi detyra të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të të gjithë ekono-

misë sonë populllore, si dhe për përmirësimin e gjendjes materiale dhe kulturale të masave punonjëse të vendit tonë.

Për zbatimin e detyrate që shtroi Kongresi III i Partisë, Komiteti Qendror, gjatë viteve të fundit, ka marrë një sërë masash të rëndësishme, të cilat kanë influencuar shumë për zgjidhjen me sukses të detyrate të shtruara. Në këtë drejtim, për t'u përmendur janë sidomos vendimet e Plenumit të Shkurtit të vitit 1957 për zhvillimin e pambukut, për përmirësimin e racës së dhene dhe për shtimin e agrumeve; vendimi i Plenumit të Korrikut të vitit 1957 mbi kuadrin dhe ai mbi tregëtinë, si dhe vendimi i Plenumit të Shkurtit të vitit 1958 mbi shtesat në planin e dytë pesëvjeçar.

Në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë marksiste-leniniste, të punës vetëmohuese të masave punonjëse dhe të ndihmës së Bashkimit Sovjetik në radhë të parë, si dhe të ndihmës së vendeve të demokracisë populllore, vendi ynë ka bërë hapa të mëdhënëj përpëra në rrugën e ndërtimit të socializmit. Qëndrimi parimor dhe i vendosur i Partisë sonë në mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, kujdesi i veçantë që tregoi ajo për përmirësimin sa më të shpejtë të jetës së masave punonjëse, lidhjet e saja të ngushta me masat, kanë bërë që të dështojnë me turp të gjitha shpresat dhe orvatjet e armiqve të popullit tonë, të imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre, sidomos të revolucionistëve jugosllavë, për të penguar ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Gjatë këtyre 3 vjetëve janë arritur përfundime të mira në realizimin e detyrate të planit të dytë posë-

vjeçar. Në krahasim me vitin 1955, prodhimi industrial në vitin 1957 është rritur 36,6 për qind më shumë dhe sipas realizimit të pritshëm në vitin 1958 do të jetë 60,6 për qind. Në këtë mënyrë, në krahasim me vitin 1938, vlera e prodhimit të përgjithshëm të industrisë do të jetë rrreth 17 herë më e madhe. Po kështu gjatë 9 muajve të vitit 1958, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, prodhimi i kromit u rrit 19 për qind, energjia elektrike — 21 për qind, çimentua — 7 për qind, bakri — 40 për qind, tekstilet e pambukta — 17 për qind etj.

Një fitore e madhe për Partinë dhe për popullin tonë qe heqja e plotë e sistemit të triskëtimit, masë që u realizua para afatit të caktuar nga Kongresi III i Partisë dhe që ndikoi shumë në ngritjen e nivelit të jetesës së punonjësve. Gjatë këtij viti u bë edhe një ulje tjetër e çmimeve të mallrave të konsumit të gjerë, në masën 1 miliard e 300 milion lekë. Si rezultat i mësive të marrura nga Partia dhe nga qeveria, paga reale e punëtorëve dhe e nepunësve, në vitin 1957 në krahasim me vitin 1955 është ngritur 8,4 për qind.

Në bazë të detyrate që shtroi Kongresi III i Partisë një punë e madhe është bërë për ngritjen e shpejtë të bujqësisë. Suksese shumë të mëdha janë arritur në rrugën e transformimit socialist të fshatit. Nga më pak se 700 kooperativa bujqësore që kishim në kohën e Kongresit III të Partisë, sot numri i tyre ka arritur në 1935, që përfshin 62,6 për qind të ekonomive dhe 74,9 për qind të sipërfaqes së tokës arë që disponon fshatarësia. Në 7 rrethe kolektivizimi në përgjithësi ka përfunduar dhe janë të gjitha kushtet që deri në fund të

vitit 1958 kolektivizimi të përfundojë në të gjithë zonën fushore të Republikës. Sivjet, rreth 89 për qind e pambukut, 92 për qind e pambukut, 92 pér qind e duhanit u mbollën në sektorin socialist të bujqësisë.

Mbjelljet e pranverës të këtij viti, me gjithë kushtet e vështira atmosferike, në saje të mobilizimit të punonjësve të fshatit, të zhvillimit të kolektivizimit të bujqësisë dhe të shtimit të traktorëve dhe maqinave bujqësore, u kryen brenda një kohe shumë të shkurtër. Një punë shumë e madhe po bëhet pér përmirësimin e racës së dhenve me anë të ndërzimit artificial. Me kënaqësi vëmë në dijeni plenumin se detyra që shtroi Plenumi i Shkurtit i vitit 1958 pér ndërzimin artificial të 550 000 krerëve dhen në vitin 1958 u realizua dhe, në saje të punës së mirë të Partisë, të besimit të patundur të kooperativistëve dhe të fshatarësë punonjëse ndaj direktivave të Partisë, të punës së mirë të teknikëve dhe të specialistëve, këtë vit u ndërzyen artificialisht 682 400 krerë dhen. Një punë e mirë është bërë pér shtimin numerik të lopëve në kooperativat bujqësore.

Sic dihet, vitin e kaluar u mbollën afro 10 herë më shumë pemë frutore se sa plani vjetor dhe ullinj u mbollën aq sa u mbollën gjatë gjithë planit të parë pesëvjeçar. Zhvillimi i frutikulturës me ritme të shpejta vazhdoi edhe gjatë pranverës së vitit 1958: nga 3,6 milion pemë frutore që është plani vjetor, u mbollën deri tani më se 4,1 milion rrënëjë, ullinj 656 mijë rrënëjë, baras me 86 pér qind të planit vjetor, pjergulla 4,9 milion, baras me 75 pér qind të planit vjetor dhe vreshtra 2 200 ha., baras me 55 pér qind të planit vjetor. Gjatë vjeshtës, duke vazhduar mëjelljet e pemëve fru-

tore, me atë ritëm që u punua në pranverë, plani vjetor do të realizohet dhe do të tejkalohet me sukses. Por, duhet treguar më shumë kujdes për cilësinë e mbjelljeve dhe për ruajtjen e bimëve të mbjella.

Edhe gjatë vitit 1958 po bëhet një punë e madhe për hapjen e tokave të reja. Deri në fund të muajit shtator ishin hapur gjithsejt 13 090 hektarë, baras me 59 pëqind të planit vjetor. Këtu nuk përfshihen sipërfaqet e hapura për vreshta dhe për pemë frutore.

Puna e madhe që bëri Partia jonë gjatë vitit 1957 dhe ndihma e Bashkimit Sovjetik kanë hapur perspektiva për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë së vendit tonë me ritme më të shpejta. Lidhur me këto, Plenumi i Shkurtit i vitit 1958 mori vendimet përkatëse, të cilat tashmë njihen prej të gjithëve. Në të gjitha anët e vendit tonë po punohet me vrull për t'i vënë në jetë këto detyra të rëndësishme të Partisë.

Me gjithë sukseset e arritura në zbatimin e direktivave të Kongresit III të Partisë, është e nevojshme të theksohet se ka akoma rezerva të mëdha të pashfrytëzuara në të gjithë sektorët dhe sidomos në sektorin e bujqësisë për zbulimin dhe për shfrytëzimin e të cilave duhet bërë një punë e vazhdueshme nga të gjithë. Në bazë të vendimeve të Kongresit III të Partisë, është punuar me kujdes për sigurimin e bukës në vend me anën e zgjerimit të sipërfaqeve të mbjella dhe për ngritjen e ndjeshme të rendimenteve. Në rrugën e zgjidhjes është vënë edhe problemi i lëndës së parë për industrinë e lehtë, siç është p.sh. pambuku, duhani dhe leshi i përmirësuar i dheneve.

Siq shihet, shumë probleme të rëndësishme që kanë

të bëjnë me zhvillimin e shpejtë të ekonomisë dhe me ngritjen e nivelit material e kultural të punonjësve janë duke u zgjidhur në mënyrë të kënaqshme, ndërsa problemi i mishit, i qumshtit dhe i yndyrnave akoma nuk është vënë në rrugën e zgjidhjes. Prodhimi i mishit, i qumshtit dhe i yndyrnave është shumë i ngadalshëm, saqë nuk mund të krahasohet me ritmet e shtimit vjetor të shumë lloj prodhimeve bujqësore dhe nuk i përgjigjet as ritmit të shtimit vjetor të popullsisë. Duke e shikuar gjendjen kështu, Byroja Politike, në bazë të porosisë së Komitetit Qendror, së bashku me organet shtetërore përkatëse, duke marrë mendimet dhe sugjerimet e organizatave të Partisë dhe të masave, ka studjuar në mënyrë të gjithanshme këtë problem të rëndësishëm dhe po i paraqit plenumit këtë raport për shqyrtim.

I

SI PARAQITET GJENDJA E PRODIIMIT DHE E KONSUMIT TË MISHIT DHE TË QUMSHTIT

Krahas çështjeve të tjera, Partia ka treguar kujdes të vazhdueshëm për zhvillimin e blegtorisë dhe për shtimin e prodhimeve blegtorale, për të plotësuar më mirë nevojat e masave punonjëse me mish, qumësht dhe yndyrna.

Vendi ynë, megjithëse në krahasim me popullatën

ka mjaft blegtori, ka trashëguar nga e kaluara një blegtori të prapambetur, me një rendiment shumë të ulët në mish, qumësht dhe lesh. Përveç kësaj, blegtoria ka pasur një dëm të madh gjatë luftës. Kështu që Partisë, pas çlirimit, iu desh të merrte masa, jo vetëm për përmirësimin dhe për transformimin e blegtorisë në baza socialiste, për përmirësimin e racës së blegtorisë dhe për ngritjen e prodhimit tarisë së saj, por edhe për plotësimin e numrit të gjësë së gjallë të dëmtuar nga lufta dhe për të siguruar një rritje të mëtejshme, sidomos për disa lloje kafshësh, ku gjendja ka qenë shumë e pakënaqshme.

Në krahasim me paraluftën, blegtoria jonë, jo vetëm që ka arritur t'i zëvendësojë dëmet, por në disa lloje kafshësh ka shënuar edhe rritje. Kështu p.sh. në krahasim me vitin 1938, në vitin 1957 numri i gjedheve është rritur 3,6 për qind më shumë, i dhene — 2,4 për qind, i dhive — 10,4 për qind, i shpendëve — 15,8 për qind dhe numri i dosave — rrëth 135,7 për qind më shumë. Kjo rritje në kërçë, si dhe përmirësimi i kushteve të blegtorisë në krahasim me të kaluarën, rritja e pjellshmërisë dhe e peshës së bagëtisë, pakësimi i humbjeve, luftimi i sëmundjeve etj., kanë ndikuar në shtimin e prodhimeve blegtoriale.

Në krahasim me vitin 1938, në vitin 1957, prodhimi i mishit është rritur nga 27 400 ton, në 33 600 ton peshë e gjallë ose 23 për qind më shumë se në vitin 1938. Këtu ndikon sidomos rritja e prodhimit të mishit të derrit dhe të gjedhit.

Të njëjtat gjëra duhen thënë edhe për qumshtin. Në vitin 1938 është prodhuar 128 770 ton qumësht,

ndërsa më 1957 u prodhuan 160 500 ton, ose 25 për qind më shumë se në vitin 1938. Në krahasim me rritjen e sektorëve të tjerë të ekonomisë sonë popullore dhe të nevojave të popullsisë për mish, si rritja e numrit të gjësë së gjallë ashtu edhe rritja e prodhimit të mishit dhe të qumshtit është përgjithësisht e ngadalshme. Rritja e prodhimit të mishit dhe të qumshtit është në fakt më e vogël se sa rritja e popullsisë së vendit, e cila në vitin 1957 është rritur 40,5 për qind më shumë se në vitin 1938.

Por shifrat e prodhimit të qumshtit e të mishit dhe të konsumit mesatar për frymë që i referohen viti 1938 dhe viteve të mëvonshme nuk janë të krahasueshme plotësisht, sepse, siç dihet në vitin 1938 është eksportuar një sasi mishi dhe djathi. Përveç kësaj, dihet se konsumi i atëhershëm nuk ishte shpërndarë në mënyrë të drejtë midis grupeve të ndryshme të popullsisë. Nga ana tjetër, dihet se gjatë viteve pas çlirimtës së përfunduar të rritur fuqia blerëse e masave punonjëse, kështu që mjetet e tyre financiare janë drejtuar më shumë në mallrat ushqimore të konsumit të gjerë, që kanë pasur një rritje më të madhe se prodhimi i mishit dhe i qumshtit.

Në krahasim me disa vende të demokracisë popullore, konsumi i mishit për frymë në vendin tonë është akoma i ulët.

Përsa i përket konsumit të qumshtit për fryshtë, megjithëse diferenca është më e vogël në krahasim me disa nga vendet e demokracisë popullore, prapëseprapë disa të tjera janë shumë më përparrë...

Sipas studimeve të bëra njeriu ka nevojë mesata-

risht për rrëth 280 kg. qumësht e prodhime qumshti dhe për 60,9 kg. mish dhe prodhime mishi në vit, nga të cilat rrëth 33 për qind mund të jenë mish derri. Sigurisht që këto norma fiziologjike nuk mund të merrin në mënyrë të barabartë për të gjitha vendet, sepse ato varen shumë edhe nga struktura e ushqimeve të tjera që përdoren, nga kushtet klimatike etj. Sido-qoftë të dhënat e mësipërme tregojnë se ne jemi shumë prapa dhe se duhet ta shpejtojmë shumë shtimin e prodhimit të qumshtit dhe sidomos të mishit.

Nuk ka dyshim se te ne mundësitë për shtimin e mishit dhe të qumshtit janë të mëdha dhe Partia duhet të punojë me të gjitha forcat që punonjësit e blegtorisë, t'i kuptojnë mirë detyrat që u dalin, të njohin mirë rezervat dhe mundësitë e t'i shfrytëzojnë ato si duhet.

Në të gjitha llogaritjet e mësipërme nuk përfshihet konsumi i peshkut. Në vitin 1957 janë zënë 2 740 ton peshk. Kjo sasi përfaqëson 8,1 për qind në krahësim me sasinë e prodhimit të mishit. Nga këto të dhëna del jo vetëm se sasia e mishit, e peshkut dhe e qumshtit që prodhohet në vit është e pamjaftueshme, por edhe se furnizimi i popullit nuk është i rregullt në çdo stinë. Detyra jonë është që të marrim masa urgjente për shtimin e prodhimit të mishit e të qumshtit dhe t'u sigurojmë një furnizim të pandërprerë masave punonjëse të qyteteve me mish dhe me qumësht.

Sot, furnizimi i popullsisë së qyteteve me mish bëhet kryesisht nga fondet e siguruara në formën e grumbullimit të detyrueshëm, të blerjes së tepricave dhe të dorëzimit nga fermat shtetërore. Sasia vjetore e mishit të grumbulluar nuk ka ndonjë rritje të dukshme.

Në vitin 1955 sasia e mishit të grumbulluar nga detyrimet, nga blerja e tepricave dhe nga sektori shtetëror ishte 18 335 ton, në vitin 1957 — 19 430 ton dhe në vitin 1958, realizimi i pritshëm, do të jetë 18 000 ton, d.m.th. 4 100 ton më pak nga sa parashikon plani i këtij viti.

Sikurse shihet grumbullimi i mishit, sipas realizimit të pritshëm, këtë vit do të jetë gati në po atë nivel që ishte 3 vjet më parë, ndërsa popullsia çdo vit shtohet dhe kërkesat bëhen vazhdimisht më të mëdha. Kuptohet se grumbullimi i mishit duhej të kishte qenë shumë më i madh nga shtimi i popullsisë. Kjo nuk ka ndodhur, jo vetëm sepse nuk është realizuar plani i blerjes së tepricave, por, para së gjithash, sepse vetë prodhimi i mishit si Republikë nuk është shtuar.

Problemi më i vështirë për furnizimin e qyteteve me mish është periudha dhjetor-mars, kur burimet janë më të kufizuara dhe nevojat më të mëdha. Në këtë drejtim, një farë përmirësimi është arritur vetëm në saje të rritjes, në këto vitet e fundit, të prodhimit të mishit të derrit nga sektori shtetëror. Mishi i derrit, jo vetëm ka ndihmuar për të plotësuar nevojat e popullsisë së qyteteve me mish, por ka ndihmuar edhe në kufizimin deri në një farë mase të rritjes së konsumit të yndyrnave, pse pa furnizimin me mish derri do të duhej të importoheshin çdo vit rrëth 400 ton yndyrna më shumë.

E vështirë paraqitet gjendja edhe në furnizimin e qyteteve me qumësht. Shkaku i kësaj gjendjeje është sepse sot baza e prodhimit të qumshtit në vendin tonë është delja dhe dhia, ndërsa lopa, nga e cila merret qu-mësht pothuajse gjithë vitin, ka qenë shumë e kufizuar në numër dhe pak kujdes është treguar për mirëmbaj-

tjen e saj. Nga ana tjetër, pjesa dërmuese e blegtorisë ka qenë rritur në ekonomitë individuale, gjë që e bënte të vështirë tregëtimin e qumshtit.

Për të rritur në mënyrë të ndjeshme prodhimin e mishit dhe të qumshtit me ritme më të shpejta, me iniciativën e Komitetit Qendror u mblohdhën gjatë muajit gusht plenumi dhe konsulta të posaçme nga të gjitha komitetet e Partisë të rretheve. Gjatë kësaj kohe u bë një punë shumë e mirë, sepse u aktivizuan të gjithë kuadrot kryesorë të rretheve, të ndërmarrjeve, të koooperativave bujqësore dhe bashkë me organizatat e Partisë kanë bërë vërejtje dhe sugjerime për shtimin e prodhimit të qumshtit dhe të mishit. Në bazë të studimit që u bë në qendër, duke pasur parasysh edhe propozimet e bëra nga rrethet, del se në krahasim me planin e vitit 1960, prodhimi i mishit në vitin 1965 mund të rritet 40 për qind dhe ai i qumshtit 61 për qind.

Në vitin 1965, në krahasim me vitin 1957, prodhimi i mishit të derrit rritet 6 herë, ai i shpendëve — 3,8 herë, i kafshëve të imta — 93 për qind dhe i gjedheve dhe buajve — 51 për qind. Prodhimi i qumshtit dhe i mishit, i krahasuar me vitin 1957 rritet gjithsejt përkatesisht 139 për qind dhe 133 për qind.

Në bazë të të dhënave të mësipërme llogaritet se në vitin 1965 konsumi i mishit dhe sidomos i qumshtit përfrymë ka një rritje të mirë në krahasim me vitin 1957...

Për të siguruar prodhimin e mishit dhe të qumshtit që parashikohet përfit 1960 dhe 1965 është e domosdoshme të merren masa:

a) përshtimin numerik të krerëve të gjësë së gjallë;

b) për përmirësimin e strukturës së kopesë, duke rritur përqindjen e pëllejave në të gjitha llojet e gjësë së gjallë, sidomos në gjedhe, dhen dhe dhi;

c) për shtimin e prodhueshmërisë së gjësë së gjallë për çdo kokë dhe për çdo 100 ha. tokë bujqësore.

A ka mundësi që të shtohet numri i krerëve të gjësë së gjallë mbi gjendjen që parashikon plani i dytë pesë-vjeçar? Në bazë të studimeve të bëra në qendër, të konsultimeve dhe sugjerimeve të bazës, del se ka mundësi që në vitin 1965, në krahasim me gjendjen e vitit 1957, numri i krerëve të shtohet në këtë mënyrë: në gjedhe 23,3 për qind, në të leshta 28,4 për qind, në të dhirta 45,7 për qind, në shpendë 274,5 për qind, ndërsa në dosa 183,3 për qind.

Një rritje e tillë e blegtorisë, dhe në mënyrë të vëçantë e shtimit të krerëve pëlleja, përmirëson në mënyrë të dukshme strukturën e blegtorisë që do të ndikojë në rritjen e prodhimit të mishit dhe të qumshtit.

Krahas kujdesit që duhet të tregohet për shtimin e krerëve të gjësë së gjallë dhe për përmirësimin e strukturës së saj, duhet të përqëndrojmë vëmendjen edhe në shtimin e prodhimit të mishit nga çdo kokë bagëti, duke rritur peshën e tyre, në shtimin e prodhimit të qumshtit nga bagëtitë pëlleja, si dhe në shtimin e prodhimit të mishit dhe të qumshtit për çdo 100 ha. tokë bujqësore.

Duhet thënë se ka rezerva të mëdha për shtimin e prodhimit të mishit dhe të qumshtit. Shtimi në peshë për çdo kokë bagëti, shtimi i prodhimit të qumshtit, sidomos për çdo lopë dhe shtimi i mishit e i qumshtit për çdo 100 ha. tokë bujqësore, janë nga detyrat kryesore ku duhet të luftohet me këmbëngulje.

Në vitin 1957 u prodhuan për çdo 100 ha. tokë bujqësore 26,4 kv. mish peshë e gjallë dhe 125,9 kv. quqmësht. Ky prodhim është shumë i ulët, gjë që tregon se toka nuk është ngarkuar plotësisht me kërret e bagëtisë së nevojshme, se toka nuk shfrytëzohet si duhet për t'i siguruar ushqime të bollshme blegtorisë dhe se prodhueshmëria për çdo kokë bagëti është e ulët. Në qoftë se do të tregohet kujdesi i duhur për rritjen e numrit të gjësë së gjallë, për përmirësimin e strukturës së pëllejave dhe për mbajtjen e bagëtisë së nevojshme -dhe të mundshme për çdo 100 ha. tokë bujqësore, duke i vënë rëndësi të veçantë përmirësimit të kushteve ushqimore dhe të jetesës së blegtorisë, ka mundësi që në vitin 1960 të merren 42,5 kv. mish dhe 181,4 kv. quqmësht për 100 ha. dhe në vitin 1965 të rritet prodhimi për 100 ha. tokë bujqësore në mish 57,5 kv. dhe në quqmësht 281,8 kv.

Një rritje e tillë e prodhimit është plotësisht e mundshme dhe e realizueshme. Duhet thënë se edhe rritja e prodhimit të mishit dhe të qumshtit për çdo 100 ha. tokë bujqësore që parashikohet të arrihet në vitin 1965 është shumë e ulët, po të krahasohet me prodhimin për çdo 100 ha. tokë bujqësore që marrin disa vende të demokracisë populllore.

Këtej del akoma më e qartë se detyrat që do të dalin nga ky Plenum i Komitetit Qendror për shtimin e mishit dhe të qumshtit duhet të realizohen patjetër -dhe të luftohet për të siguruar një prodhim akoma më të madh.

II

**MASAT QE DUHEN MARRE PER TE SHTUAR ME RITME
ME TE SHPEJTA PRODHIMIN E MISHIT**

*Burimi kryesor i shtimit të prodhimit të mishit
është shtimi i krerëve të gjitha llojeve të gjësë së
gjallë. Ekzistojnë të gjitha mundësitë që të shtohet aks-
oma numri i krerëve për të gjitha kategoritë e blegto-
risë. Fakti që bujqësia jonë vjen nga dita në ditë duke
u intensifikuar, krijon mundësi të mëdha për shtimin
e një baze ushqimore të shëndoshë dhe të qëndrueshme
për blegtorinë. Përmirësimi i gjendjes ekonomike të
masave punonjëse të fshatit dhe veçanërisht i gjendjes
së fshatarësisë së kolektivizuar, zgjerimi i kolekti-
vizimit dhe forcimi ekonomiko-organizativ i koo-
perativave, zhvillimi i harmonishëm i të gjitha de-
gëve të ekonomisë bujqësore, shpërndarja më e drejtë
e gjësë së gjallë midis sektorëve të ekonomisë dhe rre-
theve të ndryshme, të gjithë këta faktorë, si dhe masat
e tjera që janë marrë dhe po merren për përmirësimin
e kushteve të ushqimit dhe të jetesës së blegtorisë,
krijojnë mundësi për shtimin e mëtejshëm të krerëve
të gjësë së gjallë. Po të shohim me kujdes se si është
shpërndarë blegtoria në rreth dhe po të studjohen me
kujdes si janë zhvilluar degët e ekonomisë bujqësore,
del qartë se çfarë mundësi të mëdha ka për shtimin
numerik të gjësë së gjallë.*

Duke i kthyer të gjitha llojet e kafshëve në gjedhe

(sipas koeficienteve të caktuara për këtë qëllim) del se ish-qarqet Gjirokastër, Shkodër, Korçë dhe Elbasan, mbajnë sasinë më të madhe të kafshëve të Republikës, kurse midis rretheve vendin e parë e zënë rrethi i Fierit, i Vlorës, i Peshkopisë e pastaj me radhë Durrësi, Kukësi dhe Lushnja. Më pak kafshë të shprehura në njësi-gjedhi mbajnë rrethet: Tropojë, Skrapar, Krujë, Berat etj.

Ngarkesa në njësi-gjedhi për çdo 100 ha. tokë bujqësore (pa pyjet), për vitin 1956, sipas qarqeve dhe rretheve paraqitet më c madhe në rrethin e Peshkopisë, të Krujës dhe në ish-qarkun e Shkodrës, ku respektivisht ka pasur 124,115 dhe 104 krerë njësi; pastaj vijnë rrethet: Fier e Mat me afro 93 krerë njësi; në radhë të tretë vijnë rrethet: Berat, Durrës, Lushnjë, ish-qarku i Elbasanit, i Gjirokastrës dhe i Korçës me 74-88 krerë njësi e kështu me radhë. Ngarkesën më të vogël për 100 ha. e kanë Tropoja dhe Vlora me 64-66 krerë njësi.

Mbi rezervat e mëdha që kanë rrethet për shtimin e gjësë së gjallë tregojnë qartë edhe të dhënat e regjistrimit të vitit 1957 mbi numrin e krerëve për çdo 100 hektarë tokë bujqësore. Si Republikë, për çdo 100 ha. tokë bujqësore, kemi pasur vetëm 9,2 krerë lopë, nga të cilat 4,7 krerë në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe vetëm 1,1 kokë në kooperativat bujqësore si pasuri kolektive. Siç del nga regjistrimi rreth 94,2 për qind të të gjitha lopëve të Republikës janë në sektorin privat, d.m.th. pronë personale e anëtarëve të kooperativave bujqësore dhe e ekonomive individuale. Kjo gjendje tregon se kooperativat bujqësore kanë mundësi të mëdha ushqimore që ta shtojnë shumë numrin e lopëve për 100 ha. tokë. Duhet të luftohet që

shumica dërmuese e lopëve të rritet në kooperativat bujqësore dhe në ndërmarrjet bujqësore shtetërore. Këta sektorë duhet të zënë vendin kryesor në Republikë në mesataren për 100 ha. tokë bujqësore. Midis ish-qarqeve ose rrëtheve ka një ndryshim të madh në numrin e lopëve për 100 ha. tokë bujqësore. Kështu p.sh. ish-qarku i Shkodrës ka pasur 13,6 krerë lopë për çdo 100 ha. tokë bujqësore, Durrësi — 11,9 dhe Kruja — 13,3 krerë; ndërsa ish-qarku i Elbasanit kishte 6,8, ai i Gjirokastrës — 5,6, rrëthi i Beratit — 6,9, rrëthi i Vlorës — 3,5, Tirana — 7,5 krerë etj. Nga këto të dhëna duket qartë se çfarë rezervash ka akoma për shtimin e krerëve të lopëve, sidomos në ato rrëthe që kanë shumë pak krerë për 100 ha., pra edhe për shtimin e prodhimit të mishit e të qumshtit. Ndryshime të dukshme ka midis rrëtheve edhe përsha u përket kafshëve të tjera. Por ndryshimet më të mëdha janë sidomos në numrin e dosave për 100 ha. tokë. Kështu, ndërsa Shkodra ka pasur 9,9 krerë, Gjirokastra ka pasur 6,1, Lushnja dhe Fieri kanë pasur nga 5,2, Korça — 4,4 krerë etj. Rrethet e tjera kanë pasur shumë më pak (Mati 1,4, Tirana 3, Peshkopja 2,2, Berati 1,7, Elbasani 1,6 etj.).

1) Shtimi numërik i gjedhit dhe rritja e prodhueshmërisë së tij përbëjnë një rezervë të madhe për shtimin e prodhimit të mishit, qumsllitit dhe të yndyrnave. Prandaj duhet t'i kushtohet kujdes më i madh shtimit të numrit të gjedhit dhe sidomos të lopëve.

Partia ka bërë një punë të madhe gjatë vitit 1958 për krijimin e fermave të lopëve në mjaft kooperativa

bujqësore, si dhe për përmirësimin e kushteve të strehimit dhe të ushqimit të tyre. Por duhet thënë se kujdesi për gjedhin dhe në mënyrë të veçantë për lopën, që është një bazë me rëndësi për shtimin e krerëve dhe për shtimin e prodhimeve të mishit dhe të qumshtit, është akoma i pamjaftueshëm.

Sikurse tregojnë shifrat që u përmendën më lart, përveç masave të tjera që duhen marrë për shtimin e gjedhit në sektorin kooperativist, i cili duhet të mbajë epërsinë mbi të gjithë sektorët e ekonomive bujqësore, duhet të ndryshojë edhe struktura e gjedhit, duke e rritur numrin e lopëve pëlleja.

Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit në rrëthe dhe në bazë duhet të vazhdojnë të punojnë me oborret e kooperativistëve që gjedhet e tepërtë që kanë, t'ua shesin kooperativave bujqësore. Njëkohësisht viçat femra, që shtohen çdo vit në oborret e kooperativistëve, janë një burim i madh për krijimin, brenda një kohe të shkurtër, të fermave të lopëve në kooperativat bujqësore.

Interesi i ekonomisë popullore kërkon, në radhë të parë, të krijojen fermat e lopëve në kooperativat bujqësore, qoftë edhe duke blerë nga krerët që kanë oborret kooperativiste, sepse krijimi i fermave të lopëve në kooperativat bujqësore, jo vetëm do të përbëjë bazën për shtimin e shpejtë të gjedhit në të gjithë Republikën, por do të lehtësojë së tepërmzi zbatimin brenda një kohe më të shkurtër të detyrës së madhe që shtron Partia për shtimin e prodhimit të mishit dhe të qumshtit.

Krijimi i fermave të lopëve në kooperativat bujqë-

sore bën nga ana tjetër të mundur që kujdesi dhe ndihma zooveterinare, që tregon shteti për gjedhin, të jetë e efektshme, të mënjanohen sëmundjet në gjedhe, të rritet përqindja e pjellshmërisë dhe të ecet me hapa më të shpejtë në përmirësimin e racës. Duhet të zbatohet me përpikëri orientimi që ka dhënë Komiteti Qendror për të mos therur gjedhet femra që kanë vlerë zooteknike. Të gjitha gjedhet femra, që blihen nga organet e grumbullimit, të ruhen dhe t'u jepen kooperativave bujqësore me të holla në dorë ose me kredit agrar. Kjo masë është një burim tjetër për shtimin e numrit të lopëve dhe të gjedheve në përgjithësi në kooperativat bujqësore. Kooperativat bujqësore të zonave fushore duhet t'i bëjnë llogaritë mirë mbi leverdinë që u sjell lëpa. Në zonat fushore sipërfaqet me kullota dhe me livadhe janë të kufizuara dhe gradualisht po kthehen në toka të punuara. Ushqimi, gjësë së gjallë do t'i sigurohet nga tokat nën kulturë, prandaj duhet të kufizohet në maksimum gjedhi që s'prodhon dhe të përmirësohet struktura, duke mbajtur më shumë lopë. Nuk është në leverdi të kooperativave të rrethit të Lushnjës që nga 7 800 gjedhe e buaj që kanë vetëm 19,4 për qind janë pëlleja, ose rrathi i Fierit, i cili ka 10 800 gjedhe e buaj, nga këto vetëm 17,3 për qind janë pëlleja, ndërsa shumica janë qe ose gjedhe joprodhuese. Mekanizimi i bujqësisë në shkallë të gjerë nga njëranë, zëvendësimi i qeve me kuaj ose buallica, të cilat shërbejnë për tërheqje, transport dhe lëvrim, do të bëjnë që të shtohet numri i lopëve mjelëse në zonat fushore.

Ne duhet të luftojmë që në vitin 1965 kooperativat

bujqësore të kenë mesatarisht për çdo 100 ha. tokë bujqësore mbi 9,2 lopë.

Krahas me shtimin e krerëve të gjedheve, vëmendje e posaçme i duhet kushtuar edhe shtimit të buallicave. Kjo kafshë ka një vlerë të madhe ekonomike, sepse shfrytëzimi i saj është i gjithanshëm. Buallicat, jo vetëm që janë kafshë të qëndrueshme, por japid qumësht jo më pak se lopët e vendit, me një përqindje yndyre shumë më të lartë. Përveç kësaj, buallicat japid mish më shumë se gjedhet, përveç lëkurës që është e çmueshme, ndërsa për punë dhe për transport në shumë raste buallicat janë të pazëvendësueshme. Megjithkëtë, duke mos u kujdesur për to, numri i buajve dhe i buallicave ka ardhur vazhdimisht duke u pakësuar dhe sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 1957 gjendja është shumë shqetësuese. Kështu në vitin 1956 patëm 14,4 për qind rënie, kundrejt vitit 1955; në vitin 1957 patëm një rënie prej 8,6 për qind kundrejt vitit 1956 dhe gjithsejt në vitin 1957 në buaj kemi një rënie prej 59,4 për qind, kundrejt gjendjes së vitit 1938 (73,9 për qind veças në buaj dhe 54,3 për qind në buallica). Pse ka ndodhur kjo rënie? Mos vallë ka rënë ndonjë sëmundje e papritur në buajt dhe janë dëmtuar? Jo. Bualli është kafshë shumë e qëndrueshme, ha çdo lloj ushqimi dhe preket më pak nga sëmundjet. Shkaku i rënies është se për këtë kafshë kaq të vlefshme ka një nënvleftësim të madh dhe megjithëse Partia e ka ngritur vazhdimisht, nuk po merren masa për ndalimin e rënieve edhe përshtimin e tyre.

Duhet goditur si e gabuar pikëpamja që ekziston në shumë kooperativa se gjoja tanë që po bonifikohen

fushat, bualli nuk ka kushte rritjeje. Kërkesa për ujë që paraqit kjo kafshë në stinën e verës dhe nevojat për strehim në stinën e dimrit mund të zgjidhen. I gabuar është edhe mendimi i disave se gjoja buajt janë të paleverdisshëm, sepse duan më shumë ushqime se gjedhet. Kjo është e vërtetë, por bualli ose buallicat, përdoren për punë, japid më shumë mish dhe qumësht me përqindje më të lartë yndyre dhe veç asaj kanë atë të mirë që hanë shumë lloj ushqimesh, që sot nuk shfrytëzohen si duhet për gjedhin.

2) Shtimi i numrit të bagëtisë së imtë, i dhenve e i dhive dhe shtimi i prodhueshmërisë së tyre do të rritë prodhimin vjetor të mishit.

Në kushtet e vendit tonë bagëtia e imtë, dhentë dhe dhitë, përbëjnë burimin kryesor të prodhimit të mishit, të qumshtit dhe të yndyrës për nevojat e popullsisë. Nga dhentë e dhitë në vitin 1955 ne kemi marrë 57,2 për qind të prodhimit të përgjithshëm të qumshtit (31,8 për qind nga delet dhe 25,4 për qind nga dhitë), dhe 62,9 për qind të mishit (39,7 për qind nga dhentë dhe 23,2 për qind nga dhitë). Prodhimi i leshit merret kryesisht nga dhentë.

Rritja e dhenve ka tradita të lashta në vendin tonë. Fshatarë shqiptarë e do delen dhe e është i lidhur ngushtë me të. Rritja e deles dhe e dhisë favorizohen te ne sidomos nga kullotat verore dhe nga kullotat pyjore. Numri i dhenve dhe i dhive, që rriten në vendin tonë, është relativisht i madh, në krahasim me shtetet fqinje e sidomos me demokracitë popullore. Kjo vjen, jo sepse

ne i rritim më mirë këto lloje bagëtish, por se ka sipërfaqe të madhe pér zhvillimin e tyre (rreth 85 pér qind e sipërfaqes në Republikë është male, pyje dhe kullota).

Sipas të dhënave mbi regjistrimin e blegtorisë, në vitin 1957, si Republikë kemi pasur gjithsejt 1 612 100 krerë dhen dhe 1 029 300 krerë dhi. Numrin më të madh të tyre e kemi pasur në ish-qarkun e Gjirokastrës, të Elbasanit dhe të Korçës, si dhe në rrethet Vlorë e Fier. Nga rrethet më të ngarkuara me dhen janë Peshkopia, Lushnja dhe Fieri, të cilat kanë 160-166 krerë pér 100 ha. tokë bujqësore. Rrethet e tjera kanë më pak se 140 krerë pér 100 ha., ndërsa ndërmarrjet bujqësore shtetërore kanë 118,4 krerë dhe kooperativat në pronën kollektive kanë 36,6 krerë pér 100 ha.

Në mjaft rrethe të zonave malore ka mundësi që të shtohen edhe më tepër dhitë, ndërsa në zonat fushore shpërndarja e dhene duhet të bëhet më drejt. Sido-mos kooperativat bujqësore duhet t'i shtojnë shumë dhentë, duke mos u mbështetur vetëm në kullotat natyrale, por edhe duke siguruar një bazë ushqimore më të plotë.

Nga të dhënrat mbi zhvillimin numerik të gjësës së gjallë ne duhet të na tërheqin vëmendjen dy çështje kryesore që janë të lidhura drejtpërsëdrejti me realizimin e detyrave që shtrohen para nesh. E para, se blegtoria në sektorin kooperativist është shumë e kufizuar dhe e dyta se plani vjetor i shtimit të blegtorisë nuk po realizohet sipas detyrave që janë shtruar. Sipas raporteve vjetore më 1957, nga 1 352 kooperativa bujqësore, vetëm 73 prej tyre kanë pasur ferma shpendësh, 229 — ferma lopësh, 473 — ferma dhensh e dhish dhe

233 — ferma derrash. Kjo do të thotë se mjaft kooperativa s'kanë asnjë fermë ose vetëm nga një fermë blegtore. Ndryshe nuk ka si të shpjegohet fakti që të gjitha kooperativat e mësipërme kishin p.sh. 57 100 shpendë ose 60 shpendë për 100 ha. tokë të mbjellë me drithëra, në vend që të kishin 381 700 shpendë (me normativën 400 shpendë për 100 ha. drithëra). Kështu në një kohë kur kooperativat bujqësore përfaqësonin 58,1 për qind të tokës dhe 46,4 për qind të ekonomive (më 1 janar 1958), në to ishte përqëndruar vetëm 5,6 për qind e lopëve të fshatarësisë, 15 për qind e deleve, 8,8 për qind e dhive, 39,8 për qind e dosave dhe 4,9 për qind e shpendëve. Kuptohet se vetëm duke krijuar ferma të mëdha blegtoreale në kooperativat bujqësore do të bëhet e mundur që ne, brenda pak vjetëve, të shtojmë në mënyrë të konsiderueshme prodhimin e mishit e të qumshit.

Nga të dhënat që kemi del se në asnjë nga llojet e blegtorisë nuk është realizuar plani i shtimit numerik për vitin 1957 sipas pesëvjeçarit. Keq me realizimin e planit për gjedhet janë rrethet: Shkodër, Vlorë, Elbasan e Librazhd; për dhentë: Berati, Durrësi, Përmeti e Saranda; për dhitë: Vlora, Tirana, Berati e Gramshi; për derrat: Kruja, Puka, Shkodra e Tropoja; për shpendët: Korça, Kruja dhe Fieri. Më mirë i kanë plotësuar detyrat e planit rrethet: Lezhë, Lushnjë, Peshkopi, Gjirokastër, Tepelenë, Ersekë, Kukës e Tropojë.

Është për t'u vënë në dukje se për çështjet e blegtorisë, si nga ana e Partisë ashtu edhe nga ana e organeve shtetërore, nuk tregohet po ai kujdes që tregohet për problemet e bujqësisë. Në rast se problemet e bleg-

torisë në përgjithësi do të ndiqeshin më mirë nga Ministria e Bujqësisë, nga komitetet e Partisë dhe nga komitetet ekzekutive të rretheve, ashtu siç u punua vjet dhe sivjet për ndërzimin artificial të dhenve, nuk ka dyshim se edhe detyrat e planit për zhvillimin numerik të gjësë së gjallë do të ishin realizuar.

3) Mbarështrimi i rregullt i gjësë së gjallë është një rezervë e madhe për shtimin numerik të blegorisë.

Nga shkaku i mbarështrimit jo të rregullt të bagëtive pëlleja, ka shterpësi të madhe në të gjitha llojet e kafshëve. Për shkak të interesimit të paktë që tregohet në ndërzimin e pëllejave, në vitin 1957 në ndërmarrjet bujqësore, rrëth 5 300 krerë nuk u ndërzyen. Përveç kësaj ka edhe mjaft dështime të shkaktuara nga faktorët mekanikë, nga sëmundjet ngjitime, si militens, zbekthi, abortus bangu dhe nga sëmundje të tjera, për zhdukjen e të cilave nuk merren masat me kohë. Prandaj, kujdesi për mbarështrimin e drejtë të blegorisë duhet të konsiderohet si një detyrë e rëndësishme që ka të bëjë me shtimin numerik dhe me rritjen e prodhueshmërisë të gjësë së gjallë. Në qoftë se do të bëhet një luftë e vendosur kundër këtyre të metave ka mundësi që të ulet në minimum shterpësia dhe të pakësohet numri i dështimeve që ndodh sot, të shtohet më shpejt numri i blegorisë dhe të rritet prodhueshmëria e saj.

4) Kujdesi për rritjen e mirë të bagëtisë është një rezervë tjeterë e rëndësishme për shtimin numerik të blegtorisë, dhe shtimin e prodhueshmërisë.

Mjafton të përmendim se për shkak të sëmundjes së zbekthit në ndërmarrjet bujqësore 8 000 krerë dele gjatë vitit 1957 nuk morën desh ose dështuan, ose për shkak të zgjebes, që kanë më se 9 700 krerë bagëti të imta në Republikë, jo vetëm që përqindja e lindjeve qe e ulët, por edhe prodhueshmëria qe e paktë. Si rezultat i pakujdesisë, që është treguar deri tanë, kemi humbje të mëdha edhe te viçat, kecat, qengjat dhe gicat që lindin. Këta nuk mbahen me racione ushqimore të përshtatshme, nuk u sigurohen higjiena, strehimi dhe shërbimi që kërkon mosha e tyre. Mjafton të përmendim vetëm fermat e derrave të ndërmarrjeve të grumbullimit, ku gjatë vitit 1957 kanë ngordhur 2 612 gica të vegjël.

Ndërsa në sektorin e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, ku evidencat janë më të kontrolluara, gjatë vitit 1957, sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, kemi pasur këto humbje: në viça 4,2 për qind, në qengja 7,1 për qind, në gica 8,7 për qind, në shpendë 32,9 për qind etj. Vetëm në dhentë kemi pasur 4,5 për qind dështime dhe mbi 14 për qind e tyre kanë mbetur shterpa. Sipas llogarive jo të plota nga këto ne humbim të paktën 10 000-12 000 qengja dhe mbi 400 ton qumësht në vit.

Këto llogari janë vetëm për ndërmarrjet bujqësore shtetërore, ndërsa në kooperativat bujqësore humbjet

janë edhe më të mëdha. Kooperativat bujqësore, në vitin 1956, në kafshët e reja dhe në fazën e parë të rritjes së tyre patën këto humbje të ndjeshme: në derrkuca 21,2 për qind të sasisë së përgjithshme të lindjeve, në keca 16,2 për qind, në qengja 11,3 për qind, në viçë 10,9 për qind dhe në mëza rrëth 11,6 për qind. Në kafshët e rritura në vitin 1957 humbjet ishin si vijon: në dhën 13,2 për qind (në pëlleja 6,6 për qind); në dhi gjithsejt 12,8 për qind (në pëlleja 23 për qind); në shpendë 62,2 për qind, duke përfshirë edhe zogjtë e porsaçelur (në pula 25,3 për qind); në lopët humbja arrin në 3,1 për qind, në derrat 32,1 për qind, kurse në dosat 9,1 për qind. Në këto të dhëna nuk përfshihen therjet e sforcuara që janë gjithash tu të shumta. Po të llogaritim prodhimin e këtyre kafshëve të humbura, do të shohim se vetëm nga dhentë do të merrnim të paktën rrëth 250 ton mish peshë e gjallë, përveç qumshtit dhe leshit.

Humbje të mëdha kemi edhe në sektorin privat.

Gjëja e gjallë, që skartohet dhe destinohet për mish, nuk i nënshtronhet një trajtimi paraprak për të shtuar peshën, si dhe për të rritur ciliësinë dhe rrezen e mishit që theret. Ndodh shpesh që nga kooperativat bujqësore dhe ekonomitë bujqësore private dorëzohen kafshë të vjetra, që kanë dalë jashtë përdorimit për arësyet të ndryshme, kafshë të sëmurë dhe të dobësuara pa u bërë asnjë shërbim paraprak për t'i majmuri.

Nga një studim i të dhënave mbi kafshët e therura në thertoret e Republikës gjatë vitit 1957 del se pesha e gjallë mesatare për kokë ka qenë për lopët 148 kg., për demat e ndërimit — 240 kg., për qetë e punës — 192 kg.,

për mëzetërit (1-3 vjeç) — 110-150 kg., për mëshqerrat (1-2 vjeç) — 110 kg., për viçat meshkuj e femra (deri 1 vjeç) — 50-55 kg. Ndërsa për viçat meshkuj e femra (nën 1 vjeç) — 36-40 kg. Për dhentë ka qenë: delja 24 kg., dashi 28 kg., rrurëza e milore 20-23 kg., qengjat meshkuj dhe femra 12-13 kg. Për të dhirtat ka qenë: dhitë 28 kg., cjeptë 32 kg., ftujakët dhe fluat 25-27 kg., kecat meshkuj dhe femra 11-12 kg., e kështu me radhë.

Eshtë e qartë se me një trajtim më të mirë të bagëtisë para therjes ne do të merrnim rreth 10 pér qind, ndoshta dhe më shumë mish dhe nga ana tjetër nga ky trajtim, cilësia e mishit do të përmirësohej shumë. Sipas të dhënave të Komitetit Shtetëror të Grumbullimeve, gjatë vitit 1957, ndërmarrjet shtetërore të grumbullimit në Shkodër, Korçë e Gjirokastër, vetëm nga sigurimi i bazës ushqimore më të mirë, nga përmirësimi i strehimit dhe i shtimit të kujdesit pér bagëtinë e grumbulluar, kanë arritur që gjatë 3 muajve të marrin mesatarisht nga çdo bagëti e trashë e mbajtur në majmëri, një shtesë vjetore prej 45 kg. peshë e gjallë dhe nga bagëtia e imtë 10 kg. Instituti Zooteknik, në vitin 1957, pér eksperiment bleu nga ndërmarrjet e grumbullimit lopë vendi. Duke i mbajtur në kushte higjienike të mira dhe në kullota natyrale, brenda 9 muajve këto shtuan mesatarisht 23,4 kg. pér çdo kokë.

Siq shihet, kafshët që destinohen pér therje ka mundësi të japid një sasi mishi më të madhe, në rast se i nënshtrohen një majmërie dhe një trajtimi paraprak. Këtu kemi të bëjmë me një rezervë të madhe pér shtimin e prodhimit të mishit. Mjafton të përmendim

se vetëm nga organet e grumbullimit, mesatarisht për çdo vit, qarkullojnë rrëth 370 000 krerë bagëti të imta dhe të trasha, të cilat po të mbaheshin rrëth 3 muaj në majmëri do të jepnin disa mijëra kuintalë mish më shumë nga sasia e mishit që merret sot.

A duhet të lejojmë të vazhdojë më tej kjo pakujdesi ndaj bagëtive të caktuara për therje? Ka ardhur koha që t'i japim fund kësaj pakujdesie në trajtimin e blegtorisë. Ndërmarrjet shtetërore bujqësore, kooperativat bujqësore dhe fshatarësia individuale duhet të bëjnë kthesë në këtë drejtim. Interesi i tyre dhe interesi i përgjithshëm i ekonomisë popullore kërkon që bagëtia e destinuar për therje të trajtohet më mirë, të vihet patjetër në majmëri dhe pasi të ketë arritur peshën dhe majmërinë e duhur, t'i shitet shtetit. Duke ndjekur këtë rruge, jo vetëm që sasia e mishit do të shtohet, por edhe cilësia e tij do të jetë e lartë dhe ekonomitë që prodhojnë mish do të kenë më shumë të ardhura. Përsa i përket majmërisë së bagëtisë së grumbulluar përpara se të kalojë në therje, organet e grumbullimit që merren kryesisht me problemin e furnizimit të popullit me mish, duhet të marrin masa serioze që bagëtitë e grumbulluara, jo vetëm të mos humbasin në peshë, po përkundrazi t'i vënë në kushte të mira ushqimi dhe t'i trajtojnë me kujdes, në mënyrë që ta rritin shumë peshën e tyre dhe cilësinë e mishit.

Të hiqet dorë nga të majmurit spontan të bagëtive. Të bëhet majmëria e organizuar në qendra të përherëshme të majmërisë (ashtu si kanë filluar të bëjnë ndërmarrjet e grumbullimit në Shkodër dhe në Gjirokastër). Në qendrat e majmërisë të organizohet më mirë shfry-

tëzimi i kullotave, mbjellja e jonxhës, e hasëlleve, përdorimi i silazhit, shfrytëzimi i mirë i të gjitha rezervave. Të përmirësohet strehimi dhe shërbimi zooveterinar i bagëtisë së grumbulluar. Komitetet ekzekutive të rretheve ku do të ngrihen këto qendra, brenda tremujorit të parë të vitit 1959 t'u sigurojnë ndërmarrjeve të grumbullimit kullota dhe toka për t'i mbjellë me jonxhë, hasëlle e njomështira për mbajtjen e bagëtive. Këto toka dhe kullota t'u kalojnë në pronësi të përhershme ndërmarrjeve të grumbullimit, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të bëjnë investime dhe t'i përmirësojnë. Komiteti ekzekutiv i rrethit të Tiranës duhet ta shikojë problemin e kullotave për grumbullimin, se bazat e majmërisë në rrëthin e Tiranës duhet të shërbejnë për furnizimin e kryeqytetit. Vitin e ardhshëm Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve të ngrëjë një qendër majmërie pranë Kombinatit të Sheqerit në Maliq, me qëllim që bërsitë e panxharit të përdoren për majmëri.

Organet e grumbullimit duhet t'u japid fund të metave në lidhje me transportimin e bagëtive të gjalla nga një qendër në tjetrën. Nuk janë të pakta rastet që gjatë transportimit të tyre, bagëtitë kanë humbur mjaft në peshë për shkak se ndërmarrjet nuk kanë siguruar gjatë rrugës ushqimin dhe ujët e nevojshëm, nuk kanë organizuar mirë itinerarin e lëvizjes dhe nuk i kanë zgjedhur ose trajtuar mirë barinjtë. Kështu p.sh. nga 174 krerë bagëti të imta që u transportuan nga Tepelena në Tiranë, humbën gjatë rrugës 581 kg. mish peshë c gjallë, në vend të 174 kg. që parashikon rregullorja. Nga 43 krerë bagëti të trasha të transportuara nga Lushnja në Tiranë humbën 554 kg. mish (në vend

të 172 kg.) dhe kjo sepse drejtoria e ndërmarrjes nuk mori masat e duhura për ushqimin dhe për çlodhjen e bagëtive gjatë rrugës. E kundërtua u vërtetua në ndërmarrjen e grumbullimit të Shkodrës. Kjo ndërmarrje gjatë periudhës janar-gusht ka transportuar më këmbë nga Tropoja dhe nga Kukësi për në Shkodër dhe pastaj për në Tiranë mbi 300 bagëti të trasha dhe 348 të imta. Nga organizimi i mirë i lëvizjes së bagëtisë, jo vetëm që nuk pati humbje, por iu kursyen shtetit edhe 15,5 kv. mish, që parashikohej si firo e ligjshme. Në rast se të gjitha ndërmarrjet e grumbullimit do ta organizonin punën si ajo e Shkodrës, bagëtia e grumbulluar do të shtonte peshë dhe do të sigurohej më shumë mish.

Rëndësi duhet t'i vihet grumbullimit të mishit të cilësisë së lartë. Për këtë qëllim të vihen stimulime më të mira kur dorëzohet mish i kategorisë së parë dhe të dytë dhe të mos pranohet mish i kategorisë së tretë. Grumbullimi i mishit të kategorisë së tretë (mishi i gjedhit dhe i bagëtive të imta) të pranohet vetëm në raste të veçanta, shumë të kufizuara dhe me autorizim të Komitetit Shtetëror të Grumbullimeve. Të bëhet përjashtim në këtë rast për mishin e derrit, të cilin ndërmarrjet e grumbullimit duhet ta prancjnë edhe kur është i kategorisë së tretë.

Nga përllogaritjet që dalin nga mishi i kategorisë së tretë që shteti grumbullon çdo vit nga fshatarët dhe nga kooperativat bujqësore, po të dorëzoleshin të njëjtat bagëti me mish të cilësisë së parë dhe të dytë, do t'i kishin shitur shtetit 6 000 kv. mish më shumë. Ndërmarrjet bujqësore të shtetit, si dhe kooperativat bujqësore, oborret kooperativiste dhe ekonomitë bujqësore

private, duhet të kuptojnë se plotësimi i planit të shtetit nuk kërkohet vetëm në sasi, por edhe në cilësi. Populli do të furnizohet me mish rregullisht dhe me cilësi të lartë. Nga ana tjetër si ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe ekonomitë bujqësore kolektive ose private, duke dorëzuar mish të kategorisë së tretë, dëmtohen rëndë ekonomikisht, prandaj ato duhet të prodhojnë mish të kategorisë së parë dhe të dytë.

Duhet thënë se kohët e fundit Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve ka marrë masa të mira për majmérinë e bagëtisë, por ky është vetëm fillimi. Në punën e tij ai ka akoma shumë të meta.

Organet e grumbullimit nuk duhet ta përqëndrojnë vëmendjen vetëm në majmérinë e bagëtisë. Ato, në radhë të 'parë, duhet të marrin masa që të realizohet plani i grumbullimeve dhe në mënyrë të vegantë i tepricave të mishit. Duhet thënë se plani i blerjes së tepricave të mishit nuk po realizohet. Këtu organet e grumbullimit kanë shumë të meta sepse nuk kanë krijuar bazat e nevojshme, por as edhe organet e Partisë dhe të pushtetit në bazë nuk po e kryejnë si duhet detyrën. Mosgrumbullimi i tepricave të mishit do të sjellë vështirësi në furnizimin e popullit me mish, prandaj është urgjente që organet e grumbullimit, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të marrin masa të shpejta për të plotësuar në mënyrë ritmike detyrat e planit të grumbullimit, të organizojnë më mirë grumbullimin e tepricave të mishit nga kooperativat bujqësore dhe ekonomitë private nëpërmjet sistemit të kontraktimit. Të çelen në thellësi baza të posaçme grumbullimi për t'i ardhur sa më shumë në ndihmë fshatarësisë.

5) Një rezervë tjeter për ngritjen e rrzes së mishit të bagëtive që destinohen për therje, si dhe për përmirësimin e cilësisë së mishit është mbrojtja e gjësë së gjallë nga dëmet që shkaktojnë sëmundjet në përgjithësi, veçanërisht sëmundjet parazitare.

Rrallë gjen, sidomos në bagëtitë e trasha apo të imta që theren në thertore, që të mos kenë mëlcitë, mushkëritë, shpeshherë edhe organet e tjera të prekura nga sëmundje, që i bëjnë këto sasi mishi të papërdorshme. Në thertoren e Tiranës, ku mesatarisht për çdo vit theren rreth 50 000-60 000 krerë bagëti të imta dhe 25 000-30 000 krerë bagëti të trasha, duke përfshirë edhe derrat, për arësyte të sëmundjeve që kanë bagëtitë që theren, nuk lejohen të përdoren për t'u ngrënë 500 deri 700 kv. mish. Po të llogariteshin këto humbje në shkallë Republike, në thertoret e së cilës kalojnë mbi 300 000 kafshë të imta, duke nxjerrë jashtë përdorimit vetëm nga 1,5-2 kg. organe të brendshme për kokë, del se ne humbim jo më pak se 5 000 kv. mish çdo vit. Kjo është një rezervë e madhe. Prandaj, del detyrë urgjente për të gjithë punonjësit dhe specialistët e blegtorisë, sidomos për zooteknikët dhe veterinerët, që të marrin masa serioze për mbrojtjen e shëndetit të gjësë së gjallë dhe për shërimin e bagëtive të prekura nga sëmundjet.

6) Përmirësimi i racës së gjedheve dhe të dhene përbën një rezervë shumë të madhe për shtimin e prodhimit të mishit.

Sa ndryshime të mëdha shikohen si në peshë e në

qumësht midis gjedheve të vendit dhe gjedheve të racës ose atyre të përmirësuarave. Sa shumë mish ose lesh jep delja e racës «cigaja» ose «merinos», në krahësim me delen e vendit, këtë e shohim qartë në ato pak bagëti të racës që kemi në vendin tonë. Rezultatet e arritura në Institutin Zooteknik të Shkodrës, në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe në kooperativat e përparuara, janë mjaft shembuj të mirë në këtë drejtim. Kështu p.sh., duke u kryqëzuar me dema të racës Gernsej gjedhi i vendit e ka rritur peshën e vet 11-12 përqind. Kjo është një shtesë mjaft e mirë. Në pasqyrën e mëposhtme këto shtesa jepen me shifra absolute, sipas të dhënave të Institutit Zooteknik të Shkodrës.

Rritja e peshës së gjedhit të vendit (shkodran) si rezultat i kryqëzimeve me demat e racës Gernsej (në kg. peshë e gjallë):

Seks	Raca e vendit ose e kryqëzuar	Në muaj	Në 6 muaj	Në 12 muaj	Në 18 muaj
M	Shkodrane	20	99,9	162,4	221,7
	E kryqëzuar	23,8	108,3	182,7	240
F	Shkodrane	18,9	96,1	160,7	207,4
	E kryqëzuar	22,7	111,4	180,2	245,8

Provat e Institutit Zooteknik kanë treguar gjithash tu se pesha e kafshëve të vendit, të kryqëzuara me demat e përmendur më lart rritet akoma më shumë në

brezat e ardhshëm. Kështu p.sh. 3 lopë të kryqëzuara në gjeneracionin e parë e kanë rritur si vijon peshën në kg.:

<i>Pesha e lopës mëmë:</i>	<i>Pesha e lopës bijë:</i>	<i>Përqindja e rritjes:</i>
283	380	134
322	415	129
285	367	129

Rezultate të mira janë arritur edhe në kryqëzimet e dhenve. Kështu p.sh. nga studimet e bëra në Institutin Zooteknik të Shkodrës del se qengji mashkull i rudes, 60-65 ditë pas lindjes, peshon 14,1 kg., ndërsa i kryqëzuar me «merinos» peshon 3 kilogram më shumë.

Është e qartë se përmirësimi i racës së gjësë së gjallë që ka filluar në masë në vendin tonë, do të sjellë si pasojë në mënyrë të shpejtë shtimin e mishit. Prandaj, detyra që ka shtruar Komiteti Qendror për përmirësimin e racës së dhenve e tö lopëve, duhet të konsiderohet si një nga problemet më të rëndësishme që ka të bëjë me transformimin e blegtorisë sonë në një degë me rëndësi për ekonominë popullore. Organizatat e Partisë, organet e bujqësisë, teknikot dhe specialistët, rritësit e blegtorisë, jo vetëm duhet të luftojnë për të realizuar para kohe detyrën e përmirësimit të racës, por edhe të marrin masa që blegtoria e racës së re të ketë kushte jetese dhe ushqimore të përshtatshme.

7) Një problem i madhi që ka të bëjë me shtimin e mishit është mosha kur theren bagëtitë.

Prej kohësh ka qenë bërë zakon te ne, që qengjat t'i therin në moshën 1 muaj, kur pesha e gjallë e tyre nuk i kalon 10 kg. Kështu veprohej edhe për kecat. Në këtë moshë kafshët e reja zakonisht japid një rreze mishi më të madhe se në moshën e avancuar sepse siç thotë populli «nuk kanë bark» dhe se në këtë moshë ata janë më të shijshëm, por vlera ushqimore e mishit në këtë kohë është e vogël dhe sasi e mishit është e paktë. Bagëtia duhet të theret kur ka arritur në moshën e përshtatshme për therje, kur vlera ushqimore e mishit është më e lartë dhe interesit ekonomik është më i madh. Për këtë qëllim në vitin 1957, në frymën e vendimeve të Plenumit të Shkurtit qeveria, me urdhëresë të posaçme, përcaktoi se si duhet të veprohet për therjen e kafshëve. Sidomos për qengjat u ndalua therja para muajit qershor dhe rekmandohej mbajtja e qengjave deri në vjeshtë. Si rezultat, atje ku qengjat u mbajtën në kushte ushqimore të mira edhe rezultatet qenë të mira, u rrit pesha e gjallë e tyre, u muar një sasi mishi më e madhe dhe krahas me këtë edhe më shumë lesh e më tepër lëkurë. Këtë e dëshmojnë rezultatet e arritura në Ndërmarrjen Bujqësore të Lushnjës. Tufa e qengjave të kryqëzuar të kësaj ndërmarrjeje ishte mbi 790 krerë, pesha mesatare në lindje ka qenë për meshkujt 3,8 kg. dhe për femrat 3,4 kg.; në çastin e këputjes nga mëma në muajin prill, mesatarja në meshkuj arriti 19,1 kg. dhe në femrat 17,8 kg.; mbajtja

e tyre 8 muaj bëri që pesha të shtohet mjaft; 279 krerë arritën peshën mesatare prej 24 kg. Akoma më të kënaqshme paraqiten rezultatet në tufën e dhene rude të kryqëzuar me «merinos». Qengjat e kësaj tufe në moshën rreth tetë muajsh (në muajin shtator) peshuan mesatarisht meshkujt 33,7 kg. dhe femrat 30,2 kg.

Të tilla rezultate të mira në mbajtjen dhe në majmërinë e qengjave patën edhe mjaft kooperativa bujqësore të rrëthit të Lushnjës. Kooperativa bujqësore «Fieri i ri» mori 143 qengja nga kryqëzimi i deles së vendit me racën «merinos kaukazi», të cilët në kohën e lindjes peshonin 3,5 kg., ndërsa në muajin qershor, në çastin e dorëzimit për grumbullim, ata peshuan mesatarisht 20,8 kg. Për qengjat e mbajtur, pas qershorit e deri në gusht, pati shtesë peshe, por pas dyjavorit të fundit të gushtit, me pakësimin e kullotës dhe me dobësimin e bazës ushqimore, pesha e tyre ra. Peshë të mirë në qengja deri në muajin qershor kanë pasur edhe kooperativat bujqësore të Krutjes së Sipërmë dhe të Krutjes së Poshtme në qengjat e lindur nga dhentë e vendit të kryqëzuara me «cigaja», duke arritur të peshonin përkatësisht 19,7 kg. dhe 26,4 kg. Por ndryshe ndodh në ndërmarrjet shtetërore blegtore, ku qengjat, pas këputjes, nuk e kanë të siguruar bazën ushqimore. Ata në muajt e parë të këputjes nga mëma bien në peshë dhe shtojnë vetëm nga vjeshta, kur organizmi i tyre përshtatet me kullotën ku në këtë kohë mbin bari i ri. Në këtë rast ndryshimi midis peshës fillestare dhe peshës në fund të periudhës së majmërisë (në vjeshtë) është shumë i vogël. Në të tilla raste del nevoja që numri i qengjave, që do të lihet për majmëri

në ndërmarrjet blegtore, të vendoset në përputhje me kapacitetin e kullotës disponibël dhe me rezervat e tjera të bazës ushqimore, që mund të sigurohen.

Praktika e deritanishme ka treguar se kooperativat bujqësore; ekonomitë private dhe ato ndërmarrje bujqësore që kanë tufa të vogla, i kanë të gjitha mundësitë që qengjat dhe të gjitha kafshët në rritje t'i mbajnë deri në vjeshtë për të fituar peshë, lesh dhe lëkurë më tepër. Përsa u përket ndërmarrjeve shtetërore bujqësore që kanë tufa të mëdha në rritje dhe që janë të detyruara të shtegtojnë në kullotat verore, del detyrë që Ministria e Bujqësisë, në bashkëpunim dhe me Komitetin Shtetëror të Grumbullimeve, ta studojnë këtë problem dhe të caktojnë numrin e qengjave ose të kafshëve në rritje që do të mbahen për majmëri pas këputjes nga mëma, pa dëmtuar rrezen dhe cilësinë. Lidhur me këtë, përsa u përket ndërmarrjeve bujqësore shtetërore që kanë tufa të mëdha dhe kur nuk u mjaftojnë kullotat, qeveria duhet të rishikojë dispozitat e urdhëresës që ndalon kategorikisht therjen e qengjave para datës 1 qershor, duke lejuar therjen e tyre para këtij afati, por të mbahet parasysh që qengjat duhet të kenë arritur peshën e lejueshme për therje dhe cilësinë e mishit që kërkohet.

Nga të gjitha sa u tha më lart del e qartë se ne kemi mundësi që të shtojmë prodhimin e mishit si nga kafshët e trasha ashtu edhe nga të imtat. Kjo, natyrisht, do të arrihet vetëm duke marrë masa serioze për organizimin e mirë të ndërzimeve, për ngritjen e përqindjes së pjellshmërisë, për rritjen e mirë të të vegjelvë pa humbje, për luftën kundër sëmundjeve që dëmtojnë

gjënë e gjallë, për mostherjen e kafshëve të reja me peshë të vogël, për vënien në majmëri paraprake të kafshëve të caktuara për therje, për të mënjanuar të gjitha të metat që ndikojnë në dobësimin e kafshëve të grumbulluara pranë ndërmarrjeve përkatëse. Duke marrë këto masa jo vetëm që do të sigurohet rritja e numrit të krerëve që parashikohet për vitin 1965, por do të bëhet e mundur që pesha e kafshëve për therje të rritet në mënyrë të ndjeshme dhe të përmirësohet shumë cilësia e mishit.

Duhen marrë masa që pesha e lopës në vitin 1960 të arrijë 172 kg. dhe më 1965 jo më pak se 180-200 kg. Për llojet e tjera të kafshëve, pesha mesatare duhet të rritet si vijon (1960 dhe 1965): viçat 60 dhe 65 kg.; delet 30 dhe 31 kg.; deshtë 32 dhe 35 kg.; qengjat 15 dhe 17 kg.; cjeptë 35 kg.; dhitë 30 kg., dhe kecat 13 e 14 kg. Prodhimi i mishit për çdo dosë llogaritet të merret mesatarisht 245 kg. në vitin 1960 dhe 420 kg. në vitin 1965, kundrejt 166 kg. që llogaritet të ketë qenë në vitin 1957. Prodhimi i mishit nga çdo shpend, në fillim të vitit është llogaritur 0,65 kg. në vitin 1960 dhe 0,80 kg. në vitin 1965.

Duhet të vihet rregull përsa u përket kafshëve që dorëzohen në formë detyrimi ose shiten si teprica nga ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe kooperativat bujqësore në organet e grumbullimit. Të mos grumbullohen bagëti, të cilat nuk kanë mbushur peshën e caktuare dhe cilësinë e duhur të mishit. Këshilli i Ministrave të përcaktojë me vendime të posaçme rregullat, ku të caktohet pesha e kafshëve që duhet t'i dorëzojnë grumbullimit ndërmarrjet bujqësore shtetërore. Viçat e de-

rrat të mos dorëzohen nën peshën 60 kg., ndërsa për kooperativat bujqësore dhe sektorin privat viçat të pranohen kur peshojnë 60 kg. e derrat jo më pak se 40 kg.; të mos lejohet therja e tyre nga organet e grumbullimit nën peshën 80 kg. për viçat dhe 60 kg. për derrat.

Për të siguruar numrin e krerëve të bagëtisë dhe prodhimin e mishit që parashikohet për vitin 1960 dhe 1965 duhet të rritet përqindja e pjellshmërisë së bagëtisë në vitin 1965 dhe të bëjmë që të arrijmë të marrim në çdo 100 krerë: nga lopët jo më pak se 75 viça, nga delet 85 qengja dhe nga dhitë 83 keca. Megjithëse këta tregues janë shumë të lartë në krahasim me gjendjen e sotme, duke marrë masat që shtrohen, ekzistojnë të gjitha mundësitë që këta tregues të realizohen me sukses.

8) Rritja në shkallë të gjërë e derrave, organizimi i mirë i pjellshmërisë së dosave, si dhe organizimi i majmërisë së derrave për therje, janë një rezervë e madhe për shtimin e mishit.

Nga çdo kafshë tjetër derri është i vetmi që të jep më shpejt dhe më shumë mish. Vlera e derrit nuk qëndron vetëm në prodhueshmërinë e madhe të mishit. Mishi i derrit, në krahasim me mishin e bagëtive të tjera ka kalori të lartë. 1 kg. mish derri i majmë jep 2 700 kalori, ndërsa 1 kg. mish gjedhi dhe dashi i majmë përmban mesatarisht rrëth 1 400-1 600 kalori dhe ajo që ka rëndësi të madhe është fakti se këto kalori nga derri i marrim duke shpenzuar pothuajse 2 herë më pak njësi ushqimore nga sa nevojiten për gjedhet dhe për bagëtitë e imta. Derri është një nga kafshët që rri-

tet dhe zhvillohet më shpejt. Që në moshën 8-10 e maksimumi 12-14 muajsh, dosat mund të ndërzehen rregullisht dhe të jepin 7-8 gica në çdo pjellje. Gicat, po të rriten me kujdes, që kur janë 7-8 muajsh, pas një majmërie të rregullt, mund të arrijnë peshën e gjallë 70-80 kg. Vetia tjetër e derrit është se ai pëlqen pothuajse të gjitha llojet e ushqimeve, duke përfshirë edhe pjesën më të madhe të mbeturinave të industrisë ushqimore, të cilat i kthen në mish e në dhjamë. Për këto veti biologjike, kjo kafshë me të drejtë është quajtur fabrikë e madhe mishi. Këtej del, pra, se për të zgjidhur shpejt problemin e mishit, jo vetëm nuk duhet të largohet vëmendja nga rritja e derrit, por duhet treguar kujdes i veçantë që t'i shtojmë me një ritëm më të shpejtë në të gjithë vendin, duke kapërcyer të gjitha pengesat objektive dhe subjektive, që hasen në këtë rrugë.

Partia kurdoherë e ka shtruar me forcë çështjen e zhvillimit të derrit në vendin tonë. Në krahasim me gjendjen e paraluftës numri i derrave është rritur nga 15 300 krerë më 1938, në 96 200 në vitin 1957. Krahas me këtë edhe prodhimi i mishit është rritur nga 550 ton më 1938, në 3 000 ton (peshë e gjallë) më 1957. Por duhet thënë se kjo rritje e derrit nuk është përhapur në të gjitha ekonomitë bujqësore kolektive dhe private. Kjo punë është bërë në mënyrë më intensive në sektorin shtetëror (në ndërmarrjet bujqësore shtetërore, në ndërmarrjet shtetërore të grumbullimeve dhe në ekonomitë ndihmëse). Por, duke marrë parasysh mundësitë që ekzistojnë për rritjen e derrit, kushtet e krijuara, sidomos me rastin e kolektivizimit, peshën që mban sot

derri në krahasim me blegtorinë në Republikë, si dhe nevojën e madhe që paraqitet për mish, numri i derrave dhe prodhueshmëria e tyre është akoma e kufizuar.

Ku qëndron shkaku që derri rritet akoma në masë të kufizuar? Fanatizmi është një arësy që ka penguar rritjen e derrit, por kryesorja është interesimi shumë i paktë që është treguar në këtë drejtim. Nuk është punuar sa duhet me masat fshatare për njohjen e vlerës së derrit dhe për përhapjen e kësaj kafshe të çmuëshme. Si rrjedhim i këtyre shkaqeve edhe prodhimi i mishit të derrit ka qenë jashtëzakonisht i ulët. Pas çlirimt u bë një farë 'pune për sqarimin e fshatarësisë në drejtim të përhapjes së derrit.

Sipas të dhënave të vitit 1957, në sektorin shtetëror është përqëndruar 44,6 për qind e të gjitha dosave, ndërsa kooperativat bujqësore me gjithë oborret kanë pasur vetëm 36 për qind të derrave që ishin në Republikë dhe ekonomitë individuale 19,4 për qind të tyre. Një shpërndarje afersisht e tillë e derrit është edhe sot. Kjo nuk është e rregullt. Ekonomitë kooperativiste, që përbëjnë sot peshën kryesore në bujqësi, kanë rezerva të mëdha për rritjen e derrit. Sipas të dhënave del se në vitin 1957 kooperativat bujqësore, si 'pasuri kolektive, kanë pasur vetëm 1,8 dosa për çdo 100 ha. tokë të punueshme kundrejt 4,4 krerë që ka qenë mesatarja e Republikës. Të shumta janë kooperativat bujqësore që nuk kanë fare derra. Në mjaft rrethe ka mijëra ekonomi, që pothuaj nuk e njohin fare derrin. Sido-mos më keq paraqiten rrethet e Skraparit, Kukësit, Elbasanit, Gjirokastrës, Librazhdit, Matit dhe Beratit. Komitetet e Partisë dhe organet e pushtetit në këto rrethe

nuk kanë luftuar me këmbëngulje për ta bindur fshatarësinë mbi leverdinë e madhe të derrit.

A duhet të vazhdohet akoma të mbahet ky qëndrim për përhapjen e derrit? Jo. Partia duhet t'i kapërcejë vështirësitë. Të flitet me kooperativat bujqësore mbi rëndësinë që ka derri për ekonominë popullore dhe mbi interesin që kanë kooperativat dhe fshatarësia përritjen e derrit. T'u shpjegohet kooperativave dhe fshatarëve që të tregojnë kujdes të veçantë përritjen e derrit dhe t'ia shesin shtetit ose të shlyejnë detyrimet e mishit me mish derri. Kjo është në të mirën e tyre. Përritjen e derrave në kooperativa, organizatat e Partisë dhe kryesitë e kooperativave bujqësore të vënë njerëzit më të mirë që e duan dhe e kuptojnë rëndësinë e derrit dhe që janë të vendosur ta vënë në jetë porosinë e Partisë.

Sipas planit të dytë pesëvjeçar të avancuar, në vitin 1960 duhet të arrihet që për çdo 100 ha. tokë arë të mbahen në ndërmarrjet bujqësore shtetërore 9 krerë dosa dhe në kooperativat bujqësore 8,9 krerë dosa. Fshatarësia kooperativiste dhe private, ndërmarrjet bujqësore shtetërore, organet shtetërore të bujqësisë dhe vetë organizatat e Partisë të rretheve, duhet ta shikojnë derrin me një sy tjetër, jo si e shohin sot, sepse, sikurse u tha, derri është një fabrikë e madhe mishi dhe një nga mjetet më të mira për ta shtuar shpejt dhe në sasi të madhe prodhimin e mishit. Duke e shikuar kështu derrin si dhe duke marrë parasysh kushtet që ekzistojnë në vendin tonë përritjen e tij, mbështetur edhe në sugjerimet e rretheve dhe të bazës, ka mundësi që derri të përhapet shumë, sidomos në

kooperativat bujqësore, shumica e të cilave nuk kanë fare derra.

Për shtimin e derrit dhe të prodhueshmërisë së tij është e domosdoshme:

a) *Të bëhet shfrytëzimi i kujdesshëm i dosave, të merren masa për ndërzimin e rregullt të tyre, të sigurohet vijë pjellshmëri e lartë dhe të tregohet kujdes i veçantë për ushqimin dhe ruajtjen e shëndetit të gicave.* Në përgjithësi merren pak gica për çdo dosë. Sipas të dhënave të viteve 1956-1957 kooperativat për çdo dosë kanë rritur nga 3-4 gica dhe në fund të vitit skorta e gicave nuk i kalon të 2-2,5 krerë mesatarisht për dosë, ndërsa për 6-mujorin e parë të këtij viti, ato kanë marrë vetëm 3 gica nga çdo dosë, nga të cilët 1 gic për çdo dy dosa e kanë mbajtur për ta vënë në majmëri. Me një numër gicash të tillë, që zakonisht theren me një peshë të gjallë rrëth 30 kg., sigurisht që nuk mund të prodhohen sasi të mëdha mishi dhe kostojë e mishit të derrit ngrihet së tepërmë.

Në kooperativat bujqësore dosat ndërzehen zakonisht jashtë kontrollit, shpeshherë në kohë të papërshtatshme, gjë që ka rëndësi shumë të madhe. Në caktimin e afateve të pjelljeve të dosave duhen pasur para-sysh kushtet konkrete të çdo ekonomie. Si rregull është më e leverdisshme që lindjet të bëhen në muajt kur ka shumë kullota, sepse sigurohet një rritje më e mirë e të vegjëlve. Muajt më të përshtatshëm për këtë qëllim për zonat e ulëta bregdetare janë janari e shkurti, kurse për zonat malore muajt shkurt dhe mars. Në këto afate, menjëherë pas këputjes, gicat gjejnë kushte më të mira për t'u ushqyer në kullota (p.sh. në jonte

xhë, që është e pasur me proteina dhe që ndihmon përritjen e mirë të të vegjelvë). Më vonë, në muajt e parë të vjeshtës, gicat vihen në majmëri për një periudhë të shkurtër dhe pasi arrijnë peshën 70-80 kg. (sipas racës) dorëzohen menjëherë për therje. Duke lindur herët në pranverë, gicat femra në moshën 8-9 muajshe, mund të ndërzehen dhe të jasin 6-7 gica që në vitin e parë të jetës së tyre. Në këtë mënyrë për çdo dosë mëmë merren sasi të mëdha mishi. Në fakt, sot, në shumicën e rasteve, gicat femra në vjeshtë, në moshën 8-9 muajshe, nuk arrijnë as peshën dhe as zhvillimin e nevojshëm për ndërzim.

Ndërmarrjet e grumbullimit kanë filluar ta organizojnë më mirë rritjen e derrave. Duke zbatuar ato që u thanë më lart, gjatë vitit 1957, ato kanë marrë mesatarisht nga 11 gica të gjallë dhe 6 kv. mish për dosë, ndërsa ndërmarrjet e grumbullimit në Korçë, në Tiranë dhe në Fier morën mbi 12 gica dhe 7-8 kv. mish për çdo dosë. Në ekonomitë e përparuara në Rumania, në Bullgari e gjekë është arritur të merren 18-20 gica në vit për çdo dosë. Këta gica i vënë në majmëri të gjithë, natyrisht, duke siguruar kullotë të pasur e sidomos jonxhë. Kolkozet dhe sovkozat e Bashkimit Sovjetik kanë treguar se brenda një viti mund të dyfishohet prodhimi i mishit nga rritja e derrit. Kolkozet e rrethit të Krozhopolit të qarkut të Vincas, në vitin 1956 prodhuan vetëm 38 kv. mish për 100 ha., ndërsa për 10 muajt e vitit 1957 ata prodhuan 101 kv. mish për çdo 100 ha. tokë arë. Këtë eksperie ncë të pasur duhet ta përvetësojnë edhe ndërmarrjet

bujqësore shtetërore dhe kooperativat tona dhe ta vë-në me kujdes në jetë.

b) Që të shtohet *mishi i derrit i duhet kushtuar kujdes përmirësimit të racës së derrave*. Në ndërmarrjet bujqësore shtetërore, ashtu dhe në ato të grumbullimit, ku është bërë një punë e tillë, derri i vendit pothuajse është zëvendësuar me derra të kryqëzuar, kështu që në to prodhimi i mishit është i lartë. Krejt ndryshe qëndrojnë punët në kooperativat bujqësore dhe në ekonomitë individuale, ku nuk bëhet asgjë për përmirësimin e racës. Derri i vendit ka një prodhueshmëri të ulët në mish. Pesha e gjallë e tij në moshën e rritur nuk i kalon mesatarisht 50-60 dhe shumë rrallë 70 kg., majmet shumë pak, i shpërbulen keq ushqimet dhe pjellshmëria e tij është shumë e vogël (5-6 gica). Anët e mira të derrit të vendit janë qëndrueshmëria ndaj sëmundjeve dhe kërkon më pak ushqime dhe shërbim, prandaj duke e kryqëzuar derrin e vendit me derra të racës këto veti kombinohen mirë në racën e përmirësuar. Kështu p.sh. si pasojë e kryqëzimeve të bëra deri sot është rritur së tepërtmi pesha e gjallë, pjellshmëria, aftësia për majmëri dhe derrat janë bërë më të hershëm. Që të arrihet të bëhet përmirësimi i racës së derrit në të gjithë vendin duhet të përcaktohen mirë racat që duhen përhapur, duke u nisur edhe nga nevojat e vendit për mish, për sallo ose për konservim. Ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe ndërmarrjet e grumbullimit që rritin derra, duhet të bëhen bazat e përmirësimit dhe të përhapjes së racës. Sot që kooperativat bujqësore kanë fare pak derra, ato duhet të furnizojnë kooperativat bujqësore me gica të racës së për-

mirësuar, me qëllim që çdo kooperativë brenda vitiit 1960 të ketë krijuar fermën e derrave, Ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe ato të grumbullimit të sigurojnë çdo vit, duke filluar që nga viti 1959-1961 t'u shpërndajnë kooperativave bujqësore 3 000 gica në vit. Në ndërmarrjet bujqësore shtetërore të përdoret më shumë kryqëzimi industrial për të prodhuar kafshë mishit «hibride», rendimenti i të cilave në mish është gjithmonë më i madh se në riprodhimin e thjeshtë. Të krijuhen librat shtetërorë të racës në ekonomitë shtetërore dhe kooperativiste që do të merren me përmirësimin e racës së derrit, të gjedheve etj., ku të shënohen të gjitha bagëtitë me prodhim të lartë, koha e ndërzimit, koha kur pritet të pjellë etj.

c) *Të merren masa për të ndaluar humbjet e mëdha që kemi në derra, sidomos në gica.* Gjatë vitit 1957 p.sh. ndërmarrjet bujqësore shtetërore kanë pasur 8,7 për qind ngordhje gicash. Vetëm për 8-mujorin e këtij viti, Ndërmarrja Bujqësore Shtetërore e Gosës (Kavajë) ka pasur 41 për qind ngordhje gicash. Edhe në kooperativat bujqësore humbjet janë shumë të mëdha. Këto dëmtime pengojnë seriozisht shtimin e derrit dhe ndikojnë negativisht në prodhimin e mishit. Për të mënjanuar dëmtimet duhet të sigurohen në radhë të parë kushte të mira strehimi dhe ushqimi për gicat, sidomos në kohën e shkëputjes nga mëma. Në këtë periudhë gicave u mungojnë lëndët kryesore si proteinat dhe kripërat minerale dhe nga kjo mungesë ata mbeten prapa në rritje, dobësohen, preken nga sëmundje të ndryshme dhe shpeshherë ngordhin që në moshë të re.

Prandaj, kur gicat janë në moshë të re, duhet organizuar mirë rritja dhe ushqimi i tyre.

ç) Të marrim sa më shumë mish nga çdo doşë dhe me kosto sa më të ulët. Kostoja e sotme e mishit të derrit është e lartë sa e pengon përhapjen e tij të mëtejshme. Kështu p.sh. për vitin 1958, kostoja e mishit të derrit është planifikuar për ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe për ndërmarrjet e grumbullimit 147 lekë kilogrami (peshë e gjallë). Për arësyte të diferencës së madhe midis kostos dhe çmimit të grumbullimit, ndërmarrjet e grumbullimit në vitin 1956 janë subvencionuar me 35 lekë për çdo kg. mish dhe në vitin 1957 me 11,7 lekë për kg. Ndërmarrjet bujqësore shtetërore për vitin 1958 janë planifikuar për t'u subvencionuar me 47 lekë për kg. mish, duke përfshirë edhe kompensimin e triskave. Por edhe kostoja e mishit të bagëtive të tjera në ndërmarrjet bujqësore shtetërore sidomos për mishin e gjedhit nuk është më e ulët se ajo e derrit. P.sh. kostoja e mishit të gjedhit është 153 lekë kg. peshë e gjallë, ndërsa çmimi i blerjes nga fshatarësia është 56 lekë kg. Kështu, praktikisht, mishi i gjedhit, i prodhuar nga ndërmarrjet bujqësore shtetërore, subvencionohet me 97 lekë për kg. peshë të gjallë, ndërsa mishi i shpendëve subvencionohet akoma më shumë (kostoja është 257 lekë kg., çmimi i blerjes është 110 lekë kg.). Nga këto të dhëna del se edhe me gjendjen e sotme, përgjithësisht mishi i derrit prodhohet me një kosto më të ulët dhe është më i leverdissëm se mishi i bagëtive të tjera. Përveç kësaj, duhet marrë parasysh edhe fakti që rrezja e mishit të derrit, për kthimin e tij

nga pesha e gjallë në peshë të therur, është shumë më e lartë se sa e bagëtive të tjera.

Çfarë masash duhen marrë për uljen e kostos së mishit të derrit. Në radhë të parë, duhet luftuar që gjatë vitit të merren nga çdo dosë jo më pak se 12-15 krerë gica në dy pjellje, të kufizohen harçat që sot mbahen të tepërt dhe për çdo 25-30 dosa të mbahet 1 harç, në vend të 3-5 që mbahen sot. Të dhënët e mëposhtme tregojnë se sa shumë ndikojnë masat e mësipërme në uljen e kostos. Kështu p.sh.:

1) *Kur dosa ka: Kostoja e një gici 10 kg. është:*

5 gica	3 540	lekë
10 »	1 735	»
15 »	1 164	»

2) *Kur kemi 1 harç Kostoja e një gici 10 kg. zbret: për çdo 25-30 dosa
dhe kur dosa ka:*

5 gica	ngë 3 540 lekë	në 3 294 lekë
10 »	» 1 735 »	» 1 612 »

Por nuk janë vetëm këta faktorë që e rritin koston e mishit të derrit. Kostoja e lartë vjen nga se edhe kostoja e ushqimeve që i jepen derrit është e lartë. Duke e mbajtur derrin me ushqime më të lira do të ulet së tepërmë edhe kostoja e mishit të tij. Për uljen e kostos duhet të luftojmë në dy drejtime: nga njëra anë të mbajmë derrin me ushqime që kushtojnë më pak dhe, nga ana tjetër, të luftojmë për uljen e kostos

së bimëve foragjere dhe të koncentrateve. Duhet të përdoren sa më gjërë ushqimet e njoma (sidomos leguminozet) për mbajtjen e derrit. Sa më të tepërtë të jenë këto, aq më pak koncentrate shpenzohen. Kur derrat mbahen në kullota të varfëra, ku mungojnë leguminozet, foragjeret (jonxha) dhe atëhere racionin e tyre duhet ta plotësojmë me ushqime të koncentruara, këto kapin përpjesëtime të mëdha.

Në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe në ato të grumbullimit derri mbahet me ushqime të koncentruara ose të thata, gjë që rrit koston e mishit. Eksperiencia e përparuar, jo vetëm jashtë shtetit, por edhe në vendin tonë, ka treguar se derri mund të rritet edhe me pak koncentrate, duke përdorur shumë ushqime të gjelbëra. Kështu p.sh. Instituti Zooteknik në vitin 1956, duke shfrytëzuar dy pjellje në vit dhe duke i ushqyer me ushqime të bollshme të lëngshme e të gjelbëra, arriti të prodhojë nga çdo dosë 5 kv. mish, duke shpenzuar për çdo kilogram peshë të gjallë 5,41 njësi ushqimore, nga të cilat vetëm 2,9 njësi të koncentruara. Mbeturinat me origjinë shtazore janë shumë të pasura me proteina për ushqimin e kafshëve (miell peshku, miell koskash, gjak, mbeturina thertoresh etj.), prandaj Ministria e Industrisë dhe ndërmarrjet ekonomike që merren me këto lloje prodhimesh duhet të organizojnë sa më parë, brenda vitit 1959, përpunimin e këtyre ushqimeve pranë fabrikave ushqimore.

d) Përveç masave tekniko-organizative të lidhura me një rritje sa më të mirë të derrit, duhen marrë edhe një sërë masash të tjera për të favorizuar përhapjen e konsumit dhe të rritjes së derrit. Kështu p.sh.

industria duhet të zgjerojë assortimentin e sallameve, duke nxjerrë në treg proshutë, suxhuk, salsiçe dhe konserva thjesht prej derri ose të pérziera, me cilësi dhe çmime të ndryshme. Shpejtimi i ngritjes së frigoriferëve do të lejojë që therja e derrave të bëhet në çdo kohë që ka arritur peshën e caktuar. Këto masa kanë rëndësi të madhe, pse do të mënjanohen shpenzimet e mëdha që bën shteti për mbajtjen e derrit të gatshëm për therje për një kohë të gjatë, duke shpenzuar ushqime pa shtuar në peshë.

Organet e tregëtisë duhet të futin në menytë e restoranteve dhe të mensave gjellë me mish derri të preqatitura në mënyra të ndryshme dhe të shijshme, për t'u përdorur gjatë gjithë viti dhe që të pëlqehen nga klientët. Të vihen rregulla në shitjen e mishit të therur të derrit dhe të vendosen çmime të diferencuara për mishin me ose pa dhjamë, sipas kërkesës së blerësve. Nga përllogaritjet e bëra del se në vendin tonë rrëth 25 për qind e mishit që konsumohet mund të jetë prej derri, pa llogaritur këtu sallon. Duhet të bëhet një punë e madhe në organizimin e shitjes dhe të konsumit të mishit të derrit.

Nga sa u tha më lart del se derri është një kafshë me mundësi të madhe për shtimin e prodhimit të mishit dhe është një kafshë e leverdisshme, prandaj duhen kritikuar Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë e komitetet ekzekutive të rrëtheve dhe drejtuesit e kooperativave bujqësore, që nuk janë kujdesur për përhapjen e shpejtë të derrit. Partia duhet të marrë në dorë problemin e shtimit të derrit dhe të kapërcehen të gjitha vështirësitë që pengojnë zgjidhjen e kësaj detyre.

9) Nga rritja në shkallë të gjerë e shpendëve do të sigurojmë jo vetëm sasi të mëdha mishi, por edhe vezë.

Mundësi shumë të mëdha ka në vendin tonë për shtimin, jo vetëm të pulave, por edhe për shtimin e pulave të detit dhe sidomos të shpendëve të ujit, veçanërisht të patave dhe të rosave. Nga shpendët mund të sigurojmë mish dhe vezë, që janë ushqime shumë të rëndësishme për popullin, por ato, sidomos pulat dhe pulat e detit, janë të domosdoshme për bujqësinë, sepse pastrojnë tokën nga mjaft larva insektesh e parazitësh të dëmshëm për bimët, kurse rosat dhe patat janë luftrues të mirë kundër larvave dhe parazitëve të ujit. Edhe puplat e shpendëve, megjithëse te ne nuk përdoren sa duhet, kanë një vlerë të madhe dhe plehu i shpendëve është mjaft i efektshëm për rritjen e prodhimit bujqësor.

Shpendët në vendin tonë janë shumë pak të zhvilluara. Në fund të vitit 1957 te ne numëroheshin një milion e 200 mijë krerë shpendë, ose 15,8 për qind më shumë se në vitin 1938. Në vitin 1957 për çdo 100 ha. drithëra si Republikë kemi pasur 377,1 krerë shpendë, ndërsa ndërmarrjet bujqësore shtetërore 286,7 dhe kooperativat bujqësore (shpendë kolektive) vetëm 60 krerë. Sipas rretheve, ngarkesën më të madhe për 100 hektarë drithëra e kanë rrëthet: Tropojë, Mat, Lushnjë, ish-qarqet: Shkodër, Gjirokastër, Elbasan si dhe rrethi i Vlorës që ka pasur 400-562 krerë për çdo 100 hektarë. Në rrëthet: Fier, Peshkopi, Kukës dhe Berat ka pasur rrëth 300-390 krerë për çdo 100 hektarë, ndërsa në

rrethin e Durrësit, në ish-qarkun e Korçës dhe në rrethin e Skraparit ka pasur 220-280 kërë për çdo 100 hektarë.

Sic shikohet numri i shpendëve qoftë sipas sektorëve, ashtu edhe për çdo 100 hektarë, sipas rretheve është shumë i paktë. Sikurse për të gjitha llojet e tjera të bagëtisë, ashtu edhe për shpendët do të duhet një punë e madhe për të realizuar detyrat e planit të vitit 1960. Duhet të luftohet që të shtohet jo vetëm numri i shpendëve, por edhe prodhueshmëria në mish dhe në vezë; të shtohen sidomos shpendët ujëse dhe pulat e detit që janë shumë të kufizuara, megjithëse në vendin tonë gjejnë kushte të përshtatshme.

Në kushtet tona, vëmendja kryesore duhet përqëndruar në luftimin e sëmundjeve të shpendëve, e kryesisht kundër pseudopestit. Kjo sëmundje vite me radhë ka shkaktuar dëme të mëdha. Duhet të themi se shërbimi veterinar në bazë dhe Instituti i Veterinarisë nuk e kanë bërë detyrën si duhet. Ndryshe nuk ka si të shpjegohet që gjatë vitit 1957 në ndërmarrjet bujqësore shtetërore të ngordhin mbi 32 për qind e kërëve të shpendëve dhe në kooperativat bujqësore 62,2 për qind. Një gjendje e tillë duhet t'i preokupojë seriozisht organet e shërbimit veterinar dhe kryesisht Institutin e Kërkimeve Veterinare. Mjetet për luftimin e sëmundjeve ekzistojnë, por duhet organizuar më mirë vaksinimi periodik.

I palejueshëm është qëndrimi që mbajnë kryesitë e kooperativave bujqësore ose ekonomitë private në çastin kur shërbimi veterinar shkon për të marrë masat profilaktike. Nga pikëpamjet e gabuara që ata kanë për

shpendët, duke i nënveftësuar si një sektor pa leverdl, nuk interesohen të luftojnë kundër sëmundjeve të shpendëve. Edhe në ndërmarrjet bujqësore shtetërore në përgjithësi nuk u krijojnë shpendëve kushtet më elementare të strehimit dhe të ushqimit. Në kooperativat bujqësore shpendët akoma vazhdojnë të mbahen keq, në natyrë të hapur, pa asnjë mbrojtje nga të ftohit dhe nga egërsirat. Shumë kooperativa bujqësore shpeshherë tërheqin zogj nga inkubatorët, jo sepse e ndjejnë nevojën e rritjes së shpendëve pér forcimin e ekonomisë së tyre, por sepse e kanë të planifikuar. Ndryshe nuk ka si të shpjegohet fakti që kooperativa e Bërzhitës (në rrëthim e Tiranës) tërhoqi në pranverë nga inkubatori 1 000 zogj dhe rriti prej tyre vetëm 93 krerë. Kur vajtën specialistët, pér ta kontrolluar gjendjen në vend, panë se edhe pulat që kishin ngelur ishin mbushur me parazitë. Kuptohet se në këtë kooperativë mungon fare kujdesi pér shpendët.

Një bazë e rëndësishme pér shtimin e shpendëve është shfrytëzimi i mirë i inkubatorëve. Në Ndërmarrjen Zooteknikë të Tiranës ka 9 inkubatorë me kapacitet 180 000 vezë në çdo shtruarje. Përveç kësaj qendre të madhe, janë edhe 2 qendra inkubatorësh pér 40 000 kokrra vezë. Këta inkubatorë akoma nuk po shfrytëzohen si duhet. Gjatë vitit 1957 u çelën vetëm 257 000 vezë, ndërsa sivjet, deri në gusht, ishin çelur 470 000 vezë, kurse mundësitet janë të nxirren çdo vit, në rast se inkubatorët shfrytëzohen gjithë vitin, jo më pak se një milion e gjysmë zogj. Ministria e Bujqësisë duhet të marrë masa pér shfrytëzimin e plotë të inkubatorëve.

Por, shtimin e shpendëve nuk duhet ta mbështetim

vetëm te inkubatorët. Duhet që të gjitha kooperativat bujqësore dhe ekonomitë private, pavarësisht nga kontingjentet e zogjve që tërheqin nga inkubatorët, të shtrojnë periodikisht një numër të madh kloçkash. Është e këshillueshme që për këtë qëllim të përdoren më tepër pulat e detit, të cilat mund të shtrohen 2-3 herë në vit me jo më pak se 17 kokrra vezë pulash. Duhet t'i vihet rëndësi përhapjes së pulës së detit, patës dhe rossës, për të cilat vendi ynë ka kushte të favorshme dhe traditë të mirë. Pulat e detit, patat dhe sidomos rosat janë një burim i madh për prodhimin e mishit të shpendëve.

Eksperiencia e ekonomive të përparuara tregon se pulat e detit japid sasi të mëdha mishi. Kështu p.sh. kolkozi «Maksim Gorki» ndërsa në vitin 1956 mori 9,8 kv. mish pulë deti për çdo 100 ha. tokë buke, në vitin 1957 mori 29 kv. Në këtë kolkoz nga çdo pulë deti rriten jo më pak se 10-12 zogj, të cilët së bashku në fund të vitit japid 50-70 kg. mish peshë e gjallë. A nuk del qartë se një pulë deti jep më shumë mish nga sa japid **2** dele? Dihet se mishi i pulës së detit është shumë më i shijshëm në ngrënje se mishi i deles dhe ka vlerë më të madhe. Përse të mbahet ky qëndrim ndaj pulës së detit? E vlen që të mos i nënveftësojmë pulën e detit dhe shpendët në përgjithësi. Partia dhe organet e bujqësisë duhet të studjojnë mundësitë që kanë kooperativat bujqësore për rritjen e pulës së detit dhe të planifikohet rritja e tyre në masë sidomos në Myzeqe, në Elbasan dhe në gjithë zonën bregdetare.

Eksperiencia e përparuar e rritjes së shpendëve duhet të bëhet mësim për të gjithë. Shpendët rriten me

fare pak shpenzime, ushqimi më i mirë i tyre janë ushqimet e gjelbëra, hasëllat, jonxhishtet, misri foragjer i grirë. Për rritjen e tyre shfrytëzohen edhe mbeturinat e industrisë së peshkut dhe të thertoreve etj. Duhet të krijohen kushte higjenike të përshtatshme sëdomos për pulat dhe pulat e detit që të ruhen shumë nga lagështia, pse preken shpejt nga sëmundjet. Këto masa janë të mundshme. Është e domosdoshme që organet e Partisë dhe të pushtetit të punojnë që kooperativat bujqësore të krijojnë fermat e shpendëve, duke u kujdesur vazhdimit për rritjen e tyre me leverdi ekonomike sa më të madhe.

10) Rritja e lepurit ka një rëndësi të veçantë për ekonominë e familjes dhe si rrjedhim për mbarë ekonominë e vendit.

Lepuri i butë është një nga kafshët bujqësore të dobishme, pse prej tij merren mishi, lëkura, gëzofi dhe leshi, të gjitha këto, prodhime jashtëzakonisht të çmuëshme. Është për këto arësy që shumë shtete tregojnë një kujdes të madh për përhapjen e lepurit.

Në vendin tonë lepuri rritet shumë pak, vetëm nga ekonomi të veçanta. Për numrin e lepujve, nuk ka të dhëna zyrtare.

Lepuri shtohet dhe rritet shumë shpejt, mbahet me ushqime që sigurohen relativisht lehtë, prodhon mish të shijshëm dhe në sasi relativisht të mëdha. Mjafton të përmendim se nga një lepur mund të merren minimumi 6 pjellje në vit, me jo më pak se 5-6 lepurushka, të cilët në moshën 5-6 muajshe arrijnë mesatarisht 1,5-2

kg. peshë e gjallë. Kjo do të thotë që një femër e rritur të jep rrëth 50-60 kg. mish në vit. Zhvillimi i lepurit do t'u sjellë të ardhura rritësve si nga mishi ashtu edhe nga lëkura që është shumë e vlefshme.

Le të marrim të gjitha masat që lepuri të përhapet në vendin tonë dhe të bëhet një kafshë bujqësore e zakonshme, jo vetëm për ekonomitë familjare, po edhe për kooperativat bujqësore. Ekonomitë e qyteteve që kanë nga një copë kopësht dhe kanë mbeturina permesh, qendrat e punës, të gjitha shkollat fillore, 7-vjeçare, të fshatit dhe të qytetit, si dhe të gjitha shkollat bujqësore e profesionale, duhet të merren me rritjen e lepurit. Shumë mirë mund të marrë si aksion rinia përhapjen e lepurit, veçanërisht në shkollat e fshatit dhe të qytetit.

Për sigurimin e bazës materiale, organet e Partisë dhe të pushtetit duhet të kujdesen që t'i përkrahin ato ekonomi që kanë sot lepuj për t'i shtuar këta dhe për t'i shpërndarë pastaj në ekonomitë e tjera. Edhe shkollat që sot disponojnë lepuj t'i shtojnë këta dhe të ndihmojnë edhe shkollat e tjera që të krijojnë këndin e rritjes së lepurit.

Ministria e Bujqësisë nga ana e saj duhet të marrë masa të krijojë 3 baza për rritje lepujsh në ndërmarrjet bujqësore shtetërore, të cilat të kenë si detyrë prodhimin e lepurit për t'ua furnizuar shkollave, qendrave të punës dhe kooperativave bujqësore, lepuj për nevojat e tyre dhe për të furnizuar ekonomitë bujqësore dhe shkollat në afërsi. Me qëllim që të përhapet shumë lepuri, Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Tregëtisë të marrin masa që në vitin 1959 të sjellin rrëth 500 cifte

nga jashtë nga racat më të përshtatshme për mish. Ministria e Bujqësisë të nxjerrë broshura dhe material tjetër propagandistik për rritjen e lepujve. Kooperativat e artizanatit të vënë në planin e prodhimit të tyre pregetitjen e koteceve për lepuj për t'i vënë në shitje.

11) Organizimi i mirë i gjuetisë është një burim nga ku mund të sigurohet një sasi e mirë mishi.

Vendi ynë, në sajë të reliefit të tij të shumëlojshëm, bimësisë së pasur dhe klimës së favorshme, është i pasur në gjah. Por gjuetia te ne është organizuar dobët. Duke u bazuar në të dhënat e grumbullimit, rezulton se gjatë vitit 1957 janë dorëzuar nga gjuetarët pak më shumë se 53 000 copë lëkura lepujsh. Nga kjo llogaritet që të janë gjuajtur rrëth 160 ton mish lepuri në vit. Natyrisht, kjo nuk është e plotë, sepse shumë lëkura janë prishur ose nuk janë dorëzuar fare në grumbullim. Nga specialistët çmohet se çdo vit mund të janë siguruar edhe rrëth 70 ton mish nga gjuetia e rosës, e patës së egër, e derrit të egër dhe e llojeve të tjera. Si shumë e përgjithshme, pra, sot sigurohen rrëth 230 ton mish gjahu. Pjesa më e madhe e këtij mishi përdoret nga vetë gjuetarët, kurse në treg janë dorëzuar vetëm 7,8 ton (3,5 për qind e mishit të vrarë).

Vendi ynë ka mundësi të sigurojë nga gjuetia deri 400 ton mish. Po për këtë qëllim duhet të organizohet më mirë gjuetia e kafshëve të egra. Në radhë të parë, duhet të rishikohen rregullat dhe ligjet mbi gjuetinë dhe të kërkohet zbatimi i përpiktë i tyre. Nuk duhet të lejohet shkelja e ligjit dhe e rregullave të gjuetisë nga

asnjeri. Personeli pyjor duhet të jetë i rreptë ndaj atyre që shkelin rregullat e gjuetisë. Përsa i përket mishit të gjahut duhet vënë rregull që të mos shpërdorohet, por t'i ngelet shtetit. Gjuetari, që vret gjahun, do të përfitojë mish aq sa përcaktojnë rregullat dhe ligjet e posaçme të gjuetisë. Duhet forcuar Shoqata e gjuetarëve dhe organet e tregëtisë të sigurojnë nga importi matrialet e nevojshme për gjuetinë.

Ministria e Bujqësisë dhë Shoqata e gjuetarëve të marrin masa që të shpejtohet kolonizimi i fazanit, në të gjithë zonën bregdetare, duke sjellë, po qe nevoja, brenda vitit 1959 nga Rumania 500 fazanë të tjerë. Të fillohet në ndonjë qendër të caktuar rritja e drerit brilopatë, i cili jep shumë mish dhe u përshtatet më së miri kushteve të vendit tonë. Për këtë qëllim të sigurohet në vitin e ardhshëm importimi i 30 krerëve drerë brilopatë për të krijuar bazën e shtimit dhe të përhapjes së tyre. Me qëllim që të krijohet baza për shtimin e gjuetisë, qeveria të caktojë zonat e rezervuara për gjuetinë, llojin e kafshëve të egra që do të rriten në to, si dhe detyrat për shtimin e tyre.

12) Organizimi i mirë i rritjes dhe i gjuetisë së peshkut ka rëndësi të madhe për ekonominë popullore. Peshku duhet të plotësojë në një masë më të madhe nevojat e popullit, sidomos tani që sasia e mishit është akoma e kufizuar.

Nuk ka dyshim se vendi ynë, si vend bregdetar, me lumenj, liqene dhe këneta të shumta, ka peshk dhe mund të organizohet shumë mirë rritja dhe gjuetia e

tij. Duhet thënë se në gjuetinë e peshkut jemi akoma shumë prapa. Pak kujdes tregohet për rritjen dhe për gjuetinë e peshkut, megjithëse Partia e ka ngritur me forcë të madhe kujdesin e veçantë që duhet të tregohet për këtë sektor. Sasia e peshkut që gjuhet çdo vit ka pasur rritje, po kjo rritje është akoma e vogël. Në vitin 1951 janë zënë gjithsejt 1 600 ton peshk. Me pak zigzage, prodhimi i peshkut ka mbetur në këtë nivel deri më 1957, kur gjuetia e peshkut arriti në afro 2 800 ton. Kjo sasi peshku nuk u përgjigjet aspak mundësive reale të peshkut, që rritet në ujërat e vendit tonë.

Plani i dytë pesëvjeçar parashikon që në vitin 1960 të zihet 6 350 ton peshk, ndërsa nga studimi i planit perspektiv ka dalë se më 1965 duhet të zihen afro 12 000 ton peshk. Kjo detyrë është plotësisht e realizueshme, në qoftë se problemi i peshkimit do të konsiderohet si një problem i madh që ka të bëjë me plotësimin e nevojave ushqimore të punonjësve. Pesha më e madhe e këtij plani rëndon në Ndërmarrjen Shtetërore të Peshkimit, e cila duhet të japë rreth 80 për qind të sasisë së planit të peshkut. Po a vlerësohet si duhet nga të gjithë ekonomia e peshkut? Jo. Sa kujdes tregon Partia për ekonominë e peshkut dëshmon fakti se në vendin tonë është ngritur një kombinat i madh përpunimin e peshkut. Në të ardhshmen do të ngrihet edhe një fabrikë tjetër konservash. Për peshkun janë siguruar mjete moderne gjuetie, janë preqatitur kuadro, janë bërë studime të posaçme mbi ekonominë e peshkut në vendin tonë. Ndërmarrja Nationale e Peshkimit sot është pajisur me mjetet e nevojshme të gjue-tisë së peshkut.

Ku qëndrojnë atëhere arësyet që plani i peshkut nuk realizohet? Arësyet kryesore qëndrojnë se ekonomia e peshkut nuk shikohet nga të gjithë si një burim i rëndësishëm me shumë leverdi dhe të organizohet rritja dhe gjuetia e peshkut, jo vetëm në det sikurse bëhet sot, por kudo, në bregdet, në liqene, në lumenj e këneta. Të organizohet rritja e peshkut në kooperativat bujqësore, në këneta të posaçme artificiale dhe në orizore. Duhet nga të gjithë, sidomos nga organet e push-tetit dhe të Partisë në bazë, të merret më mirë në dorë ekonomia e peshkut dhe të merren masa që plani i peshkut jo vetëm të realizohet por, të hidhen baza që në të ardhshmen, peshku të zërë një peshë të madhe në furnizimin e popullit.

Neve sot na mungon një studim mbi mundësitë e zhvillimit, të rritjes dhe të gjuetisë së peshkut, sidomos në ujërat e brendshme dhe për rritjen artificiale të tij. Këto studime kanë rëndësi të madhe për t'i plotësuar detyrat vjetore të planit edhe për perspektivën e peshkut.

Ne duhet të investojmë më shumë për peshkun, sidomos në dajlanet, në ujërat e brendshme dhe për rritjen artificiale të tij. Duhet t'i kushtojmë kujdes akoma më të madh jo vetëm pregetitjes së më shumë kuadrove specialistë për peshkun, por edhe çështjes që punëtorët e peshkimit ta njohin mirë sektorin e punës së tyre, të dinë metodat e reja të gjuetisë së peshkut, të njohin mirë llojet e peshqve, të jenë punëtorë të përhershëm. Neve na duhet ta rishikojmë sistemin e shpërblimit të punonjësve të peshkimit, që të lidhen më shumë me prodhimin.

Vendosja e një regjimi të fortë në gjuetinë e

peshkut sidomos në ujërat e brendshme është kusht i domosdoshëm. Nga pakujdesia, gjuetia e peshkut në këto ujëra bëhet me mjete të dëmshme dhe jo në kohë të caktuar. Kjo bën që peshku i ujërave të brendshme të dëmtohet rëndë dhe të shkojë gjithmonë duke u pakësuar.

Sipas llogaritjeve të specialistëve, afro 20 për qind e peshkut të parashikuar për vitin 1965 do të zihet në ujërat e brendshme. Për të sigruar këtë prodhim që është disa herë më i madh nga sasia që peshkohet sot, duhen marrë një sërë masash të rëndësishme.

Në radhë të parë duhet përfunduar studimi dhe të tillohet ndërtimi i stacioneve të posaçme për popullimin e liqeneve kryesore. Jo më vonë se në vitin 1961 në Liqenin e Pogradecit duhet të ketë përfunduar ndërtimi i stacionit ku mund të zihen deri në 140 ton peshk më shumë. Po brenda kësaj kohe duhet të merren masa për të bërë sistemimin e tre përrrenjve kryesorë që derdhen në liqen, si Peskupat, Katjel dhe Homezh. Në Liqenin e Shkodrës, që zë vendin kryesor midis liqeneve përsa i përket peshkut edhe në të ardhshmen parashikohet një rritje e madhe e prodhimit (750 ton më 1965), duhet rregulluar dajlani dhe duhet përmirësuar rrënjosht sistemi i peshkimit. Në Liqenin e Prespës duhet sigruar baza materiale dhe të merren një sërë masash përmirësuese. Në kënetën e Nartës, të Karavastasë dhe në atë të Lezhës ka mundësi të gjuhet shumë peshk, po duke thelluar dhe duke zgjerruar grykat që i lidhin këto me detin. Kjo punë duhet të kryhet patjetër sidomos tashti me zbatimin e projektit të bonifikimeve të këtyre zonave. Në mënyrë të

konsiderueshme mund të shtohej zënia e peshkut në Murtepsë, ku, sipas llogarive të specialistëve, prodhimi mund të rritej 4 herë (nga 50 në 200 ton). Për këtë do të duhej që të hapej vau i Bunës, të thellohej e të zgjerohej kanali artificial Murtepsë-Vilun, të bëheshin disa kanale ndërlidhëse, barazhe etj. Duhet studjuar brenda këtyre dy vjetëve rritja e peshqve në Liqenin e Ulzës dhe në shumë liqene të tjera malore në Veri. Shumë peshq mund të rriten në Liqenet e Belshit, si edhe në kënetën e Thanës. Qeveria duhet të marrë masa që të fillohet sa më parë nga puna për rritjen e peshqve në këto liqene, duke parashikuar në plan për këtë punë fondet dhe mjetet e nevojshme.

Gjuetia e peshkut nuk duhet të kufizohet si deri sot në ndërmarrjet shtetërore të peshkimit dhe në kooperativat e peshkimit. Sot në të gjitha zonat ku ka peshk janë ngritur kooperativa bujqësore, të cilat kanë forca dhe mundësi të organizojnë gjuetinë e peshkut. Përse të mos nxiten këto kooperativa që të merren edhe me këtë punë? Ka ardhur koha që kooperativave bujqësore t'u ngarkohen detyra për gjuetinë e peshkut në ujërat që ndodhen pranë tyre. Kooperativave bujqësore buzë liqeneve dhe lumenjve dhe kooperativave bujqësore bregdetare etj., pa i larguar nga bujqësia, t'u jepet e drejta për të krijuar brigada peshkimi, duke caktuar në kontrata detyrat reciproke për zënien dhe për shitjen e peshkut. Kjo punë duhet bërë që në fillim të vitit 1959. T'u caktohen në plan kooperativave bujqësore, që kanë ujëra në afërsitë e tyre, që të zënë rrëth 300 ton peshk dhe në vitin 1965 të zënë 350-400 ton, që përfaqëson 16 për qind të sasisë së peshkut të

parashikuar për t'u zënë në ujërat e brendshme të Republikës.

Eksperiencia e shumë vendeve, sidomos eksperiencia e Kinës, ku për çdo hektar tokë të kultivuar me peshk merren rreth 40 kv. peshk, na mëson se çfarë punë e madhe mund të bëhet në kooperativat bujqësore që kanë ujë. Te ne ka shumë kooperativa që mund ta bëjnë këtë punë, vetëm se duhen mësuar, duhet të organizohet ekonomia e tyre, të rritin peshkun, të krijojnë pellgje artificiale nga ku do të sigurojnë shumë të ardhura.

Për t'ia filluar sa më shpejt kësaj pune të ngarkohet qeveria të kërkojë nga Republika Popullore e Bullgarisë, e cila ka rezultate të mira dhe eksperiençë në këtë drejtim, ose nga Republika Popullore e Kinës, të na dërgojnë një grup specialistësh për të ndihmuar në organizimin e ekonomisë të rritjes së peshkut pranë kooperativave bujqësore, si dhe për ngritjen e stacioneve të kultivimit të peshkut. Për t'i shtuar rezervat e peshkut, sidomos në ujërat e brendshme, duhet të merren masa duke i populluar me të vegjël të rritur në mënyrë artificiale. Është e nevojshme të thërriten nga jashtë specialistë si dhe të dërgohen jashtë njerëzit tanë për specializim që të merren me organizimin dhe riprodhimin gjysmartificial të peshkut, si dhe duke futur lloje peshqish me vlerë ekonomike më të madhe, si nga ana e sasisë ashtu edhe nga ana e cilësisë.

Në ujërat e pellgjeve artificiale të merren masa për të zhvilluar një kulturë më intensive të peshkut, duke përdorur edhe ushqimin artificial. Kështu mund të zhvillohej kultura e troftave, që është më rentabel se

çdo kulturë tjetër (jep 5 000 kg./ha. edhe më tepër). Për këtë qëllim që në vitin 1960 në katundin Lin të Pogradecit dhe më vonë në Virua të Gjirokastrës të fillohet nga puna për ngritjen e stacioneve të rritjes artificiale të peshkut dhe brenda vitit 1965 të organizohen pranë kooperativave bujqësore që do të studjohen më të përshtatshme, për të kultivuar artificialisht në një sipërfaqe prej 20 hektarësh tokë, rritja e koranit dhe e troftës, të cilat mund të sigurojnë një prodhim rrreth 4 000 kg. për hektar.

Për t'i përballuar me sukses detyrat e mëdha lidhur me zgjerimin shumë të madh të prodhimit të peshkut të ngarkohet Komisioni i Planit të Shtetit dhe Ministria e Industrisë që të studojnë nevojat për preqatitjen e kuadrit dhe të merren masa për plotësimin e tij. Me qëllim që të shpejtohet puna e preqatitjes së kuadrit, që në vitin e ardhshëm, të parashikohet dërgimi i 15 të rinxve, për t'u specializuar për rritjen dhe gjuetinë e peshkut, në një nga demokracitë populllore. Ministria e Bujqësisë të marrë masa që në shkollat bujqësore të futë në programin e mësimit edhe lëndën mbi rritjen e peshkut, në mënyrë që kuadrot bujqësorë, kryesisht ata të kooperativave, të kenë dijenitë elementare mbi shumëzimin dhe zënien e peshkut në ujërat e brendshme. Pranë ndërmarrjeve të peshkimit të merren masa të organizohen kurse 6-mujore (ose më shumë) me njerëz të rritur.

Të ngarkohet qeveria që të marrë masat e nevojshme për ngritjen e stacioneve të peshkut dhe për plotësimin e bazës materiale për to. Stacioni i kërkimeve shkencore për ekonominë e peshkut që varet nga

Ministria e Industrisë të bëjë studime të hollësishme për studimin e ujërave dhe të vendeve ku mund të ngrihen pellgje artificiale për kulturën e peshkut. Komitetet ekzekutive të rretheve dhe komitetet e Partisë, me ndihmën e specialistëve të peshkimit, të studjojnë mundësitë e shtimit dhe të organizimit më mirë të gjuetisë së peshkut brenda juridikSIONIT të tyre dhe të marrin masa për të shtuar prodhimin e peshkut.

III

MBI MASAT PËR SHTIMIN E PRODHIMIT TË QUMSHTIT

Sikurse u vu në dukje, që në fillim të raportit, për arësyen të prodhimit të paktë të qumshtit, që është rezultat i prodhueshmërisë së ulët të blegtorisë në vendin tonë, sasia e qumshtit që konsumon çdo frymë në vit është mjaft e ulët dhe e pamjaftueshme për nevojat e popullit. Ne duhet t'i sigurojmë popullit, jo vetëm qumëshët në sasi të bollshme, por edhe prodhime të tjera ushqimore të nxjerra nga qumshti, si djathë, gjizë, gjalpë, kos etj. Duhet thënë se për të plotësuar këto nevoja jemi akoma shumë larg nga detyra që shtron sot Partia. Qumshti për nevojat e popullit nuk gjendet në çdo stinë të vitit dhe kjo e metë rrjedh sepse ekonomia jonë blegtoreale, si trashëgim i së kaluarës, përbëhet në shumicë prej bagëtish të imta, të cilat sigu-

rojnë qumësht vetëm në një periudhë të caktuar të vitit, jo më shumë se 4 muaj në vit, ndërsa lopa, nga e cila do të merrej qumësht gjatë gjithë stinës së vitit, jo vetëm që është në numër të kufizuar, por edhe prodhueshmëria e saj është shumë e ulët. Shkaku është se kujdesi për lopën deri kohët e fundit ka qenë fare i pamjaftueshëm.

Si kemi ecur me prodhimin dhe me grumbullimin e qumshtit gjatë këtyre vjetëve të fundit?

Viti	Prodhimi në ton	Grumbullimi në ton
1955	124 344	13 674
1957	137 753	17 578
1958 (sipas planit)	162 000	33 684

Në tabelë është llogaritur në qumësht edhe sasia e djathit, e gjalpit etj., të prodhuar gjatë viteve përkatëse.

Nga pasqyra duket qartë rritja nga viti në vit e prodhimit dhe e grumbullimit të qumshtit. Megjithëse plani i vitit 1958 nuk do të realizohet plotësisht, duhet thënë se këtë vit është bërë një punë e madhe, si nga ana e Partisë dhe e organeve të pushtetit, ashtu edhe nga organet e grumbullimit dhe të përpunimit të qumshtit. Këtë 9-mujor, në krahasim me vitin 1957, u grumbulluan 6 910 ton qumësht më shumë. Për punë të kujdeshshme në realizimin e planit të grumbullimit të qumshtit janë për t'u lavdëruar rrëthi i Durrësit, i

cili deri tani e realizoi planin e grumbullimit 117,5 për qind, rrëthi i Tiranës — 110,2 për qind, rrëthi i Skraparit — 101,9 për qind, rrëthi Bajram Curri — 144,4 për qind.

Dallohen për prodhueshmëri të lartë të qumshtit për çdo kokë sidomos në lopët, ekonomitë bujqësore shtetërore, në krahasim me ekonomitë kooperativiste dhe ato private. Vitin e kaluar ndërmarrjet bujqësore shtetërore prodhuan për çdo kokë lopë mijërise 1 450 litra qumësht më shumë se mesatarja e prodhimit për çdo lopë në kooperativat bujqësore dhe këtë vit ato i dorëzojnë shtetit 17,9 për qind të gjithë sasisë së qumshtit që grumbullohet në Republikë. Sikurse shihet, ndërmarrjet bujqësore shtetërore, me gjithë numrin e paktë të blegtorisë në krahasim me blegtorinë e Republikës, luajnë një rol të rëndësishëm në furnizimin e qyteteve me qumësht dhe dallohen përpëra ekonomive kooperativiste dhe individuale për prodhueshmërinë e lartë të qumshtit për çdo lopë.

Shembulli i ndërmarrjeve bujqësore shtetërore përsa i përket prodhimit të qumshtit nga çdo lopë, si dhe shembulli i shumë ekonomive bujqësore kooperativiste dhe private që marrin prodhime të larta qumshti për çdo dele ose dhi, dëshmojnë mbi mundësitet e mëdha që ekzistojnë në vendin tonë për shtimin e qumshtit për nevoja të popullsisë brenda një kohe të shkurtër.

Partia duhet të luftojë që për çdo 100 hektarë tokë bujqësore të merren mesatarisht jo më pak se 282 kv. qumësht, d.m.th. 157 kv. qumësht më shumë nga sa është marrë në vitin 1957.

Realizimi i kësaj detyre do të jetë një fitore e ma-

dhe, pse brenda një periudhe të shkurtër ne do t'u afro-hemi normave të rekomanduara për ushqimin e njeriut.

Ku duhet ta përqëndrojmë kujdesin e veçantë për shtimin e qumshtit?

1) Në ngritjen e prodhueshmërisë së qumshtit për çdo kokë bagëti pëlleja që është rezervë kryesore për shtimin e qumshtit. Shtimi i numrit të krerëve të blegtorisë, sidomos shtimi i numrit të bagëtive pëlleja dhe rritja e përqindjes së pjellshmërisë së tyre, janë të tjera rezerva të rëndësishme ku Partia, organet e pushtetit dhe të bujqësisë, kooperativistët dhe rritësit e blegtorisë duhet të përqëndrojnë vëmendjen për shtimin e qumshtit.

2) Në shtimin e bagëtisë kolektive në kooperativat bujqësore, numri i të cilave sot është mjaft i kufizuar në krahasim me mundësitet që ato kanë. Kjo duhet të konsiderohet si një nga detyrat më të rëndësishme të Partisë, jo vetëm për shtimin e prodhimit të qumshtit, por edhe të mishit dhe për zhvillimin e blegtorisë në përgjithësi.

3) Në shtimin e numrit të lopëve, sidomos në kooperativat bujqësore dhe në ngritjen e prodhueshmërisë së qumshtit për çdo lopë. Kjo është rezerva më e madhe ku duhet të mbështetemi për realizimin e detyrës që shtrohet për të rritur sasinë e qumshtit për frymë. Nga lopa, sipas detyrës që caktohet, ne duhet të sigurojmë 62 për qind të sasisë së përgjithshme të qumshtit që mendohet të prodhohet në fund të pesëvjeçarit të tretë.

Në krahasim me vitin 1956, në vitin 1965, ne duhet të kemi më shumë: 86 000 krerë lopë mijëlëse ose 75 për

qind më shumë; 373 000 krerë dhen pëlleja ose 33 për qind më shumë; 447 000 krerë dhi pëlleja ose 68 për qind më shumë se gjendja e vitit 1956. Duke rritur numrin e bagëtive pëlleja do të krijohen kushte të përshtatshme për shtimin e shpejtë të blegtorisë, për përmirësimin e shpejtë të racës dhe për të shtuar së tepërmë prodhimin e qumshtit. Sikurse shihet, megjithëse numri i lopëve pëlleja është shumë i vogël, në krahasim me bagëtitë pëlleja të imta, lopa do të mbajë peshën kryesore të planit të qumshtit që parashikohet.

Te lopa gjejmë rezervën më të madhe për rritjen e prodhimit të qumshtit për çdo kokë, në krahasim me rritjen vjetore të bagëtive të imta. Shtrohet detyra që në vitin 1965 të merret mesatarisht nga çdo lopë 1 250 kg. qumësht ose 660 kg. më shumë nga sa është prodhuar për vitin 1957; për buallicat 500 kg. ose 50 kg. më shumë nga viti 1957; për delet 44 kg. ose 4 kg. më shumë, për dhitë 72 kg. ose 10 kg. më shumë nga viti 1957.

A mund të realizohen këto rendimente që parashikohen për vitin 1965?

Eksperienca e qindra ekonomive shtetërore dhe kooperativiste të përparuara na bind se ka mundësi të mëdha që të plotësohet dhe të tejkalohet kjo detyrë që shtron Partia. Në ndërmarrjet bujqësore shtetërore çdo vit shohim një rritje të dukshme të qumshtit për çdo lopë. Kështu p.sh. prodhimitaria mesatare e qumshtit është rritur nga 1 300 kg. që ka qenë në vitin 1951, në 1 530 kg. në vitin 1957. Ndërmarrja Bujqësore Shtetërore e Maliqit gjatë kësaj periudhe e ka ngritur rendimentin e qumshtit të lopëve nga 640 kg. në 1 577 kg., ajo e Kamzës — nga 1 590 kg. në 2 357 kg. etj. Rezultate të

mira kanë arritur edhe mjaft kooperativa bujqësore, si ajo e Dobraçit në rrëthin e Shkodrës që gjatë periudhës dhjetor 1957 — shtator 1958, ka marrë për çdo lopë foragjere 1 352 kg. në krahasim me 1 093 kg. që ka marrë gjatë gjithë viti 1956. Kooperativa bujqësore e Zharrezës, në rrëthin e Fierit, ka marrë gjatë 8 muajve të këtij viti 1 100 kg. qumësht. Kooperativa e bahçevanëve në Vlorë vitin e kaluar mori 1 200 kg., ajo e Çepratit po në Vlorë mori 1 600 kg. qumësht për çdo lopë dhë kooperativa e qytetit të Korçës — 1 700 kg.

Shembuj bindës mbi mundësinë e ngritjes së prodhimitarisë së qumshtit në lopë kemi në Institutin Zooteknik të Shkodrës, ku në tufën e lopëve shkodrane ajo është ngritur nga 1 172 kg. që ishte në vitin 1948 në 1 922 kg. në vitin 1951 për çdo lopë foragjere. Gjatë 9 muajve të këtij viti për çdo lopë foragjere në institut është prodhuar 1 787 kg. d.m.th. 182 kg. më shumë se sa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Është rritur prodhueshmëria e qumshtit edhe në kafshët e imta. Shumë kooperativa bujqësore mjelin mesatarisht mbi 50 kg. qumësht për çdo dele, siç janë kooperativa bujqësore «Asim Zeneli» dhe ajo e Erindit në rrëthin e Gjirokastrës, ndërsa kooperativa bujqësore e Zervatit në rrëthin e Gjirokastrës merr mesatarisht për çdo kokë nga tufa e dhive 110 kg. qumësht. Shembuj të tillë ka kudo. Këta janë shembuj inkurajues dhe bindës se detyra që shtron Partia, duke bërë një luftë të vendosur kundrejt dobësive që ekzistojnë sot në mirëmbajtjen e blegtorisë, është e mundshme të realizohet me sukses.

Por si paraqitet gjendja e prodhueshmërisë së qum-

shtit për çdo kokë bagëti pelleja në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë për lopët? Shumë keq. Edhe ato lopë, që kanë sot ekonomitë bujqësore, ngaqë tregojnë fare pak kujdes për të mos thënë hiç, jadin fare pak qumësht. Në bazë të raporteve vjetore të kooperativave bujqësore, gjatë vitit 1957 është marrë mesatarisht nga çdo lopë 480 kg. qumësht, nga çdo dhi — 51 kg. dhe nga çdo dele — 34,3 kg. Ka rrethe si p.sh. ai i Lezhës, ku nga çdo lopë foragjere është marrë mesatarisht 182 kg. qumësht, në Gjirokastër — 210 kg., në Krujë — 275 kg., në Fier — 373 kg. etj. Ndërsa në rrethin e Beratit është marrë 24 kg. qumësht nga çdo dele, në Tiranë — 27 kg. etj. Në disa rrethe, edhe këtë vit, megjithëse Partia e ngriti në mënyrë të posaçme problemin e shtimit të lopës dhe të kujdesit për të, prapëseprapë gjendja nuk ka ndryshuar.

Në kooperativën bujqësore të fshatit Krume të rrethit të Kukësit gjatë 7 muajve të këtij viti nga 17 lopë foragjere kanë marrë mesatarisht për secilën 123,2 kg. qumësht, pa llogaritur këtu qumshtin që pi viçat. Në bazë të provave të bëra rezultoi se prodhimi ditor, për një lopë në mjelje, me gjithë qumshtin që pinin viçat, ishte në periudhën maksimale të laktacionit 1,69 kg. d.m.th. aq sa jep një dhi. Në kooperativën bujqësore të Pobregut të këtij rrethi, gjatë 7 muajve, nga 14 lopë foragjere kanë marrë mesatarisht 51,1 kg. qumësht. Këta shembuj të dobët shpjegohen nga vetë fakti se që nga dhjetori i 1957-s e deri në 19 maj të këtij viti, në këtë kooperativë asnjë lopë nuk ka qenë në prodhim. Kooperativa bujqësore e Mashkullorës në rrethin e Gjirokastrës mori vitin që kaloi vetëm 106 kg. qumësht nga

pëve ujë të pastër, në mënyrë të vazhdueshme, prodhimi i qumshtit shtohet 10-15 për qind. Në disa koooperativa bujqësore të rrëthit të Korçës, me iniciativën e komitetit të Partisë, megjithëse kushtet ushqimore akoma nuk janë plotësuar, kanë filluar t'u sigurojnë lopëve ujë të vazhdueshëm, duke vënë pranë se cilës nga një kovë me ujë të pastër ose me mënyra të tjera. Efekti i kësaj mase u duk menjëherë. Prodhimi ditor i qumshtit është ngritur 1-1,5 kg. për kokë baras me 15-20 për qind.

Çfarë pengesash kanë kooperativat ose rrëthet e tjera për ta vënë në praktikë në masë këtë iniciativë të rrëthit të Korçës? Asgjë, përveç pakujdesisë. Është e domosdoshme që organizatat e Partisë të marrin mirë në dorë çështjen e ushqimit dhe të furnizimit të lopëve me ujë, si një nga hallkat kryesore për rritjen e rendimentit të qumshtit. Të merren masa që brenda vitit 1960, çdo kooperativë, në një mënyrë ose tjetër, t'u ketë sigruar lopëve ujë në stallë ose pranë stallës. Kjo masë ka rëndësi të madhe.

Rritja e prodhueshmërisë së qumshtit duhet të ndiqet në mënyrë të vazhdueshme dhe realizimi i planit të mos gjykohet nga rezultatet e fundit të vitit ose kur bëhen analizat 3 dhe 6-mujore. Delegacioni i Partisë që vizitoi Bashkimin Sovjetik, solli një eksperiencë të mirë në këtë drejtim. Atje, komiteti i Partisë i rajonit analizonte gjendjen e qumshtit për çdo ditë. A nuk mund ta bëjnë këtë punë organizatat bazë dhe lokalitetet në çdo 10 ditë dhe rrëthi të paktën 1 herë në muaj? Nga eksperienca sovjetike për shërimin e shpejtë të prodhimit të qumshtit ne duhet të mësojmë shumë. Nuk është e

tepërt të themi, se, me gjithë paralajmërimet e shpeshta që u janë bërë komitetete të Partisë në rrethe, ato nuk po kujdesen akoma për evidencën 3-mujore të gjendjes së blektorisë që u vendos me rekomandim të Plenumit të Shkurtit të vitit 1957 të Komitetit Qendror. Si mundet komiteti i Partisë dhe komiteti ekzekutiv i rrethit ta njohin gjendjen e blektorisë dhe të marrin masat e nevojshme për realizimin e detyrave, pa ditur të dhënat të paktën çdo tre muaj? A paraqit ndonjë vështirësi nxjerrja e këtyre të dhënave sot, kur ekonomia bujqësore pothuajse është kolektivizuar në shkallë të gjerë? Kjo nuk bëhet nga pakujdesia dhe jo nga ndonjë arësyet tjetër. Kjo pakujdesi duhet të marrë fund. Në qoftë se duam t'i drejtojmë mirë punët, duhet patjetër të njihet gjendja, ndryshe drejtimi nuk do të jetë si duhet, do të jetë i përgjithshëm dhe detyrat është vështirë të realizohen.

3) *T'i kushtohet më tepër vëmendje rritjes së përqindjes së pjellshmërisë si një faktor i rëndësishëm për shtimin e krerëve të bagëtisë dhe për ngritjen e prodhimit të qumshitit.* Mjaft ndërmarrje dhe kooperativa bujqësore që kanë pjellshmëri të lartë në bagëti dëshmojnë se ne mund të bëjmë shumë për rritjen e pjellshmërisë. Në Ndërmarrjen Bujqësore Shtetërore të Kamzës, në vitin 1957, janë marrë 89,8 krerë viça në çdo 100 krerë lopë; në atë të Xhafzotajt 81,5 qengja nga 100 dele pëlleja në fillim të vitit, ndërsa kooperativat bujqësore të rrethit të Gjirokastrës dhe ato të Beratit kanë marrë 90 qengja dhe keçë për çdo 100 pëlleja. Me qindra janë ekonomitë kooperativiste dhe private që kanë përqindje të lartë në lindjet për çdo 100 krerë pëlleja.

Por pjellshmëria mesatare e lopëve, e dhenve dhe e dhive, në përgjithësi është mjaft e ulët. Ne marrim mesatarisht 72 viça nga 100 lopë, 75 qengja nga 100 dele dhe 76 keçë nga 100 krerë dhi pëlleja. Në disa krahina malore, si në Kukës, Burrel e Skrapar marrin viça vetëm një herë në dy vjet ose dy viça në çdo tre vjet. Kooperativat bujqësore të rrëthit të Gjirokastrës, në vitin 1957, morën vetëm 59 viça nga 100 lopë. Kjo gjendje është shqetësuese, pse ekonomia popullore dëmtohet rëndë. Prandaj duhet ta ndryshojmë patjetër këtë gjendje, ta rritim pjellshmërinë e bagëtive.

Çfarë masash duhen marrë për rritjen e përqindjes së pjellshmërisë?

a) *Të merren masa për ndërzimin e kontrolluar të lopëve dhe të mëshqerrave, që ai të bëhet në moshën dhe në kohën e duhur.* Kur mëshqerrat ndërzehen jo në moshë japid pak qumësht, ndërsa kur u kalon shumë afati i ndërzimit humbasin sasi të mëdha qumshti. Mjafton të themi se po të ndërzehen vetëm me 3 muaj vonesë të 20 000 mëshqerrat që kishim në fillim të këtij viti, atëherë do të kemi 6 300 pjellje më pak (d.m.th. 6 300 laktacione), ose 25 000-30 000 kv. qumësht dhe 4 000 kv. mish më pak.

Edhe lopët nuk ndërzehen pas 60 ditësh, por mbas 80 ditësh nga dita e lindjes. Nga kjo pakujdesi çdo vit lindin 8 000-10 000 viça më pak. Kjo do të thotë se vetëm për këtë fakt humbasim 8 000-10 000 pëlleja më pak ose 40 000-50 000 kv. qumësht, 5 000-6 000 kv. mish dhe 8 000-10 000 lëkurë në vit. Çrrregullime të këtilla kanë ndodhur edhe në Ndërmarrjen Bujqësore Shtetërore të Cërrikut, ku në vitin 1957, 8 për qind e lopëve janë ndër-

zyer 60-90 ditë pas pjelljes dhe 7 për qind e lopëve pas 90 ditësh. Më keq paraqitet gjendja në kooperativat bujqësore dhe në ekonomitë individuale, ku në përgjithësi ndërzi i lopëve bëhet fare i pakontrolluar.

Kjo gjendje, duhet të marrë fund. Organet e bujqësisë në çdo rreth dhe në mënyrë të veçantë specialistët e blegtorisë, të studjojnë për çdo zonë të rrëthit të tyre kushtet konkrete dhe racat e të përcaktojnë afatet kur mëshqerrat duhet të futen në ndërzi. Si rregull, mëshqerrat duhet të ndërzehen kur kanë arritur 2/3 e poshës së gjallë të lopëve dhe jo më përpara se të kenë mbushur 7 muaj, ndërsa lopët 60 ditë pas lindjes.

Të gjitha kooperativat bujqësore, sikurse dhe ndërmarrjet bujqësore shtetërore duhet të kalojnë medoemos në ndërzin e kontrolluar të lopëve. Është e domosdoshme që në kooperativat bujqësore, brenda vitit 1959, të krijojen librat e ndërzimit dhe të pjelljes së lopëve e të mëshqerrave, të fillojë planifikimi i ndërzimit dhe i pjelljeve në periudha të caktuara të vitit, në mënyrë që të sigurohet edhe ushqimi i nevojshëm për lopët barre se dhe të sigurohet qumshti për nevojat e popullit në çdo periudhë të vitit.

b) *Evitimi i dështimeve të bagëtive pëlleja do të sigurojë jo vetëm qumësht dhe mish më shumë, por edhe do të kufizojë përhapjen e sëmundjeve në blegtori.* Për ruajtjen e bagëtive pëlleja nga dështimet nuk trengohet aspak kujdes, dëmtimet nga dështimet, sikurse u përmendën, janë të shumta. Përveç sëmundjes së dështimit (abortus bang), që ekziston në disa ndërmarrje, ka edhe mjaft raste dështimesh që rrjedhin nga shkaqe mekanike (goditje, rrëzim, trajtim i keq), prandaj, del

detyrë në mënyrë të veçantë për specialistët e blegtorisë të marrin masa për luftimin e sëmundjeve, që shkaktojnë dështimet. Nga ana tjeterë të punohet me blegtoret, nën kujdesin e organizatave të Partisë, përgjiten e tyre zooteknike, që të dinë si t'i trajtojnë bagëtitë barrse dhe t'i ruajnë nga dështimet. Gjithashtu specialistët e blegtoret në kooperativat bujqësore dhe në fermat shtetërore të vendosin rregull që për çdo dështim të përcaktohen shkaqet dhe përgjegjësia e fajtorëve.

Në lidhje me pjelljet e lopëve duhet të theksojmë edhe disa karakteristika të veçanta për vendin tonë. Lopët te ne pjellin zakonisht në pranverë, sepse në këtë kohë ka më shumë gjelbërime dhe, si rrjedhim, lopët kanë sasi të mjaftueshme qumshti për rritjen e viçave, duke qenë se për muajt e mëvonshëm nuk sigurohet ushqimi i gjelbërt edhe lopët nuk jepin më qumësht. Kështu, në vend që lopët të milen gjatë 250-280 ditësh, milen vetëm 180-220 ditë. Përveg kësaj, duke përqëndruar pjelljet e lopëve vetëm në pranverë (mars-prill) edhe prodhimi i qumshtit (si edhe konsumi i tij), merr një karakter sezonal. Kjo periudhë bie në mijljen e dhene e të dhive, prandaj në vendin tonë si rregull gjatë muajve të pranverës dhe të verës ka qumësht në treg, ndërsa në vjeshtë, e sidomos gjatë dimrit, qumshti në treg është shumë i paktë. Për të evituar këtë boshllök duhet të merren masa në dy drejtime: *së pari, të zgjatim periudhën e laktacionit të lopëve, duke mbjellë foragjere të ndryshme, me qëllim që të kemi ushqime të gjelbërtë gjatë verës, vjeshtës dhe dimrit dhe e dyta, të organizojmë ndërzimin e lopëve gjatë të gjitha stinave*

të vitit. Kjo duhet bërë duke studjuar dhe duke përcaktuar mirë kushtet e çdo zone.

c) *Po kaq e rëndësishme është edhe rritja e pjellshmërisë së dhene e të dhive.* Në Plenumin e Shkurtit të vitit të kaluar u fol hollësishët mbi masat që duhen marrë për të rritur pjellshmërinë në dhentë e dhitë, por megjithkëtë akoma vërehen dobësi të mëdha në pre-galitjen e kafshëve për ndërzim. Shumë herë ndërzimet bëhen me vonesë, prandaj ndodh që edhe në zonat e ngrohta delet të pjellin në muajt janar-shkurt, disa herë edhe në mars. Në këto kushte kullotat shfrytëzohen dhe nga dhentë barrse në vend që të përdoren kryesisht nga dhentë pëlleja. Kështu kullotat mbarohen shpejt dhe dhentë pëlleja e sigurojnë me vështirësi qumshtin për rritjen normale të qengjave dhe shterojnë shumë herët. Ne duhet të bëjmë ç'është e mundur që në zonat e ngrohta pjellja e dhene të fillojë nga fundi i dhjetorit dhe të mbarojë brenda janarit. Kjo do të thotë që ndërzimi i dhene të përfundojë, jo më vonë se deri më 15 gusht për zonat fushore bregdetare dhe në fund të shtatorit për zonat e ftohta.

d) *Të tregohet më shumë kujdes për kafshët e reja të porsandara pse rritja e mirë e tyre do të ndihmojë për shtimin e qumshtit dhe të prodhimeve të tjera.* Sa e rëndësishme është kjo masë e shohim në Fermën «Maliq Muço» të Xhafzotajt. Aty, derisa ushqehen me qumësht, viçat rriten dhe zhvillohen mirë, por pas kësaj moshe, ata fillojnë të mbeten pas. Në vend që viçat femra në moshën 12-muajshe të peshojnë 200 kg. sipas standardit, peshojnë në fakt 141 kg. dhe meshkujt, në vend të 250 kg., peshojnë vetëm 154 kg. Nga kjo pa-

kujdesi për mirëmbajtjen e tyre, në këtë ndërmarrje numri i lopëve me rendiment të lartë ka ardhur duke u pakësuar. Kështu p.sh. më 1952 në Ndërmarrjen Bujqësore Shtetërore të Xhafszotajt kishte 32 lopë me rendiment mbi 4 500 kg. qumësht, ndërsa në vitin 1957 me një prodhueshmëri të tillë nuk ka pasur asnjë lopë. Lopët me 3 200-4 000 kg. janë pakësuar nga 50 krerë në vitin 1952 në 5 krerë më 1957, megjithëse rendimenti mesatar i qumshtit për fermën është rritur. Në kooperativat bujqësore trajtimi i kafshëve të reja bëhet edhe më keq, bile që kur janë viçë nuk u jepet qumshti i mjaftueshëm dhe viçat nuk arrijnë as shtesën e rregullt ditore. Kjo bëhet për të realizuar planin e prodhimit të qumshtit në rrugë jo të drejtë, duke dëmtuar viçat.

Për të vënë në rrugë të drejtë rritjen e kafshëve të reja, trajtimi duhet filluar që në moshën kur kafsha është barrse. Duhet të konsiderohet e dëmshme praktika e derisotme që kafshët barrse të ushqehen si shterpët. Duhet të mos lejohet më një qëndrim i tillë. Teknikët dhe specialistët e blektorisë, drejtorët e ndërmarrjeve bujqësore e blektorale, si dhe kryetarët e kooperativave bujqësore, duhet të kërkojnë me këmbëngulje që t'u bëhet shërbim i veçantë kafshëve të reja, bile puna për këto duhet të fillojë që para lindjes së të vegjelvë.

Rritjes së kafshëve të reja t'i kushtohet po ajo vëmendje që u kushtohet edhe planeve të prodhimit. Për rritjen e viçave në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe në kooperativat bujqësore duhet të caktohen kryesisht gra dhe të reja. Duhet përkrahur me të gjitha forcat lëvizja e rinisë për dërgimin e sa më shumë të rejave në

fermat blegtoreale. Të gjithë mjelësit e lopëve duhen zë-vendësuar medoemos me femra, të cilat janë shumë më të përshtatshme për këtë punë. Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj vartëse të organizojnë më mirë punën për përhapjen e eksperiencës së rritësve më të dalluar të viçave që janë në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe në kooperativat bujqësore.

e) *Për ngritjen e prodhimtarisë së qumshtit të lopëve, një faktor me rëndësi është zbatimi i drejtë i teknikës së mjeljes. Me përjashtim të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe shumë pak të kooperativave bujqësore, ku tani zbatohen deri-diku drejt rregullat e mjeljes së lopëve, në shumicën dërmuese të kooperativave bujqësore ky proces nijhet shumë pak. Një fjalë e urtë popullore thotë se «qumshti ndodhet në gjuhë të lopës dhe në dorë të mjelëses». Një mjelëse e keqe, që nuk njeh teknikën e mjeljes, mund ta shterë dhe ta prishë shumë shpejt lopën, ndërsa një mjelëse e mirë e ngre vazhdimesh rendimentin. Mjelëset e dalluara i mjelin lopët me orar të caktuar dhe u bëjnë në kohë dhe në rregull të gjitha llojet e shërbimeve.*

f) *Nëse përmirësimi i racës së blegtorisë me të drejtë konsiderohet si një nga burimet e rëndësishme për shtimin e mishit, aq më tepër përmirësimi i racës, veçanërisht të gjedhit, do të sigurojë një rritje shumë të madhe të qumshtit. Për kafshët e racës nuk ka nevojë të bëhet agitacion. Kooperativistët dhe fshatarësia punonjëse, që kanë blegtori, tashmë e shohin qartë se përmirësimi i racës e ngrë degën e blegtorisë në një degë të ekonomisë bujqësore shumë të leverdissë. Viti i parë i ndërzimit artificial të dhene me desh të*

racës është një dëshmi e gjallë se, jo vetëm pjellshmëria e dhene qe më e lartë, por pesha e shqerrave u rrit shumë dhe leshi i tyre ndryshon shumë nga ai i deleve të zakonshme.

Sot kooperativistët, nga eksperienca e kooperativave të përparuara dhe nga ajo e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, ku përmirësimi i racës së blegtorisë ka filluar me kohë, shohin se sa përfitime do të ketë përmirësimi i racës së blegtorisë dhe sidomos i deles dhe i gjedhit.

Duhet të vazhdohet më me guxim dhe vendosmëri puna që ka filluar për përmirësimin e racës, jo vetëm të deles, por të hidhemi në shkallë të gjerë në përmirësimin e racës së lopëve, duke ndjekur metodën e ndërzimit artificial. Shtrohet detyra që në vitin 1960 të bëhet ndërzimi artificial i 1 100 000 krerëve dhen dhe jo më pak se i 30 000 krerëve lopë duc për vitin 1965 të ndërzehen po në këtë mënyrë 1 200 000 krerë dhen dhe 60 000-70 000 krerë lopë. Të tregohet më shumë kujdes për përmirësimin e tufave të pastra, sidomos në Ndërmarrjen Bujqësore Shtetërore të Xhafzotajt, të Sukthit e të Cërrikut që kanë racën Xhersej si dhe në Teknikumin Bujqësor të Kavajës, që rrit racën Gernsej.

Kujdes i veçantë duhet të tregohet nga ndërmarrjet bujqësore shtetërore për mirëmbajtjen, për ruajtjen nga sëmundjet dhe për trajtimin e nevojshëm të lopëve që po vijnë nga Bashkimi Sovjetik dhe nga demokracitë populllore. Ndërmarrjet shtetërore duhet të bëhen baza e sigurimit të damazëve të zgjedhur për racë për t'ua shpërndarë kooperativave bujqësore, si edhe të prodhimit të mëshqerrave të racës për nevoja të tyre dhe për t'ua shitur kooperativave bujqësore.

Në kryqëzimin e lopëve, ashtu edhe të dhenve, duhet mbajtur parasysh ruajtja e cilësive të vlefshme të racave të vendit, sidomos për delen, e cila u qëndron shumë sëmundjeve dhe kushteve tona dhe dallohet për prodhimin e lartë të qumshtit. Të luftohet që lopët e vendit, kur kryqëzohen me racat Xhersej dhe Gernsej të rritin përqindjen e yndyrës dhe të ruajnë cilësitë e tyre të mira kur bëhet kryqëzimi me raca të tjera.

Me qëllim që puna e përmirësimit të racës të bëhet e kontrolluar dhe e efektshme, të ngarkohet Ministria e Bujqësisë që brenda vitit 1959 të ngrëjë një sërë stacionesh komplekse për prodhimin e spermës, shpërndarjen e saj dhe për t'u dhënë ndihmë nga afër ekonomive kooperativiste për ndërrimin artificial dhe për përmirësimin e racës së blektorisë. Të mbahet parasysh që këto stacione të ngrihen kryesisht pranë ndërmarrjeve bujqësore shtetërore ose shkollave bujqësore dhe të vlejnë njëkohësisht për punën praktike të nxënësve të shkollave bujqësore dhe për edukimin e punonjësve të blektorisë të ndërmarrjeve shtetërorc dhe të kooperativave bujqësore.

Për të vënë në rregull përmirësimin e racës duhet të merren masa që, duke filluar nga viti 1959, të zbatohet bonitimi i detyrueshëm i bagëtive në të gjitha ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe në kooperativat bujqësore që kanë drejtë race, si dhe të krijohen librat shtetërorë të racës për gjedhin, dhentë dhe derrat, ku të regjistrohen të gjitha bagëtitë me prodhimitari të lartë. Ministria e Bujqësisë të përpunojë udhëzimet për krijimin e bërthamave të racës dhe për organizimin e mbajtjes së evidencave zooteknikë.

Të gjitha këto masa kanë rëndësi të madhe për shtimin e qumshtit, prandaj organizatat e Partisë, organet e bujqësisë dhe sidomos specialistët e bujqësisë, duhet të punojnë, për t'i vënë në jetë si në ndërmarrjet bujqësore shtetërore ashtu dhe në ekonomitë kooperativiste.

4) Strehimi i bagëtisë ka një rëndësi shumë të madhe për shtimin e rendimentit. Këto 2-3 vjetët e fundit kooperativat bujqësore kanë ngritur mjaft stalla për bagëtinë, sidomos për gjedhe e dhen, por as numri dhe as cilësia e tyre nuk u përgjigjen kërkesave të fermave të mëdha blegtore. Ndërtimi i stallave caktohet pa kriter, madhësia e tyre caktohet pa marrë parasysh perspektivën, larg ujit të pijshëm, pranë rrugëve publike, gjë që është në kundërshtim me rregullat sanitaro-veterinare. Lidhur me këto, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve duhet ta marrin nën kontroll çështjen e ndërtimit, duke kriuar sipas nevojës komisione të posaçme pranë seksioneve të bujqësisë, pa autorizimin e të cilave të mos lejohen ndërtimi. Për këtë qëllim Ministria e Bujqësisë të japë udhëzimet e nevojshme sa më parë.

Për të siguruar strehimin për gjënë e gjallë, kooperativat bujqësore çdo vit duhet të parashikojnë në planet e tyre ndërtimin e stallave, duke u mbështetur në planet perspektive të zhvillimit të llojeve të ndryshme të gjësë së gjallë.

Materialet për ndërtimin e stallave të sigurohen kryesisht nga vetë kooperativat, ndërsa Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe komitetet ekzekutive të rretheve, të parashikojnë furnizimin e

kooperativave bujqësore me materiale ndërtimi që ato vëtë nuk i sigurojnë dot në vend.

IV

**SIGURIMI I BAZËS USHQIMORE PËR BLEGTORINË
ËSHTË FAKTORI KRYESOR I ZGJIDHJES
SË PROBLEMIT TË QUMSIITIT,
MISIIT DIHE YNDYRNAVE**

Dihet se ushqimi është kushti themelor për rritjen e numrit të blegtorisë dhe shtimit të prodhimtarisë së saj. Me të drejtë populli thotë «ç't'i japësh bagëtisë atë do të marrësh». Tani që blegtoria jonë është futur në rrugën e përmirësimit të racës dhe prej saj kërkonët tē marrim sa më shumë mish dhe qumësh, sigurimi i bazës ushqimore është gjithshka. Çështja e bazës ushqimore është ngritur me forcë vazhdimisht dhe qeveria ka marrë masa të rëndësishme duke investuar çdo vit fonde, sidomos për përmirësimin e kullotave. Por megjithatë ushqimi i blegtorisë nuk ka qenë plotësuar as si cilësi as si sasi.

Në ç'drejtime duhet përqëndruar vëmendja për sigurimin e një baze të shëndoshë ushqimore?

a) Në përmirësimin, administrimin dhe shfrytëzimin rrënjosor të kullotave natyrale, të cilat sigurojnë sasinë më të madhe të ushqimeve të blegtorisë, sidomos të bagëtisë së imtë;

b) në kultivimin e koncentrateve dhe të bimëve

foragjere me rendiment të lartë që përdoren si ushqime të njoma ose të konservuara për nevoja të blegtorisë;

c) në grumbullimin e të gjitha ushqimeve të thata, si të barit, jonxhës, të mbeturinave të kulturave bujqësore, të bimëve të egra; të gjethive pyjore dhe të mbeturinave të industrisë ushqimore.

Përmirësimi rrënjosor i kullotave natyrale, administrimi i mirë dhe shifrytëzimi rrënjosor i tyre, përbëjnë rezervën më të madhe për sigurimin e bazës ushqimore të blegtorisë.

Sipas inventarizimit jo të saktë të kullotave të bërë në vitin 1951 del se kemi një kapacitet kulloso për të sigruar 40 pind të nevojave të blegtorisë në ushqime të njoma.

Regjistrimi që është duke u bërë këtë vit do të na japë shifra më të plota mbi mundësinë ushqyese që kanë kullotat natyrale. Sidoqoftë afërsisht gjendja dihet edhe sot. Për të vënë në dukje është fakti se përmirësimi i kullotave nuk po bëhet në mënyrë rrënjosore, ashtu si e ka shtruar detyrën Partia dhe shifrytëzimi i tyre bëhet keq. Megjithëse janë krijuar ndërmarrje të posaçme për kullotat, kontrolli dhe interesimi i tyre për t'i vënë qiramarrësit përparrë përgjegjësisë së zbatimit të detyrimeve të kontratës nuk bëhet i plotë. Organet shtetërore dhe organizatat e Partisë në bazë nuk e kanë kapur seriozisht këtë problem. Shpesh është shfaqur tendenca të kërkojnë nga shteti ose të prishin kontratat me blegtorët që nuk janë nga rrethi i tyre për të plotësuar nevojat, në vend që të marrin masa për të rritur kapacitetin e kullotave. Asnjë vit nuk është realizuar plani i përmi-

rësimit të kullotave, gjë kjo që tregon se sa pa kujdes është punuar në këtë drejtim.

Nga kullotat natyrale llogaritet sigurimi i 40 për qind të të gjitha ushqimeve të njoina. Prandaj, e vlen që Partia në bazë të kujdeset më tepër për përmirësimin e kullotave, pse ato ndikojnë shumë në zhvillimin e blegtorisë. Duhet të kuptohet më gjerë detyra që ka shtruar Partia për përmirësimin e kullotave, pse, kur flasim të përmirësohen kullotat, këtu bëhet fjalë, jo vetëm për kullotat dimërore, por edhe për ato verore edhe për mushatë. Përmirësimi i tyre kërkon mobilitimin e të gjitha forcave të kooperativave bujqësore dhe të ekonomive private që kanë bagëti dhe jo vetëm të rinisë fshatare, ashtu siç mendohet dhe veprohet deri tani. Kjo punë kërkon interesimin direkt të organizatave të Partisë dhe të organeve shtetërore, sidomos të ndërmarrjeve të kullotave, që janë ngarkuar me përgjegjësi për këtë punë.

Që të shtojmë kapacitetin kullosor nga kullotat natyrale duhet të bëhet përmirësimi i gjithanshëm i tyre, duke pastruar ferra, driza, gjemba dhe gurë, duke bërë terraca për mbrojtje nga erozioni, duke i mbjellë me barëra të buta ose të egra për ta përmirësuar florën, duke kultivuar në to bimë foragjere, hasëlle dhe gjithshka që shërben në këtë drejtim. E njëjtë punë duhet të bëhet edhe për kullotat verore dhe për mushatë e fshatit.

E gjithë kjo punë duhet të bëhet nën udhëheqjen e organizatave të Partisë dhe nën drejtimin e organeve shtetërore nga vetë ekonomitë kooperativiste dhe private që rritin bagëti. Në këto kushte, kur kolektivizimi i buj-

qësisë është në përfundim, ka ardhur koha që kullotat shtetërore dimërore dhe verore t'u jepen në përdorim të përhershëm, ashtu siç u janë dhënë edhe tokat e tjera bujqësore, kooperativave bujqësore dhe ndërmarrjeve shtetërore. Ndërkaq ndërmarrjet shtetërore të kullotave duhet të ushtrojnë kontroll mbi qiramarrësit për zbatimin e masave për përmirësimin e kullotave. Atje ku duhen bërë investime, sidomos në kullotat verore ku nuk ka ujë, t'u jepet ndihmë kooperativave bujqësore me anë krediti me afat të gjatë, si dhe ndihmë teknike për projektim hauzesh dhe lerash dhe për zbatimin e tyre.

Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të marrin masa që të realizohet detyra që shtron plani i dytë pesëvjeçar për ndërtimin e lerave në kullotat verore.

Ekonomia bujqësore, me zhvillimin e gjithanshëm të saj, po intensifikohet vazhdimi. Po kështu edhe blegtoria. Ajo sot zhvillohet në të gjitha degët e saja. Shumë toka të përshtatshme për drithëra e kultura industriale ose pemë frutore, që në të kaluarën përdorenësin për kullota, gradualisht po vihen nën kulturë. Përpara këtij transformimi, që pëson bujqësia jonë, duhet të gjenden burime të tjera për ushqimin e blegtorisë.

a) *Kultivimi i bimëve foragjere, shfrytëzimi i tokës arë duke marrë dy edhe më shumë prodhime në vit, organizimi i prodhimit të ushqimit të gjelbër gjatë gjithë vites, duhet të bëhen burime të rëndësishme për të siguruar nevojat ushqimore të blegtorisë. Në disa ndërmarrje bujqësore si në atë të «8 Nëntorit», «28 Nëntorit» dhe «Yllit të Kuq» është organizuar konvejeri i gjelbërt,*

në disa të tjera preqatitet ushqimi që më parë, duke e bluar, zier dhe përzier për t'ia bërë më të këndshëm kafshës dhe disa kooperativa bujqësore si ajo e Dobraçit dhe e Ajazmës në Shkodër, ajo e bahçevanëve në Vlorë, duke vënë në zbatim eksperiencën e ndërmarrjeve shtetërore, kanë rritur shumë prodhimin e qumshtit për çdo lopë.

Kultivimi në masë dhe përdorimi i mirë i ushqimeve të njoma do të ndikojë shumë në prodhimin e qumshtit. Është për t'u lavdëruar shembulli i kooperativës bujqësore të Qarrit në rrëthin e Fierit, që gjatë vitit 1957-1958 mbolli 60 ha. hasëll, 30 ha. jonxhë dhe një sasi misri foragjer nga 220 ha. tokë që ka. Ajo mbjell hasëlllet në misër para korries, ka mbjellë hasëlle në tokat e pambukut para vjeljes, në tokat me gram për të mos humbur mbjelljen e dytë dhe për të luftruar gramin, do të kullotë hamulloren në qershori, do ta punojë në korrik thellë dhe në gusht do ta mbjellë hasëll. Në këtë mënyrë kooperativa e Qarrit mendon që në të ardhshmen t'i dyfishojë kulturat foragjere. Përse të mos e ndjekin edhe kooperativat e tjera shembullin e kësaj kooperative? Mundësitë i kanë shumë kooperativa të marrin dy dhe tre prodhime në vit nga e njëjtë tokë, ashtu siç porosit Partia. Çdo rrëth në bazë të kushteve tokësore dhe klimatike, ka mundësi të mbjellë kultura të dyta dhe të shtojë shumë bazën ushqimore.

Mbjellja e hasëlleve dhe e misrit foragjer do të sigojë sasi të mëdha ushqimi të njomë. Në vitin 1965 duhet të mbillen jo më pak se 140 000 ha. hasëlle dhe kultura të tjera të dyta. Kësaj pune duhet t'ia fillojmë

mirë që sivjet dhe në vitin e ardhshëm të dyfishohet sipërfaqja e mbjellë deri sot me kultura të dyta.

Ministria e Bujqësisë duhet të marrë masa për përhapjen e kulturave foragjere si sorgumi, sudangrasi, lüpini etj. që rriten mirë në toka të paujitshme ose ranore. Rëndësi e veçantë si kulturë e dytë duhet t'i vihet mbjelljes së misrit, i cili jep ushqime më shumë se çdo kulturë tjetër po t'i bëhen shërbimet e nevojshme. Misri foragjer dhe kashta e misrit për kokërr duhet të jetë baza për realizimin e planit të silazheve. Lufta për realizimin e planit të silazhimeve duhet të konsiderohet njësoj si lufta për bukën, pambukun, duhanin etj. pse silazhi është qumshti, mishi dhe yndyra që marrim nga bagëtia. Megjithëse problemi i silazhit është shtruar me forcë, vetëm këto vitet e fundit po tregohet një interesim më i madh dhe fshatarësia koooperativiste po e kuption vlerën e madhe të tij. Këtë viti nga 157 000 ton që është plani, deri më 25 të muajit tetor janë silazhuar 134 420 ton ose 64 420 ton më shumë se viti i kaluar.

Mundësitë për silazh janë shumë të mëdha. Ne duhet të arrijmë që më 1965 të silazhojmë rrëth 1 milion ton ushqime. Burimi kryesor i silazhit duhet tëjenë kashta e misrit të korruar në fazën e dyllit, kashta e misrit foragjer, kulturat e tjera të mbjella posaçërisht për silazh, si dhe të gjitha llojet e barërave që nuk mund të konsumohen të freskëta.

Që të ushqehet mirë blegtoria, nuk mjafton vetëm të sigurohet ushqimi për periudhën e dimrit, por të sigurohet ushqimi i blegtorisë në çdo periudhë të vitit. T'i jepen kafshës jo vetëm sasia e nevojshme, por edhe

Iloji i domosdoshëm i ushqimeve për ruajtjen e shëndetit dhe për shtimin e rendimentit të saj. Kjo sigurohet me kultivimin e ushqimeve të gjelbëra gjatë të gjitha stinave. Në ndërmarrjet bujqësore shtetërore «3 Nëntori» të Sukthit dhe në atë të «29 Nëntorit» në Lushnjë, hasëllat i mbjellin «në dy duar» (që nga gushiti deri në tetor) dhe i kullotin këto që nga fundi i nënëntorit deri në fund të marsit, bile dhe në prill; në mars-prill mbjellin sudangras dhe jonxhë për ta kullotur dhe pjesërisht për ta kositur në fund të majit e deri në korrik; në maj, qershori e korrik mbjellin misër foragjer si kulturë të parë ose kulturë të dytë, për ta ngrënë të njomë në shtator, tetor e nënëntor dhe për ta bërë silazh.

Një praktikë të tillë mund ta vënë në jetë fare mirë të gjitha ndërmarrjet shtetërore bujqësore dhe kooperativat bujqësore. Ja se ç'ndodhi në kooperativën bujqësore të Frashërit në rrëthim e Fierit, ku nuk kishte grafik të rregullt për sigurimin e ushqimit për blegtorinë gjatë periudhave të vitit. Në periudhën janar-maj kjo kooperativë kishte tepricë ushqimesh (deri në 270 për qind mbi nevojat), ndërsa në periudhën qershori-shtator nevojat i plotësonte me vështirësi. Studimet në vend treguan se, duke mbjellë në fazë të ndryshme ushqime të gjelbëra, mund të sigurohet ushqim irregullisht në të gjitha stinat. Rrethi i Fierit ka parashikuar që këtë punë ta bëjë edhe në kooperativat e tjera, duke mbjellë 18 për qind të sipërfaqes së punuar me kultura foragjere të ndryshme, duke përfshirë edhe tagjitet.

b) Të tregohet më shumë kujdes për kultivimin dhe për grumbullimin e ushqimere të thata për bleg-

torinë. Në këto lloje ushqimesh përfshihen: jonxha, gjethet e pyjeve, bari i livadheve dhe i kullotave, kashata e misrit dhe e të lashtave etj.

Sipas planit të vitit 1958 në vendin tonë jonxha zë afërsisht 5 për qind të tokave të punuara. Relativisht, më shumë nga kjo bimë ka Peshkopia (10,9 pér qind), ndërsa më pak kanë rrithi i Durrësit dhe i Vlorës, (1,1 pér qind dhe 1,5 pér qind përkatësisht). Kjo është e papajtueshme me bujqësinë intensive. Arësyjeja kryesore që sipërfaqet e jonxhës nuk zgjerohen qëndron te agroteknika e ulët që përdoret. Shumë njerëz mendojnë se jonxha si «bar» që është nuk ka gjoja nevojë pér ndonjë shërbim. Duke qenë puna kështu, ajo jep rendimente të ulëta, gjë që pengon zgjerimin e mëtejshëm të sipërfaqeve. Në të vërtetë jonxha kërkon një agroteknikë të posaçme, tokë të punueshme shumë të mirë dhe plehërimë, megjithëse jonxha edhe vetë e pasuron më vonë tokën. Jonxha nuk mund të mbillet kudo.

Në tokat e thata, ku jonxha nuk rritet mirë, ajo mund të zëvendësohet me bimë të tjera leguminoze, siç është esparceta, ose trifili aleksandrin që jep prodhime të larta dhe që, duke qenë njëvjeçar, mund të futet më lehtë në qarkullim me bimët e tjera. Ne duhet t'u kushtojmë vëmendje më të madhe foragjereve leguminoze, që na japid bar të thatë e njëkohësisht sigurojnë edhe rendimente të larta pér kulturat që vijnë pas tyre.

Në bazë të studimeve të bëra del se më 1965 duhet të mbjellim 40 000 hektarë me jonxhë dhe 3 000 hektarë me foragjere të tjera, pér të cilat u fol më lart. Në kë-

të mënyrë, sipërfaqja e mbjellë me bimë foragjere, pa përfshirë hamulloret, në vitin 1965 do të jetë 8,6 për qind kundrejt 2,7 për qind më 1950 dhe 3,9 për qind që ishte më 1957, ndërsa po të llogariten edhe mbjelljet e dyta me bimë foragjere do të kemi 22,5 për qind të sipërfaqes.

Një rëndësi të veçantë ka cilësia e barit. Ky duhet kositur në fillim të lulëzimit, të thahet shpejt dhe të mbrohet nga dëmtimet. Me një manipulim të mirë, ne do ta shtojmë shumë vlerën ushqimore të barit dhe të bazës ushqimore në tërësi.

c) *Përvëç ushqimeve të thata, duhet të sigurojmë për nevojat e blegorisë sasinë e nevojshme të ushqimeve të koncentruara, si tagjirat, bimët, gëzhutat dhe mbeturinat e industrisë.* Nevojat e përgjithshme për koncentrate llogariten të jenë 263 000 ton njësi ushqimore. Nga këto llogaritje del se në fund të pesëvjeçarit të tretë mund të sigurohen 47 000 ton tagjira, 28 000 ton gëzhta dhe hime, 6 000 ton lëndë lisi dhe rrëth 25 000 ton bërsi, miell peshku, mbeturina thertoresh etj. Të gjitha këto vlerësohen rrëth 85 000 ton njësi ushqimore. Për të përballuar nevojat e tjera me koncentrate duhet siguruar nga prodhimi i misrit dhe i burimeve të tjera që ekzistojnë në bujqësi, jo më pak se 150 000 ton njësi foragjere. Në këtë mënyrë nevojat për koncentrate gati plotësohen. Vëmendja kryesore të përqëndrohet në shtimin sa më shumë të ushqimeve të njoma dhe të ulet në minimum sasia e koncentrateve. Interesi i ekonomisë popullore, duke shikuar kushtet e vendit tonç, kërkon të kufizojmë sa më shumë sasitë e tagjirave dhe t'i zëvendësojmë në një masë të madhe me ushqime të njo-

ma. Disa ndërmarrje bujqësore, si ajo e Maliqit p.sh. e ka rregulluar në mënyrë më ekonomike ushqimin e bagëtisë. Ajo përdor në maksimum barishtet e njoma e të thata, ka ulur shumë përdorimin e koncentrateve. mesatarisht 2 kg. për 100 kg. qumësh, ndërsa rendimenti për çdo lopë ka qenë 1 546 kg. Ndryshe qëndrojnë punët në Ndërmarrjen Bujqësore Shtetërore «Ylli i Kuq» në Kamëz, ku përdoren 37,5 kg. koncentrate, në Ndërmarrjen «8 Nëntori» të Sukthit — 52 kg. dhe në atë të «Maliq Muços» në Xhafzotaj — 80,5 kg. koncentrate për çdo 100 kg. qumësh. Përdorimi në këto ndërmarrje i normave të larta të koncentrateve nuk është i arësyeshëm nga pikëpamja ekonomike sepse rrit shumë koston e qumshtit në krahasim me ushqimet e njoma. Praktika ka vërtetuar se një hektar tokë e mbjellë për ushqime të njoma jep më shumë njësi ushqimore se sa hektari i mbjellë për koncentrate.

Në kundërshtim me shembujt e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore që përmenden më lart është rasti i kooperativës së Orman-Çiflikut në Korçë, ku, pa përdorur asnjë kilogram koncentrate, është marrë 1 700 kg. qumësh nga çdo lopë. Lopët e kësaj kooperative janë të racës Valdostana. Ato mund të japin jo 1 700, por 2 500 dhe 3 000 kg. qumësh, po t'u jepet norma e plotë e ushqimit. Kjo është më ekonomike, sepse tanë për çdo kilogram qumësh lopët shpenzojnë 1-5 njësi foragjerc, ndërsa për 1 000 - 1 500 kilogramët e tjerë do të harxhonin vetëm rrëth 0,48 njësi foragjere për çdo litër. Është e qartë pra, se do të ishte më e arësyeshme që kooperativa e Orman-Çiflikut t'u jepte lopëve një sasi koncentrate, krahas ushqimeve të tjera të njoma

të bollshme (bërsi panxhari, silazh me fletë panxhari, bar livadhi etj.), që ajo i disponon dhe atëhere lopët do ta shpërblenin kooperativën shumë më mirë. Ushqimi me norma më të vogla se ato që nevojiten për lopën është i dëmshëm edhe për arësyse se i ul cilësitë e mira, që ajo ka fituar gjatë jetës. Ka shumë shëmbuj që lopët e mira të blera nga kooperativat, pasi nuk janë ushqyer mirë, kanë rënë shumë shpejt, aq sa të mos dallohen nga ato të zakonshmet.

Ushqimi i çrregullt ndikon në mënyrë shumë negative edhe në dhentë, të cilët jo vetëm nuk arrijnë peshën e nevojshme dhe pakësojnë sasinë e qumshtit dhe të leshit, por humbin së tepërmë edhe cilësinë e leshit. Sipas analizave të bëra në Kombinatin e Tekstileve «Stalin». leshi i formuar gjatë periudhave që kafsha ka qenë në vuajtje nga uria është më i dobët dhe këputet lehtë.

Në llogaritjen e ushqimit të nevojshëm për blegtorinë duhen caktuar norma të drejta dhe të studjuara mirë, sipas llojit të kafshës, kërkesave të saja, kushteve klimatike dhe ushqimeve të vendit dhe jo të caktohen të njëllojta pa pasur parasysh kushtet e veçanta.

Megjithëse bërsitë e pambukut dhe të ullinjve nuk përbëjnë ndonjë vëllim të madh ushqimesh për blegtorinë, këto ushqime nuk po shfrytëzohen. Mbi këtë çështje Komiteti Qendror, që në Plenumin e vitit 1953, u ka shtruar detyra të posaçme si Komisionit të Planit të Shtetit ashtu edhe Ministrisë së Industrisë, por ato nuk i kanë zbatuar këto. Vetëm nga bërsitë e pambukut, pa llogaritur ato të ullinjve, të fabrikave të konser-

vimit të frutave e perimeve, ne humbasim në vit rrith 30 000 njësi foragjere, barazi me 23 000 kv. misër ose 30 000 kv. tershërë. Por, po të llogaritim edhe mbeturinat e konservimit të peshkut, miellin e peshkut, që është një ushqim jashtëzakonisht i vlefshëm, sidomos për përbajtjen e lartë të proteinës, kjo humbje është më e madhe. Sa kohë do të vazhdojë kjo gjendje? Sa kohë do të vazhdohet që bërsitë të hidhen poshtë dhe mbeturinat e konservave dhe peshku i prishur të hidhet përsëri në det? Ministria e Industrisë së bashku me Komisionin e Planit duhet ta zgjidhin patjetër këtë çështje brenda vittit 1959.

Planifikimi i drejtë i bazës ushqimore ka një rëndësi të madhe. Mirëpo kooperativat bujqësore janë akoma shumë prapa në këtë drejtim. Ato bëjnë vetëm disa plane vjetore të përgjithshme, nuk marrin parasysh lëvizjet e nevojshme në stinat e ndryshme të vitit. Të planifikosh kështu do të thotë të mos njohësh kërkesat ushqimore të blegtorisë gjatë periudhave të ndryshme të vitit. Kështu nuk mund të ecet. Çdo kooperativë duhet të hartojë normat dhe racionet e veta për ushqimin e bagëtisë, planin vjetor dhe mujor të nevojave, si dhe grafikun e sigurimit të ushqimeve të nevojshme. Të gjitha këto duhen aprovuar nga komitetet ekzekutive të rretheve përkatëse. Duke u mbështetur në të dhënrat e kooperativave bujqësore, komitetet ekzekutive duhet të hartojnë çdo vit planin e rrithit si vjetor dhe për periudhat e ndryshme të vitit. Ministria e Bujqësisë duhet të ndjekë më mirë çështjen e planifikimit të bazës ushqimore dhe të zbatimit të tij për çdo rrith. Lidhur

me këtë është e nevojshme që së bashku me Drejtorinë e Statistikave të vendoset evidenca mbi bazën ushqimore.

Problemet e bazës ushqimore duhet të merren më mirë në dorë nga organet e Partisë. Vetë organizatat bazë në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe në kooperativat bujqësore duhet të merren çdo ditë me çështjet e bazës ushqimore.

ç) Të merren masa për mekanizimin e punës në blegtori. Mekanizimi i punës në blegtori gjendet në fazën fillestare. Përveç ndërmarrjeve shtetërore, që kanë mekanizuar disa procese pune, në kooperativat bujqësore, të shumtë e punëve të blegtorisë bëhen me krahë. Kjo bën që jo vetëm të mos u sigurohet shërbimi i nevojshëm bagëtive, por edhe fuqia punëtore të largohet nga punimet bujqësore, ose për të kryer nevojat e bujqësisë të lihen pasdore shumë punë të blegtorisë. Sot pjesërisht bëhet kositja dhe mbledhja e barit me mjete të mekanizuara dhe këtë vit po përdoren në shkallë të gjerë maqinat për grirjen e silazhit. Vitet e fundit në të gjitha ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe në disa kooperativa bujqësore po bëhet qethja e mekanizuar e dhenve. Në Institutin Zooteknik në Shkodër dhe në disa ndërmarrje bujqësore, është mekanizuar mjelja e lopëve dhe dhënia e ujit me anë të vaskave automatike.

Puna fizike në blegtori është e rëndë dhe rendimenti i saj është shumë i ulët. Prandaj, ka ardhur koha që ta zgjerojmë mekanizimin edhe në blegtori. Lidhur me këtë në pesëvjeçarin e tretë duhet të parashikohet importimi i më shumë maqinave për fermat blegtoriale.

Deri në vitin 1965 mbjellja e kulturave foragjere në zonat fushore, sidomos e misrit, sorgumit, sudangrasit dhe hasëlleve, duhet të mekanizohet rreth 60-70 për qind, bari i livadheve natyrale dhe artificiale në zonat fushore të kositet e të mblidhet me mjete të mekanizuara, kashta e të lashtave, që korret me kombajna, të mblidhet me mjete teknike dhe jo më pak se 25-30 për qind e saj të vihet mullarë me anë të mekanizmave të posaçme. Grirja e ushqimeve të gjelbëra për silazh të mekanizohet 100 për qind. Të parashikohet mekanizimi i pregetitjes së ushqimeve për lopët në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe në disa kooperativa bujqësore; të zgjerohet mekanizimi i transportit të brendshëm në stallat e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe në një numër gjithnjë më të madh kooperativash bujqësore; të zgjerohet mijelja e lopëve me mjete të mekanizuara në jo më pak se 8 000-10 000 krerë nga të cilat 5 000 krerë në ndërmarrjet bujqësore shtetërore; të parashikohet dhënia e ujit në mënyrë të rregullt gjedheve. Në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhënia e ujit të mekanizohet, ndërsa kooperativat bujqësore të marrin të gjitha masat qoftë dhe me metoda primitive për të siguruar ujin në stallat e lopëve mijelëse pranë tyre.

V

**MASAT PËR GRUMBULLIMIN, PËRPUNIMIN DHE
FURNIZIMIN MË TË MIRE TË POPULLIT
ME QUMËSHT DHE ME MISII**

1) Mbi grumbullimin dhe përpunimin e qumshtit.

Me shtimin çdo vit të prodhimit të qumshtit, janë krijuar kushte të favorshme për të grumbulluar më shumë qumësht. Kolektivizimi i bujqësisë ka qenë një faktor i rëndësishëm që gjatë këtyre 2 vjetëve të fundit grumbullimi i qumshtit të rritet në mënyrë të ndjeshme. Kështu p.sh. nga 13 674 ton që u grumbulluan më 1955. vjet u grumbulluan 17 600 ton dhe gjatë 9 muajve të 1958-s u grumbulluan 24 486 ton ose 15,1 për qind e prodhimit të përgjithshëm të qumshtit në Republikë. Në mënyrë të konsiderueshme është rritur edhe përpunimi i qumshtit. Pjesa më e madhe e qumshtit të grumbulluar, rrëth 2/3, është nga sektori socialist i bujqësisë.

Komiteti Qendror i PPSH dhe qeveria kanë marrë masa të veçanta dhe kanë krijuar kushte të favorshme për prodhuesit e qumshtit, gjë që ka ndihmuar së tepërti për realizimin e planit të grumbullimit të qumshtit. Me interesimin e Komitetit Qendror, të komiteteve të Partisë dhe të pushtetit në rrethe e në lokalitete, këtë vit organizatat dhe ndërmarrjet e grumbullimit të qumshtit kanë punuar më mirë. Kështu numri i pikave të grumbullimit dhe të përpunimit të qumshtit

u shtua mjaft. Mesatarisht, gjatë këtij viti, në më shumë se 30 për qind të fshatrave ka pasur një qendër grumbullimi, ku fshatarët kanë dorëzuar qumësht. Në disa rrethe, ky rrjet ka qenë edhe më i dendur. Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit në zonat e Veriut, ku më përpëra nuk kishte qendra grumbullimi, me punën e mirë sqaruese që bënë me fshatarët, ndihmuan në ngritjen e rrjetit të baxhove dhe të pikave të grumbullimit të qumshtit.

Por, megjithëse në vitin 1958 është industrializuar afër 4,5 herë më tepër qumësht se në vitin 1955, ose 80 për qind më shumë se në vitin 1957, përsëri masat organizative kanë qenë të pamjaftueshme për të marrë qumësht në të gjitha fshatrat. Në tërësi kontraktimi i qumshtit u fillua me vonesë në disa rrethe, numri i pikave të grumbullimit ka qenë i kufizuar dhe në disa të tjera baxhot nuk u hapën në kohën e duhur dhe ndjekja e realizimit të kontratave ka pasur të meta të mëdha. Grumbullimi i qumshtit do të kishte shkuar më mirë në qoftë se në disa rrethe, si në atë të Vlorës, i cili ka realizuar vetëm 60 për qind të kontraktimit, në atë të Krujës — 68 për qind etj., nga puna e dobët dhe nga pikëpamja jo e drejtë që kanë disa drejtues kooperativash bujqësore, nuk do të vërtetoheshin raste që të shpërndajaq në favor të anëtarëve qumësht i bagëtive kolektive, megjithëse oborret kooperativiste kanë sigruuar qumësht nga bagëtia e tyre.

Në tërësi, nga 140 000 hektolitra qumësht që kooperativat e konsumit kontraktuani me kooperativat bujqësore, u realizuan vetëm 85 000 kv. ose 60 për qind e tij. Ka mjaft rrethe ku përqindja e qumshtit që i

është shitur shtetit nga kooperativat bujqësore është e ulët. Kështu p.sh. kooperativat bujqësore të rrethit të Lushnjës, deri në fund të gushtit, shitën vetëm 40 për qind të sasisë së qumshtit të kontraktuar, ato të rrethit të Beratit — 50 pér qind etj. Kooperativa bujqësore e Qeretit në Lushnjë, gjatë 4 muajve të parë të vitit 1958, ka dorëzuar vetëm 37,5 pér qind të qumshtit të mjelë, ajo e Rrëmbecit në Korçë — 49 pér qind, e Leshnicës në Pogradec — 59 pér qind e të tjera. Duket qartë se 'puna e organizatave të Partisë dhe e kryesisë së kooperativave, si dhe puna e organeve grumbulluese të qumshtit në këto raste nuk ka qenë e kënaqshme.

Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit duhet t'u shpjegojnë kooperativave dhe blegtorëve privatë me durim dhe me bindje leverdinë që ata kanë, duke kontraktuar dhe duke i shitur qumësht shtetit. Nga ana tjetër, entet grumbulluese të qumshtit dhe organet e tregëtisë duhet të marrin masa dhe t'ua plotësojnë me kohë prodhuesve të qumshtit kërkcsat e përcaktuara në kontratat. Kujdes i veçantë duhet të tregohet pér grumbullimin e qumshtit edhe në blegtorët privatë dhe oborret kooperativiste. Ata sot kanë rrith 80 pér qind të gjithë prodhimit të qumshtit në Republikë, ndërsa këtë vit nga ky sektor është grumbulluar vetëm 32,5 pér qind e planit të grumbullimit të qumshtit.

E meta në punën e grumbullimit të qumshtit nuk qëndron vetëm në rrjetin e pamjastueshëm të baxhove dhe të pikave të grumbullimit, por edhe në mungesën e mjeteve dhe të veglave të përshtatshme, në mjetet e transportit dhe të ruajtjes, në manipulimin e 'prodhimeve dhe në konservimin e mirë të tyre.

Tregëtimi i qumshtit në qytete nuk bëhet si duhet, mungojnë bazat e domosdoshme materiale dhe nuk i sigurohet një furnizim i rregullt popullsisë. Në shumë qytete kryesore mungojnë edhe punishte të thjeshta përzierjen dhe ambalazhimin e qumshtit, pa folur këtu për impiante për pastërizimin e tij. Edhe në Tiranë, ku nevojat janë më të theksuara, nuk ka asnje qendër të përshtatshme, si rrjedhim tregëtimi i tij bëhet në mënyrë primitive, duke mos iu përgjegjur si duhet furnizimit të popullit. Organizatat që tregëtojnë qumshtin nuk janë pajisur me mjetet dhe me kuadrin e nevojshtëm për grumbullimin dhe shpërndarjen e qumshtit sipas standardeve. Këto mungesa bëjnë që edhe tregëtimi i qumshtit dhe i nënprodhimeve të tij të bëhet në mënyrë jo të kulturuar. Nëse do të merreshin masa, ka mundësi që në qytete të tregëtohet qumësht dhe kos me shishe.

Problemi më i vështirë sot është sasia e qumshtit që tregëtohet në qytete. Kjo sasi është fare e pamjafueshme për pjesën më të madhe të viti. Edhe nënprodhimet e qumshtit, si djathërat, gjalpi i freskët, krema e qumshtit dhe kajmaku, për arësyen të sasive të kufizuara për treg, tregëtohen periodikisht dhe jo në mënyrë të vazdueshme, gjë që shkakton çrrëgullime në furnizimin e popullit.

Për përmirësimin e furnizimit të popullsisë lind nevoja që tregëtia në qytete, jo vetëm të furnizohet me sasi më të mëdha qumshti, por të sigurohen pajisje të posaçme për një trajtim të kulturuar të qumshtit. Është e domosdoshme që në vitet e ardhshme, duke filluar që nga viti 1959, të sillen më shumë materiale

edhe për grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit.

Megjithëse plani i prodhimit të bulmetrave ka ardhur duke u rritur vazhdimisht, investimet lidhur me përpunimin e tyre dhe me bazën e depozitimit dhe të konservimit, për shkak të kujdesit të pamjaftueshëm në këtë drejtim të vetë Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit, janë shumë të vogla.

Plani i furnizimit të industrisë së qumshtit me materiale nga të vendit dhe të importit është realizuar shumë dobët dhe jo në kohë. Ministria e Tregëtisë nuk i ka realizuar detyrat në këtë drejtim, ndërsa Ministria e Industrisë nuk ka marrë masa serioze për realizimin e planit të vozave, i cili si 6-mujor u realizua vetëm 60 për qind. Nga ana tjeter, një pjesë e vozave ka qenë me cilësi të dobët. Kjo gjendje ka rrezikuar vazhdimisht cilësinë e bulmetrave, ka ngritur koston e tyre dhe është bërë pengesë serioze për realizimin e planit.

Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe organet e tij në rrethe nuk e kanë organizuar si duhet punën për grumbullimin dhe për industrializimin e qumshtit. Ato kanë punuar dobët për grumbullimin e qumshtit të lopës dhe të dhisë, sidomos në fillim të stinës, të shtyra edhe nga fakti se këto lloje qumshti përpunoohen me humbje. Humbjet në baxho rëndohen edhe përfaktin se në fillim dhe në mbarim të stinës ato përpunojnë sasi shumë të vogla qumshti.

Një përgjegjësi të madhe ka Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit për preqatitjen e kuadrit. Të meta ka edhe në trajtimin e punonjësve në baxho, ku kushtet e punës dhe të jetesës janë akoma të dobëta.

Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit duhet të marrë masa serioze për përmirësimin e shpejtë të kësaj gjendjeje.

Duhet të bëhen më shumë investime për grumbullimin dhe për përpunimin e bulmetrave. Rritja e prodhimit të qumshtit, që parashikohet, duhet të na bëjë t'i dalim situatës përpura. Të shtohen shumë pikat e grumbullimit të qumshtit. Për këtë duhen siguruar me kohë enët e nevojshme dhe mjetet për ta transportuar qumshin në qendrën e përpunimit. Sa më afër prodhuesve të qumshtit të ngremë pika grumbullimi aq më shumë qumësht do të grumbullohet.

Të forcohet mirë puna në qendrat e përpunimit të qumshtit, të merren masa për edukimin dhe për pregatitjen e kuadrit të përpunimit të bulmetrave, të shtohen llojet e prodhimeve nga qumshti, sidomos llojet dhe cilësia e djathit, të merren masa për anën higjenike në qendrat e përpunimit të bulmetrave. Të luftohet për uljen e shpenzimeve dhe për uljen e kostos së bulmetrave të përpunuara. Të shfrytëzohen për nevoja të blegtorisë mbeturinat që dalin nga përpunimi i bulmetrave, sidomos hirra, e cila është mjaft e vlefshme për ushqimin e derrit. Organet e përpunimit të qumshtit të marrin masa që të mos shkojnë dëm si deri sot mbeturinat e përpunimit të bulmetrave.

Për të plotësuar gjithnjë e më shumë kërkesat e konsumatorëve me bulmetra të cilësisë së lartë dhe me shumë lloje prodhimesh, duhet të bëhet riorganizimi i mëtejshëm i rrjetit të baxhove, me të gjitha pajisjet e ndryshme të prodhimit. Sipas zhvillimit dhe rritjes së aktivitetit të bëhet gradualisht modernizimi

dhe pajisja e tyre me mjete që t'i përgjigjen perspektivës së afërt të shtimit të qumshtit dhe rishikimi i procesit teknologjik të prodhimit të bulmetrave. Të sigurohen me kohë të gjitha mjetet e prodhimit në baxho, kuadri teknik, ambalazhet, mjetet e transportit, si dhe vendet e depozitimit dhe të ruajtjes së bulmetrave.

Duke u mbështetur në shtimin e numrit të kërçeve të bagëtive pëlleja, si dhe në prodhueshmërinë e tyre, grumbullimi i qumshtit në vitin 1965 duhet të rritet nga 58 000 ton që është plani i viti 1960, në rreth 100 000 ton. Më shumë se gjysma e sasisë së planifikuar duhet të industrializohet në formë gjalpi, djathi dhe prodhime të tjera. Për këtë qëllim, gjatë pesëvjeçarit të tretë të studjohet mundësia për ngritjen e disa fabrikave për përpunimin e kondensimin e qumshtit si edhe të një sërë baxhosh. Të ndërtohen gjithashtu depot dhe frigoriferët e nevojshëm për konservimin e bulmetrave.

Krahas masave që do të merren për përpunimin e qumshtit duhet të mendohet që më parë për sigurimin e kuadrit të nevojshëm teknik, duke dërguar edhe jashtë shtetit për specializim nxënës dhe punonjës nga të praktikës.

Me sigurimin e bazës së sipërme tekniko-materiale do të bëhet i mundshëm zgjerimi i asortimenteve të reja, përmirësimi i cilësisë dhe ulja e kostos së qumshtit.

Për furnizimin e qytetit të Tiranës me qumësht të studjohet mundësia e ndërtimit të një fabrike për pastërizimin e qumshtit dhe përpunimin e asortimenteve të konsumit për popullin, gjithsejt 40 ton qumësht në 24 orë. Të shihet mundësia e ngritjes së fabrikave të

tilla, me aftësi prej 10 ton secila në 24 orë edhe në qytetet Durrës e Shkodër.

Për tregëtimin e qumshtit me shishe, Ministria e Industrisë të sigurojë prodhimin e shisheve të nevojshme për këtë qëllim.

Tani që jemi përpara stinës së re të industrializimit të qumshtit komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive dhe kooperativat e konsumit, të shqyrtojnë me urgjencë masat preqatitore për këtë punë dhe ta shtrojnë problemin me kooperativat bujqësore dhe me ekonomitë fshatare, për të përfunduar sa më parë kontraktimet dhe për të filluar në kohën e duhur nga puna për industrializimin e qumshtit.

2) Mbi industrializimin e mishit.

Mungesa e industrializimit të mishit bën që të kemi dëme të mëdha në ruajtjen e tij. Metodat primitive të konservimit të mishit që praktikohen në zona malore, jo vetëm që janë të papërshtatshme, por praktikohen në sasi të kufizuara.

Përpunimi industrial i mishit që bëhet sot në disa punishte primitive në Shkodër, Korçë e Tiranë, nuk ngre ndonjë peshë të madhe dhe assortimentet janë të varfëra si nga ana e cilësisë ashtu edhe të llojit. Edhe tregëtimi i mishit, që konservohe, nuk bëhet në mënyrë të kulturuar. Për arësyte të kostos së lartë çmimi i sallameve dhe i mishit të konservuar nuk preferohet nga konsumatorët. Me shtesën e mishit, që parashikohet gjatë këtyre 7 vjetëve, duhet të merren masa që tani për industrializimin e një pjese të konsiderueshme të

tij. Të përmirësohen cilësia dhe assortimentet sipas kërkësave dhe shijeve të popullit dhe të lehtësohen punonjësit, sidomos ata që janë në marrëdhënie pune për të gjetur në treg prodhime mishi të gatshme për ushqimin e tyre.

Qeveria duhet të marrë masa që në një të ardhshme jo të largët të sigurohen mjetet për përpunimin e jo më pak se 1 300 ton mish, duke prodhuar lloje të ndryshme sallamesh. Të merren masa që të shpejtohet ndërtimi i kombinatit të mishit, që parashikohet të ngrihet në Tiranë, i cili të ketë një kapacitet për therjen dhe për manipulimin e jo më pak se 9 000 ton mishit në vit dhe të përpunojë 1 500 ton mish, nga të cilat sallame të ndryshme 600 ton, konserva mishi 600 ton dhe mish të kripur 300 ton. Në këtë kombinat të përpunohen edhe nënprodhimet e tjera të mishit si gjaku, zorrët, mëlçia e zezë e të tjera për qëllimet e industrisë ushqimore, si dhe për nevoja të tjera si për preqatitjen e miellit të mishit, përpunimin e gjakut, shfrytëzimin e koskave për nevojat e bujqësisë etj.

Me qëllim që të mënjanohen humbjet e mëdha të blegtorisë të caktuar për therje si majmëria dhe pesha e tyre, për t'i siguruar popullit një furnizim të rregullt mishi të cilësisë së mirë, të merren masa që të shpejtohet ndërtimi i frigoriferëve të planifikuar për pesëvjeçarin e dytë dhe të avancohet afati i ndërtimit të frigoriferëve të paraparë për ndërtim gjatë pesëvjeçarit të tretë.

Krahas ndërtimit të kombinatit të mishit dhe të frigoriferëve, Ministria e Industrisë dhe Komiteti Shtet-

tëror i Grumbullimeve të marrin masa për preqatitjen e kuadrit të nevojshëm teknik dhe specialist, që do të merret me drejtimin e kësaj dege të industrisë dhe me përpunimin e me konservimin e mishit.

Punishtet ekzistuese të mishit të pajisen më mirë me mjete dhe me vegla të nevojshme dhe pranë Kombinatit të Peshkut në Vlorë të ngrihet aneksi i nevojshëm për konservimin e mishit.

Me qëllim që prodhimet e mishit dhe mishi i konservuar të përhapen sa më shumë në popullsinë e qyteteve të bëhen të gjitha përpjekjet për uljen e kostos dhe për përmirësimin e cilësisë. Byroja e çmimeve pranë Kryeministrisë, në bashkëpunim me organet e interesuara, duhet të studjojnë çështjen e kostos, çmimet për asortimentet e ndryshme të prodhimeve të konservuara dhe të bëhen korrigimet e nevojshme.

Shtimi i mishit dhe i qumshtit në atë shkallë, që parashikohet, kërkon mobilizimin e gjithanshëm të të gjitha forcave në fshat, të kooperativave bujqësore, të fshatarësisë në përgjithësi, të teknikëve dhe të specialistëve, të forcave të Partisë dhe të organeve të pushtetit.

Për realizimin me sukses të detyrave që shtron ky plenum, krahas masave që u përmendën më lart, është e nevojshme të shikohen dhe këto çështje të tjera të rëndësishme:

- 1) Problem me rëndësi për zhvillimin e blegtorisë dhe për shtimin e prodhimeve blegtorale është edhe sigurimi i interesit material, duke krijuar leverdisshmëri më të madhe për mish. Kjo do të nxitë rritësit e bëgëtive të zhvillojnë të gjitha degët e blegtorisë, të

rritin bagëti që prodhojnë më shumë mish dhe të cilësisë së mirë.

Duhet të rregullohet raporti i çmimeve për qumshtin dhe mishin, që me sa duket nuk janë ndërtuar drejt midis tyre dhe në raport me drithërat. Megjithëse ka rezerva të mëdha për uljen e kostos, prapëseprapë kostoja e të gjitha llojeve të mishit është më e lartë nga çmimi i tepricave, siç u tregua edhe më lart. Një çrregullim i tillë i vë prodhuesit e mishit në pozita jo të favorshme për shtimin e prodhimit, sidomos të derrit, prandaj duhet shikuar sa më parë çmimi i blerjes së mishit të derrit. Të vendosen çmime që të ngjallet interesit material për rritësit e derrave. Pa një masë të tillë rritja e derrit bëhet e vështirë.

2) Të organizohet më mirë ndjekja e realizimit të planeve lidhur me prodhimin e mishit e të qumshtit, me qëllim që të bëhet i mundur kontrolli preventiv. Të bëhet rregull që Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve të raportojnë disa herë gjatë viti mbi realizimin e planit të mishit dhe të qumshtit, si për kooperativat bujqësore, ashtu edhe për ndërmarrjet bujqësore shtetërore siç bëhet sot edhe për çështjet e tjera ekonomike më të rëndësishme.

3) Parashikimet në lidhje me përmirësimin e raccave dhe me shtimin e prodhimtarisë së gjësë së gjallë kërkojnë marrjen e masave serioze në lidhje me përmirësimin e drejtimit të sektorit të blegtorisë, me pregatitjen dhe kualifikimin e kuadrove me arësim të lartë, të mesëm dhe të ulët. Të merren masa që kuadrot, të cilët mbarojnë institutin dhe teknikumet bujqësore të jenë në gjendje të bëjnë bonitimin e gjësë së gjallë, të-

dinë të bëjnë ndërzinmin artificial në kafshë, të përcaktojnë pjesët përbërëse të qumshtit, të njohin teknologjinë e përpunimit të tij, të dinë mbi preqatitjen e gjalpit, djathërave të ndryshme etj. Pranë Institutit Zooteknik dhe atij të veterinarisë, si dhe në ndërmarrjet bujqësore shtetërore më të mira, të organizohen kurse dhe seminare për kualifikimin e specialistëve, si dhe përgritjen e një numri të madh brigadierësh të fermave blegtoriale, mjelësesh, teknikësh për ndërzinmin artificial dhe specialistësh të tjera.

4) Të përmirësohet rrënjosisht puna në Institutin Zooteknik të Shkodrës dhe në Institutin e Kërkimeve Veterinare të Tiranës. Transformimi rrënjosor i përbërjes së gjësë së gjallë, që parashikohet, kërkon që e gjithë kjo punë e madhe t'i nënshtrohet një studimi të vazhdueshëm sistematik dhe një kontrolli shkencor. Në planin perspektiv të kërkimeve shkencore të institutit të parashikohen: studimi i përmirësimit të gjedhit të Shkodrës në vetëvete dhe me anë të kryqëzimit, përmirësimi i gjedhit të vendit me racën Xhersej dhe me racat e tjera që do të sillen, të studjojë për dhentë aklimatizimin e racave të sjella nga jashtë dhe rezultatet e kryqëzimit të dhenve të vendit me to, duke i dhënë praktikës rekomandime të vlefshme për punën e përmirësimit të mëtejshëm të racave, të studjojë njëkohësisht metodat e organizimit të bazës ushqimore dhe të të ushqyerit të kafshëve në kooperativat bujqësore dhe në fermat shtetërore, si dhe çështjen e ngritjes së rendimentit të kullotave dhe të livadheve natyrale. Instituti duhet të fillojë të merret edhe me studimin e çështjeve

ekonomike dhe organizative të blegtorisë, gjë që sot nuk bëhet fare.

Shokë,

Detyrat që do të dalin nga ky plenum janë shumë të mëdha dhe të rëndësishme, pse kanë të bëjnë me një rritje të dukshme të blegtorisë, me zhvillimin e të gjitha degëve të saja, me shtimin e numrit të kërçeve dhe të prodhueshmërisë së tyre, me një furnizim më të mirë të popullit me quniësht, mish dhe yndyrna.

Nuk ka dyshim se pa mobilizimin e të gjitha forcave të Partisë, pa organizimin dhe pa udhëheqjen e punës nga ana e organizatave të Partisë në rrethe, në ndërmarrje, në kooperativa bujqësore ose në fshatra, pa një punë të madhe politike që duhet të bëjë Partia me masat punonjëse të bujqësisë, nuk mund të pritet zgjidhja e detyrave që shtrohen.

Partia ka një forcë shumë të madhe në fshat, 37,20 për qind e të gjithë efektivit të anëtarëve të saj punon në fshat, në kooperativat bujqësore dhe në ndërmarrjet shtetërore të bujqësisë. Por forca e Partisë në fshat nuk është vetëm kjo. Organizata e rinisë, që është rezerva kryesore e Partisë, ka rreth 63 000 anëtarë që punojnë në fshat, në bujqësi e në blegtori dhe dihet se sa luftëtare e vendosur është rinia jonë në zbatimin e detyrave që shtron Partia. Në qoftë se organizatat e Partisë të rretheve do ta marrin seriozisht në dorë edhe 'problemin e blegtorisë, sikurse kanë marrë shumë probleme të tjera, në qoftë se ato do t'i mobilizoj-

në dhe do t'i udhëheqin si duhet forcat e rinisë dhe të levave të tjera të Partisë në fshat si organizatën e Frontit, të gruas etj., në qoftë se organizatat e Partisë të çdo fshati ose kooperative do të ndjekin me shumë kujdes zbatimin e detyrave në çdo fshat ose kooperativë, vështirësitë që kemi përpara do të kapërcehen me sukses.

Dihet se pa zhvillimin e shpejtë të bujqësisë dhe sidomos pa shtimin e prodhimit të drithërave nuk mund të zhvillohet as blegtoria. Këto dy degë të rëndësishme të ekonomisë bujqësore janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetren dhe zhvillimi jo i harmonizuar i tyre, pengon zhvillimin e bujqësisë në përgjithësi. Nga zhvillimi i kulturave të arave dhe nga ngritja e prodhimit për çdo hektar të kulturave të ndryshme bujqësore, *veçanërisht nga shtimi i prodhimit të drithit, sidomos i drithërave të bukës dhe nga sigurimi i bukës në vend*, varet shumë zhvillimi i blegtorisë. Është vështirë, në mos e pamundur, që ekonomia bujqësore të rritë blegtorinë ashtu si duhet kur nuk ka sigruar bukën në radhë të parë, kur nuk siguron ushqimet e nevojshtme të njoma ose koncentrate për blegtorinë. Prandaj, *zgjidhja në vend e problemit të drithërave, sidomos e drithërave të bukës, qëndron kurdoherë detyrë e parë* dhe themelore për Partinë tonë. Partia duhet të luftojë me të gjitha forcat që t'i arrihet këtij qëllimi në kohën sa më të shkurtër. Për zgjidhjen me sukses të këtij problemi Partia duhet të përqëndrojë akoma më shumë kujdesin në realizimin dhe në tejkalimin e planit të hapjes së tokave të reja, të shtohet sipërfaqja e mbjellë, të shfrytëzohen të gjitha mundësítë

për rritjen e prodhueshmërisë së kulturave bujqësore për çdo hektar tokë, të bëhet shfrytëzimi më i plotë dhe më me ekonomi i tokës, duke marrë dy ose më shumë prodhime në vit nga çdo hektar tokë, gjë që është e mundshme në kushtet klimatike që ka vendi ynë, t'i kushtohet vëmendje ngritjes së nivelit agro-teknik dhe zooteknik të punonjësve, si dhe futjes së agroteknikës dhe eksperiencës së përparuar në shkallë të gjerë, si në bujqësi ashtu dhe në blegtori.

Marrja e të gjitha këtyre masave është vendimtare jo vetëm për zhvillimin e bujqësisë dhe për shtimin e prodhimit bujqësor, por për zhvillimin me një ritëm më të shpejtë të blegtorisë dhe shtimin e prodhimeve blegtoriale.

Çfarë kërkohet në radhë të parë për zgjidhjen me sukses të detyrave që shtrohen? Kërkohet organizimi i mirë i punës, si nga ana e Partisë ashtu edhe nga ana e organeve të pushtetit dhe sidomos e organeve drejtuese të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe të kooperativave bujqësore.

Me masat që mori Komiteti Qendror për thjeshtimin e aparateve të Partisë dhe të shtetit dhe, në mënyrë të veçantë, me riorganizimin që iu bë punës së Partisë dhe të pushtetit në rrethe dhe në bazë, baza po ndihmohet më mirë, organet udhëheqëse në rrethe janë më afër prodhimit, i njojin më mirë problemet dhe e ndjejnë më direkt përgjegjësinë që kanë për zbatimin e detyrave. Por çështja është që të mos kënaqemi me këto masa organizative që u morën, ne jemi akoma larg asaj që kërkohet. Sot ekonomia në përgjithësi zgjerohet, zhvillohet dhe bëhet më e ndërlikuar.

Ekonomia bujqësore, e cila shkon drejt përfundimit të kolektivizimit, duhet drejtar mirë dhe të zhvillohet në të gjitha drejtimet. Partia shtron detyrën që fshati i kolektivizuar të ngrihet shpejt ekonomikisht, të zhvillojë të gjitha degët e bujqësisë dhe të blegtorisë, të zhvillohet kultura, të ngrihet niveli kultural dhe agroteknik i punonjësve të bujqësisë, të ndërtohet jeta e re në fshat. Prandaj, detyrat që u dalin sot organeve të Partisë dhe të pushtetit për transformimin socialist të fshatit dhe për zhvillimin e shpejtë të ekonomisë kolektive, janë të ndërlikuara dhe me përgjegjësi të madhe.

Me të drejtë Komiteti Qendror vazhdimisht e ka ngritur dhe e ngre gjithmonë problemin e prebatitjes së kuadrit, të edukimit dhe të specializimit të tij, si një çështje themelore për zgjidhjen me sukses të të gjitha detyrave. Kuadri është ai që do të luajë rolin kryesor në forcimin organizativ të punës, ai do ta organizojë punën, do t'i edukojë masat me parti ose pa parti dhe do t'i udhëheqë ato për zgjidhjen e detyrave.

Vendimet e rëndësishme që ka marrë Partia për shumë çështje dhe në mënyrë të veçantë për bujqësinë dhe për blegtorenë nuk mund të vihen me sukses në jetë pa udhëheqës dhe pa organizatorë të aftë. Pregatitja e kuadrit, lidhja e tij ngushtë me praktikën, vendosja e tij në vendin ku jep më shumë, duhet të kon siderohet si një nga detyrat kryesore të Partisë. Por aftësia e kuadrit nuk duhet të matet vetëm nga njëra ose tjetra shkollë që ka mbaruar sa për të fituar një specialitet. Shkolla është e domosdoshme dhe Partia duhet të punojë që kuadrot, të cilët drejtojnë punën

e Partisë ose të pushtetit, në ndërmarrje shtetërore, në kooperativa ose në fshat, të mësojnë në shkolla, të fitojnë dijeni, të kenë një specialitet, por kjo nuk është e tëra. Neve na duhen kuadro që ta duan punën, të jenë të lidhur ngushtë me jetën, t'i njojin nga afër problemjet, të mos përtojnë të shkojnë në fshat, në kooperativa, ose në ndërmarrje, ta dëgjojnë me vëmendje masën, të përfitojnë nga sugjerimet dhe eksperienca e saj e pasur, t'i mësojnë me durim fshatarët dhe kooperativistët si ta organizojnë mirë punën, si ta vënë në jetë eksperiencën e përparuar në bujqësi dhc në blegtori, si ta ngrenë shpejt ekonominë dhe jetën e re në fshatin ose në kooperativën e tyre.

Punonjësit e Partisë, të gjithë komunistët në fshat, punonjësit e pushtetit që kanë të bëjnë me fshatin, duhet t'i njojin mirë problemet e fshatit, sidomos problemet e bujqësisë dhe të blegtorisë. Ka kaluar koha e agjizacionit dhe e fjalëve. Sot punonjësit e Partisë ose të organeve të pushtetit nuk mund të drejtojnë me fjalë të përgjithshme dhe me agjacion. Kooperativistët, punonjësit e bujqësisë të fshatit ose të ndërmarrjeve kërkojnë ndihmë konkrete për të zgjidhur problemet e vështira që kanë përpara. Prandaj, punonjësit e Partisë dhe të organeve shtetërore që kanë të bëjnë me bujqësinë dhe me fshatin do të drejtojnë mirë, do të fitojnë besimin, dashurinë dhe respektin e kooperativistëve dhe të fshatarëve, kur me punën e tyre, me shembullin e tyre, t'u tregojnë fshatarëve dhe kooperativistëve se ata dinë jo vetëm të flasin, por edhe si t'i vënë vetë në jetë ato që flasin. Kuadrot e Partisë dhe të pushtetit që punojnë në fshat duhet t'i njojin mirë

problemet e ndërtimit organizativ dhe ekonomik të kooperativave bujqësore, t'i njojin mirë problemet e bujqësisë dhe të blegtorisë, pse pa njojjen e tyre drejtimi i punës është i vështirë dhe nuk do të japë frutet e duhura.

Partia duhet të bëjë shumë për të nxitur iniciativën e bazës, të forcojë edhe më shumë ndjenjën e përgjegjësisë në organizatat e Partisë në fshat, te komunistët, te kryesitë dhe asambletë e kooperativave, te këshillat popullore të fshatrave dhe të lokaliteteve, të cilave u është besuar drejtimi i punës. Nxitja e iniciativës dhe e ndjenjës së përgjegjësisë në bazë, jo vetëm do të bëjë që detyrat, të cilat shtrohen, të realizohen me sukses, por edhe të zbulohen e të vihen në shërbim të ekonomisë shumë rezerva të panjohura.

Shokë,

Është e drejtë që të përqëndrohet i gjithë kujdesi i organizatave të Partisë dhe i organeve të pushtetit në drejtim të zhvillimit të ekonomisë, pse, kur populli sheh se gjithshka thotë Partia për mirëqenien e popullit, konkretizohet në të mirat materiale, në përmirësimin e jetës së tij, ai e kupton më mirë se sa e drejtë është via e Partisë, ai e sheh se ku do ta çojë Partia popullin me ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit.

Por a mund të ndahen problemet ekonomike nga problemet organizative, ideologjike dhe politike? Jo. Partia ka thënë se pa forcimin organizativ të saj, pa

forcimin e jetës së brendshme të saj, pa ngritjen ideologjike të komunistëve, pa një punë politike të vazhdueshme me masat është e pamundur që të zgjidhen me sukses problemet ekonomike.

Komititetet e Partisë në rrethe dhe organizatat bazë duhet të mos largojnë kujdesin nga çështjet kryesore të Partisë, sikurse janë: forcimi i jetës së brendshme të Partisë, ngritja e nivelit ideologjik dhe politik të komunistëve dhe të masave pa parti. Sot, më tepër se kurrë, kur armiqtë e paqes, me imperializmin amerikan në krye, luftojnë me të gjitha forcat kundër kampit të fuqishëm të socializmit, të kryesuar nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik, kur armiqtë e marksizëm-leninizmit dhe revisionistët e çdo ngjyre, me revisionistët jugosllavë në krye, të vënë në shërbim të imperializmit, sidomos të imperializmit amerikan, kanë shpërthyer fushatën e tyre të poshtër kundër Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, kundër partive komuniste dhe punëtore motra dhe në mënyrë të veçantë kundër Partisë dhe vendit tonë, forcimi i punës organizative, ngritja më lart e nivelit ideologjik të Partisë dhe edukimi politik i masave, duhet të konsiderohen nga të gjitha organizatat e Partisë, nga të gjithë komunistët, nga kuadrot e Partisë dhe të shtetit, si detyra themelore ku duhet të përqëndrohet vëmendja.

Duhet të demaskohen pa mëshirë imperialistët dhe shërbëtorët e tyre si armiq të socializmit dhe të paqes, duhet t'u bëhet një luftë e vendosur deri në shkatërrimin e plotë të revisionistëve, të cilët i kanë tradhëtuar interesat e klasës punëtore dhe janë armiq të betuar të marksizëm-leninizmit.

Shokë,

Partia jonë e lavdishme e ka udhëhequr dhe do ta udhëheqë kurdoherë popullin tonë drejt fitoreve të reja, në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit, pse ajo në këtë rrugë ndriçohet nga doktrina e madhe jetëdhënëse e marksizëm-leninizmit. Ajo ka korruar dhe do të korrë kurdoherë fitore në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Partia jonë do të fitojë mbi armiqëtë e çdo ngjyre, pse ajo është e fortë si populli ynë, pse anëtarët e saj i qëndrojnë besnikë deri në vdekje çështjes së madhe për të cilën lufton ajo. Populli ynë është i lidhur si mishi me thoin me Partinë e tij, e do dhe e mbron atë si drithën e syrit, pse në të ka parë kurdoherë udhëheqësen e tij të lavdishme, që i siguroi lirinë dhe pavarësinë, miqësinë me popujt e lavdishëm të Bashkimit Sovjetik dhe miqësinë me popujt e kampit të fuqishëm të socializmit. Ai sheh te Partia garancinë e së ardhshmes së tij të lumtur.

Me të drejtë populli ynë dhe anëtarët e Partisë sonë krenohen që kanë në krye një parti marksiste-leniniste, sikurse është Partia jonë, e cila të gjitha energjitet e saja i shkrin për mirëqenien dhe për lumturinë e popullit.

Nuk ka kënaqësi dhe inkurajim më të madh për ne, komunistët, dhe për të gjithë popullin tonë, kur shohim se çfarë simpatie, dashurie dhe respekti gëzojnë populli dhe Partia jonë nga partitë komuniste dhe punëtore motra dhe nga popujt e vendeve të tyre. Kjo, shokë, është merita e madhe e Partisë sonë, e cila e ka mbroj-

tur si gjënë më të shtrenjtë marksizëm-lininizmin, punon me të gjitha forcat për ruajtjen dhe për forcimin e unitetit të kampit tonë të fuqishëm të socializmit, bën një luftë konsekiente, pa lëkundje kundër armiqve të paqes, armiqve të socializmit, revisionistëve modernë etj., për mbrojtjen dhe për triumfin e marksizëm-lininizmit.

Partia jonë marksiste-leniniste do ta udhëheqë kurdoherë popullin në rrugën e lavdishme të socializmit dhe të komunizmit.

Botuar për herë të parë me shkurttime në gazeten «Zëri i Popullit», Nr. 266 (3167).

5 nëntor 1958

Botohet me ndonjë shkurtim sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA
SOVJETIKE NË TIRANË ME RASTIN E
41-VJETORIT TË REVOLUCIONIT
SOCIALIST TË TETORIT**

7 Nëntor 1958

I dashur shoku ambasador,
Të dashur shokë dhe miq,

Sot popujt vëllezör të Bashkimit Sovjetik, popujt e vendeve të kampit socialist dhe populli ynë veçanërisht, festojnë me entuziazëm 41-vjetorin e Revolucionit të madh socialist të Tetorit, që përmbysi përgjithmonë sundimin e egër të çifligarëve e të borgjezisë në një të gjashtën e botës, që solli vendosjen e pushtetit sovjetik në Rusi dhe hapi një epokë të re, epokën më të shkëlqyer në gjithë historinë e zhvillimit njerëzor, epokën e shembjes së kapitalizmit, epokën e triumfit të socializmit e të komunizmit.

Triumfi i Revolucionit socialist të Tetorit, jo vetëm që çoi në vendosjen e pushtetit të Sovjetëve në të gjithë Rusinë, por ngjalli shpresat në zemrat e të gjithë popujve në botë për një jetë më të mirë, për një të ardhshme më të lumtur, për realizimin e ëndrrave të

tyre shekullore. Dhe ata nuk u gabuan. Bashkimi i lavdishëm Sovjetik, që në ditët e themelimit të tij, u bë feneri që u ndriçoi rrugën popujve për jetën e lumenjtur, për socializmin, komunizmin dhe paqen, ai u trengoi popujve se ç'mund të bëjnë masat kur kanë në dorë pushtetin dha udhëhiqen nga një parti marksiste-leniniste. Punëtorët dhe fshatarët punonjës në të gjithë botën kuptuan edhe më mirë, se nën udhëheqjen e partive marksiste-leniniste në vendet e tyre, duke ecur nën flamurin e madh të Marksit dhe të Leninit sipas shembullit të shkëlqyer të proletariatit rus, mund të arrijnë fitoren e tyre mbi armiqtë shekullorë, mund të marrin fatet në duart e veta dhe ta ndërtojnë jetën dhe shoqërinë sipas vullnetit të tyre, pa shfrytëzues dhe pa shtypës.

Më kot imperializmi, i kryesuar nga ai i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i mbështetur nga forcat e brendshme kundërrevolucionare në Rusi, u orvat, me forcën e dollarit e të armës, me masakra e terror, të shtypte që në lindje pushtetin sovjetik, të mbyste me gjak Republikën e porsalindur Sovjetike. Më kot milionerët dhe miliarderët amerikanë, anglezë, francezë dhe të tjerë derdhën rrëkë floriri, më kot lanë koskat e tyre mijëra e mijëra mercenarë të huaj dhe tradhëtarë të brendshëm. Çështja e madhe e Sovjetëve, çështja e drejtë e proletariatit rus triumfoi, armiqtë u shkatërruan, populli mbrojti me heroizëm të pashoq pushtetin sovjetik, fitoret historike të vitit 1917.

E vështirë, por e lavdishme ka qenë rruga 41-vjeçare që kanë kaluar popujt sovjetikë nën udhëheqjen e Partisë heroike Komuniste. Ajo është një rrugë luftë-

rash heroike për mbrojtjen e pushtetit sovjetik nga imperialistët e tërbuar dhe në të njëjtën kohë një rrugë plot fitore të shkëlqyera në frontin e ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit.

Njerëzimi do të nderojë përjetë me respekt të madh kujtimin e heronjve të rënë në luftën për fitoren e proletariatit rus mbi borgjezinë e brendshme dhe ndërkombëtare. Ata derdhën gjakun e tyre të pastër në emër të idealeve më të larta që ka njojur deri sot njerëzimi, në emër të lirisë, të socializmit dhe të komunizmit. Bota do t'u jetë gjithashtu mirënjoyëse në shekuj luftëtarëve heroikë të Bashkimit Sovjetik, që ranë gjatë Luftës së madhe Patriotike; për mbrojtjen e atdheut të tyre dhe të qytetërimit botëror, për shpëtimin e njerëzimit nga fashizmi.

Veprimtaria dhe lufta e lavdishme e Partisë Komuniste që themeloi Lenin i madh, është shembull i shkëlqyer i luftës së pamëshirshme të partisë marksiste-leniniste për mbrojtjen e fitoreve të popullit, për mbrojtjen dhe forcimin e unititetit të radhëve të saja, për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit nga armiqtë e ngjyrave të ndryshme dhe, para së gjithash, kundër orvatjeve të revizionistëve dhe oportunistëve të të gjitha ngjyrave. Sikur Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik të mos kishte bërë një luftë të papajtueshme me armiqtë e saj, me renegatët e marksizëm-leninizmit, do të ishte e vështirë të mendohej për fitore të tilla historike botërore, si ato që ka korrur populli i madh sovjetik, nën udhëheqjen e partisë së tij të lavdishme, do të ishte vështirë që popujt e vendeve të demokracisë populllore të arrinin sot fitoret e mëdha të ndërtimit me

sukses të socializmit, nën udhëheqjen e partive të tyre marksiste-leniniste.

41 vjetët që na ndajnë nga dita e 7 nëntorit të 1917-s janë vite plot fitore për popullin vëlla sovjetik në të gjitha fushat e jetës. Nga një vend i prapambetur në të gjitha fushat, siç ishte Rusia cariste, Bashkimi Sovjetik gjatë periudhës 41-vjeçare është kthyer në një vend industrial nga më të fuqishmit në botë, me bujqësinë, shkencën dhe teknikën më të përparuar në botë.

Në vitin 1957, në krahasim me vitin 1913, prodhimi i përgjithshëm industrial në Bashkimin Sovjetik ishte 33 herë më i madh, ndërsa prodhimi i energjisë elektrike 108 herë më i madh. Në të njëjtën kohë, në vandin më të fuqishëm dhe më të zhvilluar kapitalist, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë së njëjtës periudhë, prodhimi industrial është shtuar vetëm 4,1 herë, ndërsa prodhimi i energjisë elektrike 29 herë. Për të shtuar vëllimin e prodhimit industrial afërsisht tridhjetë herë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës u janë dashur 80 vjet, Anglisë — gati 150 vjet ndërsa Bashkimi Sovjetik gjatë 40 vjetëve ka shtuar prodhimin e përgjithshëm industrial 39 herë dhe prodhimin e mjeteve të prodhimit 74 herë. Këtu duhet thënë se, pothuajse 10 vjet nga kjo periudhë 40-vjeçare Bashkimi Sovjetik i ka kaluar në luftëra që i kanë imponuar agresorët imperialistë.

Suksese të mëdha ka arritur gjatë kësaj periudhe Bashkimi Sovjetik edhe në lëmin e bujqësisë.

41 vjet janë një periudhë relativisht e shkurtër në historinë e shoqërisë, por gjatë kësaj periudhe është shënuar një revolucion i vërtetë në shkencë dhe në

teknikë në Bashkimin Sovjetik. Shkenca sovjetike tashmë është vënë në pararojë të shkencës botërore. Ajo, me veprat e saja të shkëlqyera, është vënë në shërbim të paqes dhe të përparimit njerëzor. Të gjithë i dimë sukseset e mrekullueshme të shkencës sovjetike, me aeroplanët reaktivë për pasagjerë, me raketat balistike ndërkontinentale, me sputnikët e parë e me shumë vepra të tjera. Me këto fitore të shkëlqyera shkencëtarët sovjetikë kanë dhënë një kontribut të paçmueshëm në zhvillimin e mendimit njerëzor dhe në këtë mënyrë i kanë ngritur vetes dhe atdheut të tyre të lavdishëm një monument të përjetshëm. Shkencëtarët sovjetikë, në bashkëpunim të ngushtë me punonjësit e prodhimit, sot po punojnë për zbulime të reja, për shpejtimin e përparimit teknik, për ta çuar shkencën sovjetike akoma më përpara, duke e bërë atë një faktor shumë të rëndësishëm në forcimin e paqes dhe të mirëqenies së njerëzimit.

Shokë,

Periudha që ka kaluar që nga fitorja e Revolucionit të madh socialist të Tetorit ka vërtetuar plotësisht triumfin e ideve të mëdha e të pavdekshme të marksi-zëm-leninizmit, të ideve të socializmit e të komunizmit.

Nën influencën direkte të Revolucionit të Tetorit, në saje të Luftës së madhe Patriotike të Bashkimit Sovjetik dhe të heroizmave të pashoqe të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, si dhe të luftës çlirimtare të vetë popujve në radhë të parë, që vuanin nën zgjedhën

e fashizmit, lindën vendet e demokracisë populllore.

Ngjarje me rëndësi historike botërore, pas Revolucionit të Totorit, ishte fitorja e revolucionit populor në Kinën e madhe të Mao Ce Dunit, qërimi i 650 milion kinezëve nga zgjedha e huaj dhe e tradhëtarëve të brendshëm dhe kalimi i Kinës në rrugën e ndërtimit të socializmit e të komunizmit.

Imperialistët luftënxitës, veçanërisht imperialistët amerikanë, tmerrohen nga fitoret që po korr dita-ditës kampi i madh i socializmit, nga lufta e popujve të varur dhe kolonialë për qërimin e tyre kombëtar, nga lufta e gjithë popujve të botës për paqe e për demokraci. Ata duke u preqatitur për një luftë të re kundër vendeve tona, po ndërtojnë vazhdimisht baza të reja ushtarake, po kurdisin gjithfarë intrigash e komplotesh për të dobësuar vigjilencën dhe unitetin e popujve për paqe. Por orvatjet e tyre kriminale, si kurdoherë, do të dështojnë me siguri me turp edhe në të ardhshmen. Duke e ditur, që forca e kampit të socializmit qëndron para së gjithash në unitetin e radhëve të tija, në kompaktësinë e familjes sonë të madhe socialiste, armiqjtë imperialistë i drejtojnë të gjitha përpjekjet e tyre për dobësimin dhe minimin e unitetit tonë të çelniktë, në përgarjen e radhëve të partive komuniste dhe punëtore.

Në këtë drejtim imperialistët, si kurdoherë, mbësh-teten fuqimisht te agjentët e tyre brenda radhëve të partive të klasës punëtore, te renegatët e klasës punëtore, te armiqjtë e tërbuar të marksizmit, revisionistët. Klasës punëtore, marksizëm-leninizmit, partive komuniste dhe punëtore u ka qëlluar edhe në të kaluarën

të luftojnë kundër armiqve të tyre, kundër oportunistëve, revizionistëve, trockistëve dhe rrymave të ndryshme antimarksiste, por është e para herë në historinë e lëvizjes komuniste dhe punëtore ndërkombëtare, që partitë tona detyrohen të luftojnë kundër revizionizmit që është në fuqi, në shtet, siç është revizionizmi jugosllav dhe që fshihet e maskohet nën parullat e marksizëm-leninizmit. Pikërisht për këtë arësy partitë tona e kanë luftuar, e luftojnë dhe do ta luftojnë kurdoherë pa mëshirë, me të gjitha forcat e tyre, këtë agjenturë të rrezikshme të imperializmit siç janë revizionistët e Beogradit, që udhëheqin revizionizmin modern, sepse kështu dhe vetëm kështu ato kryejnë detyrën e tyre të lartë për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, të unititetit të kampit të socializmit, të Bashkimit Sovjetik dhe të jetës së popujve të tyre.

Revolucioni i Totorit i bashkoi popujt dhe vendet tona në një familje të vetme e të pathyeshme. Uniteti dhe kompaktësia jonë janë më të forta se kurrë dhe orvatjet e imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre, revizionistëve të Beogradit, do të dështojnë plotësisht përballë forcës sonë të pamposhtur.

Imperialistët nuk duan të kuptojnë që raporti i forcave në arenën botërore ka ndryshuar një herë e mirë në favor të socializmit, në dëm të imperializmit. Agresorët imperialistë, të udhëhequr nga imperialistët e tërbuar amerikanë, po vringëllojnë në çdo anë armët për të frikësuar popujt, për t'i nënshtruar dhe për t'i skillavëruar ata siç bënin dikur. Kjo duket qartë në ndërhyrjet e turpshme, por pa sukses të imperialistëve

amerikanë dhe anglezë në Liban dhe në Jordani, si edhe në ndërhyrjet brutale të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në çështjet e brendshme të popullit kinez. Por orvatjet e tyre për të pushtuar me forca të armatosura Libanin dhe Jordaninë dështuan. Dështuan gjithashstu edhe orvatjet e tyre për të zgjeruar agresionin në ndihmë të klikës së Çan Kai Shisë, brenda tokës kontinentale të Kinës. Populli vëlla kinez ka plotësisht të drejtë të bashkojë të gjitha tokat që përkohësisht vuajnë akoma nën regjimin e kalbur të Çan Kai Shisë dhe të banditëve amerikanë dhe ne jemi të sigurtë që ai do t'i çlirojë nga klika çankaishiste ishullin e Taivanit, Macu dhe ishujt e tjerë kinezë. Përpjekjet e monopolistëve amerikanë dhë të Dallesit, për të ndërhyrë në këtë çështje të brendshme të popullit kinez, do të dështojnë, se populli kinez është i vendosur për çlirimin e të gjithë atdheut të vet.

Sot situata është e tillë, që zor të guxojnë imperialistët të shpërthejnë luftë kundër vendeve të kampit socialist. Çdo njeri me mendje dhe me arësyen të shëndoshë nuk mund të mos shohë që sot Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të kampit socialist, gjenden në një shkallë të tillë zhvillimi, që orvatja për hapjen e një lufte të re kundër këtyre vendeve do të përfundonte me shkatërrimin e sistemit kapitalist. Natyrisht, mund të ketë njerëz të çmendur nga histeria e luftës për të ndezur luftën, por, siç thotë populli ynë, ka të urtë për të marrë dhe popujt do të dinë t'u vënë zinxhirët këtyre të çmendurve dhe do të jenë kurdoherë shumë vigjilentë.

Idetë e pavdekshme të Tëtorit të madh depërtuan

deri në skajet më të largëta të vendit tonë, deri në Shpellën e Dragobisë, ku patrioti i madh shqiptar, plaku i maleve, Bajram Curri, në luftën e tij kundër regjimit të satrapit Ahmet Zog, i varte shpresat e çlirimtë të popullit te vendi i Sovjetëve. Ai thoshte se populli ynë do ta fitojë lirinë vetëm atëhere kur të triumfojnë edhe te ne idetë e «hazretit Lenin». Dhe fjalët e tij u vërtetuan. Nën udhëheqjen e Partisë sonë heroike marksiste-leniniste që u themelua si nesër, 17 vjet më parë, në zjarrin e Luftës nacional-çlirimtare, në shembullin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, klasa punëtore dhe fshatarësia patriote e vendit tonë kryen revolucionin popullor, bënë të triumfojnë idetë e Leninit të madh, bënë të realizohen dëshirat e zjarra të popullit tonë heroik duke u vendosur pushteti i vërtetë popullor në Shqipëri, ku tani po ndërtohet me sukses shoqëria socialiste.

Sikurse të gjithë popujt e vendeve socialiste, sikundër i gjithë njerëzimi përparimtar, ashtu edhe populli shqiptar dhe Partia jonë e Punës, gjëzohen pa masë për sukseset madhështore të popujve vëllezër të Bashkimit Sovjetik dhe i shohin ato si suksese të vendit tonë, si suksese të të gjithë kampit socialist.

Marrëdhënet midis vendit tonë dhe Bashkimit Sovjetik kanë qenë gjithmonë marrëdhënie vëllazërore, të mbështetura në ndjenjat më të pastra të dashurisë dhe të miqësisë që ushqejnë popujt tanë për njëri-tjetrin, në parimet e internacionalizmit proletar. Ne do të bëjmë çdo gjë që këto lidhje kaq vëllazërore midis popujve dhe vendeve tona, midis të gjitha vendeve të kampit socialist të forcohen çdo ditë e më shumë për të mirën

tonë të përbashkët, për të mirën e të gjithë familjes sonë të madhe socialiste, për unitetin e çelniktë të kampit tonë të fuqishëm e të pamposhtur socialist.

Nuk ka sot forcë në botë që të ndalojë ecjen e vrullshme të shoqërisë drejt socializmit dhe komunizmit. Popujt, çdo vit, gjithnjë më shumë përqafojnë idetë e paqes, të socializmit, të komunizmit që u sigurojnë atyre një të ardhshme të lumtur e të begatshme. Këto ide nuk janë më ëndrra për njerëzimin. Ato janë kthyer në realitet të gjallë në Bashkimin Sovjetik, ato po triumfojnë dita-ditës në vendet e demokracisë populllore. Rrezet e shkëlqyera të ideve ngadhnjimtare të marksizëm-leninizmit po i verbojnë imperialistët. Atyre çdo ditë e më shumë po u shket toka nën këmbë dhe shembja e plotë e kapitalizmit nuk do të jetë e largët. Sot jetohet në shekullin e triumfit të komunizmit, e triumfit të ideve të Teturit të madh, e triumfit të paqes dhe të mirëqenies midis popujve.

Lavdi Revolucionit të madhi socialist të Teturit!

Në fund shoku Enver ngriti dolli për miqësinë midis popujve të të dy vendeve, për Partinë Komuniste të BS, për triumfin e ideve të lavdishme të marksizëm-leninizmit.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 269 (3170), 8 nëntor 1958*

*Botohet me ndonjë shkurtim
sipas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**SHËNIM NË LIBRIN E PËRSHTYPJEVE
TË EKSPOZITES SË PRODHIMEVE
TË REJA TË UZINËS «ENVER»**

8 Nëntor 1958

Në 10-vjetorin e Uzinës «Enver» unë jam shumë i gëzuar kur shoh se, në saje të Partisë sonë heroike, ne tani kemi një uzinë mekanike të fuqishme me punëtorë, mjeshtër, teknikë të mrekullueshëm, që dolën nga gjiri i klasës punëtore dhe u edukuan nga Partia jonë.

Ju uroj, të dashur shokë punëtorë dhe inxhinierë të uzinës, suksese akoma më të mëdha! Keni parasysh se në të ardhshmen e afërt përveç kësaj uzine, e cila do të zmadhohet, do të ndërtohen edhe uzina të tjera, prandaj uzina juaj jo vetëm që duhet të bëhet për to shembull në punë, por edhe një burim e shkollë kuadrosh, pa të cilët s'mund të ecë puna përpara.

Partia ka besim të plotë te ju.

Të rrojë Partia dhe klasa punëtore e lavdishme e vendit tonë!

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në
gazeten «Zëri i Popullit»,
Nr. 270 (3171), 9 nëntor 1958

Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 270 (3171),
9 nëntor 1958

**MËMA SHIQIPËRI I KA DASHUR, I DO DHE DO T'I
DOJË ATA BIJ TË SAJ QË NË ZEMRAT E TYRE
RUAJNË ZJARRIN E DASHIURISË PËR TË**

*Letër falenderimi dërguar përfaqësuesve të Shqërisë
Patriotike «Skënderbeu» në Argjentinë*

12 nëntor 1958

**SHOKËVE MUSA NEXHIPI DHE BAJRAM VEIZI
SHOQËRIA PATRIOTIKE «SKËNDERBEU»**

Buenos-Aires

Të dashur shokë,

Unë jam prekur thellë nga urimet aq të ngrohta që më dërguat në emrin tuaj, të Shqërisë Patriotike «Skënderbeu» dhe të të gjithë shqiptarëve të Argjentinës, me rastin e 50-vjetorit të ditëlindjes sime.

Unë e di që urimet tuaja të përzemërtat, që më dërguat mua, i përkasin në radhë të parë popullit tonë heroik, i cili shekuj me radhë luftoi për lirinë e përvavarësinë e atdheut të tij të dashur dhe që në Luftën nacional-çlirimtare, nën udhëheqjen e Partisë së tij të

Punës, me gjakun e tij të shenjtë dhe me ndihmën e mikut tonë të madh, Bashkimit Sovjetik, fitoi lirinë e pavarësinë e vërtetë dhe vendosi pushtetin e tij.

Populli ynë dhe Partia e tij i çmojnë shumë ndjenjat e flakta të patriotizmit dhe të atdhedashurisë, që vlojnë në zemrat tuaja dhe ju duan ju me gjithë shpirt. Mëma Shqipëri i ka dashur, i do dhe do t'i dojë sa të jetëjeta bijtë e saj, që nuk e harrojnë, por e ruajnë në zemër dashurinë e zjarrtë për të.

Ju uroj me gjithë zemër juve, familjeve tuaja dhe gjithë vëllezërve tanë shqiptarë në Argjentinë shëndet të mirë dhe suksese në veprimtarinë fisnike të shoqërisë suaj që mban emrin e Heroit të lavdishëm të Shqipërisë. Skënderbeut!

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

TE MERREN MASA KONKRETE PER ZHVILLIMIN E PESHKIMIT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

13 nëntor 1958

Ministria e Industrisë dhe e Minierave si dhe komitetet e Partisë të rretheve ku janë zonat e peshkimit nuk janë interesuar sa duhet për peshkimin. Këtë e tregojnë shifrat e ulëta në realizimin e planit dhe vetë gjendja e pakënaqshme e këtij sektori, që po shqyrtojmë, e cila duhet të marrë fund. Të mos pranohen më humbje nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave. Nuk duhet të ecet më kështu me plan të parealizuar. Sektori shtetëror i peshkimit është një nga degët më të prapambetura të industrisë ushqimore. Janë të gjitha mundësítë që të zihet sa më shumë peshk i çdo lloji, prandaj është e domosdoshme që baza materiale të shfrytëzohet më racionalisht dhe të bëhet një shpër-

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rrëth raportit «Mbi gjendjen dhe masat për zhvillimin e mëtejshëm të peshkimit».

SHTIMIN E MISHIT E TË QUMSHTIT TA BEJMË PROBLEM TË TË GJITHA MASAVE PUNONJËSE

Nga fjala në aktivin e Partisë të rrethit të Korçës¹

22 nëntor 1958

Aktivi i organizatës së Partisë të rrethit të Korçës, si të gjitha aktivet e tjera që janë mbajtur në vendin tonë, analizoi një problem shumë të rëndësishëm, shtimin e prodhimit të mishit dhe të qumshtit. Plani ynë ekonomik ka rritje në të gjitha degët dhe plani i vitit 1958 me siguri do të realizohet me përjashtime shumë të vogla.

Ne kemi arritur suksese edhe në bujqësi, në të gjitha kulturat. Në zhvillimin e blegtorisë kemi filluar të hedhim hapa përpara. Duhet thënë se fshatarësia jonë ecën akoma me metoda të vjetra në zhvillimin e blegtorisë dhe kjo natyrisht e pengon këtë. Por megjithatë, në disa fusha, si në ndërzimin artificial etj., janë arritur suksese dhe kjo tregon se fshatarësia ka filluar të

¹ Në këtë aktiv u punuan vendimet e Plenarit XI të KQ-të PPSH.

interesohet dhe të përdorë metoda të përparuara. Në përgjithësi ne kemi rritje të blegtorisë në krahasim me paraluftën, 25 për qind më shumë nga shifrat e viti 1938, por përsëri ne nuk kemi atë prodhim mishi që duhet, kështu që kjo mbetet një detyrë e rëndësishme, që kërkon mobilizimin e të gjitha forcave të Partisë e të popullit. Në shifrën e konsumimit të mishit përfrymë ne jemi akoma prapa në krahasim me disa nga vendet e demokracisë populllore, prandaj Plenumi XI i Komitetit Qendror vuri detyra të mëdha para nesh.

Duke parë se me prodhimin e mishit e të qumshtit ne ishim mjaft prapa në krahasim me disa vende dhe duke u nisur nga ajo se janë krijuar të gjitha mundësitet përrritjen e prodhimit të tyre, në Plenumin XI të tij KQ i PPSH mori një sërë masash dhe siç e treguan edhe aktivet e Partisë të rretheve, këto masa kanë qenë të arësyeshme. Është e qartë se këta artikuj do ta rritin më shumë standardin e jetesës së popullit. Masat, që po marrim sot, do të shërbejnë që edhe zhvillimi i blegtorisë të shkojë paralelisht me zhvillimin e të gjithë sektorëve të ekonomisë së vendit. Blegtoria jonë ka arritur suksese të mëdha në drejtim të zhvillimit e të përmirësimit të racës në krahasim me paraçlirimin.

Suksese të mëdha janë arritur edhe në drejtim të kolektivizimit. Sot kuadrot e Partisë kanë fituar një eksperiencë të madhe politike në drejtim të problemeve ekonomike. Mbi 60 për qind e ekonomive dhe 74 për qind e tokës është kolektivizuar. Sukseset e deritanishme në të gjitha fushat e ekonomisë sonë bënë të mundur që të merreshin masa të reja përfshirë zhvillimin e

mëtejshëm të blegtorisë dhe për përmirësimin e racës së saj.

Ne duhet të mobilizojmë të gjitha forcat për realizimin e detyrave që shtroi Plenumi i Komitetit Qendror dhe, atje ku janë mundësítë, shifrat orientuese të tija të avancohen më tej. Por të mos harrojmë se detyrat për shtimin e qumshtit e të mishit duhet të lidhen ngushtë me rritjen e p: odhimit të misrit, për sigurimin e bukës në vend, të cilën Partia tanë është e detyruar ta importojë nga jashtë, gjë kjo që pakëson importimin e artikujve të tjerë si maqineri bujqësore etj. Çdo komunist duhet të ketë përpëra raportin dhe vendimin e Plenomit të Komitetit Qendror dhe nga ato të inspirohet për të vënë në jetë detyrat që përbajnjë këto. Për këtë duhet të bëhen përpjekje që të shfrytëzohen të gjitha rezervat e brendshme, sepse të tilla ka si në bujqësi edhe në blegtori, si në kooperativat fushore edhe në ato të zonave malore.

Organizata e Partisë e rrethit të Korçës ka arritur suksese në bujqësi dhe në blegtori. Shifrat që paraqitët pranë Komisionit të Planit të Shtetit ishin më të avancuara nga ato të atij. Është meritë e komunistëve dhe e të gjithë punonjësve të Korçës që treguan guxim e inisiativë për të aprovuar shifra më të larta. Ne jemi dakord me këtë inisiativë dhe shpresojmë që këto jo vetëm do t'i realizoni, por edhe do t'i rritni gjatë diskutimit që do t'u bëni shifrave orientuese në kooperativat bujqësore.

Një rol të madh nxitës për rritjen e prodhimit të mishit dhe të qumshtit duhet të luajnë fermat shtetërore. Në shifrat orientuese është parashikuar prodhimi

dhe rendimenti i qumshtit për çdo lloj bagëtie. Unë dëgjova këtu nga diskutantët se brenda dy vjetëve janë arritur rezultate të mira në rritjen e prodhimeve e të rendimenteve, kjo tregon se për vitet e ardhshme nga rrethi i Korçës ne do të kemi më shumë shembuj të mirë. Që t'i arrijmë rezultatet e kërkua duhet të bëhet detajimi sipas kushteve konkrete të çdo kooperative bujqësore dhe në diskutimin e shifrave në bazë të marrin pjesë të gjithë kooperativistët.

Shokë, ne duhet të shkojmë me guxim përpala si na mëson Komiteti Qendror dhe eksperiencia e Partisë sonë, prandaj çdo sektor duhet ta shohim mirë.

Të marrim çështjen e rritjes së lopës. Ka kooperativa që kanë nga 20-40 lopë e më shumë, të cilat i kanë siguruar nga fshatarët, nga tregu ose dhe nga rritja natyrore e atyre që kanë. Del e nevojshme që ndërmarrjet e grumbullimit t'u shpérndajnë kooperativave bujqësore lopë, viça femra, qoftë me pagesë ose me kredi. Rritjes së numrit të buallicave duhet t'i kushtohet një kujdes më i madh për vetë leverdinë që kanë se përdoren si forcë tërheqëse dhe prej tyre merren yndyrna dhe mish më shumë.

Plenumi XI i Komitetit Qendror i kushtoi rëndësi të madhe edhe zhvillimit të derrit që ai jo vetëm të shtohet, por edhe të hahet mish i tij. Nuk është mirë për ne që jemi një vend i përparuar dhe nuk e hamë mishin e derrit. Mish i derrit ka shumë kalori. Në Tiranë, një përqindje e mirë e mishit, që është ngrënë, ka qenë mish derri. Kjo duhet bërë edhe në rrethe të tjera. Sivjet mish i derrit nuk u konsumua dhe na kushtoi, për këtë u morën masa për të ngritur frigori-

ferë, pasi në ta ai qëndron deri 3-4 vjet. Ne duhet të luftojmë sidomos në fshat që të hahet mishi i derrit. Ne jemi mësuar që qengjin ta hamë fare të njomë, 3-5 javësh. Kjo nuk është e leverdissħħme. Prandaj disa gjëra, në drejtim të shijes së ngrënies, duhet edhe t'i ndryshojmë. Komiteti Qendoror i ka rekomanduar Këshillit të Ministrave që në ndërmarrjet që ka tufa të mëdha dhensh të shikohet therja e shqerrave para 1 qershori. Kjo bëhet se ndërmarrjet blegtoreale kanë pak kullota, sidomos pas 1 qershori. Ndërsa për kooperativat bujqësore duhet të mbetet urdhëresa në fuqi.

Krahas luftës për shtimin numerik e të peshës së bagëtive duhet të bëjmë luftë edhe për majmérinë, se kështu fshatarësia edhe popullit i jep mish të mirë, edhe ajo vetë ka fitime të mëdha. Në këtë drejtim ndërmarrjet e kooperativat bujqësore dhe ndërmarrjet e grumbullimit duhet të marrin masa të posaçme, veçanërisht ato të grumbullimit, të cilave u janë bërë disa favorizime në lidhje me kullotat etj.

Për shpendët në këtë aktiv u fol pak. Fermën e shpendëve duhet ta krijojë çdo kooperativë. Ne duhet t'u kushtojmë një vëmendje të madhe shpendëve, sepse në Korçë ka mundësi më të mëdha që ato të rriten më shumë, veçanërisht pulat, rosat etj. Shpendët japin një sasi të madhe mishi, veç vezëve. Disa kufizohen në shtimin e shpendëve, të trembur nga sëmundjet që bien në to, por për çdo sëmundje ka dhe barna dhe është tjetër çështje kërkesa për të sjellë më shumë barna dhe tjetër kujdesi për shpendët.

Edhe lepuri është shumë i leverdissħem, prandaj duhet të rritet në mënyrë sistematike.

Problemi i gjuetisë është serioz. Për këtë qeverisë i është rekomanduar që të marrë masa për shtimin dhe për ruajtjen e disa kafshëve të egra, që nuk sjellin ndonjë dëm. Kafshët e egra janë pasuri e të gjithë popullit, prandaj duhet të vihet rregull për gjuetinë e tyre. Gjuetia të bëhet sa është caktuar, mund të të dalin 20 lepuj përpara, por ti je i lejuar të vrasësh vetëm 2 dhe, po të vrasësh më shumë, tepricën, t'ia dorëzosh grumbullimit.

Rëndësi më e madhe duhet t'i kushtohet edhe peshkimit. Ne kemi sjellë shumë mjete për peshkim dhe kemi marrë masa që peshku të gjuhet më në rregull dhe më shumë. Edhe kooperativat bujqësore do të lejohen të peshkojnë, për këtë atyre do t'u jepet edhe ndihmë në mjete etj. Duhet të merren masa për rritjen e peshkut në liqene artificiale si në atë të Ulzës etj., por edhe kooperativat bujqësore të krijojnë rezervuarë të vegjël uji ku të rritet peshku.

Baza ushqimore, përmirësimi i racës dhe shërbimi i mirë luajnë një rol të rëndësishëm për zhvillimin e blegtorisë. Veçanërisht, përmirësimi të racës së blegtorisë, duhet t'i kushtojmë kujdes më të madh. Ne kemi sjellë nga jashtë disa lopë të racave të ndryshme, të cilat na kanë kushtuar shtrenjt, prandaj ato duhet të trajtohen mirë.

Unë kam pyetur dhe më kanë thënë se 'pak frekuentohet teknikumi bujqësor. Ky duhet të frekuentohet jo vetëm nga të rinjtë, por edhe nga të moshuarit, pasi ka nga ata që drejtojnë edhe sektorë në kooperativat bujqësore. Fakti që janë regjistruar 20 kryetarë kooperativash dhe pak i kanë ndjekur rregullisht mësimet flet

për një punë jo të kujdeshme në këtë drejtim. Pregatitja e kuadrove ka rëndësi shumë të madhe për vendin tonë. Vendet e tjera socialiste janë më të përparruara dhe kanë më shumë kuadro, se kanë pasur prej kohësh institute e universitete dhe këta kuadro, pas çlirimit i kanë vënë në shërbim të popullit. Ndërsa neve na kanë munguar këta. Por edhe ne s'do të mbetemi prapa. I kemi marrë të gjitha masat që të pregatitim sa më shumë kuadro. Ne duhet të punojmë që kuadrot që kemi të shkojnë e të ndihmojnë në çdo skaj të rrethit. Zootekniku p.sh. të vejë kudo të japë udhëzime, por më shpesh duhet të shkojë atje ku ka më shumë lopë. Që të bëhet mirë kjo, duhet që kuadrot të mësojnë më shumë, vetë në radhë të parë, që të jenë të aftë e të japid udhëzime me kompetenca të plota.

Për problemin e silazheve është punuar mirë dhe janë bërë gropë e transhe, vitin e ardhshëm duhet të kthehen të gjitha gropat në transhe. Misrit foragjer t'i jepni rëndësi të posaçme. Derisa ju keni krahë 'pune, mjete, ujë, pse të mos mbillni bimë foragjere? Pra, duhet më shumë iniciativë. Shfrytëzimit të tokës duhet t'i kushtohet më shumë rëndësi. Ujin duhet ta shfrytëzojmë mirë. Duhet të mësojmë artin e ujitjes. Rëndësi duhet t'i vëmë edhe mbjelljes së lakrave, kungujve etj., gjatë anëve të arave dhe këto të bëhen ushqim në masë i kafshëve.

Vëmendje duhet t'i kushton edhe ruajtjes së kafshëve nga sëmundjet. Kafshët e sëmura duhet të izolohen. Kujdes i madh të tregohet për viçat e vegjël se që në këtë moshë përcaktohet zhvillimi i tyre. Statistikat e zhvillimit të blektorisë duhet të mbahen në rregull.

Evidencat operative të ndiqen me vëmendje se nga këto do të shohim sa jep në ditë çdo lopë dhe kështu do të nxirren arësyet që kanë influencuar në rritjen ose në uljen e prodhimit. Këto evidencia duhet të ndiqen nga sekretari i Partisë një herë në çdo 10 ditë, ndërsa nga kryetari i kooperativës në çdo 5 ditë. Librat e prodhimit të plotësohen me kujdes dhe t'i paraqiten rrëthit në kohën e duhur. Kjo do të bëjë që dhe Partia të dijë se ç'masa duhen marrë.

Roli i rinisë në zhvillimin e blegtorisë është i madh, se kjo është revolucionare dhe detyrat i kryen me pasion, prandaj duhet rritur pjesëmarrja e të rejave në blegtori si stalliere, mjelëse etj. Rregullat zooteknikë që caktohen në vendim të zbatohen dhe këto do të zbatohen më mirë në qoftë se në blegtori, veçanërisht me lopët, punojnë të reja. Dërgimi i vajzave dhe i grave për të punuar në stalla duhet të zgjidhet menjëherë. Ato duhet t'i edukojmë për t'i shërbyer sa më mirë blegtorisë. Vajzat tonë tani kanë mbaruar edhe shkollë 7-vjeçare dhe i kuptojnë shpejt rregullat që duhen zbatuar në stalla për trajtimin e mirë të lopëve. Gruaja nga vetë natyra është më e kujdeshme, prandaj është e domosdoshme që ajo të merret kryesisht me këtë sektor. Këtë e tregon dhe fakti që në Pojan janë arritur suksese të mira në drejtim të mirëmbajtjes së blegtorisë që kur në stalla janë futur e punojnë vajza.

Shokë,

Ne kemi arritur suksese të mëdha në sektorin e blegtorisë, por duhet thënë se kemi edhe të meta, të

ARËSIMTARI DUHET TË BËJË PUNË TË GJITHANSHME ME MASAT E FSHATIT

*Nga fjala në takimin me punonjësit e arësimit të rrëthit
të Korçës*

24 nëntor 1958

Shoku Enver Hoxha i falenderoi arësimtarët për punën e mirë që bëjnë për edukimin e brezit të ri, duke mbajtur lart traditën kulturale dhe arësimore të Korçës dhe i vuri në dijeni ata mbi vendimin e Plenumit të fundit të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi masat që duhen marrë për shtimin me ritëm më të shpejtë të prodhimit të mishit dhe të qumshtit». Pasi theksoi rënëdësinë e madhe që ka ky vendim për përmirësimin e mëtejshëm të jetës së popullit tonë dhe vuri në dukje rolin që duhet të luajnë e detyrat që kanë arësimtarët që vendimi të kuptohet sa më mirë nga masat punonjëse dhe për t'i mobilizuar ato në realizimin me sukses të tij, tha:

Arësimtarët nuk duhet ta kufizojnë punën e tyre vetëm brenda mureve të shkollës. Ata duhet të marrin pjesë në të gjithë jetën e fshatit, të ndihmojnë në

zgjidhjen e problemeve ekonomike dhe kulturale të tij. Arësimtarët tanë, që kanë një rol të madh në ndërtimin e socializmit, nuk duhet ta shkëputin veten e tyre nga problemi i lopës, i dhenve, i derrave e i shpendëve, sepse shtimi, përmirësimi i racës dhe rritja e prodhimtarisë së tyre janë të lidhura me jetën e popullit tonë, pra, me ndërtimin e socializmit.

Arësimtarët duhet të bëjnë punë të gjithanshme me masat e fshatit, në mënyrë që ato jo vetëm ta rritin derrin dhe ta shtojnë atë, por edhe ta hanë, t'u shpjegojnë atyre leverdinë e madhe që ka rritja e derrit për sigurimin e mishit dhe për vlerën e tij të madhe ushqimore. Arësimtarët duhet të bëjnë ç'është e mundur për të luftuar fanatzimin dhe paragjykimet prapanike, që pengojnë në rritjen dhe në zhvillimin e derrit.

Por duhet theksuar se rritja e bagëtive, përmirësimi i racës, rritja e prodhimtarisë së tyre, sigurimi i një baze të shëndoshë ushqimore dhe përdorimi i saj me kriteret e drejta, kërkojnë njerëz të ditur, kërkojnë kuadro të aftë dhe këta kuadro dalin nga shkollat. Ja këtu duhet të lidhet mirë teoria me praktikën, shkolla me jetën. Mësuesit duhet të punojnë për të krijuar te nxënësit, duke filluar që nga klasat e para, dashurinë për punën, për t'u dhënë atyre njojuritë e nevojshme për punën praktike, për prodhimin, në mënyrë që njerëzit e rinj, kur të dalin në jetë, të mos kenë frikë nga ajo dhe të jenë të aftë të bëjnë gjithshka që kërkon ndërtimi i socializmit në vendin tonë.

Është e domosdoshme që arësimtarët të tregojnë një kujdes më të madh për edukimin e tyre me teorinë

marksiste-leniniste, sepse ajo do t'u hapë atyre horizonte të gjera në punë e në jetë dhe do t'i pastrojë nga mbeturinat mikroborgjeze. Në këtë drejtim, ju, do të ndihmoheni më shumë në të ardhshmen nga Partia.

Duke folur mbi gjendjen e brendshme e të jashtme, shoku Enver tha:

Koha punon për ne, se vendi ynë, nën udhëheqjen e Partisë dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë e të vendeve të demokracisë popullore, ka shkuar shumë përpara dhe për të ardhshmen atij i hapen perspektiva të shkëlqyera; ekonomisë sonë do t'i shtohen kombinatet, fabrikat, hekurudhat, centralet elektrike, do të bëhen bonifikime të reja etj., që do t'i parashikojë plani i tretë pesëvjeçar, shifrat e të cilit do të shpallojnë së shpejti.

Për t'i kryer të gjitha këto detyra, Partia ka besim të patundur te populli ynë, që është i bashkuar plotësisht rrëth Partisë së tij dhe përkrah pa rezerva politikën e saj, se populli ynë është dhe do të jetë kurdoherë vigjilent për të ruajtur si sytë e ballit fitoret e arritura dhe për mbrojtjen e paqes.

Fjalët e shokut Enver Hoxha u dëgjuan me interesim të madh nga arësimtarët. Ato qenë një ndihmë e madhe dhe një mësim shumë i vlefshëm për punën e tyre në të ardhshmen. Pjesëmarrësit duartrokitën dhe brohoritën shpeshherë për Partinë tonë të Punës.

Botuar për herë të parë në gazeten «Zëri i Popullit». Nr. 283 (3184), 25 nëntor 1958

Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga gazeta «Zëri i Popullit», Nr. 283 (3184), 25 nëntor 1958

FESTAT E ÇLIRIMIT DHE PATRIOTËT TANE¹

Nëntor 1958

Çdo vit populli shqiptar feston dy data të shënuara të historisë së tij: ditën e shpalljes së pavarësisë ose ditën e flamurit, siç e quajmë, dhe ditën e çlirimit të atdheut nga robëria e huaj dhe nga skllavëria e feudo-borgjezisë së vendit.

E para festohet që prej 1912-s kur u ngrit flamuri i Shqipërisë në Vlorë, dhe e dyta që prej 1944-s, që kur u çlirua e gjithë Shqipëria dhe përgjithmonë nga çdo zgjedhë e jashtme dhe e brendshme.

Këto dy data të shënuara historike, kanë një gjë të përbashkët: ato janë të popullit, janë fitoret e tija, janë etapa të historisë së tij të shkruara me gjakun e tij dhe që përfaqësojnë dëshirat dhe aspiratat e tija shekullore për pavarësi dhe 'për çlirim.

Rasti mund të kishte qëlluar që këto dy festa të mos binin kështu afér njëra-tjetrës, por në qëllimet dhe në veprimet e popullit shqiptar ka pasur kurdoherë vazhdimësi dhe këmbëngulje që të kalonte nëpërmjet she-

¹ Nga biseda në takimin me patriotë shqiptarë të mërguar që kishin ardhur në Shqipëri me rastin e festave të nëntorit.

kujve në shumë data historike të luftërave për pavarësinë dhe për çlirimin, të kalonte nga etapa e 28 Nëntorit 1912 dhe të arrinte më në fund, pas kaq heroizmash dhe sakrificash në datën e 29 Nëntorit 1944.

Mbeturinat e feudalizmit dhe të borgjezisë, që s'kanë asgjë të përbashkët me popullin, që e kanë pasë shtypur popullin, vrarë e shitur atë te të huajt, në të kaluarën e largme dhe në atë të afërme para 14 vjetëve, përpinqen t'i ndajnë këto data, pikërisht t'i ndajnë nga mëma që i krijoj, nga populli dhe këtë gjë ata e bëjnë për interesat e klasave të tyre të perënduara ose për padronët e tyre imperialistë, armiq të betuar të popullit tonë. Ç'gjë të përbashkët mund të ketë 28 Nëntori me reaksionarët tradhëtarë shqiptarë dhe me padronin e tyre Xhon Foster Dalles, që sigurisht, si kurdoherë nga Departamenti i Shtetit, do të lëshojë një mesazh për popullin shqiptar «për t'ia uruar këtë ditë». Natyrisht, asgjëkafshë. Sigurisht, për ta populli shqiptar «mbaroi së jetuari» që kur u shpëtoi zogu nga dora më 1944, kurse për popullin shqiptar që prej kësaj date filloj jeta e tij e lirë, e pavarur, sovrane.

Ndërsa për imperialistët dhe për shërbëtorët e tyre data e 29 Nëntorit 1944 përfaqëson një ndërprerje në historinë e Shqipërisë, se në fakt ua preu atyre duart e djallëzuara, për popullin shqiptar kjo s'është një datë ndërprerjeje, por një vazhdimësi konsekiente, një hallkë nga më të rëndësishmet e jetës së popullit e të historisë së tij shekullore, plot luftëra për liri që nga koha e romakëve, e Skënderbeut, e kryengritësve të Shqipërisë së Veriut e të Jugut, e kryengritjeve të Kosovës, e Rilindasve, e luftërave ballkanike, e ditës së fla-

murit, e luftës së popullit kundër regjimit feudal të Zogut, dhe më në fund e Luftës së lavdishme nacional-çlirimtare kundër fashizmit, të bërë prej popullit tonë të vogël, por trim, i udhëhequr kësaj here nga Partia e lavdishme Komuniste e Shqipërisë, sot Partia e Punës, e brumosur dhe e frymëzuar nga idetë ngadhnjimtare të marksizëm-leninizmit. Urrejtja ndaj popullit tonë dhe Partisë së tij marksiste-leniniste, që i lanë me duar thatë imperialistët dhe shërbëtorët e tyre dhe që u hoqën çdo mundësi këtyre keqbërësve për të dëmtuar dhe për të skllavëruar popullin tonë që po ndërton socializmin, i bëri këta të demaskohen keq jo vetëm për egërsinë e tyre, por dhe për injorancën e madhe.

Endërojnë të mjerët me sy hapur, se mos populli ynë i gjelltit kollaj djallëzitë e tyre, kur ata pretendojnë se luftërat e popullit shqiptar dhe të eksponentëve të lëvizjeve të ndryshme të popullit tonë, s'na përkasin neve marksistëve, bijve të popullit, por këto gjoja u përkasin këlyshëve të feudalëve, bejlerëve dhe borgjezëve, se ata patriotë të shquar të luftërave të popullit tonë në të kaluarën jo vetëm nuk ishin marksistë, por shumë herë ishin me prejardhje bejlerësh ose agallarësh.

Që Ismail Qemali, Bajram Curri, Sami Frashëri, Naim Frashëri, Luigj Gurakuqi e qindra e qindra patriotë të tjerë të flaktë nuk ishin marksistë, kjo është fare e vërtetë, që mjaft prej tyre ishin bij feudalësh, bejlerësh ose agallarësh, dhe kjo është e vërtetë, por është e vërtetë edhe një çështje tjetër, që na intereson neve dhe s'u intereson imperialistëve dhe tradhëtarëve: këta patriotë të flaktë ishin shkëputur nga klasa e tyre

dhe nga qëllimet e idealet skllavëruese të klasës së tyre, ata ishin bashkuar me popullin, i lidhën fatet dhe jetën e tyre me qëllimet dhe me luftën e popullit, pikërisht me atë popull që luftonte për t'u çliruar nga kthetrat e imperialistëve dhe të feudalëve të shitur.

Kush nuk e di, që kur Naimit i digjej shpirti si qiriu për Shqipërinë, Lumo Skëndua¹ u puthte dorën pashallarëve që shtypnin kryengritësit, siç u puthi dorën italianëve dhe gjermanëve fashistë kur vrisnin dhe digjinin popullin tonë. Të gjithë e dinë se, kur Bajram Curri luftonte si luan në Shpellën e Dragobisë, bejlerët dhe agallarët e tjerë hanin në grazhdin e Musolinit dhe të kralit serb Aleksandër dhe tok me italianët erdhën në Shqipëri, u bënë shërbëtorë të fashizmit dhe të nazizmit dhe sot hanë në grazhdin e Amerikës e të imperialistëve të tjerë.

Të gjithë e dinë se kur Ismail Qemali qëllohej me bacë në parlamentin turk pse mbronte të drejtat e popullit, se kur ai tok me Gurakuqin e të tjerë, në mes të kaq rreziqeve erdhën në Vlorë, ngritën flamurin, formuan qeverinë e Vlorës, bejlerët e agallarët u vunë pushkën atyre, internuan e vranë shumë patriotë.

Këta ishin njerëzit e popullit që luftuan për lirinë e tij, pra, janë njerëzit tanë.

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

¹ Mithat Frashëri.

**LETËR ARËSIMTARIT THOMA PAPAPANO
KU PËRGËZOHET PËR NGRITJEN E MUZEUT
TË SHKOLËS SË PARË SHQIPE
NË QYTETIN E GJIROKASTRËS**

3 dhjetor 1958

I nderuari shoku Thoma Papapano,

Ju përgëzoj për kujdesin që keni treguar së bashku me kolegët tuaj në lidhje me ngritjen e muzeut të shkollës së parë shqipe në qytetin e Gjirokastrës. Kujdesi, që tregoni ju dhe kolegët tuaj, për të ruajtur dhe për të nxjerrë në dritë traditat patriotike të popullit të Gjirokastrës, është një kontribut i vlefshëm për edukimin patriotik të brezit të ri e të punonjësve jo vetëm të rrëthit të Gjirokastrës, po të të gjithë atdheut tonë.

Ju uroj me gjithë zemër, shoku Thoma, shëndet, pleqëri të bardhë dhe suksese në punën tuaj të palodhur!

Me ndërime

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

LETËR QYTETARES ÇEKOSLLOVAKE NEUMANOVA

4 dhjetor 1958

Shumë e nderuara Bozena Neumanova,

Ju jam thellësisht mirënlohës për letrën që më dërguat dhe fjalët e mira që thoni për popullin, vendin dhe Partinë tonë, si edhe për dhuratat që më dërguat, të cilat do të ruhen si gjëra shumë të shtrenjta në Muzeumin tonë të Luftës nacional-çlirimtare.

Ne e njohim mirë jetën, veprimtarinë e shquar patriotike dhe letrare të të ndjerit Neuman, kontributin që ai ka dhënë në lëvizjen demokratike dhe komuniste në Çekoslovakia si shkrimtar dhe publicist dhe çmojmë shumë ndjenjat e thella të miqësisë që ka ushqyer ai për popullin tonë.

Për të gjitha këto, emri i S.K. Neumanit gjëzon respekt të madh dhe nderohet nga populli ynë, sikurse nga të gjithë njerëzit përparimtarë që çmojnë kontributin e tij si shkrimtar realist, që i kushtoi forcat dhe energjitet e tija luftës për çlirimin e popullit, për forcimin e miqësisë me Bashkimin e madh Sovjetik, për triumfin e realizmit të ri socialist në letërsi.

Ne jemi shumë të gëzuar që Çekoslovakia motër, për lulëzimin dhe përparimin e së cilës punoi dhe luftoi

aq shumë shoku Neuman, sot është bërë një shtet i përparuar dhe i zhvilluar në botë dhe bashkë me vendet e tjera të kampit të fuqishëm të socializmit po jep një kontribut të madh në luftën për paqe e socializëm, kundër imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre.

Popujt dhe vendet tona, të udhëhequr nga partitë e tyre marksiste-leniniste, janë të lidhur me një miqësi vëllazërore të pathyeshme dhe me ndihmën e mikut tonë të madh e të përbashkët, popullit vëlla sovjetik, po ndërtojnë me sukses jetën e tyre të lumtur, socialistin dhe komunizmin.

Duke ju falenderuar edhe një herë me gjithë zemër për letrën dhe për dhuratat tuaja shumë të çmuara, më lejoni që, në shenjë respekti të thellë kundrejt shokut Neuman dhe veprave të tija, si dhe kundrejt jush personalisht, t'ju dërgoj disa dhurata modeste, të përbëra nga një album me pamje ngajeta e qytetit të Elbasanit¹ dhe disa punime të artizanatit shqiptar.

Ju uroj me gjithë shpirt shëndet të mirë, jetë të gjatë dhe pleqëri të rehatshme!

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ S. K. Neuman — (1875-1947), poet revolucionar çek. Gjatë Luftës së parë botërore duke qenë i mobilizuar në ushtrinë austro-hungareze u dërgua në Shqipëri ku qëndroi një vit e gjysmë në Elbasan dhe në Beragozhdë të Pogradecit, të cilave u kushtoi vëllimet «Elbasani» dhe «Beragozhda», me vjersha e kujtime me tema krejt shqiptare.

**LETËR QYTETARES ÇEKOSLLOVAKE
NEUMANOVA**

4 dhjetor 1958

Shumë e nderuara Bozena Neumanova,

Ju jam thellësishjt mirënjoës për letrën që më dërguat dhe fjalët e mira që thoni për popullin, vendin dhe Partinë tonë, si edhe për dhuratat që më dërguat, të cilat do të ruhen si gjëra shumë të shtrenjta në Muzeumin tonë të Luftës nacional-çlirimitare.

Ne e njohim mirë jetën, veprimtarinë e shquar patriotike dhe letrare të të ndjerit Neuman, kontributin që ai ka dhënë në lëvizjen demokratike dhe komuniste në Çekoslovakia si shkrimtar dhe publicist dhe çmojmë shumë ndjenjat e thella të miqësisë që ka ushqyer ai për popullin tonë.

Për të gjitha këto, emri i S.K. Neumanit gëzon respekt të madh dhe nderohet nga populli ynë, sikurse nga të gjithë njerëzit përparimtarë që çmojnë kontributin e tij si shkrimtar realist, që i kushtoi forcat dhe energjitet e tija luftës për çlirimin e popullit, për forcimin e miqësisë me Bashkimin e madh Sovjetik, për triumfin e realizmit të ri socialist në letërsi.

Ne jemi shumë të gjëzuar që Çekoslovakia motër, për lulëzimin dhe përparimin e së cilës punoi dhe luftoi

kryesisë së kooperativës, nga dobësitë e theksuara të organizatës bazë të Partisë, si dhe nga sajet e rënda të ish-kryetarit të kooperativës, M.C.

Për shumë kohë në organizatën e Partisë të kësaj kooperative ka pasur grindje dhe ngatërresa. Disa shokë që kritikonin veprimet e padrejta të ish-kryetarit nuk kanë gjetur as mbështetjen e komunistëve të tjerë që mbanin anën e tij, as përkrahjen e komitetit të Partisë të rrethit. Komiteti i Partisë në rreth nuk i ka vlerëuar drejt sugjerimet e shumë anëtarëve të kooperativës, nuk ka ushtruar kontroll të rreptë në punën e organizatës bazë të Partisë dhe të kryesisë së kooperativës, sepse ka pasur besim të verbër te ish-kryetari, pasi ky ishte anëtar i plenumit të komitetit të Partisë të rrethit. Zakonisht të gjitha kritikat që i bëhen në këtij, nga shokët e komitetit të Partisë të rrethit të Lushnjës quhen si të padrejta ose si akuza të bëra nga njerëz të pakënaqur.

Ky qëndrim ndaj kritikave, e pati inkurajuar edhe më tepër ish-kryetarin që të mbante një qëndrim arrogant prej mendjemadhi, si dhe të bënte një sërë veprimesh krejt të palejueshme. Në kryesinë e kooperativës kanë munguar kritika dhe bashkëpunimi i drejtë midis anëtarëve të kryesisë, se rreth ish-kryetarit ishin grumbulluar një grup njerëzish, që i vinin pas qejfit. Ishte mënjanuar me qëllim nga drejtimi edhe mbledhja e përgjithshme e kooperativës, e cila nënveftësohej pa asnjë të drejtë.

Këto dobësi të theksuara në punën e organizatës bazë të Partisë dhe të kryesisë së kooperativës kanë shkaktuar administrimin e keq të prodhimeve dhe të

vlerave monetare. Inventarët e pasurisë pothuajse nuk janë bërë asnjëherë sipas rregullave në fuqi. Në magazinë, në shumicën e rasteve, hyrja dhe dalja e prodhimeve dhe e mallrave të tjera ishte bërë pa peshim dhe pa dokumenta të rregullta; janë ndërruar katër magazinierë brenda dy vjetëve dhe prej tyre vetëm njëri ka bërë dorëzimet. Një anomali e madhe është krijuar sidomos në mbajtjen e llogarive, ku shumë dokumenta nuk janë kontabilizuar fare, një pjesë e tyre janë zhdukur dhe mjaft të tjera janë falsifikuar.

Si rezultat i një qëndrimi të tillë ndaj pasurisë së përbashkët, i mungesës së plotë të kontrollit dhe i lëshimeve të shumta, në kooperativë, që prej vitit 1956 e këtej, kanë ndodhur vjedhje dhe dëmtime serioze të pronës kolektive.

Në sektorin e blegtorisë mungonin 11 krerë që, 6 mëshqerra, 21 krerë bagëti të imta, 1 kalë, 1 gomar, 92 derra e gica, 108 pula etj., të cilat kapin shumën mbi 700 000 lekë. Shumë prej këtyre bagëtive janë shitur nga persona të ndryshëm dhe të ardhurat janë përvetësuar. Në magazinë mungonin 416 kv. misër, si dhe një sasi farë jonxhe, farë tagjie, djathë, gjalpë etj. me vleftë prej më se 1.9 milion lekë.

Përvetësimë të mëdha janë bërë veçanërisht në administrimin e vlerave monetare. Duke falsifikuar firmat e anëtarëve dhe duke mos mbajtur llogari të saktë mbi shlyerjen e kësteve të qeve të kolektivizuar janë përvetësuar nga kjo llogari 42 500 lekë, janë tërhequr nga banka me çeqe 85 200 lekë dhe nuk dihet se ku kanë shkuar, janë shitur mallra të ndryshme me një vlerë prej 137 120 lekë dhe kjo shumë nuk rezul-

ton të jetë derdhur në arkën e kooperativës. Ka dhe shumë raste të tjera, ku nuk dihet se ku janë të hollat e arkëtuara nga shitja e mallrave të ndryshme.

Për t'u përmendur është gjithashtu praktika e ndjekur në këtë kooperativë, ku, për të humbur gjurmët, blerja e materialeve të ndryshme dhe kalimi i tyre në shpenzime, bëhej pa kryer asnjë formalitet. Në këtë mënyrë rreth 500 000 lekë materiale nuk dokumentohen fare ku janë shpenzuar.

Siq shihet, në këtë kooperativë kanë ndodhur dëmtimë dhe abuzime të mëdha dhe për këto ka përgjegjësi të madhe dhe të rëndë ish-kryetari i kooperativës, i cili është vetë i implikuar në shumë raste abuzimi. Për këtë ai u është dhënë organeve kompetente dhe do të dalë përpala gjyqit.

Me të drejtë mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të kooperativës kritikoi komitetin e Partisë dhe komitetin ekzekutiv sepse nuk e kanë ndihmuar me kohë kooperativën dhe nuk janë thelluar në analizën e signalizimeve që bëhen nga anëtarë të ndryshëm të kooperativës. Ata kritikuani gjithashtu instruktorët dhe revizorët e ndryshëm për ndihmë të pamjaftueshme dhe për kontroll të përciptë; këta kanë shkuar herë pas here në kooperativë dhe nuk i kanë zbuluar të metat e përmendura më lart.

Nga ato që ndodhën në kooperativën bujqësore të Krutjes së Poshtme duhet të nxirren mësimet dhe konkluzionet e nevojshme.

Komititetet e Partisë të rretheve duhet të marrin masa dhe të punojnë në mënyrë të vazhdueshme për forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave buj-

qësore dhe, me anën e organeve shtetërore e të bujqësisë në rrëth, sidomos me instruktorët e kooperativave bujqësore dhe me instruktorët e Partisë në zona, të ushtrojnë kontolle të herëpashershme në të gjitha kooperativat pa përjashtim. Ato nuk duhet të mbështeten vetëm në të dhënrat që jep kooperativa, por të kontrollojnë dhe të verifikojnë në vend gjendjen e tyre. Në këtë drejtim të vihen përparrë përgjegjësisë të gjithë punonjësit e komiteteve ekzekutive që merren me sektorin e bujqësisë, sidomos me kooperativat bujqësore, për të ndihmuar nga afër dhe më mirë ato.

Kujdes të veçantë duhet të tregojnë komitetet e Partisë për forcimin e organizatave bazë të Partisë, për forcimin në to të unitetit të mendimit dhe të veprimit, për forcimin e ndjenjës së përgjegjësisë të komunistëve në mbarëvajtjen e punës së kooperativave bujqësore. Në këtë drejtim duhet të punohet me kujdes, me durim dhe me këmbëngulje për të mos u lënë shteg grindjeve dhe tarafeve në organizatat e Partisë, se këto janë burim i shumë të këqiave që reflektohen në mbarëvajtjen e punës në kooperativat bujqësore.

Të luftohet që të zbatohen me përpikëri statuti i kooperativave bujqësore dhe rregullat për drejtimin e punëve në kooperativë, të rritet roli i mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve, i kryesisë dhe i komisionit të revizionimit, të dëgjohet zëri i anëtarëve, të studjojnë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Kjo do të thotë se drejtimi i punëve në kooperativë nuk duhet të mbështetet vetëm te një njeri, vetëm te kryetari, sado i mirë që të jetë ai, por te gjithë organizata bazë, te kryesia dhe masa e anëtarëve të kooperativës.

Komititetet e Partisë bashkë me komitetet ekzekutive të marrin masa për të vënë rregull në administrimin e pasurisë së kooperativave bujqësore, të zbatohen me përpikëri rregullat mbi mbajtjen e llogarive, në magazinat etj. me qëllim që të mos u lihet shteg abuzimeve dhe dëmtimeve të pasurisë së përbashkët.

Për këtë qëllim komitetet e Partisë duhet t'i kushtojnë kujdes më shumë se deri sot zgjedhjes dhe preqatitjes së kuadrove për drejtimin e punës në kooperativat bujqësore. Zgjedhja e elementeve besnikë, të ndershëm dho të aftë për t'i vendosur në udhëheqje të kooperativave bujqësore ka rëndësi të veçantë, por po aq e rëndësishme është edhe ndihma e vazhdueshme që u duhet dhënë këtyre kuadrove, ndryshe ata nga padija, nga vështirësitë që kanë, nga dobësitë e punës në vetë kooperativën, bien në gabime të rënda dhe bëjnë faje.

Për të mos u lënë shteg shthurjes së disiplinës në kooperativat bujqësore, mosrespektimit të statutit, haterillëqeve dhe komprometimit reciprok të njerëzve në kooperativë, është e domosdoshme që komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të marrin masa tanë që jemi përpara mbylljes së llogarive vjetore dhe ndarjes së të ardhurave në kooperativa, të kërkojnë zbatimin me përpikëri të statutit në të gjitha drejtimet, sidomos përsa u përket oborreve personale, bërjes së ditëve të punës të detyrueshme nga çdo anëtar i kooperativës, ndarjes së fondit të paprekshëm jo më pak se sa përqindja që parashikohet në statut si dhe masa të tjera të domosdoshme.

Duke marrë parasysh se mbi kooperativat bujqë-

sore bie pesha më e madhe për zbatimin e detyrave që ka shtruar për bujqësinë Plenumi i Shkurtit i vitit 1958 i Komitetit Qendror mbi shtesat e planit të dytë pesëvjeçar, si dhe të detyrave të shtruara në plenumin mbi shtimin e mishit dhe të qumshtit, komitetet e Partisë të rretheve dhe komitetet ekzekutive duhet të përqëndrojnë më shumë vëmendjen për forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave, për zhvillimin e harmonishëm të degëve të ekonomisë kooperativiste, për ngritjen e nivelit agrozooteknik të punonjësve, për organizimin dhe ndarjen e mirë të forcave të punës.

Komititetet e Partisë duhet ta konsiderojnë si kusht të domosdoshëm për mbarëvajtjen e kooperativës, forcimin e punës organizative dhe politike në kooperativë, ngritjen e rolit udhëheqës të organizatës së Partisë, ngritjen e rolit të komunistëve, të cilët bashkë me rininë duhet të jepin shembull si për zbatimin e statutit të kooperativës ashtu edhe për zbatimin e detyrave që shtron asambleja e kooperativës.

Komititetet e Partisë të shqyrtojnë më me kujdes në plenumet e Partisë gjendjen e kooperativave të rrethit dhe të përcaktojnë mirë masat që duhen marrë për forcimin e gjithanshëm të tyre.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë si-
pas originalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë

THË PREOKUPOHEMI MË SHUMË PËR MBROJTJEN E PASURISË SOCIALISTE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

24 dhjetor 1958

Organizata e Partisë në rrëthin e Peshkopisë duhet të preokupohet më shumë për mbrojtjen e pasurisë socialiste. Ky është një problem politik, të cilit i duhet shkuar deri në fund. Të merren masa të gjithashme për të edukuar njerëzit me koncepte më të shëndosha mbi pronën e shtetit, që është prona e tyrc, mbi pasurinë e kooperativave të konsumit, që janë kooperativat e popullit.

Në Peshkopi puna e Partisë për të mos prekur pronën socialiste nuk është akoma në nivelin e duhur. Njerëzit në Peshkopi janë punëtorë dhe patriotë, por

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rrëth relacionit «Mbi punën e Partisë për mbrojtjen dhe administrimin e pronës në sektorin e tregëtisë kooperativiste të rrëthit Peshkopi» paraqitur nga një ekip i Komitetit Qendror të PPSH.

në ndërgjegjen e tyre ende ekzistojnë mbeturinat e bajraktarëve, ekziston pikëpamja e gabuar e «mallit belik». Këto pikëpamje të vjetra manifestohen, binc edhe në disa kooperativa bujqësore, ku vidhet pasuria kollektive. Mos i harroni, shokë, konceptet e bajraktarëve, influencën e tyrc. Prandaj organizata e Partisë në rrethin e Peshkopisë ta shikojë me shumë kujdes këtë problem dhe të bëjë punë politike dhe edukative. Të preqatitni leksione për të luftuar kundër mbeturinave të vjetra. Por mos kujtoni se kjo punë mund të arrihet vetëm me ndonjë referat, kërkohet punë e vazhdueshme ideo-politike, me qëllim që të rrënjoset konceptet e Partisë, në radhë të parë te komunistët, te të gjithë kuardrot e organeve të Partisë e të pushtetit. Edhe gjyqtarët, kur gjykojnë, të mos kufizohen vetëm në masa, por të dalin me konkluzione politike, të cilat të shërbejnë për edukimin e punonjësve. Me sa duket, ka akoma mjaft njerëz që nuk e kanë kuptuar si duhet se pushteti është i tyre dhe prandaj ai duhet mbrojtur bashkë me pasurinë e përbashkët të popullit. Po kështu edhe organet e policisë, në punën e tyre të nxjerrin konkluzione e të bëjnë përgjithësim, të cilat të vleinë për forcimin dhe për mbrojtjen e pushtetit e të pronës së popullit. Të përdoren edhe forma të tjera të punës me masat në përshtatje me kushtet e Peshkopisë. Duhet të punohet jo vetëm për edukimin politik të masave, por të merren edhe masa të rrepta kundër atyre që dëmtojnë pasurinë e popullit ose që mbrojnë e inkurajojnë vjedhësit e pronës shoqërore.

Çështja e forcimit të kooperativave të konsumit është një detyrë e rëndësishme partie dhe shtetërore.

Edhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit duhet të bëjë punë politike e partie dhe të marrë masa për zbatimin e vendimeve. Në rrugën shtetërore Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit të zbatojë më mirë detyrat, sepse në dyqanet e tij bëhen vjedhje.

Ne duhet të marrim shumë masa për të evituar deficitet, vjedhjet etj. Por, në qoftë se nga ana e Partisë do të kuptohet drejt përimi i ndërtimit të kooperativave të konsumit, atëherë mua më duket se një punë e mirë politike do të ndihmonte më shumë se sa sigurimi i disa veglave për ruajtjen e misrit ose të grurit nga lagështira.

Rëndësi të madhe ka zgjedhja e njerëzve në organet e kooperativave të konsumit dhe zbatimi i kritereve të shëndosha në caktimin e shitësve. Shitësi është përgjegjës dhe duhet të jetë kurdoherë nën kontrollin e masës. Po të zbatohet mirë ky parim, me siguri shitësit do të fillojnë të punojnë si duhet. Partia dhe organet e kooperativave të konsumit do të bëjnë kontroll nga ana e tyre, por edhe dëshirat dhe sinjalizimet e popullit duhet të mbahen vazhdimesh parasysh. Në kushtet e sotme, ne mund të pranojmë si shitës edhe njerëz që nuk dinë shumë të bëjnë llogari, por mjafton të jenë të ndershëm dhe të zgjuar, sepse brenda një kohe të shkurtër ata do të mësohen t'i shërbijnë popullit.

Këshillat e kooperativave të konsumit në shumë raste janë formale. Në qoftë se këto këshilla bëhen jo vetëm organe regjistruese, por edhe zbatuese të vërejtjeve e të ankesave të anëtarëve dhe po t'u qëndrojnë shitësve mbi kokë, në mënyrë që ata ta ndjejnë kontrollin e popullit, kjo gjë do të ndihmojë shumë për

forcimin e punës në kooperativat e konsumit. E gjithë kjo punë duhet të udhëhiqet nga Partia, e cila të kërkojë nga çdo fshatar që të jetë vigjilent dhe të ruajë pasurinë e kooperativës së konsumit, që është pasuri e tij. Kur është çështja për interesin personal fshatari edhe qimen e vë re, prandaj kështu duhet ta mbrojë ai edhe pasurinë e kooperativës.

Pra, duke u nisur nga parimi që fshatari, duke mbrojtur kooperativën, mbron pasurinë e tij, kooperativa e konsumit do të forcohet. Partia duhet të dëgjojë ankesat e fshatarëve, njëkohësisht të organizojë edhe kontrollle pa pritur kontrollet nga qendra. Kur ka të dhëna, pa shkelur ligjet, mund të jepen urdhëra edhe për mbylljen e një dyqani, ndaj të cilat ka ankesa. Komisione të ngarkuara bëjnë inventarin e mallrave dhe, po të vërtetohen vjedhje, atëherë mund të merren edhe masa pushimi ndaj një shitësi ose sipas rastit ai i jepet edhe gjyqit. Në qoftë se shitësi gjendet nën një saç të tillë, ai nuk e ka lehtë të vjedhë.

Vjedhjet, që kanë ndodhur në rrëthin e Peshkopisë, të bëhen mësim si për Partinë, ashtu dhe për vetë kooperativat e konsumit, policinë, gjykatat etj. Këto organe nuk duhet të lënë pasdore edhe një të dhënë, sado e vogël të jetë, se pa ngrënë hudhër nuk bie erë. Zbulimi i vjedhjeve ngarkon me përgjegjësi organet e diktaturës së proletariatit, në radhët e të cilave duhet të luftohet çdo shfaqje familjariteti, që është shumë e rrezikshme në punën e tyre.

Organizata e Partisë në Peshkopi duhet të marrë të gjitha masat që u thanë në këtë mbledhje për ngritjen e ndërgjegjes së punonjësve të tregëtisë shtet-

tërore dhe të atyre të kooperativave të konsumit.

Mos harroni, shokë të Peshkopisë, se ju veproni në një rrëth kufitar, te ju punon edhe agjentura jugosllave, prandaj masat e popullit, bashkë me dashurinë që kanë për pushtetin, duhet të zhvillojnë më tepër dhe vigjilencën që të luftojnë kundër agjenturës jugosllave konkretisht e kundër revizionizmit titist. Për asnjë minutë mos e pushoni këtë luftë, se të gjitha mbeturinat e vjetra të borgjezisë dhe të bajraktarëve tani janë duke u mbështetur nga propaganda e revolucionisteve jugosllavë. Kjo luftë duhet të mbetet vazhdimi si një detyrë aktuale dhe nuk duhet të kufizohet vetëm në fushën e propagandës, por të organizohet mirë puna në të gjitha drejtimet, në mënyrë që në rrëthin tuaj të mos ndodhin më as vjedhje dhe as dëmtime të tjera në ekonominë popullore. Popullin e Peshkopisë e kemi shumë të mirë, të lidhur me Partinë, punëtor e patriot dhe në disa probleme ai është shembull për të gjitha rrëthet e tjera të vendit tonë. Prandaj besimi ynë është i patundur se edhe në të ardhshmen, ai, nën udhëheqjen e Partisë do të arrijë suksese akoma më të mëdha.

Botohet për herë të parë sëpas tekstit të ntjerë nga proces-verballi i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

TË FORCOHET PUNA E PARTISË NË REPARTET E KUFIRIT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

24 dhjetor 1958

Në repartet e kufirit ka përmirësime si në punën e Partisë, ashtu dhe në atë të komandës, po megjithatë, natyrisht, ka akoma shumë të meta, që nuk do të zhduken menjëherë, ka dhe shumë probleme që dalin gjatë punës, të cilat duhet të kishin gjetur një zgjidhje më të mirë. Për këtë duhet ta ndjejnë thellë përgjegjësinë që kanë pérpara udhëheqjes së Partisë shokët drejtues të kufirit, të cilët të bëjnë një analizë kritike të dobësive të punës dhe të marrin masa pér ta forcuar më tej atë.

Në radhët e kufitarëve tanë s'ka më analfabetë, kjo është pasojë e tërë zhvillimit të vendit tonë. Në je-

¹ Në këtë mbledhje u muar në shqyrtim raporti «Mbi gjendjen e disa reparteve të kufirit dhe punën që zhvillohet nga komanda dhe organet politike» paraqitur nga një ekip i Komitetit Qendror të PPSH.

tën e Partisë ka përparime, po ka të meta serioze në punën politike, ideologjike. Prandaj, të mos justifikohemi me kushtet e vështira të shpërndarjes së reparteve të kufirit, por të punohet me këmbëngulje dhe me shumë kujdes për ngritjen ideo-politike të kufitarëve. Ky problem duhet të preokupojë më tepër Partinë dhe komandën në kufi. Të përfitohet nga eksperiencia e ushtrisë që edhe në kufi të mos mungojnë mjetet figurative. Ushtria të interesohet për repartet e kufirit, të marrë dhe të japë eksperiencë, të ndihmojë për të gjallëruar punën kulturale ideologjike etj. Todi [Lubonja] s'bëri mirë që nuk foli për këtë çështje sepse puna e rinisë është kudo. Komiteti Qendror i BRPSH nuk merret si duhet me punën e rinisë në zonat kufitare. Prandaj Komiteti Qendror i Rinisë dhe Dega Politike e Kufirit duhet menjëherë të bashkëpunojnë më mirë për këtë çështje, të gjallërohen të gjitha format e edukimit dhe të dëfrimit me rininë e kufirit, të shfrytëzohen nga punëtorët politikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme klubet që janë në kufi, të ketë atje radio, organe të shtypit etj. Për strehimin e kufitarëve të interesohet seriozisht Partia.

Rëndësi të veçantë ka çështja e forcimit të vigjilencës revolucionare, kontrollit dhe punës edukative me kuadrot e kufirit. Sipas kushteve duhet punuar për edukimin e kufitarëve me artin e mbrojtjes. Prandaj, të organizohen kurse, të shfrytëzohet eksperiencia jonë, e BS si dhe e vendeve të demokracisë populllore.

Me kufitarët të tregohet më shumë durim e kujdes, të punohet me ta në mënyrë të diferencuar, sepse janë nga zonat e ndryshme të vendit. Komandat dhe organet

politike të kufirit të kenë parasysh që kritika e Partisë duhet të zhvillohet ashtu si në ushtri. Prandaj Dega Politike të ndihmojë organizatat bazë si duhet bërë kritika dhe të mos lihen akte të papëlqyera pa u kritikuar. Kjo të shërbejë për edukimin e kuadrove dhe ushtarëve të kufirit. Edukimi të bëhet në format më të ndryshme dhe në fryshtë partie, në punë, në jetë. Kjo çështje të shihet në organizatat bazë, në byrotë e tyre etj. Puna e Partisë ka rëndësi kudo, po sidomos në kufi, ku duhet të jenë njerëzit më të dalluar. Prandaj të luftohet për të gjallëruar organizatat bazë të Partisë, të luftohet familjariteti i sëmurë që ekziston në disa prej tyre, sepse kjo është një sëmundje e rrezikshme sidomos për organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Besojmë se problemet që u diskutuan në këtë mbledhje do të mbahen parasysh dhe detyrat që u shtruan do të zbatohen më mirë nga Ministria e Punëve të Brendshme, veçanërisht nga kuadrot drejtues të kufirit.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

PËRMIRESIMIN E METODES SE PUNES TA KËRKOJMË NË RADHË TË PARË NGA VETJA JONË SI SEKRETARIAT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

24 dhjetor 1958

Këtu u ngritën probleme shumë të drejta e të rëndësishme, por e keqja është se ne kërkojmë t'i shqyrtojmë ato në një mbledhje, ndërsa çshëtë më mirë që në mbledhjet tonë t'ë analizojmë probleme të veçanta. Të marrim për shembull punën politike me arësimtarët. Kjo është një temë që duhet t'ë bëhet objekt studimi në një mbledhje të Sekretariatit të Komitetit Qendror. Kështu ka edhe çështje të tjera të veçanta siç janë çështja e programeve mësimore, çështja e rinisë shkolllore, e disiplinës së nxënësve në shkolla, çështja e edukimit profesional të mësuesve në shkollat e mbrëm-

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi rezultatet e bimestrit të parë të shkollave, sipas një informacioni të paraqitur nga Ministria e Arësimit dhe e Kulturës.

jes etj. Duke i marrë në shqyrtim një nga një këto probleme, ne do t'i japim mundësi Partisë që të jetë e qartë se si po zbatohen vendimet e Komitetit Qendror.

Çështjet e arësimit janë të shumta, ne nuk duhet të mjaftohemi duke i marrë ato vetëm një herë në shqyrtim e të themi nga pak e nga të gjitha menjëherë. Kjo do të thotë që Partia dhe Komiteti Qendror t'i ndje-kin këmba-këmbës vendimet, në mënyrë që, kur ne të shkojmë në Byronë Politike ose në Plenum të Komitetit Qendror për të raportuar mbi çështjet e arësimit, të themi se si ka punuar Partia, si i kemi zgjidhur ne problemet dhe të shohim rezultatet konkrete.

Ju, shokë të Ministrisë së Arësimit, bëtë një seminar këtu në Tiranë, mbledhje të tillë zhvillohen edhe nga drejtoretitë e Komitetit Qendror, po Sekretariatit nuk po i sillet një raport konkret se çfarë u bë në këto mbledhje, ç'probleme dalin, sigurisht kjo të bëhet shkurtazi, në mënyrë që baza të ndihmohet për punën e mëtejshme. Bile mbledhjet që zhvillohen te ne duhet të nisen nga disa arësyte dhe, ato më kryesoret duhet t'i dijë Sekre-tariati, me qëllim që sekretarët e Komitetit Qendror, duke i ditur që më parë këto mbledhje, konferanca ose aktive, të marrin pjesë në to dhe të shtrojnë e të zbër-thejnë probleme në bazë të orientimit të Byrosë Politike ose të Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë.

Lidhur me këto probleme ne duhet të përmirësojmë metodën e punës së Sekretariatit të Komitetit Qendror. Byroja Politike nuk duhet të na lejojë të vazhdojmë duke punuar kështu me të meta. Po pse nuk e përmirë-sojmë metodën e punës, apo nuk ka probleme të ndry-shme për të shqyrtuar? Në mbledhjet që bëjmë, të gjithë

ne, sekretarët e Komitetit Qendror, japim mendime shumë të mira, që janë pasojë e kontakteve tona me njerëz të ndryshëm. Po shumë gjëra nuk është hera e parë që i themi. Tani është koha t'i shohim konkretisht çështjet dhe të vëmë dorë te ato që nuk po na ecin mirë. Po të marrim si shembull çështjet e arësimit, sekretarët e Komitetit Qendror dhe drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror duhet të mendojnë thellë se si ta përmirësojnë metodën dhe stilin e punës së Sekretariatit, pra, t'i sjellin Sekretariatit problemet për të cilat duhet të mobilizohet Partia. Kjo do të bëjë që edhe kur të vijnë disa të ftuar për të dëgjuar zërin e Sekretariatit të Komitetit Qendror, ata të përfitojnë dhe të nxiten për të zbatuar vendimin që do të merret. Në këtë prizëm duhet t'i shikojnë të gjitha çështjet shokët sekretarë dhe drejtorë të Komitetit Qendror.

Duke analizuar probleme të veçanta, kjo nuk do të thotë se ne do të zhvillojmë mbledhje çdo ditë. Në Sekretariat, të shumtë e çështjeve duhet të kalohen me nga një diskutim të shkurtër. Si mund të arrihet kjo? Kjo mund të arrihet atëhere kur problemet të paraqiten në një raport shumë të shkurtër dhe jo si deri tani që këto raporte janë shumë të gjata. Kjo gjë ka bërë që mbledhjet e Sekretariatit të Komitetit Qendror të mos jenë të rregullta. Njerëzit që i prega-titin materialet për mbledhje duhet të mësohen të shkruajnë shkurt, të mësohen se si t'i nxjerrin të dhë-nat nga baza dhe si të arrijnë në konkluzionet e tyre të përbledhura. Ne kemi nevojë të na thuhet se ku qëndrojnë dobësítë në një çështje të caktuar dhe ç'masa duhen marrë për likuidimin e tyre. Kjo mund të na

paraqitet në një projektvendim të shkurtër. Kur të punohet ky vendim, shokët e ngarkuar le ta zhvillojnë, ta zbërthejnë e ta komentojnë edhe më tej. Në rast se dikush kërkon shpjegime, këto le t'i japë ai që është i ngarkuar për punimin e tij në organizatën bazë. Me raporte të gjata, shpeshherë shokët që ftohen në mbledhje vihen në pozita të vështira. Të mos diskutojnë nuk është mirë, sepse do t'u thonë përsë nuk fole; të diskutojnë ka rrezik se nuk do të bëjnë gjë tjetër veçse do të përsëritin, mbasi të gjitha janë thënë në atë reportin e gjatë që është paraqitur për shqyrtim. Kështu duhet ta shikojmë punën tonë në Sekretariat. Po kjo varet shumë nga sekretarët e Komitetit Qendror dhe nga drejtorët që janë ndihmësit e tyre më të afërt dhe kryesorë. Drejtori duhet të ketë parasysh që të shtrojë para sekretarit të Komitetit Qendror problemet më të rëndësishme dhe të bëjë propozimet përkatëse për zgjidhjen e tyre.

Është e nevojshme që për këto çështje ne të caktojmë edhe disa norma. Ne kemi të drejtë t'i themi një komiteti partie se në rrethin tuaj kjo çështje nuk shkon mirë, pastaj shokët e rrethit le ta zhvillojnë vetë vërejtjen e Komitetit Qendror. Duke vepruar kështu do të lehtësohet shumë edhe puna e inspektorëve dhe e instruktorëve të Komitetit Qendror. Duhet të ketë udhëzime të përcaktuara mirë për çdo problem. Shokët të dinë se gjatë muajit do të zhvillohen dy mbledhje të Sekretariatit të Komitetit Qendror dhe do të merren në analizë disa vendime për të parë se si janë zbatuar ato. Mirëpo në praktikën tonë të tanishme ka fare pak vendime ose ka një apo dy ven-

dime të ngarkuara me shumë probleme. Kur nuk veprojmë si duhet ne që jemi më të ngritur dhe për shkak të metodës jo të mirë të punës nuk arrijmë dot të bëjmë konkluzionet e nevojshme mbi një çështje dhe të marrim vendim, atëherë ç'presim të na bëjnë inspektorët? Ne bëjmë mirë që kritikojmë byrotë e komiteve të Partisë se nuk e organizojnë si duhet punën, por para së gjithash ne duhet të shohim veten tonë, pse edhe ne nuk po e organizojmë mirë punën. Nga metoda dhe stili i punës së Sekretariatit varet shumë edhe puna e të tjerëve. Ne duhet t'i japim tonin gjithë punës së Partisë në lidhje me studimin e problemeve që shqyrtojmë dhe me vendimet që merren. Përse ne t'i kritikojmë komitetet e Partisë se i harrojnë problemet e arësimit kur vetë ne nuk jemi në rregull? Ka shumë kohë që ne nuk kemi shqyrtuar në Sekretariatin e Komitetit Qendror problemin e arësimit. Atëherë përse t'i kritikojmë rrëthet për një çështje që vetë nuk kemi dhënë shembullin e mirë? Në rast se ne arrijmë t'i marrim në shqyrtim problemet e arësimit në kohën e duhur, atëherë as komitetet e Partisë e as organizatat bazë nuk kanë përse t'i harrojnë ato, pasi do të thonë se ky është një problem i rëndësishëm derisa vetë Sekretariati e ka shqyrtuar. Në qoftë se ne u kërkojmë më shumë komiteteve të Partisë për problemet ekonomike, ato do të mobilizohen më tepër pikërisht për këto probleme. Prandaj themi që metoda e mirë ose e keqe e punës sonë si Sekretariat ndikon edhe në rrethe e në bazë. Pra, përmirësimin e metodës së punës ta kërkojmë në radhë të parë nga vetja jonë si Sekretariat.

Unë jam kundër mbledhjeve të shumta dhe kundër trajtimit të shumë problemeve në to. Këtë kritikë e kam bërë edhe në qeveri e në Kryesinë e saj ku në çdo mbledhje të tyre merren në shqyrtim shumë probleme. Është e vërtetë se këto probleme që merren në shqyrtim edhe në këto organe janë të mira e të nevojshme, megjithatë edhe atje ka pak kërkime llogarie dhe jo kurdoherë merren masa konkrete. Kjo ndodh se ministritë po e mbulojnë Kryesinë e Këshillit të Ministrave me shumë probleme, dërgojnë shumë materiale. Përse u dashka që ne, në Sekretariat, të marrim në shqyrtim çështjen e traktorëve që nuk ngarkohen sa duhet? Përderisa u muar vendimi mbi fillimin e viti bujqësor, atëhere çështjet e vendosura duhet të ndiqen nga organet shtetërore.

Në këtë drejtim ne duhet të jemi të informuar mbi gjendjen e problemeve të ndryshme. Kjo do të jetë shumë e rëndësishme për të ditur se ku e përse të organizojmë ndihmën e kontrollin. Shokët e Sekretariatit duhet të janë të gjithë të informuar, sepse ndodh shpesh që disa çështje nuk i dimë të gjithë. Sekretarët e Komitetit Qendror duhet të janë në dijeni të gjithë për shumë probleme që i përkasin Partisë, të cilat është e nevojshme të pasqyrohen edhe në planin e Sekretariatit të Komitetit Qendror. Kështu problemet do të zgjidhen më mirë dhe ne ndihmojmë më tepër shoku-shokun.

Kjo çështje meriton të studjohet me hollësi dhe të vendosim një formë pune më të mirë, sepse ka shumë probleme të bujqësisë, të arësimit, të agjizacionit e të propagandës, të ushtrisë etj., që ne i marrim njëherazi.

Për shembull ushtrinë mund ta ndihmojmë më mirë duke mos i marrë në shqyrtim problemet e saj në përgjithësi, po kur marrim në shqyrtim disa probleme të veçanta të këtij sektori. Për disa çështje mund të raportohet edhe verbalisht, mjafton të paraqitet një projektvendim i shkurtër, që shokëve t'u jepet mundësia të pregetiten për të folur në Sekretariat për një çështje të caktuar. Kështu mund të veprohet edhe për problemet e tjera.

Lidhur me informacionin që na është paraqitur për arësimin, mendoj që të pregetitet një tematikë me probleme të veçanta që duhet të shqyrtojmë në Komitetin Qendror, në Byronë Politike dhe në Sekretariat. Është fakt se në punën e Byrosë Politike ne kemi shumë të meta, për të cilat përgjegjësia kryesore i takon Sekretariatit të Komitetit Qendror. Prandaj, duhet të mendojmë seriozisht se si ta përmirësojmë punën edhe në Byronë Politike. Mendoj që në planin e punës të caktohen edhe normat e mbledhjeve që do të bëjë Byroja Politike. Po të zhvillojmë dy mbledhje të Byrosë Politike në muaj na bëjnë 24 në vit. Çështjet që do të shqyrtojmë në këto mbledhje të burojnë nga problemet që diskutohen dhe nga vendimet që merren në plenumet e Komitetit Qendror. Natyrisht, mbledhjet tona duhet të ndihmojnë në realizimin e planit të shtetit në të gjithë sektorët. Partia të kontrollojë dhe të ndihmojë organet dhe organizatat e saja si dhe organet shtetërore në zgjidhjen e problemeve kyç në ekonomi, në arësim etj. Mbledhjet e Byrosë Politike duhet të korrespondojnë me mbledhjet e Plenomit të Komitetit Qendror, në mënyrë që, kur të vijë mbledhja e ple-

numit, Byroja Politike dhe Sekretariati i Komitetit Qendror të kenë marrë që më parë një sërë problemesh në shqyrtim, t'i kenë studjuar e t'i kenë zbërthyer ato duke ndihmuar kështu mbledhjen e plenumit. Në këtë mënyrë të gjithë ne vemë në mbledhjen e plenumit të armatosur më mirë. Raporti që do të mbahet në plenum të jetë një pasqyrë e plotë e zbatimit të detyrave kryesore të Komitetit Qendror. Natyrisht, në mbledhjen e plenumit mund të na dalin edhe probleme të paparashikuara, por këto do të jenë si probleme të dorës së dytë dhe mund t'i jepen për shqyrtim Byrosë Politike. Po të veprohet në këtë mënyrë nuk do të na mbetet asnjë sektor pa u kontrolluar. Kështu si po veprojmë ne tani nuk e kemi mirë punën, mjaft kuadro lodhen shumë, janë në tension dhe hutohen.

Janë të gjitha mundësitë që të ndryshojmë metodën e punës. Një tematikë më e mirë do të bëjë që secili të dijë se cilat probleme do të marrë në shqyrtim Byroja Politike dhe cilat Sekretariati i Komitetit Qendror. Mbledhjet e Sekretariatit të Komitetit Qendror duhet të zgjidhin problemet më të rëndësishme që vendos Byroja Politike. Ideja ime kryesore është që të përmirësojmë punën, ndërsa mendimet që po them duhen studjuar. Vërejtjet që bëhen në këtë informacion për Byronë Politike dhe për aparatin e Komitetit Qendror t'i thellojmë.

Rëndësi të veçantë ka kontrolli nëpër shkolla nga ana e drejtorive dhe e këshillave pedagogjike. Për punën e tyre mësuesit duhet të vihen përpara përgjegjësisë në rrugë shtetërore dhe shoqërore.

Edhe Bashkimi i Rinisë dhe organet e tij drejtuese duhet të interesohen më shumë për problemet e shkollës, të mendojnë se te ne ka rëndësi edhe edukimi i brezit të ri në familje. Ç'na pengon që të mos na ecë si duhet organizata e pionierit? Përse të thërrasim prindër për një kujdes më të madh ndaj fëmijëve dhe të kërkojmë që ata të na i edukojë plaka e shtëpisë, kur organizata e pionierit mund ta bëjë më mirë këtë punë? Këto gjëra nuk duhet t'i shohim vetëm në teori, por në praktikë, në bazë të kushteve tona.

Përsa u përket disa propozimeve për shtesa kuadri, unë jam dakord që këto të studjohen dhe t'i paraqiten Byrosë Politike. Vetëm të kihet parasysh që kuadrot e arësimit, për shembull inspektorji, të jetë njeri i kualifikuar, të jetë nga mësuesit më të mirë, njeri me autoritet dhe me eksperiencë. Në rast se akoma nuk i kemi kuadro të tillë, atëhere të marrim masa që t'i pregatitim me këmbëngulje. Çështjen e drejtorive të shkollave gjithashtu ta shohim me kujdes, të vendoset disiplina shtetërore në shkolla, ky problem të preokupojë Partinë, pushtetin dhe rininë. Nuk janë të mira ato raste, kur nxënësit nuk kanë respekt për mësuesit e tyre. Organizata e rinisë duhet të ndihmojë më shumë për forcimin e disiplinës në shkollë.

Gjithashtu, organizata e rinisë, punën e saj edukative duhet ta shohë të lidhur ngushtë me kushtet e vendit tonë dhe me moshën. Përse të rinjtë të qëndrojnë rrugëve deri në orët e vona? Kjo nuk duhet të lejohet. Ne nuk jemi konservatorë, po nuk ka asnje arësye përsë të rinjtë dhe të rejat të bredhin rrugëve natën. Kjo nuk është edukatë dhe duhet të shtrohet në

mbledhjet e organizatës së rinisë, të cilat nuk duhet të zhvillohen natën, por në kohën më të përshtatshme e sipas moshës.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

PROBLEMET T'I TRAJTOJMË NË NJË FRYMË MË KRITIKE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 dhjetor 1958

Duke përmirësuar raportin me vërejtjet që u bënë duhet t'i bëhen atij edhe dissa shkurtime, si për shembull, mbi gjeologjinë nuk është nevoja të flitet në një kapitull aq të madh. Kështu mund të ketë edhe pjesë të tjera.

I gjithë raporti duhet të përqëndrohet në një analizë kritike të gjendjes dhe të përcaktojë mirë detyrat në lidhje me dobësitë ekzistuese dhe me nevojat kryesore që i paraqiten planit në sektorët kyç. Për shembull në bujqësi problemet janë të shumta, prandaj, kur flitet në raport për këtë sektor të kafen disa çështje themelore që kanë lidhje me rendimentet e kul-

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit që do t'i paraqitej Plenumin të KQ «Mbi realizimin e planit të vitit 1958 dhe detyrat për planin e vitit 1959».

turave dhe të analizohen ato në mënyrë kritike. Ose, kur trajtohet problemi i traktorëve, të thuhet përsë këta shfrytëzohen vetëm 40 për qind, cilat janë shkaqet? Të rishikohet edhe çështja e normave të traktoristëve.

Çështja e sigurimit të lëndës së parë mund të trajtohet veçanërisht si një problem me rëndësi shumë të madhe, të dalin mirë shkaqet e mosrealizimit të planit në këtë drejtim, të kritikohen dobësitë dhe të shtrohen detyrat. Në këtë mënyrë mund të trajtohen edhe një sërë problemesh, analiza si duhet e të cilave do të ishte shumë edukative edhe për vetë Plenumin e Komitetit Qendror. Prandaj, shumë vërejtjeve që bënë shokët, t'u gjendet vendi përkatës në raport, pa lënë pasdore edhe çështje që s'preken fare, siç janë problemi i kuadrove të ndërtimit ose çështja e sigurimit të farërave në bujqësi, për mungesën e të cilave të kritikohet Instituti i Kërkimeve Bujqësore dhe disa komitete ekzekutive, që s'janë në rregull.

Po kështu, edhe sektori i arësimit është me rëndësi të madhe. Çështja e shkollave ne duhet të na preku pojë, po nuk është ky i gjithë problemi, sepse ne duhet ta shohim tërë problemin e sigurimit të kuadrit. Ata që mbarojnë shkollat 7-vjeçare dhe punojnë në industri, në bujqësi e kudo, është e domosdoshme që t'i bindim për të vazhduar shkollat edhe më lart, sepse kuadro të mesëm ata bëhen brenda një kohe të shkurtër.

Ministrisë së Arësimit dhe të Kulturës mund t'i bëhet një kritikë, sepse s'ka punuar sa duhet për forcimin e disiplinës në shkolla, në radhë të parë të mësuesve. Ka në shkolla mësues që nuk shkojnë të pre-

gatitur për të dhënë mësim. Prandaj, ministria duhet t'i vërë mësuesit përpara përgjegjësisë. Organizatat e Partisë dhe ato të rinisë të tregojnë një kujdes më të madh për shkollën. Të merren masa deri në pushim nga puna ndaj mësuesve që nuk kryejnë si duhet detyrat, të rishikohet i gjithë kuadri drejtues i shkollave dhe të punohet për të rritur më tej ndërgjegjen në punë të mësuesve.

Jam dakord që të ngrihet edhe problemi i forcimit të kuadrove drejtues të kooperativave bujqësore dhe i kualifikimit të tyre. Të shikohet gjithashtu çështja e inspektorëve të kooperativave bujqësore. Çështjen e kuadrit të bujqësisë duhet ta shikojmë mirë. Një kooperative të madhe, me 1 500-3 000 ha. tokë, ia vlen që shteti t'i japë një agronom. Por ky problem, para se të vendoset, duhet diskutuar dhe duhet studjuar thellë.

Edhe unë them t'i hapim shkollat bujqësore të Peshkopisë dhe të Delvinës, por të mos zgjerohemi sot për sot shumë me teknikumet bujqësore. Këto shkolla duhen parë edhe në drejtim të gjendjes e të preqatitjes së kuadrit. Shteti ka caktuar një sasi bursash, si për të gjithë sektorët, edhe për bujqësinë, por s'duhet lënë pasdore edhe ana tjeter që, të gjitha kooperativat bujqësore të dërgojnë në shkolla edhe të rinj me bursat e tyre. Vetëm duhet të mbahet parasysh që këta kuadro, kur të mbarojnë shkollën me bursën e kooperativës, duhet të shërbejnë në kooperativë. Në të njëjtën kohë të zgjerojmë sistemin e kurseve bujqësore pa u shkëputur nga puna.

Kam një vërejtje për Komisionin e Planit, i cili

pregatit dhe na paraqit raporte uniforme për çdo vit. Edhe reporti i kësaj here, nuk është një material që të përbajë gjithë atë eksperiencë të Partisë dhe të pushtetit në problemet kryesore, të cilat të trajtohen në fryshtën e një kritike dhe autokritike të shëndoshë. Krahas kësaj, në raport duhet të vihen në dukje edhe disa rrethe e sekretarë që s'i kanë realizuar detyrat e planit dhe të jepet eksperienca e atyre rretheve, që i kanë realizuar ato. Në këtë mënyrë, duke vënë në dukje anët pozitive dhe negative, do të përfitohet më tepër, prandaj ndryshoni metodën që përdorni në preqatitjen e materialeve, shokë të Komisionit të Planit!

Për shumë nga çështjet që u diskutuan këtu duhet të merren masa nga vetë dikasteret, të cilat të kritikohen për dobësitë e tyre dhe të insistohet që të gjithë 'punonjësit e ministrive të mësojnë dhe të përmirësojnë punën e tyre.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

ORGANET DREJTUESE TË PARTISE Ë TË SHTETIT TË FORCOJNË MË SHUMË NDIHMËN DHE KONTROLLIN PËR ZBATIMIN E PLANIT

*Fjala e mbylljes në Plenumin XII
të KQ të PPSH¹*

27 dhjetor 1958

Edhe unë do të përpinqem të mos zgjatem, sepse problemet e rëndësishme që na dalin përpara u trajtuan në raport dhe u prekën edhe nga shokët. Unë them se kjo mbledhje e plenumit do të na shërbejë shumë të gjithëve për ta përmirësuar punën tonë në vitin e ardhshëm.

Plenumet e Komitetit Qendror janë ngjarje me rëndësi në jetën e Partisë dhe të popullit tonë. Është fakt se mbledhjet e plumeve të Komitetit Qendror kanë edukuar njerëzit dhe kjo ka bërë që të kemi rezul-

¹ Plumi dëgjoi reportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi realizimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1958 dhe detyrat që dalin për vitin 1959», mbajtur nga shoku Koço Theodhosia.

tate në punë. Analiza që i bëmë planit si këtu në plenum, ashtu edhe në Byronë Politike, lidhur me realizimin e planit të vitit 1958 na tregon se nga punonjësit tanë janë bërë përpjekje të mëdha, prandaj edhe zhvillimi i ekonomisë së vendit tonë gjatë këtij viti ka shkuar përpara. Konkluzioni është se ne po e zhvillojmë ekonominë, po natyrisht në punën tonë ashtu sikurse ka suksese, ka edhe të meta dhe nuk është e mundur që i gjithë ky plan, të gjitha këto detyra të realizohen pa të meta fare dhe pa vështirësi. Në realizimin e planeve tona ndodh kjo gjë, po fakti është se Partia dhe njerëzit tanë kanë qenë kurdoherë në krye të detyrave, janë mobilizuar, janë lodhur dhe kanë punuar me kokë.

Po rëndësi ka çështja që lë metat t'i zbulojmë dhe t'i luftojmë. Edhe në këtë plenum u vunë në dukje plot të meta dhe u kritikuan si për ato që u takojnë shokëve poshtë, ashtu edhe këtu, se edhe ato që bëhen këtu duhet të njihen mirë dhe të mos i marrë përsipër të gjitha baza, ndërsa të gjitha të mirat t'i marrë udhëheqja. Pra, të metat ashtu siç ekzistojnë t'i marrë edhe baza edhe udhëheqja për ato që ka, pra, secila të marrë ato që i takojnë. Këtë e theksoj se është bërë zakon që bazës t'i heqim drurin më të madh dhe dobësitet që vërehen këtu lart dhe që janë pasojë e mungesës së kontrollit ose e burokracisë sonë nuk vihen në dukje, bile as nga baza nuk vihen në dukje me kurajë. Baza po e zhvillon kritikën dhe kjo është pozitive, po përsëri ajo është e pamjaftueshme. Kur bëhet kritika, qoftë kjo edhe në drejtim të shokëve të organeve më të larta të Partisë, cilido që të jetë ai që kritikohet duhet të ndreget. Duke bërë një kritikë me vend nuk i bie nderi

askujt dhe ajo bën një efekt shumë të mirë kur gabimi ndreqet. Prandaj, kur bëhet një kritikë, e cila duhet të jetë realiste, të mos merret parasysh personi, po të kihen parasysh interesat e Partisë dhe të popullit.

Kur themi se kemi suksese ne mbështetemi në faktet se realizimi i planit në industri është një sukses i madh për vendin tonë. Edhe realizimet në ndërtim ne duhet t'i konsiderojmë si një sukses me rëndësi, sepse përpala atje nuk kanë shkuar mirë punët, ndërsa plani, megjithëse në lekë, po realizohet, prandaj është një sukses. Në bujqësi, megjithëse kemi mjaft deficite të cilat nuk duhet t'i harrojmë dhe se puna atje është shumë më e vështirë nga industria dhe ndërtimet, përsëri edhe këtu, po ta shohim çështjen me objektivitet, kemi përparime. Ne duhet të shkojmë me parimin se këto deficite i mban në kurriz populli, se kanë penguar ekonominë, ngritjen e nivelit të jetesës së popullit tonë.

Prandaj, që tani, përpala vitit 1959 të organizojmë mirë punën dhe të mobilizojmë të gjitha forcat jo vetëm për realizimin, po për tejkalimin e planit të vitit të ardhshëm. Ky plan është mjaft i ngjeshur, po mund të realizohet me një mobilizim të madh të të gjitha forcave. Na vihet detyra që ta realizojmë dhe ta tejkalojmë planin e 1959-s që të plotësojmë deficitet e krijuara deri tani dhe t'i dalim Partisë përpala me pesëvjeçarin të realizuar në Kongresin IV, me detyrat kryesore të Kongresit III të plotësuara. Prandaj të përpinqemi që nderi i Partisë sonë përpala popullit të mos cënohet.

Unë nuk do t'u hyj në detaje këtyre çështjeve, po ka disa prej tyre që duhen përmendur. Për industrinë

dhe për sektorët që janë të lidhur me të, baza duhet të sigurojë në kohën e duhur lëndën e parë. Për këtë qëllim, baza që është e lidhur me këtë problem dhe sidomos organet e bujqësisë e të grumbullimit, duhet të bëjnë përpjekje të mëdha për të siguruar lëndën e parë për industrinë, sepse mungesa e saj sjell një sërë ngatérresash, që na dëmtojnë shumë.

Ministria e Industrisë duhet ta shfrytëzojë mirë maqinerinë që ka në dispozicion, d.m.th. ta rishikojë ngarkesën e maqinerisë sipas rregullave, pasi në analizat që janë bërë del se shumë fabrika nuk ngarkohen sipas kapacitetit, nuk shfrytëzohet kështu në maksimum maqineria e megjithkëtë në shumë raste kërkohen fabrika dhe punishte të tjera, kur nuk i kemi ngarkuar sa duhet ato që kemi me nga dy turne, pa lëre pastaj me nga tre. Prandaj Ministria e Industrisë dhe e Misionerave këtë problem, si dhe atë të mirëmbajtjes së maqinerisë ta shikojë më me kujdes.

Rëndësi të madhe ka edhe çështja e kontrollit të zbatimit të planit dhe t'i vihet rëndësi edhe çështjes së edukimit dhe të perfeksionimit të kuadrit. Ne kemi shumë kurse dhe shkolla, po Ministria e Industrisë, ndërmarrjet e saja vartëse dhe organizatat e Partisë në bazë nuk po interesohen si duhet për problemin e kuadrit. Kuadrot e mesëm të indistrisë të mos i presim vetëm nga shkollat. Për këtë çështje mendoj që nxënësit, siç na tha shoku Manush, që lënë shkollat e mesme dhe shkojnë në 'prodhim, në fabrika, punishte ose në bujqësi e ndjekin shkollat pa u shkëputur nga puna, t'i bëjmë teknikë të mesëm duke u kujdesur për ngrijtjen e tyre atje ku janë, në punë e sipër. Duke orga-

nizuar mirë punën dhe me një kontroll rigoroz, brenda 2-3 vjetësh t'i preqatitim edhe këta sikurse ata që dalin nga teknikumet. Prandaj të mos lihet pasdore ky numër mjaft i madh kuadrosh dhe që punon në prodhim.

Për bujqësinë shoku Mehmet i theksoi shumë mirë çështjet, prandaj nuk është nevoja të zgjatem edhe unë, sepse jam plotësisht dakord me ato që tha ai dhe me sa thanë shokët e tjerë që diskutuan.

Në sektorin e ndërtimit tani kemi një organizim më të mirë. Masat që ka marrë Josifi [Pashko], për të cilat ai foli vetë, më duket se janë të mira, vetëm ministria dhe organizatat e Partisë të bëjnë përpjekje për t'i zbatuar, sepse organizimi i mirë i punës në ndërtim do të bëjë që plani të realizohet me sukses. Po edhe për sektorin e ndërtimit është për t'u theksuar lufta për sigurimin e lëndës së parë dhe të projekteve, si dhe për shfrytëzimin e maqinerisë.

Edhe Ministria e Ndërtimit duhet të bëjë shumë kujdes për çështjen e kuadrit, sepse plani i ardhshëm pesëvjeçar do të kërkojë një numër të madh specialistësh për nevojat e ndërtimit që të realizohen veprat e pesëvjeçarit të tretë. Prandaj, po të mos marrim masa me kohë për edukimin e kuadrit, për organizimin e mirë të punës, për shfrytëzimin e maqinerisë në të ardhshmen, do të gjendemi përpara vështirësish shumë të mëdha. Prandaj Ministria e Ndërtimit t'i ketë para-sysht detyrat e ardhshme të pesëvjeçarit të tretë dhe dy vitet që vijnë të bëhen një shembull i madh për preqatitjen e kuadrit, për t'i hedhur ata në luftë për pesëvjeçarët që vijnë.

Problemi i kuadrit është një problem shumë i

rëndësishëm, që e dinë të gjithë. Disa shokë të mos e marrin këtë çështje nga ana subjektive, po fakti është se Partia nuk interesohet si duhet për çështjen e shkollave.

Shumë nga sekretarët e rretheve në diskutimet e tyre prej më se gjysmë ore nuk thanë asnje fjalë për shkollat. Ne mund t'ua falnim këtu e disa vjet më parë kryetarëve të komiteteve ekzekutive dhe sekretarëve të parë të komiteteve të Partisë në rrethe nëse ata kishin frikë të kontrollonin mësuesit dhe shkollat, pasi nuk kishin eksperiencë, po tanë ka ardhur koha që kjo mungesë nuk mund t'u falet, sepse kryetarët e komiteteve ekzekutive në mos janë me shkolla të larta, shumica janë duke i ndjekur ato, ndërsa sekretarët e parë të komiteteve të Partisë dhe shumë sekretarë të tjerë kanë mbaruar Shkollen e lartë të Partisë dhe janë shumë mirë në gjendje të kontrollojnë shkollat. Prandaj, nuk u lejohet më të mos interesohen për mbarëvajtjen e arësimit dhe për të mos ndihmuar dhe kontrolluar mësuesit dhe shkollat. Kishte të drejtë 6 vjet më parë sekretari i Komitetit të Partisë të ish-rrethit të Shijakut kur më tha se nuk shkonte dot në shkollë se nuk kishte haber, po, siç thashë, tanë gjendja ka ndryshuar.

Çështja e shkollës është çështje kuadrosh. Këtu ne po flasim për të preqatitur inxhinierë, agronomë etj. Po si do të dalin këta, në rast se ne nuk interesohemi për sigurimin e nxënësve, që kur ata fillojnë jetën e tyre në shkollë? Pa këtë interesim do të bëhej një punë shumë e dobët. Vetëm Partia mund ta ngrejë këtë çështje në nivelin që kërkon koha. Nuk është aspak e drejtë që kuadrot tanë drejtues t'i preokupojë vetëm

realizimi i prodhimit industrial ose i grurit, i misrit, i pambukut, i duhanit, i transportit, i xhiros në tregëti etj. Këto janë sigurisht çështje të dorës së parë, por duhen edhe kuadrot që preqatiten me anë të shkollës, duhet të kujdesemi edhe për shëndetin e popullit si nga ana e bazës ashtu edhe e Ministrisë së Shëndetësisë. Çështjen e kam, pra, që Partia të interesohet për të gjitha.

Ka nxënës që lënë mësimin dhe nuk tregojnë respekt për shkollën dhe mësuesin. Për këtë gjendje duhen vënë përpara përgjegjësisë mësuesit. Në radhë të parë ata duhet të mos venë në shkollë të papregatitur, por kurdoherë të preqatitur dhe të kuptojnë mirë se shteti i paguan për punën që bëjnë. Më e rëndësishmja është se atyre u është dhënë një besim shumë i madh, siç është edukimi i kuadrove. Po ata shumë herë bëjnë si mësuesit në kohët e vjetra, që mendonin se nuk kishte kush t'i kontrollonte dhe disa prej tyre shkojnë pa u preqatitur fare për mësim. Po edhe kur shkon ndonjë kontroll, ata justifikohen sikur fajin e kanë nxënësit. Jo, fajin nuk është nxënësit, po në radhë të parë mësuesi, drejtori, këshilli pedagogjik. Po të forcohet kontrolli shtetëror dhe ai i Partisë mbi shkollat do të ecë më mirë puna. Mua më duket se janë fjalë ato që thonë disa mësues se për edukimin e nxënësve duhet të kujdeset shumë familja. Është e vërtetë se edukata në familje influencon shumë te fëmijët, po ne e dimë gjendjen e familjes sonë fshatara. Ajo nuk është në atë nivel që thonë mësuesit. Ne e dimë se babai ose nëna në fshat i thonë djalit të lërë mësimet dhe të shkojë të kullotë lopët. Prandaj, rolin kryesor në edukimin e fëmijëve te ne do ta luajë kryesisht mësuesi. Ne jemi

dakord me mësuesit që ata duhet të ndihmohen, të mbahen afër, po edhe të vihen përpëra përgjegjësisë kur nuk e kryejnë mirë detyrën.

Organizimi i mirë i punës si poshtë ashtu edhe lart ka një rëndësi të madhe për realizimin e planit. Puna jonë ka përmirësimë në këtë drejtim, po ne kemi edhe të meta serioze. Të meta ka në bazë, po kemi edhe ne në punën tonë.

Është konstatuar se ndihma nga lart me anë ekipe shka dhënë rezultate shumë më të mira nga sa mund të jepet në mënyrë individuale duke kaluar si era në bazë e pastaj ktheu prapë pa lënë gjurmë. Ndihma me ekipe, si nga Partia ashtu edhe nga qeveria, ose ndihma e kombinuar e dyanshme jep rezultate. Kjo mënyrë jo vetëm jep rezultate duke e ndihmuar bazën të zbulojë të metat, rezervat e brendshme dhe t'i japë hov punës, po ajo ka ndihmuar të gjithë kuadrin që ka bërë pjesë në ekipe, të mësohet dhe të edukohet në mënyrë të organizuar nga baza. Dhe eksperiencia është e tillë që shokët, që kanë pasur rastin të venë nëpër ekipe dhe të kenë ndenjur në bazë një ose dy muaj, kanë bërë një shkollë të madhe. Prandaj të vihet sa më mirë në jetë parimi i lidhjes së mirë me bazën. Kush është i lidhur mirë me të, ai e bën edhe punën më mirë nga të gjithë. Prandaj detyra jonë, duke filluar që nga Komiteti Qendror, Byroja Politike dhe qeveria, nga Sekretariati i Komitetit Qendror ose Kryesia e Këshillit të Ministrave, si dhe nga ministrat duhet të jetë që të lidhemi sa më mirë me bazën, me problemet e saj. Që të realizohet plani duhet që edhe ne këtu të bëjmë shumë gjëra. Me të drejtë kritikoni ju qoftë njërin ministër

ose tjetrin, ose një nga sekretarët e Komitetit Qendror, po kur vjen çështja pse nuk erdhi kjo ose ajo nga lart, ju jepen shumë arësyte dhe më në fund ju kërkohet përsë nuk u realizua plani.

Prandaj edhe nga lart duhet të merren masa që të sigurohet realizimi i planit, ardhja në kohën e duhur e materialeve të brendshme ose të jashtme. Të mos themi se kjo ose ajo nuk u siguria, sepse një dobësi e tillë do të rëndoje që të mos realizohet detyra që kemi vënë. Kjo bën që shumë herë të mbeten edhe punëtorët pa rrrogë të plotë, gjë që është si në dëm të tyre se nuk do të paguhen plotësisht, ashtu edhe në dëm të arkës së shtetit që paguan njerëz pa punuar dhe plani s'realizohet. Derisa një material e kemi vënë në plan duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që ai të sillet në kohë. Bile qeveria në këtë drejtim më duket se ka qenë edhe pak si dorëlëshuar. Me gjithë planifikimin, punishtet, që u thanë këtu, nuk po vijnë akoma. Kjo ndodh edhe për shumë materiale të tjera. Edhe materialet që kërkohen për tharjen e pambukut ose ndonjë gjë tjetër, që na intereson shumë, mund t'i sjellim menjëherë sepse ne kemi në vendet miq shumë kredi që nuk po i shfrytëzojmë plotësisht si p.sh. në Rumani, në Hungari etj. Atëherë kur çështja është kështu, ato gjëra që i vlejnë shumë ekonomisë sonë, duhet të blihen menjëherë.

Duhet që edhe nga ana jonë këtu lart të merren masa serioze dhe të rrepta që të sigurohen materialet që vendosin për realizimin e planit. Për këtë ministrat të vihen përpara përgjegjësisë dhe të mos lejohen që ata të na nxjerrin 101 mijë avaze. Qeveria dhe Byroja Politike janë në gjendje t'i kuptojnë ata kur kanë bërë të

gjitha përpjekjet dhe nuk i kanë siguruar, po shumë herë përpjekje të mjaftueshme nuk bëhen. Prandaj, këtej e tutje të kihet parasysh kjo gjë.

Ne themi se duhet ta ndihmojmë bazën me kontroll të vazhdueshme. Po kjo ndihmë dhe ky kontroll duhet të bëhen të organizuara dhe të venë në kohën e duhur, bile më shpejt, që t'i dalim punës përpara. Për këtë çështje edhe ju duhet ta përmirësoni punën, po edhe ne këtu lart duke filluar që në Byronë Politike, në qeveri, në Sekretariat dhe në Kryesinë e Këshillit të Ministrave dhe pastaj akoma më poshtë nëpër dikasteret etj. Qëllimi është që t'ju jepet juve një ndihmë më e mirë. Në këtë mënyrë edhe ju të ndërroni metodën e punës.

Pse thashë unë që kemi faj ne? Byroja Politike ka marrë në shqyrtim shumë probleme kyçë dhe ka marrë vendimet përkatëse. Po mendimi im është se ne nga ana e Sekretariatit të Komitetit Qendror, nuk ia kemi paraqitur Byrosë Politike si duhet problemet dhe faji përkëtë na bie neve, sekretarëve të Komitetit Qendror. Vetëm duke i paraqitur mirë problemet ajo mund të ushtrojë një ndihmë dhe kontroll të vazhdueshëm mbi bazën. Po këto pësime kë të na bëhen mësime.

Unë mendoj që në të ardhshmen, me aprovin e planit të vitit 1959, ne duhet ta përmirësojmë metodën e punës, ta përmirësojmë këtë në radhë të parë në Byronë Politike dhe në qeveri, në Sekretariatin e Komitetit Qendror dhe në Kryesinë e Këshillit të Ministrave, në mënyrë që t'i jepet një ndihmë më efektive bazës. Po si mund të jepet kjo ndihmë?

Ne kemi marrë në shqyrtim shumë probleme në

Byronë Politike, po ato nuk i janë pregetit asaj në mënyrë të rregullt. Byrosë Politike ne duhet t'i paraqitim problemet në bazë të planit vjetor, duke caktuar një normë mbledhjesh për çdo muaj. Atëherë, Sekretariati, duhet t'i paraqitet Byrosë Politike për një vit planin e vet të punës. Po këto duhet të jenë probleme kyçë që t'i zgjidhin çështjet në mënyrë rrënjosore dhe ta ndihmojnë Partinë për zgjidhjen e problemeve të planit të viti 1959. Problemet duhet të renditen e të paraqiten siç e lyp nevoja, pasi tanë ne kemi 14 vjet që drejtojmë Partinë dhe shtetin, pra, dimë cilat janë problemet më të rëndësishme dhe cilat duhen zgjidhur në këtë ose atë kohë.

Pra, Byrosë Politike duhet t'i caktojmë një plan perspektiv. Kjo do të na ndihmojë t'i dalim punës përrapa, do të ndihmojë të pregetiten raportet si duhet, sepse edhe inspektorët dhe drejtorët e drejtorive të aparatit të Komitetit Qendror do të dinë se ç'probleme do të marrë në shqyrtim Byroja Politike. Prandaj gjatë punës së tyre në bazë punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror do të interesohen se si shkon ky problem, ku janë vështirësítë dhe të metat këshitu që kur të vijë koha Byrosë Politike do t'i cohët një raport i qartë, jo i gjatë, dhe me propozime konkrete për masat që duhen marrë. Kjo punë do ta lehtësojë shumë edhe bazën se ndihma do t'i shkojë në kohën e duhur e studjuar dhe konkrete, kurse qeveria do të marrë me kohë masa nga ana materiale dhe Partia do të sigurojë mobilizimin e masave për realizimin e detyrave që do të ndihmojnë në zgjidhjen e problemit. Byrosë Politike mund t'i vijnë për shqyrtim edhe probleme të tjera të paparashikuara

në plan, po ato do të jenë probleme të dorës së dytë.

Një tjetër çështje që nuk na shkon mirë është puna e Sekretariatit të Komitetit Qendror. Ai nuk po e kryen si duhet detyrën. Edhe për këtë faji është yni. Sekretariati duhet të jetë organi operativ i Byrosë Politike për të ndjekur dhe për të shqyrtruar probleme të kohës, të shkurtëra e operative dhe për të marrë masa. Po kjo punë nuk po bëhet. Sekretariati shumë herë nuk mblidhet në rregull, sepse kur caktohen këto probleme ato shkruhen nga 20 faqe të gjata kështu që humbet karakteri operativ, nuk dallohen problemet e Partisë nga ato shtetërore. Pra, karakteri i problemeve të Sekretariatit duhet të jetë operativ, ndihmë e shpejtë dhe kontroll i zbatimit të detyrave. Problemët që do të marrë në shqyrtim Sekretariati duhet të jenë të shumta. P. sh. në Byronë Politike ne kemi marrë në shqyrtim çështjen e shkollave. Po atje ka shumë detyra, prandaj mund të merren në shqyrtim se si po zbatohen dy-tri nga këto detyra të vendimit të Byrosë Politike mbi shkollat dhe ç'duhet bërë më tej për sigurimin e zbatimit të plotë të vendimit të Byrosë Politike. Nuk është nevoja që në këto vendime të Sekretariatit t'u bëjmë propagandë komiteteve të Partisë, po me to ne t'i sinjalizojmë se ky ose ai problem te ju nuk po shkon mirë. Në këtë rast ne jemi të bindur se komitetet e Partisë do të mobili-zohen. Edhe inspektorët e aparatit të Komitetit Qendror nuk do t'u shkojnë rrtheve për të gjitha problemet, ata do të kenë në plan 4-5 probleme të Sekretariatit dhe ndonjë nga të Byrosë Politike dhe në bazë të tyre do ta bëjnë kontrollin, do të japin ndihmën e tyre, po do të marrin edhe eksperiencën tuaj. Ndërsa tanë ata ju vijnë

për shumë gjëra. Kjo mënyrë pune do të jetë një ndihmë për të gjithë Partinë, për qeverinë dhe kryesinë e saj.

Edhe në qeveri merron në shqyrtim probleme në çdo mbledhje, prandaj puna për kontrollin e zbatimit të vendimeve lë shumë për të dëshiruar. Këtë e them sepse kryesinë po e mbulojnë shumë probleme, me nga 20 e 30 çështje të rëndësishme në çdo mbledhje. Unë mendoj se në këtë çështje janë shumë fajtorë edhe ministrat që e pengojnë kryesinë për të organizuar më shumë ekipe kontrolli dhe për të dhënë një ndihmë më konkrete dhe operative për bazën. Prandaj, ne duhet ta përmirësojmë punën tonë këtu lart se kjo do të jetë një tjetër ndihmë për bazën, për instruktorët e në përgjithësi për të gjithë Partinë. Në këtë drejtim këto të meta duhet të ndiqen medoemos.

Një çështje tjetër që ne duhet të theksojmë është puna për të mos frenuar iniciativën e masave. Të inkurajohet kjo iniciativë kur është fjala për të prodhuar më shumë vlera materiale dhe të mos sillen pengesa. Në këtë drejtim u bënë me të drejtë edhe kritika, po të kihet parasysh edhe çështja që masa të mos marrë edhe iniciativa të tillë që të vëré pushtetin, Partinë dhe qeverinë në pozita të vështira materiale, për lëndë të parë etj. Jashtë mundësive sepse kjo iniciativë në vend që të jetë e mirë do të bëhet e dëmshme. Iniciativave të mira të mos u pritet hovi.

Një tjetër problem i rëndësishëm për ne është çështja që Partia të vëré në lëvizje të gjitha levat e saja. Këtë ne e përsëritim shumë herë në teori, po në praktikë lë shumë për të dëshiruar. Jo se nuk bëhet

gjë fare, po Partia nuk i shfrytëzon sa duhet levat e saja, nuk jeton me dinamizmin e tyre.

Kanë kaluar 14 vjet që nga çlirimi i vendit, po në drejtim të Organizatës së Frontit Demokratik më duket se nuk ka aq përparime në lidhje me kartërat e anëtarëve. Gjatë kësaj kohe edhe mentaliteti i ish-ballistëve ka ndryshuar dhe kjo u kuptua në zgjedhjet që u bënë verën e kaluar në të cilat vetëm 261 votë nuk ishin me ne, nuk na e dhanë votën. Po edhe nga ata ish-ballistët që na dhanë votën nuk do të thotë se janë qind për qind me nc, po të paktën nuk janë qind për qind në luftë të hapur. Po pse atëhere ata nuk votuan kundër? Kjo ndodh se disa nga këta njerëz kanë filluar të mendojnë pak ndryshe. E ç'humbejm ne që t'i japim kartën e Frontit tanë një njeriu të tillë që ishte i lëkundur, por që nuk u gjakos me ne? Ne t'ia japim se ajo nuk është teser partie. Tjetri voton për ty, punon nën direktivat e Partisë, po dikur ka qenë edhe ballist. Mirëpo mos harroni se kanë kaluar kaq vjet që nga koha e luftës. Atij që është edhe sot armik, natyrisht, të mos i jepet karta, por të tjerët që kanë qenë të mashtruar dhe kanë bërë ndryshime në pikëpamjet e tyre duhet t'i shohim më ndryshe. Dua të them që Partia t'i vërë në lëvizje këto masa nëpërmjet organizatave dhe organizatat bazë të Frontit të punojnë në rregull dhe të mos mbeten formale.

Organizatat profesionale duhet të jenë ndihmëset kryesore të Partisë në radhët e klasës punëtore. Mirëpo Partia nuk është aq aktive në punën me bashkimet profesionale, e quan punën në të si diçka formale. Prandaj duhet punuar më mirë me to.

Tani desha t'ju informoj edhe për disa probleme vitale të jetës së popullit tonë. A i kemi siguruar ne kreditet e nevojshme për planin e tretë pesëvjeçar?...

Siq e dini në përgjithësi ne e siguruam pak a shumë planin e tretë pesëvjeçar përsa i përket ndihmës që duhet të na jasin miqtë tanë nga jashtë. Prandaj përpara kësaj gatishmërie të madhe që tregojnë ata për popullin dhe për Partinë tonë, Partia dhe populli ynë duhet të mobilizojnë të gjitha forcat për t'i realizuar dhe për t'i tejkaluar këto plane për të mirën e popullit. D.m.th. pengesa në këtë drejtim ne nuk kemi.

Varet tani nga ne të hartojmë një plan me të vërtetë konkret dhe real dhe të mobilizojmë të gjitha forcat e popullit për ta tejkaluar atë, për shtimin e prodhimeve tona që populli të rrojë më mirë. Po e gjithë kjo detyrë varet shumë nga organizimi i mirë i punës sonë. Ne kemi bindje se do të kemi suksese më të mëdha në të ardhshmen për të mirën e popullit, sepse situata në vendin tonë po forcohet dita-ditës si nga ana ekonomike, ashtu edhe nga ana politike. Uniteti i Partisë dhe i popullit tonë është i çelniktë dhe i tillë që intrigat dhe puna armiqësore e revisionistëve tradhëtarë të Beogradit dhe e armiqve të tjera të jashtëm nuk kanë mundur dhe nuk do të mundin ta cënojnë. Kjo vjen, sigurisht, nga uniteti i çelniktë i Partisë sonë marksiste-leniniste, që po ngrihet politikisht, ideologjikisht çdo ditë dhe po bëhet me të vërtetë një luftëtare e papërkulur për çështjen tonë të lavdishme, për çështjen e komunizmit.

Situata në vendin tonë është e shëndoshë, politika e drejtë e Partisë sonë ka krijuar entuziazëm, na mbush zemrën me gjëzim dhe ngjall gjithnjë respekt dhe dashuri

të madhe në vendet socialiste dhe në partitë e tjera marksiste-leniniste.

Edhe situata ndërkontaktare, megjithëse imperialistët preqatiten për luftë, mund të themi se në përgjithësi po shkon në favorin tonë. Të gjitha këto, pra, rëndojnë në balancën e paqes d.m.th. në dëm të punës së imperialistëve. Po edhe armiqjtë nuk rrijnë me duar lidhur, ata luftojnë kundër nesh dhe ne i shohim dita-ditës përpjekjet e tyre.

Kur u kthyem nga Moska ne patëm edhe një takim me shokët hungarezë. Në biscedime ata na vunë në dijeni se gjendja në Hungari po shkon duke u forcuar, se kanë akoma mjaft vështirësi që vijnë në radhë të parë nga inteligjencia, se tani është qetësuar gjendja, klasa punëtore ka besim në vetëvete dhe po bën përpjekje të mos përsëritet më 1956. Bile, na thanë se ka edhe nga ata që morën pjesë në kundërrevolucion, dhe që tani e kuptojnë se kanë bërë gabim.

Në fshat përsa i përket kolektivizimit shokët hungarezë janë në vështirësi të mëdha, kanë qenë në dilemë të shpejtojnë me kolektivizimin, apo të ecin më me kujdes. Kështu në komitetin e tyre qendror kanë pasur dy pikëpamje për këtë problem. Pikëpamja e dytë për të ecur me kujdes dominon më shumë dhe këtë e argumentojnë me dy gabimet që janë bërë për 'kolektivizimin, një herë në kohën kur ishte kryeministër Imre Nagi që u la fushë të lirë kulakëve dhe i likuidoi kooperativat dhe një herë gjatë kundërrevolucionit. Për këtë arësy, thanë shokët hungarezë, ne kemi frikë të shpejtohem, prandaj duhet të ecim me kujdes.

Ne u thamë atyre se kështu ka vepruar edhe Partia jonë, e cila ka ecur me shumë kujdes në këtë çështje, megjithëse ne kemi pasur një fshatarësi shumë patriote, që vepron kurdoherë siç i thotë Partia. Tani që na u krijuan kushtet nga ana materiale si dhe pas një propagande të vazhdueshme, fshatarësia është bindur dhe kolektivizimi te ne ka marrë një hov të mirë. Por lufta e Partisë sonë për kolektivizimin, u thamë ne, nuk ka përfunduar.

Për Poloninë keni një ide në lidhje me ato që shkruajnë gazetat. Ne dimë se atje pozitat e elementit të shëndoshë të partisë nuk janë akoma të forta, pasi oportunistët janë në fuqi dhe kanë forca. Por pas vajtjes së delegacionit qeveritar dhe të partisë të Polonisë në Moskë vihen re disa shenja pozitive. Në radhë të parë vihen në dukje miqësia me BRSS, çështja e kampit, lufta kundër revizionizmit. Edhe fjala që ka hedhur Gomulka kundër revizionistëve jugosllavë ka bërë përshtypje te jugosllavët se ata prisnin tjetër qëndrim nga ai. Po me gjithë sulmet që i kanë bërë jugosllavët Gomulkës ai nuk u është përgjegjur akoma se nuk do të hyjë në polemikë. Në plenumin e fundit të KQ ata kanë diskutuar edhe çështjen e kolektivizimit dhe kanë marrë vendime që tregojnë se po bëhen hapa përpara.

Po ne jemi marksistë dhe çështjet duhet t'i shohim nën këtë prizëm. Neve na vjen mirë kur punët ecin në rrugë të mirë në Poloni, po çështja tani është, do të shkojnë apo jo deri në fund në këtë rrugë. Deri tani ne po shohim se në disa çështje organizative ka paqartësira. Tani në Poloni po pregatiten për kongresin e partisë,

po nuk mund tē mos vëmë re se atje zgjedhjet ndryshojnë nga irregullat e partisë, nga normat leniniste. Atje zgjedhjet po bëhen me zgjedhës tē dytë, natyrisht, pér tē shkuar në kongres ata elementë që oportunistët duan tē venë dhe jo ata që dërgon masa. Ne mund tē themi se baza atje është treguar shumë e vendosur kundër revizionizmit, se ajo ka bërë përpjekje pér tē shkuar njerëz tē mirë në kongres. Po kur u bënë këto zgjedhje pér në kongres ato, siç thashë, u bënë me dy shkallë. Mendimi i shokëve tani është tē shohim se si do tē zbatohet kjo kthesë në praktikë, se ne shohim që përveç fjalëve të mira që thonë po bëjnë edhe disa gjëra tē tjera, që nuk na duken tē rregullta. Kjo nuk është mirë. Sido që këto janë çështje tē brendshme, po edhe neve na vjen keq pér këtë gjendje, se Polonia është pjesëtare e kampit. Megjithatë tē shohim se si do tē zhvillohet më tej situata atje.

Në Kinë, ndërtimi i socializmit ka marrë hov tē madh. Atje po merren rendimente shumë tē larta në bujqësi dhe përparime kolosale po bëhen në sektorin e industrisë. Kjo na gjëzon tē gjithëve, sepse Kina po bëhet një forcë e madhe pér socializmin. Atje kemi tē bëjmë me një popull shumë punëtor, tē thjeshtë, akoma tē varfër, sepse niveli i jetesës në Kinë ka qenë shumë i ulët. Masa e kinezëve në tē kaluarën nuk hanin veçse pak oriz dhe shumë jetonin në kasolle, guva ose varka. Mirëpo tani është ndryshe, kur ai kthehet nga puna në vend tē shtëpisë së varfër shkon pér tē ngrënë në një mensë tē bukur, ha shumë më mirë se në shtëpinë e tij. Kjo është një punë shumë e mirë, sepse ka edhe anët e saja pozitive, zhvillon te punonjësit ndjenjën e ko-

lektivitetit, të ekonomizimit të kohës, sepse të punosh i organizuar është një gjë shumë e mirë.

Prapambetja e madhe ekonomike dhe kulturale që ka ekzistuar në Kinë nuk ka se si të kapërcehet ndryshe veçse me një organizim të mirë, me një punë të tillë, me një vullnet të fortë, cilësi këto që nuk u mungojnë kinezëve. Prandaj, masat që po marrin shokët kinezë u përshtaten kushteve të vendit të tyre, pra, komunat popullore janë pozitive dhe po jasin rezultate. Në fillim, sigurisht, do të ketë edhe gabime sepse si Partia Komuniste Kineze ashtu edhe shoku Mao Ce Dun kanë thënë se gabimet eventuale që mund të bëjnë do t'i rregullojnë në punë e sipër.

Shokë, ne duhet të punojmë pa pushim që të forcojmë Partinë tonë, unitetin e Partisë me popullin, të luftojmë për mbrojtjen e interesave të popullit, të realizojmë planet tona ekonomike dhe të bëjmë një luftë të vazhdueshme dhe të pamëshirshme kundër revizionistëve modernë jugosllavë etj., sepse kështu ne jo vetëm u kemi shërbyer interesave të socializmit në vendin tonë, që janë të lidhura shumë ngushtë me interesat e gjithë kampit tonë, po i kemi mbrojtur dhe kemi bërë një detyrë të madhe internacionliste, marksiste-leniniste.

Tani, shokë, varet nga ne, nga Partia, nga të gjithë kuadrot që të dalim me sukses në punën tonë për realizimin e planit të vitit 1959. Komiteti Qendror dhe Byroja Politike e sigurojnë Partinë se do të vënë të gjitha forcat që të metat që janë vërtetuar në punën e

Byrosë Politike të Komitetit Qendror dhe të qeverisë t'i përmirësojnë dhe se do të mbajnë lidhje akoma më të ngushta me masat dhe se do të marrin masa që plani i vitit 1959 të realizohet me sukses.

*Botohet për herë të parë, me
ndonjë shkurtim, sipas tekstit
të marrë me stenogram
që gjendet në AQP*

MESAZH DREJTUAR POPULLIT ME ANË TË RADIOS ME RASTIN E VITIT TË RI

31. dhjetor 1958

Të dashur shokë dhe shoqe, mëma dhe baballarë, motra e vëllezër, ushtarë dhe oficerë, të rinj e të reja, pionierë dhe fatosa të Shqipërisë,

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punes të Shqipërisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe të Qeverisë së Republikës sonë Popullore, ju uroj nga zemra Vitin e Ri 1959. Qoftë ky vit i lumtur, i gëzuar dhe plot suksese për atdheun tonë të shtrenjtë, për popullin tonë heroik, për të gjithë ju, punëtorë, fshatarë, intelektualë, ushtarë dhe oficerë, për të gjithë ju, fëmijë të dashur të Republikës sonë Popullore!

Viti që mbaroi qe viti i një sërë suksesesh të reja për vendin tonë. Klasa punëtore heroike, fshatarësia punonjëse dhe inteligjencia popullore, nën udhëheqjen e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, me punën e tyre vetëmohuese kanë arritur rezultate të mira në forcimin dhe në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë popullore, në zhvillimin e industrisë, në forcimin e bujqësisë mbi baza socialiste, në lulëzimin e arësimit dhe të kulturës. Plani i shtetit për vitin 1958, siç e

konstatoi edhe Plenumi i fundit¹ i Komitetit Qendror të Partisë, u realizua në mënyrë të kënaqshme. Kjo do të thotë se u bë edhe një hap tjetër i rëndësishëm përpara drejt përmirësimit të mëtejshëm të jetesës së masave punonjëse, që është qëllimi kryesor i Partisë dhe i qeverisë sonë.

Sukseset e deritanishme të popullit tonë, liria, pavarsia e atdheut,jeta e re që po bëhet nga viti në vit më e begatshme, u bënë të mundshme në saje të heroizmave tuaja, në saje të zotësisë suaj, në saje të udhëheqjes së urtë të Partisë sonë të Punës, organizatorës së lavdishme të të gjitha fitoreve të popullit tonë, në saje të ndihmës bujare dhe të përkrahjes së Bashkimit Sovjetik, në radhë të parë, dhe të vendeve të demokracisë popullore. Forca dhe uniteti i çelniktë i Partisë, lidhur ngushtë dhe përjetë me popullin, janë garancia e këtyre fitoreve dhe e fitoreve të ardhshme të popullit shqiptar. Asnjëherë si sot në historinë e popullit tonë nuk është parë një entuziazëm kaq i madh në popull, një patriotizëm kaq i lartë; asnjëherë nuk janë realizuar kaq vepra monumentale siç janë industria jonë moderne, bujqësia jonë që po përparon çdo ditë, zhvillimi i vrullshëm i arësimit në çdo kënd të atdheut, përhapja e kulturës dhe e artit në masat e gjera, ruajtja e shëndetit, përmirësimi i vazhdueshëm i jetës materiale dhe kulturale të popullit.

Për këto arësyje populli ynë e do dhe e ruan Partinë si driten e syrit.

Akoma më e bukur do të jetë e ardhshmja për

¹ Është fjala për Plenumin XII të KQ të PPSH.

Shqipërinë. Populli ynë, i mobilizuar në punë për ndërtimin e socializmit, e di se ato që janë bërë deri tani janë të mëdha, por s'janë të mjaftueshme, prandaj ai duhet të punojë akoma për të siguruar fitore të reja për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë.

Plenumi i fundit i Komitetit Qendror të Partisë vendosi detyrat që duhen kryer për vitin 1959, viti i katërt i planit të dytë pesëvjeçar, që do ta çojë atdheun tonë akoma më përpara.

Në vitin 1959 do të rritet vëllimi i përgjithshëm industrial 17 për qind më shumë, ndërsa prodhimi bujqësor — 26 për qind më shumë se në vitin 1958. Populli do të ketë më shumë prodhime bujqësore, do të shtohet veshmbathja, punonjësve do t'u jepen më shumë apartamente, do të shtohen shkollat, kinematë, teatrot, bibliotekat etj.

Prandaj, le të vëmë të gjitha forcat, dituritë dhe aftësitë tona, të mobilizohemi si gjithnjë e akoma më shumë, të forcojmë disiplinën dhe ndërgjegjen në punë, të ngremë çdo ditë asflësitë tona teknike, të ngremë rendimentin në punë, të ekonomizojmë dhe të ruajmë lekun e popullit, në mënyrë që 15-vjetori i çlirimit të na gjejë me duar plot dhe të kemi plotësuar me nder detyrat që na shtrohen përpara, për t'i bërë popullin dhe fëmijët e vendit tonë të lumtur.

Komiteti Qendror i Partisë, Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe qeveria jonë, duke iu drejtuar sot klasës punëtore, fshatarësisë punonjëse, intelektualëve, rinisë sonë, grave të Shqipërisë dhe gjithë popullit, janë të sigurtë dhe të bindur se nën udhëheqjen e Partisë sonë

të lavdishme ne do të korrim akoma dhe vazhdimisht suksese të mëdha.

Sihariqi më i madh për popullin tonë është projektplani i ri i tretë pesëvjeçar që u hartua nga Komiteti Qendror dhe nga qeveria jonë. Ky plan do ta bëjë vendin tonë më të begatshëm dhe jetën e popullit tonë më të bukur. Ky do të jetë një plan madhështor, që do të fuqizojë industrinë tonë, së cilës do t'i shtohet një numër i madh kombinatesh dhe fabrikash të reja.

Industria e naftës do të zgjerohet, do të zgjerohen gjithashtu edhe minierat e tjera, të cilat do t'i japin të ardhura shumë të mëdha ekonomisë sonë popullore. Do të vihen në shfrytëzim hidrocentralet e reja të Bistricës dhe të Shkopetit, do të zgjerohet dhe do të zhvillohet më tej industria e veshmbathjes dhe industria ushqimore, do të ngrihet për herë të parë në vendin tonë industria kimike, e cila do të ndihmojë bujqësinë që të shtojë prodhimet.

Bujqësia jonë socialiste, me mekanizimin e mëtejshëm, zgjerimin e sipërfaqeve të mbjella si rezultat i hapjes së tokave të reja, tharjen e kënetave dhe liqeneve, ndërtimin e kanaleve të mëdha vaditëse, do ta shtojë shumë prodhimin bujqësor, gjë që do të thotë të shtohen për popullin buka, mishi, qumshti, gjalpi, perimet, frutat etj. Arësimi, kultura, arti do të marrin një hov të madh. Popullit do t'i jepen me mijëra apartamente të reja.

Të gjitha këto do të realizohen se Partia jonë nuk e bën fjalën dy, se çdo gjë që ajo e vendos e realizon, sepse garancia e sigurtë e realizimit të këtyre detyrave madhështore qëndron në patriotizmin e lartë, në punën

heroike të masave tona punonjëse dhe në drejtësinë e vijës së Partisë sonë marksiste-leniniste.

Viti 1958, që mbaroi, ka qenë një vit përpjekjesh të vazhdueshme nga gjithë kampi socialist për forcimin e paqes në botë kundër përpjekjeve luftënxitëse të imperializmit. Në këto përpjekje fisnike ka dhënë kontributin e vet edhe Republika jonë Popullore, e cila vazhdimisht ka ndjekur dhe ndjek politikën e paqes dhe të miqësisë midis popujve. Gjatë vitit të ri 1959 ne do t'i shtojmë akoma më shumë përpjekjet tona, me qëllim që çështja e paqes të triumfojë mbi atë të luftës, që çështja e popujve që duan të rrojnë të lirë e të qetë të triumfojë mbi politikën sklavërucese dhe aggressive të qarqeve imperialiste, që kryesohej nga imperializmi amerikan. Por në të njëjtën kohë ne duhet të shtojmë vigjilencën revolucionare, të ruajmë lirinë dhe pavarësinë tonë, të bëjmë që të dështojë çdo intrigë e imperializmit dhe e shërbëtorëve të tij, revisionistëve jugosllavë, të cilët e kanë halë në sy popullin tonë dhe lirinë e tij.

Si pjesëtar i denjë i kampit të madh të socializmit, që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik, vendi ynë do të bëjë të gjitha përpjekjet edhe në të ardhshmen për të dhënë kontributin e tij në luftën për paqe dhe bashkëpunim midis popujve.

Të dashur shokë dhe shoqe,

Sukseset e ardhshme, të cilat do ta bëjnë vendin tonë më të pasur, më të fortë dhe më të bukur, mbështetën kurdoherë në punën tonë të vazhdueshme dhe

të palodhur për kapërcimin e vështirësive në realizimin e planit të pesëvjeçarit të dytë. Prandaj, viti 1959 bashkë me vitin 1960 le të jenë dy vjet suksesesh të mëtejshme në plotësimin e detyrave tona.

Nën udhëheqjen e drejtë të Partisë sonë marksiste-leniniste të Punës të vazhdojmë me hov punën ndërtimtare dhc le ta presim festën e madhe dhe të lavdishme të 15-vjetorit të çlirimit me fitore të reja, duke u mobilizuar i madh e i vogël për lulëzimin e atdheut tonë të shtrenjtë socialist.

Qofshi kurdoherë të gëzuar dhe të lumtur të gjithë ju dhe e gjithë familja e madhe socialiste e popullit tonë!

Rroftë populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë organizatorja e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

*Botuar për herë të parë në
gazeten «Zeri i Popullit».
Nr. 1 (3216), 1 janar 1959*

*Botohet me ndonjë shkurtim
sipas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

L E N D A

PARATHËNIE PËR VELLIMIN 16

V—VIII

1958

- «MBI PIKEPANJET ANTIMARKSISTE E ANTISO-CIALISTE QË U SHPREHËN EDHE NJË HERË NË KONGRESIN VII TË LIDHJES SË KOMUNISTËVE TË JUGOSLLAVISË E NË PROGRAMIN E SAJ DHE MBI LUFTËN PA KOMPROMIS QË DUHET BËRË PËR DEMASKIMIN E SHKATËRRIMIN POLITIK E TEORIK TË REVIZIONIZMIT MODERN» — Raport i mbajtur në Plenumin X të KQ të PPSH (20 qershor 1958) 1—24
- MBI ZHVILLIMIN E PUNIMEVE TË MBLEDHJES SË PËRFAQËSUESVE TË PARTIVE KOMUNISTE DHE PUNËTORE TË VENDEVE SOCIALISTE QË U MBAJT NË MOSKË NGA 20-24 MAJ 1958 — Nga raporti i mbajtur në Plenumin X të KQ të PPSH (20 qershor 1958) 25—31
- FJALA E MBAJTUR NË SESIONIN I TË LEGJIS-LATURES SË KATËRT TË KUVENDIT POPULLOR (21 qershor 1958) 32—39

REVIZIONIZMI MODERN DUHET LUFTUAR PA MËSHIRE DERI NË SHKATËRRIMIN E TIJ TË PLOTË TEORIK E POLITIK (22 qershori 1958)	40—50
POPULLI SHQIPTAR ëSHTë I LASHTË NGA MO- SHA, POR KURDOHERË I RI NGA ZEMRA — Fjala në takimin e parë zyrtar me delegacionin qeveritar çekoslovak (24 qershori 1958)	60—73
FJALA E MBAJTUR NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA ÇEKOSLOVAKË NË TIRANË (28 qershori 1958)	74—80
FJALA E MBAJTUR NË MITINGUN E ORGANI- ZUAR NË TIRANË PËR NDER TË DELEGACIONIT QEVERTAR ÇEKOSLOVAK QË KA ARDHUR NË VENDIN TONË (29 qershori 1958)	81—91
TË MENDOJMË E TË VEPROJMË VAZHDIMISHT PËR PËRMIRESIMIN E MËTEJSHËM TË METODËS SË PUNËS UDHËHEQËSE TË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (3 korrik 1958)	92—108
TELEGRAM NGUSHULLIMI DËRGUAR KQ TË PK FRANCEZE ME RASTIN E VDEKJES SË FREDERIK ZHOLIO KYRISË (17 gusht 1958)	109
GUR THEMELTAR I FITOREVE (6 shtator 1958) ..	110—115
NGA FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBA- SADA BULLGARE NË TIRANË ME RASTIN E	

14-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË BULLGARISË (9 shtator 1958)	116—121
MBI DISA MASA PËR PËRMIRESIMIN E PUNËS SË KËSHILLAVE POPULLORE TË LOKALITETEVE (16 shtator 1958)	122—124
ORIENTIME KRYESORE QË DUHEN MARRE SI BAZË PËR HARTIMIN E PLANIT TË TRETE PESË- VJEÇAR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (17 shtator 1958)	125—142
TË AKTIVIZOJMË MË MIRE ANETARËT E PLE- NUMEVE TË KOMITETEVE TË PARTISE — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (24 shtator 1958)	143—148
TË MERREN TË GJITHA MASAT POLITIKO-ORGAN- IZATIVE DHE TEKNIKE PËR TË PËRFUNDUAR BONIFIKIMIN E THUMANËS — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 shtator 1958)	149—152
ZHVILLIMI I KULTURES DHE I ARTIT KËRKON NJË ORGANIZIM DHE DREJTIM MË TË MIRE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 shtator 1958)	153—155
FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA KINEZE NË TIRANË ME RASTIN E 9-VJETORIT TË THEMELIMIT TË RP TË KINËS (1 tetor 1958) ..	156—165
TA ZHVILLOJMË BLEGTORINË MBI BAZA SHKEN-	

CORE — Nga fjala në takimin me kooperativistët e Dukajt të rrethit të Tepelenës (4 tetor 1958)	166—168
ARËSIMTARI TA EDUKOJË RININË QË AJO TË MOS U TREMBET VËSHTIRËSIVE — Nga fjala në takimin me arësimtarët e shkollës 7-vjeçare «Abaz Shehu» të Tepelenës (4 tetor 1958)	169—171
NGA FJALA ME PUNONJËSIT E MINIERËS SË QYMYRGURIT NË MEMALIAJ (4 tetor 1958)	172—174
RRITJA E NORMAVE SJELL RRITJEN E TË AR-DHURAVE — Nga biseda në takimin me kooperativistët e Katalit të Përmetit (5 tetor 1958)	175—177
TË RRITET GJITHMONË E MË SHUMË ROLI UDHE-HEQËS I PARTISË NË USHTRI — Nga fjala në takimin me ushtarët dhe me oficerët e repartit të Përmetit (5 tetor 1958)	178—180
BONIFIKIMI DHE HAPJA E TOKAVE TË REJA — REZERVA TË MËDHA PËR EKONOMINË TONË — Nga fjala në takimin me kooperativistët e Statorës së Beratit (6 tetor 1958)	181—182
DISA POROSI DHËNË SEKRETAREVE TË ORGANIZATAVE TË PARTISË E KRYETAREVE TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE TË ZONAVE MALORE TË BERATIT (7 tetor 1958)	183—186
ARËSIMTARËT TANË DUHET T'I NDIHMOJNË FAMILJET QË EDHE ATO TË KUJDESEN PËR EDUKIMIN E FËMIJËVE — Nga fjala në takimin me	

arësimtarët e shkollave të mesme të qytetit të Beratit (7 tetor 1958)	187—189
FJALA NË CEREMONINË E DHËNIES SË TITULLIT «HERO I PUNËS SOCIALISTE» ME RASTIN E 50-VJETORIT TË DITËLINDJES (15 tetor 1958)	190—195
FALENDERIM DREJTUAR GJITHË ATYRE QË I DËRGUAN URIME ME RASTIN E 50-VJETORIT TË DITËLINDJES (20 tetor 1958)	196—197
PARTIA JONË ËSHTË E PASTËR SE AJO NUK E KA PUSHUAR KURRË LUFTËN KUNDËR REV- ZIONIZMIT — Nga biseda në takimin me dy shokë të PK të Finlandës (27 tetor 1958)	198—229
ME FORCAT TONA, TË SIGUROJMË PËR POPU- LLIN MË SHUMË MISH DHE QUMËSHT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (28 tetor 1958)	230—233
PARTIA JONË ËSHTË KALITUR NË LUFTË ME VËSHTIRËSITË — Nga biseda në takimin me dy shokë të PK të Indonezisë (30 tetor 1958)	234—268
MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJEVE TË PLENUMEVE TË KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETËHEVE — Letër dërguar komitetev të Partisë të rretheve (31 tetor 1958)	269—277
MBI MASAT QË DUHEN MARRË PËR SHTIMIN ME RITËM MË TË SHPEJTË TË PRODHIMIT TË MISHIT DHE TË QUMSHTIT — Raport i mbajtur në Plenumin XI të KQ të PPSH (3 nëntor 1958)	278—395

FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA SOVJETIKE NË TIRANË ME RASTIN E 41-VJETORIT TË REVOLUCIONIT SOCIALIST TË TETORIT (7 nëntor 1958)	396—405
SHËNIM NË LIBRIN E PËRSHTYPJEVE TË EKSPozITËS SË PRODHIMEVE TË REJA TË UZINES «ENVER» (8 nëntor 1958)	406
MËMA SHQIPËRI I KA DASHUR, I DO DHE DO T'I DOJË ATA BIJ TË SAJ QË NË ZEMRAT E TYRE RUAJNË ZJARRIN E DASHURISË PËR TË — Letër falenderimi dërguar përfaqësuesve të Shoqërisë Patriotike «Skënderbeu» në Argjentinë (12 nëntor 1958) ..	407—408
TË MERREN MASA KONKRETE PËR ZHVILLIMIN E PESHKIMIT — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (13 nëntor 1958)	409—411
SHTIMIN E MISHIT E TË QUMSHTIT TA BËJMË PROBLEM TË TË GJITHA MASAVE PUNONJËSE — Nga fjala në aktivin e Partisë të rrëthit të Korçës (22 nëntor 1958)	412—421
ARËSIMTARI DUHET TË BËJË PUNË TË GJITHANSHME ME MASAT E FSHATIT — Nga fjala në takimin me punonjësit e arësimtë të rrëthit të Korçës (24 nëntor 1958)	422—424
FESTAT E ÇLIRIMIT DHE PATRIOTËT TANË (Nëntor 1958)	425—428
LETËR ARËSIMTARIT THOMA PAPAPANO KU	

- PËRGËZOHET PËR NGRITJEN E MUZEUT TË SHKOLLËS SË PARË SHQIPE NË QYTETIN E GJIROKASTRËS (3 dhjetor 1958) 429
- LETËR QYTETARES ÇEKOSLLOVAKË NEUMANOVË (4 dhjetor 1958) 430—431
- LETËR DËRGUAR KOMITETEVE TË PARTISË NË RRETË MBI DOBËSITË DHE TË METAT NË KOOPERATIVËN BUJQËSORE TË KRUTJES SË POSHTME (11 dhjetor 1958) 432—438
- TË PREOKUPOHEMI MË SHUMË PËR MBROJTJEN E PASURISË SOCIALISTE — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (24 dhjetor 1958) 439—443
- TË FORCOHET PUNA E PARTISË NË REPARTET E KUFIRIT — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (24 dhjetor 1958) 444—446
- PËRMIRESIMIN E METODËS SË PUNËS TA KËRKOJMË NË RADHË TË PARË NGA VETJA JONË SI SEKRETARIAT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (24 dhjetor 1958) 447—456
- PROBLEMET T'I TRAJTOJMË NË NJË FRYMË MË KRITIKE — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 dhjetor 1958) 457—460
- ORGANET DREJTUESE TË PARTISË E TË SHTETIT TË FORCOJNË MË SHUMË NDIHMËN DHE KONTROLLIN PËR ZBATIMIN E PLANIT — Fjala

-
- e mbylljes në Plenumin XII të KQ të PPSH
(27 dhjetor 1958) 461—480
- MESAZH DREJTUAR POPULLIT ME ANË TË RADIOS ME RASTIN E VITIT TË RI (31 dhjetor 1958) 481—486

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NENTORI» — Tiranë, 1973